

ENVER HOXHA

VEPRA

37

PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!

ENVER HOXHA

VEPRA

BOTOHET ME VENDIM TE KOMITETIT
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE
SHQIPERISE



ENVER HOXHA

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH

ENVER HOXHA

VËLLIMI

37

NËNTOR 1967 — PRILL 1968

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»
TIRANË, 1982

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 37-TË

Vëllimi i 37-të i Veprave të shokut Enver Hoxha përfshin materiale të periudhës nëntor 1967-prill 1968, një pjesë e të cilave botohen për herë të parë.

Në këtë vëllim pasqyrohen përpjekjet e komunistëve dhe të masave punonjëse për të vënë në jetë vendimet historike të Kongresit të 5-të të Partisë lidhur me revolucionarizimin e mëtejshëm të vetë Partisë, të pushtetit dhe të gjithë jetës së vendit.

Një vend të rëndësishëm në materialet e këtij vëllimi zë trajtimi shkencor i problemeve të ekonomisë sonë socialiste për realizimin me sukses të planit të katërt pesëvjeçar.

Në këtë periudhë luftime e përpjekjesh shoku Enver Hoxha trajton, zbërthen e thëllon më tej mjaft probleme të rëndësishme teorike e praktike, siç janë rëndësia e luftës për ruajtjen e pastërtisë së radhëve të Partisë dhe për zbatimin e normave leniniste të saj, lartësimi i figurës së komunistit, forcimi i unitetit Parti-popull, roli historik i masave në revolucion dhe në ndërtimin e shoqërisë socialiste, nevoja e kalitjes ideologjike të kuadrove, rëndësia e përvetësimit dhe e zbatimit të mësimëve të marksizëm-leninizmit etj.

Një kontribut të rëndësishëm për zhvillimin e pandalshëm të revolucionit socialist dhe për forcimin e

diktaturës së proletariatit përbën fjala e mbajtur në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH, më 9 prill 1968 «Kontrolli i klasës punëtore». Në të trajtohen probleme të edukimit politik e ideologjik të klasës punëtore, të kuptimit të drejtë e joformal të kontrollit të klasës punëtore, të rëndësisë së tij dhe të luftës kundër burokratizmit. Në të autori thekson rëndësinë teorike e praktike për realizimin në mënyrë revolucionare të kontrollit efektiv të klasës punëtore në të gjithë sektorët e fushat e jetës së vendit. «Udhëheqja e kontrolli nga ana e klasës punëtore dhe e Partisë, — thekson shoku Enver, — mbi çdo gjë dhe mbi këdo, mbi kuadrot, forumet, administratat, komisionet, duhet të jenë të plotë, pa të çara, vendimtarë». Mësimet që dëlnin nga ky fjalim u bënë një armë e fuqishme për ngritjen e nivelit ideologjik e politik të klasës punëtore në radhë të parë, duke e bërë atë edhe më të ndërgjegjshme e më të aftë për të luajtur më me efikasitet rolin udhëheqës në tërë jetën e vendit.

Në bazë të orientimeve të Kongresit të 5-të detyra të mëdha i dëlnin përpara edhe shkollës sonë. Në fjalimin historik «Për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë», mbajtur në mbledhjen e Byrosë Politike më 7 mars 1968, shtrohen, nga pozitat materialiste dialektike, problemet themelore të shkollës në kushtet e reja të ndërtimit të socializmit në vendin tonë. Në të zërthehen detyrat themelore të shkollës sonë në etapën e re të ndërtimit të plotë të socializmit, shtrohet domosdoshmëria e kryerjes së një hopi të madh cilësor përpara në shkollën tonë, duke përcaktuar drejt dhe me kujdes parimet e rrugët nëpër të

cilat do të kalojnë procesi revolucionarizues i saj. Theksi vihet në atë që «shkolla jonë e re socialiste duhet të përshkohet dhe të udhëhiqet fund e krye, në çdo gjë, nga filozofia jonë materialiste», si dhe në nevojën e domosdoshme të lidhjes së shkollës me jetën, të teorisë me praktikën, të ideve me veprimet, me punën dhe luftën revolucionare për ndërtimin e socializmit e mbrojtjen e atdheut.

Në këtë vëllim botohen edhe mjaft dokumente ku trajtohen probleme të lëvizjes marksiste-leniniste dhe vihet theksi te domosdoshmëria e forcimit të luftës kundër imperializmit dhe revizionizmit modern, kundër aleancave midis imperializmit amerikan, social-imperializmit sovjetik e të gjitha forcave reaksionare.

Në diskutimin shumë të rëndësishëm të mbajtur në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH, «Analizat marksiste-leniniste të partive komuniste dhe punëtore janë thesar i madh për lëvizjen komuniste botërore», mbajtur më 7 mars 1968, trajtohen dhe analizohen në mënyrë shkencore çështja e studimit të përvojës marksiste-leniniste të partive komuniste si dhe e shkaqeve të vërteta që sollën lindjen e revizionizmit. Duke vlerësuar zbatimin konsekuent të marksizëm-leninizmit nga çdo parti, jashtë pikëpamjeve antimarksisiste, «parti e madhe», «parti e vogël» do të nxirren konkluzione që do t'u shërbejnë partive marksiste-leniniste aktualisht dhe në perspektivë.

Në artikullin «Një krizë e thellë e gjithanshme po trondit botën kapitaliste» etj., trajtohen probleme të revolucionit proletar dhe të diktaturës së proletariatit, të rolit të klasës punëtore dhe të partisë së vërtetë

komuniste për shpërthimin dhe triumfin e revolucionit, për ndërtimin e shoqërisë pa klasa shfrytëzuese.

Në disa materiale të këtij vëllimi pasqyrohet lufta kundër revizionizmit hrushovian. Në to bëhet demaskimi i qëllimeve antimarksiste e antirevolucionare të revizionistëve hrushovianë, tregohet zhvillimi i situatave drejt pjekjes së kushteve për revolucion dhe hapen perspektiva për luftën që duhet të bëjë klasa punëtore, për të dalë nga gjendja ku e çuan revizionistët, duke u kalitur nëpërmjet aksionit revolucionar. Këto analizohen shkencërisht në artikullin «Klasa punëtore në vendet revizioniste duhet të zbresë në fushën e betejës dhe të rivendosë diktaturën e proletariatit». Shumë artikuj të tjerë kanë si objekt ngjarjet e fillimit të vitit 1968, sidomos në Evropën Qendrore, e veçanërisht në Çekoslllovakë. Duke dhënë një tablo të qartë të ngjarjeve dhe të situatave, autori zbulon rrënjët e këtij kaosi në stanin revizionist, që s'ishte gjë tjetër veç rrjedhim logjik i ideologjisë dhe i politikës kundërrevolucionare të revizionistëve hrushovianë sovjetikë e vasalëve të tyre. Shoku Enver paralajmëron se pas presioneve të shumta politike të revizionistëve hrushovianë do të vinin pasoja të tjera më të rënda, të cilat u vërtetuan disa muaj më vonë me futjen e tankeve sovjetike në Çekoslllovakë.

Qëndrimi vigjilent dhe i vendosur i Partisë sonë përballë kërcënimeve dhe bllokadës së revizionistëve hrushovianë nxjerr më së miri në pah drejtësinë e vijës marksiste-leniniste të Partisë.

Në materialet e këtij vëllimi, pasqyrohet edhe lufta parimore e Partisë sonë kundër titizmit, kësaj

agjente të imperializmit në gjirin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Në artikujt «Demagogjia titiste nuk mund t'i mbulojë plagët e hapëta të Kosovës» dhe «Terrorizimi i popullsisë shqiptare — politikë e përhershme e klikës titiste» zbulohen, në dritën e tyre të vërtetë, qëndrimet armiqësore e shkombëtarizuese të titistëve.

Nga ana tjetër, duke pasur parasysh edhe gjendjen në Kinë shprehen rezerva ndaj qëndrimeve të dyshimta e inkonsekuente të PK të Kinës.

Materialet e këtij vëllimi, me analizën e thellë marksiste-leniniste të fenomeneve, me shikimin në dialektikën e tyre, me vlerësimin dhe ndriçimin e qartë e largpamës të situatave dhe me vlerat aktuale, do t'u shërbejnë komunistëve, klasës punëtore dhe gjithë popullit tonë si një frymëzim për suksese të reja në rrugën e ndërtimit të plotë të socializmit në vendin tonë.

**PRODHIMI VARET KRYESISHT NGA
FAKTORI NJERI, NGA DITURIA, ZOTËSIA
DHE VENDOSMËRIA E TIJ**

*Fjala në takim me kooperativistët e kooperativave
bujqësore «Shkëndija»¹ e të Gostimës
në rrethin e Elbasanit*

3 nëntor 1967

Të dashura shoqe dhe shokë kooperativistë të kooperativave «Shkëndija» dhe të Gostimës,

Sot për ju është një ditë e gëzuar, sepse grave të kooperativës suaj u dorëzohet flamuri i Kongresit të Bashkimit të Grave të Shqipërisë, që u mbajt ditët e fundit në Tiranë.

Ky është një vlerësim i madh që i bëhet punës suaj e, në mënyrë të veçantë, grave. Kjo ngjarje duhet të bëhet nxitje për të gjitha kooperativat e rrethit tuaj, që në të ardhmen të arrihen kudo suksese akoma më të mëdha në luftën e Partisë dhe të popullit për këtë çështje kaq të mprehtë për ne, për çlirimin e plotë të gruas shqiptare nga prangat e paragjyqimeve të vjetra prapanike.

Fjalimin tim e fillova me fjalët për flamurin që morët ju, duke i lënë për më pas çështjet e zhvillimit të ekonomisë sonë. Përse e bëj këtë? Partia na mëson

1 Kooperativa bujqësore e Shtërmenit.

që ekonomia ka rëndësi të madhe, por atë e ndërtojnë dhe e çojnë përpara njerëzit, mendja, forca dhe zotësia e tyre. Kjo do të thotë se sa më të përparuar të jenë njerëzit, aq më e përparuar do të jetë ekonomia, aq më e bukur do të bëhet jeta e tyre. Por ka përparim e përparim. Përparim në zhvillimin e teknikës e të shkencës ka edhe në vendet kapitaliste e revizioniste, por frytet e tij shkojnë në favor të një grupi njerëzish, të të pasurve, të shfrytëzuesve, siç i kemi pasur edhe në vendin tonë para Çlirimit. Ka pastaj përparim, si në vendin tonë, që bëhet në favor të të gjitha masave të popullit. Mjaft vende kapitaliste e revizioniste mund të kenë një teknikë e industri më të zhvilluar, po përparimi te ne është shumë më i madh, është një përparim i vërtetë shoqëror, që mishërohet në faktin se njerëzit në vendin tonë janë të edukuar me botëkuptimin revolucionar, kanë pikëpamje ideologjike dhe politike përparimtare, revolucionare. Kurse në vendet kapitaliste e revizioniste, klasat sunduese, kleri etj. jo vetëm i shfrytëzojnë masat ekonomikisht, por edhe përpiqen t'i mbajnë në errësirë, në padituri, të pengojnë ngritjen e tyre ideologjike e politike, t'i degjenerojnë ato moralisht. Populli ynë, që kishte punuar e kishte vuajtur tërë jetën nën thundrën e armiqve të klasës, të cilët mbytnin me gjak luftën e tij dhe e kishin lënë në varfëri, në sëmundje e në padituri, pas Luftës Nacionalçlirimtare i përmbysi bejlerët, agallarët, fajdexhinjtë e spekulatorët dhe mori vetë pushtetin në dorë. Revolucioni popullor, i udhëhequr nga Partia, i futi armiqtë thellë në gropë, që kurrë të mos e ngrenë kokën.

Populli ynë, që bejlerët dhe agallarët e quanin xhahil, i ndriçuar nga idetë revolucionare marksiste-leniniste të Partisë, nën udhëheqjen e saj, gjatë këtyre njëzet e ca vjetëve, ka bërë mrekulli. Për të gjitha ato vepra që ka realizuar populli shqiptar gjatë më pak se një çerek shekulli, vendeve të tjera u janë dashur me qindra vjet. Atje ku akoma sundon kapitali, masat e proletariatit dhe të fshatarësisë, të cilat ruhet e gjallë ndjenja e lirisë, fryma revolucionare, nuk i kanë mundësitë për të plotësuar dëshirën e tyre për mësim e përparim. Ndryshe ndodh në vendin tonë, ku janë krijuar të gjitha mundësitë për të ecur përpara, sepse njerëzit e kanë fituar lirinë dhe pavarësinë e atdheut dhe kanë vendosur demokracinë popullore. Në vendin tonë populli punon për ndërtimin e socializmit dhe për të siguruar mirëqenien materiale e kulturore për vete dhe për brezat e ardhshëm. I lirë dhe i pavarur, nën udhëheqjen e Partisë, ai po zhvillon me vrull ekonominë e vendit. Gjatë këtyre njëzet e tre vjetëve dhe sidomos në këto vitet e fundit, ky zhvillim ka marrë një hov të paparë.

Të gjitha këto suksese të pakrahasueshme me të kaluarën, nesër, të dashur vëllezër dhe motra, do të na duken të vogla, sepse në të ardhmen do të jemi në gjendje të bëjmë gjëra më të mëdha dhe do të arrijmë të kuptojmë më mirë rëndësinë e zgjidhjes së shpejtë të problemeve, në mënyra dhe në forma që do të na ndihmojnë për t'i çuar punët përpara edhe më shpejt. Dhe kësaj do t'ia arrijmë, se Partia ka hapur shkolla në të katër anët, ajo po mëson të mëdhenj e të vegjël për t'i bërë të ndërgjegjshëm

përse punojmë dhe djersitim. Që të arrijmë sa më shpejt qëllimin tonë, secili duhet t'i hyjë punës së vet thellë, deri në palcë, t'ia dijë mirë të gjitha anët e të fshehtat. Partia punon për këtë dhe po i përgatit si duhet njerëzit, sidomos brezin e ri që do të marrë në duar stafetën e revolucionit dhe do të sigurojë një të ardhme akoma më të mirë për atdheun.

Këto nuk janë ëndrra, motra dhe vëllezër, por ky është realiteti ynë i gjallë, që e krijuam nën udhëheqjen e Partisë, me vijën e saj të drejtë marksiste-leniniste, e cila sintetizon dëshirat e popullit. Ky realitet do të bëhet akoma më i mirë në sajë të zotësisë dhe të mençurisë së masave tona punonjëse.

Populli ynë po e kupton gjithnjë e më mirë vijën e drejtë të Partisë, po e kupton gjithnjë e më shumë se realizimi i çdo detyre të ne sigurohet nëpërmjet zbatimit dhe mbrojtjes së kësaj vije marksiste-leniniste. Ndoshta jo të gjithë e zotërojnë marksizëm-leninizmin nga ana teorike, por sot, edhe njeriu më i thjeshtë në vendin tonë, nga praktika e luftës dhe e ndërtimit socialist, e kupton se marksizëm-leninizmi është ajo filozofi e thellë dhe fitimtare që e bën të ndërgjegjshme klasën punëtore për forcën e saj të pamposhtur, për rolin e saj udhëheqës në aleancë me fshatarësinë, që ndriçon rrugën drejt komunizmit. Marksizëm-leninizmi përfaqëson sintezën shkencore të mendimeve, të dëshirave, të vuajtjeve dhe të përpjekjeve për përparim e jetë të lumtur të të gjithë njerëzimit. Këto ide të mëdha i kanë hedhur në letër mësuesit tanë të mëdhenj Marksi, Engelsi, Lenini, Stalini, ato i ka përvetësuar dhe i ka zhvilluar më tej në ku-

shtet e Shqipërisë Partia jonë. Këto ide janë ligje që punëtorët dhe fshatarët tanë po i vënë në jetë me sukses.

Kështu, të pajisur me vijën e drejtë të Partisë sonë të lavdishme heroike, ne jemi në gjendje të krijojmë çdo gjë. Të mirat materiale e shpirtërore i krijojnë njerëzit, që nga i riu e gjer te plaku me flokë të bardhë, burrat e gratë dhe shoqëria ecën përpara vetëm me përpjekjet e përbashkëta të tyre. Prandaj të çohen në këmbë të gjithë së bashku për zbatimin sa më mirë në jetë të vijës së drejtë të Partisë, t'i kuptojnë problemet njëllor, të duhen me njëri-tjetrin dhe kështu të bashkuar të ecin përpara.

Në këtë drejtim në vendin tonë po zhvillohet një luftë e pandërprerë, të cilën Partia jonë e ka filluar që në kohën e pushtimit, kur komunistët u hodhën të parët me armë në dorë dhe pas tyre dolën partizanë vëllezërit dhe motrat tona. Në Luftën Nacionalçlirimtare morët pjesë edhe ju, nëna dhe motra, që, ashtu si burrat e vëllezërit tuaj, u bëtë ballë hordhive të pushtuesve dhe egërsive të bejlerëve, të agallarëve, të banditëve si Xhaf Bali me shokë, që ju digjnin, ju vritnin e ju grabitnin shtëpinë e katandinë. Kasollet tuaja u bënë foleja dhe ju u bëtë mbështetja jonë. Pa ju, nëna dhe motra, që qëndruat dhe u rezistuat armiqtë, nuk mund të fitohej Lufta Nacionalçlirimtare, që ishte luftë e gjithë popullit tonë, e burrave dhe e grave.

Lufta për çlirimin e gruas apo, siç i themi në gjuhën politike, «emancipimi i gruas» është një problem i vjetër për Partinë, që çdo vit ka marrë një kuptim gjithnjë e më të thellë. Partia bëri që energjitë e grave të shpërthejnë fuqishëm. Gruaja shqip-

tare e qyletit dhe e fshatit sot është hedhur e tëra në punë, në fabrika, në uzina, në ndërtim, në ara, në shkolla dhe në institucione kulturore. Por gjatë këtij hovi të madh, Partia vërejti se kishte akoma disa gjëra që na pengonin, disa mbeturina dhe sjellje që e poshtëronin dhe e nënvleftësonin gruan. Atëherë Partia filloi luftën kundër zakoneve prapanike që ekzistojnë më shumë te burrat, por që e drejta është të themi se ekzistojnë edhe te gratë. Prandaj, të gjithë së bashku, të përpigemi të pastrojmë ndërgjegjen çdo ditë me fshesë të madhe nga këto mbeturina, të cilat, duhet ta kuptojmë, nuk zhduken menjëherë. Edhe ai që kujton se i ka hedhur tej, po t'i bëjë analizën vetes, do të shohë se diku, në ndërgjegjen e tij, do t'i ketë mbetur ndonjë çikë pluhur. Në qoftë se ka njeri që e heq veten si luftëtar për lirinë e popullit, ndërsa gruan e konsideron sklave, ai as vetë nuk mund të jetë i lirë.

Që ta quajmë veten të lirë, duhet të punojmë që edhe gruaja të jetë e lirë, të mos vuajë nga asnjë shtypje nga ana e burrit. Kjo nuk duhet parë si një çështje e ngushtë familjare. Ka njerëz, edhe në vendin tonë, që në shoqëri hiqen si shumë përparimtarë, po në familje nuk sillen drejt ndaj shoqeve dhe motrave të tyre. Nuk është aspak i mirë një qëndrim i tillë. Por ka edhe gra që dashurinë, lidhjet familjare, nuk i kuptojnë në rrugë të drejtë. Zakonisht gruaja është më e sjellshme se burri, zemra e saj është e pastër dhe përpigjet të mos ia prishë qejfin atij. Kjo është një gjë e mirë, por ajo, gjithashtu, duhet të kërkojë që edhe burri ta respektojë dhe ta dojë atë.

Gruaja ndjenjat e pastra të dashurisë ndaj burrit nuk duhet t'i ngatërrojë me përruljen para tij. Burri është për gruan shoku i jetës, me të ajo lind e rrit fëmijët dhe ndërton jetën e lumtur në familje. Edhe sikur ai të jetë më i zoti se gruaja për disa gjëra, kjo e fundit nuk duhet t'i bëjë lëshime kur ai nuk ka të drejtë. Gruaja mund të jetë më mbrapa në disa drejtime për shkakët që dihen, po duke u ndihmuar dhe duke iu dhënë mundësitë, ajo mund të bëhet e aftë si edhe burri. Partia punon që ajo të ecë përpara në çdo drejtim, por për këtë duhet ta ndihmojnë edhe burri e fëmijët e saj.

Nuk është aspak e pëlqyeshme që burri dhe gruaja të futen në grindje, përkundrazi, ata duhet të forcojnë marrëdhëniet, duke e dashur dhe duke e respektuar njëri-tjetrin, duke çelikosur unitetin në familje me mendimet e tyre, me përpjekjet e tyre, me dashurinë e tyre për atdheun dhe për Partinë, me dashurinë dhe kujdesin e përbashkët për fëmijët. Po të ecet në këtë mënyrë, në familje nuk ka për të pasur grindje, por miqësi të shëndoshë. Prandaj të bëjmë përpjekje të mëdha për të zhdukur nga mendja pikëpamjet e palejueshme për gruan në jetën tonë shoqërore, në punë dhe në familje.

Ndërgjegjen e njerëzve tanë, pikëpamjet e tyre për jetën familjare ashtu dhe atë shoqërore i ka helmuar dhe i ka ngatërruar shumë feja. Feja është një gënjeshtër e madhe, motra dhe vëllezër, me të cilën klerikët kanë mashtruar popullin për shekuj të tërë. Ju keni lindur dhe po jetoni këtu në fshat, por tani e kuptoni mirë se varfërimi i fshatarëve në të

kaluarën vinte nga shfrytëzimi i klasave feudale dhe kapitaliste. Gjithashtu ju po e shihni me sytë tuaj se lulëzimin e tanishëm të jetës së re nuk e solli as perëndia, as hoxha apo prifti, që majmeshin në kurrrizin tuaj, por socializmi, e solli forca juaj nën drejtimin e Partisë. Pikërisht kjo forcë dhe vija e drejtë e Partisë, që ju përqaftuat dhe zbatuat, dhe jo «fryma e shenjtë», bënë që kooperativa «Shkëndija» të realizojë dhe të tejkalojë të gjitha planet e prodhimeve bujqësore dhe që ju të merrni këtë vit më shumë prodhim në grurë, misër, duhan, pambuk, oriz etj. Të gjitha këto të mira i solli, pra, rruga e kolektivizimit që ju këshilloi Partia të ndiqnit.

Kolektivizimi, vëllezër dhe motra, siç kanë thënë Lenini dhe Stalini, është rruga shpëtimtare për fshatarësinë, është forma më e përshtatshme për ndërtimin e socializmit në fshat. Pa kolektivizimin nuk mund të ecte përpara revolucioni ynë, nuk mund të krijohet bollëku, nuk mund të revolucionarizohen mendjet e njerëzve, nuk mund të arrihet, ashtu siç do Partia, çlirimi i plotë i njeriut nga të gjitha mbeturinat e këqija të së kaluarës, brumosja e njerëzve të rinj me mendime, me qëllime dhe ideale të reja, me arsim dhe kulturë me një përmbajtje të lartë ideologjike dhe politike.

Më parë thoshin se fshatarët nuk mësojnë dot. Kjo ishte një parullë krejt e gënjeshtërt, që feudalët dhe kapitalistët e përdornin për t'i mbajtur fshatarët përjetë në errësirë dhe të nënshtruar. Shembull i shkëlqyer që e hedh poshtë këtë mendim reaksionar është sot edhe kooperativa juaj, anëtarët e së cilës

jo vetëm kanë mësuar në shkollat që kanë ndjekur, por edhe kanë dalë me rezultate nga më të mirat. Shumë nga bijat dhe bijtë tuaj kanë kryer shkollë të mesme dhe të lartë, disa janë bërë mjekë, të tjerë agronomë, inxhinierë, një pjesë më të rinj janë duke vazhduar shkollat dhe do të marrin profesione të ndryshme. Kështu, nga ky fshat, i shtypur në të kaluarën, kanë dalë vajza e djem të zotë që jo vetëm drejtojnë kooperativën tuaj, por kanë zënë vende të rëndësishme në aparatet e Partisë, të pushtetit e të ekonomisë, në të katër anët e Shqipërisë. Ja si kanë ndryshuar punët që nga koha kur u përmbysën borjezët, bejlerët e agallarët në vendin tonë.

Puna e madhe e Partisë i ka edukuar njerëzit tanë të socializmit që të mos mendojnë vetëm për veten e tyre. Përpara, kushtet ekonomike e shoqërore kishin rrënjosur të njerëzit shumë pikëpamje individualiste, ata mendonin dhe punonin vetëm për familjen e vet, për tokën e vet, për kalamanët e vet. Kurse në socializëm çdonjëri është i bashkuar me lidhje të forta me jetën e tërë kolektivit, me prodhimin e përbashkët. Të gjithë ju tani mendoni se në vendin tonë ne jemi si një familje e madhe, prandaj po punoni me një hov e vrull të madh, se e kuptoni që nuk jeni vetëm, se jeni lidhur ngushtë me qytetin dhe me gjithë Shqipërinë. Ju i jepni bukë qytetit, por edhe klasa punëtore ju dërgon juve mekanizma, traktorë, vegla të ndryshme bujqësore, vajguri, kripë e sa e sa prodhime të tjera industriale të nevojshme për jetesën tuaj. Të gjithë te ne mendojnë për një dhe secili mendon për të gjithë. E gjithë kjo forcë e madhe

që është krijuar në vendin tonë, të gjitha këto fabrika e miniera, arat që lulëzojnë, i bënë duart e arta të klasës punëtore, puna e palodhur e fshatarësisë sonë punonjëse, pa të cilën nuk mund të siguroheshin tërë këto pasuri të mëdha, të sistemoheshin arat, të hapeshin kanale kulluese dhe ujitëse, gjatësia e të cilave shtohet gjithnjë e më shumë nga viti në vit. Por Partia na mëson dhe na këshillon që kurrë të mos qëndrojmë në vend, të mos kënaqemi me ato që kemi bërë, por, duke u mbështetur në sukseset e arritura, të ecim gjithnjë më përpara, për të korrur fitore më të mëdha në çdo sektor. Mundësitë për këtë i kemi, sepse na udhëheq e sigurt për fitore Partia.

Ju thoni me të drejtë «Rroftë Partia», «Rroftë pushteti popullor» për këto që po bëjnë për fshatarësinë. Por Partia dhe pushteti nuk qëndrojnë në hava, ata kanë dalë nga gjiri juaj, ju jeni rrënjët e shëndosha të tyre, njerëzit e Partisë dhe të pushtetit kanë dalë nga populli, nga familja jonë e madhe socialiste.

Partia ju këshilloi të organizoheni në kooperativa, ju e dëgjuat fjalën e saj dhe s'kaloi shumë kohë dhe patë që kjo ishte një punë e bukur. Në këtë punë dhe jetë të përbashkët ju keni mësuar shumë gjëra, por Partia tani na thotë të mësojmë çdo ditë e më shumë, se dituritë që keni fituar janë akoma të pakta, prandaj të bëjmë përpjekje që t'i zgjerojmë ato. Pra, edhe nga kooperativa juaj, ashtu si dhe nga gjithë kooperativat e Shqipërisë, nga gjithë ndërmarrjet e ndryshme, fshatrat dhe institucionet e vendit tonë, kërkojen njerëz të mësuar, që të shohin larg, që t'i shqyrtojnë problemet gjer në fund, të bëjnë propo-

zime dhe punë konkrete të dobishme në çdo fushë. Por dituria nuk merret vetëm në shkolla, por edhe në kurse, në ara, në fabrika e uzina, në praktikë. Një-riu me shkollë nuk duhet ta heqë veten sikur i di të gjitha dhe të mendojë sikur ai që punon në arë ose në fabrikë nuk di gjëkafshë. Kjo s'është e vërtetë, të dy palët dinë, por që të dinë edhe ca më mirë duhet që prodhimi të kombinohet me shkollën dhe teoria të lidhet me praktikën.

Kuptohet se nuk mund të venë dot të gjithë në shkollë, por tani ne kemi krijuar mundësi të mëdha që të gjithë të mësojnë, njëlloj si në shkollë. Shumë herë ky mësim duhet të bëhet atje ku punojnë njerëzit, në fabrika, në ara etj. dhe do të shikojmë se njerëzve do t'u hapen sytë. Disa do të shkëputen nga puna dhe do të venë në kurse, ku do të mësojnë më shumë. Por edhe të tjerët që do të venë në shkolla të mesme dhe në universitet, ku do të marrin njohuri të reja akoma më të thella e më të sistemuara, do të kenë nevojë të lidhen ngushtë me prodhimin, sepse mësimet që ata do të marrin në shkollë nuk do të vlejné, në qoftë se nuk lidhen me kazmën, me lopatën, me traktorin, me grurin, me kaun etj., pra, me praktikën.

Prandaj, krahas teorisë që mësohet në shkolla dhe në kurse, ne duhet të kthejmë sytë edhe nga praktika, pse kështu do të ecim gjithnjë e më përpara dhe ju në vend që të merrni 10-11 kuintalë pambuk për hektar si tani, do të arrini të merrni 18-20 kuintalë për hektar; në vend të 10-11 kuintalëve për hektar duhan, do të merrni 16 kuintalë për hektar, lëre pas-

taj misër dhe grurë. Përse të mos merren në arat e kooperativës suaj 100 kuintalë misër për hektar, siç ka marrë kooperativa bujqësore e Vorës në rrethin e Tiranës? Ndonjë mund të thotë se ky është një rezultat i arritur në një eksperiment të bërë në një parcelë prej 20 hektarësh. Dakord, por vitin tjetër kooperativistët e Vorës do ta shtrijnë këtë eksperiment në 40 hektarë, kurse i gjithë rrethi i Tiranës parashikon që këtë rendiment ta arrijë në një sipërfaqe prej 800 hektarësh. Me këtë dua të them se toka ka mundësi të prodhojë shumë dhe se prodhimi bujqësor varet kryesisht nga faktori njeri, nga dituria, zotësia dhe vendosmëria e tij. Çdo gjë mund të bëni ju kooperativistët, vetëm duhet kujdes në punë. Eksperiencën e vjetër ta ruani, por mos qëndroni në vend, mësoni edhe të rejtat e shkencës, edhe eksperiencën e përparuar të të tjerëve dhe ecni kurdoherë përpara.

Ju, shoqe dhe shokë të rinisë, jeni shpresa e atdheut, jeni fidani i pastër për të cilin Partia dhe prindërit tuaj tregojnë kujdesin më të madh që ju të rriteni të kulluar, të mos jeni si disa të moshuar që kanë edhe lakra në kokë. Partia punon që këto lakra, këto ferra që u janë qepur atyre nga e kaluara, të mos ju prekin ju të rinjve, me qëllim që të rriteni si do Partia, që të bëheni të zotë jo vetëm të na zëvendësoni ne në të gjitha punët, po të ecni edhe shumë më përpara. Ajo udhëheqje, ajo parti dhe ai shtet që nuk mendojnë për të ardhmen, që nuk mendojnë për edukimin e pastër revolucionar të rinisë, e cila do të zërë vendin e brezit të mëparshëm, nuk kryejnë një nga detyrat më të rëndësishme për sigurimin e sù

ardhmes. Jo kur të vijë koha që të vdesim, por qysh tani ne duhet të mendojmë për zëvendësimin tonë, me qëllim që këtë punë ta kryejmë në rrugë të natyrshme, pa e kuptuar, pse Shqipëria dhe populli janë të përjetshëm. Një punë e tillë është e domosdoshme të bëhet që të mos krijojmë lëkundje nesër në jetën e popullit.

Prandaj Partia i kushton një kujdes jashtëzakonisht të madh përgatitjes së rinisë, e cila u përgjigjet me entuziazëm kërkesave të saj dhe të popullit. Vërtet kemi një rini të mrekullueshme, por duhet të punojmë vazhdimisht që ta rritim akoma më të pastër e më revolucionare.

E ardhmja e vendit tonë në vitet që vijnë do të jetë edhe më e bukur; planet që po zbatojmë po e çojnë përpara ekonominë. Edhe sivjet rezultatet janë të kënaqshme. Kudo, në industri, në bujqësi, në arsim dhe në kulturë, do të realizohen e do të tejkalohen detyrat. Planet që ju diskutuat së bashku, në fillim ndoshta ju dukën pak si të vështira për t'u realizuar, mirëpo, siç doli, shifrat që i caktuat vetë ishin të drejta, prandaj u mobilizuat dhe i tejkaluat.

Masat punonjëse, në bazë, punuan vetë për përgatitjen dhe diskutimin e planeve të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës dhe kjo ka rëndësi të madhe. Këtë traditë marksiste-leniniste duhet ta vazhdojmë ta praktikojmë edhe në të ardhmen. Çdo vit, kur bëhen planet, kini parasysh rezultatet e shokëve që punojnë më mirë, por kini gjithashtu parasysh që të rritet numri i ditëve të punës të bëra nga gratë. Partia tani ka dhënë një sërë orientimesh dhe i këshillon

burrat që të ndihmojnë në familje, të mbushin ujë, të çajnë dru, të pastrojnë oborrin dhe dhomat, dhe kjo nuk është turp. Në qoftë se burrat do t'i bëjnë këto, pjesëmarrja e grave në punë të kooperativës do të jetë më e madhe. Plani ynë që na hap perspektiva të mëdha është real, sepse mbeshtetet në vijën dhe në direktivat e drejta të Partisë. Ai është gjithashtu një plan i vetë masave punonjëse, të cilat marrin vetë pjesë në hartimin e tij, prandaj edhe bëjnë gjithçka për ta realizuar.

Gjatë viteve të ardhshme do të kemi kushte më të mira ekonomike, të cilat do të na japin mundësi ta ndihmojmë më mirë bujqësinë. Edhe tani ne kemi mundësi më të mëdha në krahasim me të kaluarën, sepse tashmë prodhojmë në vend plehrat kimike. Por mos kujtoni se vetëm me plehrat kimike do të mund të arrijmë rezultatet që dëshirojmë. Natyrisht, ato do të luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë sonë, por të mos harrojmë për asnjë çast rëndësinë e madhe që kanë plehrat organike. Kooperativa juaj, që i ka vënë një rëndësi të madhe lopës, është për t'u lavdëruar, pse lopa është jo vetëm fabrikë qumështi dhe mishi, po edhe një fabrikë e madhe plehu dhe duhet ditur prej kujtdo se pa pleh organik nuk mund të ketë bujqësi të përparuar. Prandaj i kushtoni gjithnjë kujdes sigurimit të tij, ndërsa shteti do t'ju ndihmojë edhe më shumë me plehra kimike që do t'i prodhojnë uzinat e mëdha që kemi ndërtuar. Këto plehra deri tani ju janë dërguar jo me bollëk, sepse aq kishim, por paskëtaj ne do të kemi sasi të mëdha plehrash fosfatike dhe azotike, përdor-

rimi i të cilave do të ndihmojë në shtimin e rendimenteve të prodhimeve bujqësore.

Megjithatë këto na duken akoma të pamjaftueshme. Prandaj Partia ka në plan që ta dy dhe trefishojë prodhimin e plehrave azotike dhe fosfatike, në mënyrë që të arrijmë t'i hedhim çdo hektari toke 5-6 kuintalë pleh kimik. Atëherë do të shohim se me ç'vull të madh do të zhvillohet bujqësia, sa shumë drithëra, patate, oriz, pambuk, luledielli, panxhar etj. do të marrim. Por shteti do t'i ndihmojë kooperativat bujqësore edhe më shumë me mekanizma.

Ne tani disponojmë edhe farëra të zgjedhura drithërash që do të na ndihmojnë shumë për rritjen e rendimenteve. Por çdo kooperativë duhet të prodhojë edhe vetë të tilla farëra, duke u kujdesur që nga caktimi i tyre në arë, nga trajtimi i mirë në depo e gjersa të hidhen në tokë. Shumë kujdes kërkohet sidomos për të zbatuar si duhet kodin agroteknik, faktor tjetër me rëndësi ky që bujqësia jonë të përparojë më shpejt dhe të kemi prodhime gjithnjë e më të mëdha.

Së shpejti në Byronë Politike do të marrim në studim zhvillimin e mëtejshëm të lopës në të gjithë Shqipërinë¹. Synojmë dhe do të bëjmë përpjekje të përmirësojmë, në radhë të parë, racën e lopës. Por është e domosdoshme që të zhduket mënyra e vjetër e trajtimit të kësaj kafshe kaq të dobishme të ne, mënyra sipas së cilës punohej vetëm sa për të siguruar një viç dhe për të marrë prej saj deri në 300 kilogramë qumësht në vit. Nevojat tona kërkojnë dhe mu-

1 Shik në këtë vëllim, f. 27.

ndësitë janë që të rritim lopë që të jenë fabrika të vërteta mishi, qumështi e plehu dhe jo vetëm në fusha, po edhe në zonat malore. Për këtë problem së shpejti do të kemi një plan të tërë.

Nga kryetari juaj mësova se ju vendosët të shkurtoni oborret personale. Ju kështu treguat edhe një herë patriotizmin tuaj të lartë dhe kuptimin e drejtë marksist-leninist që keni për zhvillimin e ekonomisë bujqësore, pra u treguat njerëz politikë. Veç kësaj, ju i falët qetë kooperativës, gjë që do të thotë se ia dhatë atdheut, vetes tuaj. Edhe ata që hezituan në fillim, që ua bëri «cërr» zemra, kur bashkëfshatarët propozuan shkurtimin e oborreve, të mos turpërohen, se është e kuptueshme që disa mund të mos e kuptojnë menjëherë të mirën e përgjithshme, por më vonë binden për këtë.

Duke shkurtuar oborrin dhe bagëtinë personale ju ndihmoni jo vetëm që fuqia ekonomike e kooperativës të rritet, por njëkohësisht të ndryshojnë edhe konceptet e njerëzve për pronën. Kjo është një çështje me rëndësi të madhe, prandaj kjo masë që morët ka një vlerë të paçmueshme.

Partia ka porositur që një pjesë e mirë e prodhimit që do të merret nga sipërfaqja e tokës dhe nga blegtoria e shkurtuar e oborreve personale, t'u shpërndahet në natyrë anëtarëve për të bërë ca zahire, si: trahana, makarona etj. Në këtë sipërfaqe mund të mbillni edhe oriz dhe sidomos zarzavate, si: patate, specë, patëllxhanë, bostan etj., në mënyrë që kooperativistët të mos i blejnë në treg.

Këto porosi të Partisë kanë rëndësi të madhe, pra-

ndaj duhet të zbatohen me përpikëri nga kryesia e kooperativës. Dhe t'ia vini këmbët në një këpuçë udhëheqjes së kooperativës, po të mos zbatojë si duhet qoftë këto porosi, qoftë vendimet që merrni vetë ju. Kur të shihni se nuk janë duke u zbatuar si duhet këto vendime nga ana e kryesisë, mos e mbyllni gojën, por kritikoni pa frikë ata që gabojnë, bile edhe organizatën e Partisë, ashtu sikurse nuk duhet t'i lini pa i lavdëruar ata që punojnë mirë. Partia nuk do njerëz të heshtur që të thonë amin, kur flet kryetari i kooperativës, sekretari i organizatës-bazë të Partisë apo kushdo tjetër, edhe kur e shohin se ata nuk kanë të drejtë. Në qoftë se një njeri punon mirë, t'i themi «të lumtë!», por në qoftë se kryetari i kooperativës, fjala vjen, nuk punon mirë, atëherë ta kritikojmë, t'i kërkojmë llogari përse nuk e kryen detyrën, ta porositim të jetë i vëmendshëm dhe të zbatojë detyrat. Edhe kryetari i kooperativës kur shikon që ndonjë kooperativist nuk e kryen detyrën, ta këshillojë e ta kritikojë, e po të jetë nevoja ta çojë deri para asamblesë. Nga ana tjetër, ai me vartësit e tij të bëjnë shumë kujdes që t'i trajtojnë njëllor të gjithë, të mos mbajnë hatëre e të mos u sigurojnë favore njerëzve të familjeve e të farefisit të tyre, bile motrën, vëllanë, xhaxhanë e të afërm të tjerë t'i lënë për në radhën e fundit. Drejtuesit e kooperativës nuk duhet t'i zërë gjumi kur është fjala për të mirën tuaj, përkundrazi, ata duhet të bëjnë çmos që çdo gjë të shkojë në rregull dhe të jenë të fundit që të bien për të fjetur dhe të ngrihen të parët për të shkuar në punë. Kështu i mëson Partia të punojnë drejtuesit.

Shoqe dhe shokë kooperativistë,

Edhe industria e sektorët e tjerë në vendin tonë kanë marrë një hov të madh. Planet në të gjithë sektorët e rëndësishëm të ekonomisë jo vetëm realizohen, por edhe tejkalohen nga vrulli i paparë i klasës punëtore, i të rinjve e të rejave të vendit tonë. Hekurudhën Rrogozhinë-Fier parashikuan të ndërtohej brenda 3-4 vjetëve, kurse rinia, djemtë dhe vajzat tona, u zotuan ta mbarojnë brenda dy vjetëve. Edhe punëtorët u zotuan gjithashtu që hidrocentralin e madh të Vaut të Dejës ta ndërtojnë një vit para afatit. Në këtë mënyrë po ecet edhe për objektet e tjera, si për fabrikat e tullave, të plehrave kimike, të çimentos etj. Klasa jonë punëtore dhe rinia po i avancojnë afatet dhe ndërtimi para afateve i objekteve të ndryshme ekonomiko-shoqërore na vë përpara detyrën të mendojmë çfarë duhet të bëjmë tjetër për të shfrytëzuar kohën e fituar. Mund të mendojmë, për shembull, të fillojmë ndërtimin e një hidrocentrali tjetër, gjersa do të kemi një vit fitim nga përfundimi para afatit i atij të Vaut të Dejës.

Ju në Elbasan e përfunduat më shpejt ndërtimin e Fabrikës së Çimentos. Atëherë çfarë duhet të bëjmë me këto forca të lira pune që na teprojnë? Partia dhe Qeveria kanë vendosur t'i shfrytëzojnë forcat dhe kohën e kursyer për të dyfishuar kapacitetin e kësaj fabrike, me qëllim që të shtohet prodhimi i çimentos. Çimentoja neve na duhet shumë, si për ndërtimet e veprave të ndryshme, ashtu edhe për hapjen e mi-

nierave të reja, ku do të na nevojiten në masë shtylla betonarmeje.

Të rinjtë dhe të rejat, kudo në vendin tonë, tani u janë qepur kodrave dhe maleve për të hapur toka të reja dhe për të bërë kërkime gjeologjike. Tani ne kemi edhe hartën gjeologjike të vendit, e cila na tregon se si janë ndërtuar formacionet e tokës shqiptare, ku mund të ketë naftë, bakër, krom, hekur etj. Kjo do të na krijojë mundësi që në vitet e ardhshme të zhvillojmë edhe më shumë nxjerrjen e mineraleve, sepse do të disponojmë të dhëna të reja. Po ç'të bëjmë me mineralet që do të nxjerrim, t'i shesim të papërpunuara? Gjer tani ashtu i kemi shitur, se nuk kishim mundësi t'i përpunonim, por këtej e tutje do ta bëjmë në vend përpunimin e tyre, sepse kemi ngritur disa fabrika dhe në të ardhmen do të ngremë edhe të tjera. Kështu fitimet e ekonomisë sonë nga eksporti do të rriten. Në Elbasan, siç e dini, do të ndërtojmë kombinatin e madh të metalurgjisë së hekurit, për të cilin vendi ynë ka shumë nevojë. Vetëm juve në kooperativën tuaj kushedi sa vegla hekuri ju nevojiten çdo vit, merreni me mend sa hekur duhet për gjithë vendin. Partia dhe Qeveria mendojnë ta shtojnë disa herë sasinë e prodhimit të mineralit të hekur-nikelit të përpunuar, për të plotësuar nevojat e ekonomisë sonë, por edhe për të eksportuar. Gjithashtu, ju e dini se në Laç kemi ngritur Fabrikën e Superfosfatit, e cila punon me lëndë të parë që importojmë. Mirëpo njerëzit tanë i janë futur punës, po çajnë malet e Labërisë për të gjetur fosforite, që këtë lëndë të parë të përpiqemi ta sigurojmë vetë.

E shikoni shokë ç'bëjnë socializmi, kolektivizimi, forcat e përbashkëta, aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë, vija e drejtë e Partisë sonë të dashur? Socializmi po bën në vendin tonë gjithë këto mrekulli, që kanë për qëllim të përmirësojnë jetën e popullit, që ai të ketë më shumë veshje, banesa, ushqime, shkolla, energji elektrike dhe çdo gjë tjetër të nevojshme, që jeta e tij të bëhet çdo vit e më e mirë.

Prandaj, motra dhe vëllezër, në të gjitha drejtimet e ardhmja e popullit tonë është e bukur. Ne do ta ndërtojmë vetë me forcat tona këtë të ardhme.

Kjo është në përgjithësi situata e vendit tonë, një situatë shumë e mirë, e cila në të ardhmen do të jetë edhe më e mirë. Megjithatë, nuk duhet të na zërë gjumi, të mos flemë. Kurrë të mos e harrojmë armikun dhe të kaluarën e hidhur të vendit tonë, pse, po fjetëm, po të mos tregohemi vigjilentë, atëherë armiku ngre kokë. Jashtë kemi armiq të egër e të fuqishëm që bëjnë plane dhe komplete për të na dëmtuar dhe, po të jetë e mundur, për të na asgjësuar. Të tillë janë imperialistët amerikanë, reaksionarët e gjithë botës dhe revizionistët modernë.

Revizionistët sovjetikë tani janë në aleancë me imperialistët amerikanë. Ata përpiqen ta përmbysin pushtetin tonë popullor, të ndalojnë ndërtimin e socializmit në Shqipëri, me qëllim që te ne të vendoset përsëri kapitalizmi, ashtu si në vendin e tyre. Por ata nuk do t'ia arrijnë kurrë qëllimit. Ne do t'i shkatërrojmë komplotet e tyre. Armiqtë e marksizëm-leninizmit do të shpartallohen dhe revolucio-

ni do të fitojë kudo, edhe në vetë Bashkimin Sovjetik. Midis klasës punëtore dhe revolucionarëve të vërtetë atje tani ka pakënaqësi kundër tradhtisë së revizionistëve që e kthyen Bashkimin Sovjetik në rrugën e kapitalizmit. E njëjta gjë ndodh kudo ku revizionistët modernë janë në fuqi.

Në ilegalitet të rëndë tani po organizohen parti të reja marksiste-leniniste në vendet e ndryshme dhe po shtohet e do të shtohet vazhdimisht rezistenca dhe lufta kundër revizionizmit modern. Ky është ligj. Nuk mund të durojë në asnjë vend populli i ndershëm, nuk mund të durojnë klasa punëtore dhe fshatarësia që atdheu të shitet tek imperialistët amerikanë, anglezë, francezë, etj., që janë armiq të betuar të socializmit.

Shihni ç'ndodh në Jugosllavi, që është plotësisht një vend kapitalist. Krerët e klikës titiste janë majmur me djersën e popullit dhe me kreditë e imperializmit dhe vetë Titoja është një nga kapitalistët më të mëdhenj jugosllavë. Kohët e fundit, kur vdiq në një aksident automobilistik njëfarë Krajkeri, që s'ishte tjetër veçse një zyrtar mesatar titist, u zbulua se ky na paskësh depozituar në bankat e Zvicrës jo më pak se 6 milionë dollarë. E ku i gjeti ky gjithë këto para? Sigurisht, ai ia ka vjedhur ekonomisë dhe popullit jugosllav. Merrni me mend ç'pasuri të mëdha duhet të ketë vënë Titoja dhe gjithë krerët e tjerë jugosllavë gjatë këtyre 20 e ca vjetëve.

Në Jugosllavi tani po zhvillohen grindje midis kombësive të ndryshme që jetojnë në këtë shtet. Shqipëtarët e Kosovës, që përbëjnë kombësinë më të shty-

pur në Jugosllavi, nuk harrojnë kurrë, se janë shqiptarë, nuk harrojnë kurrë gjuhën dhe mëmën e tyre, Shqipërinë. Por në Kosovë ka edhe tradhtarë kosovarë, agentë të Titos, të cilët përpiqen që këtë luftë të drejtë për kërkesa kombëtare të kosovarëve ta shuajnë, por nuk do të mundin kurrë ta bëjnë këtë.

Udhëheqësit revizionistë jugosllavë, me Titon në krye, po manovrojnë për t'i gënjyer kosovarët, duke u thënë se duan t'i përmirësojnë marrëdhëniet me Shqipërinë, bile për këtë kanë vënë tradhtarët shqiptarë kosovarë të mbajnë fjalime dhe t'i thonë popullit të Kosovës se janë gjoja bujarë, se duan të afrohen me Shqipërinë, por nuk dashka Shqipëria! Por as te ne, as te shqiptarët e Kosovës, të cilët janë djegur me dhjetëra e dhjetëra vjet, nuk shkojnë këto manovra. Ne duam që nga Shqipëria të dërgojmë libra dhe filma, që populli shqiptar në Kosovë të shikojë si është zbukuruar kudo jeta në Shqipëri, në qytete dhe në kooperativa. Ne do t'u dërgojmë atyre edhe këngë shqiptare. Gjithçka, çdo gjë që kërkojnë për të mbajtur gjallë zakonet dhe traditat patriotike shqiptare do t'u dërgojmë ne vëllezërve tanë kosovarë, por luftën kundër tradhtarëve titistë kurrë nuk do ta pushojmë, deri në shkatërrimin e tyre të plotë.

Motra dhe vëllezër kooperativistë,

Le të ecim kurdoherë përpara me besim të plotë në fitoren përfundimtare të socializmit. Partia jonë është një Parti shqiponjë, e kalitur si çeliku në luftë-

ra dhe beteja të përgjakshme, se e tillë është vetë klasa jonë punëtore nga gjiri i së cilës ajo ka dalë. E kalitur është edhe fshatarësia jonë, inteligjencia popullore dhe rinia shqiptare, që po rritet e pastër nën kujdesin e Partisë. Prandaj të punojmë me të gjitha forcat që të realizojmë planet dhe detyrat që na janë ngarkuar, të jemi kurdoherë vigjilentë dhe kurrë të mos na zbutet zemra ndaj armiqve, të brendshëm apo të jashtëm qofshin, gjithnjë t'i kemi sytë hapur, sepse vetëm kështu nuk do të ketë armik që të na dëmtojë dhe në qoftë se ndokush do të orvatet të prekë kufijtë tanë, ai do të gjejë me siguri vdekjen, pse ata janë të pakapërcyeshëm. Le të lehin sa të duan armiq-të tanë, ata duhet t'i bëjnë mirë llogaritë para se të prekin Shqipërinë dhe duhet ta dinë se po të na prekin, do të thyhen.

Dhe tani, duke shprehur gëzimin që pata nga ky takim, ju uroj të gjithëve nga zemra shëndet, lumturi nëpër familjet dhe sukses në punët e kooperativës.

Rroftë Partia!

Rroftë kolektivizimi!

Përpara drejt sukseseve më të mëdha, shokë kooperativistë të kooperativave «Shkëndija» dhe të Gostimës!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

LETËR DREJTUAR SHOKUT PAL VATA

9 nëntor 1967

I dashur shoku Pal,

Në këto ditë të mëdha hovi revolucionar që po kalon vendi ynë për ndërtimin e jetës së re socialiste, vargut të madh të mijëra dëshmorëve të lavdishëm të luftës dhe të punës iu shtua edhe emri i bijës suaj Shkurta, malësore revolucionare, anëtares së organizatës së BRPSH, bijës së paharruar të popullit shqiptar.

Megjithëse e vogël nga mosha, pse të pesëmbëdhjetat sapo i kishte mbushur, por tepër e madhe, e pjekur, e zgjuar dhe e vendosur nga vepra, si bijë e denjë e një familjeje patriote, bijë e popullit të malësive tona kreshnike që kanë qëndruar kryelarta e të papërkulura kundër çdo armiku e rrebeshi, me aktin e saj heroik e trimëror Shkurta dha një shembull të lartë patriotizmi, trimërie e dashurie të pakufishme për atdheun, për Partinë dhe popullin e vet. Akti i saj do të frymëzojë rininë heroike dhe gjithë punonjësit e vendit tonë se si duhet të punohet e të luftohet për socializëm, si duhet të mposhten pa u përku-

lur çdo vështirësi e pengesë, zakonet prapanike, feja e kanunet poshtëruese ndaj femrës shqiptare, prandaj kujtimi i saj do të mbetet i paharruar e do të nderohet kurdoherë me respektin më të madh nga të gjithë.

Ju më njoftuat në letër, i nderuari shoku Pal, se çikën nuk e qatë, pse ashtu siç i ka hije shqiptarit, trimëreshat nuk qahen dhe së bashku me mbesën, vendosët dhe shkuat në hekurudhë në vend të saj për ta zëvendësuar. Ky është një tjetër shembull patriotizmi të lartë socialist që jepni ju, një akt tjetër i madh atdhedashurie e besnikërie ndaj Partisë, popullit dhe atdheut, është një përtëritje në një shkallë më të lartë e traditës patriotike të familjes suaj, gjyshit, axhës e babës suaj që derdhën gjakun duke luftuar kundër pushtuesve turq, malazez e regjimit satrap të Zogut. Duke mposhtur dhimbjen e thellë që ju shkaktoi humbja e vajzës së dashur, Shkurtës, në pranverën e jetës së saj, ju vutë mbi të gjitha interesin e përgjithshëm mbi atë të familjes dhe, megjithëse i shkuar në moshë, u drejtuar në hekurudhë që ajo të ndërtohet në kohën e duhur për të mirën e gjithë popullit, për lulëzimin e forcimin e atdheut.

Partia krenohet me bija dhe bij të tillë të dalë nga gjiri i popullit tonë, i malësorëve trima e të papërkulur që me burrinë, mençurinë, besnikërinë e frymën e lartë të sakrificës dhe me heroizëm në luftë e në punë, pa u thyer përpara asnjë vështirësie zbatojnë në jetë me një vendosmëri të admirueshme mësimet dritëdhënëse të Partisë në zhvillimin më lart të traditave të lavdishme të të parëve tanë.

Populli ynë nuk do t'i harrojë kurrë dhe rapso-dët gojartë e poetët tanë të talentuar do t'u këndojnë brez pas brezi dhe do të përjetësojnë në shekuj em-rat e bijave dhe bijve të këtij trualli që nuk kursejnë as gjënë më të shtrenjtë për lirinë e pavarësinë e atdheut, për ndërtimin e socializmit dhe të komuniz-mit.

Ju uroj shëndet e punë të mbarë në hekurudhë e në fshatin tuaj malor dhe familjes suaj patriote gjithë të mirat. Zemra juaj bujare paskëtaj qoftë kurdoherë e gëzuar dhe e lumtur në atdheun tonë të lirë socialist, për të cilin bija juaj Shkurta dha gjënë më të shtrenjtë, jetën e saj të re.

Juaji

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë
në gazetën «Zëri i popullit»,
nr. 207 (5995), 10 nëntor 1967*

*Botohet sipas gazetës «Zëri i
popullit», nr. 207 (5995), 10
nëntor 1967*

NDRYSHIMI I STRUKTURËS SË BLEGTORISË KËRKON MASA TË STUDIUARA MIRË

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

10 nëntor 1967

Jam dakord me mendimet e shokëve që diskutuan. Punën që ka bërë komisioni i ngarkuar për studimin e këtij problemi, materiali që përgatiti në fillim Komisioni i Planit të Shtetit, po dhe ky që na solli Ministria e Bujqësisë, duhen konsideruar të mirë. Raporti që kemi sot në dorë u përgatit në bazë të direktivave që dha Kongresi i 5-të i Partisë.

Dëshiroj të them edhe unë mendimin tim për këtë çështje me rëndësi të madhe. Zhvillimi i lopës, që ndikon shumë në zhvillimin e mëtejshëm me ritme më të shpejta dhe me cilësi të bujqësisë së vendit tonë, ka mbetur akoma prapa për shumë arsye objektive, po edhe subjektive dhe kryesisht për arsye pikëpamjesh të ndryshme. Prandaj themi që ky problem i madh do të zgjidhet jo vetëm me masa ekonomike por edhe politike, sepse është pikërisht puna

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi masat që janë marrë dhe do të merren për zbatimin e detyrave të Kongresit të 5-të të PPSH për shtimin e lopëve, përmirësimin e racës së tyre dhe shtimin e qeve të punës».

politike që do të thyejë shumë pengesa, të cilat, në një mënyrë ose në një mënyrë tjetër, ekzistojnë edhe tani për këtë çështje.

Partia ka dhënë direktiva e janë marrë masa për zhvillimin e lopës, në sajë të të cilave janë arritur rezultate, si në shtimin numerik, ashtu edhe në rritjen e prodhimit të saj. Por këto rezultate nuk erdhën vetvetiu, ato u arritën me punën e gjithë punonjësve tanë të bujqësisë, të frymëzuar nga direktivat e Partisë.

Zhvillimi i lopës është një proces i ndërlikuar që lidhet ngushtë me zhvillimin e gjithë ekonomisë. Është shpejt të flasim me hollësi për rrugën që do të ndjekë ky zhvillim, por tani në vendimet tona duhet të shënojmë qartë piketat si dhe ku do të shkojmë. Raporti që marrim sot në shqyrtim është një bazë për këtë, se specialistët e Ministrisë së Bujqësisë nuk e kanë bërë studimin nga zyra. Edhe projektvendimi që e shoqëron është gjithashtu një bazë, por duke marrë parasysh diskutimet që bënë shokët, mendoj se atij i duhen bërë akoma perfeksionime të mëtejshme.

Në vendim nuk duhet të përcaktojmë me shifra kategorike se sa qindra apo mijëra litra qumësht do të marrim në këtë ose në atë vit nga lopët, se mund të gabohemi. Për zhvillimin e lopës të kemi parasysh ato që thanë shokët, domethënë, të punojmë në dy drejtime, edhe për shtimin numerik të lopëve, edhe për rritjen e rendimentit të tyre. Në kushtet e tanishme, hëpërhë nuk mund ta vëmë theksin te rritja e rendimentit të qumështit. Në fakt, të gjithë e kuptojmë se shtimi i rendimentit është më ekonomik, po tani për tani na vihet detyrë të rritim numrin e

krerëve, pra, në radhë të parë, të krijojmë një bazë të shëndoshë, të cilën nuk e kemi akoma në shkallën e duhur. Me qindra kooperativa, bile edhe ndërmarrje bujqësore, si ato të ushtrisë, nuk kanë fare lopë ose kanë fare pak. Prandaj na vihet detyra që të shtojmë numrin e lopëve dhe gjatë kësaj pune të marrim të gjitha masat që rendimenti i qumështit të rritet gradualisht.

Rretheve nuk duhet t'u planifikojmë rendimente të njëllota. Ato duhet të jenë të diferencuara për zonat fushore e malore dhe të caktohen sipas mundësive të çdo rrethi e bile të çdo ekonomie të veçantë bujqësore, shtetërore ose kooperativiste. Pastaj këtë proces ta ndjekim çdo vit. Ndërmarrjet bujqësore, që kanë mundësi më të mëdha duhet jo vetëm t'i realizojnë, por dhe t'i tejkalojnë rendimentet e planifikuara. Njëkohësisht, të punohet që edhe në ato kooperativa malore ku tash po futet lopa për herë të parë, të tejkalohet plani i rendimenteve të qumështit. Për ta realizuar këtë detyrë do të na duhen, siç u tha, disa vjet. Rrethet e kanë bërë parashikimin për 10 vjet dhe ne mund ta lëmë kaq afatin, po gjatë kësaj kohe Partia duhet t'u hapë perspektiva punonjësve të bujqësisë se si të punojnë. Problemi i zhvillimit të lopës nuk është i lehtë dhe nuk mund të zgjidhet shpejt në nivelin që duam ne pa një punë të madhe politike, ideologjike dhe organizative. Prandaj për këtë do të duhet një kohë pak a shumë e gjatë, mbase dhjetë vjet, ndofta edhe më shumë. Ky afat do të përcaktohet më mirë mbasi të merren disa të dhëna plotësuese për qumështin, për krerët, për kullotat etj., etj.

Megjithëse kjo çështje me rëndësi të madhe kër-

kon kohë të realizohet, ne të mos vëmë në vendim vetëm disa direktiva të përgjithshme ekonomike ose politike, por edhe disa përcaktime, që Partia dhe punonjësit e bujqësisë të punojnë konkretisht për zbatimin e tyre. Në vendim mund të vëmë edhe shifra të cilat të mos jenë definitive, por të diskutueshme, me qëllim që, duke i ballafaquar ato me praktikën dhe me mundësitë e reja që do të krijohen për mirërritjen e shtimin e lopës, të avancohen e të saktësohen. Kjo kërkon që secilit t'i punojë mendja. Kështu do të bëjmë që Partia dhe populli, specialistët e blegtorët të mendojnë për këtë problem. Kjo do t'i hapë perspektiva të reja zhvillimit të lopës.

Detyrat e planit pesëvjeçar për zhvillimin e lopës, si gjithë detyrat e tjera të këtij plani, duhet t'i avancojmë më tej. Kjo kërkon të mendojmë dhe të shikojmë të gjitha mundësitë që kemi dhe se ç'mund të bëjmë më tej dhe ç'nuk mund të bëjmë për lopën. Duke u mbështetur në zhvillimin revolucionar të situatës së brendshme në vendin tonë, kam bindjen se shumë nga këta kufij që do të caktojmë për këtë problem, masat punonjëse, të udhëhequra nga Partia, do t'i kapërcejnë.

Gjatë kohës që në bazë do të punohet për vënien në jetë të këtyre orientimeve, do të vëmë re se me masat që do të merren dhe me realizimet që do të kryhen, do të ndryshohet edhe struktura e blegtorisë sonë. Nuk mund të themi që kjo do të bëhet brenda një, dy, pesë, shtatë ose dhjetë vjetësh, po me domosdo ajo gradualisht do të ndryshojë. Do të bënim një gabim shumë të madh, po të merrnim vendim dhe të thoshim se du-

hen skartuar kaq ose aq dele apo dhi etj. brenda kësaj kohe, sepse ndryshimet në strukturë do të bëhen kur të merren masa të studiuara mirë, kur planin perspektiv, që do ta detajojmë për pesëvjeçarin e ardhshëm, ta bëjmë të studiuar politikisht dhe ekonomikisht, kur të përgatitim njëkohësisht edhe mentalitetin e njerëzve dhe kur këtë mentalitet ta ngremë në atë nivel që secili ta kuptojë jo vetëm si ide, po edhe në praktikë, se nuk duhet ruajtur struktura e vjetër e blegtorisë vetëm për arsye se gjyshërit tanë i paskan pasur vazhdimisht delet. Përpara dhentë hanin bar pa shkop. Kur e kritikuam dhe vendosëm të mos vazhdohej më kështu, disave u erdhi keq, kurse tani askujt s'i bën më përshtypje që ne e caktojmë vetë sa duhet të hajë çdo dele.

Për përcaktimin e zhvillimit perspektiv të blegtorisë gjer në vitin 1980, nuk do të mjaftohemi vetëm me lëshimin e një direktive, por do të marrim edhe një sërë masash konkrete. Për këtë qëllim duhet të perfeksionojmë mirë gjendjen kadastrale të kullotave, të prozhmeve e të tokave të pashfrytëzuara, se gjithnjë është folur që kemi kaq qindra e mijëra hektarë nga këto, por akoma nuk dimë me saktësi se sa kemi. Kur të bëhet një kombinim më i mirë i livadheve, i prozhmeve, i kulturave të dyta etj., lidhur me zhvillimin e blegtorisë, kjo do të jetë njëkohësisht një rihforcim i madh i orientimit politik, që do t'i japë blegtorisë dhe bujqësisë një zhvillim më të drejtë, më modern e më rentabël. Tani duhet t'i vihem konkretisht kësaj pune, se shumë gjëra do të na i mësojë vetë baza. Kur t'i thuhet kooperativave malore, që nga asnjë do të kenë 15-20 lopë, ato me-

doemos do të mendojnë ku do t'i ushqejnë, edhe do të na mësojnë ç'duhet të bëjmë për këtë, po edhe ne do t'i mësojmë ato për t'u kujdesur, që nga stalla e gjer te kuadri që duhet për mbajtjen e tyre.

Një revolucion i vërtetë është filluar dhe po zhvillohet në bujqësinë tonë. Te punonjësit e këtij sektori vihet re një etje e madhe për të mësuar agroteknikën dhe të fshehtat e zanatit, si për drithërat, për bimët industriale, për frutikulturën, ashtu edhe për blegtorinë. Por kthesës që po bëhet, sidomos në blegtori, duhet t'i vëmë rëndësinë e duhur, sepse, siç shohim në praktikë, për lopën nuk ekziston një preokupacion i tillë si ai që tregohet, për shembull, për grurin, për prodhimet e tjera etj.; për bagëtitë njerëzit tanë kanë akoma vetëm një eksperiencë empirike, prandaj për zhvillimin e lopës duhet bërë shumë kujdes.

Qeveria duhet të studiojë dhe të bëjë llogari ç'na japin tufat që kemi, nëse duhet të sjellim nga jashtë damazë, në ç'sasi etj. Fakt është që dema të racës kemi sjellë edhe përpara, por edhe tani kemi planifikuar të sjellim. Megjithatë, pasi të bëjmë mirë llogaritë në frymën e kërkesave të studimit që po përgatitet, mund të na duhen edhe të tjerë mbi ata që kemi parashikuar, prandaj çdo gjë ta shohim me kujdes dhe brenda mundësive tona, të cilat t'i studiojmë në kompleksin e tyre, duke pasur parasysh që po bëhet një kthesë e madhe dhe me interes për bujqësinë tonë.

Sigurimi i ushqimit të lopëve është një problem tjetër me shumë rëndësi, sepse pa të lopa nuk mund

të zhvillohet. Baza e nevojshme ushqimore për lopën të llogaritet duke marrë parasysh edhe sasinë e krerëve që kemi, edhe planin e rritjes së tyre të mëtejshme, por edhe lopët e oborreve kooperativiste. Si këto, ashtu edhe ato të kooperativave bujqësore duhen konsideruar medoemos si një e tërë; nuk i lejohet askujt që të mos mendojë se ku do të kullostin lopët e oborreve. Në situatën ekzistuese, tek oborret kemi një bazë të madhe për zhvillimin e lopës. Prandaj jo vetëm t'u sigurohet kashtë e bar anëtarëve të kooperativave për lopët e oborrit, po të kihet parasysh edhe çështja e bazës së remontit të tyre. Gjersa çdo oborri kooperativist ne i kemi caktuar kufijtë, duke mos e lejuar të mbajë më shumë se një lopë, atëherë s'duhet t'i krijojmë pengesa, por ta ndihmojmë atë për çdo gjë.

Që t'i japim një ndihmë efektive zhvillimit të lopës s'duhet fluturuar, por duhet menduar mirë për çdo gjë dhe në çdo pesëvjeçar t'i përcaktojmë kurdoherë më drejt detyrat. Mendoj që masat që do të marrim për këtë çështje të vihen në zbatim nga viti 1970 e gjer më 1980, se për pesëvjeçarin e tanishëm e kemi bërë planin, të cilin duhet të bëjmë përpjekje që ta tejkalojmë duke bërë korrigjime e shtesat e nevojshme brendapërbrenda tij. Pra orientimin duhet ta japim edhe për pesëvjeçarët e ardhshëm.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH që
gjendet në AQP*

TË SJELLIM GJAK TË RI NË ORGANET E PUNËVE TË BRENDSHME

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

11 nëntor 1967

Nxjerrja në lirim e kuadrove, që për arsye shëndetësore ose moshe nuk japin dot më në këtë sektor të rëndësishëm, lind nevojën e vendosjes së tyre në punë në sektorin civil. Largimi i tyre nga organet e punëve të brendshme kërkon të kuptohet drejt edhe politikisht nga kuadrot, prandaj duhet punuar me kujdes me ta. Po të bëhet kështu, atëherë çështja e sjelljes së gjakut të ri në këto organe do të zgjidhet më mirë.

Tani në Ministrinë e Punëve të Brendshme shumica e kuadrove janë me përvojë të gjatë. Këtyre u bie barra jo vetëm të kryejnë e të drejtojnë punët e organeve të Sigurimit të Shtetit etj., por edhe të ndihmojnë me aftësitë e me përvojën e tyre kuadrot e rinj, të cilët

¹ Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi gjendjen e kuadrit në organet e punëve të brendshme».

nuk e kanë përvojën e madhe të kuadrove me stazh të gjatë në këtë punë. Prandaj nuk duhet kërkuar që të rinjtë të jenë menjëherë «profesorë të mbaruar» në drejtimin dhe në zgjidhjen e problemeve, se as kuadrot e vjetër, kur e filluan veprimtarinë e tyre, nuk ishin «profesorë të mëdhenj» në detyrat që u ngarkoi Partia, po në luftë dhe në punë e sipër u mësuan. E kam fjalën që kuadrot e rinj në asnjë mënyrë të mos nënvleftësohen, por të ndihmohen të mësojnë dhe të përgatiten për t'i zëvendësuar denjësisht të vjetrit. Kështu do të mund të sigurojmë vazhdimësinë në çështjen e kuadrit.

Edhe në organet e punëve të brendshme dhe të Sigurimit të Shtetit, ashtu si në dikasteret e tjera dhe në forumet e Partisë, të futim dhe të ngremë në përgjegjësi elementë nga klasa punëtore. Punëtorë të mirë tani kemi mjaft. Vërtet shumica e atyre që punojnë në sigurim dhe që mendohet të nxirren në lirim, nuk vijnë nga radhët e klasës punëtore, megjithatë ata janë shokë besnikë, të luftës, njerëz të vendosur, që në luftë e në punë u mësuan të drejtojnë. Por, si kudo, sot ne kemi mundësi të vëmë edhe në organet e punëve të brendshme më shumë punëtorë.

Po të kuptohet mirë çështja e kuadrit, mendoj se ngritja dhe edukimi i tij nuk do të gjejnë pengesë. Ne kemi sot të rinj me kulturë që, pasi mbarojnë shkollat dhe futen në punë të ndryshme, janë në çdo kohë të gatshëm të punojnë në organet e punëve të brendshme. Gjithashtu dëshirë për të punuar në këto organe kanë edhe shumë djem që mund të mos kenë

kryer shkollë të mesme, por punojnë kush tornitor e kush diku gjetkë dhe janë me përbërje politike të mirë. Po të bëhet një punë e kujdesshme me gjithë këta të rinj, jo një, po shumë punonjës përnjëherësh mund të gjenden për organet e Sigurimit të Shtetit. Aty ata vijnë me plot gatishmëri, siç vajtën këtë vit edhe në ushtri, ku shkuan më shumë nga sa kërkoi Ministria e Mbrojtjes Popullore.

Ne tani kemi mjaft njerëz me prejardhje punëtorë të formuar politikisht, si dhe fshatarë e qytetarë me përbërje të mirë, që mund t'i futim të punojnë në organet e punëve të brendshme. Por që këta të futen në këto organe u duhet hapur rrugë, të mos pengohen. Kjo presupozon që kuadrot që kanë mbushur moshën për të dalë në pension ose që janë të sëmurë etj., të largohen e t'ua lënë vendin të rinjve. Këtë ta kuptojnë drejt shokët e vjetër. Pikëpamja që mund të shfaqet te ndonjëri, sikur tani Partia nuk paska më besim te kuadrot e vjetër, nuk është e bazuar, se për ata që kanë kontribuar për një kohë të gjatë, Partia ka respekt të madh. Partisë i vjen shumë keq që një kuadër, i cili ka luftuar me besnikëri për shumë kohë, të largohet nga puna me zemër të thyer. Por ekzistenca e një pikëpamjeje të tillë te disa kuadro tregon se disa organizata partie nuk e kanë bërë mirë edukimin e këtyre shokëve. Prandaj me ta të punohet me kujdes të veçantë, që t'u bëhet e qartë se ata, duke dalë në pension, prapë janë aktivistë të shquar të Partisë. Ndonjë prej tyre, që ka akoma forca, mund të futet edhe në punë, ku sigurisht do të marrë më pak se atje ku ishte.

Shokëve që do të dalin në lirim ose në pension t'u thuhet drejt, hapur se, që arma e Sigurimit të Shtetit të jetë kurdoherë e më e fortë, është e domosdoshme që në radhët e kësaj arme të futen gradualisht edhe elementë të rinj. Po t'u flitet kështu, të gjithë ata që do të jenë me të vërtetë të partishëm, do të jenë patjetër dakord dhe askush që ka qenë, fjala vjen, drejtor, shef etj., etj., nuk do të pretendojë që përsëri të jetë i tillë, sepse tani në moshë të thyer ai nuk i ka dhe nuk mund t'i ketë më ato forca dhe atë kapacitet që kërkohet.

Me shokët e organeve të Sigurimit të Shtetit që dalin në pension ose në lirim dhe kalojnë në sektorë civilë Partia duhet të mbajë lidhje, t'u ngarkojë edhe detyra të rëndësishme dhe të mos i aktivizojë vetëm për ndonjë punë në lagje. Natyrisht ata do të aktivizohen edhe atje me punë shoqërore, por, duke qenë njerëz të ngritur politikisht, ata mund të punojnë edhe për edukimin politik të masave dhe në këtë drejtim mund të japin shumë. Përveç kujdesit që duhet të tregojmë për t'u gjetur punë këtyre shokëve (kur kanë mundësi të punojnë akoma), të bëjmë kujdes që atyre t'u dëgjojmë edhe fjalën. Shokët e komiteteve të Partisë mund edhe të këshillohen me ta për ndonjë problem, për të cilin ata janë në gjendje të japin mendime. Një gjë e tillë të praktikohet sa herë lind nevoja dhe jo formalisht, se Partia ka nevojë për mendimet e ndihmën edhe të këtyre njerëzve.

Komitetet e Partisë t'i ndihmojnë organet e Sigurimit të Shtetit duke u dhënë elementë të rinj, siç kursë bëri Komiteti i Partisë i Rrethit të Tiranës. Për-

vojën e Tiranës ta kenë parasysh edhe komitetet e Partisë të rretheve të tjera.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH që
gjendet në AQP*

TË ECIM KRAHAS ME VRULLIN E JETËS, ME KËRKESAT E KOHËS

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

11 nëntor 1967

Situata që na paraqitet në lidhje me forcimin e organizatave të Partisë tregon se studimi dhe zbërthimi i direktivave të dhëna në lidhje me forcimin, rritjen e mëtejshme të Partisë e të tjera çështje organizative janë marrë me seriozitetin më të madh.

Mendoj se ky mund të quhet fillimi i një pune më të studiuar për këtë çështje të rëndësishme, prandaj të kemi parasysh që punën tonë për të realizuar këtë detyrë të madhe organizative ta thellojmë më tej dhe të mos e lëmë me kaq, duke menduar se e kemi kryer si duhet. Është fakt se me këtë punë që kanë

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth raporteve të komiteteve të Partisë të rretheve të Gjirokastrës, të Lushnjës dhe të Dibrës «Mbi zbatimin e detyrave të Kongresit të 5-të të PPSH për pranimet, përbërjen, shtrirjen e shpërndarjen e forcave të Partisë», si dhe rreth raporteve të komiteteve të Partisë të rretheve të Krujës e të Elbasanit «Mbi punën që bëhet për pranimin e shoqeve në Parti».

bërë tash komitetet e Partisë, e kemi më të qartë situatën e Partisë, dobësitë e saj, nevojat dhe masat e mëtejshme që duhet të merren. Ka filluar, si të thuash, të shkundet gjendja apatike e pranimeve në shumë organizata-bazë, të cilat, me vite, nuk kishin pranuar anëtarë të rinj, nuk kishin aktivizuar aktivin e Partisë dhe s'kishin punuar seriozisht me kandidatët e Partisë për t'i bërë të gjithë këta të shkathët dhe aktivë. Një studim i tillë i gjendjes organizative, natyrisht, solli me vete edhe pranimin e anëtarëve të rinj e veçanërisht të shoqeve.

Megjithatë, konstatojmë se ka edhe organizata partie, që ndonëse e ndiejnë nevojën, akoma vazhdojnë të mos bëjnë pranime. Të mos mendojmë se kjo është një çështje e thjeshtë dhe se dëshira e nevoja për të shtuar radhët e Partisë me gjak të ri, janë ndier dhe janë kuptuar plotësisht. Mbeturinat e së kaluarës për këtë çështje, nuk janë zhdukur akoma. Ka raste që bëhen pranime për pranime, po kjo nuk duhet të ndodhë. Organizatat e Partisë të vënë në lëvizje çdo gjë për të përgatitur seriozisht kandidaturat dhe për të mos ia lënë këtë çështje spontancitetit ose rutinës. Prandaj them që, metodat e punës edukuese me kandidatët, me aktivin e Partisë, në përgjithësi detyrat e veçanta për kandidatët, të studiohen më thellë dhe të zgjerohen e të perfeksionohen më tej.

Pranimi i anëtarëve të rinj në ato organizata-bazë partie ku ka pak komunistë, ose në ato fshatra ku s'ka asnjë komunist, të mos lihet pas dore. Përkundrazi, është e domosdoshme të bëhet një studim i imët, organizatë më organizatë dhe fshat më fshat,

në brigada e skuadra pune në kooperativat bujqësore, në mënyrë që pranimet e reja në Parti të mos pengohen duke sjellë arsye të shumta e të pathemelta. Me këtë nuk dua të them të shkelen kërkesat e Statutit dhe rregullat e pranimeve, por këto kërkesa e rregulla të zbatohen me një dinamizëm të madh, domethënë kandidatët për anëtarë partie të bëhen të aftë brenda një kohe të shkurtër. Puna dhe lufta e përditshme do t'i bëjë këta që të kaliten e të zhvillohen më tej e të plotësojnë më mirë disa kushte, në plotësimin e të cilave mund të kenë edhe boshllëqe, që i tolerojmë përpara nevojës së madhe që kërkon zgjerimi i organizatës, duke menduar se do t'i eliminojnë gjatë periudhës së stazhit.

Për shembull, ndjekja e shkollës është dhe duhet të mbetet një kusht i rëndësishëm për pranimin në Parti. Për zbatimin e këtij kushti ne duhet të jemi të rreptë, sidomos për moshat e reja deri në 30-35 vjeç. Edhe nga komunistët mbi këtë moshë duhet të kërkohet ndjekja e shkollës dhe zhvillimi i tyre i mëtejshëm kulturor, por për anëtarët e Partisë të moshave disi të kaluara, kjo kërkesë të mos merret në mënyrë shabllone e të mos vihet përpara luftës revolucionare dhe përvojës së fituar prej tyre në jetë. Atje ku nuk ka pasur shkolla 7-8-vjeçare, për shembull, ne nuk mund të rrimë pa pranuar në Parti elementët më revolucionarë vetëm për arsye se ata nuk e plotësojnë këtë kusht. Ky rregull, pra, nuk duhet të merret në mënyrë shumë të ngurtë për disa moshë dhe krahina, por, në përgjithësi, kriteret që kemi vendosur duhen zbatuar.

Nga materialet që shqyrtuam konstatojmë luftën që ka bërë Partia për ngritjen e nivelit ideologjik të anëtarëve të saj dhe ritmikën e pranimeve. Këtej nxjerrim edhe një herë konkluzione se ç'rëndësi të madhe ka çështja e pranimeve dhe ajo e edukimit të komunistëve me ideologjinë tonë marksiste-leniniste e me një jetë aktive revolucionare.

Në raportin e Komitetit të Partisë të Rrethit të Lushnjës ne shohim se në tabelën analitike të të përjashtuarve, që nga viti 1961 gjer më 1967, përqindja e shokëve është më e madhe nga ajo e shoqeve. Kjo është inkurajuese për shoqet dhe dëshmon për ndershmërinë e korrektësinë e tyre revolucionare ndaj vijës së Partisë. Këndej del detyra që ne të forcojmë luftën e organizatave të Partisë për pranimet nga radhët e shoqeve në fshatra, duke synuar në ato me origjinë fshatare të varfra, kurse në qytete, në klasën punëtore në radhë të parë.

Në Lushnjë, por edhe në rrethet e tjera, ne duhet të përmirësojmë edhe përqindjen e shoqeve në përbërjen e Partisë me gra nga prodhimi. Në këtë rreth ndihet kjo nevojë sidomos në zonën e Fier-Sheganit, të Hysgjokajt, të Qendrës dhe të Çermës. Të kemi parasysh se gruaja fshatare kudo në Shqipëri, ashtu sikurse edhe në Lushnjë, ka qenë më e shtypur, pra, më revolucionare. Por, nga ana tjetër, ajo njëkohësisht ka më shumë nevojë për edukim politik dhe ideologjik. Prandaj të organizohet më mirë puna për pranimin e tyre në Parti dhe edukimi i tyre të shikohet më nga afër.

Duke pasur parasysh nivelin e ulët kulturor të

shoqeve komuniste, ose të kandidatëve për anëtarë partie të fshatit, mungesën e praktikës dhe të metodës së të mësuarit, mendoj se, nën kontrollin e Partisë dhe me tema të caktuara, me libra e dispenca që ka nxjerrë Partia, ne duhet të ngarkojmë edhe mësues të paorganizuar në Parti për t'u mësuar shoqeve komuniste marksizëm-leninizmin. Duke vepruar kështu do të kemi dy përfitime: do t'i nxitim mësuesit dhe mësueset ta mësojnë dhe ta përvetësojnë marksizëm-leninizmin, gjë që do t'u shërbejë në jetë dhe në punë dhe, nga ana tjetër, ata do t'ua mësojnë edhe të tjerëve. Natyrisht, për këtë punë të zgjidhen mësueset e mësuesit më të mirë, më aktivë, më metodistë, që tani nuk na mungojnë në fshatin tonë. E gjithë kjo punë, mendoj unë, të bëhet jashtë formave të rregullta të edukimit ideologjik të komunistëve, por e koordinuar me to dhe të jetë e efektshme, plotësuese dhe ndihmëse e këtyre formave.

Në çështjet organizative të Partisë shifrat dhe rezultatet e arritura nuk duhet të na kënaqin dhe të na bëjnë që ta flemë mendjen. Rëndësi në këto çështje kanë metoda e punës dhe orientimi i drejtë. Prandaj, sidomos metodën e punës, komitetet e Partisë duhet ta studiojnë, ta thellojnë e ta përsosin vazhdimisht në praktikë.

Çështjet organizative duhet të preokupojnë gjithë Partinë e jo vetëm komitetet e Partisë të rretheve, sekretarët dhe instruktorët e tyre, as vetëm sekretarët e organizatave-bazë. Është e kuptueshme që këta pajtjetër duhet ta zotërojnë mirë problemin, që ta udhëzojnë dhe ta ndihmojnë mirë Partinë, të kontrollojnë

zbatimin dhe të nxjerrin konkluzionet e përshtatshme, por, në rast se këto çështje nuk bëhen problem i gjithë Partisë, atëherë zgjidhja e tyre do të bëhet e çalë. Partia ka një përvojë të madhe për pranimet dhe shtrirjen e Partisë, por ne duhet të njohim se në këtë përvojë nuk ekziston sa duhet kuptimi i thellë shkencor dialektik marksist-leninist i problemeve kapitale të jetës së Partisë. Në këto çështje ne konstatojmë spontaneitet, punë me hope, subjektivizëm, shfaqje hatëresh në pranime, sektarizëm, patriarkalizëm, liberalizëm e shfaqje të tjera, që nuk lejojnë të bëhet si duhet zhvillimi i Partisë. Të gjitha këto shfaqje duhet të luftohen, por kjo nuk arrihet pa ngritjen e domosdoshme ideologjike të anëtarëve të Partisë, pa u marrë seriozisht me problemet organizative të Partisë e gjithë Partia, të gjithë komunistët. Duhet t'ua mësojmë, pra, të gjithë komunistëve metodën e punës organizative të Partisë dhe orientimin ideologjik dhe politik në këtë çështje, t'i bëjmë shokët të kuptojnë se çështjet organizative të partisë nuk janë probleme zyre, burokratike, shifrash ose rregullash të ngurta, se ato kanë të bëjnë me zbërthimin e direktivave ideologjike dhe politike të Partisë. Prandaj, kërkohet një metodë sa më e përsosur që puna organizative të mundë t'i konkretizojë këto direktiva ideologjike dhe politike.

Kur nxjerrim një direktivë për çështje organizative në Parti, do të thotë që ajo është ndier nga një nevojë ideologjike e politike e Partisë, se atë e kanë kërkuar momentet e zhvillimit ekonomik dhe politik, e ka kërkuar vetë zhvillimi i Partisë. Kur themi se

një organizatë partie është plakur dhe ka nevojë për gjak të ri, kjo nuk duhet kuptuar aq thjesht, duke menduar se me të pranuar dy të rinj problemi është zgjidhur. Po të veprohet kështu, atëherë tregon se çështjet organizative të Partisë nuk kuptohen mirë. Kur themi se kjo apo ajo organizatë-bazë nuk punon mirë, se në të ka dobësi, se nuk e mbulon dot territorin ku vepron, domethënë nuk ka komunistë sa duhet dhe ku duhet, se tek ajo mungojnë elementë punëtorë, shoqe, elementë të rinj ose nuk ka ndonjë arsimtar në gjirin e saj etj., duke e shikuar në këtë prizëm të gjerë, atëherë del se ky problem organizativ nuk është aq i thjeshtë, po i ndërlikuar. Pikërisht, ashtu siç është e gjerë dhe e thellë direktiva politike dhe ideologjike, po kështu duhet të jetë edhe forma dhe metoda e punës që do të ndiqet për ta zbatuar sa më mirë atë. Duhet organizuar, pra, zbatimi i direktivës dhe me këtë kuptojmë punën organizuese të Partisë, pa të cilën direktiva e dhënë mbetet pa u zbatuar. Nga organizimi i mirë i punës varet edhe suksesi i zbatimit të direktivës. Nuk mund të kuptohet, pra, që një komunist, i cili ka për detyrë të parë të zbatojë direktivën, të mos interesohet si duhet për çështjet organizative të Partisë. Në asnjë mënyrë. Në çdo gjë, në çdo punë, kërkohet organizim i fortë. Vetë partia është një repart i organizuar i klasës punëtore. Një parti e organizuar mirë, që e kupton si duhet ideologjikisht rëndësinë e çështjeve organizative, direktivat, rregullat dhe Statutin e Partisë, nuk i zbaton automatikisht dhe në mënyrë administrative. Kur ajo shikon se në një organizatë-bazë punët nuk ecin, merr

masa edukuese dhe organizon punën në ato drejtime të shumta që përmenda më lart.

Do të jetë gabim, pra, në rast se çështjet organizative të Partisë nuk i merr në dorë e gjithë Partia; do të jetë gabim që ato të kuptohen në mënyrë burokratike; do të jetë gabim në qoftë se nënvleftësohen këto probleme dhe ua lëmë në dorë vetëm aparateve të Partisë dhe përgjegjësve të këtyre aparateve; do të jetë gabim në rast se në krye të këtyre aparateve nuk vihen shokë që të jenë nga njerëzit më të mirë të Partisë, me aftësi të mëdha politike, ideologjike dhe organizative.

Për jetën e Partisë duhet të interesohen të gjithë komunistët. Por, kur flasim për interesimin që duhet treguar për problemet organizative nga ana e sekretarëve të komiteteve të Partisë, kjo do të thotë që me to të merret ose sekretari i parë, ose një nga sekretarët e tjerë, por që ka një përvojë më të madhe, një nivel më të ngritur ideologjik e politik. Sekretari që merret me çështjet organizative të Partisë dhe ndihmësit e tij, duke njohur mirë direktivat politike, ideologjike dhe ekonomike të Partisë, duhet t'i shikojnë çështjet organizative në funksion të këtyre direktivave. Për shembull, kur venë në bazë, jo të shohin si është prashitur misri, po të shohin si e kupton dhe si e organizon organizata-bazë punën për zbatimin e direktivës së Partisë për rritjen e rendimentit të misrit etj., etj.

Në shokët që merren me çështjet organizative të Partisë, ka prej tyre që zakonisht bien në dy lloj gabimesh:

Së pari: Jetën e organizatave ata e kontrollojnë

dhe e shikojnë shumë ngushtë, disa herë rekomandojnë, pa u thelluar mirë, masa të cekëta dhe harrojnë ndihmën efektive, të gjallë, në perspektivë, që i duhet dhënë organizatës. Ata merren me gjëra që nuk i takojnë drejtpërdrejt Partisë, në vend që të organizojnë një punë të thellë politike dhe ideologjike me njerëzit. Duke vepruar kështu, ata i mësojnë keq edhe shokët e bazës.

Së dyti: Merren më shumë me çështje ekonomike dhe harrojnë se vetëm një parti e kalitur, e ngritur ideologjikisht e politikisht, e organizuar si duhet, është në gjendje të zgjidhë mirë edhe probleme ekonomike. Kjo nuk do të thotë se ata nuk duhet të interesohen për problemet ekonomike e për çështje të tjera, pse atëherë puna e tyre organizative nuk do të kishte objektiva, por as këta dhe askush nga punëtorët e tjerë të Partisë, në asnjë moment të mos harrojnë se pa Partinë e organizuar mirë asgjë nuk bëhet si duhet. Punët organizative të Partisë nuk janë të ndara me mur nga problemet ekonomike, arsimore, kulturore etj. Përkundrazi, ato janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Por ato duhet të kombinohen, të harmonizohen, të ndihmojnë dhe të kontrollojnë njëra-tjetrën, të pasurojnë përvojën, diturinë dhe zotësinë e Partisë.

Puna që po bëjmë aktualisht nuk është e re, por mund të them se është një punë që po fillojmë ta bëjmë me një stil të ri, më të kualifikuar. Zakonin e keq te disa shokë që i mbulon kënaqësia, duke thënë se «bëmë një punë të mirë» dhe pastaj këtë ia lënë spontaneitetit, duhet ta luftojmë. Puna e Partisë është e përditshme, me suksese e me të meta, për atë nuk

duhet të na zërë gjumi e jo më të punojmë përcip-tazi ose me hope. Komitetet e Partisë ta ndjekin vazhdimisht këtë problem, të ndihmojnë, të kontro-llojnë, të korrigojnë dhe të ndryshojnë. Me një fjalë, të jenë kurdoherë të ngritur, të zgjuar, revolucionarë, që Partia jonë të mos plakët kurrë, përkundrazi, të jetë kurdoherë plot shëndet dhe revolucionare.

Në vendin tonë klasa punëtore është rritur dhe po rritet çdo ditë në numër, po ngrihet gjithashtu edhe niveli i saj politik, ideologjik dhe teknik. Në çdo rreth ne kemi një numër të konsiderueshëm punëtorësh me ndërgjegje të lartë klasore, kemi shumë punëtorë me aftësi të mëdha drejtuese, jo vetëm në zanatin ose në ndërmarrjet e tyre, por që kanë arritur pjekurinë e nevojshme të drejtojnë edhe punët kyç të Partisë, të pushtetit, të ekonomisë dhe të kulturës. Ky është një sukses shumë i madh i arritur në sajë të vijës së drejtë klasore të Partisë.

Këta punëtorë të dalluar, qoftë me origjinë, qoftë me gjendje punëtore, me një stazh të gjatë si punëtorë drejtpërdrejt në prodhim, ruajnë të pastër ndërgjegjen e klasës, me të cilën i ka kalitur Partia, ruajnë dhe duhet të ruajnë tërë jetën virtytet e larta të punëtorit pararojë. Kjo ndërgjegje klasore dhe këto virtyte të punëtorit të pararojës shumë herë nuk çmohen sa duhet, veçanërisht nga forumet udhëheqëse të Partisë, kur është çështja (dhe kjo është çështje kryesore) për t'i zgjedhur këta në vendet udhëheqëse të Partisë, në plenumet, dhe sidomos në byrotë e komiteteve të Partisë.

Përse ngjet kjo? A mund ta quajmë këtë një

pengesë të vetëdijshme? A mund ta quajmë këtë një nënvleftësim të direktivës, apo një shpirt të sëmurë burokratik intelektualësh, nëpunësish partie, që kanë fituar një përvojë pune e drejtimi dhe nënvleftësojnë, me dashje ose pa dashje, zotësitë e punëtorëve e, mbi të gjitha, ndjenjat e virtytet klasore të tyre? Apo mos vallë udhëheqjet e Partisë zbatojnë në mënyrë shabllone disa praktika organizative, që kanë qenë të nevojshme dhe të drejta për një periudhë, por, që me rritjen dhe forcimin e Partisë, me rritjen dhe forcimin e klasës punëtore, me rritjen dhe ngritjen e kuadrove në përgjithësi dhe me perfeksionimin e organizmave duhen ndryshuar?

Ka diçka nga të gjitha këto që përmenda më lart, por, në përgjithësi, këto bëhen në mënyrë jo të vetëdijshme, jo me qëllim të keq, aspak për të shtrembëruar vijën në këtë çështje parimore. Sidoqoftë, neve na vihet si detyrë që në udhëheqje të Partisë të sjellim më me shumicë elementë të klasës punëtore, ta bëjmë këtë në një shkallë më të madhe nga sa e kemi bërë më parë, kur kemi qenë të detyruar nga rrethanat objektive, por, disa herë, mundet padashur, edhe nga rrethanat subjektive. Ta shohim më thellë këtë problem dhe të marrim masat e përshtatshme që ta zgjidhim si duhet, t'i japim rëndësinë që meriton.

Partia ka pasur kurdoherë parasysh që në plenumet e komiteteve të Partisë të zgjidhen elementë të klasës punëtore dhe, në fakt, sa herë janë bërë zgjedhje, në udhëheqje të Partisë kanë ardhur shokë punëtorë. Në përgjithësi, nuk mund të themi se ngjitja e elementëve punëtorë në byrotë e komiteteve të Partisë

të rretheve dhe në kryesitë e organeve qendrore të organizatave të masave (mundet, me përjashtim të bashkimeve profesionale) bëhet në mënyrë të kënaqshme. Kjo është një e metë serioze parimore, që duhet ta ndreqim, duke përmirësuar përbërjen e byrove të komiteteve të Partisë dhe të kryesive të organizatave të masave me shokë dhe shoqe punëtorë.

Pse ngjet kjo, ç'të keqe ka dhe ç'duhet të bëjmë? Mendoj se këtu nuk ka ndonjë sëmundje, pse Partia e ka pasur kurdoherë në kujdes çështjen e përbërjes klasore të vetvetes dhe të udhëheqjes së saj. Por kjo mund të bëhet një sëmundje, një rrezik, në rast se nuk e përmirësojmë punën.

Sigurisht, Partia ka sjellë në udhëheqje njerëz nga më të dalluarit, më të vendosurit, të qartë politikisht dhe ideologjikisht në vijë. Ky ka qenë dhe mbetet një orientim i drejtë. Shumë prej tyre fituan edhe një përvojë të mirë dhe stazh në punë partie. Shumë prej këtyre nuk ishin me origjinë ose me stazh punëtor, por kishin stazhin e madh të luftës dhe të rindërtimit, kishin besnikërinë ndaj Partisë, ndaj marksizëm-leninizmit. Gradualisht në udhëheqje erdhën edhe punëtorë, por në Parti ata me origjinë dhe stazh jopunëtor përbënin kurdoherë dhe akoma përbëjnë shumicën. Në kushtet tona një zhvillim i tillë i këtij problemi ishte, mund të themi, objektiv e normal dhe zbatimi i përpiktë i vijës bëri dhe bën që Partia të mos ketë rreziqe në udhëheqje. Por mendoj se me gjithë kujdesin që është treguar, në mënyrë të pandërgjegjshme, mendohet edhe tashti se punëtorë për në udhëheqje kemi, por akoma jo sa duhet për në nivelin e

byrove të komiteteve të Partisë të rretheve. Ky mendim nuk është i drejtë, nuk i përgjigjet realitetit. Atëherë, çfarë na e ushqen këtë mendim jo real dhe çfarë na bën të hezitohet e të ngurrojmë për të sjellë më me shumicë elementë të klasës punëtore në të gjitha instancat e udhëheqjes?

Këtë ngurrim, në radhë të parë, na e sjell mbi-vlerësimi që i bëjnë vetes shokët që kanë stazh pune si udhëheqës partie dhe që, dashur pa dashur, arrijnë të mendojnë se janë të pazëvendësueshëm, ose që nuk kanë sigurinë se një shok ose shoqe punëtore do ta kryejë si duhet detyrën në udhëheqje, sepse i nënvleftësojnë aftësitë e tyre. Ky «qeder» që punët të shkojnë mirë ka dhe krimbin e një mentaliteti jo të shëndoshë klasor, të një fryme burokrati dhe intelektual mikroborgjez, pse, në fakt, kështu nënvleftësohen kapacitetet e mëdha të klasës punëtore, kapacitetet drejtuese, organizuese dhe, mbi të gjitha, vendosmëria e klasës. Shokët, pa dashje, harrojnë punën e tyre në fillim. Të gjithë ne, kur horizontin e kishim më të ngushtë, me punë, me luftë, me suksese e me gabime, mësuam të drejtojmë. Kështu, kur punëtori merr tornon në dorë, ai bëhet, në punë e sipër, tornitor i mirë. Duke e sjellë atë edhe në udhëheqje, ai do të mësojë të drejtojë gjithnjë e më mirë.

Duhet të luftojmë çdo pikëpamje intelektualiste ose burokratike lidhur me këtë problem të dorës së parë. Të mos nisemi nga mendimi se në udhëheqje lipset të vijmë njerëz që të dinë edhe të flasin si oratorë, edhe të shkruajnë si shkrimtarë, edhe të jenë të mësuar si profesorë të ditur. Natyrisht, Partia nuk

duhet të sjellë në udhëheqje punëtorë me nivel të ulët, por, tash, ne kemi punëtorë që i kanë të gjitha kualitetet e një udhëheqësi të vërtetë dhe që në udhëheqje do t'i perfeksionojnë më tej.

Prandaj, Partia, mendoj unë, të tregojë kujdesin më të madh për përbërjen e udhëheqjes, të ecë me kohën, me nevojat, me zhvillimin dhe me kushtet reale të saj. Në rast se më parë kushtet ishin të atilla që të kishim pak punëtorë në udhëheqje, tash që kushtet kanë ndryshuar rrënjësisht dhe ka mundësi që të vijnë më me shumicë punëtorë në udhëheqjet e Partisë, kjo praktikë, që dikur ishte e nevojshme, të mos përjetësohet, sepse bëhet një zakon i rrezikshëm burokratik. Zgjedhja me shumicë e elementëve të klasës punëtore në udhëheqjet e Partisë do t'i forcojë jashtëzakonisht këto në të gjitha drejtimet, do të zhdukë në to çdo frymë intelektualizmi dhe çdo mbeturinë mikroborgjeze në mendime dhe në punë. Kur mungojnë elementët e klasës, të njerëzit e zgjedhur në organet udhëheqëse ka rrezik të zhvillohen vetëkënaqësia, mendjemadhësia, burokratizmi, mëritë, smira, fërkimet, hatëret e mbetura, lajkat, zënkat, të cilat mund të degjenerojnë edhe në devijime politiko-ideologjike. Ky është një rrezik i madh. Edhe në Partinë tonë kemi pasur elementë të tillë, të cilëve ajo u ka treguar vendin, por nuk duhet harruar ç'u bë në Bashkimin Sovjetik dhe në partitë e tjera revizioniste. Ne nuk duhet të lejojmë qoftë edhe shfaqjen më të vogël të degjenerimit.

Nga ana tjetër, të mos mendohet sikur udhëheqja e Partisë është një me aparatet e Partisë. Udhë-

heqja është udhëheqje dhe aparati është aparat në shërbim të saj. T'i përziejme këto të dyja, bëjmë gabim të madh, pse udhëheqjen e kthejmë kështu në aparat dhe udhëheqësit në «aparatchikë» dhe, në këtë rast, udhëheqja burokratizohet. Ky kuptim dhe kjo praktikë pune, ky rrezik, ekziston për sekretarët e komiteteve të Partisë dhe për ata anëtarë të byrove të komiteteve që janë lidhur drejtpërdrejt me aparatet e Partisë ose me ato shtetërore. Ky rrezik nuk është imagjinar dhe është vështirë të luftohet, në rast se nuk sjellim në byrotë e komiteteve shokë punëtorë.

Në këtë mbivlerësim të rrezikshëm të rolit të aparateve ne duhet të kërkojmë dhe do të gjejmë edhe një pjesë të shkaqeve të atij nënvleftësimi për punëtorët që, gjoja, «nuk janë pjekur për në udhëheqje». Mendohet, në këtë rast, se «pjekja» e tyre do të vijë atëherë, kur ata të jenë pleksur me ingranazhin burokratik të aparateve. Ky mendim i gabuar duhet luftuar si në parim, ashtu edhe në praktikë.

Mendoj se praktika e deritanishme sikur i ka lejuar të zhvillohen këtë mendim dhe praktikë të gabuar që kanë penguar futjen e elementëve punëtorë, sidomos, në byrotë e komiteteve të Partisë. Deri në zgjedhjet e fundit, kur ne e shtuam me kandidatë numrin e anëtarëve të byrove të komiteteve të Partisë të rretheve, gati të gjithë anëtarët e byrove i kishim (dhe i kemi edhe aktualisht) me funksione drejtuese jo vetëm në sektorë të ndryshëm por edhe në aparate. Nga kjo praktikë që është ndjekur na del se tani gati të gjithë sekretarët janë anëtarë të byrosë; anëtarë të byrosë janë gjithashtu kryetari i degës së punëve të

brendshme, sekretari i parë i rinisë, kryetarja e gruas, ai i bashkimeve profesionale, përgjegjësi kryesor i ushtrisë në rreth dhe ndonjë drejtor fabrike, kryetar kooperative bujqësore ose prokuror. Kështu, duke shkuar nga parimi që në byro duhet të ketë nga një titullar të çdo sektori të madh pune, natyrisht, atje vijnë drejtuesit kryesorë të këtyre sektorëve dhe, kështu, s'mbetet vend për të tjerë, pavarësisht se ata që zgjidhen janë shokë nga më të mirët.

A duhet të vazhdojmë me këtë praktikë, apo të studiojmë ç'ndryshime pozitive duhet t'i bëjmë kësaj situatë për ta forcuar punën edhe në drejtim të atyre që thashë më lart, por edhe për zhdukjen e familjaritetit që mund të krijohet në byro, në dhënien si duhet të llogarisë përpara udhëheqjes etj.?

Unë propozoj që, më parë se të vendosim, këtë problem ta studiojmë në bazë. Për shembull, do të mendoja që jo të gjithë sekretarët e komitetit të Partisë të jenë anëtarë të byrosë së komitetit të Partisë të rrethit, jo kurdoherë dhe në çdo rast është e domosdoshme që udhëheqësit e organizatave të masave ose të organeve shtetërore të jenë anëtarë të byrosë së komitetit të Partisë. Në këtë mënyrë në komitetet e Partisë të rretheve do të kemi edhe sekretarë që nuk do të jenë anëtarë të byrosë. Sekretariati, ku mund të zgjedhim edhe ndonjë nga drejtuesit e organizatave të masave, do të ketë funksionet dhe detyrat e tij: do të drejtojë aparatit, do të përgatitë materialet dhe do t'i shtrojë probleme udhëheqjes, do të ndihmojë e do të kontrollojë zbatimin e vendimeve të saj. Të gjithë anëtarët e sekretariatit, që nuk do të jenë anëtarë të by-

rosë, të marrin pjesë në mbledhjet e byrosë me të gjitha të drejtat, por jo me të drejtë vote.

Kështu, mendoj unë, udhëheqjen do ta çlirojmë nga zinxhirët e aparateve dhe do të kemi mundësi të sjellim në të më shumë shokë punëtorë. Me një fjalë, kështu do të përmirësojmë përbërjen e udhëheqjes dhe do të forcojmë punën drejtuese. Prandaj, duke u thelluar në këtë problem, ne ta studiojmë më parë atë dhe pastaj të vendosim.

Së fundi, dua të prek edhe një çështje tjetër me rëndësi për Partinë, atë të ngritjes së kuadrove të rinj.

Kuadrot e rinj, me një pjekuri të madhe politiko-ideologjike, po shpërthejnë me të vërtetë si një vullkan. Në to ne duhet të kemi besim të madh, si për besnikërinë e tyre politike, ashtu edhe për zotësitë e tyre organizative, politike dhe teknike.

E rëndësishme është që të heqim dorë nga njohja e kuadrit vetëm nëpërmjet fishave e formularëve, nëpërmjet formulave të skedarëve të paazhurnuar, pa shpirt, që jeta i lë pas. E them këtë sepse, kur vjen çështja e plotësimit të ndonjë nevoje për kuadro, gjendemi shumë ngushtë, pikërisht kur ne kemi me mijëra e mijëra nga ata. Atëherë ç'bëjmë? U referohemi skedarëve dhe bëhemi skllever të tyre, ato na bëhen hajmali. Administrata na mbyl me rekomandimet e saj, mendimi i saj predominon, sepse udhëheqja vendos sipas mendimit të shokut që merret me kuadrin, pse kemi më shumë besim në disa letra të thata sesa në njohjen e kuadrit në punë dhe në jetë. Kuadri mëson, zhvillohet, përparon çdo ditë në mënyrë të mrekullueshme, ndërsa kur na paraqiten ato pesë

radhë të biografisë së tij zyrtare, në të do të gjejmë të dhëna të vjetra, shumë herë disa karakteristika që i janë qepur si ferrë biografisë së kuadrit, në një kohë kur kjo biografi e gjallë ka bërë ndryshime të mëdha pozitive.

A mund të ecet kështu? Natyrisht jo. Po ç'bëjmë atëherë? Vazhdon sëmundja e vjetër: vijmë rrotull disa kuadrove të njohur, të cilët i lëvizim si gurët e shahut, i mbivlerësojmë, sikur pa ata të mos bëhej asgjë e mirë, i ngarkojmë me kushedi sa përgjegjësi, që shumë herë nuk kryejnë asnjë si duhet, në një kohë kur sa e sa të tjerë janë aftësuar e janë bërë të zotë. Ne kujtojmë se në këtë mënyrë, duke qenë në rregull me skedarët e sektorit apo të degës së kuadrit dhe me të dhënat e saj, veprojmë mirë, por harrojmë (dhe për këtë ndërgjegjja s'duhet të na lërë të qetë) se kështu frenojmë punën, pengojmë lumin e vrullshëm të ujitë arat e t'i bëjë pjellore dhe u rritim mendjen disa kuadrove, të cilët hiqen gjoja si të pazëvendësueshëm, pse janë bërë, si të thuash, të përkëdhelurit e komiteteve dhe të skedarëve të sektorit të kuadrit.

Po a na duhen këta skedarë? Na duhen dhe ne themi vazhdimisht që ata të pasurohen çdo ditë. Mirëpo kjo nuk bëhet. Por, edhe sikur të bëhej si duhet, kjo nuk mund të konsiderohet kurrë e mjaftueshme. Skedarëve ne duhet t'u referohemi, por të mos bëhemi skllëvër të tyre, njerëzit t'i njohim kryesisht në punë, në jetë, në zhvillimin e tyre të vazhdueshëm.

Kush mund t'i njohë gjithë këta njerëz, gjithë këtë mori kuadrosh? A do të mjaftonin për këtë punë

vetëm shokët që merren me kuadrin, bile duke u shtuar këtyre edhe instruktorët e sekretarët e komiteve të Partisë? Në asnjë mënyrë jo. Por, në realitet, ne mjaftohemi me këta. Në parim themi që kuadrot t'i njohë Partia, por në praktikë nuk ngjet plotësisht kështu. Udhëheqja e pyet organizatën-bazë, po për atë që cakton ajo, dhe nuk kërkohet që propozimin për kuadrin ta bëjë vetë organizata-bazë që e njeh në punë, në jetë. Kjo pak bëhet dhe këtu qëndron e keqja.

Kur themi që çështja e kuadrit të jetë në dorën e Partisë, kjo kështu ka qenë dhe kështu duhet të jetë. Politikën e kuadrit ne në asnjë mënyrë të mos e katandisim që të bëhet nga dy-tre persona që mbështeten në skedarë.

Për njohjen e kuadrove, për vlerësimin e tyre objektiv, as mbledhjet e shumta të Partisë, as ato të organeve të pushtetit nuk mund të quhen të mjaftueshme përpara njohjes në dinamizmin e jetës. Por mbledhjet kanë një rëndësi të madhe jo vetëm për problemet që shtrohen e diskutohen në to dhe për vendimet që merren, por edhe për njohjen e kuadrit. Problemit të fundit i vihet pak rëndësi. Udhëheqësit që marrin pjesë në mbledhje, duhet të nxjerrin konkluzione për kuadrot, duke mos harruar se Partia i njeh kuadrot në tërësi, me të mirat dhe me të metat e tyre, jo vetëm në mbledhje, por, sidomos, në jetën e përditshme dhe kjo është njohja kryesore. Këtu duhet të mbështetet kryesisht puna për njohjen e kuadrit dhe për vlerësimin e meritave e të aftësive të tij.

Megjithatë, ç'po shohim nëpër mbledhjet? Ç'pamë

në Kongresin e fundit të gruas? Ne pamë atje gra e vajza të mrekullueshme të Partisë dhe të popullit, pamë gra e vajza të malësisë, kooperativiste, mësuese fshati etj., që diskutuan me zjarr e vendosmëri të madhe, me një pjekuri politike, që elektrizuan me mijëra veta. Mirëpo, kur vjen puna për të zgjedhur një përgjegjëse gruaje në rreth, atëherë harrohen këto gra e vajza të mrekullueshme, shokët fillojnë të qahen se s'kanë kuadro dhe më në fund kthehen si kurdoherë te ndonjë shoqe e vjetër, që është e mirë, por që tani ka të tjera edhe më të mira e që, nga shumë anë, atë e kanë lënë pas. Askush nuk duhet t'u mohojë kuadrove të vjetër meritat që kanë. Ata duhen respektuar, pse pikërisht puna e tyre ka kontribuar fuqimisht në krijimin e një situatë të tillë, por ata nuk duhet të bëhen barrikadë për të rinjtë dhe udhëheqja, veçanërisht, nuk duhet të shërbejë për të ferrobetonuar këto barrikada me praktika jo të drejta dhe jo të zhdërvjellëta në zbatimin e politikës së kuadrit.

Duke dëgjuar në Kongresin e BGSH-së ato gra dhe vajza që flisnin me aq zjarr, aq rrjedhshëm, pa fraza stereotipe për problemet e tyre të mëdha, probleme të Partisë, të shtetit, të shoqërisë mbarë, për problemet e emancipimit të plotë të gruas, mendoja se ka ardhur koha që në vetë kuadrot udhëheqës të Partisë duhet bërë një emancipim serioz nga frazeologjia stereotipe, nga diskutimet «raport», me vend e pa vend, ku mjaft shokë përpiqen t'i thonë të gjitha nga një çikë pa harruar asgjë, që nga a-ja deri te zh-ja, pse mendojnë që kështu «afirmohen» si udhëheqës dhe harrojnë se disa herë bëhen të mërzitshëm. Mendojnë

se shtrojnë probleme, dhe në fakt shtrojnë, por vetëm majën e veshit të tyre, në vend që të kapin një ose dy probleme dhe atyre t'u shkojnë deri në fund. Shtrimi i problemeve në këtë mënyrë është mbeturinë e asaj kohe kur ne ishim të rinj dhe pa shumë përvojë në punë dhe në drejtim. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se metoda e punës sonë s'ka qenë e dobishme dhe e efektshme. Në asnjë mënyrë jo, pse ishte ajo metodë që solli rezultatet e tanishme. Gjithashtu nuk do të thotë se metoda e punës sonë, gjatë gjithë këtyre viteve që kanë kaluar, s'ka pësuar ndryshime pozitive, qoftë në brendi, qoftë në forma. Jo, ajo metodë ka pësuar ndryshime, bile, të habitshme, progresive. Por puna qëndron në çështjen që ne të ecim krahas me zhvillimin e vrullshëm të jetës, të kërkesave të kohës. Dhe që të ecim me kohën, lipset të spastrojmë nga metoda e punës sonë ato forma të vjetruara pune që në një kohë kanë qenë të drejta dhe kanë dhënë fryte të mira, por që tash zhvillimi i jetës së vendit tonë i ka lënë prapa dhe kërkon forma të tjera, të reja e më të larta.

Ku do t'i gjejmë ne këto forma e shprehi të reja? Në punën e madhe, në përvojën kolosale të Partisë, në mundësitë reale dhe të mëdha në veten tonë, të gjithsecilit. Me përpjekje dhe me një kujdes më të madh do të shohim me sa njohuri na kanë pajisur Partia, puna, lufta, revolucioni.

Ne kuadrot e vjetër kemi qenë dhe jemi mësues të kuadrove të rinj, të këtyre njerëzve të thjeshtë të popullit dhe të Partisë dhe ky është një satisfaksion i madh. Por ne nuk duhet të mendojmë se lindim më-

sues dhe do të vdesim vetëm mësues. Duke qenë edhe mësues, ne duhet të jemi, në radhë të parë, kurdoherë nxënës. Pra, t'i kthejmë sytë, mendjen dhe zemrën e të mësojmë nga kuadrot e rinj, që ne vetë i kemi mësuar, se si t'i shtrojmë problemet, rrjedhshëm, thjesht e thellë, me zjarr e me qartësi, me dinamizëm krijues, me logjikën e fortë të popullit. Këtu qëndron forca jonë, forca e marksizëm-leninizmit, forca e fjalës së komunistëve.

Ky emancipim është i domosdoshëm të bëhet nga ne, pse nuk do të jetë i shëndetshëm vetëm për ne, por edhe për ata që kanë etje të mësojnë nga ne. Në qoftë se nuk e bëjmë këtë emancipim, atëherë ne do t'i mësojmë keq kuadrot dhe njerëzit, gjë që nuk është as e mirë, as e drejtë, se i frenojmë këta kuadro dhe këta njerëz që vërshojnë përpara si ujë i kulluar. Dhe kjo është akoma më e keqe.

T'i kemi, pra, parasysh këto gjëra, mendoj unë, në punën e përditshme të Partisë.

Problemet që shtrova sot, propozoj t'i studiojmë më parë, pastaj t'i sjellim përsëri për shqyrtim dhe aprovim në Sekretariat.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Se-
kretariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

REVIZIONISTËT I DEMASKON LUFTA DHE QËNDRIMI I PATUNDUR I MARKSISTË-LENINISTËVE

Nga biseda me delegacionin e grave kineze

11 nëntor 1967

Pasi u përshëndet me pjesëtarët e delegacionit, e mori fjalën shoku Enver Hoxha:

Bëtë mirë që erdhët të takohemi së bashku. Ju falënderoj shumë dhe dëshiroj t'ju shpreh gëzimin që ju kemi midis nesh.

Ne marksistë-leninistët e kuptojmë çështjen e miqësisë dhe të dashurisë për njëri-tjetrin jo sikurse e matin revizionistët në marrëdhëniet në mes tyre, domethënë, me vënien e interesave egoistë të ngushtë materialë në plan të parë. Miqësia jonë mbështetet në besnikërinë ndaj parimeve marksiste-leniniste, ajo ushqehet nga ndjenja të tilla të pastra e të ndritshme që mbi të gjitha vënë interesat e mëdha të revolucionit, të çlirimit të të gjithë popujve nga kuçedra imperialiste dhe revizioniste. Një miqësi e tillë parashikon kompaktësinë e pathyeshme në betejat revolucionare që kemi përpara, sakrificat e gjakderdhje, sepse imperializmi dhe revizionizmi nuk i dorëzojnë lehtë

armët. Prandaj, duke ditur këtë gjë, duke marrë parasysh të gjitha këto, sepse jemi revolucionarë, miqësia në mes nesh, në kohë të qeta dhe në furtuna, merr një kuptim edhe më të madh.

Revizionizmi është një mashtrim i madh për popujt, për komunistët, është një rrymë e rrezikshme e maskuar në shërbim të plotë të imperializmit. Por maska e tij nuk mund të qëndrojë për shumë kohë. Revizionistët përpiqen të kenë fytyra të ndryshme, por kjo i demaskon ca më tepër ata. Revizionistët modernë i demaskon, në radhë të parë, lufta dhe qëndrimi i patundur i marksistë-leninistëve dhe i të gjitha partive marksiste-leniniste. Çdo ditë që kalon ne i demaskojmë gjithnjë e më shumë qëndrimet e tyre, prandaj ata vazhdimisht po humbasin, si të thuash, edhe atë pak mbështetje të dobët që kanë. Çështja e shpartallimit të tyre total nuk shtrohet për një vit e për dy, por ai është i sigurt. Njerëz të këtillë të pabesë, që mohojnë jo vetëm marksizëm-leninizmin, por edhe gjakun e qindra mijë njerëzve që kanë rënë në luftë për çlirimin e tyre, do të hidhen të tërë në varr, kurse ne do të fitojmë, sepse jemi në rrugë të drejtë. Të tillë hrushovianë të maskuar keni ju andej nga Azia, por kemi dhe ne këndeje nga Evropa. Megjithatë ata nuk na gënjejnë dot. Qëndrimet e tyre pseudomarksiste-leniniste tregojnë se ata janë armiq të maskuar të popujve të tyre në radhë të parë, por dhe të lëvizjes komuniste botërore.

Përpara thoshin që fantazma e komunizmit që vjen rrotull botës po tmerron kapitalizmin. Tani komunizmi ekziston dhe është i fuqishëm, sepse janë të gjitha

forcat marksiste-leniniste që militojnë në tërë botën që i bëjnë imperialistët dhe revizionistët të dridhen, kurse popujt gëzohen, marrin forcë, marrin shembull, fitojnë eksperiencë, armatosen, luftojnë. Idetë marksiste-leniniste na tregojnë se jo vetëm popujt e mëdhenj prej dhjetëra apo qindra milionësh mund të fitojnë lirinë e pavarësinë. Këto ide përbëjnë një armë të fuqishme që i jep edhe një populli të vogël, një forcë kolosale dhe bindjen se, edhe pse i vogël, kur është i edukuar dhe i frymëzuar për revolucion, mund të hedhë në erë edhe një fuqi të madhe.

Kundër revizionistëve modernë janë mobilizuar të gjitha partitë e vërteta marksiste-leniniste dhe grupet revolucionare në botë. Nuk do të jetë e largët koha kur këto grupe, sot të vogla, nesër do të transformohen në parti të mëdha revolucionare dhe do të udhëheqin popujt në luftë për t'u bërë varrin imperialistëve amerikanë, revizionistëve sovjetikë, gjithë revizionistëve të tjerë dhe të gjithë atyre që mbajnë një qëndrim të dyfishtë, që qëndrojnë në dy karrige.

Imperialistët dhe revizionistët shpresonin që me anën e «kalit të Trojës», Hrushovit të Kinës të ju, ose me tradhtarët që dolën në Partinë tonë, të rrëzonin diktaturën e proletariatit në vendet tona. Por idetë marksiste-leniniste lëshojnë rreze të forta dhe lufta e marksistë-leninistëve do t'i shkatërrojë të gjitha shpresat e tyre.

Në vendin tonë, siç e patë gjatë vizitave, ekonomia ecën me vrull përpara, duke krijuar çdo vit e më shumë mundësi për ngritjen e nivelit të jetës së popullit. Kurse revizionistët janë në kriza të mëdha po-

litike dhe ekonomike. Për të dalë nga këto kriza, ata kanë kërkuar «ndihmë» tek imperializmi amerikan dhe te vendet e tjera kapitaliste. Kapitalet e imperialistëve kanë vërshuar në ekonominë e tyre dhe kanë zënë pozita kyç. Pra, në çdo gjë revizionistët po bëjnë prapakthehu.

Kurse te ne, siç e patë vetë, punët ecin përpara në mënyrë të pandalshme dhe rezultatet janë të mëdha në të gjitha fushat. Natyrisht, edhe vështirësi, të meta e gabime kemi, por ashtu sikurse nuk na dëhin sukseset, edhe të metat, gabimet e vështirësitë nuk na dëshpërojnë, por me besim të patundur punojmë dhe luftojmë për t'i kapërcyer e për t'i ndrequr ato.

Ju u takuat me shoqet shqiptare dhe mund të themi që ato janë duke bërë një revolucion të madh. Gratë e vendit tonë janë revolucionare të patrembura, ato karakterizohen në çdo drejtim nga një vullnet i hekurt për të mësuar, për t'u edukuar dhe për të luftuar. Ato hidhen në zjarr për të vënë në zbatim vijën e Partisë. Këto janë karakteristika nga më të lavdishmet të grave tona, prandaj Partia jonë i ka vënë një kujdes të jashtëzakonshëm emancipimit të mëtejshëm të tyre. Si rezultat, në këtë drejtim te ne janë bërë përparime të mëdha, por në ndërgjegjen e njerëzve tanë ekzistojnë akoma shumë pengesa, të cilat, kemi bindjen e plotë se nëpërmjet hovit revolucionar që na karakterizon, do t'i zhdukim dhe do t'i zëvendësojmë me pikëpamje të reja për gratë që këto të bëhen mbështetje me të vërtetë të çelikut të shoqërisë sonë. Është me rëndësi të madhe që te ne është kuptuar drejt,

si nga gratë dhe nga burrat, se nuk janë burrat që ua japin këto të drejta grave, por janë ato vetë që i fitojnë dhe që duhet të luftojnë për t'i fituar të drejtat e tyre. Për këtë kudo ka unitet mendimi midis burrit dhe gruas, të cilët, nën udhëheqjen e Partisë, luftojnë për të ecur së bashku. Ne sot shohim gjithë këto rezultate që kemi arritur, por nesër do të shohim arritje shumë më të mëdha që do të jenë pasojë e revolucionit të madh socialist që po bëhet në vendin tonë dhe veçanërisht e pjesëmarrjes së gruas në të gjitha aktivitetet e fushat e jetës. Prandaj ne jemi shumë optimistë. Revolucionarët janë kurdoherë optimistë, edhe në kohë të vështira, sepse e dinë që do të fitojnë dhe, kur korrin fitore, revolucionarët marrin krahë edhe më shumë e ngjiten edhe më lart.

Ju, të dashura shoqe, së shpejti do të ktheheni në Kinë dhe ne jemi të bindur se ju do të ruani për motrat dhe shoqet tuaja shqiptare një dashuri të pashlyeshme, ashtu sikurse jemi të bindur që edhe shoqet tona do të ruajnë për ju gjithashtu kujtime të pashlyeshme. Frymëzimi i këtyre ditëve kaq entuziashte që kaluat në Kongresin¹ e rëndësishëm të Bashkimit të Grave të Shqipërisë dhe në kontaktet me masat e ndryshme të grave të vendit tonë, do t'i ndihmojë shoqet tona të kryejnë me nder detyrat e tyre.

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

¹ Kongresi i 6-të i BGSH i zhvilloi punimet në Tiranë prej datës 25 deri më 28 tetor 1967.

DEMAGOGJIA TITISTE NUK MUND T'I MBULOJË PLAGËT E HAPËTA TË KOSOVËS

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

16 nëntor 1967

Ka disa muaj që klika e Titos ka shpërthyer një fushatë të gjerë demagogjike e mashtruese në drejtim të Kosovës dhe të popullsisë shqiptare në Jugosllavi, duke bërë gjithfarë premtimesh false e lajkash dinafë. Sunduesit e Beogradit hiqen tani sikur po duan të korrigjojnë «gabimet shoviniste të Rankoviçit», sikur po i kushtojnë një vëmendje të posaçme zhvillimit ekonomik të krahinës së Kosovës, sikur po duan të zgjidhin problemin e arsimit të kosovarëve në gjuhën amtare, të vendosin sistemin dygjuhësor në administratë, të lejojnë kultivimin e traditave e të kulturës kombëtare etj. Njëkohësisht agentët e Titos në Kosovë e gjetkë po tregojnë një zell të madh për të reklamuar «masat shpëtimtare» të ustait të tyre, duke bërtitur me sa fuqi që kanë për vëllazërimin dhe për bashkimin e xhelatëve me viktimat.

Bëhet pyetja: Çfarë e shtyn klikën titiste të kthejë pikërisht tani «vëmendjen» e saj drejt Kosovës dhe të mobilizojë mjete të mëdha propagandistike për të krijuar një situatë të tërë të rreme e false? Kuptohet se

nuk është dëshira e mirë ose qëllimet e singerta, që i shtyjnë Titon dhe bandën e tij të bëjnë deklarata «miqësie» e të marrin masa gjoja në interes të shqiptarëve, që jetojnë në Kosovë e në Rrafshin e Dukagjinit, ose për përmirësimin e marrëdhënieve me Shqipërinë, gjë për të cilën bëri fjalë Titoja kohët e fundit në një fjalim që mbajti në Kroaci. Këto ua imponon atyre ashpërsimi i ri edhe më i madh i kontradiktave të brendshme e të jashtme, që e kanë mbërthyer Jugosllavinë e sotme.

Një gjendje e rëndë krize, degjenerimi dhe konfuzioni ka pllakosur regjimin titist në Jugosllavi. Të gjithë tani, me dashje ose pa dashje, pranojnë faktin se makina titiste është në shturje të plotë dhe se «socializmi specifik» jugosllav, i ndërtuar me shumë mundime e sakrifica nga imperializmi dhe nga i gjithë reaksioni ndërkombëtar, ia arriti qëllimit në të gjitha drejtimet për ta kthyer Jugosllavinë në një shtet kapitalist. Ekonomia ndodhet në krizë dhe reformat e njëpasnjëshme me karakter kapitalist e kanë bërë akoma më kaotike gjendjen e saj. Në sferat e larta, lufta për pushtet midis hierarkëve titistë po zhvillohet gjithnjë e më e ashpër. Eliminimi i Rankoviçit, në vend që t'i qetësonte, i nxiti edhe më tepër grindjet e vjetra nacionaliste e shoviniste. Degjenerimi i jetës shpirtërore, anarkia e prodhimit dhe konkurrenca midis kapitalistëve të rinj kanë bërë të mundur që sektorë të jetës ekonomike, politike e kulturore të mos i nënshtrohen më asnjë kontrolli. Po të kemi parasysh edhe faktorin tjetër, atë të luftës për epërsi e influencë, që zhvillohet në terrenin jugosllav midis imperialistëve amerikanë dhe revii-

zionistëve sovjetikë, nuk është shumë e vështirë të kuptohet se sa e errët dhe pa rrugëdalje paraqitet tabloja e sotme e regjimit titist.

Për të dalë nga kjo gjendje e rëndë kaotike dhe për të lehtësuar sadopak shtrëngimin e darëve të kontradiktave të ashpra, Titoja dhe banda e tij përpiqen me demagogji, me premtime e me mashtrime të qetësojnë masat e revoltuara që vuajnë nga regjimi titist dhe të shuajnë atë gjendje shpërthyesë që është krijuar në vend nga shtypja fashiste dhe shfrytëzimi kapitalist. Një qëndrim të tillë dinak, thellësisht mashtrues e demagogjik dhe shumë të rrezikshëm, klika e Titos përpiqet tani ta zbatojë, sidomos ndaj popullsisë shqiptare në Kosovë, ku shovinizmi serbomadh, shtypja dhe brutaliteti titist kanë bërë kërdrinë për vite me radhë.

Por, sado përpjekje që të bëjnë sundimtarët e Beogradit, asnjë ilaç nuk mund të shërojë regjimin e kalbur titist, që tani ka filluar të dekompozohet nga brenda e nga jashtë, asnjë demagogji nuk mund ta shuajë zemërimin e popujve të Jugosllavisë për regjimin e urryer titist.

Krizat e sotme politike, ekonomike dhe thellimi i kontradiktave antagonistë në fusha të ndryshme të jetës politike, ekonomike, shoqërore e nacionale të Jugosllavisë janë pasoja të pashmangshme të sistemit kapitalist që sundon në Jugosllavi. Zhvillimi disproporcional e anarkik i forcave prodhuese, spontaneiteti i tregut dhe veprimi i ligjeve të konkurrencës kapitaliste në treg, papunësia kronike, shfrytëzimi i punonjësve dhe ulja e nivelit të tyre të jetesës, varësia e plotë

ekonomike e politike nga imperializmi dhe nga monopolet e huaja nëpërmjet integritit e kooperimit me sistemin perëndimor, pabarazia e zhvillimit të rajoneve dhe tendencat nacionaliste-shoviniste, të gjitha këto përbëjnë veçoritë dalluese të jetës së sotme jugosllave.

Tani Jugosllavia është bërë një nga pazaret më të lira, ku kapitalistët e huaj vijnë me shumicë për të blerë forcën e lirë punëtore që u ofron regjimi titist. Qeveria e Titos u ka krijuar këtyre blerësve të gjitha lehtësitë, duke i braktisur punëtorët jugosllavë në mëshirën e shfrytëzimit kapitalist, pa asnjë të drejtë dhe pa asnjë mbrojtje.

Një nga aspektet e jetës ekonomike jugosllave është zhvillimi i shpejtë i sektorit kapitalist privat, i paruar nga shteti dhe as nga ndërmarrjet e «vetadministruara». Sipas të dhënave zyrtare jugosllave, çmohet se gati një e treta e prodhimit bujqësor të vendit, megjithëse të drejtën ekskluzive të tregtimit të drithërave, të bimëve industriale, të mishit etj. e kanë të ashtuquajturat kooperativa të prodhimit ose organizatat gjoja të kolektivizuara, është realizuar nga vetë prodhuesit drejtpërdrejt në tregun e lirë. Kjo shpjegon në një shkallë të madhe edhe rritjen e vazhdueshme të çmimeve të prodhimeve bujqësore në Jugosllavi, të cilat janë bërë tanimë të pakapshme nga punonjësit e thjeshtë.

S'ka asnjë dyshim se brenda një kohe të shkurtër, me masat favorizuese që po merren në Jugosllavi, sektori kapitalist privat do të marrë jo vetëm një zgjerim të madh, por edhe një fuqi të konsiderueshme ekonomike e politike.

Para pak kohësh, qeveria jugosllave, mbas shumë manovrash e peripecish, adoptoi një ligj, i cili lejon këtej e tutje investimet e drejtpërdrejta të kapitalit të huaj në Jugosllavi. Siç njoftonte agjencia Tanjug, investuesve të Perëndimit u garantohen fitime më të mëdha në Jugosllavi nga ç'mund të nxirrnin sikur këto kapitale t'i investonin në vendet e tyre. Atyre u është njohur e drejta e drejtimit të ndërmarrjeve me kapital të përbashkët, e caktimit të numrit të punëtorëve, të pagave, të profilit të prodhimit dhe sigurisht e eksportimit të lirë të fitimeve të tyre. Në një artikull të gazetës së Beogradit «Politika» të datës 4.6.1967 me titull «Kapitali i jashtëm dhe ora e vendit» shkruhej: «Po vendësit çfarë u sjellin të huajve? Fitim më të madh, për të cilin ata, duke investuar kapitalin, në bazë të zakonit të fitimit janë më të interesuar. Afarishtët do të vijnë në Jugosllavi vetëm në qoftë se në këtë tokë do të mund të fitojnë më shumë se në një tjetër».

Kjo masë e udhëheqësve të Beogradit konfirmon në mënyrë definitive jo vetëm restaurimin e plotë të sistemit kapitalist në Jugosllavi, por edhe qëllimin e integritimit ose të thithjes së ekonomisë jugosllave nga kapitali monopolist perëndimor.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, veç vendeve të tjera kapitaliste, i kanë dhënë regjimit të Titos miliardë dollarë në formën e «ndihmës» ekonomike dhe ushtarake. Por këto shuma të mëdha, natyrisht, sollën dobi për kapitalizmin amerikan dhe jo për popujt e Jugosllavisë. Gjendja e vajtueshme e ekonomisë jugosllave tregon se këto shuma janë përdorur kryesisht për të mbajtur gjallë regjimin titist, dhe sidomos

aparatin politik shtypës të tij, për të financuar diversionet e tij politike në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare etj.

S'ka asnjë dyshim se investimet e drejtpërdrejta të kapitaleve perëndimore në Jugosllavi do t'i shtojnë edhe më shumë kontradiktat e thella, që kanë mbërthyer jetën jugosllave, jo vetëm në planin ekonomik, po edhe në atë politik. Në qoftë se sot Titoja, me përpjekje të mëdha, mundohet të mbajë «unitetin» e serbëve dhe të kroatëve e «të bindë» bosnjakët e maqedonasit, vështirë se do të jetë në gjendje ta bëjë këtë nesër. Në qoftë se sot, kapitalistët e rinj kroatë e sllovenë kundërshtojnë me gjysmëzëri se ata nuk duan të japin asnjë dinar për krahinat e pazhvilluara, nesër, kur të kenë përkrah trustet e Gjermanisë Perëndimore, bursën e Nju-Jorkut dhe bankat e Vatikanit, «argumentet» e tyre do të jenë më «bindëse».

Kohët e fundit popujt e Jugosllavisë dhe e gjithë bota ishin dëshmitarë të shpërthimit të hapët të përleshjeve, të luftës për pushtet dhe të rivaliteteve nacionaliste brenda gjirit të vetë udhëheqjes titiste.

Grupet e ndryshme titiste në fuqi kanë pasur edhe më parë shumë grindje nacionaliste. Por, në qoftë se deri më sot ato kanë mundur të bëjnë kompromise e lëshime reciproke, me qëllim që lufta e brendshme të mos dalë në publik, tani gjendja konkrete e punëve në Jugosllavi nuk e lejon një manovrim të tillë. Reforma e re ekonomike, që adoptuan vitin e kaluar, nuk mund të mos çonte në një luftë të ashpër midis grupeve rivale borgjeze, midis republikave dhe Federatës, midis krahinave të zhvi-

lluara dhe atyre të prapambetura, midis aparatit të burokracisë shtetërore dhe atij ekonomik. Vetadministrimi në ekonomi nuk mund të mos çonte dhe në kërkesat për një vetadministrim edhe në politikë.

Për të fshehur mprehtësinë e kësaj lufte dhe për të kamufluar disi luftën për pushtet, që zhvillojnë midis tyre grupet borgjeze kroato-slllovene e serbo-malazeze, propaganda titiste e quan këtë si një konflikt midis partizanëve të centralizmit dhe atyre të decentralizmit. Në të vërtetë këtu kemi të bëjmë me luftën e tërbuar që bëjnë industrinë e fuqishme të republikave të veriut dhe përfaqësuesit e tyre, të cilët, pasi fituan pavarësinë ekonomike kapitaliste, tani kërkojnë edhe pavarësinë politike nga Federata, nga ndërhyrja e organizmave qendrorë dhe e grupit borgjez serb, i cili, duke qenë jo aq i fuqishëm ekonomikisht, kërkon të mbajë krejtësisht për vete pushtetin qendror politik e ushtarak, nëpërmjet të cilit mund të ndërhyjë në punët e republikave të tjera dhe të përfitojë për vete.

Kjo luftë, që zhvillohet me zigzage, do të marrë forma më të përcaktuara dhe proporcione më të mëdha në të ardhmen. Por, që ajo zhvillohet me një intensitet të madh, zbulohet fare qartë edhe nga vetë shtypi jugosllav, i cili sjell përditë fakte të shumta rreth përleshjeve, që ndodhin në vend midis të dy grupeve.

Heqja e Rankoviçit dhe e miqve të tij, të cilët stigmatizohen tani si partizanë të centralizmit e të unitarizmit, ishte vërtet një fitore për grupin kroato-sllloven dhe një grusht i rëndë për borgjezinë e re serbe, por ajo nuk ishte akoma, as një fitore definitive për të parët, as një humbje përfundimtare për të

dytët. Ajo i ndezi më shumë gjakrat, i nxiti ata për t'u përleshur akoma më me ashpërsi, për sulme të reja reciproke, për revanshe.

Deklarata e intelektualëve kroatë «mbi thirrjen dhe pozitën e gjuhës letrare kroate», që ishte një sulm tjetër që i bëhej grupit nationalist serb, si dhe reaksioni i tërbuar i këtij të fundit, e vërtetojnë plotësisht këtë realitet. Përleshje jo të vogla u bënë edhe tani së fundi, pas zgjedhjeve për vendet kryesore në organet e pushtetit qendror. Sado që të përpiqet propaganda titiste t'i shpjegojë ndryshimet e mëdha në krye të organeve të larta si rezultat i politikës së «rotacionit», që ndiqet gjoja në Jugosllavi, mjafton të shikohet kombësia e hierarkëve, që zunë postet kryesore të pushtetit për të parë se sa të vështira kanë qenë kompromiset e lëshimet reciproke.

Se sa ia kanë frikën njëri-tjetrit ujquit e mëdhenj titistë dhe sa e madhe është lufta midis tyre, këtë e tregon edhe fakti tjetër se shumica dërrmuese e krerëve të bandës tani, pas zgjedhjeve, nuk morën funksione konkrete në pushtet. Të gjithë ata u ngarkuan vetëm si anëtarë të Këshillit të Mbrojtjes Popullore të Jugosllavisë. Me sa duket, nuk u arrit dot ndonjë kompromis tjetër i përshtatshëm dhe Titoja zgjodhi këtë formë për t'i mbajtur afër dhe nën kontrollin e tij, duke shpresuar se, me kalimin e kohës, ata do të pajtohen dhe do të krijohet përsëri «uniteti». Por kjo është një zgjidhje e përkohshme dhe formale, mbasi dihet se kudo që të jenë, në krye të dikastereve, në komisionet e parlamenteve, ose në forumet e organizatave të ndryshme, krerët titistë, që përfaqësojnë

grupet e ndryshme borgjeze, nuk do ta pushojnë kurrë luftën pa vendosur ndonjëri pushtetin e tij të plotë dhe pa e likuiduar krejtësisht rivalin e tij.

Kriza e thellë politike, ekonomike e shoqërore, që po bren nga themelet regjimin titist, gjendja e rëndë që ekziston sot në Jugosllavi, i kanë shtuar edhe më shumë vuajtjet e popullit jugosllav, por në mënyrë të veçantë ato kanë shtuar vuajtjet e mjerimet e popullsisë shqiptare në Kosovë, e cila ndodhet nën shtypjen e dyfishtë — kapitaliste dhe shoviniste të serbomëdhenjve. Pikërisht për të mbajtur të shtypur dhe në gjendje apatie Kosovën, Titoja dhe klika e tij kanë shpërthyer në drejtim të saj një fushatë të gjerë premtimesh false e demagogjike, hiqen sikur u vjen keq për Kosovën dhe se duan «të korrigojnë» disa nga gabimet që atje paska bërë Rankoviçi dhe që Titoja nuk «i dinte». Ai kërkon tani të zbutë ose të shuajë valën e zemërimit të popullsisë shqiptare në Jugosllavi, t'i mbajë të ndrydhura dhe t'i mbytë kërkesat e tyre të drejta ekonomike, politike e kombëtare, t'i pengojë ata të bashkohen me të gjithë popujt e Jugosllavisë në luftën kundër regjimit titist. Por shqiptarët në Kosovë nuk mashtrohen, ata e dinë se fajtor nuk është askush tjetër, përveç Titos e klikës së tij.

Shkaku kryesor i prapambetjes kriminale, në të cilën ndodhet Kosova, nuk është vetëm politika diskriminuese e investimeve, që ka zbatuar me qëllim për vite me radhë klika titiste, por janë vetë synimet për shkombëtarizimin dhe serbizimin e rajoneve shqiptare në Jugosllavi. Popullsia e Kosovës përbën 5,1 për qind të popullsisë së Jugosllavisë, por krahinës

së Kosovës i kanë caktuar vetëm 1,2 për qind të konsumit buxhetor. Në fushën e arsimit e të kulturës diskriminimi gjuhësor e kombëtar është fare i hapur. Vitin e kaluar në Kosovë kanë mbetur jashtë skollës 50 000 fëmijë të moshës shkollore, për shkak të rrjetit të pamjaftueshëm të shkollave e të personelit mësues. Gazeta e Beogradit «Politika» shkruante se vitin e kaluar nuk mundën të ndjekin shkollën në Serbi 16 000 fëmijë. Këto dy të dhëna mjaftojnë për të krahasuar gjendjen e arsimit në Kosovë e në Serbi. Vlen të shtojmë ndërkaq se tani në Kosovë mungojnë 2 400 arsimtarë. Edhe prej atyre që tani punojnë në arsim 70 për qind janë të pakualifikuar. Shumë më keq është gjendja e shqiptarëve në Maqedoni e sidomos në Malin e Zi, ku atyre u janë mohuar edhe të drejtat më elementare kombëtare, ku ndiqet një politikë e egër barbare për shkombëtarizimin e tyre.

Viti 1964, sipas Titos, ishte caktuar si viti kur do të zhdukeshin ndryshimet midis zonave të zhvilluara e atyre të pazhvilluara. Ky ishte një premtim bajat për të mashtruar naivët. Gjendja sot, më 1967, në Kosovë është shumë më e rëndë, hendeku midis saj dhe viseve të zhvilluara të Jugosllavisë është thelluar edhe më tepër. Në vitin 1964 të ardhurat kombëtare për frymë në Slloveni u rritën me një shumë prej 7 588 dinarësh të rinj, ndërsa Kosova nuk kishte arritur akoma as mesataren e Jugosllavisë të vitit 1947, që ishte 730 dinarë.

Disproporcioni këtu është shprehje dhe pasojë e vijës diskriminuese të klikës titiste, e politikës shoviniste dhe e trajtimit të Kosovës vetëm si burim lëndësh

të para, si një zonë e shtrirjes koloniale për forcat e tepërta e të pakualifikuara të Serbisë e të Malit të Zi.

Për amullinë e tmerrshme dhe prapambetjen ekonomike flasin edhe të dhënat e mëposhtme: Në Kosovë është përqendruar vetëm 2,4 për qind e industrisë metalike të Serbisë. Kjo do të thotë se prej 158 sipërmarrjeve të kësaj industrie vetëm 4 prej tyre ndodhen në Kosovë me një pjesëmarrje prej 0,3 për qind të mjeteve themelore, me 0,6 për qind të punëtorëve dhe gjithsej me 0,4 për qind nga të ardhurat e përgjithshme të kësaj dege të industrisë.

Tani, në Kosovë, pas fillimit të zbatimit të «reformave ekonomike» dhe të ashpërsimit të grindjeve nacionale, gjendja e krizës, e konfuzionit, e depresionit ekonomik dhe e pasigurisë politike është rënduar edhe më shumë. Drejtuesit titistë dhe organet e shtypit, duke mos mundur ta mbulojnë dot këtë, pohojnë hap-tazi rënien ekonomike, shthurjen organizative, konfuzionin e anarkinë, që janë krijuar. Prodhimi në krahinë ka rënë 14 për qind nga plani i parashikuar, ndërsa humbjet në organizatat ekonomike, vetëm për gjashtë muajt e këtij viti, përfshijnë 10 000 000 dinarë të rinj. Udhëheqja revizioniste e krahinës, duke shqyrtuar gjendjen e krijuar, më 15 shtator ka pranuar se «në një numër të konsiderueshëm të organizatave ekonomike në krahinë procesi i prodhimit ka dobësi të theksuara, mungesa të shumta në punë, papërgjegjësi të theksuar ndaj punës dhe mungon plotësisht disiplina, por ekzistojnë edhe shfaqje të padurueshme midis njerëzve dhe në marrëdhëniet midis kombësive si dhe shfaqje të anarkisë».

Në mënyrë të veçantë në Kosovë po rritet me ritme të shpejta papunësia. Jo vetëm që nuk ndërtohen objekte të reja industriale, të cilat mund të angazhohin një pjesë të lirë të fuqisë punëtore, por edhe industritë ekzistuese, si rezultat i konkurrencës që u bëjnë fabrikat e veriut, të pajisura me një nivel më të lartë teknik dhe me mjete më të shumta financiare, po e pakësojnë prodhimin e bashkë me të edhe numrin e punëtorëve të zënë me punë. Sunduesit titistë nuk kanë gjetur tjetër rrugëdalje për këto masa shqiptare të papunësh, përveçse t'u tregojnë rrugët e largëta të mërgimit ose kantieret e Kroacisë e të Sllovenisë, ku mund të shesin për pesë para forcën e muskujve të tyre. Po dhe atje ato ndeshin me konkurrentë më të fortë nga krahinat e tjera të Jugosllavisë, kështu që nuk u mbetet gjë tjetër, përveçse të kthehen në endacakë dhe në lypës të mjerë.

Për të larguar vëmendjen e kosovarëve nga kjo gjendje e mjeruar dhe për t'i mbajtur ata me shpresa boshe se gjoja në një të ardhme jo të largët gjendja do të rregullohet, klika e Titos hiqet sikur po merr disa masa favorizuese për shqiptarët. Në këtë plan hyjnë, për shembull, disa masa gjysmake në çështjen e mësimin të fëmijëve shqiptarë në gjuhën amtare ose njëfarë liberalizimi demagogjik në kultivimin e kulturës kombëtare. Por këto masa janë vetëm premtime dhe fjalë, pse klika e Titos nuk jep asnjë dinar për zhvillimin e vërtetë të arsimit në gjuhën shqipe në Kosovë ose të kulturës kombëtare atje, pa përmendur këtu luftën e egër që i bëjnë shovinistët serbë çdo përpjekjeje të kosovarëve për njohjen dhe zhvillimin e tra-

ditave e të pasurisë shpirtërore kombëtare të tyre. Nën pretekstin e mungesës së fondeve ose të kuadrove, Kosovës i janë mohuar dhe i mohohen vazhdimisht krijimi i institucioneve më modeste kulturore në gjuhën shqipe, përdorimi i administratës dygjuhëshe, zhvillimi i arsimit të lartë e teknik në gjuhën amtare, botimet shqip etj., etj. Por bëhet pyetja: Pse të tilla institucione ekzistojnë, për shembull, në Maqedoni e në Malin e Zi? Mos vallë Kosova është më e varfër nga këto? Ajo s'është më e varfër, por ajo është e grabitur dhe e shtypur, atë e kanë zënë për fyti shovinistët serbomëdhenj dhe nuk e lënë të marrë frymë. Titistët thonë se Jugosllavia është vendi i «barazisë së madhe nacionale», por popullsia shqiptare, që jeton në Malin e Zi, në Ulqin, e në rrethet e liqenit të Shkodrës, në Tuz, në Plavë dhe në Guci etj., nuk ka jo më një gazetë në gjuhën shqipe, por asnjë buletin informativ, pa përmendur faktin që atë e detyrojnë me forcë të ndjekë shkollat serbe.

Prandaj deklaratat demagogjike të Titos dhe të agentëve të tij se gjoja ata po marrin masa në interes të shqiptarëve që jetojnë sot në Kosovë dhe në Rrafshin e Dukagjinit, janë pasojë e situatave të rënda të krijuara në Kosovë dhe në gjithë Jugosllavinë; ato janë premtime bajate për të qetësuar masat e revoltuara, për t'i zgjatur edhe ca jetën regjimit të falimentuar titist. Politika titiste ndaj shqiptarëve ka qenë dhe mbetet një politikë shkombëtarizimi, një politikë shtypjeje e shfrytëzimi, një politikë e kolonializmit serb dhe e shpërnguljes me forcë të shqiptarëve nga trojet e tyre shekullore. Ajo është politika e mbytjes së

traditave dhe e ndjenjave kombëtare, e shtypjes së ideve revolucionare dhe e qëndrimeve internacionaliste.

Krizat, kaosi dhe konfuzioni, që ekzistojnë sot në Jugosllavi, nuk ia lehtësojnë, por, përkundrazi, ia shtojnë akoma më shumë vuajtjet dhe mjerimet popullsisë shqiptare në Kosovë, të cilën gjatë viteve të regjimit titist, Tito-Rankoviçët dhe lakenjtë e tyre, si Dushan Mugosha e Xhavit Nimani me shokë, e shtypën dhe e masakruan, e poshtëruan dhe i bënë një mijë e një të zeza. Në zemrat e popullit të Kosovës gjatë këtyre viteve janë grumbulluar një zemërim i tillë i rëndë dhe një urrejtje e tillë e madhe për regjimin titist, sa asnjë lajkë e hipokrizi nuk është në gjendje t'i çrrënjosë, ose t'i shuajë. Sado të përpiqen me demagogji e me premtime titistët që ta qetësojnë popullsinë shqiptare në Kosovë, në Rrafshin e Dukagjinit, në Malin e Zi e në Maqedoni, ajo nuk mund të mashtrohet.

Popullsia shqiptare në Kosovë e në Rrafshin e Dukagjinit, në Maqedoni dhe në Malin e Zi nuk do ta harrojë kurrë vallen makabre të përgjakshme që për më se njëzet vjet ka luajtur në kurrizin e saj klika e Titos. Titoja dhe banda e tij janë përgjegjës për masakrën e Drenicës, për vrasjen e mijëra e mijëra të rinjve shqiptarë në rrugën Prizren-Ulqin, për mbytjen e mijëra shqiptarëve në kampet e përqendrimit të Shkupit, të Tetovës, të Prishtinës, të Mitrovicës etj., për shpërnguljen me dhunë të dhjetëra mijë shqiptarëve në zonat e thella të Jugosllavisë, për dëbimin nga toka amtare në Turqi të qindra mijë shqiptarëve, për politikën e terrorit fizik e shpirtëror, të asgjësimit

masiv e të gjenocidit kundër popullsisë shqiptare.

Shqiptarët në Kosovë, në Rrafshin e Dukagjinit, në Maqedoni e në Malin e Zi e duan tokën e tyre, i nderojnë e i ruajnë traditat, zakonet, kulturën dhe pasurinë e madhe shpirtërore të tyre, që kanë trashëguar dhe shpëtuar nga dallgët e shekujve. Ata e duan Shqipërinë dhe nuk do të lejojnë kurrë të bëhen vegla të politikës antishqiptare të Titos e të shërbëtorëve të tij. Ata nuk kanë pasur e nuk do të kenë kurrë iluzione për Titon dhe bandën e tij dhe nuk mashtrohen nga manovrat e ndryshme që bëjnë titistët, por luftojnë për të fituar të drejtat e tyre.

Populli shqiptar në Kosovë e në Rrafshin e Dukagjinit, në Maqedoni e në Malin e Zi është një popull trim, patriot e i pamposhtur, që di përse lufton dhe ka plotësisht të drejtë të kërkojë me këmbëngulje dhe me vendosmëri që të kthehen në vendin e vet të lindjes bijtë e tij, që banda titiste i ka shpërngulur dhe i ka shpërndarë nëpër Jugosllavi, të kthehen në vendin e vet, në Kosovë, ata qindra mijë emigrantë shqiptarë, që regjimi titist i detyroi të lënë vatrat e tyre dhe të marrin arratinë.

Shqiptarët në Kosovë, në Rrafshin e Dukagjinit, në Malin e Zi e në Maqedoni kanë të drejtën juridike, morale e historike të rrojnë vetë në trojet shekullore të stërgjyshërve të tyre. Ata kanë të drejtë të flasin e të shkruajnë lirisht gjuhën amtare, të kenë shkollat e tyre të të gjitha shkallëve, shtypin dhe letërsinë në gjuhën shqipe, bibliotekat dhe teatrot, institutet e studimeve dhe të përhapjes së kulturës së tyre kombëtare. Atyre nuk mund t'u mohohet e drejta që të ke-

në administratën e përbërë prej shqiptarësh, me një-rëz të zgjedhur nga populli dhe jo të imponuar nga banda titiste.

Ata kanë të drejtën të luftojnë kundër grabitjes dhe shfrytëzimit të pashembullt, që kapitalistët e rinj titistë u bëjnë pasurive të zonave të banuara nga shqiptarët, të kërkojnë që këto pasuri të shfrytëzohen për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës së tyre e jo të bëhen pre e borgjezisë serbomadhe dhe e kapitalistëve të huaj.

Populli shqiptar ka dënuar gjithmonë me vendosmëri, ka denoncuar e denoncon botërisht politikën titiste të gjenocidit, të persekutimeve e të asgjësimit masiv, politikën e diskriminimit nacional e të padrejtësive të pashembullta, që i janë bërë e i bëhen çdo ditë popullsisë shqiptare në Jugosllavi.

Shqipëria nuk i harron kurrë, por ka nderuar e nderon kurdoherë patriotet e patriotët kosovarë, që kanë luftuar gjatë historisë për lirinë dhe pavarësinë e plotë të Shqipërisë.

Titoja dhe banda e tij po hartojnë lloj-lloj taktikash për të ngritur kurthe të reja kundër vëllezërve tanë kosovarë e për të errësuar politikën parimore të Republikës Popullore të Shqipërisë. Kështu, kohët e fundit ata po bëjnë zhurmë rreth dëshirës së tyre gjoja për «pajtim» me Shqipërinë dhe nuk është e rastit që kjo zhurmë ka gjetur një jehonë të gjerë dhe përkrahje të madhe në shtypin reaksionar imperialist e revizionist. Por, kjo fushatë është thjesht për konsum të brendshëm në Kosovë, për t'u thënë kosovarëve: «Ja, ne duam pajtim me Shqipërinë, por kë-

të nuk e duan shqiptarët». Bile banda titiste, dhe këtë e bën jo vetëm për konsum të brendshëm në Jugosllavi, por edhe për jashtë saj, edhe shkëmbimet tregtare, që Shqipëria bën me Jugosllavinë kapitaliste njësoj si me vendet e tjera kapitaliste, kërkon t'i paraqitë si njëfarë zbutjeje të luftës sonë ideologjike kundër saj. Këto manovra nuk mashtrojnë njeri dhe titistët, sado të përpiqen, nuk mund ta shtrembërojnë karakterin e këtyre shkëmbimeve dhe aq më pak ta errësojnë politikën parimore të Shqipërisë socialiste.

Zëra shqiptarë ngrihen në Kosovë dhe kërkojnë të njihen me veprimtarinë e mrekullueshme dhe me jetën e Republikës Popullore të Shqipërisë. Kosovarët kërkojnë libra letrarë, historikë, shkencorë nga Republika Popullore e Shqipërisë, kërkojnë abetare të gjuhës shqipe, filma e muzikë shqiptare. Ata kanë të drejtë, pse çdo gjë u mungon. Dhe Republika Popullore e Shqipërisë është gati t'ua përmbushë dëshirën, por vëllezërit kosovarë duhet të jenë në roje që elementët titistë të mos i deformojnë e të mos i shtrembërojnë materialet letrare, historike, artistike etj. të vendit tonë.

Gjithashtu, shumë shqiptarë të thjeshtë e patriotë të Kosovës dëshirojnë të bëjnë vizita në Shqipëri për t'u njohur me vendin tonë dhe me sukseset që ai ka arritur në ndërtimin e socializmit. Veç dihet se titistët, prapa vizitave gjoja turistike, ndjekin qëllime të tjera. Ata dërgojnë agjentë dhe spiunë për të dëmtuar Shqipërinë, prandaj ne u themi vëllezërve kosovarë se, kur titistët u thonë: «Ne ju lejojmë të shkoni në Shqipëri, por nuk do Shqipëria», këtë e bëjnë ve-

tëm për t'i mashtruar e për të fshehur qëllimet e tyre antishqiptare.

Për popullin shqiptar është shumë e qartë se politika titiste ndaj Shqipërisë mbetet po ajo që ka qenë. Fjalët «e ëmbla» nuk mund të mbulojnë helmin e veprave.

Politika e Partisë sonë është e kthjellët, e drejtë, parimore dhe korrekte. Veç askush të mos krijojë iluzione në Beograd apo gjetkë se do të ndryshojë qëndrimi ynë i njohur ndaj bandës tradhtare titiste. Ne do të luftojmë pa kompromis në plan ideologjik e politik kundër kësaj bande për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, do të demaskojmë pa mëshirë tradhtinë dhe komplotet e Titos dhe të revizionistëve të tjerë, do të dënojmë çdo orvatje të kësaj agjente të imperializmit për të futur hundët në punët tona të brendshme, do të denoncojmë vendosmërisht politikën titiste të shkombëtarizimit dhe të gjenocidit ndaj popullsisë shqiptare në Jugosllavi. Ky qëndrim do të jetë i njëjtë, i prerë e i vendosur derisa do të jetë në fuqi banda titiste e tradhtarëve, e kriminelëve dhe e aventurierëve ndërkombëtarë. Ne do të vazhdojmë pa u lëkundur dhe deri në fund luftën tonë për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit fitimtar nga armiqtë e çdo ngjyre, për mbrojtjen e lirisë e të pavarisë së popullit shqiptar, të fitoreve të tij socialiste, për mbrojtjen e të drejtave elementare të vëllezërve tanë në Kosovë, në Rrafshin e Dukagjinit, në Maqedoni e në Malin e Zi, për miqësinë e sigurtë me popujt vëllezër jugosllavë.

Udhëheqja revizioniste jugosllave dihet se s'ka

pasur kurrë asgjë të përbashkët me marksizëm-leninizmin dhe me internacionalizmin proletar. Duke spekuluar me frazeologjinë revolucionare, në fakt, ajo ka ruajtur dhe ka ngritur në një shkallë më të lartë politikën e vjetër nacionale shoviniste të kralëve të Serbisë, nga e cila vuajnë tani edhe serbët, edhe kroatët, edhe maqedonasit, edhe shqiptarët. Plagët e Kosovës dhe të popujve jugosllavë mbeten të hapëta dhe asnjë demagogji titiste nuk mund t'i mbulojë.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 275 (6000), 16 nëntor 1967

Botohet sipas librit: Enver Hoxha «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1965-1967», f. 594

LETËR DREJTUAR FAMILJES SË PJETËR LLESHIT¹

20 nëntor 1967

Të dashurit e mi, nana e Pjetrit, Xhelë, shoqja Lizë e Pjetër Lleshit, të dashur fëmijë të Lizës e të Pjetrit, Mrikë, Zef, Mark, Pashkë dhe Llesh.

Po vij me këtë letër në Domgjon të Fanit, në shtëpinë tuaj, në votrën e zjarrit, ku sonte jeni grumbulluar, t'ju puth e t'ju përqafoj, ashtu sikundër vinte pas pune Pjetri juaj, Pjetri ynë.

Fort më ka gëzu letra jote, Lizë, ku më shkruaje për nanën e Pjetrit dhe për fëmijët që janë të gjithë mirë nga shëndeti. U gëzova shumë për Mrikën që vazhdon 8-vjeçaren në konviktin e Krumës. Mos u ba merak se Mrikën dhe të gjithë vocërrakët e tjerë, nëna jonë Parti do t'i rritë si jo ma mirë, do t'i mësojë, do t'i edukojë, do t'i bëjë trima dhe trimnesha si babën dhe mëmën e tyre.

Fal me shëndet, o nana e Pjetrit, që linde dhe rrite këtë djalë dragua. Dy fjalë desha me të thanë:

¹ Pjetër Llesh Doda ra në krye të detyrës më 30.12.1966, duke punuar për mirëmbajtjen e linjës telefonike Kukës-Fan. Presidiumi i Kuvendit Popullor i dha atij titullin e lartë «Hero i Punës Socialiste».

Lizën e Pjetrit e ke një burrneshë që punon e lufton në kooperativë për me i rrit fëmijët si duhet, për me zbukuru jetën e kooperativës. Ju jeni shumë në familje dhe kam frikë se ditët e punës të Lizës dhe pensioni i Pjetrit mund të mos jenë aq të mjaftueshëm. Po të rronte Pjetri, për ndonjë nevojë ti do t'i drejtoheshe atij, por Pjetri rron në Partinë tonë të madhe, prandaj ti mos mungo me iu drejtu Partisë, me më shkru mu drejtpërdrejt për ndonjë nevojë, sikur me i shkru Pjetrit. Po ta bëj ty këtë lutje, o nanë, pse e di që po t'ia shkruaj Lizës, ajo si komuniste nuk do të na shkruajë.

Çështja është sa të rriten fëmijët, sa të mbarojnë shkollën Mrika dhe të tjerët dhe të fitojnë jetën me djersën e ballit.

Qofshi të lumtur dhe të gëzuar të gjithë në atdheun tonë socialist që udhëheq Partia!

Do të gëzohem shumë që herë pas here të më kujtoni me ndonjë letër. Ju uroj gëzuar festat e 28 dhe 29 Nëntorit.

Ju përqafoj të gjithëve me radhë

Juaji

Enver

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

SHEMBULLI YT KA RËNDËSI PËR TË GJITHE

Nga biseda me Fuat Çelën

23 nëntor 1967

SHOKU ENVER HOXHA: U gëzova shumë kur mësova se erdhe këtu në Tiranë për të marrë pjesë në takimin kombëtar të përfaqësuesve të vullnetarëve të aksioneve të ndryshme të rinisë. Edhe sikur të mos kishe ardhur me këtë rast, unë do të të ftoja vetë të piqeshim një herë, sepse na ke entuziazmuar të gjithë me letrën tënde, që ka një përmbajtje aq të lartë. Ti je pa sy, por atje, në Vërzhezhën e largët, punon pa u trembur, me një vullnet të madh, i frymëzuar nga vija e drejtë e Partisë sonë të shtrenjtë.

Unë e kam vizituar krahinën e Skraparit edhe para katër vjetësh. Gjatë kohës së luftës kam qenë gjithashtu edhe në fshatin ku ke lindur dhe je rritur ti dhe ruaj kujtimet më të mira për ato vise.

SHOKU FUAT ÇELA: Letrën jua dërgova se më frymëzuan mësimet tuaja, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Letra jote ka entuziazmuar popullin e në mënyrë të veçantë rininë tonë.

Mua po më drejtohen tani me qindra letra e telegrame nga masat e popullit, të rinj e të reja, burra

e gra dhe më thonë se nën shembullin tënd dëshirojnë të luftojnë me vendosmëri si ti për të realizuar planet; deri edhe nxënësit e shkollave fillore premtojnë se do të mësojnë sa më mirë që të bëhen të vlefshëm për atdheun dhe popullin e të vendosur, ashtu si edhe ti. E shikon, pra, ç'ndikim të madh po ushtron te njerëzit tanë patriotë qëndrimi yt revolucionar?

Si po shkoni në Vërzhezhë? Do ta bëni bukën sivjet?

SHOKU FUAT ÇELA: Është i treti vit ky që ne po e prodhojmë bukën në fshatin tonë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ti, si aktivist shoqëror në fshat i di punët që bëhen atje? Mund të më thuash si po i realizoni detyrat që keni përpara?

SHOKU FUAT ÇELA: Kemi tre vjet që po marrim prodhime të mira. Tani në Vërzhezhë nuk mendon më njeri për bukën, pse prodhimin e drithit e kemi të sigurt.

SHOKU ENVER HOXHA: Misër apo grurë mbillni më shumë?

SHOKU FUAT ÇELA: Përpara mbillnim më shumë misër, kurse këtë vit kemi mbjellë më shumë grurë, për arsye se misri kërkon më tepër shërbime, kurse krahët e punës në kooperativë i kemi të paktë. Sivjet mbollëm tetëdhjetë hektarë me grurë dhe, sipas cilësisë së parcelave e të shërbimeve, morëm nga nëntë deri në dymbëdhjetë kuintalë për hektar, kurse misër nga njëmbëdhjetë kuintalë për hektar, që kishim planifikuar, kemi marrë tetëmbëdhjetë kuintalë.

SHOKU ENVER HOXHA: Keni sipërfaqe toke nën ujë dhe a punoni për t'i shtuar këto?

SHOKU FUAT ÇELA: Kemi hapur kanale për ujitje dhe jemi duke punuar akoma për këtë çështje.

Edhe me blegtorinë tani jemi mirë, megjithëse sivjet me prodhimin e blegtorisë nuk kemi dalë aq mirë, sepse bagëtitë i kemi pasur të sëmura.

SHOKU ENVER HOXHA: Si është mësuesja Drita¹ që të ka marrë në patronazh?

SHOKU FUAT ÇELA: Shumë mirë, ajo është arsimtare e dalluar dhe me vullnet.

SHOKU ENVER HOXHA: Ke në familjen tënde njerëz që ndjekin shkollën?

SHOKU FUAT ÇELA: Jo, një motër që kam në shtëpi e ka mbaruar shtatëvjeçaren, kurse vëllanë e kam ushtar.

SHOKU ENVER HOXHA: Jam në dijeni se në Vërzhezhë tani do të vijnë plot të rinj e të reja nga rrethe të ndryshme që do të punojnë krahas teje. Shumë prej tyre po shkojnë gjithashtu në Pecaj të Dukagjinit, në fshatin e Shkurte Vatës, pastaj prej andej disa do të vijnë edhe në fshatin tënd.

Në Tiranë kemi ngritur një shkollë të posaçme për mësimin e të verbërve, të cilët mësojnë atje të shkruajnë e të lexojnë.

SHOKU FUAT ÇELA: Edhe unë kam filluar të mësoj për të shkruar.

(Fuati, mbi një letër që i jep shoku Enver, shkruan në tavolinën e tij të punës fjalët Parti-Enver.)

Ju zotohem se gjer në fund të muajit shkurt do të kem mësuar të shkruaj si duhet.

1 Drita Gjondeda.

SHOKU ENVER HOXHA: Ne duhet të gjejmë një mënyrë se si të mësosh më lehtë për të shkruar. Mësuesja Dritë të të mësojë më parë alfabetin dhe pastaj ti do të arrish të shkruash e të lexosh me gishtërinj. Kjo është një metodë e njohur në të gjithë botën për mësimin e të verbërve.

Është e çuditshme, ti i verbër dhe ke mësuar të bësh gjithë këto punë, si: shporta, krevate, lëre pastaj punimin e tokës që e bën shumë mirë.

SHOKU FUAT ÇELA: Si të mos punoj unë, shoku Enver, kur Partia bën gjithë këto gjëra për mua që të më lehtësojë vuajtjet.

SHOKU ENVER HOXHA: Shembulli yt ka rëndësi për gjithë njerëzit tanë. Ti je pa sy dhe bën gjithë këto gjëra, prandaj ata marrin forca nga shembulli yt i shkëlqyer për të punuar e për të mësuar shumë më tepër. Partia i rekomandon çdo njeriu të mësojë shumë zanate, me qëllim që në çdo moment të jetë në gjendje t'i shërbejë atdheut për çdo punë që të jetë nevoja. Zbatimi i kësaj porosie nga ana jote është diçka e mrekullueshme dhe kam besim se ti do të bësh gjëra akoma më të mëdha e më të bukura.

SHOKU FUAT ÇELA: Unë kurrë nuk i them vetes se jam pa sy, përkundrazi, përpiqem t'i bëj ballë çdo vështirësie. Asnjëherë nuk jam kursyer për punë dhe për çdo aktivitet tjetër, pse kam vendosmërinë që më frymëzon besimi te Partia.

SHOKU ENVER HOXHA: U gëzova shumë kur të pashë në një fotografi në fshat duke ndërtuar mur me motrën tënde, Lirinë. Ku e keni shtëpinë në fshat?

SHOKU FUAT ÇELA: Te shkolla që është ndër-tuar në një vend të ulët në fund të fshatit.

SHOKU ENVER HOXHA: Po të vij ndonjëherë në Vërzhezhë, edhe pse e ke shtëpinë atje poshtë, do të të bëj një vizitë në familje.

SHOKU FUAT ÇELA: Po të vish në shtëpinë time unë do të jem shumë i lumtur dhe kjo do të më japë krahë që të punoj më shumë në dobi të Partisë e të popullit.

SHOKU ENVER HOXHA: Është rregulluar rruga automobilistike e fshatit tuaj?

SHOKU FUAT ÇELA: Nuk është rregulluar akoma e tëra, po besojmë që së shpejti do të përfundojë. Kur të sigurohet komunikacioni, atëherë ne do të jemi më mirë se tani.

SHOKU ENVER HOXHA: U prishën gjë patatet te ju?

SHOKU FUAT ÇELA: Asnjë kokërr.

SHOKU ENVER HOXHA: Sa kuintalë patate morët për hektar?

SHOKU FUAT ÇELA: Parashikuaam të merrnim shtatëdhjetë kuintalë për hektar, kurse morëm më shumë, nëntëdhjetë kuintalë për hektar, por përdorëm edhe pleh kimik.

SHOKU ENVER HOXHA: Janë ndërtuar shtëpi të reja në Vërzhezhë?

SHOKU FUAT ÇELA: Po.

SHOKU ENVER HOXHA: Sa nxënës dhe mësues ka në shkollën e fshatit?

SHOKU FUAT ÇELA: Nxënës ka rreth njëqind e pesëdhjetë, kurse mësues nëntë.

SHOKU ENVER HOXHA: Keni mami, infermier etj.?

SHOKU FUAT ÇELA: Kemi një ndihmësmjek.

SHOKU ENVER HOXHA: E ke takuar shokun Zylyftar Veleshnja, që e kemi një nga shokët më të mirë?

SHOKU FUAT ÇELA: Sivjet e kam takuar një herë dhe kam biseduar gjerë e gjatë me të.

SHOKU ENVER HOXHA: Ç'pushkë mban ti?

SHOKU FUAT ÇELA: «Belxhik».

SHOKU ENVER HOXHA: Do t'u them shokëve të të dërgojnë një pushkë të re automatike që të këndojë si bilbil.

Gjendjen e kemi të fortë si çeliku dhe Partinë të lidhur ngushtë me popullin.

SHOKU FUAT ÇELA: Sot unë bisedova me shokun Ramiz Alia si me vëllanë tim.

SHOKU ENVER HOXHA: Shoku Ramiz më informoi mua se ti fole shumë mirë në takimin kombëtar të vullnetarëve të rinisë dhe i entuziazmove të gjithë të rejtat dhe të rinjtë që ishin aty. Ti fole mirë se frymëzohesh dhe ke bindje të thellë te vija e Partisë.

Shkon ti në mbledhjet e Frontit?

SHOKU FUAT ÇELA: Unë shkoj edhe në mbledhjet e Frontit, edhe në ato të rinisë e të organizatave të tjera. Tani kam bërë kërkesë për t'u pranuar në Parti¹, vetëm se nuk kam sy. Por, pavarësisht nga vendimi që do të marrë organizata-bazë, unë do të

¹ Shoku Fuat Çela u pranua anëtar partie më 20 shkurt 1970.

luftoj deri në fund për zbatimin e porosive të Partisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ne kemi një anëtar partie të verbër në rrethin e Gjirokastrës¹, që është shok shumë i mirë, i vendosur dhe punëtor i palodhur. Unë besoj se organizata e Partisë në Vërzhezhë do ta shikojë pozitivisht kërkesën tënde, se ti je bir i Partisë.

Do ta çoni Fuatin të flasë në disa qendra pune këtu në Tiranë, shoku Ramiz²?

SHOKU RAMIZ ALIA: Të tërë na e kërkojnë të vejë t'u flasë.

SHOKU FUAT ÇELA: Unë jam dakord të shkoj ku të më çoni ju, po jo të qëndroj këtu më shumë se tri-katër ditë, se punët i kam në fshat.

Kur të kthehem në fshat kam dëshirë të kaloj në Dushk³ e prej andej në Berat, ku më ka kërkuar sekretari i parë i komitetit të rinisë të rrethit. Kam qenë edhe herë tjetër atje, në mbledhje me nxënës nga shkollat e qytetit. Pastaj shkova në Lushnjë, ku u takova me babanë e Shkurtes, Pal Vatën.

SHOKU ENVER HOXHA: Edhe Shkurta ishte një vajzë heroike.

Shoku Ramiz, mos e lodhni shumë Fuatin këtu në Tiranë, me të duan të takohen e të bisedojnë të gjithë, pse është njeri i thjeshtë. Prandaj mendoj se do të ishte më mirë të bëhej një takim i

1 Është fjala për komunistin e verbër Ilia Gazhga.

2 Në këtë takim merrte pjesë edhe shoku Ramiz Alia.

3 Fshat në rrethin e Lushnjës. Atje ishte ngritur një sektor i ndërtimit të hekurudhës Rrogozhinë-Fier.

vetëm në Pallatin e Kulturës, ku Fuati t'u thotë të pranishmëve disa fjalë për t'i frymëzuar si ta duan Partinë, si të jenë luftëtarë të pararojës e të mos tërhiqen para vështirësive, ashtu siç bën edhe vetë ai, që jo vetëm ka punuar në mënyrë shembullore në fshat, por edhe në hekurudhë punoi aq mirë sa doli katër herë sulmues.

SHOKU FUAT ÇELA: Eh, si u bë puna tani shoku Enver, përpara kishin të hanin vetëm disa njerëz, ndërsa populli vuante. Tani të gjithë janë mirë nga gjendja, askush nuk vuan, mjaft të punojë.

SHOKU ENVER HOXHA: Këtë situatë e solli forca e madhe e Partisë dhe e popullit, që po zbulurojnë jo vetëm fushat, po edhe malet.

SHOKU FUAT ÇELA: Përpara, te ne në Skrapar, thoshin se «ha pula strall», kurse tani as në malësitë tona të thella nuk mendon njeri vetëm për të siguruar bukën, përkundrazi, të gjithë punojnë si e si të marrin sa më shumë prodhime nga toka.

SHOKU RAMIZ ALIA: Kur venë vullnetarë për të punuar në Vërzhezhë e kanë për gëzim që venë në vendlindjen e Fuatit.

SHOKU FUAT ÇELA: Dhe unë, miqve që vijnë në fshatin tonë, u hap që në orën pesë radion që më dërgoi dhuratë shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Radion hape gjithnjë që të dëgjosh, sidomos lajmet që jep Tirana, në mënyrë që politikisht të jesh në dijeni për çdo problem. Duke punuar dëgjo edhe radion.

Si e keni planin me Fuatin sot?

SHOKU RAMIZ ALIA: Sot pasdite Fuati do të

bëjë disa vizita dhe nesër do të niset për në hekurudhë në sektorin e Dushkut, ku ka punuar.

SHOKU ENVER HOXHA: Meqenëse do të vizitojë disa qendra pune, jepni porosi të mos e lodhin.

Kur të kthehesh në Skrapar, përqafoji fort nga unë nënën dhe babanë, motrat e tua, Lirinë dhe Shpresën. U bëj të gjithëve shumë të fala nga ana ime. Mësuesen që kujdeset aq shumë për ty falënderoje gjithashtu nga ana ime për vullnetin e fortë që ka për të mësuar ty që të shkruash.

Mirupafshim!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

NJERËZIT E THJESHTË JANË NJERËZIT MË HEROIKË

Nga fjala në takimin me anëtarët e brigadës vullnetare të rinisë «Mehmet Shpendi» dhe me patriotin Pal Vata, që punuan në ndërtimin e hekurudhës Rrogozhinë-Fier

27 nëntor 1967

I dashur shoku Pal,

Të dashura shoqe dhe shokë të rinisë të brigadës «Mehmet Shpendi», ku militoi, luftoi, punoi dhe ra heroikisht shoqja jonë, komunistja trimëreshë, Shkurte Pal Vata!

Shkurta është edhe sot këtu në mes nesh, ajo është kudo në Shqipëri, në zemrën e në mendjen e mbarë rinisë dhe të popullit shqiptar. Shkurta jonë nuk ka vdekur, kujtimi i saj rron e do të rrojë përjetë. Atë nuk e mbuloi balta, por lavdia.

As ty shoku Pal Vata, as ju shoqe e shokë të rinisë të brigadës «Mehmet Shpendi» nuk do t'ju ngu-

shëlloj sot për humbjen e saj, ashtu siç është zakoni, përkundrazi, ju ftoj të brohorasim për Partinë tonë të lavdishme dhe për Shkurte Pal Vatën, që është midis nesh dhe do të rrojë kurdoherë!

Na gëzuat shumë që erdhët të takohemi, po vështirë e kam të flas ashtu si komandantja e brigadës suaj. Ajo foli shumë bukur, rrjedhshëm, qartë, plot zjarr dhe me një dashuri të madhe për Partinë, për popullin, për atdheun. Ajo shprehu këtu ndjenjat tuaja, atë çka ju mendoni dhe keni në zemër për të tashmen dhe për të ardhmen e gjithë Shqipërisë, veçanërisht të malësisë së Dukagjinit. Të tilla ndjenja, kaq të pastra e patriotike, ushqente edhe Shkurta jonë.

Po ç'ishte Shkurta? Ajo ishte një vajzë e thjeshtë e popullit, e pastër, me zemër të çeliktë e me mendje të kthjellët. Ajo s'kishte histori, por shkroi një histori dhe hyri në histori. Emri i Shkurtes u bë një pishtar që lëshon dritë në gjithë Shqipërinë, u bë flamur që përfaqëson heroizmin e rinisë së mbarë Shqipërisë, veçanërisht heroizmin e rinisë së malësisë së Dukagjinit, së cilës i thotë me shembullin e vet: «Përpara, kurdoherë përpara në rrugën e lavdishme të Partisë!».

Ju, atje ku punuat, e patë vetë se rënia heroike e Shkurtes ka ngjallur një hov të tillë të madh e të paimagjinueshëm, të cilin ju, ndoshta, nuk e merrnit dot me mend.

Me mijëra letra i vijnë tani Komitetit Qendror të Partisë nga të katër anët e Shqipërisë, nga i madh e i vogël, nga të rinj e të reja, pleq e plaka, nga fu-

shat e malësitë, në të cilat njerëzit tanë, me emrin e Shkurtes në gojë e në zemër, zotohen se do të luftojnë si gjithë heronjtë e popullit shqiptar dhe si Shkurte Pal Vata. Kudo, në mbarë vendin tonë, po merren zotime nga nxënësit se do të arrijnë rezultate të mira në mësim, merren zotime nga punëtorët e fshatarët se do të ngrenë rendimentet në industri e në bujqësi, do të kanalizojnë fushat, do të zbulojnë thesaret e nëntokës, do të ngrenë fabrika e hidrocentrale të reja më parë nga ç'parashikon plani, do të shtojnë bagëtitë etj. Me një fjalë, heroizmi i shoqes sonë të re, Shkurte Vatës, ka frymëzuar, ka mobilizuar dhe ka ngritur peshë gjithë Shqipërinë. Ja ç'është heroizmi i të rejave dhe i të rinjve! Ja ç'është forca dhe vija ngadhënjimtare e Partisë sonë!

Disa njerëz thonë: «Ç'po bëhet kështu me Shkurte Pal Vatën? Një cucë e vogël e malësisë të ngrejë në këmbë tërë Shqipërinë?». Po, kjo është e natyrshme, sepse njerëzit e thjeshtë janë njerëzit më heroikë. Mendoni ç'ishte Partia jonë më parë? Ajo në fillim ishte e panjohur, kurse sot njihet në gjithë botën. Ishte e vogël dhe u bë e madhe. S'ishte në fuqi, por erdhi në fuqi dhe u bë udhëheqësja e lavdishme e popullit shqiptar. Dhe kur flas për Partinë e kam fjalën për njerëzit heroikë e të thjeshtë të popullit, të klasës punëtoare, të fshatarësisë, të inteligjencies popullore, të cilëve nuk u rritet mendja dhe nuk e mbajnë hundën lart, por punojnë për idealin e tyre, për të mirën e popullit shqiptar, për ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit, për mbrojtjen dhe fuqizimin e atdheut tonë socialist.

Anëtarët e Partisë sonë janë njerëz të thjeshtë si Shkurte Pal Vata, janë bij të popullit, virtytet e mira të të cilit i marrin që kur thithin qumështin në gjirin e nënës. Prandaj Shqipëria jonë, e udhëhequr nga Partia e lavdishme e Punës, do të lulëzojë në shekuj, sepse ka bija e bij të tillë heroikë si Qemal Stafa, Vojo Kushi, Alqi Kondi, Shkurte Vata, Muhamet Shehu e mijëra e mijëra të tjerë, që hidhen në sulm, kudo ku u thotë Partia, për të fituar çdo betejë e për të marrë çdo kala.

Ndryshime të mëdha po bëhen sot në vendin tonë. I ka ndryshuar dhe po i ndryshon dita ditës faqja atdheut. Shqipëria po lulëzon, jeta e popullit bëhet çdo ditë më e gëzueshme dhe më e lumtur. Mendoni, shoqe dhe shokë të Dukagjinit, sa gëzohen Partia dhe e gjithë Shqipëria kur shohin se malësitë tona kreshnike, që kurrë nuk e kanë ulur kokën përpara armiqve të panumërt dhe të egër, ndjekin me besnikëri të madhe vijën shpëtimtare të Partisë, kur shohin që populli në këto vise kreshnike është mobilizuar me të gjitha fuqitë për forcimin e rendit tonë socialist që do t'ia bëjë jetën të lumtur e të gëzuar fshatarëve tanë.

Këto vitet e fundit malësia gjëmon si në ditë furtune. Direktiva e Partisë për t'i çliruar plotësisht gratë e vajzat nga mbeturinat e së kaluarës është përqafuar me entuziazëm dhe po zbatohet në jetë me vrull të madh, të paparë. Një shembull i shkëlqyer për zbatimin e kësaj direktive të Partisë jeni edhe ju, anëtarët e brigadës «Mehmet Shpendi», ku militonte edhe Shkurta jonë. Kur ajo ra, ju ishit më

pak cuca në brigadë, por menjëherë numri juaj u pesëfishua me vajza të tjera nga Dukagjini, pa folur për ato qindra e mijëra të tjera që u ngritën nga e gjithë Shqipëria.

Në mes atyre që erdhën për të zëvendësuar Shkurtën tonë ishte edhe ti, shoku Pal Vata. Ky ishte një gjest i madh patriotik, komunist, pse ti jo vetëm mposhte dhimbjen e thellë që të solli humbja e Shkurtes, por shkove edhe në hekurudhë për të zëvendësuar çupën, duke marrë me vete mbesën tënde, Katrinën. Ashtu si në luftë, dy të tjerë u ngritën dhe nuk e lanë bosh vendin e Shkurtes. Dëgjova në radio, shoku Pal, se djali juaj, Nduja, i aprovoi të gjitha ato çka thatë ju kur ishit në hekurudhë, por shtoi: «Një gjë nuk e tha aq mirë baba, që unë Nduja qenkam i vogël» dhe u zotua se kur të kthehet baba në familje do të shkojë edhe ai në hekurudhë.

Ti shoku Pal mbase nuk i di përmasat e atij entuziazmi që ka shkaktuar qëndrimi yt burror dhe ç'vlerësime i vijnë Komitetit Qendror nga masat e popullit për ty. Populli shqiptar e ka çmuar shumë lart gjestin tënd, si babë dhe si patriot. Mua më vijnë me shumicë letra me kërkesa dhe dëshira të atilla që nuk kemi mundësi t'ua plotësojmë të gjithëve. Në një letër disa vajza të Tiranës shkruajnë se edhe ato janë të reja si Shkurta, bile njëra prej tyre thotë se quhet Shkurtë dhe më lutet të ndërhyj që të vijë në familjen tuaj të rrijë e të jetojë një muaj me Palin dhe mëmën e Shkurtes sikur të ishte bija juaj. Por po t'ju vijnë të tëra këto në shtëpi, shoku Pal, nuk ke mundësi as me se t'i ushqesh, as ku t'i

strehosh. Megjithatë, me qindra do të vijnë në Peçaj, atje ku lindi e u rrit, atje ku prehet shoqja jonë, komunistja e lavdishme, Shkurte Vata. Njerëz nga e gjithë Shqipëria, sidomos të rinj e të reja, do të vijnë atje t'ju vizitojnë, të frymëzohen e të marrin forca të reja nga Shkurta dhe nga malësorët e malësoret e Dukagjinit. Prandaj me zjarrin e Partisë në gji, me kujtimin e heronjve dhe të dëshmorëve të Luftës Nacionalçlirimtare dhe të luftës për ndërtimin e socializmit, me kujtimin e shoqes sonë Shkurte Pal Vata, të ecim kurdoherë pa u ndalur përpara për të realizuar vijën e Partisë në të gjitha drejtimet.

Populli ynë, me Partinë në krye, do të bëjë mrekulli. Këto ne nuk na habitin, pse ne e dimë se ç'mund të arrijmë me punën tonë të palodhur, por sukseset tona do të gëzojnë miqtë tanë, kurse armiqtë do t'i futin në brenga e në shqetësime të mëdha.

Me këtë rast dëshiroj t'ju them një lajm të gëzuar. Së shpejti Komiteti Qendror do të marrë një vendim që, për të nderuar kujtimin e Shkurte Vatës, brenda vitit 1968 të elektrifikohet i gjithë lokaliteti i Dukagjinit, të gjitha fshatrat tuaja, shtëpi më shtëpi. Sa bukur do të jetë, kur shtëpitë e fshatrave të Dukagjinit të ndritin nga drita elektrike! Pastaj masat e mëtejshme që do të merrni ju të rinjtë dhe të rejat, sipas udhëzimeve të Partisë, ashtu sikurse foli shoqja komandante e brigadës, do ta zbu-kurojnë edhe më tepër jetën tuaj.

Të gjitha masat që përmendi komandantja juaj janë jashtëzakonisht të drejta dhe shumë të nevojshme. Ju të rinjtë, me komunistët në krye, duhet të

jeni kurdoherë përpara për vënien në jetë të vendimeve që ka marrë brigada. Që të realizohen ato, në radhë të parë, ju duhet të luftoni që gruaja dhe vajza të vihen në një radhë me burrin, domethënë, ato dhe ju të kuptoni drejt vijën e Partisë për çlirim e plotë të grave e të vajzave nga zakonet e vjetra. Për këto zakone të vjetra nuk mund t'i bëjmë shumë fajtorë prindërit tanë, sepse ato i kanë trashëguar nga e kaluara si norma të shoqërisë dhe ishte krijuar një opinion i tillë se kushdo që vepronte jashtë këtyre rregullave të caktuara e të zbatuara në shekuj, bënte një turp të madh. Mirëpo tani ka ndryshuar gjendja, jo vetëm te ju të rinjtë që jeni të qartë, por edhe te prindërit tuaj. Forca e Partisë dhe e rinisë, bindja juaj në radhë të parë dhe puna që do të bëni ju për t'i bindur më të vjetrit, do të ndihmojnë të realizohet qëllimi i madh i Partisë që vajzat tona të jenë si kurdoherë të ndershme, të papërtuara, të mësuara, të shkojnë në shkolla, të këndojnë, të vallzojnë, të jenë njëkohësisht të lira të fejojnë dhe të zgjedhin vetë shokun e jetës, të dalin nga fshati e të bashkohen me motrat dhe me vëllezërit e gjithë Shqipërisë.

Ne të gjithë jemi jashtëzakonisht të prekur e të gëzuar kur shohim se cucat e malësisë janë kaq të mençura e të zonjat në çdo pikëpamje, se ato e kuptojnë kaq drejt vijën e Partisë dhe i zbatojnë mësimet e saj me heroizëm. Gëzohet njeriu kur sheh se vajzat e malësisë nuk kanë ndryshim nga vajzat e qytetit. Ju jeni vajza të shëndetshme, sytë ju ndritin, jeni të pastra. Partia ju porositi që kështu si ve-

ten të mbani pastër edhe shtëpitë dhe unë kam bindjen se këtë porosi ju do ta zbatoni, sepse pastërtia është në traditën e popullit tonë dhe sot ne i kemi të gjitha mundësitë për këtë. Më parë shumë sende mungonin në malësinë e Dukagjinit, në Malësinë e Madhe dhe në disa krahina të tjera, për arsye se ato kanë qenë të varfra, kurse tash edhe atje po bëhen me shpejtësi ndryshime të mëdha ekonomike, të cilat në të ardhmen do të rriten akoma më tepër. Me vendimet që ka marrë dhe me planet që ka Partia për të ndihmuar malësitë, për t'i bërë malet po aq pjellore sa edhe fushat, nuk do të kalojnë shumë vjet dhe malësitë e Shqipërisë në përgjithësi, e në veçanti malësitë e Veriut, do të ngrihen me shpejtësi nga pikëpamja ekonomike e kulturore dhe jeta e tyre do të bëhet më e begatshme dhe më e bukur.

Ne nuk kënaqemi me sukseset e arritura, ato s'janë asgjë përpara atyre që mendon Partia të realizohen në të ardhmen. Ne do të bëjmë gjëra akoma më të mëdha. Lajme të tjera të gëzueshme do të ketë së shpejti për ju dhe për gjithë Shqipërinë. Ato do të ngrenë peshë tërë popullin, në fusha e në male, në fabrika e në shkolla, do të ndikojnë që të tejkalohen kudo planet dhe të plotësohen brenda pesë vjetëve ato detyra që i kishim parashikuar të realizoheshin pas pesëmbëdhjetë vjetësh.

Ne kemi besim të patundur se edhe malësitë do ta ndërrojnë krejtësisht faqen e tyre dhe për këtë një ndihmë të madhe do të japin edhe krahinat e tjera të vendit. Që tani ka filluar një lëvizje e madhe

nga fusha në malësi e anasjelltas dhe kjo lëvizje do të rritet edhe më shumë.

Fshati juaj, që tani ka vetëm njëzet e shtatë shtëpi, do të zmadhohet, ashtu si edhe fshatrat e tjera të Dukagjinit, sepse me qindra e mijëra janë ata që kanë shfaqur dëshirën të vijnë të punojnë e të jetojnë te ju. Dhe kuptohet, sa më shumë krahë pune e familje të ketë në malësi, aq më shpejt do të transformohet ajo. Në një kohë shumë të shkurtër do të mobilizoheni jo vetëm ju, por masa të mëdha të popullit do të shkulen nga Jugu për në Veri, ashtu siç u shkulet ju për të shkuar në Lushnjë e gjetkë për ndërtimin e hekurudhës e të veprave të tjera. Një unitet i madh i paparë i popullit, një lëvizje e gjerë Veri - Jug, Jug - Veri, nga fusha në mal dhe nga mali në fushë, do të karakterizojë jetën në vendin tonë. Të gjithë: punëtorë, shkollarë, fshatarë janë mobilizuar e po punojnë një për të gjithë e të gjithë për një, që vendi ynë të përparojë frontalisht, që të gjitha krahinat e atdheut të ecin përpara krah për krah. Këtë transformim do ta ndihmojë shumë edhe ndërtimi i rrugëve që do ta lidhin krahinën tuaj me gjithë vendin. Direktiva e Partisë është që atje ku duhet hapur rruga e madhe automobilistike, shteti të marrë përsipër barrën kryesore, kurse në ndërtimin e rrugëve që do të lidhin fshatrat me njëri-tjetrin të ndihmojë edhe vetë populli. Partia është e bindur se ai do ta realizojë këtë detyrë. Unë jam njoftuar se në Dukagjinin tuaj po punohet për të hapur njëzet kilometra rrugë të re për të lidhur tërë fshatrat tuaja me Thethin.

Të dashura vajza dhe djem të rinj të Dukagjinit! Nuk do ta harroj kurrë ditën e sotme, takimin me ju. Më duket sikur sot u poqa edhe me Shkurte Pal Vatën. Ju siguroj se Partia do ta ndihmojë rininë me të gjitha forcat, pse ajo është e ardhmja e Shqipërisë, ajo do të na zëvendësojë ne të moshuarit dhe do të marrë në dorë frenat e drejtimit të Partisë e të shtetit, do të zbatojë, do të fuqizojë e do të çojë më përpara vijën e drejtë të Partisë. Kujdesi më i madh i Partisë do të jetë që rinia të rritet heroike, e pastër, e kulturuar dhe me zell të madh për punë.

Ju duhet të bëni të gjitha përpjekjet që mësimet e Partisë t'i bëni mishin dhe gjakun tuaj, t'i kuptoni thellë dhe t'i vini në jetë. Të kini kurdoherë iniciativë dhe të mos trembeni se mund të gaboni, se s'ka njeri që të mos bëjë gabime, se, kur gabimet njihen, ato korrigjohen, bëhen mësim dhe nuk përsëriten më. Prandaj njerëzit e Partisë dhe rinia jonë duhet të kenë iniciativë e guxim dhe askush të mos i pengojë në këtë drejtim.

Ja, për nder të Shkurte Vatës tani është ngritur në këmbë i gjithë populli ynë. Nëpërmjet mijëra letrave e telegrameve, drejtuar Komitetit Qendror, populli shpreh një entuziazëm e vullnet të madh. Zotësia e Partisë dhe e Qeverisë sonë është tani që këto dëshira të zjarra të popullit të dinë t'i organizojnë, pse vullneti i tij, sidomos i rinisë, është i pakufishëm.

Kështu, pra, vihet problemi që Partia të forcojë organizimin. Por kush është Partia? Partia jemi të gjithë ne. Kur ju mendoheni mirë dhe vendosni të kry-

eni diçka, ia thoni Partisë që ne do të bëjmë këtë ose atë gjë, në mënyrë që të shkojmë përpara. Partia kurrrë nuk duhet ta presë hovin tuaj e t'ju thotë «dale të shohim». Ata që thonë «dale një herë, të shohim» janë burokratë.

Në Dukagjin ju keni në krye të organizatës së Partisë një udhëheqës partie shumë të mirë, shokun Mark¹, njeri energjik, mirëpo energjike janë edhe çupat e brigadës «Shkurte Vata» nga Lushnja, të cilat kanë vajtur në Pecaj për të ngritur shtëpinë e kulturës dhe atë të Pal Vatës. Kur sekretari i Partisë i lokalitetit tuaj u tha cucave se tani që filloi të bjerë borë, llaçi nuk përgatitet dot, mbasi ngrin uji, ato nuk u tërhoqën, po vendosën që ujin ta ngrohin në kazan dhe shtëpinë ta ndërtojnë. Dhe me siguri do ta ndërtojnë. Kur rinia vendos të ndërtojë shtëpitë, pavarësisht nga kushtet e vështira, kjo do të thotë se vullneti i saj është edhe më i madh. Kështu ju do Partia edhe ju cucat, të jeni kurdoherë në ballë, në çdo gjë, të guximshme, të papërkulura. Partia, gjithashtu, ju këshillon t'i doni dhe t'i respektoni prindërit sepse edhe ata ju duan shumë, megjithëse jo të gjithë janë të qartë e të zhvilluar ideologjikisht e politikisht, kanë koncepte e paragjykime të trashëguara nga e kaluara, prandaj me ta duhet të punohet akoma. Ju të rejat e të rinjtë duhet të dini si ta kapërceni këtë vështirësi e të çani përpara, sepse kurdoherë do të keni ndihmën e Partisë dhe, si rrjedhim, do të keni edhe dashurinë e mëmës e të atit që ju duan, pse ju

1 Mark Ndou.

kanë fëmijët e tyre. Durimi, zotësia, mençuria dhe ndershmëria juaj do t'ua rrëzojnë disave pikëpamjet e prapambetura dhe ju do të shikoni pastaj ç'ndihmë do t'ju japin ata.

Si në malësi, ashtu edhe në fushë në kokën e disa njerëzve ka pasur, ka e do të ketë akoma mendime të mykura. Por është fakt që, pasi Partia shtroi çështjen e çlirimit të plotë të gruas, shohim me kënaqësi se vajzat, kur kthehen nga aksionet në fshatrat e shtëpitë e tyre, në përgjithësi gjejnë nga ana e prindërve një klimë krejt të ndryshme. Ata i presin me dashuri e gëzim. Nuk është e vërtetë se prindërve nuk u pëlqen t'ju shohin të veshura me rrobat e aksionit, me shami të bukura, me leshra të prera kur ktheheni nga aksionet. Përpara, siç tha shoqja komandante e brigadës, ka qenë zakon që vetëm kur donin ta turpëronin gocën, ia prisnin flokët. Tashmë ky zakon është thyer, prandaj kur të ktheheni në fshat e në familje, jo vetëm që prindërit nuk do t'ju thonë gjë, por do t'ju shikojnë me kureshtje e gëzim edhe shoqet e tjera që s'kanë qenë në aksion, të cilat do të ndjekin gjithashtu rrugën tuaj në çdo gjë.

Përvoja që fituat ju gjatë punës në hekurudhë do ta ndihmojë shumë Partinë për zhvillimin e kulturës dhe për përmirësimin e jetesës në fshat, në fushë e në malësi, sepse ju jeni bërë luftëtare para-rojë të së resë.

Unë uroj, ashtu siç po brohoritni tani ju, që fjala e Partisë të jetë vepra juaj. I realizofshi të gjitha detyrat që keni marrë përsipër! Qofshi kurdohe-

rë të lumtura e të gëzuara! Të jeni punëtores heroike si Shkurte Pal Vata, luftëtare të guximshme si Qemali, Vojoja e qindra vajza e djem të tjerë të luftës e të ndërtimit socialist. Përvishjuni punës e mësimin! Mos mendoni vetëm për fshatin tuaj, për malësinë tuaj, por për gjithë Shqipërinë! Kur të mbaroni shkollat, mendoni se për ju ka nevojë jo vetëm malësia e Dukagjinit, po gjithë Shqipëria. Prandaj horizonti juaj duhet të jetë i gjerë dhe që të jetë i tillë ju duhet të punoni e të mësoni në fshatin tuaj, por edhe të dilni prej andej. Partia dhe Qeveria do të organizojnë vazhdimisht aksione që ju të mund të shkoni në to e të shikoni, të punoni dhe të mësoni nga e gjithë rinia e Shqipërisë. Të shikoni si zhvillohet në gjithë vendin tonë bujqësia, industria, si mësojnë e punojnë nxënësit e studentët tanë nëpër shkolla anekënd Shqipërisë, në mënyrë që kur Partia të thotë se në Dukagjin do të bëhet diçka, ajo të bëhet, e bile brenda një kohe shumë të shkurtër, sepse atje ka djem e vajza të zonja, që vënë në jetë vendimet e Partisë.

Prandaj, shokë edhe shoqe të rinisë, kur të shkoni në fshatrat tuaja në Dukagjin, u transmetoni, ju lutem, të gjithëve, baballarëve, mëmave, vëllezërve e motrave tuaja, gjithë të njohurve, dashurinë e sinqertë dhe nderimet e mia më të mëdha. U thoni të gjithëve se Partia ju do me gjithë shpirt dhe do t'ju ndihmojë me të gjitha forcat që Dukagjini i Shkurte Vatës të bëhet një krahinë që të shkëlqejë, ashtu siç shkëlqen fytyra e Shkurtes sonë heroike.

Ju falenderoj shumë, të dashura të reja e të rinj,

për dhuratat kaq të çmueshme që i dhatë Partisë. Këto dhurata shumë të shtrenjta ne do t'i ruajmë në muzeun e Komitetit Qendror, së bashku edhe me shumë sende të tjera. Shamia që ka mbajtur Shkurte Vata dhe libri që u gjet nën jastëkun e saj pas vdekjes, do të jenë nga thesaret e paçmueshme për brezat që do të vijnë.

Në emër të Komitetit Qendror të Partisë dëshiroj t'ju dhuroj edhe unë diçka, një bust të Vladimir Iliç Leninit, mësuesit të madh të komunistëve shqiptarë dhe të të gjithë botës.

Lavdi Shkurte Pal Vatës!

Të rrojë rinia!

Të rrojë Partia!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

TË KËRKOJMË QË PLANI TË REALIZOHET

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

1 dhjetor 1967

Këtu shokët bënë shumë vërejtje e propozime rreth raportit. Disa nga këto vërejtje e propozime, jemi dakord të gjithë që të pasqyrohen në raport brenda këtyre 10 ditëve që na ndajnë nga Plenumi² i Komitetit Qendror, kurse disa të tjera duhen rishikuar. Shokët e kryesisë së Këshillit të Ministrave dhe të Komisionit të Planit të Shtetit të shikojnë ç'duhet hequr ose ç'duhet shtuar menjëherë nga propozimet që u bënë në mbledhjen e sotme dhe të gjitha ndryshimet që duhen bërë t'ia paraqitin Plenumit. Këtu u shtruan edhe disa probleme të tjera që duhen shqyrtuar e duhen zgjidhur gjatë vitit.

Kisha edhe unë disa vërejtje. Një pjesë e tyre u konsumuan nga shokët që folën, prandaj do të

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi plotësimin e planit e të buxhetit të shtetit për vitin 1967 dhe detyrat e projektplanit e të projektbuxhetit të shtetit për vitin 1968».

2 Është fjala për Plenumin e 4-t të KQ të PPSH, që i zhvilloi punimet nga 11 deri më 12 dhjetor 1967.

flas vetëm për disa që nuk u prekën, të cilat, po të quhen të drejta, të merren parasysh.

Të mos flitet në përgjithësi për shkaqet dhe për masat që duhet të merren për përmirësimin e gjendjes në miniera, se ka rëndësi të madhe që të veprohet konkretisht për forcimin e tyre, prandaj të merren menjëherë masa dhe problemet që dalin në to të zgjidhen seriozisht, me qëllim që gjendja të stabilizohet sa më parë.

Procesin për nxjerrjen e acidit sulfurik nga gazrat e kanë zbuluar të tjerët, prandaj, gjersa ky proces është i njohur, të marrim masa për ta realizuar dhe jo të rrimë një vit për ta studiuar. S'ka pse t'i kushtohet kaq kohë studimit të këtyre problemeve.

Jam dakord me shokët e Komisionit të Planit të Shtetit që të mos u japim ministrive valutë jashtë caqeve të caktuara për të sjellë pjesë ndërrimi nga jashtë.

Mendoj se nuk ka pse të bëhet rishikimi i sipërfaqeve të caktuara për mbjelljen e patates. Pse të bëjmë një ndarje të re? Në rast se pranojmë ta bëjmë këtë, do të thotë të biem në pozitat e atyre që e propozojnë rindarjen dhe që vendimi që kemi marrë të vihet në diskutim. Po të veprojmë kështu, atëherë ne nuk do ta arrijmë dot në vitin 1970 objektivin që i kemi caktuar vetes. Nuk ka arsye që Ministria e Bujqësisë të bëjë tani një rindarje të këtyre sipërfaqeve, prandaj të mos bëhet asnjë lëshim në këtë drejtim. Bile duhet të synojmë që të gjitha rrethet, si ato që kanë shumë sipërfaqe për të mbjellë, ashtu edhe ato që kanë pak, t'i shtojnë këto.

Planifikimi është bazë, atë e kemi vendosur dhe

nuk duhet të luajmë duke thënë se shifra e planifikuar mund të mos realizohet. Ne tani kërkojmë që në një të katërtën e sipërfaqes të marrim rendimente të larta. Ky është një hap më përpara, por, krahas përpjekjeve për realizimin e kësaj detyre, të punohet që edhe në tre të katërtat e sipërfaqes të merren rendimentet e parashikuara sipas planit.

Në përgjithësi jam dakord me të gjitha çështjet që ngriti shoku Hysni [Kapo], të cilat të shikohen, të detajohen dhe të na paraqiten.

Tani që numri i bagëtive të oborreve kooperativiste është zvogëluar, mendoj të mos grumbullojmë më qumësht nga këto oborre, por t'ua lëmë atë anëtarëve të kooperativave ta përdorin për ushqimin e familjeve të tyre. Në qoftë se plani i grumbullimit të qumështit është mbështetur te këto bagëti, ky plan të ndryshohet. Ndonjëri mund të thotë se nga kjo masë do të pakësohet furnizimi i qyteteve me qumësht. Edhe kjo mund të ndodhë, megjithatë, gjersa u vendos të shkurtohen bagëtitë e oborrit, nuk është aspak e drejtë t'i merret fshatarit edhe qumështi i bagëtive që i kanë mbetur. Duhet të kemi parasysh se shumica e popullsisë jeton në fshat dhe fshatarësia jonë tregon një gatishmëri e patriotizëm të madh në çdo drejtim. Kemi thënë që anëtarëve të kooperativave t'u ndahet edhe pak bulmet nga tufa e krijuar me bagëtitë personale që u shkurtuan. Në qoftë se kjo nuk bëhet, atëherë duhet ta ndryshojmë planin e grumbullimeve.

Të kemi parasysh edhe raportin midis të ardhurave të punëtorëve dhe të fshatarëve. Një punëtor

ka mesatarisht 7 000 lekë të ardhura në vit, kurse fshatari ka më pak. Në këto kushte, t'i grumbullohet edhe qumështi fshatarësisë, se nuk u plotësuaka plani i furnizimit të qyteteve, kjo nuk shkon.

E njëjta gjë duhet thënë edhe për leshin e bagëtive të oborreve, me të cilin fshatari bën çorape, fanella, triko. Në qoftë se ua grumbullojmë të gjithë këtë lesh, por nuk kujdesemi sa duhet që të çojmë atje ku bën shumë ftohtë shajak, triko, fanella, çorape etj., do të thotë t'i iëmë njerëzit në malësi të dridhen nga të ftohtit. Kjo nuk është e drejtë. Leshi i bagëtive të oborreve nuk duhet grumbulluar pa marrë masa për t'ia plotësuar të gjitha nevojat për veshje fshatarësisë.

Tani, me ndryshimin e rrobave të rënda, fshatarët kanë nevojë të madhe edhe për beze, dok, kadife, vatë. Këto nevoja shteti duhet t'ua plotësojë sa më mirë kooperativistëve duke i furnizuar me artikuj të përshtatshëm veshjeje. Ne do të luftojmë që malësorët të mos bëjnë xhubleta të rënda, po në dimër për shembull, çermenikasi ka nevojë për shajak dhe për çorape të trasha leshi. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për Malësinë e Madhe e për Veriun në tërësi, prandaj plotësimi i kërkesave të fshatarësisë për veshje kërkon kujdes. Kjo duhet pasur mirë parasysh.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

AS DEMAGOGJIA DHE AS MBLEDHJA REVIZIONISTE NUK I SHPËTOJNË DOT RENEGATËT HRUSHOVIANË NGA DISFATA E PLOTË

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

3 dhjetor 1967

Komunistët dhe punonjësit e gjithë botës përkujtuan sivjet 50-vjetorin e triumfit të Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit. Ata përkujtojnë këto ditë edhe dy ngjarje të tjera të shënuara: 10-vjetorin e Deklaratës së Moskës të vitit 1957 dhe 7-vjetorin e Deklaratës së Moskës të vitit 1960.

Për këto ngjarje të rëndësishme kanë bërë e po bëjnë një zhurmë të madhe dhe revizionistët modernë, me udhëheqjen sovjetike në krye. Tërë veprimet e tyre i karakterizon demagogjia. Ata u përpoqën e përpiqen ta paraqitin veten si trashëgimtarë e vazhdues të veprës së tetorit të madh dhe si partizanë të flaktë të unitetit të lëvizjes komuniste dhe të të gjitha forcave antiimperialiste në botë.

Por faktet provojnë se klika udhëheqëse sovjetike i ka tradhtuar përfundimisht idetë e marksizëm-leninizmit, mësimet dhe veprën e Revolucionit të Te-

torit, parimet revolucionare të Deklaratës së Moskës, ka minuar unitetin e lëvizjes komuniste e të forcave antiimperialiste. Jubileun e Tetorit dhe përvjetorin e Deklaratave të Moskës revizionistët hrushovianë mundohen t'i shfrytëzojnë për qëllimet e veta kundërrevolucionare: për të mbuluar tradhtinë e tyre, për të mashtruar popujt dhe për të përgatitur komplete të reja kundër marksizëm-leninizmit, kundër revolucionit e socializmit.

Për këtë flet qartë raporti i Brezhnjev, i mbajtur më 3 nëntor në Moskë, i cili është një dokument fund e krye demagogjik, që, në fakt, kundërshton me tërbim marksizëm-leninizmin dhe Tetorin e kuq, Leninin e Stalinin dhe popullin sovjetik, diktaturën e proletariatit dhe revolucionin, që kundërshton socializmin dhe popujt revolucionarë të botës. Megjithëse udhëheqësit e sotëm sovjetikë nuk duan ta heqin veten si pasardhës të Hrushovit famëkeq e të diskredituar, Brezhnjevi, në raportin e tij të gjatë, nuk bëri gjë tjetër, veçse veshi me një ambalazh të ri mallin e skaduar revizionist të kongreseve të 20-të, të 22-të e të 23-të dhe të programit të PK të BS.

Renegati Brezhnjevi shtrembëroi pa skrupull historinë e lavdishme të Revolucionit të Tetorit. Ai e kaloi në heshtje faktin se fitorja e tij u arrit e u konsolidua me një luftë të ashpër e të pamëshirshme klasore të proletariatit rus e të Partisë Bolshevike, kundër regjimit të egër carist të çifligarëve e të kapitalistëve, kundër oportunitizmit e kapitullimit mikroborgjez e menshevik, kundër bashkëpunimit klasor e aventurizmit eser e trockist, kundër bandave bjellogardiste dhe

intervencionit të Antantës. Ai shtrembëroi të vërtetën dhe mësimin e madh historik se proletariati rus mori pushtetin politik dhe krijoi shtetin e sovjetëve me anën e dhunës revolucionare dhe, në kundërshtim me këtë, e vuri theksin te «format paqësore të luftës» dhe te «taktikat elastike» të kalimit në socializëm. Duke u tallur me cinizëm me gjakun e mijëra e dhjetëra mijë revolucionarëve, që dhanë jetën në betejat klasore dhe në frontet e luftës civile, me sakrificat e padëgjura që u detyrua të përballojë populli rus, Hrushovët, Brezhnjevët dhe renegatët e tjerë, me qëllim që të mos e trembin borgjezinë me «socializmin» e tyre, janë përpjekur e përpiqen t'i japin një lustër oportuniste revolucionit socialist, ta zhveshin atë nga përmbajtja klasore thellësisht antikapitaliste, ta zbutin, ta paraqitin si një «evolucion paqësor», si një revolucion, që u krye «pothuajse pa gjak», si diçka të pranueshme për «humanizmin» borgjez.

Brezhnjevi, në fjalimin e tij të gjatë, nuk gjeti asnjë fjalë për të përmendur periudhën tridhjetëvjeçare të udhëheqjes së Stalinit, që përbën një ndër periudhat më të lavdishme në historinë e Partisë Komuniste dhe të shtetit sovjetik. Ai e mohoi tërë këtë periudhë, duke mohuar kështu meritat historike të popullit sovjetik, i cili, gjatë kësaj periudhe, nën udhëheqjen e drejtë e të shkëlqyer të J.V. Stalinit, krijoi shtetin e fuqishëm socialist, ngriti një industri të fuqishme socialiste, përfundoi me sukses kolektivizimin e bujqësisë në rrugën e Leninit, forcoi mbrojtjen e vendit, arriti fitoren historike në Luftën e madhe Patriotike, asgjësoi bishën fashiste dhe u bë

çlirimtari i popujve të Evropës, ringjalli nga shkatërrimet e luftës fuqinë ekonomike të shtetit sovjetik dhe ngriti në një shkallë të paparë autoritetin e tij botëror.

Mohimi i kësaj periudhe të lavdishme nga re-negatët revizionistë nuk është i rastit. Revizionizmi është mohimi i marksizmit dhe revizionistët janë antipodi i revolucionarëve të vërtetë. Ata nuk mund të flasin për periudhën heroike të Stalinit, sepse ecin në drejtimin e kundërt të kësaj rruge, të rrugës së Tetorit të madh, të rrugës së Leninit e të Stalinit, ata ecin në rrugën e restaurimit të kapitalizmit.

Duke mohuar mësimin e pavdekshëm të Leninit se shteti është organ i sundimit e i dhunës klasore dhe se shteti sovjetik, në të gjitha fazat e zhvillimit të tij historik, është organ i sundimit klasor të proletariatit, shtet i diktaturës së proletariatit dhe, si i tillë, mjet i domosdoshëm për kalimin nga kapitalizmi në komunizëm, klika renegate e revizionistëve sovjetikë, me gojën e Brezhnjev, përsëriti dhe zhvilloi më tej tezat e Hrushovit e të kongreseve të 20-të e të 22-të mbi degjenerimin e shtetit sovjetik në «shtet të të gjithë popullit», mbi degjenerimin e partisë së Leninit në «organizatë politike të të gjithë popullit».

Nën zhurmën e «festimeve të Tetorit», Brezhnjevi dhe klika e tij donin të fshihnin faktin se kanë hequr dorë prej kohësh nga ligjet e përgjithshme të revolucionit e të ndërtimit socialist, të sanksionuara në Deklaratën e vitit 1957. Revizionistët sovjetikë i

kanë hapur të gjitha dyert procesit kundërrevolucionar të restaurimit kapitalist. Në themel të «reformës së tyre ekonomike» qëndrojnë format e organizimit e të drejtimit të ekonomisë mbi baza kapitaliste. Fitimi material me çdo mjet e në çdo rrugë është bërë motoja kryesore për zhvillimin e prodhimit e të kulturës. Anarkia, konkurrenca, tregu i zi, spekulimi dhe fenomene të tjera tipike për ekonominë kapitaliste po duken gjithnjë më qartë në realitetin e Bashkimit Sovjetik. Prona socialiste po copëtohet e po shndërrohet çdo ditë e më tepër në pronë kapitaliste të një tipi të ri. Ideologjia borgjeze dhe kultura dekadente perëndimore, së cilës revizionistët i kanë lënë fushë të lirë veprimi, po shkallmon ndërgjegjen e njerëzve dhe kulturën socialiste. Brezhnjevi dhe klika e tij i kanë hapur dyert vërshimit të kapitaleve të huaja, po ua shesin Siberinë Lindore kapitalistëve japonezë, ashtu siç bëri cari me Alaskën, duke ua shitur kapitalistëve amerikanë për një grusht dollarësh. Klika renegate sovjetike ka përkrahjen e monopoleve të mëdha amerikane në rivendosjen e kapitalizmit. Për këtë qëllim ajo i ka lejuar edhe grupet kapitaliste italiane, angleze, franceze të shfrytëzojnë tokën ruse, krahun e punës dhe lëndët e para sovjetike. Me kënaqësi të madhe gazeta reaksionare angleze «Gardian» shkruante se politika sovjetike dhe ajo amerikane «po i përshtaten njëra-tjetrës» çdo ditë e më shumë dhe se Bashkimi Sovjetik «po u ngjan shumë Shteteve të Bashkuara në organizimin ekonomik».

Duke braktisur e shkëlmuar konkluzionet dhe parimet revolucionare të Deklaratave të Moskës mbi

epokën e sotme si epokë e revolucioneve socialiste e nacionalçlirimtare, mbi luftën e vendosur kundër imperializmit me SHBA-në në krye, mbi përkrahjen e lëvizjes revolucionare e të luftërave çlirimtare të popujve, klika renegate e revizionistëve sovjetikë, me gojën e Brezhnjevit, u bëri përsëri apologjinë «bashkekzistencës paqësore», «garës paqësore» dhe «kalimit paqësor», përdori përsëri shantazhin e asgjësimit termobërthamor për të thyer dhe paralizuar vullnetin luftarak të popujve. Brezhnjevi deklaroi me paturpësi se politika e jashtme e klikës revizioniste sovjetike është «internacionaliste» dhe «plotësisht revolucionare në përmbajtjen e saj», se ajo klikë ka hequr dorë «nga metodat e diplomacisë së fshehtë dhe nga politika e bashkëpunimit prapa shpinës së popujve». Ky është kulmi i gënjeshtërs, i hipokrizisë dhe i cinizmit. Ngjarjet e përditshme ndërkombëtare, veprimet konkrete të klikës revizioniste sovjetike provojnë se këto veprime s'kanë absolutisht asgjë internacionaliste e revolucionare, por se pikërisht bashkëpunimi kundërrevolucionar me imperializmin amerikan në shkallë globale për mbytjen kudo të revolucionit përbën thelbin e politikës së jashtme antisocialiste dhe antimarksiste të renegatëve të Moskës.

Pa e zgjatur me numërimin e fakteve të shumta të tradhtisë në dhjetëvjeçarin e fundit, me të cilat është mbushur politika e jashtme hrushoviane, mjafton të përmendim komplotin kriminal të Glasboros, ku dy krerët e dy superfuqive — SHBA dhe BS — Xhonsoni e Kosigini, përcaktuan prapa shpinës së popujve bashkëveprimin e tyre në kuadrin e strategjisë globale

kundërrevolucionare për sundimin e botës, për të kundërshtuar popujt revolucionarë, për ta detyruar popullin heroik vietnamez të gjunjëzohet e të kapitultojë, për t'u vënë thikën pas shpine popujve arabë dhe popujve të tjerë që luftojnë agresionin dhe imperia-lizmin. «Internacionalizmin» me fjalë dhe tradhtinë me vepra të revizionistëve hrushovianë e kanë provuar dhe po e provojnë në shpinën e tyre, me gjakun e tyre, gjithë popujt revolucionarë, që janë në ballë të luftës kundër armikut më të egër e të rrezikshëm të njerë-zimit — imperializmit amerikan.

Ja përse sot krerët e imperializmit e të reaksionit ndërkombëtar dhe propaganda e tyre përshëndetin e brohorasin varrmihësit e Revolucionit të Tetorit. Xhons-soni e Uilsoni, Suhartoja e Mobutuja, shahu i Persisë dhe Kerenski janë «optimistë» për «zhvillimin e ngjarjeve» në Bashkimin Sovjetik, prandaj nuk munguan t'i dërgojnë përshëndetjet e tyre entuziaste klikës udhëheqëse sovjetike me rastin e festës së Tetorit. Është kuptimplote deklarata e Aleksandër Keren-skit, kreut të pushtetit çifligaro-kapitalist rus, që u përmbys nga Revolucioni i Tetorit, i cili shpreh tani me kënaqësi bindjen e tij se «ka ardhur koha të flakim pesimizmin në vlerësimin e rrjedhës në Bashkimin Sovjetik», se revizionistët hrushovianë nuk interesohen më «për të çuar përpara revolucionin botëror», se «drejtimi kryesor në Bashkimin Sovjetik është kalimi drejt lirisë» (në kuptimin borgjez të kësaj fjale).

Kreu i revizionistëve sovjetikë, Leonid Brezhnjev, nga tribuna e oratorisë së mbledhjes «jubilarë» më 3 nëntor, ndërsa sulmoi me tërbim marksizëm-leniniz-

min dhe gjithë revolucionarët proletarë, tundi flamurin fals të unitetit, bëri thirrje për një «mbledhje ndërkombëtare të partive komuniste e punëtore». Ai tha ndër të tjera: «Partia jonë është gati të bëjë gjithçka për suksesin e takimit të ri botëror të komunistëve». Grupi i Brezhnjev-Kosiginit e shfrytëzoi vajtjen në Moskë të të gjithë renegatëve e lakenjve të vet, që nga agjenti i vjetër e i sprovuar i imperalizmit amerikan J.B. Titoja e deri te socialshovinisti i regjur indian Dange, për të organizuar konsultime dhe për të bërë presione të drejtpërdrejta për thirrjen e mbledhjes ndërkombëtare revizioniste. Tani njoftohet zyrtarisht se 18 parti që patën marrë pjesë në mbledhjen revizioniste famëkeqe të 1 marsit 1965 në Moskë, paskan vendosur që në shkurt të vitit 1968 të mbahet në Budapest një «takim konsultativ për shkëmbimin e mendimeve mbi thirrjen e mbledhjes ndërkombëtare» dhe u drejtohen të gjitha partive të marrin pjesë në këtë takim konsultativ, duke i vënë kështu «të pabindurit» para faktit të kryer.

Mbledhja, që kërkohet me kaq zell e ngutje nga udhëheqja revizioniste sovjetike, nuk është ndonjë gjë e re. Ajo është një ringjallje e iniciativës që pati ndërmarrë dikur po me aq zell e pasion, paraardhësi dhe mësuesi i saj, renegati Hrushov. Tanimë të gjithë e dinë se cili ishte fundi i kësaj «iniciative» dhe i vetë «iniciatorit». Ai u flak në koshin e plehrave të historisë. Të vendosur për ta çuar deri në fund kursin tradhtar të N. Hrushovit, udhëheqësit e sotëm revizionistë sovjetikë nxjerrin përsëri nga varri iniciativën e kryetarit të tyre të falimentuar për të arritur me forma

e mënyra të ndryshme po ata objektiva, po ato qëllime.

Po përse udhëheqësit hrushovianë sovjetikë, me gjithë dështimet e derisotme, që i kanë diskredituar keq, ngulin kaq shumë këmbë për një mbledhje të re ndërkombëtare? Mos vallë me të vërtetë ata i preokupon «çështja e unitetit» të forcave revolucionare dhe e përpunimit të një «vije të përbashkët» revolucionare siç e propagandojnë me të madhe? Në fakt, ata e kanë minuar prej kohësh unitetin me forcat revolucionare, janë hedhur në luftë kundër tyre dhe janë bashkuar me forcat reaksionare të imperializmit ndërkombëtar, me SHBA-në në krye. Ata e kanë braktisur prej kohësh vijën revolucionare, e kanë zëvendësuar atë me një vijë kundërrivolucionare, që po minon kudo në botë çështjen e revolucionit dhe të socializmit.

Këtë mbledhje revizionistët sovjetikë e kërkojnë jo nga e mira, por nga e keqja, dhe jo për të mirë, po për të kryer krime të reja. I ndodhur përpara disfatave të rënda në lëmin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar, përpara demaskimit gjithnjë më të vendosur, që i bëjnë marksistë-leninistët dhe popujt revolucionarë kursit tradhtar e kapitullues të udhëheqësve revizionistë sovjetikë, grupi renegat Brezhnjev-Kosigin kërkon të gjejë rrugëdalje nga kjo situatë e vështirë për të. Dhe këtë rrugëdalje ata e shohin në radhë të parë në organizimin e një mbledhjeje «ndërkombëtare të komunistëve». Në këtë mbledhje, pasi të varrosin me ceremoni (sepse në fakt i kanë bërë me kohë copë e thërrime) parimet revolucionare të Deklaratës së partive komuniste e punëtore të nënshkruara 10 vjet më parë, si dhe ato të Deklaratës së Moskës të vitit 1960,

ata do të mundohen të sigurojnë aprovimin nominal të renegatëve të tjerë revizionistë për vijën e tyre tradhtare dhe ta përlligjin atë zyrtarisht si «vijën e lëvizjes komuniste ndërkombëtare».

Strumbullar të kësaj mbledhjeje, udhëheqja sovjetike kërkon të bëjë dënimin e mallkimit zyrtar si «dogmatike», «përçarëse», «sektare» etj. të PPSH dhe të partive të tjera marksiste-leniniste, të cilat janë flamurtaret e marksizëm-leninizmit e të luftës kundër revizionizmit, mbrojnë e zbatojnë me konsekuencë parimet revolucionare të deklaratave të viteve 1957 e 1960.

Orvatjet e revizionistëve hrushovianë për të dënuar e izoluar PPSH shprehin jo forcën, por dobësinë e pozitive të tyre në luftën e paparim kundër marksizëm-leninizmit. Ato janë orvatje të kota, që do të dështojnë me turp, ashtu si deri sot. Të dënuar nga historia e të izoluar nga popujt janë pikërisht revizionistët. Çështja e revolucionit dhe e socializmit është e pathyeshme, sepse të pathyeshëm janë popujt që e mbrojnë dhe e çojnë atë përpara në luftë kundër imperializmit, reaksionit e revizionizmit.

Çështja e thirrjes së një mbledhjeje ndërkombëtare të partive ka një histori të gjatë, plot disfata e deziluzione për klikën udhëheqëse sovjetike. Vendimi për të bërë të ashtuquajturin «takim konsultativ» të Budapestit nuk ka zhdukur e nuk mund të zhdukë vështirësitë për thirrjen e mbledhjes ndërkombëtare të partive, gjë për të cilën flet edhe eksperiencia e hidhur e takimit famëkeq të dështuar të 1 marsit 1965 dhe atij të Karlovi-Varit në prill 1967.

Udhëheqja revizioniste sovjetike nuk po lë gur pa

lëvizur e presion pa ushtruar për të kapërcyer vështirësitë dhe pengesat që has në rrugën e organizimit të mbledhjes ndërkombëtare të tradhtarëve. A do t'ua arrijë apo jo qëllimeve të saj, këtë do ta tregojë koha. Por, sido që të ndodhë, mbahet apo nuk mbahet një mbledhje e tillë, për marksistë-leninistët fitorja është e pashmangshme. Në rast se renegatët revizionistë e mbajnë mbledhjen, do të demaskohen akoma më shumë, sepse do të zbulohet edhe më qartë fytyra e tyre tradhtarë. Po nuk e mbajtën, do të diskreditohen akoma më keq, sepse kanë kaq kohë që flasin për mbledhje dhe s'mund ta bëjnë dot. Ia arrijnë ose jo qëllimit për të organizuar mbledhjen e tyre «të famshme» e zhurmëmadhe, revizionistët nuk do të mund të riparojnë të çarat në kampin e tyre, nuk do të mund të zhdukin krimbin që i bren nga brenda, nuk do të mund të shpëtojnë nga disfata përfundimtare dhe e pashmangshme. Kursi i tyre tradhtar, antimarksist dhe antisocialist do t'i çojë patjetër në këtë fund të palavdishëm. Por objektivat dhe qëllimet e tyre do të vijë dita që të shpartallohen. Dallgët e stuhishme të luftës së marksistë-leninistëve dhe të revolucionarëve të vërtetë kudo në botë, duke përfshirë edhe bolshevikët sovjetikë, që u qëndrojnë besnikë ideve të Tetorit të madh, mësimëve të Leninit dhe të Stalinit, do të fshijnë nga faqja e dheut grupin tradhtar Brezhnjev-Kosigin dhe pasuesit e tij, marksizëm-leninizmi do të triumfojë mbi revizionizmin.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 290 (6015), 3 dhjetor 1967

Botohet sipas librit: «E vërteta marksiste-leniniste do të triumfojë mbi revizionizmin», vëll. VII, f. 189. Tiranë 1968

PLENUMI I KOMITETIT TË PARTISË ËSHTË UDHËHEQJA KRYESORE E PARTISË NË RRETH

*Diskutim në mbledhjen e sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

4 dhjetor 1967

Nuk kisha shumë gjëra për të thënë, pse shokët që diskutuan bënë mjaft vërejtje, me të cilat jam dakord edhe unë. Puna tani është që këto çështje t'i thellojmë më tej dhe të luftojmë të gjithë që, sa të jetë e mundur, ato t'i kuptojë mirë edhe baza, sepse ky është një problem me shumë rëndësi.

Mendimi im është se punët e Partisë ecin përpara, prandaj nuk duhet të jemi pesimistë për faktin që në punët tona ka edhe disa të meta. Ato në asnjë mënyrë nuk duhet të na çojnë në konkluzionin sikur plenumet e komiteteve të Partisë nuk po na ecin, përkundrazi, ato ecin, komunistët e kuadrot e Partisë në bazë punojnë, po, natyrisht, ka edhe të meta. I tillë

1 Në këtë mbledhje u thirrën për të raportuar komitetet e Partisë të rretheve të Fierit e të Kolonjës lidhur me punën e bërë për ngritjen e mëtejshme të rolit të plenumeve të komiteteve të Partisë.

është zhvillimi dialektik. Por tani duhet ta përqendrojmë mirë kujdesin tonë për ta përmirësuar më tej punën e plenumeve të komiteteve të Partisë të rretheve.

Të mos kuptohet shtrebrë çështja se gjithë udhëheqjen e Partisë në rreth tani duhet ta spostojmë nga byroja në komitetin e Partisë. Byroja e komitetit të Partisë ka funksionin e vet, edhe plenumi i komitetit të Partisë ka gjithashtu funksionin e vet udhëheqës. Komiteti Qendror duhet ta bëjë të qartë mirë që e gjithë Partia në bazë dhe vetë anëtarët e plenumit të kuptojnë se plenumi i komitetit të Partisë është udhëheqja kryesore e Partisë në rreth. Nga kjo rrjedhin një mijë e një detyra të tjera, kolegjiale dhe individuale, del, në radhë të parë, përgjegjësia e çdo anëtari plenumi, i cili duhet të jetë me të vërtetë në pararojë, mbi të gjithë komunistët, lëre pastaj që duhet të jetë në çdo drejtim shembull pozitiv për masat.

Por nuk mjafton vetëm njohja e parimit që plenumi është udhëheqja kryesore edhe mbi byronë e komitetit të Partisë. Byroja është e zgjedhur nga plenumi, ashtu siç janë zgjedhur prej tij edhe sekretarët e komitetit të Partisë, që janë, gjithashtu, anëtarë të plenumit, nga i cili ata janë caktuar në këto detyra, prandaj si të tillë ata janë edhe të kritikueshëm, edhe të lavdërueshëm dhe mund të vazhdojnë të qëndrojnë në detyrë kur punojnë mirë, ndërsa kur nuk e meritojnë, mund të hiqen vetëm prej plenumit ose prej konferencës së Partisë. Këtë çështje ne duhet ta theksojmë dhe ta bëjmë të qartë jo vetëm pari-

misht, po edhe ta vëmë mirë në zbatim, në praktikë.

Në Komitetin Qendror ne kemi të drejtë t'i aprovojmë ata që janë zgjedhur në byro, edhe sekretarët e komitetit të Partisë, por me këtë të drejtë, kur s'kemi asnjë vërejtje, ne nuk bëjmë tjetër veçse aprovojmë vullnetin e Partisë në bazë. Por në qoftë se Komiteti Qendror konstaton se organizata e Partisë në një rreth ka arritur të zgjedhë në udhëheqje një element të padëshiruar, ai ka të drejtën t'i rekomandojë plenumit të komitetit të Partisë të rrethit të mblidhet përsëri për këtë çështje, t'i tregojë çfarë njeriu është ai që është zgjedhur dhe ta orientojë që t'i futet më thellë çështjes së tij, ta njohë si duhet, ta gjykojë ashtu siç është. Ose kur Komiteti Qendror ka një vërejtje për njërin nga sekretarët ose për sekretarin e parë të komitetit të Partisë, që zgjedh plenumi si organ më i lartë i Partisë, ai ka të drejtë t'i sinjalizojë plenumit që e zgjodhi se ai nuk e kundërshton vendimin, po i rekomandon të ketë parasysh se sekretari ka edhe këto apo ato të meta, të cilat duhet t'ia vërë në dukje dhe ta kontrollojë në punë e sipër, me qëllim që të ndreqet.

Edhe çështjen e konformizmit shokët e plenumit duhet ta kuptojnë mirë dhe çdo gjëje t'i qëndrojnë mbi kokë. U fol këtu se anëtarët e plenumit nuk flasin sa duhet për shokët e byrosë dhe për sekretarët e komitetit të Partisë. Përse ata nuk flasin haptazi kur kanë kritika për të metat e shokëve të byrosë, ose për sekretarët e komitetit të Partisë? Shkaku duhet zbuluar dhe të punohet që të kuptohet drejt përgjegjësia kolektive dhe personale e plenumit dhe e

qdo anëtari të tij ndaj byrosë së komitetit të Partisë të rrethit.

Por duhet pasur parasysh edhe ana tjetër e problemit: byroja nuk mund të zëvendësohet nga plenumi i komitetit të Partisë. Ajo ka për detyrë të zbatojë gjer në fund vendimet që merr plenumi, të cilat nuk janë vetëm ato që merren gjatë mbledhjeve midis dy konferencave të Partisë në rreth. Përveç atyre, ka edhe një sërë vendimesh të tjera për zbatimin e të cilave janë ngarkuar byroja dhe sekretarët e komitetit të Partisë, që duhet t'u qëndrojnë mbi kokë atyre, gjersa të zbatohen plotësisht. Këtë punë mund ta bëjë vetëm byroja, pse është më praktike të mblihdhen më shpejt anëtarët e byrosë, pse janë më pak, se sa gjithë anëtarët e plenumit.

Prandaj, në qoftë se shokët në bazë nuk i njohin mirë funksionet e byrosë, ne edhe një herë duhet t'ua bëjmë të qarta, ashtu siç duhet t'ua bëjmë të qarta edhe funksionet e plenumit. Çështja nuk qëndron vetëm në atë që plenumi të bëjë aq mbledhje sa janë caktuar në Statutin e Partisë ose në udhëzime të Komitetit Qendror, ai mund të bëjë edhe një mbledhje më tepër, ose po të dojë në një mbledhje mund të marrë edhe dy probleme në shqyrtim. Këto plenumi mund t'i bëjë, po funksionet, si të byrosë, ashtu dhe të plenumit, janë të caktuara. Prandaj funksionet e byrosë nuk mund t'i marrë plenumi, ndryshe punët do të na çalonin.

Vendimet që merr plenumi kanë rëndësi, po rëndësi më të madhe ka revolucionarizimi i anëtarëve të tij, lufta që duhet të bëjë vazhdimisht dhe gjithë vitin

secili prej tyre. Pikërisht për këtë duhen zbatuar të gjitha ato masa që propozoi shoku Hysni Kapo. Qëllimi është që nga vetë anëtarët e plenumit të kuptohet thellë rëndësia e funksioneve të plenumit dhe e vendimeve që merren, të cilat duhet t'i zbatojnë ata të parët.

Gjatë gjithë vitit, pra, anëtarët e plenumit, në forma dhe mënyra të ndryshme, duhet të aktivizohen dhe të jenë çdo ditë në vijën e parë të luftës për zbatimin e detyrave dhe vendimeve të Partisë. Detyra e tyre nuk duhet të kuptohet vetëm me pjesëmarrjen e gjallë në mbledhje, po në punën që duhet të bëjnë ata vazhdimisht, çdo ditë. Kjo ka rëndësi të madhe. Në këtë drejtim të insistojmë më shumë që anëtarët e plenumit të jenë në ballë të kësaj lufte të përditshme, sepse vetëm kështu do të zbatohen plotësisht vendimet që merren në mbledhjet e plenumit të komitetit të Partisë.

Anëtarët e plenumit të komitetit të Partisë të rretheve tani janë duke u aktivizuar më mirë se më parë. Me ta po përdoren disa forma që kanë dhënë rezultate dhe mendoj se në të ardhmen do të japin rezultate edhe më të mëdha. Një nga këto forma është caktimi i tyre për të punuar vendimet e ndryshme në bazë. Ky është një aktivizim që u bëhet shokëve të plenumit, gjë që përpara e bënim me të meta. Një formë tjetër e aktivizimit të tyre është se ata ngarkohen tani me detyrë që të venë të punojnë në bazë në një shkallë më të gjerë. Edhe kjo është një formë që nuk e praktikojmë gjer ca kohë më parë, formë që i detyron shokët e plenumit t'u punojë mendja. Gjithashtu, ne organizojmë grupe pune për probleme

të veçanta me anëtarët e plenumit. Edhe kjo është një formë aktivizimi për ta. Disa nga anëtarët e plenumit, duke parë se po aktivizohen si anëtarë të udhëheqjes në rreth nëpërmjet këtyre tri formave, ecin vetë më tej, u rritet iniciativa për të shkuar edhe në organizata të tjera partie, jashtë organizatës së tyre. Natyrisht, këtë nuk e bëjnë të gjithë dhe ne duhet të përpiqemi që t'i aktivizojmë më shumë në këtë drejtim, por të mbahet parasysh edhe fakti se anëtari i plenumit është i lidhur më tepër me atë qendër pune ku punon vetë. Megjithatë, anëtarin e plenumit që punon dhe jeton ta zëmë në një kooperativë bujqësore, mund ta nxitim të vejë në organizatën-bazë të kooperativës që ka afër. Por akoma më mirë është që ai, megjithëse punon në një kooperativë, të vejë, ta zëmë, edhe në ndonjë fabrikë që e ka afër, po do të ishte zor për një anëtar plenumi të Komitetit të Partisë të Rrethit të Korçës, për shembull, të ngrihej nga Opari dhe të shkonte në Bilisht, se në këtë rast nuk ka si të dijë as kur bëhet mbledhja e organizatës së Partisë atje, as rendin e ditës.

Një formë tjetër pune që disa e praktikojnë me sukses, ndërsa të tjerë e praktikojnë, por nuk kanë rezultatet e dëshiruara, pse ka pakujdesi nga ana e tyre, është organizimi i informacionit për të mbajtur në dijeni anëtarët e plenumit me problemet që i takojnë udhëheqjes. Kjo ka rëndësi të madhe dhe bën që anëtari i plenumit ta ndiejë më shumë përgjegjësinë e detyrës si anëtar i forumit. Byroja e komitetit të Partisë të rrethit merr mjaft probleme në shqyrtim, për të cilat duhet të vihen në dijeni anëtarët e ple-

numit atje ku punojnë, ose duke ua dërguar konkluzionet e mbledhjes së byrosë, ose, sipas rastit, të njoftohen ata të vijnë për t'i lexuar në aparatën e komitetit të Partisë, siç bëhet te ne me shokët e Plenumit të Komitetit Qendror. Me këtë mënyrë mendojmë se shokët e plenumit do të mbahen të informuar dhe do të ndihmohen që të kualifikohen më tej. Puna është që nëpërmjet formave të ndryshme të përpjekimi të ngremë nivelin e shokëve dhe të luftojmë që këto forma t'i zgjerojmë e t'i përsosim më tej.

Por gjatë punës të kemi kujdes që të mos kërkojmë njëlloj si nga shokët e thjeshtë të rinj të plenumit, ashtu edhe nga anëtarët e byrosë dhe ca më tepër nga sekretarët e komitetit të Partisë, të cilët janë efektivë, profesionistë dhe janë zgjedhur në këto poste të rëndësishme, sepse janë nga njerëzit më të ngritur të organizatës së Partisë në rreth, fakt ky që përbën një plus për Partinë.

Partia në bazë e ka të qartë, megjithatë dëshiroj të theksoj se mbledhjet e plenumit nuk duhen konfunduar me aktivin e Partisë të rrethit. Këto janë dy gjëra krejt të ndryshme. Le të marrim një shembull: Komiteti Qendror mori kohët e fundit vendimin për zhvillimin e mëtejshëm e të shpejtë të lopës në vendin tonë. Për ta punuar këtë vendim mund të bëhet në çdo rreth një aktiv partie, ku të shtrohet direktiva e Komitetit Qendror. Në këtë aktiv do të thirren natyrisht aktivistët më të mirë të Partisë. Po aktivin nuk mund të konfundohet në asnjë mënyrë me mbledhjen e plenumit. Atëherë çfarë duhet të bëjë plenumi për këtë vendim? S'ka dyshim që në aktiv do të marrin

pjesë edhe të gjithë anëtarët e plenumit, mjaft prej tyre do të diskutojnë atje, po plenumi dhe byroja e komitetit të Partisë, nga ana e tyre, të përgatiten në mënyrë të veçantë për të përcaktuar konkretisht masat e nevojshme që duhen marrë për zbatimin e plotë të vendimit të Komitetit Qendror. Por këtu të keni kujdes që masat që do të vihen në vendimin e plenumit ose të byrosë të mos jenë perifrazime dhe të përgjithshme, por konkrete. Për shembull, në Mallakastër ta zëmë nuk ka lopë. Atëherë plenumi i komitetit të Partisë të rrethit duhet të analizojë përse nuk ka dhe ç'duhet bërë që të ketë. Problemi, pra, të trajtohet konkretisht. Ose, sikur në kooperativën bujqësore të Semanit të jenë krijuar kushtet për shtimin më tej të tufave të lopëve, atëherë për këtë kooperativë të përcaktohet në vendimin e plenumit se ç'masa duhen marrë konkretisht atje, natyrisht duke mos insistuar në të njëjtat masa si në Mallakastër, po të vihet detyra që në Seman të ecet më përpara, duke vënë edhe cage gjer ku do të arrihet. Ky do të jetë një vendim i efektshëm që do të marrë plenumi i komitetit të Partisë të rrethit në bazë të vendimit të Komitetit Qendror.

Kurse byroja e komitetit të Partisë të rrethit, pas marrjes së vendimit nga plenumi, të organizojë punën në mënyrë të atillë që ai të zbatohet me sukses. Po plenumi i komitetit të Partisë të rrethit nuk mund të përcaktojë kokë më kokë çdo gjë, ai jep disa vija kryesore, zbatimin e të cilave, mbasi të konkretizohen në mbledhjet e çdo organizate-bazë, byroja do ta ndjekë zonë më zonë.

Po si do të bëhet kjo punë? Ka shumë forma. Mënjëherë pas aktivitetit të Partisë, ku do të vihen detyra për zhvillimin e lopës, pjesëmarrësit e aktivitetit, me të vajtur në bazë, mbledhin përkatësisht komunistët dhe kooperativistët dhe i informojnë për punimin e vendimit të Komitetit Qendror dhe për detyrat që nxori aktiviteti lidhur me të. Pastaj, mbasi të merret vendimi nga ana e plenumit të komitetit të Partisë të rrethit, bëhen mbledhje në çdo organizatë-bazë, ku përcaktohet konkretisht çfarë do të bëhet. Mund të gjenden edhe forma të tjera, mund të ftohen, për shembull, në mbledhje të hapët të organizatës-bazë punonjësit më të dalluar, që përbëjnë aktivitetin e blegtorisë të kooperativës, ku shtrohen vendimet e plenumit të komitetit të Partisë dhe ku njerëzit diskutojnë e japin mendimet e tyre. Pastaj komunistët në organizatën-bazë diskutojnë dhe vendosin ç'duhet bërë konkretisht në kooperativë nga ana e tyre, në mënyrë që organizata-bazë dhe komunistët të jenë në ballë për zbatimin e vendimeve të plenumit, duke organizuar, fjala vjen, skuadra për sigurimin e silazhit, disa që të merren me strehimin, të tjera me mbarështimin etj., etj.

Në zbatimin e të gjitha këtyre detyrave duhet të shquhen në radhë të parë anëtarët e plenumit, të cilët, duke u shkundur nga burokratizmi, konformizmi etj. dhe duke u frymëzuar nga shembulli i masave të gjera punonjëse, që po bëjnë heroizma në punë, të tregojnë edhe vetë guxim e iniciativë, ndryshe nuk ka kuptim që janë në udhëheqje. Gjatë luftës për zbatimin e vendimeve të Partisë, do të dallohen nje-

rëzit më të mirë dhe do të gjykohet kush mund të jetë ose jo në plenumin e ardhshëm që do të zgjidhet pas dy vjetësh. Në këtë proces të jemi të matur dhe të mos largojmë të gjithë shokët e vjetër që janë të zotë, ose kuadrot me kapacitet, të cilët, kur janë njerëz të mirë, të mbahen në udhëheqje dhe të heqim ata që nuk kanë kapacitet, që tregohen të plogësht etj. Atyre që do të hiqen u duhen vënë me kohë në dukje të metat e gabimet, me qëllim që, kur të vijë koha dhe nuk do t'i zgjedhim më, të mos jenë të pakënaqur. Në këtë drejtim duhet bërë shumë kujdes, pse pakënaqësia e këtij ose atij njeriu të brezit që ka luftuar, por që tani është mbi 45 vjeç, është një gjë jo e mirë për Partinë. Po edhe nga ana e këtyre kuadrove nuk është e drejtë të mendohet sikur e kanë marrë me tapi vendin që zënë, vetëm për faktin se kanë luftuar. Ata që s'punojnë duhet të zëvendësohen. Partia ka tani plot njerëz të rinj të aftë, të gjallë dhe të sakrificës që bëjnë çdo gjë për interesin e popullit dhe të atdheut. Ja, për shembull, Mehmet Mustafa Elezi la gruan dhe fëmijët në Berat dhe shkoi për të zëvendësuar vëllanë që ra në kufi. Ai është një shembull i lartë frymëzimi për të gjithë. Në qoftë se ne i edukojmë njerëzit me një frymë të tillë, atyre që nuk do ta bëjnë dot punën dhe do të hiqen, duke u zëvendësuar me njerëz më të zotë dhe që janë gati të sakrifikojnë gjithçka, nuk ka pse t'u mbetet qejfi kur t'i heqin.

Por ka akoma disa shokë të vjetër që nuk mendojnë drejt. Kohët e fundit, një nga këta shokë më bëri një letër me të cilën shpreh habinë, si është e mundur

që ai të lihet mësues në një fshat, kur tani janë duke u ngritur plot njerëz të rinj në vende me përgjegjësi! Ky komunist i vjetër ma drejton letrën pikërisht në një kohë kur në vendin tonë është ngritur më këmbë i madh e i vogël. Me këtë letër ai bën një gafë të madhe, kërkon post për vete. Si ky ka edhe të tjerë, që fshihen, deri në aparatet e komiteteve të Partisë. Njerëz të tillë duhet t'i zbulojmë dhe t'i heqim nga ai vend pune që kanë zënë, po kurdoherë në rrugën marksiste-leniniste, revolucionare, që të mos kenë pse të mbeten të pakënaqur. Duhet të kemi, pra, mjaft kujdes në këtë drejtim.

Jam dakord me të gjitha mendimet që u shfaqën për problemin që shqyrtuam. Për sa i përket përbërjes së byrove të komiteteve të Partisë, të gjithëve na tërhoqi vëmendjen fakti që në to kemi vetëm pak punëtorë, kurse në plenumet gjendja është diçka më e mirë, megjithëse jo ajo që duam. Zhvillimi i gjendjes në Parti nuk na pengon të sjellim tani në byrotë dhe në plenumet e komiteteve të Partisë të rretheve shokë të rinj që dallohen, por duke marrë parasysh edhe faktin që këta të rinj nuk kanë përvojë, të punojmë që t'i ndihmojmë. Të rinjtë nuk mund të ngrihen pa i ndihmuar. Për një shok të ri që vjen në byro ose në plenum, pasi ta shohim për një kohë në punë dhe pasi t'i jetë dhënë një ndihmë serioze, mund të themi bën apo s'bën, dhe jo pas një viti të gjykojmë me lehtësi e të vendosim ta heqim, pa e ndihmuar fare. Të kemi gjithashtu kujdes të mos i heqim nga byrotë e plenumet të gjithë kuadrot që kanë një stazh të gjatë në udhëheqje. Shokët e

vjetër përbëjnë një fond të artë për Partinë, prandaj të kujdesemi vazhdimisht për ta, t'i duam e t'i respektojmë, ndërsa ata që kanë gabime e të meta të punojmë t'i ndreqim. Por, kur midis tyre ka nga ata që qëndrojnë më poshtë nga disa të tjerë të rinj dhe në vend të punës, kanë vetëm llafe dhe heqin këmbët zvarrë, edhe pse kanë një stazh të gjatë (10-15 vjet) në plenumë dhe në byro, ne mund të mos i zgjedhim më. Udhëheqja e Partisë në rreth të kujdeset në rrugë të drejtë për vazhdimësi në sigurimin e kuartrit, të ketë parasysh pjekurinë dhe përvojën e shokëve të vjetër, po kjo të mos kuptohet nga ana e këtyre sikur janë të pazëvendësueshëm. Kur e kërkon nevoja dhe interesi i forcimit të punës së Partisë, ata do të zëvendësohen me të rinj më të aftë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

KOMUNISTËT NË SHKOLLA DHE NË SEKTORËT E ARTIT, SI KUDO, TË JENË NË ROLIN PARAROJË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

4 dhjetor 1967

Para shkollës sonë shtrohen shumë probleme për t'u zgjidhur. Ca kohë më parë ne kemi diskutuar problemin e kalueshmërisë së nxënësve në mësim, për të ulur në maksimum, sa të jetë e mundur, numrin e atyre që mbeten në klasë. Me këtë lidhet ngushtë edhe problemi i notës. Ç'është bërë gjer tani në këtë drejtim?

Një tjetër problem i madh është çështja e teksteve shkollore. Ç'po bëjnë për këtë problem organizatat-bazë të Partisë të universitetit, të shkollave, pikërisht në kohën e një hovi të madh revolucionar të masave punonjëse, kur është ngritur në këmbë gjithë populli?

1 Në këtë mbledhje raportuan komitetet e Partisë të rrethëve të Tiranës e të Korçës, lidhur me forcimin e punës së Partisë në sektorët e arsimit e të kulturës.

Ka apo nuk ka lëvizje dhe punë konkrete për vënien në rrugë të këtyre problemeve? Sigurisht në shkollat tona bëhet dhe punë e mirë në këtë drejtim, e kjo duhet çuar më tej, por tani ka ardhur koha që të flasim më konkretisht, a është duke u vënë ujë në zjarr për këto dy probleme të rëndësishme, apo i mori era ato që kemi thënë, kur kemi analizuar këtu punën e shkollës? Janë çështje të thella këto, prandaj duhet menduar seriozisht për zgjidhjen e tyre, si nga sektori përkatës i aparatit të Komitetit Qendror të Partisë dhe nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, ashtu dhe nga vetë shkollat. E rëndësishme është që të dimë se ç'bëhet në bazë, për shembull, a janë mbledhur mësuesit dhe nxënësit për ta diskutuar problemin e kalueshmërisë në mësim? Çfarë mendojnë dhe çfarë konceptesh kanë arsimtarët për notën? Cili është mendimi i mësuesve dhe i pedagogëve tanë për këtë çështje?

I shtroj këto gjëra sepse edhe unë jam i një mendjeje me atë që thanë shokët se jashtë shkollës, pra në klasën punëtore, në fshatarësinë kooperativiste, vërehet një lëvizje e madhe, kurse brenda mureve të saj nuk po bëhet sa duhet. Kjo është serioze, prandaj gjendja në shkollë duhet të përmirësohet. Kjo nuk mund të bëhet pa udhëheqjen e pa nxitjen e Partisë, si në universitet, ashtu edhe në çdo shkollë tjetër.

Në tekstet dhe në programet mësimore të shkollës sonë ruhen akoma disa pikëpamje të vjetra. Natyrisht, ne nuk i hedhim poshtë të tëra ato që përmbajnë programet, por nevoja e përgatitjes si du-

het të kuadrove na detyron t'i shkurtojmë, t'i përmirësojmë më tej këto, sepse në praktikë ndodh që në shkolla, në vend që t'u mësohen nxënësve e studentëve ato pjesë të domosdoshme që, kur të dalin në jetë, t'u vlejné për ta marrë si duhet punën në dorë, dhe, me atë zjarr të madh revolucionar që ka rinia, ta çojné atë më përpara, vazhdohet me një ritëm të plakur t'u mësohen shumë gjëra, edhe nga ato që nuk do t'u duhen në jetë. Këtu nuk e kam fjalën vetëm në histori, në gjeografi etj., por edhe në shkencat e tjera. Lëre pastaj ç'bëhet në letërsi për edukimin patriotik e revolucionar të nxënësve e të studentëve!

Unë nuk them të mos flitet për De Radën, po jo ama të mbetemi duke e studiuar atë gjerë e gjatë. Të gjithë kemi një admirim të madh për Naim Frashërin, kemi vlerësuar sa dhe si duhet veprën e Mjedës, po nuk është e drejtë që në tekstet shkollore të zënë vendin më të madh klasikët tanë e një vend fare të vogël ta zënë disa pak autorë të afirmuar të sotëm. Pra, nuk është e drejtë që gjithë ky frymëzim i madh që po shpërthen edhe në fushën e letërsisë nga talente të reja me gjithë ato krijime letrare, tregime, romane, vjersha e poema, me përmbajtje të shëndoshë, të bukur, prekëse, frymëzuese të mbeten qosheve, t'i marrë era bashkë me gazetatat e përditshme dhe të mos njihen e të mos mësohen nga fëmijët e nga rinia shkollore. Kur një vjershë, poemë, dramë a tregim i bukur i kushtohet zjarr për zjarr heroizmit të Shkurte Pal Vatës, cucës së malësisë, aksioneve revolucionare ose qoftë dhe gurskalitësve

të vegjël, ato të futen në program nga vetë shkolla dhe nga mësuesit pa pritur muaj e vite, pa pritur rekomandime nga lart. Apo duhet të presim gjersa t'u vijë koha të rishikohen programet nga Ministria e Arsimit, ose gjersa këtij ose atij autori t'i jepet «konfirmimi zyrtar» si autor i afirmuar për t'u futur në historinë e letërsisë? Rëndësi ka vepra letraro-artistike, fryma e saj revolucionare dhe e kohës e jo të kapemi vetëm nga autori, nga mosha ose stazhi i tij si letrar dhe artist. Rëndësi ka që krijimtaria letrare artistike të shkojë në masa, të edukojë dhe të frymëzojë masat dhe një nga rrugët e mjetet më efektive për këtë është shkolla.

Çdo gjë pra në tekstet e programet shkollore duhet vënë në vend aq sa duhet, kur duhet dhe si duhet. Dhe të mos ndodhë ashtu siç bëhet në ndonjë emision të Radio Tiranës. Sot në mëngjes dëgjova enciklopedinë kalendarike ditore në radio. Pas fjalëve për luftën e Drashovicës që udhëhoqi shoku Hysni Kapo, spikeri filloi të flasë për Nekrasovin, për rreth dy minuta të tëra, duke treguar edhe hollësira më të vogla, se ai na qenkësh i biri i një pasaniku etj., etj., sikur popullin tonë e intereson të dijë se biri i kujt ishte Nekrasovi!

Pra, po e theksoj edhe një herë: çështja e teksteve dhe e programeve përbën një problem të madh, prandaj të merret mirë në dorë nga Partia.

Drejtuesit dhe punonjësit e sektorëve të arsimit e të kulturës, ashtu si në çdo sektor duhet të kenë mirë parasysh që kur jep një direktivë Kongresi i Partisë, Komiteti Qendror ose Byroja Politike, ajo

duhet të zërthehet e të kuptohet mirë dhe punën për zbatimin në jetë të saj ta udhëheqin organizatat-bazë të Partisë, duke vënë në lëvizje e në rolin pararojë çdo komunist.

Anëtarët e Partisë duhet të jenë të ndershëm, njerëz me moral të lartë etj. Por midis punonjësve tanë të artit, që janë të gatshëm për çdo gjë, midis artistëve tanë, për të cilët kemi dëgjuar fjalë shumë të mira, që venë edhe në fshatra, punojnë, lodhen, bashkohen e bisedojnë me popullin etj., ka dhe nga ata që, kur kthehen në qendrat e tyre të punës, e kalojnë kohën duke marrë njerëzit nëpër gojë, e sidomos kolegët e tyre. Mos vallë këta janë njerëz me dy faqe? Fakti që ata punojnë, janë të gatshëm të venë të japin shfaqje për popullin në çdo krahinë, do të thotë se kanë edhe cilësi të mira, e duan popullin dhe këndojnë e kërcëjnë bashkë me të. Prandaj mendoj se edhe ata që manifestojnë shfaqje të huaja mund të orientohen fare mirë në rrugë të drejtë. Sigurisht, kjo kërkon një punë të dendur edukuese nga ana e organizatave-bazë të Partisë. Një rol të madh në këtë drejtim duhet të luajnë në radhë të parë komunistët, të cilët të jenë kurdoherë në pararojë. Nëse ka midis tyre nga ata që nuk janë në pararojë, që manifestojnë shfaqje të huaja, atëherë këta që bëhen pengesë, të hiqen nga trupat artistike dhe në vend të tyre të vijnë të tjerë që e meritojnë dhe që do t'i japin hov organizatës-bazë dhe kolektivit.

Kjo është e lidhur edhe me vetë gjendjen e organizatave-bazë në këta sektorë. Me sa shohim, me vështirësi po ecet në shtimin e radhëve të tyre me

gjak të ri. Në statistikat që kemi, shoh se në Tiranë ka boshllëqe në shtrirjen e Partisë në sektorët e arsimit e të kulturës, ndërsa në sektorët e administratës është mbledhur një mori komunistësh. Na thuhet se këta bëjnë pjesë në repartet ndihmëse. Por, po t'i krahasojmë shifrat, del se në repartet ndihmëse ka më shumë komunistë sesa në radhët e arsimtarëve e në sektorët artistikë. Pra del nevoja e forcimit të organizatave të Partisë në këta sektorë. Në lidhje me pranimin e pak më shumë mësuesve në Parti, sidomos në fshatra, duhet pasur kujdes qysh më parë që elementët që do të pranohen të përgatiten me kujdes. Me këtë nuk dua të them të mos futim njerëz të rinj në Parti, po jo edhe të futen thjesht për të shtuar numrin. Ata që do të pranojmë në Parti të jenë të tillë që të ndihmojnë me të vërtetë për të revolucionarizuar jo vetëm organizatat-bazë, por shumë gjëra, sidomos brenda shkollës, ku ka akoma shumë e shumë për të bërë.

Si konkluzion, pra, desha të them se duhet të udhëhiqemi nga parimi që me njerëzit të punojmë vazhdimisht, t'i ndreqim dhe t'i edukojmë ata. Ca më shumë të punojmë me artistët, me punonjësit e arsimit dhe të kulturës dhe në qoftë se midis tyre ka njerëz që duhen spastruar, le të spastrohen. Në qoftë se në Parti duhet të pranojmë nga radhët e tyre, të pranojmë ata që e meritojnë, domethënë kurdoherë në baza të shëndosha. Dua të them, të mos nisemi vetëm nga pikëpamja se mbasi kemi pak arsimtarë komunistë, atëherë të pranojmë cilindo qoftë. Ne të pranojmë kur lind nevoja dhe kur elementi që

diskutohet i plotëson kushtet. Kjo punë, pra, të mos bëhet në formë fushate.

Për sa i përket problemit që ngrihet për të bërë lëvizjen e disa artistëve të shkuar nga mosha etj., edhe kujdes të keni në këtë çështje, por edhe duhet vepruar, se në kor, në balet etj. nuk ecet me njerëz të moshuar. Nëse ndonjëri mund të mbahet, domethënë kur mund të bëjë një punë, le të mbetet, po ata për të cilët s'kemi nevojë, duhen hequr.

Që të bëhet kjo, duhet punuar më parë politikisht me ata që do të hiqen, që të largohen të bindur se interesi i punës e do që të largohen dhe vendin e tyre ta zënë elementë të rinj që mund të japin më shumë. Të vjetrit të transferohen, por edhe të ndihmohen që të mësojnë zanate të tjera, gjersa të vijë koha për të dalë në pension.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP

TE BËJMË ÇDO SAKRIFICË EKONOMIKE PËR RRITJEN E MIRËQENIES SË POPULLIT

Fjala në Plenumin e 4-t të KQ të PPSH¹

12 dhjetor 1967

Shokë,

Si konkluzion, dëshiroj të prek shkurtimisht vetëm disa gjëra dhe në radhë të parë problemin e elektrifikimit, pse raporti dhe diskutimet e shokëve i rrahën mirë të gjitha çështjet që u shtruan.

Vendimi që po marrim për elektrifikimin e krejt fshatrave të vendit tonë, ashtu siç e çmoi edhe Plenumi i Komitetit Qendror, ka një rëndësi të madhe historike dhe do të ngrejë peshë gjithë popullin tonë. Por kryerja me sukses e këtij aksioni të madh varet, së pari, nga ngritja në një shkallë shumë të lartë e punës politike të Partisë, që do t'i mobilizojë masat

1 Plenumi i 4-t i KQ të PPSH, që u zhvillua më 11 dhe 12 dhjetor 1967, diskutoi rreth raportit «Mbi plotësimin e planit e të buxhetit të shtetit për vitin 1967 dhe detyrat për vitin 1968, si dhe mbi elektrifikimin e krejt fshatrave të vendit deri më 8 nëntor 1971, me rastin e 30-vjetorit të themelimit të Partisë».

për të realizuar të gjitha detyrat dhe veçanërisht detyrën e madhe të elektrifikimit; së dyti, nga organizimi i mirë i kësaj pune; së treti, nga studimi i thellë dhe korigjimet e nevojshme që do t'i bëjnë pas këtij studimi organet e qendrës planit ekzistues të elektrifikimit.

Çështjen e elektrifikimit të plotë të vendit duhet ta kuptojmë drejt, gjerë dhe me perspektivë. Dhënia e dritës elektrike fshatit është pjesë përbërëse e planit madhështor të Partisë për elektrifikimin e të gjithë Shqipërisë, që do të realizohet kur energjia elektrike të hyjë në shkallë të gjerë në të gjitha sferat e zhvillimit tonë ekonomik e kulturor. Lenini thotë se

«Komunizmi është pushteti sovjetik plus elektrifikimi i të gjithë vendit...»¹.

Por tani, me çuarjen kudo të dritës elektrike, nuk mund të themi se po shkojmë në komunizëm, pse jemi akoma larg këtij objekti të madh. Vendimi që po marrim sot është vërtet i guximshëm, që ndoshta s'e ka marrë asnjë vend tjetër, por duhet ta kemi të qartë se për sa i përket elektrifikimit në përgjithësi, pra përdorimit në shkallë të gjerë të energjisë elektrike në industri, në bujqësi etj., jemi prapa të tjerëve. Prandaj, për të arritur atje ku na mëson Lenini, do të na duhet të bëjmë një rrugë shumë të gjatë.

Ne duhet të sigurojmë energjinë e domosdoshme, jo vetëm për të vënë në lëvizje industrinë ekzistuese,

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 480.

por edhe për të përballuar në të ardhmen nevojat gjithnjë në rritje të një industrie më të madhe e më të zhvilluar. Përveç kësaj, mekanizimi i të gjitha proceseve të punës në bujqësi lidhet ngushtë me elektrifikimin e plotë të saj. Dhënia e dritës elektrike të gjithë fshatrave është një aksion politik me rëndësi të pallogaritshme për vendin tonë dhe një hap i rëndësishëm për përdorimin e energjisë elektrike në bujqësi, por për të realizuar tërësisht elektrifikimin e bujqësisë kërkohet një potencial energjetik, të cilin tani për tani ne nuk e kemi.

Fusha e përdorimit të energjisë elektrike në bujqësi është e gjerë. Kjo duket edhe po të shikojmë vetëm mekanizimin e procesit të ujitjes. Ne kemi ndërtuar dhe vazhdojmë të ndërtojmë mjaft kanale ujitëse, njëkohësisht prodhojmë në vend edhe pompa me kapacitet të madh për ngritjen e ujit lart, si dhe pompa për ujitje, të cilat i vëmë në lëvizje me traktorë ose me energji elektrike. Por baza e nevojshme energjetike për përdorimin në shkallë të gjerë të këtyre pompave, sot për sot, është akoma e pamjaftueshme. Prandaj, për ta siguruar këtë bazë, duhen bërë investime, të cilat mund të jenë më të vogla nga investimet e vazhdueshme që kemi bërë dhe po bëjmë për ndërtimin e kanaleve të mëdha ujitëse etj., etj.

Për të zbatuar vendimin për elektrifikimin e krejt fshatrave të vendit deri më 8 nëntor 1971¹, po-

1 Ky vendim, në sajë të punës vetëmohuese të të gjithë popullit nën udhëheqjen e Partisë, u realizua para afatit, më 25 tetor 1970.

pulli dhe Partia do të duhet të bëjnë sakrifica. Për të çuar kudo dritën elektrike do të investohen 335 milionë lekë dhe do të shpenzohen 60 milionë lekë valutë për sigurimin e materialeve të importit, kurse nga rrjeti i madh i sistemit energjetik të Republikës do të duhet t'u jepen fshatrave miliona kilovat-orë. Kjo, natyrisht, do të krijojë vështirësi për ekonominë tonë, sepse, kur të mos bjerë shi, siç ndodhi këtë vit, dhe energjinë nga hidrocentralet do ta kemi më të paktë, mund të detyrohemi t'u presim energjinë elektrike, jo vetëm fshatrave që do të jenë lidhur me rrjetin e madh, të cilat në një rast të tillë do të mbesen përkohësisht në errësirë, por edhe shumë fabrikave, uzinave etj.

Partia dhe pushteti, duke marrë parasysh çfarë duhet të realizojnë për këtë popull heroik e të mrekullueshëm, që hidhet në zjarr kudo ku i thotë Partia, do të bëjnë çdo sakrificë ekonomike për zbatimin në kohë të këtij vendimi, sepse populli ynë e meriton një gjë të tillë. Vetëm hapi perspektivën popullit tonë, organizoje dhe ai bëhet pastaj si dragua! Këtë, ne udhëheqja, duhet ta kemi parasysh jo vetëm për tani ose për detyrat e këtij pesëvjeçari, gjatë të cilit po marrim këto vendime suplementare revolucionare jashtë planit, por edhe për të ardhmen.

Duke u bazuar në vrullin revolucionar të klasës punëtore dhe të të gjithë punonjësve tanë të fshatit dhe të qytetit, ne jemi të bindur për realizimin dhe tejkalimin e detyrave të planit të katërt pesëvjeçar. Zotimi që kanë marrë punonjësit e Vaut të Dejës për ta përfunduar hidrocentralin një vit para afatit, na

mbush me krenari e me optimizëm. Ndërtimi i këtij hidrocentrali para afatit i detyrohet heroizmit të klasës sonë punëtore, ndërtuesve tanë të këtij objekti dhe organizatës së Partisë që punon e udhëheq atje gjithë kolektivin punonjës. Kjo do të jetë një fitore e madhe që do të na japë mundësi të përqendrojmë edhe forcat për të filluar një vit përpara ndërtimin e Hidrocentralit të Fierzës, që është akoma më i madh nga ai që po ndërtojmë tani.

Por ç'do të bëhet gjithë kjo energji elektrike që do të prodhohet nga këto vepra të mëdha? Ajo do të përdoret në industrinë tonë, që do të fuqizohet më shumë. Gjer në fund të pesëvjeçarit do të krijohen me siguri linja, reparte e fabrika të reja mbi planin (të gjithë e dimë ç'iniciativa të panumërta po merren tani nga masat punonjëse në këtë drejtim), që do të kenë nevojë për energji elektrike. Ne duhet të mendojmë gjithashtu edhe për nevojat që do të kemi në perspektivë për energji elektrike. Me zhvillimin e vrullshëm që ka marrë vendi ynë, në të ardhmen do të na duhet ta dy dhe trefishojmë kapacitetin e fabrikave ekzistuese të çimentos; ta dyfishojmë kapacitetin e Uzinës së Plehrave Azotike, kurse prodhimi i Uzinës së Superfosfatit në Laç të rritet më shumë se tri herë; ta dhjetëfishojmë prodhimin e ferrokromit; prodhimi i hekur-nikelit të rritet nga 3-4 deri në 7 herë. Më vonë do të na duhet të ngremë fabrika për të përpunuar edhe fosforitin që kemi zbuluar e po zbulojmë, jo vetëm për të plotësuar nevojat e Uzinës së Superfosfatit në Laç, por edhe për eksport. Do të shtohet prodhimi dhe përpunimi në vend i naftës

e i gazit, i lëndëve plastike etj. Tani që po ndërmar-
 rrim aksionin e madh për elektrifikimin e të gjitha
 fshatrave, nuk do t'i përballojmë dot nevojat e ven-
 dit për llamba me fabrikën që jemi duke ndërtuar
 në Vlorë, prandaj kapacitetin e kësaj vepre duhet ta
 dy dhe bile ta trefishojmë etj.

Shikoni, shokë, ç'perspektiva të mëdha e të ndritu-
 ra kemi përpara! Por të gjitha këto vepra të mëdha
 e të vogla që do të ndërtojmë, kërkojnë energji elek-
 trike. Prandaj, që të mundim t'u bëjmë ballë të gji-
 tha nevojave për energji, organeve të pushtetit, ndër-
 marrjeve ekonomike dhe gjithë popullit u del detyrë
 të vendosin një regjim të fortë kursimi dhe të kuj-
 desen për ta ekonomizuar sa më shumë energjinë elek-
 trike. Edhe organet qendrore duhet të rishikojnë pla-
 nin ekzistues lidhur me të gjitha ato që thashë. Kë-
 shtu, për shembull, në rast se diku ka perspektivë
 nxjerrja e boksideve ose e polimetaleve, të merren
 masa për ngritjen atje të linjës së tensionit të lartë.
 Në qoftë se në Dukagjin ka mundësi që uji të ngrihet
 nga lumi me pompa elektrike, të mendojmë të bëjmë
 atje për këtë qëllim një derivat. Duke marrë parasysh
 perspektivat e mëdha që kemi për rritjen e fuqizi-
 min e industrisë sonë, të mendojmë qysh tani për
 një shfrytëzim më racional të burimeve tona ujore.
 Kështu, për shembull, kur shohim se diku ka ujë të
 bollshëm, në vend që të ngremë një hidrocentral të
 vogël, të përpiqemi të ngremë një më të madh, të cilin
 ta lidhim më vonë me rrjetin e tensionit të lartë të
 sistemit energjetik. Pra, çështjen e elektrifikimit ta
 studiojmë duke pasur parasysh gjithë këtë perspek-

tivë dhe jo duke u bazuar në gjendjen e tanishme, kur mbi 70 për qind të fshatrave i kemi akoma të palektrifikuara.

Natyrisht, të gjitha ndërtimet që do të bëjmë janë aksione të guximshme. Vihet pyetja: Vallë janë të gjitha këto të bazuara? Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje nuk duhet të llogaritim thjesht mundësitë materiale e monetare, por edhe një faktor tjetër shumë të rëndësishëm: hovin e madh revolucionar që ka krijuar Partia në masa. Po të marrim parasysh këtë, mendoj se të gjitha këto ndërtime janë plotësisht të realizueshme.

Hovi i madh që ka krijuar Partia në popull është diçka e mahnitshme, prekëse, që jo vetëm duhet të mbahet gjallë, por edhe të rritet e të forcohet, duke kalitur vazhdimisht masat ideologjike. Gjithë kjo energji, ky entuziazëm, ky heroizëm i madh i masave, duhet të organizohen. Në rast se do të kënaqemi vetëm me sukseset e gjertanishme dhe nuk do të mendojmë si ta shfrytëzojmë e ta kanalizojmë këtë hov të madh që ka shpërthyer, për ta kthyer në të mira materiale për popullin, mund të themi ç'të duam, por toni i këtij hovi të paparë do të bjerë, gjë të cilën në asnjë mënyrë nuk duhet ta lejojmë. Bile do të ishte krim po të mos e mbajmë kurdoherë lart këtë hov revolucionar dhe ta ngjitim, ta ngjitim e ta ngjitim gjithnjë e më lart për të arritur që ndërgjegjja e popullit tonë të shkëlqejë e pastër si drita e diellit.

Shikoni, shokë, ç'po bëhet te ne, me ç'sukses po realizohen planet! Mijëra letra i vijnë Komitetit Qendror nga kolektiva dhe individë që kërkojnë të

punojnë vullnetarisht në hekurudhë. Po në hekurudhë nuk ka front pune për të gjithë, kurse të rinjtë e shkollave duan të punojnë të tërë.

Iniciativat e shumta që kanë shpërthyer në popullin dhe në rininë tonë duhet të frymëzojnë edhe Ministrinë e Arsimit në punën për revolucionarizimin e programeve të teksteve, të dhënies së mësimit, për orientimin e mësuesve, të cilët më shpejt duhet t'u përshtaten kërkesave të kohës, nevojave, hovit revolucionar dhe dëshirave të studentëve e të nxënësve dhe jo të ecin me hapat e breshkës në këto drejtime. S'ka asnjë rëndësi për ndërtimin e socializmit në rast se studentëve u kërkohet, për shembull, të dinë që Luigji XIV e mori faktikisht pushtetin pikërisht në vitin 1661. Nxënësit e studentët tanë kanë nevojë të mësojnë për elektricitetin, bile të mësojnë të bëjnë edhe mure, ledhe, kanale, që të mund të ndihmojnë vëllezërit e tyre në fshat etj. Me këtë nuk dua të them që ata të mos marrin kulturë të përgjithshme, por nuk i duhet qëndruar besnik rutinës së vjetër, se në kulturën e përgjithshme që merret sot në shkollë, ka akoma shumë gjëra të panevojshme që duhen pastruar.

Kjo kërkon që vetë Ministria e Arsimit dhe e Kulturës të merret seriozisht me revolucionarizimin e programeve e të teksteve shkollore. Me këtë punë të rëndësishme nuk lejohet të ecet ngadalë, por as edhe të ecet keq për hir të shpejtësisë. Ne shohim se me gjithë vrullin e madh që ka shpërthyer në vendin tonë, populli dhe Partia nuk punojnë keq, përkundrazi ato po bëjnë shumë gjëra të mrekullueshme.

Prandaj duhet të revolucionarizohet më shumë puna në të gjithë sektorët, të revolucionarizohen vetë kuadrot drejtues, pse, në rast se do të vazhdojnë të punojnë me metoda të vjetra, me frymën e ngushtë të zyrës apo të sektorit, me kuptime jo të drejta e me ngurrime për t'u dhënë përgjegjësi brezave të rinj që po rriten, nuk do të ecim përpara si duhet.

Nga mobilizimi dhe vrulli i masave na është forcuar më tepër besimi për të ndërtuar e prodhuar më shumë. Kur shikojmë atë që kemi bërë dy vjet më parë, sot themi: ku kemi qenë, sepse mendojmë ndryshe, më mirë. Tani udhëheqja e Partisë dhe e pushtetit duhet t'i shohin më gjerë këto çështje. Kjo nuk do të thotë të tregohemi dorëlëshuar dhe për çdo problem të bëjmë shpenzime, pa llogaritur më parë fitimet që do të kemi, por t'i organizojmë më mirë forcat tona dhe t'i shfrytëzojmë si duhet mjetet, se kështu jo vetëm do t'i realizojmë, por edhe do t'i tejkalojmë të gjitha planet, do të bëjmë mrekulli.

Detyrat që shtruan në këtë plenum për planin e vitit 1968 duhet të merren me seriozitetin më të madh. Gjersa vendosëm që në 1/3 e sipërfaqes së grurit dhe 1/4 e asaj të misrit e të patates të merren rendimente të larta, të bëjmë të gjitha përpjekjet që këto rendimente jo vetëm t'i realizojmë, por medoemos t'i tejkalojmë për të rritur gjithnjë edhe rezervat tona.

Ndërtimi i socializmit kërkon sakrifica dhe këto po i bën populli ynë. Të tre brezat tanë kanë bërë dhe vazhdojnë të bëjnë sakrifica në emër të një qëllimi shumë të lartë, rritjes së mirëqenies së popullit.

Kujdesi i Partisë për popullin duhet të jetë kur-

doherë i vazhdueshëm. Duke rendur pas realizimit të planeve (për të cilët medoemos do të tregojmë vëmendje, se, pa kryer detyrat e caktuara, nuk mund të ketë mirëqenie të popullit), disa herë shokët e nënvleftësojnë kujdesin e madh që duhet të tregojnë për njerëzit. Në përgjithësi, në drejtim të zhvillimit arsimor e kulturor, edukimit politik e ideologjik të njerëzve, sado që me të meta, vëmendja e shokëve është më e madhe nga ç'ishte më parë. Edhe furnizimi i popullit tani bëhet gjithnjë e më mirë, por këto rezultate nuk janë gjithçka.

Vija e Partisë sonë ka qenë që, krahas zhvillimit të ekonomisë, të përmirësohen edhe kushtet e jetesës (dhe në fakt këto kushte janë përmirësuar, por s'duhet të na mbulojë vetëkënaqësia për ato që kemi arritur), jo vetëm të qytetarëve, por edhe të fshatarëve. Mjekun dhe fluorografin, për shembull, ne mund t'i dërgojmë edhe në malësi, por, për të evituar sëmundjet, kanë rëndësi masat preventive, sigurimi i kushteve të mira të jetesës, siç janë ushqimi, veshja, higjiena, pastërtia, banesa e deri tek ajri dhe dielli. Mirëpo këtyre çështjeve shpesh nuk u kushtohet kujdesi i duhur. Kur themi që prodhimet të realizohen sipas sasisë, cilësisë, asortimentit dhe me kosto gjithnjë më të ulët, këto detyra duhet të realizohen medoemos dhe mallrat e prodhuara të dërgohen kudo për ku janë destinuar, sidomos në fshat.

Partia ka orientuar të mos përdoren veshjet që janë të rënda dhe shumë të kushtueshme, por të zëvendësohen ato me të tjera sipas kushteve ekonomike e klimaterike. Por shokët e Shkodrës, për shembull,

nuk mund të këshillojnë malësorët e Kelmendit që të heqin rrobat e leshta me karakter nacional dhe të vishen me basma të holla, sepse kjo do të dëmtonte shëndetin e njerëzve. Ne luftojmë t'i zhdukim veshjet e papërshtatshme, por krahas kësaj pune të kujdesemi për zëvendësimin e tyre me rroba të përshtatshme. Kështu, në malësi ku bën ftohtë duhet të shiten shajak, xhupa etj. ndryshe po i veshëm malësorët në dimër me rroba të lehta, me siguri do të na sëmuren.

Pas shpalljes së vendimit të Qeverisë për elektrifikimin e fshatrave të malësisë së Kelmendit dhe të Dukagjinit, lexova në gazetën «Zëri i popullit» një artikull, në të cilin autori shkruante se në një fshat të Kelmendit dielli duket vetëm 3 orë në ditë. Përnjëherë m'u kujtua se diku kisha lexuar për një ngjarje të tillë. Në një fshat të Alpeve brez pas brezi kalamanët lindnin të gjymtuar, bile shumica e tyre vdisnin pa u rritur akoma mirë. Për një kohë të gjatë nuk u gjet dot shkaku i kësaj fatkeqësie. Një mjek iu qep këtij problemi dhe më së fundi zbuloi se të gjitha këto pasoja të hidhura fshatit i vinin nga mungesa e diellit në këtë vend, prandaj i këshilloi fshatarët ta braktisnin atë sa më parë. Ata kundërshtuan në fillim, po më në fund u larguan dhe kështu shpëtuan njëherë e përgjithmonë nga sëmundjet. E kam fjalën që në qoftë se ajo që shkruhej në gazetën «Zëri i popullit» është vetëm një figurë poetike, mirë, ndryshe, në rast se është e vërtetë që në Kelmend ekziston një fshat i tillë, që e shikon diellin vetëm 3 orë në ditë, duhet me doemos të kujdesemi dhe të marrim masat e duhura për t'i siguruar këtij fshati një vend të shëndetshëm.

Ne e kemi shtruar edhe herë të tjera çështjen e pastërtisë, po realitetin duhet ta shohim drejt në sy. Është fakt i hidhur që në disa fshatra të malësive tona të Veriut nuk e përdorin akoma sa duhet sapunin. Atje ka njerëz që nuk e lajnë trupin. Shoqja Haxhire Brahja¹ na ka treguar se disa të reja vullnetare, të ndikuara nga zakonet prapanike me të cilat ishin rritur gjatë gjithë jetës, kur shkuan në fillim në hekurudhë, kundërshtonin të laheshin, duke thënë se i paskësh larë zoti me «ujë të bekuar». Pas punës edukative ato më së fundi u bindën dhe filluan të lahen. Pastaj, këto vajza, nga pastërtia dhe nga puna ndienin një kënaqësi të tillë shpirtërore dhe trupore, që s'e kishin njohur gjer atëherë dhe brenda një kohe të shkurtër u çelën e u bënë si lule.

Pastërtia nuk është luks, ajo është një nevojë që ka të bëjë me shëndetin e njerëzve që luftojnë, punojnë e krijojnë, që janë të lidhur ngushtë me Partinë dhe e duan atë. Ne drejt veprimë kur bëjmë përpjekje të realizojmë çdo gjë, po mendoj se në radhë të parë duhen bërë përpjekje për të trefishuar prodhimin e sapunit.

Vizitova një ditë kooperativën bujqësore të Shijakut, ku, midis të tjerash, pashë edhe furrën (tani po thuhetse kudo në kooperativat tona bujqësore ka furra). Atje kanë tri furra të mëdha, të sistemuara bukur. Po vallë nuk ka mundësi të ngrihet pas furrës një banjë e madhe, e ndarë më dysh, njëra për t'u larë burrat e tjetra për gratë? Për këtë s'mendon njeri. Ba-

1 Në atë kohë sekretare e KQ të BRPSH-së.

njo e lavanderi ndërtohen vetëm në qytete, kurse për këto ka nevojë edhe fshati. Në qoftë se thuhet që fshatari ose gruaja e tij nuk vete në asnjë mënyrë të lahet në banjë, një shtruarje e tillë e problemit nuk qëndron. Unë mund t'ju kujtoj shokëve që kanë qenë edhe më parë në Tiranë, se si gratë fanatike tiranase të asaj kohe, me çarçaf në kokë e një bohçe nën sqetull dhe me kalamanët në duar venin laheshin në hamamin e vetëm që kishte qyteti. Atëherë si të mos venë të lahen sot në banjo shiakasit, më parë kalamanët e tyre, pastaj burrat e gratë? Po të punojë Partia në këtë drejtim, ashtu si për të gjitha çështjet e tjera, unë mendoj se ata patjetër që do të venë. Por kjo nuk bëhet në zonat fushore, kurse në malësitë e Veriut as u bie fare në mendje për të bërë gjëra të tilla.

Prandaj, shoqe dhe shokë, të gjitha këtyre çështjeve, që përbëjnë një kompleks të tërë, t'u vëmë shumë rëndësi. Në qoftë se dëshirojmë të realizojmë planin e prodhimeve industriale, të shtohen rendimentet e prodhimeve bujqësore e blegtorale, të na rriten rezervat në çdo drejtim, në qoftë se duam të ngrihen sa më parë hidrocentralet dhe të shkojë drita elektrike kudo në malësi, ne duhet të forcojmë medoemos e vazhdimisht punën politike dhe ideologjike me njerëzit tanë, por njëkohësisht të kujdesemi edhe për shëndetin dhe për përmirësimin e jetesës së tyre. Të gjitha këto çështje janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën dhe asnjë prej tyre nuk duhet nënvleftësuar. Kur arsyet për mosrealizimin e një detyre janë të bazuara dhe të njohura, ato i pranojmë dhe populli është gati të bëjë dhe bën sakrifica, por kur nuk ka arsye të tilla, s'du-

het lejuar asnjë justifikim. Duhet të marrim patjetër masa politike dhe organizative që këtë realitet ta çojmë gjithnjë e më shumë përpara.

Të gjithë ata që nuk bëjnë përpjekjet e duhura për realizimin e detyrave të mëdha që kemi përpara, të gjithë ata që bëhen pengesë për arritjen e këtyre objektivave, Partia t'i heqë pa druajtje dhe t'i zëvendësojë me njerëz të rinj, të shkathët, që shquhen në këto situata tepër revolucionare dhe janë në gjëndje ta organizojnë punën shumë më mirë nga disa që i ka mbuluar rutina dhe fryma e vjetër burokratike. Natyrisht të vjetrit ne nuk i hedhim poshtë, por edhe t'u falemi kur nuk e bëjnë detyrën, t'i mbajmë sa për formë, vetëm për hir të së kaluarës, nuk është e drejtë, nuk është marksiste.

Rëndësi të madhe për zbatimin në jetë të të gjitha detyrave që shtruan ka edhe propaganda. Thelimi i revolucionit në vendin tonë shkaktonte lindjen e shumë formave të reja të punës. Propaganda e Partisë duhet të jetë në gjendje t'i kapë format e reja, më të përparuara të punës, t'i zhvillojë dhe të ndihmojë që ato të zëvendësojnë sa më parë format e vjetra.

Në shtypin tonë botohen shumë letra nga populli. Në qoftë se mendohet që këto letra tani u bënë bajate do të thotë se nuk po e shfrytëzojmë si duhet propagandën. Po për ç'qëllim botohen tërë këto letra, që shumë herë kur i lexojmë na prekin aq tepër sa edhe lot na dalin nga sytë? Botohen pikërisht që populli t'i lexojë, të frymëzohet nga ato, t'i shtohen forcat për veprim dhe të forcojë gjithnjë e më shumë unitetin

e tij me Partinë. Prandaj nga këto letra shokët duhet të nxjerrin mësim, jo vetëm propagandistike, por edhe organizative. Më vonë (se mund të vijë një moment që këto letra të mos botohen në këtë shkallë si tani) duhen gjetur forma apo mënyra të tjera pune, duke shkruar, për shembull, artikuj ku të pasqyrohen përvoja dhe ndjenjat e popullit, të përgjithësohen këto dhe të nxirren disa konkluzione teoriko-politike, pa harruar problemet e tjera të mëdha konkrete, se e gjithë propaganda jonë është e lidhur me realizimin e planit të prodhimeve, të rendimenteve, të elektrifikimit, të transportit dhe me të gjitha çështjet e tjera. Në asnjë mënyrë s'duhet lejuar që vëmendja të përqendrohet vetëm në ndonjërin prej këtyre dhe të spostohen të tjerat.

Tani ne kemi një shtyp më revolucionar, më popullor dhe më të gjerë, sepse përveç gazetave që dalin në qendër, botojmë edhe 8-9 të tjera në rrethe. Gazetat lokale, sa të jetë e mundur, duhet t'i marrin orientimet nga qendra dhe të ngrihen në atë nivel që t'i frymëzojnë me të vërtetë punonjësit e rrethit të tyre, t'i edukojnë e t'i mobilizojnë ata për të realizuar detyrat, ndryshe nuk ka asnjë kuptim t'i nxjerrim. Por që t'i arrihet këtij qëllimi, me gazetën e rrethit nuk duhet të merren vetëm 2-3 njerëz që janë caktuar në redaksi. Për botimin e saj duhet të punojnë në radhë të parë, shokët kryesorë të Partisë dhe të pushtetit në rreth, ata që janë drejtues të punës politike dhe ekonomike. Të gjithë këta duhet të jenë shtylla e gazetës, t'i japin asaj tonin, që ajo të pasqyrojë konkretisht jo vetëm realizimet, por edhe gabim-

met, kritikën e autokritikës. Pastaj duhet menduar për të gjetur edhe format më të përshtatshme të paraqitjes së problemeve në gazetë, duke pasur parasysh edhe mentalitetin e njerëzve, që ndryshojnë sipas rrethit. Në disa rrethe, për shembull, njerëzit janë më të hedhur e më të çelur, në disa të tjera më seriozë. Tjetër është natyra e malësorit, tjetër ajo e myzeqarit, se edhe zhvillimi i krahinave të ndryshme nuk është i njëjlojtë. Prandaj që propaganda jonë të jetë me të vërtetë e efektshme, duhet të ketë parasysh të gjitha këto rrethana.

Këto kisha për të thënë. Ashtu sikurse të gjithë ju, shoqe dhe shokë, edhe unë kam bindjen se planin e vitit 1968 do ta realizojmë, megjithëse është mjaft i ngjeshur. Partia dhe populli janë në këmbë dhe kam besim se ky hov revolucionar që ka shpërthyer kudo, do të shkojë kurdoherë duke u ngjitur.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Plenu-
mit të 4-t të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

**NË PUNË E NË LUFTË NE DUHET TË MËSOHEMI
TA ORGANIZOJMË PUNËN GJITHNJË E MË MIRË
NË MËNYRË KRIJUESE**

*Fjala e mbajtur në Peshkopi, në mbledhjen e
përbashkët të kuadrove të Partisë, të pushtetit
dhe të organizatave shoqërore të rretheve
të Dibrës dhe të Librazhdit*

16 dhjetor 1967

Të dashura shoqe dhe shokë, vëllezër dhe motra të rretheve të Dibrës e të Librazhdit dhe të gjithë Shqipërisë,

Më lejoni që, në emër të Komitetit Qendror, të Këshillit të Ministrave, të shokëve që ndodhen sot këtu në Peshkopi dhe personalisht timin, pas vizitës së shkurtër që bëmë në krahinat e dëmtuara nga tërmeti. në të dy rrethet tuaja, t'ju sjell përshëndetjet më revolucionare të Partisë dhe të të gjithë popullit tonë. Më lejoni, gjithashtu, t'ju them se në gjithë vendin tonë, pas fatkeqësisë që ndodhi në këto dy rrethe, u ngritën në këmbë kudo, i madh e i vogël, për arsye se vija e Partisë sonë, lufta e saj heroike i ka lidhur njerëzit ngushtë me njëri-tjetrin, popullin tonë e ka

bërë të mendojë, të luftojë dhe të ndiejë si një trup i vetëm, të mendojë, të ndiejë dhe të luftojë si revolucionar i lavdishëm.

Prandaj ishte e natyrshme që dhimbja, kur ngjau kjo fatkeqësi në rrethet tuaja, të ishte e madhe në të gjithë vendin, por krahas dhimbjes e solidaritetit vëllazëror socialist dhe njëkohësisht me të u manifestua menjëherë edhe ndjenja e fortë e papërkuljes përpara çdo vështirësie e sakrifice dhe i gjithë populli, Partia dhe pushteti u ngritën në këmbë dhe morën vendime historike revolucionare të papara kurrë ndonjëherë në të kaluarën, me një efektivitet të tillë sa që kjo fatkeqësi kaq e madhe po bëhet e mundshme të kapërcehet dhe do të kapërcehet brenda një kohe shumë të shkurtër.

Të gjithë u hidhëruam, mbi të gjitha për atë që në rrethet tuaja pati 12 të vrarë dhe 171 të plagosur. Për ne, për gjithë popullin dhe Partinë tonë kjo ishte humbja më e madhe, pasi njeriu në socializëm është gjëja më e çmuar, por hidhërimit e dhimbjes së madhe që na pruri kjo fatkeqësi e rëndë e natyrës, ne duhej t'u vinim përballë trimërinë, guximin e papërkulshmërinë e shqiptarëve. Dhe kështu ngjau. Të gjithë na shqetësonte, gjithashtu, në radhë të parë çështja se po vinte dimri, prandaj medoemos duhej të merreshin masa që njerëzit e familjeve të dëmtuara të futeshin sa më parë dhe në një kohë rekord brenda nëpër shtëpi të ngrohta dhe për zhdukjen e shkatërrimeve. Ne nuk na shqetësonte aspak problemi i furnizimit të materialeve, bile për këtë as që menduam fare, sepse kjo ishte një çështje e padiskutueshme përpara heroizmit të po-

pullit të Dibrës, të Librazhdit dhe të gjithë Shqipërisë. Dhe ja, shoqe dhe shokë, ky qëllim i lartë i Partisë, kjo dëshirë e zjarrtë e popullit, për sigurimin e kushteve normale të strehimit të motrave e vëllezërve të dëmtuar, sot është gati duke u realizuar dhe së shpejti të gjithë pa përjashtim do të futen në shtëpitë e tyre të reja dhe më të mira.

Ne dëgjuam sot këtu raportet e shokëve kryetarë të komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve të Dibrës e të Librazhdit, në të cilat u vu në dukje se shkatërrimet nga tërmeti në këto dy rrethe nuk ishin të vogla, përkundrazi, shumë të mëdha. Por fryma e lartë patriotike, ideologjike dhe politike e masave tona punonjëse, forca e madhe organizative e Partisë dhe e shtetit tonë, organizimi në vend i forcave nga ana e komiteteve të Partisë dhe e komiteteve ekzekutive të të dy rretheve tuaja, bënë që punimet e meremetimit e të ndërtimit që nga themeli të të gjitha ndërtesave të dëmtuara ose krejt të rrëzuara, të ecin çdo ditë me një vrull të pandalshëm dhe, sikurse u raportua këtu, të përfundojnë përpara afateve të vendosura nga Këshilli i Ministrave.

I gjithë populli shqiptar, shoqe dhe shokë, do të gëzohet dhe do ta konsiderojë si një nga shtarët më të mëdha njoftimin tuaj përfundimtar mbi realizimin e plotë të punimeve. Prandaj të gjithë ju, së bashku me masat kooperativiste të rretheve të Dibrës e të Librazhdit dhe vullnetarët e ardhur nga të katër anët e Shqipërisë, që i jeni përveshur me kaq zell punës për të kapërcyer sa më parë pasojat e rënda të tërmetit, mendoni për tërë popullin tonë, i cili pret me

padurim të madh lajmin për realizimin përpara afatit të kësaj detyre të madhe, duke plotësuar kështu dëshirën e tij të zjarrtë. Punoni pa u lodhur, shoqe dhe shokë, ditë e natë, si një trup i vetëm, për të zhdukur përgjithmonë pasojat e rënda, të përkohshme të kësaj fatkeqësie, në mënyrë që, kudo ku pati dëme, jeta së shpejti të rifillojë normalisht, e gëzuar dhe plot punë të frytshme për realizimin e planeve.

Ne që erdhëm këtu, në këto momente të jashtëzakonshme, u prekëm me të vërtetë shumë nga ndjenjat e larta patriotike të popullsisë së këtyre dy rrethëve. Këto ndjenja të zjarrta nuk mund të përshkruhen vetëm me pak fjalë që mund të them sot këtu. Nuk mund të përshkruhen ndjenjat e mirënjohjes së pafund për Partinë e pushtetin popullor, që gufonin nga zemrat e grave dhe të kooperativistëve, që takuam kudo ku shkuam.

Ajo që ka rëndësi më të madhe është se çdonjëri, me të cilin u poqëm, asnjë qime nuk e ndiente veten të shkëputur nga Partia. Për cilindo Partia dhe vetja e tij ishin bërë një. Ky është ai unitet i madh i çeliktë që Partia ka rrënjësuar në popull, prandaj edhe uniteti i popullit rreth Partisë sonë të lavdishme është i pafytyr. Ky unitet shfaqet çdo ditë me të gjithë madhësinë e tij, por në mënyrë të dukshme ai u shfaq sidomos në këto momente të vështira që kaloi popullsia e Dibrës dhe e Librazhdit. Pikërisht në këto momente të jashtëzakonshme ky unitet arriti kulmin e vet, u shprehën edhe një herë më fort se kurrë dashuria dhe mirënjohja e thellë e popullit tonë për Partinë

e tij të shtrenjtë, për pushtetin e tij popullor, për diktaturën e proletariatit.

Për fatkeqësinë që na ngjau mund që edhe lot na kanë shkuar, pasi nuk i mbanim dot, se të tilla ishin shprehjet e ndjenjave fisnike të këtij populli trim e të guximshëm, i cili në këto momente të vështira tregoi forcën e karakterit të vet të lartë, ai i tregoi Partisë çfarë mundësish kolosale fsheh në gjirin e tij, ç'vepra madhështore është në gjendje të ngrejë ai nën udhëheqjen e drejtë të Partisë, me forcat dhe vullnetin e tij të çeliktë, me mendjen e tij të qartë, me duart e tij të mrekullueshme.

Partia duhet të nxjerrë mësimë të mëdha nga këto momente, mësimë politike, ideologjike, organizative, të nxjerrë mësimë nga organizimi i punës dhe nga lufta për ndërtimin dhe rindërtimin e objekteve të dëmtuara, me qëllim që ta përmirësojë më tej punën e saj, për të ecur kurdoherë e më mirë përpara.

Këtë që na ngjau, shoqe dhe shokë, le të mos e quajmë më një fatkeqësi, por një provë të madhe për Partinë dhe për pushtetin, për gjithë popullin tonë. Prova nëpër të cilën kaluam në këto momente vërtetoi forcën e vijës së drejtë politike të Partisë sonë, forcën e marksizëm-leninizmit, të ideologjisë sonë të lavdishme, të cilën Partia po na e mëson neve dhe popullit, çdo ditë, në punë dhe në luftë, gjatë betejave të mëdha revolucionare. Ajo vërteton, gjithashtu, shpirtin luftarak, sulmues e vetëmohues, si dhe forcën e madhe organizative të Partisë dhe të pushtetit tonë popullor. Ajo ishte një provë gjatë së cilës njerëzit do të tregonin e do të vërtetonin në jetë zotësitë e tyre

për ato që kishin mësuar në jetë, në punë, nëpër shkolla, zotësi që vërtetohen çdo ditë dhe çdo orë në punë dhe në luftë. Por këtë herë ato u vërtetuan në një moment të jashtëzakonshëm që kërkonte zgjuarsi, shpejtësi të madhe në marrjen e vendimeve, njëkohësisht zotësi dhe vetëmohim të madh. Për të gjitha këto, vëllezër dhe motra, kjo fatkeqësi ishte një provë e madhe, ishte një hallkë e zinxhirit të vrullit të madh revolucionar që ka ngritur më këmbë gjithë Shqipërinë, ishte prova e shkëlqimit të vijës së drejtë të Partisë sonë që ka ngritur peshë zemrat e gjithë popullit, të çdo njeriu tonë, të madh e të vogël, të të rinjve dhe të pleqve.

Sigurisht, ne nuk e dëshironim të na ndodhte ky tërmet, por ishte jashtë mundësive tona për ta ndaluar. Ai na solli shumë të këqija, por në të njëjtën kohë, na solli edhe të mirat që përmendëm më lart, të cilat nuk mund të vlerësohen as me miliona, as me miliarda. Cilësitë e larta që ka kalitur Partia te njerëzit tanë, cilësi këto që duken e zhvillohen në të gjithë madhësinë e tyre çdo orë, çdo ditë, çdo muaj e çdo vit, janë të paçmueshme. Ato mobilizojnë të gjitha energjitë e popullit për rritjen e prodhimit dhe krijimin e bollëkut, për ngritjen e madhe morale, politike, ideologjike te njerëzit tanë që po transformojnë e do ta transformojnë gjithnjë e më shumë vendin tonë, po përforcojnë e po zhvillojnë me një vrull gjithnjë më të madh fitoret e revolucionit tonë socialist në të gjitha fushat.

Prandaj, vëllezër dhe motra të Dibrës dhe të Librazhdit, kjo fatkeqësi qoftë e shkuar dhe e harruar

nga pikëpamja psikologjike. Ndërsa nga pikëpamja materiale, sikurse morët sot këtu vetë zotime, mobilizohuni me të gjitha forcat që ndërtesat e rrënuara apo të dëmtuara të ndërtohen diku më 20, diku më 25, më 27 ose 28 dhjetor, por kurdoherë përpara afatit që parashikohet në vendimin e Qeverisë. Dhe unë kam besim të plotë se me masat që kemi marrë ato do të përfundohen me siguri para fundit të këtij muaji dhe të dëmtuarit, si dhe i gjithë populli ynë, do të ndiejnë një kënaqësi të thellë, atyre do t'u rriten pa masë forcat, të cilat në të ardhmen ne duhet t'i shfrytëzojmë kurdoherë për të mirën e vendit.

E para, këto momente ne duhet t'i shfrytëzojmë politikisht. Çdo ditë në vendin tonë ka shembuj të shumtë konkretë heroizmi e vetëmohimi të paparë, me të cilët mund të ilustrimet në mënyrë të shkëlqyer vija e Partisë sonë. Dhe duke i lidhur të gjithë këta shembuj me vijën e drejtë politike të Partisë, duke i parë ata gjithmonë në prizmin politik, ne do të jemi të sigurt se këto akte heroizmi, zotësie dhe force nuk mund të venë dëm dhe as të dobësohen, përkundrazi, do të qindfishohen.

E dyta, këto momente ne duhet t'i shfrytëzojmë edhe ideologjikisht. Partia gjithnjë na ka mësuar se ideologjia jonë marksiste-leniniste nuk është e pakuptueshme për masat. Përkundrazi, ajo është e kuptueshme, e kapshme nga çdo njeri, me shkollë ose pa shkollë. Por Partia duhet të punojë vazhdimisht që ideologjinë marksiste-leniniste t'ua bëjë të kuptueshme masave, duke e ilustruar atë me vetë veprat e popullit shqiptar, të udhëhequr nga Partia dhe për

këtë ajo i ka të gjitha mundësitë, bile sot këto mundësi mund të themi se janë shumë të mëdha.

Kanë qenë pikërisht shembujt e luftës dhe të heroizmit, kanë qenë realizimet dhe iniciativat e mrekullueshme, guximi i madh dhe fryma e lartë e vetëmohimit të masave ato që frymëzuan dhe i bënë mësuesit tanë të mëdhenj, Marks, Engels, Lenin dhe Stalin, që të sintetizojnë teorinë tonë socialiste, e cila lind nga lëvizja krijuese revolucionare e proletariatit, e masave popullore. Në rast se njerëzit e Partisë çdo akt, çdo vepër, kolektive apo individuale, të klasës punëtore, të fshatarësisë punonjëse dhe të inteligjencies sonë, çdo sakrificë që bëjnë heronjtë tanë të punës dhe të luftës për ndërtimin e socializmit dinë (dhe ata duhet të dinë e të mësojnë) t'ia referojnë teorisë, atëherë nuk do të ketë njeri që të mos e kuptojë dhe të mos e zotërojë marksizëm-leninizmin, atëherë të gjithë do të thonë se kjo teori që na udhëheq nuk është edhe aq e vështirë. Në fakt, te ne çdo veprim ndriçohet nga teoria jonë, Partia jonë atë, marksizëm-leninizmin, ka për flamur. Prandaj nga më i vogli gjer te më plaku, të gjithë qytetarët e Republikës sonë Popullore, që shprehen me kaq zjarr për Partinë dhe për zbatimin e vijës së saj në jetë, që ngrenë ndërtesa, hapin toka të reja, ndërtojnë kanale dhe hidrocentrale etj., etj., edhe në qoftë se nuk dinë të bëjnë teori, edhe në qoftë se nuk dinë të flasin (ashtu sikur u duk për shokun Kamber Shevroja¹, i cili pavarësisht se nuk di të flasë me fjalë të bukura, ai i di

1 Mjeshtër i ndërtimit të urave, Hero i Punës Socialiste.

mirë ligjet e ndërtimit të urave dhe të rrugëve dhe zbaton kështu si duhet mësimet e Partisë), kur punojnë, kur ndërtojnë gjithë këto vepra të mëdha, e zbatojnë si duhet në jetë këtë teori të lavdishme të Partisë sonë.

Tani neve na del një detyrë e madhe, ta futim akoma më me forcë ideologjinë e Partisë sonë në masat e gjera të popullit. Nuk mjafton vetëm të kemi disa qindra specialistë teoricienë. Ata nuk kanë vlerë në qoftë se teorinë nuk ua mësojnë masave, të gjithë njerëzve, edhe në praktikë, sepse socializmi është ajo forcë e madhe politike dhe ideologjike që vë në lëvizje masat punonjëse. Teoria nuk ka kuptim pa praktikën revolucionare të masave, prandaj Partia jonë, Partia me të vërtetë revolucionare marksiste-leniniste, në mënyrë konsekuente dhe kurdoherë në ngjitje, i vë në lëvizje masat tona qindramijëshe, të gjithë popullin, deri te fëmijët që kanë fituar konceptet e para të jetës, pa përmendur këtu punën e madhe që keni bërë ju, shokë komunistë.

Këtë nuk e them që të na rritet mendja, sepse edhe ne kemi gabime, të cilat popullit asnjëherë nuk ia kemi fshehur. Kush i shikon punët drejt në sy, pranon se njeriu që punon, edhe gabon. Por, pavarësisht nga këto, realizimet në vendin tonë janë kolosale, populli shikon çdo ditë në jetë ç'forcë e madhe është Partia, dhe kur themi Partia, me këtë kuptojmë të gjithë komunistët nga të cilët ajo përbëhet. Puna e madhe e Partisë, puna e madhe e komunistëve vërtetohet çdo ditë në jetë. Janë komunistët ata që e kanë frymëzuar, që e kanë ngritur popullin politikisht e

ideologjikisht, prandaj ky është bërë tanimë si një dragua i pamposhtur dhe realizon me ndërgjegje të lartë, me besim të madh e zgjuarsia të rrallë atë që i thotë Partia. E gjithë kjo, pra, është vepra e Partisë, e komunistëve.

Le ta shohim veprën e Partisë në zhvillimin e saj. Vështirësi të shumta e të mëdha kemi pasur në fillim, por ato i kapërcyem me sukses njëerën pas tjetrës dhe tani jemi kalitur, kemi fituar një përvojë të madhe dhe po ecim gjithnjë përpara. Si pasojë, edhe rezultatet e arritura janë të mëdha, të pakrahasueshme me të kaluarën. Nesër ato do të jenë akoma edhe më të mëdha.

E treta, ne duhet të shfrytëzojmë në maksimum edhe përvojën e madhe në organizimin e punës që fituam nga kjo provë e madhe. Mos vallë deri tani ne nuk dinim të organizonim punën? Sigurisht, ne dinim. Ne kemi organizuar punë të mëdha, por duhet të kemi parasysh se organizimi i përsosur është vështirë të arrihet. Në punë e në luftë ne duhet të mësohemi ta organizojmë punën gjithnjë më mirë në mënyrë krijuese, sipas kushteve e rrethanave që na paraqiten. Kështu ndodhi kohët e fundit edhe në rrethet tuaja. Organizatat e Partisë dhe organet shtetërore të ju krijuan menjëherë, pas tërmetit, në çdo fshat të prekur, shtabe për drejtimin e punëve për normalizimin e jetës së popullit të dëmtuar; ato morën të gjitha masat e nevojshme për zhdukjen e pasojave të tërmetit dhe fituan nga kjo një përvojë të madhe organizative në kushte të jashtëzakonshme e të vështira natyrore.

Nga kjo përvojë duhet të nxjerrim mësim të gjithë ne, shteti, Këshilli i Ministrave, ministritë. Kjo përvojë e nxjerrë gjatë një muaji është e tillë që, në kushte normale, nuk mund të fitohet as në tre vjet dhe do të na ndihmojë në të ardhmen aq shumë sa tani është vështirë të mendohet.

Po si do të na ndihmojë? Në realizimin e planeve tona ekonomike. Ne kemi tani planin ekonomik pesëvjeçar që vendosi Kongresi i 5-të i Partisë, pas të cilit shpërtheu një entuziazëm i madh në Parti e në popull për realizimin e tij. Masat punonjëse morën zotime që janë duke i konkretizuar dhe po i kthejnë në të mira materiale. Ne sot po vëmë re se si po tejkalohen këto zotime dhe si po merren të tjera të reja, akoma më të guximshme, që jo më shumë se para pesë vjetësh, do të na dukeshin fantastike po t'i dëgjoni, ndërsa tani ato janë bërë si diçka e zakonshme dhe po luajnë një rol të madh për realizimin e detyrave të planit pesëvjeçar në industri, në bujqësi e në shumë drejtime të tjera qysh gjatë viteve 1968-1969.

Ku qëndron kjo forcë e madhe, që i bën të mundur të tilla realizime? Janë pikërisht puna e Partisë për revolucionarizimin e mëtejshëm të mendjes së njerëzve, fryma e lartë politike e vijës së saj për të krijuar të mira materiale, zbatimi i porosive të saj për të vënë politikën në plan të parë, që ngritën pesë në këmbë gjithë Shqipërinë. Kjo shpjegon edhe faktin që kur në hekurudhë ra Shkurte Pal Vata, u ngrit i madh e i vogël në të gjithë vendin, njerëzit nuk mund të përmbaheshin, as në fabrika, as në kooperativa, as në shkolla. Me qindra e mijëra letra e te-

legrame i kanë ardhur e vazhdojnë t'i vijnë Komitetit Qendror, Kolektivat nuk shprehin në këto letra e telegrame vetëm dëshirën për të shkuar në aksion, shumë prej tyre, duke u nisur për atje, ia kanë dërguar ato Komitetit Qendror në rrugë e sipër, duke njoftuar se me iniciativën e tyre dhe pa prituri përgjigje ishin nisur dhe po marshonin drejt hekurudhës për të punuar vullnetarisht, duke i vënë kështu shtetin dhe Partinë para një fakti të kryer. Kjo masë e madhe njerëzish, e ngritur peshë nga shembulli i një vajze të re 15-vjeçare, tregon se sa lart, me ç'frymë e hov revolucionar i kuptojnë politikisht njerëzit e Shqipërisë së re problemet e ndërtimit të socializmit.

I verbri Fuat Çela, me ndërgjegjen e tij të lartë në punë, elektrizoi dhe mobilizoi gjithë punonjësit, dhe sidomos rininë tonë. Gjithsecili filloi të mendonte se ç'duhej të bënte kur Fuat Çela pa sy kryen pa u përkulur gjithë ato punë. E frymëzuar nga jeta dhe puna e tij, u ngrit peshë e gjithë Shqipëria. I verbri na mësoi kështu të tërëve të shkundemi e të themi: «Kur Fuati pa sy vepron kështu, po ne që i kemi sytë?». Te ne po ndodh tani ajo që na mësojnë Lenini dhe Stalini, që çdo komunist në mbremje po i bën vetes pyetjen: «Si e kam kryer unë detyrën sot?».

Në vend të Shkurte Pal Vatës, që ra në krye të detyrës, shkoi në hekurudhë i ati, Mehmet Elezi erdhi këtu në rrethin e Dibrës për të zëvendësuar të vëllanë që ra në kufi. Këto nuk janë akte të thjeshta. Këto qëndrime revolucionare shembullore që mbajnë njerëzit e thjeshtë të popullit tonë, kanë një kuptim të lartë politik, ato revolucionarizojnë mendjet e nje-

rëzve tanë dhe i bëjnë ata si luanë, u qindfishojnë energjitë, u japin zemër të hidhen në zjarr po të jetë nevoja për Partinë, për atdheun, pasi janë të ndër-gjegjshëm që këtë e bëjnë për veten e tyre, për atdheun e dashur, për të ardhmen e vet e të fëmijëve të tyre dhe të brezave që do të vijnë më vonë. Këto akte revolucionare që ndodhin te ne, pasqyrojnë vijën e drejtë politike të Partisë, të mbujtur me ideologjinë tonë marksiste-leniniste.

Pra, politikisht kjo provë na ngriti shumë. Ajo do të na shërbejë neve edhe për realizimin me sukses të planeve tona. Tani që në rrethin e Dibrës dhe në atë të Librazhdit po ndërtohen me mijëra shtëpi brenda një kohe kaq të shkurtër, jo vetëm ju, por të gjithë njerëzit do të reflektojnë akoma më thellë, do të pyesin veten: «Kur në Dibër e në Librazhd po ndërtohen me mijëra shtëpi brenda një muaji, a nuk mundet që planin pesëvjeçar të hapjes së tokave të reja ta realizojmë brenda një kohe rekord?». Duke reflektuar në këtë mënyrë revolucionare, do të dalim me konkluzionin që kemi mundësi të arrijmë në rezultate të mëtejshme të shpejta, bile nga veprimtaria për realizimin e këtyre objektivave ne do të fitojmë edhe një përvojë më të mirë në organizimin e punës. Deri tani në industri, në bujqësi e gjetkë ne kemi përvojën e punës me brigada, me brigadierë, me skuadra. Kjo përvojë pune te ne ka marrë një rrugë të mirë, por, pas krijimit të shtabeve për drejtimin e punimeve për kalimin e pasojave të tërmetit, ju i vutë përpara përgjegjësisë komandantët dhe anëtarët e shtabeve dhe morët zotime përpara Partisë e Qeve-

risë për t'i realizuar para afatit detyrat që ju janë ngarkuar, sepse ato kanë një rëndësi të madhe politike, ideologjike, brenda dhe jashtë Shqipërisë. Atëherë e gjithë kjo forcë, kjo përvojë e fituar do të shfrytëzohet edhe në drejtim të forcimit të mëtejshëm të punës së skuadrave e brigadave të prodhimit në bujqësi, në industri etj. Kjo frymë revolucionare do të futet, e duhet sa më parë të futet, edhe në shkollat tona.

Mësuesit e shkollave tona të mbajnë kurdoherë parasysh direktivat e Komitetit Qendror të Partisë për lidhjen sa më ngushtë të mësimit me jetën dhe të bëjnë përpjekje të vazhdueshme për t'i pastruar programet dhe tekstet shkollore nga uji i tepërt që ato kanë akoma. Programet e shkollave tona të jenë të tilla, që njerëzit të dalin të mësuar prej tyre, që mësuesit të mos ua mbushin mendjen nxënësve me gjëra të kota, që nuk do t'u hyjnë kurrë në punë. Prandaj mësuesit të hedhin poshtë çdo gjë që s'vlen, me qëllim që nxënësit të fitojnë kohë të çmueshme për të marrë atë kulturë të nevojshme të përgjithshme, që do t'i ndihmojë të bëhen të zotë për jetën. Qysh kur janë në shkollë ata duhet të mësohen të bëhen të zotë për bujqësinë, për të ndërtuar mure, të dinë të presin xhame, të mbulojnë çati etj. Mësuesit tanë të reflektojnë pak më thellë mbi këto çështje. I riu vullnetar nga Vlora që diskutoi në këtë mbledhje, na tregoi këtu (dhe ju këtë e dini vetë) se të rinjtë e të rejat shkollare që kanë ardhur këtu përkohësisht, tani po bëjnë mure, mbërthejnë dritare, hipin e rregullojnë çati dhe bëjnë sa e sa punë të tjera. Ja, pra, si po rea-

lizohet në praktikë vija e Partisë. Çdonjëri te ne duhet të mësojë dy-tri zanate. Kështu edhe nxënësit në shkollë, krahas mësimëve, të përpiqen e të mësojnë të bëhen muratorë, stukaxhinj, marangozë, apo të marrin çdo profesion tjetër për të cilët ka aq nevojë vendi ynë. Këto zanate nuk mësohen të gjitha në shkollë, por në jetë. Organizimi i rrufeshëm për zhdukjen e pasojave të tërmetit në rrethet e Dibrës dhe të Librazhdit do të na japë neve mësimë kolosale në këto drejtime.

Por çfarë do të rezultojë nga përvetësimi i kësaj përvoje të madhe nga masat tona punonjëse në gjithë sektorët? Kjo punë do të na sjellë përfitime të mëdha. Komiteti Qendror i Partisë, për shembull, kur shqyrtoi planin e vitit 1968, vendosi të tejkalohen rendimentet e parashikuara të bimëve të ndryshme në bujqësi. U morën me këtë rast disa vendime, të guximshme revolucionare, të cilat vetëm të fjeturit nuk mund t'i pranojnë, kurse revolucionarët do të thonë se këto janë akoma pak.

Prandaj edhe ju në Dibër në këto kushte me siguri do të mendoni: «Edhe për ne e ka fjalën Komiteti Qendror që në një të katërtën e sipërfaqes së misrit të marrim 40 kuintalë misër për hektar». Unë kam bindjen se ju do të jeni nga të parët që do të premtoni që jo në një të katërtën, po në gjysmën e sipërfaqes së misrit të merrni jo 40 kuintalë, por 50 kuintalë misër për hektar. Këtë e them pasi ju keni një popull heroik e patriot, si i gjithë populli ynë, pastaj ju keni një përvojë të madhe në kultivimin dhe ujtitjen e misrit dhe se Partia, si kudo te ne, ju

ka dhënë tani të gjitha mundësitë, në radhë të parë për ngritjen politike dhe ideologjike, ju ka dhënë edhe mundësi të tjera dhe do t'ju japë akoma më shumë në të ardhmen, si farëra të zgjedhura, plehra, etj., etj. Prandaj, vendimin që mori Komiteti Qendror i Partisë ju jo vetëm do ta realizoni, por kam bindjen se do ta tejkaloni dhe do të bëheni kështu flamur për gjithë Shqipërinë në rendimentet e misrit. Këtë e them me bindje, pasi prova është e freskët: ja si u ndërtuan mijëra shtëpi brenda një muaji. Askujt nuk ia merрте mendja ca kohë më parë një gjë të tillë.

Shembulli pozitiv luan një rol të madh edukativ dhe frymëzues në shoqërinë tonë socialiste. U përlesh me dallgët e detit Adem Reka për mbrojtjen e pasurisë socialiste. Ra në krye të detyrës fillrojtësi i paturbur nga Kukësi, Pjetër Lleshi, u hodhën në flakë e në zjarr shokët Muhamet Shehu dhe Myrteza Kepi. Shembujt e tyre të heroizmit frymëzojnë sot gjithë punonjësit dhe rininë tonë për të zbatuar pa u përkulur detyrat që u ngarkohen. Por në vendin tonë kemi ende shumë shembuj të tjerë heroizmi. Ne duhet të shfrytëzojmë gjithçka pozitive që lind, kudo që masat tona punonjëse krijojnë dhe bëjnë gjithçka pa u ndier, pa bujë, për realizimin dhe sidomos për tejkalimin e detyrave të planeve tona. Punën dhe përvojën e tyre t'i bëjmë probleme politike, ashtu siç bëmë shembullin e heroinës komuniste Shkurte Pal Vata, siç kemi bërë heronjtë e rënë në Luftën Nacionalçlirimtare dhe në luftën për ndërtimin e socializmit. Fjalën e kam që ne të përfitojmë deri te shembulli i mirë i një kooperativisti brendapërbrenda çdo koope-

native, brigade apo skuadre. Edhe ju në rrethet tuaja keni brigada të mrekullueshme, që marrin jo 40, po edhe 80 e 90 kuintalë misër për hektar. Këta njerëz që arrijnë të tilla rekorde ju duhet t'i bëni flamur, që të mësojnë të gjithë nga përvoja dhe puna e tyre. Figurat kombëtare duhet të na nxitin, të na mësojnë dhe të na frymëzojnë për t'u hedhur përpara, por ne nuk duhet të harrojmë se ai kooperativist ose ajo skuadër që merr 90 ose 100 kuintalë misër për hektar, duhet të bëhet një flamur jo vetëm për kooperativën, por edhe për rrethin, bile për gjithë Shqipërinë dhe të tërë të luftojnë t'ia arrijnë kësaj. Atëherë, shokë, nuk do të jetë aspak e vështirë që ne të marrim zotim që kudo, siç thashë më parë, të arrihet të merren nga 50 e 60 kuintalë misër për hektar. Kështu mund të themi edhe për grurin, panxharin e sheqerit dhe për prodhimet e tjera bujqësore.

Pra, shoqe dhe shokë, vëllezër dhe motra, planin ekonomik që kemi vendosur duhet ta realizojmë me një guxim të tillë të madh. Në emër të Komitetit Qendror, ju rekomandoj që, duke i parë qartë këto probleme, me këtë sy, me këtë zemër, me plot energji dhe heroizëm revolucionar, t'u futemi atyre më thellë, t'i rishikoni edhe një herë planet dhe të merrni zotime të tjera, të reja. Organizoni për këtë qëllim më mirë punën politike, organizative, frymëzoni njerëzit që t'i realizojnë dhe t'i tejkalojnë planet që janë vendosur. Por në rast se ne do të ecim (dhe për këtë s'ka dyshim se do të ecim) me vrullin që shpjegova tani, në mbarrim të vitit 1968 do të na jepen mundësi që gjatë vitit

1969 të krijojmë të mira materiale në atë masë që pikërisht as tani nuk na shkon ndër mend.

As Byrosë Politike, as Qeverisë nuk u shkante ndër mend vitin e kaluar që do të merrnim sivjet një vendim kaq të guximshëm dhe me rëndësi historike, siç është ai i elektrifikimit brenda një periudhe të shkurtër prej më pak se katër vjetësh, i të gjitha fshatrave të Shqipërisë. Të gjithë e dini se ne kishim një vendim për këtë çështje, realizimi i të cilit parashikohet për vitin 1985, domethënë pas 17-18 vjetësh. Po kur Byroja Politike dhe Qeveria u gjendën përpara këtij hovi të madh të paimagjinueshëm e të papërshtueshëm të Partisë dhe të gjithë popullit, përpara kësaj krijimtarie nga e cila lindën vendimet e Komitetit Qendror, atëherë na u desh që këtë çështje ta ristudionim dhe, pasi bëmë llogaritë, në përfundim vendosëm që kjo detyrë të kryhet brenda një periudhe prej katër vjetësh. Ky është një vendim i bazuar dhe që nuk do të prekë asnjë nga zërat e tjerë të planeve tona. Prandaj ju thashë që, në shembullin e Byrosë Politike dhe të Qeverisë, edhe ju t'i rishikoni planet. Ato me të vërtetë janë të ngjeshura, por, duke i parë edhe një herë me këtë sy, me këtë frymë politike, me besim dhe vendosmëri, caktoni shifrat e reja dhe njoftoni Komitetin Qendror se, për shembull, ka gabuar duke ju caktuar 40 kuintalë misër për hektar, kurse ju jeni të bindur që do të realizoni 50-60 kuintalë e më tepër për hektar dhe ne do të pranojmë që kemi gabuar dhe do t'ju heqim kapelën.

Por le të mos largohemi nga çështja e elektrifikimit. Vendimin e Plenumit të 4-t të Komitetit Qe-

ndror, që është me të vërtetë një aksion i madh historik, ne duhet medoemos ta realizojmë me rastin e 30-vjetorit të lavdishëm të themelimit të Partisë. Realizimi i tij do të jetë vepra e Partisë, vepra e popullit tonë të mrekullueshëm, të edukuar nga Partia. Ka vende të tjera në botë që kanë shumë më tepër nga ne energji elektrike, por popullin e kanë lënë në errësi dhe as që interesohen për këtë. Ne akoma kemi shumë nevojë për energji elektrike. Lenini ka thënë se

«Komunizmi është pushteti sovjetik plus elektrifikimi i të gjithë vendit. . . »¹.

Por duke u dhënë dritë elektrike të gjitha fshatrat e Shqipërisë pas katër vjetësh, nuk do të thotë se me këtë shkuam në komunizëm. Por mbi planin që kanë Partia dhe shteti ynë për elektrifikimin e vendit, domethënë për zhvillimin e të gjitha degëve të industrisë, për elektrifikimin e bujqësisë etj., Byroja Politike, Qeveria dhe Plenumi i Komitetit Qendror morën vendimin që, pa e arritur akoma realizimin e kësaj detyre të madhe në perspektivë, brenda kësaj periudhe të shkurtër katërvjeçare, të bëjmë çdo sakrificë ekonomike për t'ia plotësuar popullit tonë këtë nevojë, sepse heroizmi i tij gjatë Luftës Nacionalçlirimtare dhe sot për ndërtimin e socializmit nuk mund të shpërblehet me asnjë sakrificë. Populli dhe fshatarësia jonë patriotike e meritojnë plotësisht këtë që po bëjmë për ta, prandaj t'ia çojmë dritën, kudo që të ndodhen, deri edhe në zonat më të largëta.

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 480.

Drita elektrike në fshatra do ta ngrëjë edhe më kulturën e masave tona kooperativiste. Çuarja e saj kudo do të na kushtojë disa qindra milionë lekë të rinj, por ne do t'i shpenzojmë këto fonde, me qëllim që dritën t'ua sigurojmë të gjitha fshatrave të vendit tonë, pa i sjellë asnjë pengesë planit në të gjithë zërat. Vetëm ta kemi të qartë se për të realizuar këtë detyrë kërkohet një mobilizim i plotë nga të gjithë. Prandaj themi që çdo ditë duhet të përfitojmë sa më shumë nga përvoja e arritur gjer tani, të cilën ta zbatojmë kudo, në mënyrë që t'i shumëfishojmë të ardhurat tona dhe të krijojmë kështu sa më shumë rezerva për të përballuar çdo nevojë që mund të na paraqitet.

Të krijojmë rezerva nuk do të thotë të sigurosh vetëm nevojat ushtarake në kohë rreziku, por edhe për të përballuar fatkeqësi të tilla si kjo që ndodhi në rrethet tuaja. Të gjithë ju e kuptoni vetë tani ç'vlerë të madhe kanë ekonomizimet që rekomandon vazhdimisht Partia, tejkalimi i planeve, ruajtja dhe shfrytëzimi i mirë i materialeve, lufta klasore kundër armiqve e vjedhësve etj. Shteti ynë i diktaturës së proletariatit krijon rezerva të atilla për të përballuar e për të realizuar plane kurdoherë e më të mëdha dhe momente më të vështira. Prandaj ne, gjatë punës për realizimin e planeve, të mendojmë njëkohësisht edhe për detyrat që do të na vihen për t'i dhënë dritën elektrike të gjitha fshatrave.

Për këtë qëllim duhet që edhe vetë fshatrat të marrin pjesë fuqimisht në realizimin e kësaj detyre. Ato të ndihmojnë në prerjen dhe në transportimin e shtyllave, në shtrirjen e telit, në hapjen e gropave dhe në

vendosjen e shtyllave, në lidhjen e telave përjashta dhe brenda shtëpive etj. Por si do të bëhen të gjitha këto punë? Do t'i bëjmë në mënyrë të organizuar. Të mos na duket tani sikur kemi arritur në një nivel organizimi të përsosur. Jo, vetë këto vendime të mëdha revolucionare gjatë zbatimit të tyre do të na detyrojnë dhe do të na mësojnë si ta organizojmë sa më mirë punën tonë.

Tani mjaft nga kooperativat tona bujqësore janë të kënaqura që kanë nga një kovaç, berber, rrobaqepës etj., por nesër atyre do t'u duhet edhe elektrikisti, që të ketë dijeni të vërë në lëvizje turbinat, që të dijë të shfrytëzojë energjinë elektrike për t'i bërë pompat që të ngrenë ujën për ujitjen e bimëve, për të vënë në lëvizje makinat për grirjen e silazhit etj. E tillë është perspektiva e zhvillimit të kooperativave tona dhe kjo kohë do të vijë medoemos. Prandaj jo vetëm prerja dhe sigurimi i shtyllave, por edhe përgatitja e kuadrove është një tjetër detyrë me rëndësi që na vihet përpara tani, për zbatimin e këtij vendimi.

Detyra që thashë që çdo njeri të mësojë shumë zanate, është me rëndësi të madhe për kushtet tona. Por vetëm në shkolla nuk mësohen zanatet, ato mësohen më mirë e më shumë në punë e sipër dhe në aksione masive. Partia po na hap perspektiva të mëdha, vetë populli, me zotësinë dhe iniciativat e tij, na frymëzon të bëjmë gjithçka për zbatimin në kohën e caktuar, bile edhe më përpara të vendimit për elektrifikimin. Të bëjmë çdo përpjekje që gjithçka lidhet me këtë vendim ta realizojmë në kohë, duke përfshirë edhe përgatitjen dhe edukimin e kuadrove.

Të gjithë, sidomos në qytete, po e ndiejnë tani nevojën që kemi për shtëpi banimi. Më parë ne ndërtonim më shumë banesa dhe kjo ishte e natyrshme, pasi për të ndërtuar më shumë fabrika, uzina, kombinate, hidrocentrale etj. s'kishim mundësi, ose këto mundësi i kishim akoma të pakta. Mirëpo tani kemi ecur përpara, filluam të ndërtojmë vetë fabrika, hidrocentrale, të hapim miniera të reja etj. Aftësitë tona ndërtuese po vijnë duke u rritur. Megjithatë, ne nuk e kemi lënë pas ndërtimin e shtëpive të banimit nëpër qytete.

Ndërtimi i mëtejshëm i socializmit është një domosdoshmëri për rritjen gjithnjë e më shumë të mirëqenies materiale e kulturore të gjithanshme të popullit tonë, pasi mund të kesh shtëpi, por s'ka asnjë kuptim po të mos kesh bukë, rroba etj., etj. Prandaj ne duhet të ndërtojmë gjithnjë më shumë vepra për rritjen e forcave prodhuese, pa lënë, sigurisht, mënjane edhe ndërtimin e shtëpive të banimit. Mirëpo në rrugën e zakonshme nuk kemi mundësi të bëjmë më shumë në krahasim me popullsinë që po rritet. Vajza ose djali që dy pesëvjeçarë më përpara ishin 10-15 vjeç, tani janë bërë 20-25, janë martuar; ata, pra, kanë nevojat e tyre edhe për strehim. Si Republikë tani ne po arrijmë në gati dy milionë banorë. Në fshat problemi i shtëpive paraqitet më mirë se në qytet. Edhe për qytetet ne kemi parashikuar në plan të ndërtojmë shtëpi banimi, por sa kalon koha aq më shumë ndihet nevoja më e madhe e investimeve për banesa. A mund ta pranojmë një gjë të tillë? Këtë e pranojmë nga zori, pasi të gjithë duam t'u ndërtojmë shtëpi punonjësve, të cilët lodhen, bëjnë heroizma në

punë dhe kur e do puna janë gati të punojnë nga 13 ose 14 orë në ditë, por ka prej tyre që janë shumë ngushtë me strehim.

Prandaj Partia dhe shteti ynë, si në fushat e tjera, duhet të çajné edhe në këtë drejtim, ta zgjidhin këtë problem të madh. Po në ç'mënyrë? Në rrugën revolucionare të masave. Vetë vrulli i punonjësve, vetë masat po e mësojnë Partinë çfarë duhet të bëjë edhe për zgjidhjen e këtij problemi shumë të madh. Strehimin ta bëjmë problem të të gjitha masave; njëkohësisht, të marrim masa të forta organizative, të kontrollojmë mirë e të shikojmë ç'pyje kemi, pasi ka shumë vite që është bërë një studim mbi pyjet, i cili mund të mos jetë i azhurnuar si duhet. Prandaj çdo rreth, nën drejtimin e seksionit të bujqësisë, të përcaktojë skuadrat që do të merren me punën për t'i kontrolluar pyjet, ku janë e ku nuk janë, sa lëndë kemi prerë në to gjer tani dhe sa na lejohet të presim, duke llogaritur që kapaciteti i tyre të rritet vazhdimisht. Me një fjalë, Partia të ketë kështu një pasqyrë të qartë dhe të jetë e ndër-gjegjshme ç'sakrifica duhet të bëjmë akoma për të prerë lëndë për ndërtimin e shtëpive për popullin. Në rast se llogaritë na dalin që ka mundësi, atëherë të presim lëndë në pyjet tona për të ndërtuar shtëpi komode një ose dykatëshe në qytete. Dhe këto shtëpi do t'i ndërtojë vetë populli, duke u mobilizuar i madh e i vogël, burra e gra nga dy orë çdo ditë pas punës, ashtu si u punua në katundin tuaj, Burim, te shtëpia e rrënuar e Halim Pikut, të cilit iu vra i nipi nga tërmeti etj. Duke kontribuar vetë masat në këtë çështje, s'ka dyshim që këto shtëpi do t'i ndërtojë edhe me

kosto shumë të ulët. Kjo punë nuk do të na pengojë në asnjë mënyrë për ngritjen e pallateve të larta anës rrugëve kryesore nëpër qytete, por në lagje nevoja na detyron përkohësisht të ngremë në masë edhe shtëpi të vogla me dy ose tri dhoma e një kuzhinë, ku të futen njerëzit. Vetëm kështu ne do të mund të ndihmojmë zgjidhjen e këtij problemi të madh dhe të ngutshëm që na del përpara, siç është strehimi i popullsisë. Dhe gjatë kryerjes së këtij aksioni të madh, njerëzit tanë do të mësojnë jo nga një, por nga dy dhe tri zanate. Kështu që, kur të fillojmë të ndërtojmë Hidrocentralin e madh të Fierzës dhe vepra të tjera të pesëvjeçarit të ardhshëm, të mos mendojmë atëherë ku do t'i gjejmë karpentierët, muratorët, elektrikistët etj., etj., këta ne do t'i kemi përgatitur dhe duhet t'i përgatitim me kohë dhe për këtë qëllim. Dhe kjo kohë do të vijë shpejt, prandaj gjer atëherë të punojmë që me këtë vrull të madh revolucionar që ka shpërthyer në vendin tonë të përgatitim me dhjetëra mijë specialistë që do të na duhen, me shkollë të lartë, të mesme, të ulët ose pa shkollë profesionale.

Për të gjitha punimet e mëdha në perspektivë, sigurisht, neve do të na duhet më shumë çimento, më shumë hekur etj. Po ku do t'i gjejmë këto? Për t'i siguruar ato do të na duhet në të ardhmen ta dy dhe trefishojmë kapacitetin e fabrikave ekzistuese të çimentos, ta trefishojmë bile edhe ta pesëfishojmë planin e shkrirjes së hekurit, në mënyrë që të arrijmë të shkrijmë deri në 500 mijë, bile në perspektivë deri edhe në një milion ton hekur në vit, pasi dihet që hekuri për industrinë është i nevojshëm si buka. Vetëm po të

kemi hekur dhe çimento më shumë, atëherë edhe pallasat do të jemi në gjendje t'i ngremë me shpejtësi, pasi me sasi të që kemi tani dhe me ato që parashikohet të blejmë, do të na duhet të ndërtojmë fabrikat që kemi në plan, pa të cilat nuk mund të zhvillohet ekonomia jonë popullore. Populli ynë i kupton këto plane të Partisë, ai është i bindur se ato kanë për qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të jetës së tij, prandaj bën edhe sakrifica, ai e kupton që vija e Partisë është e drejtë dhe është i gatshëm të punojë që të ecim gjithnjë përpara, të realizojmë rendimentet dhe të gjitha zërat e planeve tona në çdo drejtim.

Ne ndërtuam kohët e fundit disa uzina për prodhimin e plehrave kimike, por nevojat për to janë gjithnjë në rritje. Prandaj Komiteti Qendror i Partisë dhe Qeveria kanë menduar ta dy dhe trefishojnë kapacitetin e tyre dhe për këtë do të duhet të bëhen shpenzime më të vogla. Kështu, plehra fosfatike do të arrijmë të marrim gati trefish, do të përpiqemi të dyfishojmë, gjithashtu, kapacitetin e Uzinës së Plehrave Azotike, do të dhjetëfishojmë kapacitetin e metalurgjisë dhe përpunimin në vend të ferro-kromit. Në këtë mënyrë ekonomia jonë popullore do të ketë përfitime të mëdha. E kështu me radhë, vëllezër e motra, do të ndërtohen një sërë veprash të tjera të mëdha.

Partia dhe populli ynë kanë fituar tani një përvojë të madhe, ata nuk përgatiten më vetëm në një vit për tjetrin, por mendojnë edhe perspektivën e largët, për t'u përgatitur në çdo drejtim për të ardhmen. Kështu mendon Partia edhe për përgatitjen e kuadrit, jo vetëm me disa shkolla, por në masë; kështu mendon

ajo për të krijuar rezerva, jo vetëm sa për të kaluar një dimër, po për të fuqizuar më shumë gjithë ekonominë e vendit tonë, që po ecën me hapa të mëdhenj përpara në ndërtimin e socializmit.

Të gjitha këto që mendon Partia janë plotësisht të realizueshme. Partia dhe populli do t'i realizojnë ato patjetër, sepse vija jonë është e drejtë, se forca e Partisë dhe e popullit tonë është kolosale.

Por ne nuk do të bëjmë vetëm ndërtime, ne do të bëjmë gjithashtu përpjekje të mëdha për të përmirësuar çdo vit e më mirë edhe jetën e popullit, duke e furnizuar atë çdo vit e më shumë me prodhime bujqësore e blegtorale dhe me gjithfarë mallrash të tjera të konsumit të gjerë. Por si do ta bëjmë këtë? Për furnizimin e popullit me artikujt e nevojshëm bujqësorë e blegtoralë përvoja jonë tanimë është e madhe, prandaj çdo vit e më mirë do të shtohet prodhimi, që populli të ketë në radhë të parë të hajë më shumë, të vishet dhe të rrojë më mirë, të jetë sidomos i shëndetshëm, pasi të gjitha këto punë të mëdha që na presin kërkojnë energji dhe shëndet.

Problemin e shëndetit të popullit ta kemi kurdoherë të gjithë parasysh, shoqe dhe shokë. Në asnjë mënyrë të mos e nënvleftësojmë këtë çështje, pasi në qoftë se duam të hidhemi të gjithë në punë me frymë e vrull revolucionar për ngritjen e rendimenteve në industri, në bujqësi e në çdo sektor tjetër, të gjitha këto i bëjmë me një qëllim të vetëm: të përmirësojmë pandërprerë jetën e njerëzve tanë. Prandaj Partia t'i kushtojë njeriut kujdesin më të madh. Ky kujdes nuk qëndron vetëm në përmirësimin e vazhdueshëm

të kushteve materiale, si të ushqimit, të veshmbathjes, të banesave etj., por ka edhe një sërë çështjesh të tjera. Ky është një kompleks i tërë, që fillon qysh nga puna për ngritjen politike dhe ideologjike, nga puna praktike revolucionare, deri te pastërtia, veshja, kultura, revolucionarizimi i ndërgjegjes të njerëzve, te lufta për emancipimin e gruas dhe lufta e klasave etj., etj. Prandaj të gjitha këto të mos merren të shkëputura, por në një kompleks të tërë, që shpjegohet nga politika dhe ideologjia e Partisë sonë. Për realizimin e tyre duhet të ecim frontalisht.

Ajo që ka rëndësi të madhe është fakti se ne kemi krijuar tani në vendin tonë një klasë punëtore të lavdishme, që ka fituar një përvojë të tillë saqë është zor të arrihet në një periudhë kaq të shkurtër në vendet e tjera. Kjo ndodh për arsyen e vetme se punëtorët tanë janë të mbujtur me ideologjinë marksiste-leniniste, prandaj janë të aftë dhe të zotë për të krijuar gjëra të mrekullueshme. Organet shtetërore në qendër e në rreth gjenden tani përpara propozimeve të panumërta për të krijuar linja të reja në ndërmarrjet ekzistuese, bile deri ndërmarrje të tëra. Tani të gjithë njerëzit tanë kanë një preokupacion të madh, të krijojnë sende të nevojës së parë për popullin, pasi ne kemi akoma nevoja të mëdha. Në qoftë se në shumë raste populli në të kaluarën hante në një çanak, këtë e bënte jo vetëm nga mentaliteti dhe zakonet prapanike, por edhe nga që ishte i varfër, kishte pak gjëra për të ngrënë, dhe jo vetëm kjo, por as pjata nuk kishte në të kaluarën, bile edhe sot akoma nuk ka sa duhet. Prandaj të punojmë që fshatit t'i japim

edhe më tepër dhe nga çdo gjë. Qeveria, nën drejtimin e Partisë, do të marrë masa, do të shfrytëzojë të gjitha mundësitë që kemi dhe do të kujdeset që të shtohen gjithnjë e më shumë sendet e nevojës së përditshme të popullit. Kjo është një çështje me rëndësi të madhe.

Prandaj, shoqe dhe shokë, në gjithë këtë kuadër që shkurtimisht ju thashë, sa detyra të mëdha, heroike, u vihen përpara Partisë, pushtetit, njerëzve tanë! Por këto janë të realizueshme, sepse populli ynë ka një forcë, zotësi, zgjuarsia e vendosmëri të madhe, ai ka udhëheqjen e Partisë, prandaj këto detyra do t'i plotësojë me nder. Duke e parë në këtë prizëm, tërmeti që ra, na bëri keq, por na bëri edhe mirë, harxhuam me këtë rast shumë, por këto harxhe nuk janë asgjë përpara fitimeve të mëdha që arritëm, në radhë të parë kënaqësinë që ndien populli, i cili u fut dhe do të futet menjëherë brenda në shtëpitë e reja, dhe e dyta, përvoja e madhe që fituam gjatë këtij aksioni kaq të rëndësishëm.

Të dashura shoqe dhe shokë,

Në emër të Komitetit Qendror të Partisë, të shoqëve të tjerë që janë këtu, dhe timin, edhe një herë ju falënderoj me gjithë zemër për besnikërinë e madhe që ushqeni ndaj Partisë dhe pushtetit tonë popullor. Kjo është garancia e fitoreve, garancia e ruajtjes së lirisë dhe pavarësisë së atdheut tonë socialist nga armiqtë e shumtë që na rrethojnë dhe na kanë halë në

sy. Por armiqtë nuk kanë ç'na bëjnë, pasi Partia jonë, me vijën e saj të drejtë dhe me qëndrimot parimore internacionaliste, çdo ditë e më shumë ka ngritur prestigjin dhe autoritetin e Shqipërisë në botë. Kudo jashtë flitet me respekt për Republikën Popullore të Shqipërisë, jo vetëm nga miqtë, por edhe nga armiqtë, bile deri armiqtë më të vendosur e barbarë e kanë të zorshme ta errësojnë atë që kanë bërë dhe po bëjnë Partia dhe populli ynë në politikë, në ekonomi, në artim e kulturë, në të gjitha fushat.

Në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, siç na njofton përfaqësuesi ynë atje, miqtë e shumtë të Shqipërisë, përfaqësuesit e vendeve të Azisë, të Afrikës dhe të Amerikës Latine janë mahnitur me këto që po bëhen në Shqipëri. «Ju lutemi, — kërkojnë ata, — na jepni vendimin e Qeverisë suaj për çështjen e tërmetit», sepse kjo që po bëjmë ne është diçka e pakonceptueshme për ta. Në vendet kapitaliste kanë ndodhur e ndodhin katastrofa, por të dëmtuarit kurdoherë kanë mbetur pa asnjë ndihmë, në katër rrugët. U dëmtua Kazablanka ca më shumë se dy rrethet tona, po kush t'i vinte në ndihmë popullit maroken? Prandaj habiten të gjithë nga kjo që po bëhet te ne, prandaj përfaqësuesit e shumë vendeve flasin me simpati për vendin tonë, dhe jo vetëm me këtë rast, por sepse vazhdimisht shohin politikën e drejtë, konsekuente të Republikës sonë Popullore në Kombet e Bashkuara në mbrojtje të popujve, ndjekin me simpati qëndrimet tona të vendosura kundër imperializmit amerikan, revizionistëve sovjetikë dhe tradhtarëve të tjerë të marksizëm-leninizmit. Përfaqësuesit e këtyre vendeve në Organizatën

e Kombeve të Bashkuara thonë se Shqipëria është i vetmi shtet anëtar i kësaj organizate që mban qëndrim të drejtë dhe lufton me guxim e heroizëm për mbrojtjen e të drejtave të popujve. Këto nuk janë lëvdata, pasi ata që flasin kështu shohin që politika e drejtë marksiste-leniniste e Partisë dhe e shtetit tonë mbron kurdoherë të drejtën dhe demaskon pa mëshirë padrejtësitë e poshtërsitë që u bëhen popujve të botës nga imperialistët amerikanë dhe të tjerë, si dhe nga revizionistët sovjetikë.

Për këtë arsye Partia jonë gëzon një simpati të madhe në të gjitha vendet e Azisë, të Afrikës dhe të Amerikës Latine. Kudo në këto vende flitet me ngrohtësi për sa ngjet në Shqipëri, forcat përparimtare kërkojnë të dinë sa më shumë për punët që bëhen në vendin tonë, shprehin dëshirën të dërgojnë njerëz të marrin përvojën tonë dhe ne u japim mundësi shumë elementëve revolucionarë të vizitojnë Shqipërinë. Fitorret tona i inkurajojnë ata, u ngjallin dhe u forcojnë besimin e shpresën këtyre njerëzve, të cilët largohen të ngrohtë nga Shqipëria.

Të gjitha këto, motra dhe vëllezër, duhet të shihen në tërë kuadrin që thashë; Partia dhe shteti ynë i diktaturës së proletariatit me këto që bëjnë, kryejnë njëkohësisht edhe një detyrë të lartë internacionaliste ndaj shokëve e vëllezërve në vendet e tjera, që luftojnë në kushte jashtëzakonisht të vështira të terrorit dhe të shtypjes kapitaliste dhe revizioniste.

Në Bashkimin Sovjetik, ku sundojnë tradhtarët revizionistë hrushovianë, ka shpërthyer një terror i madh dhe si atje, ashtu edhe në vendet e tjera revizio-

niste burgjet janë mbushur plot. Shokët revolucionarë po i burgosin, po i vrasin për të vetmen arsye se ata rezistojnë kundër tradhtisë revizioniste hrushoviane. Por revizionistët nuk do ta thyejnë dot kurrë rezistencën e marksistë-leninistëve dhe sado që përpiqen t'i fshehin masat shtypëse që ushtrojnë kundër tyre, ato përsëri merren vesh, dalin në shesh. Në Bashkimin Sovjetik elementët revolucionarë i arrestojnë dhe i gjojnë si terroristë, se gjoja u gjejnë armë, bomba, i akuzojnë se janë të lidhur me organizata revolucionare.

Lëvizja revolucionare e popujve dhe e komunistëve në botë është në ngritje të pandërprerë, prandaj imperialistët janë në një krizë të madhe politike, ekonomike dhe ushtarake. Revizionistët, gjithashtu, janë në një krizë të madhe në të gjitha drejtimet. Do të flas vetëm pak dhe shkurtimisht mbi çështjet ndërkom-bëtare.

Kohët e fundit, sterlina angleze u zhvleftësua dhe me siguri ky zhvleftësim do të vazhdojë më tej. Ky fenomen ka futur në një krizë të rëndë edhe dollarin, që imperialistët amerikanë po bëjnë gjithfarë përpjekjesh për ta mbajtur gjallë, duke rritur taksat në kurriz të popullit, duke shtuar shtypjen dhe shfrytëzimin mbi masat e gjera etj. Kjo, pa dyshim, do të krijojë pakënaqësi të reja akoma më të mëdha te punonjësit e vendeve kapitaliste. Zhvleftësimi i sterlinës dhe kriza e dollarit në të ardhmen do ta tërheqin në humnerë dhe në kriza akoma më të rënda ekonominë e të gjitha vendeve të tjera kapitaliste.

Kjo krizë ekonomike në kampin e imperialistëve

po shkakton turbullira të mëdha edhe në fushën politike. NATO-ja ka pësuar e vazhdon të pësojë të çara shumë të thella. Imperialistët amerikanë përpiqen t'i futin partnerët e tyre në rrugën e shtypjes së lëvizjeve nacionalçlirimtare të popujve me luftë të armatosur, siç bëjnë ata vetë në Vietnam. Por këto përpjekje kanë gjetur kudo rezistencë. Franca, siç dihet, praktikisht doli nga NATO-ja. Kjo tregon dobësinë e madhe të kësaj organizate. Vendet e tjera anëtare duan t'i shpëtojnë diktatit amerikan, që përpiqet t'i mbajë përreth. Kjo do të thotë se një krizë e madhe politike, ushtarake dhe ekonomike është duke u rritur dhe e bren përbrenda këtë organizatë. Pra, ekonomikisht, politikisht dhe ushtarakisht në gjirin e NATO-s ka krizë, ka të çara të mëdha, që sa vijnë e po shtohen, për arsye të hovit të madh revolucionar në ngjitje të popujve. Dobësimi i përgjithshëm i shteteve kapitaliste e imperialiste vjen, pra, për shkak të ngritjes së vazhdueshme revolucionare të popujve, të zgjerimit të luftërave nacionalçlirimtare, të luftës heroike të popullit vietnamez etj.

Imperializmi amerikan ka shumë vjet që është futur në moçalin e luftës vietnameze dhe, sado që ka dërguar atje rreth 500 mijë ushtarë, nuk po del dot nga gjendja e vështirë që i ka krijuar lufta heroike popullore e vietnamezëve, prandaj po pëson humbje kolosale, ushtarake dhe politike. Politika e Xhonsnit po tronditet në të gjitha drejtimet; ajo ka shkaktuar turbullira financiare dhe ekonomike dhe një lëkundje të madhe në masat e gjera të popullit amerikan, nga radhët e të cilave janë me qindra mijë ata që shpre-

hen kundër luftës së imperialistëve amerikanë në Vietnam, bile ka shumë nga ata që guxojnë të demonstronjë deri para Shtëpisë së Bardhë. Kjo situatë ka bërë që edhe brenda radhëve të manjatëve kapitalistë amerikanë, deri në senat, të ketë kundërshtime të rrepta për shumë çështje politike. Vetëm populli Vietnamez, me luftën e tij heroike kundër imperializmit amerikan, po i shkakton këtij kolosi me këmbë prej argjili, siç ka thënë Lenini për imperializmin në përgjithësi, një krizë kolosale të pandreqshme.

Në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet ku janë në fuqi klikat revizioniste po vihet re një degjenerim i madh moral, politik dhe ekonomik. Me hapa të mëdhenj po shkohet drejt degjenerimit, sidomos të rinisë. Format e ndryshme të organizimit e të administrimit të ekonomisë, sipas formave kapitaliste, kanë krijuar në Bashkimin Sovjetik një situatë pikërisht si në Jugosllavinë e Titos. Nga ana tjetër, në fushën politike, duke ndjekur rrugën tradhtare revizioniste, Bashkimi Sovjetik nuk e ka më atë hegjemoni sundimi mbi vendet e tjera ku janë në fuqi revizionistët në Evropë dhe në Azi. Këto shtete gjithnjë e më shumë po lidhen drejtpërsëdrejti me imperialistët amerikanë, anglezë, francezë etj.

Çfarë po ndodh në Bashkimin Sovjetik pas rrëzimit të Hrushovit? Udhëheqja revizioniste, pas tij, po përpiqet të bëjë një mbledhje të përbashkët gjoja të lëvizjes komuniste ndërkombëtare për të dënuar Kinën dhe Shqipërinë. Por midis vetë udhëheqësve revizionistë të vendeve të ndryshme nuk ka unitet për këtë çështje, jo se na duan ne, por se nuk duan

të hyjnë në orbitën e hegjemonisë sovjetike. Prandaj lëkunden. Ata janë për një mbledhje sa për të thënë ndonjë fjalë, por me këtë mënyrë nuk do të arrijnë veçse një zero me bisht.

Josip Broz Titoja nuk dëgjon të shkojë në këtë mbledhje. Imperialistëve amerikanë nuk u intereson aspak mbledhja e gjithë revizionistëve, megjithëse ajo drejtohet kundër Kinës, kundër Shqipërisë, kundër marksizëm-leninizmit. Revizionistët titistë, që janë futur me kohë gjer në grykë në luftë kundër marksizëm-leninizmit, nuk duan të vihen nën frerën e Bashkimit Sovjetik, qëllimi i të cilit është t'i ketë të tërë revizionistët modernë në drejtimin e vet. Kjo gjë edhe imperialistëve amerikanë nuk u intereson. Këta duan që çdo vend revizionist t'i ketë duart të lira nga lidhjet me sovjetikët, që të mund t'i gllabërojnë më lehtë, duke e dobësuar kështu edhe vetë Bashkimin Sovjetik, për ta detyruar këtë që të ecë akoma më shpejt dhe më hapur në rrugën që duan imperialistët amerikanë. Prandaj revizionisti Tito, si agjent i vjetër i amerikanëve, ka refuzuar të vejë në këtë mbledhje dhe ka shfaqur mendimin se ajo nuk duhet bërë, ndërsa revizionistët sovjetikë i bëjnë presion që të vejë.

Shikoni çfarë situatë kanë krijuar banditët tradhtarë revizionistë. Ata nuk kanë parime. Politika e tyre antisocialiste ka ngjallur pakënaqësi të mëdha në popujt e vendeve të tyre. Ky është një proces dialektik në zhvillim e sipër. Këto pakënaqësi, pak nga pak, do të grumbullohen vazhdimisht, do të fryhen e do të fryhen dhe një ditë, më së fundi, do të pëlçasë.

Prandaj partitë dhe grupet e reja marksiste-leniniste, që janë krijuar e po krijohen, duhet të kaliten dhe ta fuqizojnë luftën e tyre kundër tradhtarëve revizionistë, që shkatërrimi i tyre të vijë sa më parë. Ne kemi për detyrë të madhe që t'i ndihmojmë popujt vëllezër që vuajnë nga shtypja revizioniste, të punojmë pa u lodhur për ta forcuar pareshtur Partinë, shtetin, ekonominë, ushtrinë tonë, t'i kemi të gatshme dhe më këmbë, t'i bëjmë akoma më të forta, më të çelikta e më të kalitura, që armiqtë të na e kenë frikën.

Fatkeqësia natyrore që u ndodhi vëllezërve tanë të Dibrës matanë kufirit, i ka vënë titistët në pozita jashtëzakonisht të vështira, sepse ndërsa këtej kufirit, në vendin tonë, ku po ndërtohet me sukses socializmi, po ngrihen 5 000 e ca shtëpi të shkatërruara e të dëmtuara brenda 20 ditëve, nga ajo anë njerëzit vuajnë jo vetëm nga dimri që ka filluar, por do të vuajnë për vite të tëra. Dje u dha urdhër nga titistët që të largohen edhe ata 200-300 specialistë që ishin dërguar, duke thënë se tani në dimër gjoja ka borë, ka ngrica, nuk mund të ndërtohet etj. Disa nga shokët e fshatrave tona kufitare që diskutuan, thanë se kanë parë vetë çfarë po ndodh matanë kufirit: asgjë nuk po bëhet për shërimin e plagëve të tërmetit, vetëm se titistët shovinistë serbë, malazezë etj. përpiqen të përfitojnë nga fatkeqësia e tërmetit për të dobësuar qëndresën e popullsisë shqiptare dhe prandaj bëjnë përpjekje të mëdha e të vazhdueshme për t'i shpërngulur dibranët në të katër anët e Jugosllavisë, me qëllim që t'i shkombëtarizojnë këto vise

shqiptare. Por ata nuk do t'ia arrijnë kurrë këtij qëllimi, sepse shqiptarët, ashtu si i kanë ruajtur gjatë shekujve të pastra brez pas brezi ndjenjat e tyre kombëtare, gjuhën, traditat luftarake dhe dashurinë e pakufishme për atdheun, edhe tani këto ndjenja i kanë aq të forta, saqë titistët e kanë kot me ato që bëjnë kundër tyre. Vëllezërit tanë të përtejkuqfirit kurrë nuk do të mposhten. Ata janë të lidhur fort me tokën e trashëguar nga të parët, me fshatrat ku kanë lindur, prandaj, me rastin e këtyre fatkeqësive, vetëm fëmijët kanë larguar andej nëpër miq në vende pak më larg, kurse të rriturit, burra e gra, pleq dhe plaka, po qëndrojnë me këmbëngulje e pa asnjë ndihmë, duke përballuar borën dhe akullin.

Megjithëse atje tërmeti shkaktoi shumë më pak dëme se te ne, revizionistët jugosllavë kanë bërë një propagandë të madhe për të zhvatur nga të katër anët e botës ndihma gjoja për viktimat e tërmetit dhe kanë vënë në lëvizje për këtë qëllim ambasadorët e tyre. Kështu, në Jugosllavi, nga organizata të vendeve të ndryshme, po dërgohen të holla, veshmbathje etj., por popullit të Dibrës nuk i arrin as një e treta, sepse shumica futet në xhepat e burokracisë titiste. Sidomos në Shkup, me rastin e tërmetit atje, janë bërë vjedhje kolosale. Vetëm një «fitim» patën vëllezërit dibranë, të dëmtuar nga tërmeti në Jugosllavi, atë që autoritetet titiste kanë marrë me këtë rast deri në 300 vendime, të cilat synojnë vetëm si e si të rregullojnë sa më mirë vjedhjen e ndihmave që u dërgohen nga jashtë të dëmtuarve nga tërmeti dhe nuk synojnë aspak për të shpëtuar popullsinë

që vuan nga kjo fatkeqësi. Populli shqiptar dhe e gjithë bota po i shikojnë këto monstruozytete që po bëhen në kurriz të popullsisë së dëmtuar.

Shoqe dhe shokë të dashur,

Të më falni që ju mbajta gjatë, prandaj në emrin e shokëve të pranishëm të Byrosë Politike, si dhe në emrin tim, ju falënderoj nga zemra për vëmendjen që treguat dhe për këtë pritje kaq të nxeh-të, vëllazërore, shoqërore, që i detyrohet vetëm Partisë sonë, jo neve si persona, pasi ne nuk jemi gjë tjetër veçse ushtarë të Partisë, ashtu sikurse jeni edhe ju. Partia, ju, na keni ngarkuar me detyra dhe me barrë të rënda, të cilat ne do të përpiqemi t'i kryejmë me nder, duke qëndruar kurdoherë në ballë të luftës për të merituar besimin e madh të Partisë, tuajin dhe të popullit dhe me këtë ne e kemi të qartë se nuk bëjmë veçse detyrën tonë si komunistë.

Çdo gjë, shoqe dhe shokë, i detyrohet Partisë, vijës së saj të drejtë, i detyrohet popullit tonë heroik, të zgjuar dhe punëtor, i detyrohet unitetit të popullit me Partinë, dashurisë së madhe për njëri-tjetrin, unitetit, pra, të vetë popullit. Kur dje më fliste fshatari Halim Piku, që kishte humbur të nipin nga tërmeti, midis të tjerave më tha se e harroi dhimbjen e djalit që iu vra sa mori vesh vdekjen e ushtarit që ra në kufi. Ç'tregon kjo? Këto janë ndjenja nga më fisniket, këto shprehin atë frymë të madhe solidariteti dhe uniteti proletar brendapërbrenda vendit tonë. Ndjenjat kaq të larta të këtij fshatari të thjeshtë dibran shprehin ndje-

njat e gjithë fshatarësisë sonë ndaj vijës së Partisë, ndaj klasës sonë punëtore, muratorëve, inxhinierëve, teknikëve e specialistëve që erdhën vullnetarisht me njëherë nga të katër anët e atdheut për të ndihmuar vëllezërit e tyre fshatarë të rretheve të Dibrës dhe të Librazhdit. Kjo tregon sa e fortë është te ne aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë kooperativiste.

Shihni ç'bëri klasa punëtore! Punëtorët u ngritën nga të katër anët dhe erdhën të ndihmojnë me të gjitha mjetet dhe zotësitë për ndërtimin e shtëpive të shokëve të tyre aleatë, fshatarë të dëmtuar, të Dibrës e të Librazhdit. Shoferët tanë heroikë, në borë e në akull, por me zjarrin e Partisë në zemër, çajnë ditë e natë rrugët, herë fjetur e herë pa fjetur, herë me bukë e herë pa bukë, drejtojnë makinat për të sjellë këtu lëndët e nevojshme të ndërtimit që ka caktuar Partia për të ndihmuar për ngritjen e shtëpive, pasi mendojnë për vëllezërit e dëmtuar, mendojnë që gratë e fëmijët dibranë e librazhdas të futen sa më parë në banesat e reja e të ngrohta. Lavdi shoferëve tanë heroikë! Është, gjithashtu, për t'u përmendur lidhja e ngushtë e fshatarëve të këtyre dy rretheve me ushtrinë, me forcat e kufirit, me gjithë rininë e vendit tonë. Shikoni si është pleksur vija e Partisë sonë dhe me ç'nyje të forta është çelikosur uniteti i popullit në mes tij dhe me Partinë. Prandaj them që çdo gjë u detyrohet Partisë dhe popullit, kurse ne jemi vetëm ushtarë besnikë gjer në vdekje të Partisë dhe të pushtetit tonë, të diktaturës së proletariatit.

Edhe një herë ju lutem që, në emrin e shokëve dhe timin, t'i transmetoni popullit të rretheve tuaja,

kudo që do të shkoni, përshëndetjet më të nxehta të Partisë, të Qeverisë dhe tonat, i thoni atij se Partia është e popullit, siç ka qenë gjithmonë, dhe ajo do të jetë kurdoherë me të deri në fund. Çdo gjë që bën Partia, çdo vendim që merr, ka për qëllim vetëm të mirën e popullit, prandaj le të kalitim me luftë akoma më tej këtë unitet të çeliktë Parti-popull.

Rroftë Partia!

Rroftë populli i Dibrës!

Rroftë populli i Librazhdit!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 305 (6030), 21 dhjetor 1967

Botohet me ndonjë shkurtim sipas librit: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1967-1968», f. 264. Tiranë, 1969

LETËR DREJTUAR FAMILJES SË TOSUN SHAHINASIT

21 dhjetor 1967

E dashur nënë Shaqe,

E dashur motër Anife,

Të dashur shokë e vëllezër të të paharruarit Tosun Shahinasi,

Në vrullin e solidaritetit të madh revolucionar që shprehu gjithë populli ynë për të ndihmuar motrat dhe vëllezërit e Librazhdit e të Dibrës që u dëmtuan nga tërmeti, djali juaj Tosuni, nënë Shaqe, dhe bashkëshorti juaj, shoqja Anife, bir besnik i popullit, patriot e revolucionar i vendosur për çështjen e Partisë, i dashur dhe i shtrenjtë për familjen tuaj dhe për të gjithë, shkoi nga të parët në Librazhd, ku punoi me vetëmohim, duke mos kursyer asgjë, gjersa në punë e sipër dha edhe jetën. Një ndjenjë e fortë hidhërimi përshkoi të madh e të vogël, anembanë Shqipërisë, prandaj në këto çaste të vështira dhe i prekur thellë nga kjo humbje e rëndë për familjen, për shokët e kolektivit ku punonte dhe për të gjithë, ju dërgoj ngushëllimet e mia më të përzemërta.

Familja juaj është një familje me tradita patriotike, pjesëtarët e saj janë gjakosur me armiqtë e at-

dheut qysh përpara kundër shovinistëve grekë dhe gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, në të cilën morën pjesë aktive me armë në dorë. Sakrifica e Tosunit është një akt tjetër i lartë patriotik e revolucionar në vargun e pambaruar të heroizmave të popullit tonë trim e legjendar.

Rënia e Tosunit në krye të detyrës do të bëhet një tjetër shembull i lartë frymëzimi dhe do t'i ndezë më shumë zemrat e fshatarëve tanë patriotë, të klasës sonë heroike punëtore, të ushtarëve trima të Shqipërisë, të grave e të rinisë sonë, do të bëjë që të vlojë te të gjithë, akoma më tepër, dinamizmi revolucionar për çështjen e madhe të Partisë e të popullit.

Ti, e dashur nënë Shaqe, me kurajën dhe qëndrimin tënd të papërkulur përpara humbjes së djalit, na kujton nënat heroike shqiptare, që historia i përmend me respekt për trimërinë, urtësinë dhe papërkulshmërinë e tyre. Ti linde dhe edukove kaq fëmijë, që u bënë partizanë dhe më pas punëtorë e kooperativistë të dalluar, si Tosuni, oficerë guximtarë të ushtrisë sonë, i edukove ata me traditat patriotike të familjes dhe të popullit tonë, që po zhvillohen çdo ditë më lart nga Partia.

Ti, e respektuar motër Anife, bashkëshortja e Tosunit, ashtu si nëna e tij, nuk e qatë shokun tuaj të jetës, por, si një trimëreshë, krah për krah vëllezërve, kushërinjve e miqve të tij, pa u përkulur aspak para ngjarjes së hidhur, shkuat menjëherë për të vazhduar gjer në fund punën e tij të lavdishme ndërtime në rrethin e Librazhdit. Ky akt i lartë patriotik e revolucionar do të mbetet në historinë e lavdi-

shme të gruas shqiptare si një shembull i lartë frymëzimi për gratë dhe vajzat e vendit tonë, për gjithë popullin tonë. për t'u hedhur me forca dhe energji të shumëfishuara në punë, në luftë, në revolucion, me një vrull akoma më të madh.

Një epokë heroike po jeton sot populli shqiptar. Mrekulli të papara po bëhen në Shqipëri. Njerëzit punojnë e luftojnë për ndërtimin e socializmit. Disa edhe bien në fushën e nderit, por me dhjetëra, me qindra, me mijëra ngrihen. Gjithë populli është sot më këmbë dhe, nën udhëheqjen e sigurt të Partisë, po korr fitore pas fitoresh, sepse të gjithë, të bashkuar si një trup i vetëm, kanë një ideal të madh të për-bashkët, lirinë dhe pavarësinë e atdheut, ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit në vendin tonë, lumturinë e këtij populli heroik, prandaj s'ka pengesa, s'ka vështirësi, s'ka e s'do të ketë asnjë fatkeqësi e hidhërim që do të na ndalë në rrugën tonë. Provë për këtë është edhe shembulli i lartë patriotik i familjes suaj.

Më lejoni, të dashura mëmë Shaqe, motër Anife, ju pjesëtarët e familjes dhe shokë e miq të Tosunit që shkuat të kryeni atë detyrë që ai s'arriti ta çojë gjer në fund, t'ju dërgoj njëkohësisht përshëndetjet e mia revolucionare dhe t'ju uroj të gjithëve shëndet, punë të mbarë e dalshi faqebardhë!

Juaji

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 306 (6031), 22 dhjetor 1967

Botohet sipas gazetës «Zëri i popullit», nr. 306 (6031), 22 dhjetor 1967

PËRSE UDHËHEQJA REVIZIONISTE SOVJETIKE NGUL KËMBË PËR MBLEDHJEN NDËRKOMBËTARE

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

26 dhjetor 1967

Pas shpalljes mbi thirrjen e «takimit konsultativ» të revizionistëve në Budapest, udhëheqja sovjetike po bën një zhurmë të madhe propagandistike rreth të ashtuquajturës mbledhje ndërkombëtare të partive komuniste e punëtore.

Kuptohet se udhëheqja sovjetike vazhdon të ngulë këmbë për thirrjen e mbledhjes jo nga e mira. Ajo shpreson se, me anën e saj, do të dalë ose të paktën do të lehtësohet nga vështirësitë e mëdha të brendshme e të jashtme në të cilat ndodhet dhe do të arrijë disa nga qëllimet e veta kundërrevolucionare në lëvizjen komuniste botërore.

Vështirësia kryesore dhe më e thellë për udhëheqjen e sotme sovjetike qëndron në faktin që, si rezultat i luftës parimore të hapët e të pamëshirshme të partive marksiste-leniniste, u demaskua në sytë e popullit sovjetik e të popujve të tjerë vija antimarksiste, antisocialiste, kundërrevolucionare e proimperialiste, që ka ndjekur e ndjek ajo në të gjitha fushat.

Parullat demagogjike të «ndërtimit të komunizmit» në Bashkimin Sovjetik, apo të «ndërtimit të socializmit» në vendet e tjera revizioniste nuk po pinë më ujë. Populli sovjetik dhe popujt e tjerë po e shohin se vendin e socializmit dhe të komunizmit tek ata e kanë zënë tani proceset e restaurimit kapitalist në ekonomi dhe të degjenerimit borgjez në tërë jetën shoqërore. Fitimi kapitalist është bërë strumbullari kryesor i gjithë jetës së tyre, duke helmuar ndërgjegjen e njerëzve me egoizmin dhe individualizmin borgjez, duke i shtyrë ata të rendin pas pasurimit me çdo mjet e në çdo rrugë. Decentralizimi revizionist i drejtimit të ekonomisë, zgjerimi i parcelave personale në dëm të ekonomisë kolektive në bujqësi dhe «reforma» të tjera të këtij lloji kanë çuar e çojnë në minimin e pronës socialiste dhe në gjallërimin e në lulëzimin e pronës private kapitaliste. Po shkohet gjithnjë më tej në rrugën e përfshirjes së ekonomisë së vendeve revizioniste në ingranazhet e ekonomisë kapitaliste botërore, në rrugën e integritit të socializmit në kapitalizëm, të predikuar nga renegati Tito. Kapitalet franceze, italiane, gjermanoperëndimore, japoneze e të tjera po depërtojnë gjithnjë e më lehtë në ekonominë e vendeve revizioniste.

Si një murtajë e zezë po përhapet në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera revizioniste degjenerimi borgjez, i cili po pushton gjithë jetën e tyre shpirtërore. Mënyra perëndimore e jetesës, veshja perëndimore, vallet dhe muzika borgjeze, arti decadent perëndimor po rrënjosen me të gjitha mjetet dhe mënyrat nga klika revizioniste, sidomos në bre-

zin e ri, për ta korruptuar atë. Po hiqet dorë gjithnjë e më hapur nga traditat dhe idealet e lavdishme të Revolucionit të Tetorit, që frymëzonin njerëzit në periudhën e Leninit e të Stalinit për luftë dhe për punë vetëmohuese në shërbim të çështjes së revolucionit e të socializmit. Në vend të tyre klikat revizioniste predikojnë ideale të tjera «më praktike e reale» — apolitizmin, rendjen pas interesit personal, pas jetës së lehtë, privilegjeve e dëfrimeve, pacifizmin, humanizmin borgjez e vëllazërimin kristian. Diferencat midis aristokracisë së re borgjeze sovjetike dhe masave të gjera popullore po bëhen përditë e më të mëdha. Ato shprehen tani jo vetëm në pasurimin e madh të shtresës borgjeze, por edhe në shtypjen ekonomike dhe në represionin politik që ajo ushtron për të ruajtur privilegjet e saj.

Kuptohet se atje ku ka shtypje e persekutime do të ketë edhe rezistencë, edhe luftë. Me gjithë censurën e rreptë që ekziston, në shtypin revizionist dhe në atë perëndimor janë dukur tani së fundi lajme, që bëjnë fjalë për demonstrata politike të studentëve, që kundërshtojnë politikën represive të qeverive revizioniste, për greva punëtorësh, që kërkojnë sigurimin e të drejtave të tyre dhe, më në fund, për disa gjyqe të mbyllura, që janë zhvilluar në Bashkimin Sovjetik kundër disa grupeve të armatosura, që, siç thonë ata, kanë luftuar «për përmbysjen e pushtetit» që sundon sot atje.

Pavarësisht nga shkalla e organizimit, e ndërjegjes dhe e madhësisë së tyre, këto përpjekje tregojnë se politika e brendshme e falimentuar e revii-

zionistëve sovjetikë dhe e pasuesve të tyre po çon me shpejtësi drejt përlëshjeve të pashmangshme midis masave popullore dhe klikave sunduese revizioniste.

Jo më pak e vështirë dhe pa rrugëdalje për udhëheqjen revizioniste sovjetike paraqitet gjendja dhe në zbatimin e politikës së saj të jashtme tradhtare. Tanimë i ka dalë boja demagogjisë së saj të «antiimperializmit». Bashkëpunimi gjithnjë e më i ngushtë e më kriminal i saj me armikun më të tërbuar të popujve — imperializmin amerikan — dhe me imperialistët e reaksionarët e tjerë, tradhtia e saj e madhe ndaj popujve liridashës dhe vendeve socialiste tani nuk mund të mbulohet më me disa parulla bajate. Popujt kanë mësuar dhe po mësojnë gjithnjë e më mirë të gjykojnë jo nga fjalët e revizionistëve, por nga veprat e tyre. Udhëheqja sovjetike në çdo moment krize, me qëndrimet dhe me veprimet e saj kapitulluese e tradhtare, ka marrë kurdoherë anën e imperializmit. Peshën e kësaj tradhtie e kanë ndier mbi kurrizin e tyre popujt e Kongos, të Vietnamit e të vendeve arabe, Kuba dhe Republika Demokratike Gjermane, si dhe mjaft popuj e vende të tjera, pa përmendur këtu komplotet e përbashkëta të revizionistëve hrushovianë me imperialistët dhe forcat reaksionare më të tërbuara kundër Kinës e Shqipërisë.

Kjo vijë tradhtare e udhëheqjes revizioniste sovjetike dhe e përkrahësve të saj nuk mund të mos çonte në lindjen dhe në acarimin e vazhdueshëm të kontradiktave të klikave revizioniste, jo vetëm me partitë marksiste-leniniste, por edhe me popullin so-

vjetik dhe me popujt e tjerë. Përditë e më shumë po rriten dyshimi, pakënaqësia dhe rezistenca e revolucionarëve të vërtetë, e punonjësve të vendeve revizioniste dhe e gjithë popujve ndaj veprimtarisë antimarksiste e kundërrevolucionare të klikës revizioniste sovjetike e të bashkëpunëtorëve të saj në arenën ndërkombëtare. Aleanca sovjeto-amerikane për ndarjen e zonave të influencës dhe sundimin e botës është tanimë një fakt që duket sheshit. Por, duke kërcënuar me synimet e saj ekspansioniste e skllavëruese interesat jetikë të të gjithë popujve të botës, kundër saj nuk mund të mos ngrihen të gjithë ata që luftojnë për lirinë dhe pavarësinë e popujve, të gjithë ata që urrejnë imperializmin dhe nuk e durojnë skllavërinë. Dhe këta nuk janë pak. Këta janë qindra e qindra milionë në të gjitha kontinentet, janë popuj të tërë, të cilët hedhin poshtë me vendosmëri pazarllëqet e ndyra imperialisto-revizioniste në kurriz të tyre.

Në të gjitha vendet ku udhëheqjet revizioniste i kanë degjeneruar e i kanë likuiduar partitë proletare, duke përfshirë edhe vendet e sunduara nga revizionistët, janë krijuar e po krijohen parti e organizata të reja marksiste-leniniste, që po rritin ditaditës shkallën e organizimit dhe luftën e tyre kundër tradhtisë revizioniste, po i forcojnë lidhjet me masat dhe po ngrenë me guxim flamurin e revolucionit.

Të gjitha këto i tmerrojnë për vdekje klikat revizioniste. Prandaj udhëheqja sovjetike, për të dalë nga kjo situatë e rëndë dhe shumë e vështirë, me gjithë disfatat e mëparshme, var shpresa të mëdha te një

mbledhje ndërkombëtare e të ashtuquajturave parti komuniste e punëtoze.

Mbledhja e «forumit komunist ndërkombëtar» i duhet asaj për të gënjyer popullin sovjetik e popujt e tjerë, për t'u thënë atyre se ja, kursi i saj revizionist e tradhtar është një «vijë e vërtetë marksiste-leniniste», që e ka aprovuar edhe një «forum i madh komunist» ndërkombëtar. Me këtë «çertifikatë mirësjelljeje» ajo do pastaj të justifikojë brenda vendit represionet ndaj atyre që kundërshtojnë politikën e saj antimarksiste e tradhtare, që luftojnë për përmbysjen e saj dhe kthimin e Bashkimit Sovjetik në rrugën e drejtë, të diktuar nga Lenini e Stalini.

Udhëheqësit renegatë sovjetikë kërkojnë të përgatitin kështu terrenin dhe të sigurojnë përkrahjen e frontit revizionist ndërkombëtar për hapat e mëtejshëm tradhtarë që po ndërmarrin e që kanë ndër mend të ndërmarrin në të ardhmen, qoftë në drejtim të restaurimit kapitalist brenda vendit, qoftë për zgjerimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me imperializmin amerikan, për sabotimin e luftës çlirimtare të popullit vietnamez e të popujve të tjerë lirishtës, për integrimin e socializmit në kapitalizëm etj.

Duke aprovuar në fund të mbledhjes ndonjë «komunikatë të përbashkët», ndonjë «deklaratë» apo ndonjë dokument tjetër të këtij lloji, ata dëshirojnë të krekosen pastaj dhe të reklamojnë, se gjoja solidariteti, uniteti dhe ndihma reciproke në mes revizionistëve qëndrojnë «të forta» jo vetëm midis partive, por edhe midis shteteve, se lidhjet e tyre kanë bërë një «hap të ri» drejt forcimit të mëtejshëm.

Nga një rreshtim i tillë i gënjeshtërt dhe mashtrues i qëllimeve dhe i synimeve të «mbledhjes së Budapestit», udhëheqësit revizionistë kërkojnë të arrijnë pastaj në disa objektiva edhe më të mëdhenj, që kapin fushën e gjerë të luftës që zhvillohet sot në botë midis forcave të shëndosha marksiste-leniniste dhe revizionizmit modern, midis revolucionit e kundërrevolucionit.

Ata do të përpiqen në Budapest të ligjërojnë se «orientimet që do të japin aty janë orientim i përgjithshëm për lëvizjen komuniste botërore, i sanksionuar gjoja në një mbledhje të të gjitha partive komuniste dhe punëtore të botës». Me një dokument të tillë ndërkombëtar gjoja marksist-leninist, sipas tyre, ata jo vetëm do të mund të mashtrojnë popujt e të fshehin para tyre tradhtinë e madhe që po bëjnë, por, nga ana tjetër, do të heqin qafe edhe deklaratat e Moskës të viteve 1957 e 1960, të cilat janë një pengesë në rrugën e tyre antimarksiste e kundërrevolucionare.

Mbledhja ndërkombëtare i duhet udhëheqjes revizioniste sovjetike, gjithashtu, për të inskenuar «dënimin ndërkombëtar» të partive marksiste-leniniste, «për t'i izoluar» ato, për të frenuar procesin e rritjes e të zhvillimit të lëvizjes revolucionare marksiste-leniniste në botë. Sigurimet e disa udhëheqjeve revizioniste se mbledhja nuk ka gjoja qëllim të dënojë asnjë parti, janë një blufë trashë. Por sido që të vejë puna, nëse udhëheqja sovjetike do të mundë ose jo të sigurojë përkrahjen e nevojshme të grupeve të tjera revizioniste për një sulm të hapët

kundër partive të vërteta marksiste-leniniste, kjo nuk e ndryshon aspak thelbin e çështjes. Sepse nuk ka rëndësi parimore nëse mbledhja revizioniste do t'i sulmojë drejtpërdrejt apo tërthorazi partitë marksiste-leniniste, duke u kundërvënë atyre, pa i përmendur, vijën revizioniste si vijë gjoja të të gjithë lëvizjes komuniste botërore. Kjo ka të bëjë vetëm e vetëm me taktikën që do të gjykohet më e përshtatshme të ndiqet, ndërsa thelbi, qëllimi, mbetet po ai: përpjekja për të izoluar partitë marksiste-leniniste, për të ndalur procesin e zhvillimit të lëvizjes marksiste-leniniste, për të mbytur e për të shuar luftën e tyre parimore kundër tradhtisë revizioniste.

Demaskimi i plotë i tradhtisë së tyre të madhe ndaj marksizëm-leninizmit nga Partia e Punës e Shqipërisë dhe nga partitë e tjera marksiste-leniniste përbën atë darë të fuqishme, që i ka zënë për gryke revizionistët dhe nuk i lëshon. Partia e Punës e Shqipërisë dhe partitë e tjera marksiste-leniniste janë armiqtë kryesorë të revizionistëve, janë ato forca që, me luftën e tyre parimore e konsekuente, kanë nxjerrë në shesh dhe kanë demaskuar pa mëshirë tradhtinë revizioniste, që u kanë prishur dhe u prishin planet e tyre tradhtare, që u kanë shkatërruar manovrat e tyre demagogjike e mashtruese. Lufta e forcave të shëndosha marksiste-leniniste ka bërë që revizionistët të mos i zërë gjumi as natën, as ditën. Prandaj edhe në Budapest, si në çdo rast, udhëheqësit sovjetikë do të mundohen patjetër që shigjetat e tyre helmuese t'i drejtojnë kundër partive marksiste-leniniste, pavarësisht se nga shkaku i kontradiktave të

brendshme të frontit revizionist dhe nga frika e demaskimit të mëtejshëm përpara opinionit publik botëror mund të përpiqen që ato t'i mbulojnë me ndonjë cipë sheqeri.

Por klika revizioniste sovjetike dhe përkrahësit e saj i bëjnë hesapet pa hanxhinë dhe ngushëllojnë veten me iluzione. Sido që të përpiqen, ata nuk do të mundin kurrë, as të shesin mallin e tyre revizionist nën etiketa marksiste, qoftë edhe të vulosura nga «forumi komunist ndërkombëtar», as të izolojnë PPSH dhe partitë e tjera marksiste-leniniste, as të ndalin procesin e pandalshëm të rritjes dhe të forcimit të parështur të lëvizjes marksiste-leniniste në botë. Jeta po u tregon çdo ditë e më qartë popujve se e vetmja vijë e vërtetë marksiste-leniniste është ajo që mbrojnë Partia e Punës e Shqipërisë dhe partitë e tjera marksiste-leniniste, është vija e luftës revolucionare për përmbysjen e borgjezisë dhe vendosjen e diktaturës së proletariatit, vija e luftës së klasave për eliminimin e rrezikut të revizionizmit dhe të restaurimit të kapitalizmit, për të çuar deri në fund ndërtimin e shoqërisë socialiste e komuniste. Ajo është vija e luftës së paepur, thikë më thikë, kundër imperializmit dhe revizionizmit modern, kundër kokës së tyre, imperializmit amerikan dhe udhëheqjes revizioniste sovjetike, vija e përkrahjes pa rezerva të lëvizjeve revolucionare e çlirimtare të popujve. Kjo vijë revolucionare po pushton çdo ditë e më tepër mendjet e punonjësve dhe të popujve në mbarë botën. Dëshmia më e qartë për këtë është hovi gjithnjë në rritje i luftës revolucionare të punonjësve e të popujve

në kontinente të tëra, të cilën nuk mund ta mbytin e ta shuajnë as agresionet e shtypja e egër e imperialistëve dhe as demagogjia e manovrat mashtruese të renegatëve revizionistë.

Partia e Punës e Shqipërisë dhe partitë e vërteta marksiste-leniniste, me qëndrimin e tyre të guximshëm në mbrojtjen e marksizëm-leninizmit dhe me demaskimin e tradhtisë revizioniste, janë bërë pishtarë të luftës revolucionare në botë. Rreth tyre militojnë sot një numër i konsiderueshëm marksistë-leninistësh, që shtohen kudo, që organizohen në parti të reja dhe që fuqizojnë rezistencën, luftën kundër borgjezisë, që demaskojnë revizionistët modernë kudo që janë në çdo veprim të tyre tradhtar. Duke goditur partitë marksiste-leniniste, revizionistët duan pikërisht të shuajnë këtë luftë revolucionare, të sanksionojnë vijën oportuniste dhe sundimin e tyre në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Por, sado propagandë dhe manovra mashtruese që të bëjnë revizionistët, vija marksiste-leniniste është ajo që frymëzon e do të frymëzojë komunizmin ndërkombëtar, që demaskon dhe do të demaskojë revizionizmin modern në të gjitha çështjet.

Thirrja e mbledhjes së Budapestit është e lidhur edhe me gjendjen e rëndë që ekziston në frontin revizionist, në marrëdhëniet reciproke midis grupimeve të ndryshme revizioniste.

Hegjemonia sovjetike në frontin revizionist është tronditur shumë dhe sado përpjekje që të bëjnë udhëheqësit tradhtarë të Bashkimit Sovjetik, ata nuk mund t'i mbyllin të çarat e mëdha të barkës së tyre

që po mbytet. Sot nuk bëhet më fjalë për disa tendenca mosbindjeje të grupeve të ndryshme revizioniste ndaj qëndrimeve të veçanta politike të udhëheqjes sovjetike, për disa shfaqje, qoftë edhe të theksuara, nacionaliste e partikulariste, po për një luftë të ashpër e të gjithanshme që zhvillon secili kundër të tjerëve për t'u imponuar atyre zgjidhjet e veta politike, interesat e ngushtë nacionalë, për t'i marrë tjetrit gjithçka dhe për të mos i dhënë asgjë.

Grindjet dhe përleshjet e rënda që po e brejnë dhe po e degjenerojnë gjithnjë e më shumë frontin revizionist, krerët revizionistë mundohen t'i justifikojnë duke pretenduar se qëndrimet dhe vlerësimet e ndryshme politike, kontradiktat dhe mungesa e koordinimit të veprimit, lufta për epërsi e influencë që ata zhvillojnë midis tyre, qenkan gjoja shprehje të kushteve konkrete ekonomike e kombëtare të terrenit, ku vepron secila parti, të niveleve jo të barabarta politike e ideologjike të tyre, janë gjoja shprehje të lirisë dhe të pavarësisë, që ka secila parti në formulimin e politikës së vet, të barazisë dhe të demokracisë, që gjoja ekziston në marrëdhëniet midis tyre etj.

Por me të tillë sofizma nuk mund të shpërndalet era e keqe, që del nga shturja, degjenerimi dhe kalbëzimi i pandalshëm i sistemit revizionist. Shkaqet e vërteta të këtyre fenomeneve të shëmtuara qëndrojnë kryesisht dhe tërësisht në tradhtinë e madhe që klikat revizioniste u kanë bërë marksizëm-leninizmit dhe lëvizjes komuniste ndërkombëtare, qëndrojnë në vijën tradhtarë të restaurimit të kapitalizmit në Ba-

shkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera, ku janë në fuqi revizionistët, qëndrojnë në kthesën oportuniste të disa partive komuniste drejt socialdemokracisë dhe transformimit të tyre në një bisht të borgjezisë së madhe monopoliste. Praktika e këtyre viteve të fundit ka treguar se midis thellimit të proceseve të largimit nga marksizëm-leninizmi dhe shtimit të divergjencave, kontradiktave e grindjeve midis partive e shteteve revizioniste ekziston një proporcion i drejtë, i cili sa vete e po bëhet gjithnjë më i madh.

Pasqyrë e rënies dhe e gjendjes së rëndë që ekzistojnë në marrëdhëniet midis partive revizioniste dhe në tërë frontin revizionist është vetë fushata për thirrjen e mbledhjes së Budapestit. Ajo zhvillohet në ethe, në një atmosferë pasigurie dhe hutimi. Mbi iniciatorët e saj qëndron pesha e rëndë e frikës së dështimit, e rrugëve kryq dhe e shumë të panjohurave. Me gjithë vendimin dhe thirrjen e 18 partive për takimin konsultativ në Budapest, jo të gjithë revizionistët u treguan të gatshëm të marrin pjesë. Disa nga këta lëkunden të shkojnë në Budapest, disa përpiqen të gjejnë ndonjë mënyrë për t'i bërë bisht, disa refuzojnë të marrin pjesë e kështu me radhë. Kuptohet se shkak i këtyre lëkundjeve, ngurrimeve e refuzimeve nuk ka të bëjë me ndonjë çështje parimore, ose pse ata janë më pak revizionistë se të tjerët. Në radhë të parë, ata nisen nga interesat e tyre të ngushtë nacionalë dhe duan të ruajnë në këtë drejtim lirinë më të madhe të veprimit në të ardhmen; në radhë të dytë, atyre nuk u pëlqen aspak të bëhen një vegël e thjeshtë e lojërave dhe e manovrave politike të

udhëheqësve sovjetikë, gurë shahu të politikës shoviniste të Brezhnjev it e të Kosiginit. Ata nuk janë aq naivë sa të mos kuptojnë se mbledhja që kërkojnë të bëjnë sovjetikët është një mbledhje për të nënshtruar dhe për të mbajtur në zap të tjerët.

Tanimë është e qartë se udhëheqësit sovjetikë luftojnë për një mbledhje të përgjithshme të partive revizioniste për të forcuar pozitat e tyre revizioniste, për t'u diktuar dhe për t'u imponuar të tjerëve disa qëndrime të caktuara në favor të tyre. Me anë të kësaj mbledhjeje ata duan të bëjnë që, mundësisht, shkarja e plotë e revizionistëve të ndryshëm në prehrin e kapitalizmit të mos zhvillohet me një vrull të tillë të papërmbajtur saqë të bëhet shumë diskredituese dhe demaskuese. Atyre u pëlqen që kjo shkarje të jetë e drejtuar nga vetë ata, që ata ta shpejtojnë, ose ta frenojnë sipas nevojave dhe interesave të koniunkturave të ndryshme politike. Udhëheqësit sovjetikë dëshirojnë që mbledhja të organizojë një shkarje më të rregullt, për të krijuar mendimin e rremë se ky është një «proces normal paqësor», në përputhje gjoja me «zhvillimin e mëtejshëm të marksizëm-leninizmit», një proces që gjoja imponohet nga «analiza reale» e zhvillimit aktual të forcave në arenën botërore.

Por nëse këto janë qëllimet dhe dëshirat e udhëheqësve sovjetikë, ndryshe janë ato të partive të tjera.

Çështja e thirrjes së një mbledhje ndërkombëtare të partive ka një histori të gjatë, plot disfata e deziluzione për klikën udhëheqëse sovjetike dhe është një pasqyrë shumë e qartë e përçarjes së thellë e të pandreqshme të frontit revizionist. Vendimi për të bë-

rë të ashtuquajturin «takim konsultativ» të Budapes- tit nuk ka zhdukur e nuk mund të zhdukë vështirë- sitë për thirrjen e mbledhjes ndërkombëtare të parti- ve, gjë për të cilën flet edhe eksperiencia e hidhur e takimit famëkeq të dështuar të 1 marsit 1965 dhe e atij të Karlovi-Varit në prill 1967. Partnerët revizio- nistë të udhëheqjes sovjetike vazhdojnë të shfaqin dy- shime e ngurrime për pjesëmarrjen në një mbledhje të tillë, për mënyrën e përgatitjes së saj, për çështjet që do të diskutohen në të dhe për rezultatet që do të ketë ajo, sepse ata nuk duan kurrsesi t'i nënshtrohen diktatit shovinist të udhëheqjes sovjetike, nuk duan t'u nënshtrohen asnjë lloj vendimi e asnjë lloj disipline, qofshin këto edhe mbi bazat e vijës revizioniste. Në stanin revizionist, të bazuar në marrëdhëniet e na- cionalizmit borgjez, nuk mund të ketë unitet e kom- paktësi të shëndoshë e të qëndrueshme, përkundrazi, kontradiktat, grindjet dhe tendencat centrifugale the- llohen dita-ditës më tej.

Shumë nga këto grupe revizioniste nuk dëshirojnë më të jenë të varura nga kapriçiot e politikës sovjetike, nga koniunkturat e komplikuar që ajo krijon për inte- resat e saj. Mjafton të përmendim këtu konfuzionin dhe divergjencat që kanë lindur në vendet revizioniste në lidhje me qëndrimin ndaj RF të Gjermanisë, për të kuptuar se sa e thellë është tani mosbindja ndaj shkopit të dirigjentit në Moskë. Ndonjë tanimë ka ve- ndosur marrëdhënie diplomatike, disa ndodhen akoma në fazën e misioneve tregtare e konsullore, të tjerë presin vetëm momentin oportun. Krerët revizionistë, që kërkojnë ta ruajnë RD Gjermane si një plaçkë shkë-

mbimi në kombinacionet e tyre të mëdha me amerikanët dhe me borgjezinë monopoliste perëndimore, kanë ushtruar mjaft presione, por asnjë s'i ka dëgjuar. Për më tepër, afrimi dhe lidhja e vendeve revizioniste të Evropës me Republikën Federale të Gjermanisë u shpreh si një masë që synon t'i lehtësojë ato nga pesha e hegjemonisë sovjetike, ashtu si, përgjithësisht, lidhjet e tyre me Perëndimin, përveç të tjerave, morën formën e një presioni mbi Bashkimin Sovjetik për të liruar vidhat në Traktatin e Varshavës dhe në Këshillin e Ndihmës Ekonomike Reciproke.

Gjendja në lidhje me qëndrimin ndaj konfliktit arabo-izraelit nuk është më e mirë. Shumë mbledhje janë bërë për ta koordinuar këtë, por, me sa duket, jo të gjithë janë të gatshëm të përkrahin politikën e vjetër cariste të udhëheqësve të sotëm sovjetikë në Lindjen e Afërt e të Mesme.

Mund të përmendim këtu divergjencat që kanë lindur në frontin revizionist në lidhje me politikën monopoliste që ndjek Bashkimi Sovjetik në KNER, mbi kontradiktat në lidhje me marrëveshjet tregtare e pagesat, strategjinë e përgjithshme të Traktatit të Varshavës dhe raportet e ushtrive dhe të komandave të shteteve anëtare etj. Por këto do të përbënin një kapitull më vete. E rëndësishme është se në mbledhjen e Budapestit apo në çdo mbledhje tjetër revizioniste hija e errët e tyre do të sundojë kurdoherë. Formulimet «e mëdha teorike» kanë shumë pak vlerë, kur nuk janë zgjidhur çështje të tilla «të vogla» praktike.

Një faktor tjetër i rëndësishëm, që i nxit dhe i forcon tendencat centrifugale të revizionistëve hru-shovianë është, pa dyshim, edhe presioni i vazhdueshëm e gjithnjë më i madh i borgjezisë dhe i imperializmit, që luftojnë me këmbëngulje për një shkëputje sa më të shpejtë e më të plotë të vendeve ku sundojnë revizionistët, nga influenza sovjetike. Jo më kot Xhonsoni ndërton «urat» e tij me Evropën Lindore, ashtu si jo më kot monopolet e Gjermanisë Perëndimore, të Anglisë, të Francës, të Italisë etj. janë bërë dorëlëshuara në kreditë që u japin, ose në kapitalët që investojnë drejtpërsëdrejti në ekonominë e tyre. Dhe kuptohet se një nga «ndihmat» kryesore, që imperializmi u jep vendeve revizioniste, është edhe ajo për t'i larguar nga Bashkimi Sovjetik dhe për t'i lidhur pas qerres së tij. Manovrat që zhvillon tani Titoja, ky agent i vjetër i imperializmit amerikan, kundër mbledhjes së Budapestit nën parullat e «pavarësisë», «mosnënshtrimit» etj. janë vazhdim i politikës së tij të vjetër për t'i shkëputur partitë e Evropës Lindore nga influenza e Bashkimit Sovjetik dhe, bashkë me të, të kalojnë përfundimisht në Perëndim. Shtetet imperialiste punojnë që mbledhja e projektuar e partive revizioniste të ketë sukses, por në drejtimin që u intereson atyre, domethënë për dobësimin e hegjemonisë sovjetike mbi këto parti, për dobësimin e ndihmës formale që i jepet Vietnamit. Ato punojnë që kjo ndihmë për Vietnamin ose për luftërat nacionalçlirimtare të popujve të tjerë të jetë ashtu siç është sot, ndihmë me fjalë dhe sabotim me vepra, dhe për më tepër, të forcohet lufta kundër Shqi-

përisë dhe forcave të tjera marksiste-leniniste, të shtohen mundësisht më shumë mosmarrëveshjet e revizionistëve të tjerë me sovjetikët.

Më në fund, duhet mbajtur parasysh edhe frika që ndiejnë shumë parti e grupe revizioniste nga qëllimi i udhëheqësve sovjetikë, që nëpërmjet një «mbledhjeje të përgjithshme», të «skomunikojnë» Kinën e Shqipërinë. Ato e ndiejnë në palcë se një hap i tillë do t'u shtonte atyre vështirësitë e brendshme, do të demaskonte edhe më keq vijën tradhtarë e antimarksiste, do të rriste edhe më shumë pakënaqësinë e masave ndaj veprimeve të tilla të turpshme, do të rriste, më në fund, luftën e forcave të shëndosha marksiste-leniniste dhe do ta afronte edhe më tepër kohën e përmbysjes së tyre.

Tipike të lëkundjeve, të ngurrimeve dhe të frikës nga mbledhja, që kërkojnë të bëjnë udhëheqësit sovjetikë, janë qëndrimet e revizionistëve italianë. Ndërsa udhëheqësi i partisë revizioniste italiane Lixhi Longo ndodhej në tribunën e mbledhjes «jubilarë» në Moskë, nga ku renegati Brezhnjev bënte thirrje për «mbledhjen e re botërore të komunistëve», gazeta «Unita» e 3 nëntorit botonte një artikull të Longos. Duke iu referuar vështirësive për një mbledhje të tillë, ai theksonte: «Duhet të njohim se arsyeja që qëndron në bazën e mjaft rezervave e dyshimeve për sa i përket thirrjes së një mbledhjeje botërore të partive komuniste, është frika se mos ajo, në njëfarë mase për vetë mënyrën e përgatitjeve, organizimit, zhvillimit dhe konkluzioneve të saj, prek kufirin e pavarësisë së partive të veçanta; është frika, gjitha-

shtu, që, në fund të fundit, kërkesat e tyre, kushtet e veçanta të punës së tyre, të mos mbahen parasysh» dhe u shpreh fare hapur se «në të ardhmen nuk është e domosdoshme të vendoset një taktikë, bile edhe një strategji e përbashkët dhe e ngurtë.

Bile tani partitë dhe grupet e ndryshme revizioniste jo vetëm që nuk duan të jenë lodër në duart e sovjetikëve, por kërkojnë t'i përdorin këta të fundit ose të tjerët për nevojat dhe qëllimet e tyre të veçanta. Pelegrinazhet e Gromikos, Podgornit e të tjerëve në Vatikan nuk janë bërë pa nxitjen e Longos e të shokëve të tij, ashtu si dhe afrimet e krerëve sovjetikë me regjimet diktatoriale të Amerikës së Jugut nuk bëhen pa këmbënguljen e partive revizioniste latino-amerikane, të cilat duan të justifikojnë me këto veprime afrimin dhe kapitullimin e tyre përpara borgjezisë reaksionare kombëtare, heqjen dorë nga revolucioni dhe transformimin e tyre në parti reformiste, antipunëtore e antisocialiste.

Fushata dhe përgatitjet e revizionistëve hrushovianë për mbledhjen e tyre «të famshme», tanimë tregojnë se ata ndodhen në rrugëkryq, ndodhen përpara një disfate tjetër të madhe të pashmangshme, përpara një përçarjeje akoma më të madhe midis tyre. Ata i pret një dobësim i ri i mëtejshëm i pozitave të tyre, si në politikën e jashtme, ashtu edhe në atë të brendshme.

Kjo gjendje do të bëjë me siguri që rezistenca e komunistëve dhe e popujve, si brenda në Bashkimin Sovjetik, ashtu edhe në vendet e tjera revizioniste, të shtohet, të organizohet, të fuqizohet, të fi-

llojnë goditjet e armatosura. Po kështu, partitë revizioniste në vendet kapitaliste do të krimben e do të shpartallohen, do të shndërrohen në vegla të hapëta të borgjezisë dhe do të krijohen e do të fuqizohen kudo partitë e vërteta marksiste-leniniste, që do të vazhdojnë luftën në krye të klasës punëtorë, të fshatarësisë revolucionare dhe të inteligjencies patriotike kundër imperializmit, borgjezisë, revizionistëve dhe reaksionit.

Mbledhje të tilla si kjo, që përcipen tani të organizojnë revizionistët hrushovianë, janë të mira për revolucionin botëror, për komunizmin ndërkombëtar. Ato i dobësojnë dhe i demaskojnë keqas klikat tradhtarë revizioniste, i izolojnë këto klika nga masat e komunistëve dhe të popujve të tyre, ndihmojnë në polarizimin e forcave dhe në dizagregimin e klikave revizioniste.

«Uniteti» që proklamojnë revizionistët jo vetëm që nuk është një unitet marksist-leninist, jo vetëm që nuk është një unitet partish, por ai nuk është as unitet klikash. Ai është një bluf, një orvatje për t'u hedhur hi syve dhe për të gënjyer kë mund të gënjëjnë. Por tani është vështirë të gënjë shumë njëri për t'i gënjyer. Jeta shpejt do ta zhdukë edhe këtë perde tymi fjalësh e demagogjie bajate.

Është detyrë e rëndësishme internacionaliste e të gjithë revolucionarëve dhe e komunistëve të vërtetë t'i goditin dhe t'i demaskojnë pa mëshirë planet e reja tradhtarë të udhëheqjes revizioniste sovjetike që ajo thur rreth së ashtuquajturës mbledhje të partive komuniste. Populli sovjetik dhe marksistë-leninistët

sovjetikë, në radhë të parë, nuk duhet t'i durojnë më gjatë propagandën demagogjike dhe pretendimet mashtruese të klikës uzurpatore të Brezhnjevit e të Kosi-ginit, që hiqet gjoja sikur lufton për forcimin e socializmit e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe se vija e saj ka aprovimin dhe përkrahjen e partive komuniste të botës. Ata duhet të ngrihen në këmbë dhe të revoltohen me guxim kundër demagogjisë dhe veprimtarisë së shëmtuar revizioniste, që ka për synim të fshehtë tradhtinë e saj ndaj marksizëm-leninizmit, të lavdërojë aleancën e saj reaksionare me imperializmin amerikan dhe të nxitë luftën kundërrevolucionare kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe partive të tjera marksiste-leniniste. Ngritjen në luftë kundër revizionizmit, kësaj pjelle të imperializmit dhe të reaksionit botëror, e kërkon interesi i revolucionit e i socializmit, këtë e kërkojnë interesat jetikë të popullit sovjetik, të cilit klika revizioniste i ka rrëmbyer fitoret e lavdishme të Tetorit dhe kërkon ta kthejë në skllavërinë kapitaliste. Ne jemi të bindur se komunistët dhe popujt e vendeve ku sundojnë revizionistët, do ta rritin pareshtur luftën revolucionare dhe do ta ngrenë nga balta, ku e kanë hedhur revizionistët, flamurin e marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 309 (6034), 26 dhjetor 1967

Botohet sipas librit: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash), 1965-1967», f. 609

TI NGREMË ZONAT E THELLA NË NIVELIN E ZONAVE TË PËRPARUARA

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

10 janar 1968

Në raportet që na kanë paraqitur komitetet e Partisë të rretheve të Shkodrës dhe të Sarandës, si dhe nga diskutimet shumë të mira e instruktive që bënë këtu sekretari i Komitetit të Partisë për zonën e Dukagjinit, shoku Mark Ndou, dhe sekretari i Komitetit të Partisë për zonën «Partizani», shoku Jorgo Mici, shikojmë se në të dyja këto zona ka shumë gjëra të mira që duhet t'i zhvillojmë më tej, shikojmë gjithashtu se kanë suksese dhe eksperiencë të mirë, që na ndihmojnë për të ecur përpara.

Por, natyrisht, në këto zona ka akoma të meta dhe tendenca të gabuara. Kështu, për shembull, siç doli edhe këtu, në Dukagjin ka mbeturina dhe influenza të bajraktarizmit, të cilat, në mënyrë direkte

1 Në këtë mbledhje u diskutua për punën e komiteteve të Partisë të zonës së Dukagjinit në rrethin e Shkodrës dhe të asaj «Partizani» në rrethin e Sarandës.

ose indirekte, pengojnë përparimin dhe zhvillimin e luftës së klasave; ka shfaqje të kapadaillëkut, të mendjemadhësisë, të konceptit të «derës së madhe»; ekzistojnë zakonet e vjetra të sundimit të plakut, të babës ose të mashkullit, domethënë mbeturinat e familjes patriarkale, të feudalizmit dhe të bajraktarizmit me të gjitha të këqijat e tyre; ekziston konservatorizmi i hapët ose i fshehtë në dhënien e dënimeve dhe tendenca për t'iu shmangur ligjeve të pushtetit etj., etj.

Tani në Dukagjin është bërë një revolucion i madh, janë bërë transformime të dukshme, janë zhdukur zakone të vjetra prapanike, por megjithatë ka nga ato që akoma ekzistojnë, prandaj na vihet detyra që t'i luftojmë vazhdimisht. Por, që këto mbeturina të luftohen me sukses dhe të zhduken rrënjësisht, duhet të forcohet organizata e Partisë dhe, në radhë të parë, t'i kushtohet kujdes punës me të rinjtë dhe me të rejat, pse këta janë më përparimtarë, mund të zhvillojnë më lehtë e më me guxim luftën e klasave kundër këtyre mbeturinave të së kaluarës në malësi dhe të bëjnë edukimin klasor revolucionar.

Një anë tjetër ku duhet treguar kujdes i veçantë është riedukimi i komunistëve të vjetër. Këta janë shokë të mirë, të vendosur, të lidhur ngushtë me Partinë, por të mos harrojmë se në ndërgjegjen e tyre ruajnë edhe disa botëkuptime të huaja, siç janë konceptet patriarkale, shfrytëzimi i pozitave dhe i autoritetit, ndjenjat e pronës private (se, të mos harrojmë, gjer djc ata s'kanë qenë në kooperativë). Prandaj, me këta shokë Partia duhet të zhvillojë një

punë të madhe për riedukimin, frymëzimin dhe kalitjen e tyre revolucionare. Puna e Partisë me ta të bëhet një shkollë e vërtetë edukimi politik dhe ideologjik, e cila të ketë për qëllim të ruajë të gjitha virtytet e mira të karakterit të malësorit dhe t'i kthejë këto në shërbim të edukatës që synon Partia, t'i përgatitë në luftën ideologjike për të zhdukur konservatorizmin, arkaizmin, partikularizmin dhe bajraktarizmin në ideologji dhe në jetën praktike, t'i bëjë këta komunistë që të qëndrojnë kurdoherë në pararojë të luftës së Partisë në malësi dhe që me shembullin e tyre të influencojnë pozitivisht në masat.

Për këtë punë duhet të përgatiten leksione që t'i kuptojnë komunistët dhe rinia, duke mbajtur kurdoherë parasysh nivelin e tyre kulturor, e jo të bëhen ato këtu, nga lart, me një stil që njerëzit në bazë të mos i kuptojnë. Në to të shpjegohet, sipas nivelit të tyre, se cilat janë këto të këqija, si shfaqen ato dhe si duhet të luftohen, duke dhënë shembuj konkretë nga jeta e përditshme. Pasi të kemi shpjeguar ç'do të thotë konservatorizëm, arkaizëm, bajraktarizëm etj., duhet thënë konkretisht si duhet të mendojë dhe të veprojë njeriu i socializmit dhe pastaj, mendoj unë, të jepet definicioni në përshtatje me nivelin e tyre. Definicioni mund të jepet edhe në fillim dhe më poshtë të kalohet në dhënien e shembujve, kurse unë them se do të jetë më mirë që nga shembujt të arrihet në definicion. Kjo do të jetë një edukatë konkrete për t'i ngritur njerëzit nga ana ideologjike.

Po në këtë mënyrë duhet të luftohen mbeturinat fetare, liturgjia, misticizmi, zbatimi i hapët ose

i fshehtë i praktikave fetare, pse akoma ka njerëz që fshehurazi mbajnë kreshmë ose ramazan.

Krahas kësaj, duhen ruajtur përrallat dhe legjendat e bukura, me përmbajtje të shëndoshë, të malësisë, por duke i spastruar nga shtojzovallet nga idetë fataliste, mistike, të fuqisë së mbinatyrshme, pse ato që populli ka ruajtur gjer në ditët tona, pasqyrojnë epokën e kaluar me botëkuptimin e saj. Gjithashtu, me talentin e tij populli duhet të krijojë përralla e legjenda të reja për epokën e re, për njeriun e ri. Këto kanë rëndësi, sepse janë pjesë e edukimit në masë të popullit. Përrallat e legjendat që do të përgatiten, bie fjala, për Shkurte Pal Vatën do të jenë një flakë për gjithë malësinë. Pra, ne duhet të arrijmë të realizojmë që traditat e mira të popullit dhe epokën tonë të re t'i shpjegojmë sipas botëkuptimit tonë marksist-leninist.

Mungesa e unitetit që shfaqet në disa organizata-bazë të Partisë në malësi e ka burimin pikërisht në mbeturinat që përmenda më lart, të cilat duhet t'i luftojmë në mënyrën që thashë, sepse kështu forcohet edhe uniteti. Për çdo shfaqje të huaj gjithmonë duhet gjetur burimi dhe pastaj, duke zbuluar shkakun, duhet menduar se ç'mund të bëhet për t'i prerë rrugën ose për ta shteruar ujin e këtij burimi të keq. Burimet e këqija nuk thahen me urdhra, por duke vepruar ashtu sikurse veprojmë me ndërtimin e një dige që, duke i njohur e duke i shfrytëzuar ligjet e natyrës, ndalojmë ujin të mos vërshojë si më parë. Pra, duke i njohur e duke u mbështetur në ligjet e shoqërisë, duhet të veprojmë që me botëkuptimin

tonë marksist-leninist t'i shterojmë këto burime të këqija të trashëguara nga shoqëria e mëparshme.

Një nga mjetet për edukimin e malësorëve është aksioni masiv, shkëmbimi i grupeve të mëdha midis kooperativave të malësisë së Veriut dhe të Jugut për një muaj ose një muaj e gjysmë, për të cilin kam menduar t'i propozoj Byrosë Politike. Në skuadrat ose në brigadat që do të shkojnë për këtë qëllim nga Veriu në Jug, të mos ketë vetëm vajza e djem, por edhe burra e gra.

Kjo gjë do të shërbejë për të thyer jetën e mbyllur, monotone dhe pa horizonte të gjera të malësorëve. Udhëtimet dhe kontaktet që malësorët do të kenë me njerëzit e tjerë në zonat ku do të shkojnë, do t'u mësojnë atyre shumë gjëra që nuk mund t'ua mësojnë leksionet dhe konferencat. Duke dalë nga malësia jo vetëm cucat, por dhe burrat, te të cilët ekzistojnë konservatorizmi dhe ndjenja e sundimit, konfliktet midis burrit dhe gruas, po ashtu konfliktet midis së vjetrës dhe së resë do të zgjidhen më lehtë dhe më shpejt, fërkimet nuk do të jenë të mëdha, se vetë burri do të shohë dhe do të njohë si ka ecur përpara jeta në zonat fushore.

Partia duhet të tregojë kujdesin më të madh për dërgimin e kuadrove të përgatitur politikisht, ideologjikisht dhe teknikisht në zonat e thella të malësisë. Kuadrat që dërgohen duhet të instruktohen e të ndihmohen, të njohin gjendjen nga afër, pse kështu do të bëjnë më mirë punën që u kërkohet. Pra, duhet ndihmuar me të gjitha mundësitë që malësia të dalë nga jeta e saj meskine, në një jetë të përparuar

socialiste, të përdoren të gjitha format e mjetet që të luftohen zakonet prapanike etj. Njerëzit e malësisë janë shumë të zgjuar. Po të mbështetemi në këtë karakteristikë të tyre e të punojmë mirë, kthesa që dëshirojmë do të arrihet shumë shpejt.

Për sa i përket zonës «Partizani» dua të them se edhe atje kemi përparime të dukshme, kemi një organizatë partie të fortë, të lidhur ngushtë me masat e popullit. Malësia e Veriut dhe e Jugut natyrisht kanë veçoritë e tyre, të cilat duhet të njihen mirë nga Partia dhe mbi bazën e kësaj njohjeje duhet të ndërtohet edhe puna e veçantë me to. Shumë gjëra në parim mund të jenë të njëjlojta, por ndryshe shfaqen në Veri dhe ndryshe në Jug, për arsye të zhvillimit ekonomik e kulturor. Ashtu sikurse u tha këtu, është e vërtetë që për sa i përket qëndrimit ndaj fesë në zonën «Partizani» ka ndryshime, por edhe konditat e kësaj zone ndryshojnë nga ato të Dukagjinit.

Megjenëse në zonën «Partizani» rron popullsia e minoritetit grek, që është e lidhur ngushtë me popullin shqiptar, pavarësisht nga sukseset që janë arritur, puna politike e Partisë duhet të jetë e vazhdueshme, intensive dhe e thellë. Kjo nuk është një gjë speciale vetëm për minoritetin, po për të gjitha zonat kufitare të Shqipërisë, ku edhe propaganda e armikut zhvillohet më e madhe.

Sukseset shumë të mëdha që ka arritur minoriteti nën udhëheqjen e Partisë, janë një bazë e shëndoshë ku ne duhet të mbështetemi për të thelluar punën politike dhe ideologjike me masat, në mënyrë që ato të kuptojnë mirë sa drejtë, pra në rrugën marksiste-

-leniniste, e ka zgjidhur Partia jonë çështjen e minoritetit grek, sa fort është ai i lidhur dhe se akoma edhe më shumë duhet ta kalitim këtë lidhje me popullin vëlla shqiptar dhe me Partinë e Punës të Shqipërisë. Kjo duhet të jetë abëcëja e punës politike e ideologjike me minoritetin dhe mbi këtë bazë të lidhet çdo gjë tjetër. Kështu do të kemi suksese edhe më të mëdha në të ardhmen.

Te të rinjtë dhe të rejat, shokë, duhet të gjeni mbështetjen më të madhe. Kjo është e njëjtë si për Shqipërinë e Veriut, të Jugut dhe të Mesme. Mbështetja te rinia duhet të kuptohet jo vetëm nga Partia, por edhe nga fshatarët, nga populli.

Komiteti i Partisë i Rrethit të Sarandës duhet vazhdimisht ta shikojë nga afër zonën «Partizani» dhe t'i japë asaj prioritet në çdo gjë. Së bashku me fshatin Leshnicë duhet të merren masa që drita elektrike të vejë dhe në të dy fshatrat e tjera që, sipas parashikimit tuaj, mbeten pa u elektrifikuar në vitin 1968.

Organizata e Partisë në këtë zonë duhet të ketë kujdes të veçantë edhe në një drejtim tjetër. Asnjë nuk duhet të mendojë se tani që u prishën kishat çdo gjë mbaroi, se rreziku i fesë u zhduk. Të mos harrohet se çështja e fesë në minoritet ka qenë e lidhur me propagandën greke të megaliidhesë dhe të «Vorio-Epirit», prandaj duhet zhvilluar një luftë e pandërprerë politike dhe ideologjike. Ne e dimë se besimet fetare ekzistojnë në ndërgjegjen e njerëzve, sidomos në pleqtë e plakat, por ne duhet të shohim sa të rrezikshme e të dëmshme për socializmin janë

këto dhe t'u vëmë barrikadë. Ndërsa kur shikojmë që çështja e fesë përzihet edhe me politikën, atëherë lufta duhet bërë më e fortë. Pra në këtë drejtim duhet bërë një punë e diferencuar. Por për të thyer edhe te të moshuarit ndjenjat dhe besimet fetare duhet të mbështetemi te të rinjtë dhe te të rejat.

Në Dropull (në popullin e minoritetit), gratë janë përparimtare, punëtore, patriotë, të lidhura me tokën dhe me familjen, pse burrat në të kaluarën më shumë kanë emigruar ose kanë punuar si artizanë, kurse gratë punonin tokën, rritnin kalamanët, grindeshin me agallarët. Këto janë disa karakteristika të mira të grave minoritare, që duhen zhvilluar e thelluar më tej, duke bërë një punë edhe më të mirë për edukimin e tyre.

Këto kisha për të thënë, shokë, natyrisht, nuk janë gjëra të reja, por i shtrova këtu, pasi kërkojnë vëmendje. Partia do të përpiqet, sa të jetë e mundur më shumë, t'i ndihmojë zonat e thella që ato të ngrihen në nivelin e zonave të tjera më të përparuara.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH që
ajendet në AQP*

EDUKIMI IDEOLOGJIK I KUADROVE DHE I MASAVE

*Fjala në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH*

13 janar 1968

ORIGJINA IDEOLOGJIKE E KONSERVATORIZMIT NË POLITIKËN E NGRITJES NË PËRGJEGJËSI TË KUADRIT TË RI

Kujdesi për edukimin e kuadrit të ri (dhe kur flas për kuadrin e ri, nuk kuptoj vetëm drejtuesit e çdo niveli dhe të çdo sektori, por edhe masat në përgjithësi, në radhët e të cilave dallohen dhe shquhen njerëzit e talentuar që ngrihen në përgjegjësi të ndryshme) duhet të jetë një nga preokupacionet e vazhdueshme, një kujdes i përhershëm i Partisë. Ky kujdes duhet të shfaqet në edukimin moralo-politiko-ideologjik dhe teknik masiv të kuadrit. Në bazë të këtij edukimi masiv shquhen kapacitete dhe ngrihen kuadro në përgjegjësi sipas kriterëve të drejta që ndjek Partia, siç janë besimi politik, ngritja politiko-ideologjike, ngritja tekniko-profesionale, origjina dhe sjelljet morale proletare etj.

Përgatitja e kuadrove nuk duhet të shkëputet nga përgatitja dhe edukimi i masave, ndryshe degjeron koncepti ynë i drejtë filozofik se janë masat të parat, pastaj individët. Këta të fundit nuk mund të bëjnë pa masat, po, të edukuar me konceptet e drejta filozofike të Partisë sonë, vënë në shërbim të masave, të interesit të përbashkët, dituritë, zotësitë dhe talentet e tyre. Konceptimi drejt i rëndësisë së kuadrit, i prejardhjes, i edukimit dhe i ngritjes së tij në përgjegjësi, ndihmon që të luftohen dhe të zhduken shumë koncepte të huaja për marksizëm-leninizmin, koncepte borgjeze, kapitaliste, idealiste, pra anti-socialiste.

Koncepte të tilla të huaja për ideologjinë tonë dhe për formimin e kalitjen e njeriut të ri komunist, mund të themi se jemi akoma larg t'i kemi zhdukur, për të mos thënë t'i kemi shkukur nga rrënjët, sepse, për t'ia arritur kësaj, do të duhet të kalojnë shumë breza komunistësh, të cilët duhet të kaliten nga Partia në mënyrë intensive revolucionare, brez pas brezi.

Puna e Partisë për kalitjen e kuadrit me botëkuptimin marksist, si në çdo gjë, nuk duhet të synojë vetëm për fshirjen e një elite, por të gjitha masat, të gjithë popullin. Kalitja në veçanti e komunistëve nuk duhet të kuptohet, gjithashtu, si kalitje e një elite në vetvete, por si një mjet, si një armë, si edukim i pararojës së klasës punëtore që vihet në udhëheqje, në shërbim të revolucionit, në shërbim të kalitjes së masave dhe të edukimit të tyre marksist-leninist. Duke e kuptuar dhe duke e zbatuar kështu në jetë këtë çështje, evitohet dhe luftohet shkëputja

e kuadrove nga masat, individi vihet në marrëdhënie të drejta me shoqërinë, edukohen njerëzit në masë për të kuptuar ç'do të thotë në teori dhe në praktikë socializëm dhe komunizëm, ç'do të thotë pronë individuale dhe pronë shoqërore socialiste, ç'do të thotë roli i masave që bëjnë historinë, ose si e koncepton filozofia jonë marksiste rolin e masave dhe rolin e individit në shoqëri.

Këndeji vjen dhe shoshitja e shkallmimi i koncepteve filozofike borgjeze-idealiste nga ndërgegjja e njerëzve. Them shoshitja pse çdo gjë në botëkuptimin e masave nuk është dhe nuk mund të jetë borgjeze, idealiste. Superstruktura e regjimeve të kaluara, me filozofinë e saj, me mënyrën e jetesës, me ligjet, me kulturën dhe me shtypjen, ka lënë mbresa të thella në masat, prandaj Partia e ka për detyrë të ndajë shapin nga sheqeri dhe të shkallmojë shapin.

Partia, me punën e saj të madhe dhe me vijën e saj të drejtë, në dekada të tëra ka arritur suksese të mëdha në zgjimin e masave, në edukimin e tyre politik, arsimor, teknik, në revolucionarizimin e tyre. Masat, nën udhëheqjen e Partisë, bënë revolucionin dhe po ndërtojnë me sukses socializmin. Në këtë zhvillim masiv, që ka ndodhur në vendin tonë, janë kryer një sërë procesesh revolucionare, herë të dukshme, herë të padukshme. Këto procese të fundit, nën ndikimin e drejtpërdrejtë dhe si pasojë e të parave, të dyja së toku kanë ndjekur rrugën e dialektikës marksiste të ndryshimeve sasiore dhe cilësore, kurdoherë në lëvizje, në zhvillim, në përparim.

Gjatë këtyre proceseve, e reja ka luftuar me të

vjetrën, ka çarë rrugën përpara dhe e ka mundur atë, por jo plotësisht. Procesi i shembjes të së vjetrës, sidomos në ideologji, është i gjatë, është një luftë e ashpër me botëkuptimet, me konceptet e prapambetura, me mbeturinat e tyre, me mundësinë e ringjalljes së tyre në ndërgjegjen e individit dhe me rrezikshmërinë në një rikthim masiv të këtyre botëkuptimeve idealiste.

Pra, zhvillimi masiv revolucionar ka hasur edhe në pengesa dhe në vështirësi të çfarëdollojshme, objektive dhe subjektive, në papjekuri politike të individëve ose të grupeve të individëve, në injorancën e disave, në prapambetje, në rezistencën kryeneçe të koncepteve të vjetra, të dëmshme dhe të rrezikshme që ishin kthyer në mënyrë jetese dhe në zakone, që rrezikshmëria e tyre, anakronizmi, kontradikta dhe antagonizmi me zhvillimin e shoqërisë së re, nuk arriheshin të kuptoheshin shpejt nga çdo njeri.

Nuk dëshiroj të zgjatem këtu edhe për vështirësitë materiale që kemi hasur gjatë gjithë procesit të zhvillimit të vendit tonë, por, në përgjithësi, në luftën për të përballuar si të parat, ashtu dhe të dytat, Partia ka arritur suksese të mëdha. Ajo ka kapërcyer vështirësi të shumta dhe me revolucion e nëpërmjet një revolucioni të thellë politik, ideologjik, ekonomik material ka hedhur baza të shëndosha të socializmit dhe po e ndërton këtë me sukses.

Revolucioni socialist është i pandalshëm, ai duhet të thellohet në çdo fushë dhe në radhë të parë në politikë dhe në ideologji, si fusha të cilat duhet të na preokupojnë shumë dhe vazhdimisht. Këtë e lyp

medoemos konsolidimi i fitoreve të arritura dhe kalimi në fitore të reja. Kjo, na mëson Partia, duhet të zhvillohet nëpërmjet vijës së masave. Le të nxjerrim disa konkluzione nga rezultatet e kësaj vije të shkëlqyer revolucionare të masave që po zbaton Partia.

Po të kemi parasysh zhvillimin revolucionar të masave tona në ndërtimin e socializmit, në kalitjen e ndërgjegjes socialiste, do të shohim edhe ndryshimet sasiore dhe hopet cilësore. Partia është mbështetur vazhdimisht në masat, i ka ngritur ato në luftë dhe në punë, por kjo ngritje nuk ka qenë kurdoherë e njëlojtë. Në këtë ngritje kreshendo të hovit të masave, rol vendimtar ka luajtur vija e drejtë dhe konsekuente e Partisë në të gjitha drejtimet e jetës politike, shoqërore, kulturore, ekonomike. Partia ka mbajtur kurdoherë në evidencë, në teori dhe në praktikë, rolin jetik të vijës së masave si dhe rolin vendimtar të masave në transformimin e shoqërisë dhe të individëve që e formojnë atë. Këtij roli të madh të masave, të udhëhequra nga Partia, i detyrohen këto transformime kaq të mëdha, me baza të shëndosha dhe me perspektivë të madhe. Po të mos ishte kuptuar dhe zbatuar kështu vija e Partisë, ndërtimi i socializmit do të ishte në rrezik dhe po të mos vazhdohet të kuptohet kështu dhe të revolucionarizohet më tej vija jonë, ndërtimi i plotë i socializmit mund të rrezikohet.

Le t'i hedhim një sy të shpejtë zhvillimit të industrisë sonë. Sa vështirësi kemi hasur dhe i kemi kapërcyer, vështirësi jo vetëm materiale, profesionale, por edhe politike! Ne nuk duhet të harrojmë konceptet

e vjetra mbi punën, siç janë fryma konservatore, artizanale, plogështia e dembellëku, si dhe mungesa e disiplinës dhe e ndërgjegjes socialiste në punë, koncepte këto që ekzistonin dhe që duheshin thyer; nuk duhet të harrojmë gjithashtu vështirësitë që kemi hasur në krijimin e klasës punëtore, në punën shoqërisht të përbashkët etj.

Masat e marra ishin një kompleks i tërë që ndihmuan në kapërcimin e gjithë këtyre vështirësive, por kurrë nuk duhet të harrojmë se vendimtar në këtë kthesë ka qenë roli masiv i masave, të cilat, duke kuptuar gradualisht vijën e Partisë dhe perspektivën e saj, edukuan vetveten në punë dhe në luftë, fituan ndërgjegje të lartë dhe rritën besimin në zotësinë e tyre, u edukuan dhe u inkurajuan nga shembulli dhe nga realizimet e arritura. Shkollat, kurset etj., gjithashtu, kanë luajtur rolin e tyre, kanë shërbyer në çështjen që theksova më lart, ato ishin një nga mjetet që ndihmuan në kryerjen e këtij hopi të madh që tashmë është i papërmbajtur. Asnjë nuk pranon tash të qëndrojë pa punë, të gjithë duan të punojnë, të mësojnë zanate, të shkojnë atje ku paraqitet nevoja. Pra u thyen, në përgjithësi, shumë pengesa e paragjykime në këtë drejtim.

Dhe ne shohim tani atë që prisnim: hovin revolucionar të masave, të drejtuar nga Partia, që është kthyer në një levë kolosale, në një edukator të shkëlqyer, në një rregullator të madh që fuqizon frymëmarrjen e shoqërisë sonë socialiste.

Çdo gjë, fuqizimi i mëtejshëm i industrisë sonë, perfeksionimi dhe kualifikimi masiv i kuadrove të

këtij sektori, do të ecë paskëtaj me vrull të paparë ndonjëherë.

Të marrim bujqësinë. I njëjti proces ndodh, bile edhe ca më i komplikuar akoma, po sa rezultate të mëdha janë arritur! Nga prona e copëtuar individuale, nga botëkuptimet individualiste të pronës private, konceptet e theksuara të familjes patriarkale, të fisit, nga mënyra e vjetër e punës, nga tregu i lirë e spekulimi, nga Reforma Agrare kaluam në luftën e lavdishme, por të koklavitur, të vështirë, të kolektivizimit të fshatit. Një epope e tërë e vijës ngadhënjimtare të Partisë! Këndej arritëm në kolektivizimin e plotë, në bonifikimin e fushave, në hapjen e tokave të reja, në ujitjen me përmasa të papara, në kolektivizimin e bagëtisë, në ngushtimin e oborreve dhe të bagëtisë së këtyre, në kuptimin e lartë socialist të pronës së përbashkët, në solidaritetin dhe në ndihmën në shkallë kombëtare të kooperativave bujqësore të fuqishme për kooperativat bujqësore malore, në kuptimin e përparuar të mënyrës dhe të metodave të punës, në mënyrën e jetesës, në konceptimin e ri të zakoneve, në luftën kundër bestytnive, fesë dhe zakoneve prapanike.

Vetëm Partia jonë, vetëm masat e gjera të edukuara me vijën e Partisë, mund t'i bënin këto transformime të thella revolucionare. Pikërisht këtë dua të vë në dukje. Ne dimë se në ndërgjegjen e individëve bëhet dhe do të bëhet një luftë e pareshtur kundër mbeturinave të ideologjisë së vjetër borgjeze kapitaliste. Në shumë punëtorë, fshatarë dhe intelektualë, në të rinj e në të moçëm, në gra e në burra,

në komunistë dhe në anëtarë të Frontit Demokratik, ekzistojnë, ku më shumë e ku më pak, këto mbeturina, të cilat luftohen, shfaqen përsëri dhe prapë luftohen. Pa një vijë të drejtë, pa një kudhër kolosale si kjo e Partisë dhe e masave që Partia i vë në lëvizje, nuk mund të arriheshin këto rezultate. Vija e masave, masat e ngritura në revolucion, Partia me vijën e saj marksiste-leniniste, janë edukatorët e vërtetë të individëve, të cilët duhet të shkrihen në masat, të kaliten në luftë tok me to, të shporrin nga ndërgjegjja e tyre çdo kalbësirë.

Heroizmi masiv revolucionar është shembulli më i madh edukativ për njerëzit tanë. Heroizmi individual ka vlerë edukuese po ashtu, kur realizohet në kuadrin e këtij heroizmi masiv, kur është pjesë përbërëse dhe e pandarë e tij.

Prandaj nënvleftësimi i vijës së masave, i rolit të tyre vendimtar, i hovit, i heroizmit masiv revolucionar, është gjëja më e rrezikshme. T'u kundërvësh atyre pikëpamjet individualiste me të gjitha të këqijat morale, politike dhe ideologjike, është antisocialiste, antimarksiste dhe shumë e rrezikshme. Individit ka rolin e vet në shoqërinë tonë, pse nga individët e veçantë formohen masat. Marksizëm-leninizmi nuk ka për qëllim të nënvleftësojë rolin e individit në shoqëri, por ta edukojë atë me ideologjinë proletare, me koncepte të drejta shoqërore dhe filozofike, me koncepte socialiste mbi jetën, mbi punën, mbi pronën, mbi familjen, mbi prodhimin, mbi politikën, mbi marrëdhëniet në mes të njerëzve, popujve, shteteve etj. Kjo është çështje lufte, çështje botëkuptimesh

diametralisht të kundërta. Partia synon ta çlirojë njeriun, kurse borgjezia ta mbajë atë në robëri shekullore.

Edukimi ideologjik dhe politik i njerëzve ka një rëndësi të madhe. Prandaj Partia i ka vënë kujdesin më të madh kësaj pune dhe ka përdorur e përdor një larmi formash për të arritur rezultate të dukshme dhe me baza në këtë çështje.

Mbeturinat në ndërgjegjen e njerëzve duhet t'i luftojmë pa pushim, pa ngurrim dhe njerëzit t'i sqarojmë me durim. Këto mbeturina mund t'i spastrojmë, po ato mund të ripërtërihen në forma dhe në rrethana të tjera. Kjo është punë dhe luftë për shumë dekada, por duke luftuar që ato të zhduken rrënjësisht, çdo vit e çdo dekadë, do të konsolidojmë veprën e madhe të Partisë. Kjo është rruga e kalimit për në komunizëm. Por që të arrijmë me siguri atje, duhet të zhvillojmë, natyrisht, një luftë të pandërprerë dhe ta shohim kurdoherë realitetin në sy, me të mirat dhe me të këqijat e tij, me sukseset dhe me dështimet, që dështimet t'i kapërcejmë dhe sukseset t'i konsolidojmë.

Mbeturinat borgjeze dhe mikroborgjeze në ndërgjegjen e njerëzve janë individuale, të ndryshme në lloje, në intensitet dhe në rrezikshmëri. Ato mund të shfaqen në mënyra të ndryshme, me intensitet të ndryshëm dhe jo njëlloj te çdo njeri e në çdo vend. Ata kanë një origjinë të përbashkët, filozofinë idealiste, borgjeze, kapitaliste, por revolucionin, puna dhe lufta e Partisë po i zhdukin. Ato diku kanë ngelur, diku luftohen me sukses, diku durojnë, diku shfaqen dhe dëmtojnë shoqërinë dhe individin, diku qëndrojnë

të fjetura, por rilindin në rrethana të veçanta. Shumë nga këto mbeturina janë kthyer në zakone për disa shtresa të tëra dhe pengojnë ecjen e tyre si duhet përpara. Prandaj Partia zhvillon frontalisht dhe në detaje këtë edukim të madh të masave.

Le të marrim disa shembuj të mëdhenj, siç është konsolidimi i kooperativizmit i parë nga ana ideopolitike, për të mos folur për atë ekonomike. Ne kemi bërë një hap të madh cilësor përpara, por do të jetë një gabim dhe miopi e madhe në rast se mendojmë që fshatari ynë i ka zhdukur krejtësisht shumë nga konceptet e tij të vjetra. Sa luftë kemi për të bërë për edukimin e tij! Një program të madh pune dhe lufte të pandërprerë kemi përpara në këtë drejtim.

Të marrim çështjen e fesë. Ne kemi bërë një hap cilësor të madh në luftën kundër saj. Por i kemi zhdukur vallë besimin te feja, bestytnitë dhe zakonet që lidhen me të? Jo. Jemi akoma shumë larg, prandaj s'duhet të kemi iluzione, të na mbulojë kënaqësia e të bëjmë gjumë. Feja është benzina e zjarreve të këqija.

Të marrim çështjen e çlirimit të gruas. Ne kemi bërë një hap cilësor të madh përpara, por lufta e Partisë është larg të ketë mbaruar në këtë drejtim. Një letër anonime më ka ardhur nga Shkodra, në të cilën autori, gjoja si patriot, më qorton se «nuk bëjmë mirë që ngremë gruan në këtë mënyrë dhe ulim nderin e burrit». Por kështu si mendon ky njeri, mos vallë, shokë, janë vetëm njëqind ose një mijë? Jo. Me siguri janë më shumë që flasin ose nuk flasin, që veprojnë kundër ose rezistojnë në forma të ndryshme.

Kështu mund të themi për problemin e familjes së re në përgjithësi, të mbrojtjes së pronës së përbashkët socialiste etj.

Le të marrim disa çështje që ngre raporti i Komitetit të Partisë të Rrethit të Shkodrës. Unë jam dakord me punën e shokëve të Partisë të Shkodrës, ata janë në rrugë të drejtë, veprojnë gjallërisht e drejt dhe duhet të përgëzohen për kuptimin dhe për ndihmën që i japin malësisë me kuadro partie e teknikë.

Mbeturinat mikroborgjeze në ndërgjegjen e njerëzve, siç e theksova më sipër, luftohen me konsekuencë nga Partia, nëpërmjet edukimit ideopolitik dhe punës praktike revolucionare. Edukata e organizuar masive, si dhe edukimi individual ose i organizuar në grupe, bëjnë të gjitha një efekt pozitiv në kalitjen e njerëzve dhe kanë dhënë rezultate të mira. Shumë nga këto rezultate na duken si të natyrshme, sikur kanë ardhur vetvetiu. Por nuk është ashtu.

Të marrim, për shembull, çështjen e edukimit të punëtorëve me profesione të ndryshme, ose çështjen e edukimit të fshatarësisë me agroteknikën, si dhe atë të edukimit në përgjithësi të të gjithë punonjësve. Në këto drejtime janë thyer shumë barrkada, shumë koncepte të vjetra mikroborgjeze e prapanike, siç janë konservatorizmi, pikëpamjet e ruajtjes së zanatit për vete, konceptet jopërparimtare mbi kuptimin e punës, të normës, të fitimit etj. Këto koncepte kanë ekzistuar, ku më shumë, ku më pak, tek individët, por këndej ato e kalonin edhe kufirin e individit dhe ishin bërë pikëpamje edhe të grupeve e të shtresave. Si pasojë, ekzistonte një rrezik i dyfishtë, prandaj

edhe duhej një edukim i dyfishtë, në planin individual dhe në planin masiv.

Ne mund të përsëritim prapë se Partia, me punën e saj të palodhur, ka arritur rezultate të mëdha në këto drejtime, se janë thyer në përgjithësi konceptet e vjetra, që ekzistonin për edukimin masiv të njerëzve me profesione, me njohuri etj. Kjo nuk do të thotë se në rrugë nuk hasim akoma vështirësi të shumta, subjektive dhe objektive, por jemi larg asaj kohe kur i nxirreshin një mijë pengesa këtij problemi të madh. Kjo është njëra anë, ndërsa ana tjetër është problemi i ngritjes së njerëzve në përgjegjësi. Kur vjen çështja që nga kjo masë e madhe njerëzish që përparojnë, që mësojnë, që shquhen, të ngrihen në përgjegjësi, hasen shumë pengesa. Kjo e ka buri-min, më të shumtat e herës, pikërisht në ato koncepte dhe mbeturina mikroborgjeze të huaja për ideologjinë tonë marksiste-leniniste dhe, ç'është më e rrezikshme, ato shfaqen edhe në kuadro të Partisë dhe të shtetit, që kanë përvojë të madhe, që janë të kalitur ose më të përgatitur politikisht dhe ideologjikisht se masat e gjera të punonjësve.

Nevoja e edukimit të kuadrit të ri, ngritja e tij në përgjegjësi në bazë të meritave, problemi i qarkullimit të kuadrit e shumë probleme të tjera që kanë lidhje me të, në përgjithësi kuptohen drejt nga kuadrot e Partisë dhe të pushtetit dhe gjithashtu në përgjithësi zbatohen drejt. Por ka shumë raste që vërtetojnë se jo kudo dhe jo prej të gjithëve këto parime kuptohen dhe zbatohen drejt. Ka shkelje flagrante të politikës së drejtë të Partisë për ngritjen në për-

gjegjësi të kuadrit të ri dhe këto, në rastet më të shumta, korigjohen menjëherë kur dallohen dhe bëhen, ashtu si duhet, mësim dhe edukatë. Këto raste flagrante kapen më mirë nga Partia dhe u vihet gishti si duhet arsyeve që kanë lejuar të bëhet ky gabim, domethënë vihen në dukje dhe analizohen mbeturinat antimarksiste në ndërgjegjen dhe në punën e atij personi fajtor, siç janë: egoizmi, mendjemadhësia, arroganca, hakmarrja, hatëri, përfitimi personal, lavidia personale etj., etj. Kjo është një gjë shumë e mirë, dhe, kur thellohet si duhet, është akoma më e mirë. Kjo punë jep shumë fryte në zbatimin korrekt të vijës së Partisë, në kontrollin e rreptë të zbatimit të saj, vlen për të ndrequr individin dhe i shërben edukimit të masës.

Mirëpo gabimet në zbatimin e politikës së kuadrit nuk janë kurdoherë flagrante dhe jo kurdoherë me karakter të izoluar. Shumë herë gabimet në këtë drejtim pleksen dhe mbulohen, me dashje ose pa dashje, e me shumë arsye të tjera objektive dhe subjektive, të bazuara ose të pabazuara. Të tilla gabime joflagrante mund të jenë për raste të veçanta, por mund të bëhen edhe rrugë, e cila është më e rrezikshme ngaqë edhe kjo mbulohet e arsyetohet me plot shkaqe gjoja subjektive dhe objektive.

Në raportin e Komitetit të Partisë të Rrethit të Shkodrës që kemi në analizë (dhe ky problem nuk është vetëm për Shkodrën), shohim se në punën për zbatimin e politikës së kuadrit ekzistojnë koncepte konservatore, patriarkale, familjare dhe shfaqje të tjera të kësaj natyre. Sigurisht këto janë koncepte të dë-

nueshme dhe të dëmshme. Nga Partia bëhet luftë kundër tyre, por, me sa gjykoj unë, nuk bëhet sa duhet për të evituar plotësisht rrezikshmërinë e tyre, pasi nuk kuptohet gjithnjë si duhet se këto koncepte mund të kalojnë nga platforma individuale në rryma dhe në botëkuptime të huaja për ideologjinë dhe politikën tonë marksiste-leniniste.

Individi i pakalitur mirë politikisht dhe ideologjikisht kontribuon në këtë gjendje, duke ndikuar me mbeturinat mikroborgjeze që ekzistojnë në ndërgjegjen e tij dhe këto i arsyeton gjoja me qederin, me kujdesin «e vërtetë» dhe të shëndoshë që duhet të ketë Partia për edukimin dhe për ngritjen e kuadrit në përgjithësi. Një individ i tillë me të gjitha të këqijat që përmenda më lart, siç janë: egoizmi, mbivlerësimi i aftësive të tij personale, ndjenja e sigurimit të postit që mban, e përfitimeve personale ekonomike dhe e prestigjit personal etj. fsheh dhe infekton vijën e Partisë. Duke e njohur rrezikshmërinë e këtyre veseve të këqija, duke i korigjuar dhe duke i dënuar vetëm në individët, ne nuk bëjmë sa duhet dhe si duhet një luftë të thellë ideologjike kundër këtyre shfaqjeve që të mos shndërrohen në tendenca dhe në rryma.

Ç'do të thotë të jesh konservator në zbatimin e politikës së kuadrit? Kjo do të thotë të mos ecësh me zhvillimin e vrullshëm të revolucionit tonë, të mos e kuptosh këtë zhvillim, të mos e ndjekësh atë dhe të tërhiqesh zvarrë, duke e frenuar zhvillimin. Kjo natyrisht do të thotë të mos i kesh të qarta parimet e Partisë, të kesh rezerva, të mos kesh besim në

zhvillimin krijues dhe të nënvleftësosh rolin e masave, aftësitë e tyre politike, organizative dhe të mbivlerësosh e të kënaqesh vetëm me atë që është bërë; të kesh frikë nga çdo gjë që është e re, novatore, premtuese dhe nën maskën e ruajtjes nga gabimet të preferosh të frenosh, se gjoja kështu mund të bëhen gabime më pak. Këndeje lind mosbesimi në kuadrot e rinj, ngjallen një dashuri dhe miqësi e sëmurë për shokët e vjetër, për bashkëpunëtorët e vjetër, pse gjoja i ke njohur në punë, kanë përvojë, kanë merita të pazëvendësueshme etj., etj. Natyrisht, këtyre pikëpamjeve individi përpiqet t'u gjejë edhe individë të tjerë që mendojnë pak a shumë si ai dhe kështu nga një bëhen shumë, bëhet një tendencë, një vijë, që, po të mos luftohen nga Partia, vishen me «arsyet» gjoja të drejta «të qederit, të kujdesit, të mungesës së përvojës, të asaj që duhet ta provojmë», që janë të arsyeshme, por që nuk shihen nga këta njerëz në dritën e vërtetë siç na mëson Partia.

Ç'është familjariteti në punë, në zbatimin e politikës së kuadrit dhe në çdo sektor të Partisë? Familjaritet, vjen nga fjala familje. Partia familjen nuk e dënon, përkundrazi e mbron dhe e forcon, duke spastruar nga ajo botëkuptimet e vjetra borgjeze dhe mikroborgjeze që e rregullonin dhe e drejtonin atë. Këto botëkuptime të vjetra jomarksiste ekzistonin dhe ekzistojnë të rrënjosura, ku më shumë dhe ku më pak, në pjesëtarët e familjes, por edhe si zakone e ligje të kësaj celule të shoqërisë.

Ç'janë këto mbeturina që shfaqen në të dyja planet? Përveç të tjerave janë «shpirti i familjes, i

klanit, i fisit», «mbrojtja dhe interesi i familjes si entitet mbi atë të shoqërisë dhe shumë herë në dëm të kësaj të fundit», «mbrojtja dhe mbështetja me të drejtë ose pa të drejtë e çdo pjesëtari të familjes», «në gjirin e familjes nuk ka asgjë të fshehtë, por çdo gjë gjykohet e çmohet në bazë të këtij entiteti dhe në interesin e këtij entiteti, ligjet e familjes qëndrojnë mbi ato të shoqërisë». Në një familje të tillë ekziston patriarkalizmi, që do të thotë pushteti i babës. Merret me mend pra se ç'barëra të egra dhe të helmatisura mund të mbijnë dhe të marrin zhvillim në këtë truall të infektuar me këto koncepte antimarksishte, antishoqërore. Egoizmi, nga ndjenjë e neveritshme që çdo gjë e lidh me veten, me individin, kalon në një ves masiv, prona private merr kuptimin e egër, interesi personal mbisundon mbi çdo gjë. Duke i shtruar përciptazi dhe shkurtazi këto, merret me mend ç'dëme i sjell punës së Partisë dhe të shtetit kjo frymë, kur nuk luftohet dhe lejohet të kalojë në politikë.

Ne flasim kundër familjaritetit në punë, por nuk shihet sa duhet rrezikshmëria e kësaj së keqeje për Partinë, për socializmin dhe vazhdohet të mbrohen shokët që gabojnë, pse «jemi shokë, kemi luftuar tok, kemi punuar tok». Kjo frymë e sëmurë kalon nga platforma e «shokut» në platformën e dikasterit, të ndërmarrjes, të komitetit, lind shpirti i repartit që ne e përmendim, por shumë herë edhe buzëqeshim dhe themi, «hajde se s'ka gjë». Kjo ka rreziqe të mëdha. Çdo gjë që nuk i qëndron termometrit të pagabuar marksist-leninist, është e sëmurë, tregon se trupika ethe dhe sëmundje të tjera më të rënda mund

t'u shkaktohen njeriut, Partisë, shoqërisë, socializmit.

Mundet që u zgjata në këto çështje, bëra dhe përsëritje për shumë gjëra që Partia vazhdimisht i ka shtruar dhe i ka zgjidhur me sukses, por përfitova nga ky rast për të përforcuar ca më shumë çështjen e zhvillimit të një pune akoma më të thellë politike dhe ideologjike për të gjitha këto probleme. Duhet t'u shkojmë problemeve deri në taban, t'i analizojmë qartë dhe në mënyrë të kuptueshme për kua-drot dhe për masat. Të largohemi nga formulat dhe nga citatet e shkëputura. Mendoj se çdo gjë duhet të shfrytëzohet në mënyrë të zgjuar dhe të thjeshtë, popullore, për të arritur në përfundime me përmbajtje të thellë parimore, ideopolitike, që t'u shërbejnë kua-drove dhe masave konkretisht në punë, në jetë.

Edukimi me moralin komunist mendoj se duhet të konsistojë në atë që t'i armatosë njerëzit si duhet, në këto çështje të jetës, me mësimet e marksizëm-leninizmit dhe t'u krijojmë atyre, t'u rrënjosim, t'u kalitim që në vegjëli dhe deri në pleqëri konceptet dhe botëkuptimin e shoqërisë socialiste dhe komuniste. Shumë ka bërë Partia në këtë drejtim dhe shumë po bën, por akoma më shumë na vihet detyrë të bëjmë në të ardhmen. Po kalojmë nga një etapë në tjetrën, nga një stad në tjetrin, nevojat shtohen, kërkesat po ashtu, njerëzit rriten, zhvillohen, krijo-hen kushte të reja, prandaj metoda të reja pune, lufte dhe edukimi kërkojnë situatat dhe jeta. Vetëm Partia është në gjendje të bëjë analizën e drejtë, të përcaktojë orientimet e përshtatshme, të bëjë përgji-thësime, të krijojë format dhe metodat më të për-

shtatshme e më frytdhënëse. Të gjitha këto, e gjithë kjo punë e Partisë, e zgjuar, e zhdërvjellët, dinamike e parimore në çdo gjë, do të fuqizojë vijën, do të forcojë kuadrot e masat dhe do të arrijmë fitore të atilla që tani nuk na i merr dot mendja.

Partia jonë, veçanërisht në këtë kohë, kur revizionizmi modern, me renegatët sovjetikë në krye, po sulmon teorinë tonë revolucionare dhe po restauron kapitalizmin në Bashkimin Sovjetik e në vendet e tjera ku në fuqi janë revizionistët, ka një mision të madh e një detyrë të rëndë, të mbajë lart dhe të përkulur flamurin e marksizëm-leninizmit, që do të thotë të kryejë si duhet detyrat dhe të bëhet shembull në planin e brendshëm, duke ndërtuar socializmin dhe komunizmin, dhe në plan ndërkombëtar të jetë pishtarë e zbatimit korrekt të ideologjisë marksiste-leniniste dhe të internacionalizmit proletar.

Kurrë të mos harrojë Partia se, si pararojë e organizuar e klasës punëtore dhe duke ruajtur si sytë e ballit këtë parim të madh, ka për mision të lartë jo vetëm ta ruajë, por çdo ditë ta kalitë unitetin e popullit rreth saj, pse ky unitet është jetik më tepër se çdo herë tjetër në rrothanat e këtij rrethimi kapitalisto-revizionist, siç ndodhet Shqipëria socialiste. Ky unitet vetëm në këtë rrugë, vetëm me këtë vijë, që ndjek Partia jonë, mund të ruhet dhe të kalitet. Çdo shmangie është katastrofë.

Vija marksiste-leniniste e Partisë sonë është sintetizimi në rrugën e dialektikës materialiste marksiste i luftës, i aspiratave, i realizimeve, i veprave revolucionare të masave. Kjo vijë e drejtë e Partisë pasuro-

het çdo ditë nga përvoja e masave dhe materializohet në të mira materiale dhe morale të mëtejshme.

Pra, masat krijojnë, Partia udhëheq, sintetizon, edukon dhe përsëri krijon. Kështu, gjatë këtij procesi të vazhdueshëm janë Partia dhe masat që jo vetëm krijojnë e realizojnë, por, nëpërmjet kësaj krijimtari të madhe e të frytshme, ato edukohen, fitojnë përvojë, dituri, zotësi, vendosmëri etj.

Në këto lëvizje të mëdha revolucionare, lëvizje të gjera masash, që frymëzohen dhe udhëhiqen nga Partia, lind dhe kalitet edhe etika jonë marksiste që ka në bazë materializmin historik dhe ku evolucioni shoqëror i nënshtrohet evolucionit ekonomik.

Pra, në krijimtarinë e madhe të masave e të Partisë dhe në procesin e zhvillimit ekonomik të vendit tonë në rrugën e socializmit, lindin e afirmohen edhe normat e vërteta të moralit të ri socialist. Pikërisht në këtë rrugë revolucionare ne u bëmë marksistë dhe u kalitëm në luftën e masave dhe të revolucionit proletar. Ne nuk u formuam as nga parimet sociale aristoteliane, ose të Spencerit dhe as nga etika e Spinozës ose teoritë e Zhan-Zhak Rusoit. Ne bëmë edhe pa i njohur teoritë e tyre filozofike, bile më mirë që nuk i mësuam, se do të na ngatërronin. Por ne nuk mund të kishim jetë, nuk mund të bënim asnjë hap përpara, do të sorollateshim si qorra dhe si skllever në shekuj, pa Marks, Engelsing, Leninin dhe Stalinin, pa teorinë tonë të lavdishme marksiste-leniniste. Disa mund të thonë se, që të kuptohet dhe të zbatohet Marksi, duhet të studiohen medoemos korrentet e mëparshme filozofike të men-

dimit njerëzor, ashtu siç bëri edhe Marksi. Kjo nuk është e thënë dhe shumë herë jo e domosdoshme. Gjeneraliteti i Marksit dhe i Leninit e bënë këtë, na ndritën rrugën, i vunë të gjitha në vend dhe na krijuan armën e mprehtë për të çarë përpara. Dije-tarët dhe filozofët le t'i studiojnë me hollësi, po të duan, korrentet e vjetra filozofike, shoqërore dhe etike idealiste, por vetëm të mos harrojnë kurrë një gjë, të ruhen se mos u ngatërrohet mendja dhe nga-tërrojnë pastaj edhe të tjerët me sofizma dhe me ndër-time të gjithfarë teorish e interpretimesh false idealiste, revizioniste, siç po ngjet me shumë të ashtuquajtur filo-zofë dhe estetë revizionistë, që hiqen si marksistë, por që çdo gjë mund të jenë, vetëm marksistë nuk janë.

Kjo nuk do të thotë të mos studiosh zhvillimin e mendimit njerëzor dhe evolucionet e tij, nuk do të thotë të mos studiosh zhvillimin ekonomik-shoqë-ror të njerëzimit. Është gabim të mendosh kështu, por në këtë studim duhet të udhëhiqesh fort nga marksizëm-leninizmi, çdo skaj të ta ndritë drita e teo-risë sonë marksiste-leniniste. Po edhe kjo nuk është e mjaftueshme në rast se studiuesi nuk merr pjesë aktive, nuk futet i tëri kokë e këmbë në dallgët e revolucionit, që të bëhet luftëtar aktiv i tij, sepse te revolucioni e ka burimin teoria jonë, prej tij ajo pasurohet dhe tek ai vërtetohen parimet e filozofisë sonë materialiste marksiste-leniniste.

Në bibliotekën time në shtëpi kam veprat e Ru-soit në frëngjisht, në mes të të cilave edhe «Emilin». Por nuk mungoi të më vinte «Emili» i përkthyer edhe në shqip. Pyes, kujt i duhet «Emili» në shqip,

që botohet dhe u jepet masave tona ta lexojnë atë libër filozofik borgjez të shekullit të 18-të që i ka ikur krejt koha, jo më për ne që ndërtojmë socializmin dhe që rritim e edukojmë një rini të zjarrtë revolucionare, në luftë të hapët me parimet sociale të Rusoit, por edhe për vetë borgjezinë, e cila e ka vënë këtë libër në raftin e bibliotekave, pse është anakronik edhe për edukimin aktual të rinisë borgjeze? Ata që humbasin kohën kot duke përkthyer gjëra të tilla, kanë lakra në kokë dhe ne, si pa gjë të keqe, ua ujitim atyre këto lakra, duke botuar libra si ky, vetëm për «famën e Rusoit».

Rrojmë në kohë historike dhe vendimtare, shokë, kur Partia po udhëheq revolucionin në mënyrë të shkëlqyer. Askush nuk duhet të mbetet jashtë këtij revolucionit të madh. I madh e i vogël duhet të kontribuojnë, të mendojnë, të punojnë për të, në të gjitha drejtimet, në të gjitha specialitetet, me të gjitha kapacitetet. Mendimet dhe veprat e cilitdo duhet të jenë të lidhura me nyje të pazgjydhshme me revolucionin tonë, krijimtaria e çdo njeriu duhet të frymëzohet nga revolucionit i masave që udhëheq Partia dhe ta fuqizojë këtë revolucion. Këndeje duhet të frymëzohen pedagogët dhe mësuesit, shkrimtarët, poetët, kompozitorët, këngëtarët, artistët, profesorët, shkencëtarët; këndeje, nga revolucionit proletar, nga vepra masive e popullit për ndërtimin e socializmit dhe për krijimin e të mirave materiale, duhet të udhëhiqen e të frymëzohen gjithë njerëzit tanë në punët e ndryshme të tyre dhe për revolucionin, për socializmin të destinohet çdo punë, çdo krijimtari e tyre.

Vetëm duke ndjekur këtë rrugë ne do të pastrojmë truallin tonë nga barërat e këqija të së kaluarës, vetëm kështu do të afirmohet dhe do të kalitet etika marksiste-leniniste, do të zhvillohet shkenca jonë sociale marksiste-leniniste. Vetëm në këtë rrugë dhe jo nga imagjinata të sëmura ose nga studime të kota libeske, ne do të farkëtojmë njeriun e ri komunist që ndërton socializmin dhe që ngritja e tij politike, ideologjike e teknike ta pasurojë këtë zhvillim revolucionar të vendit dhe të mos mbetet prapa këtij zhvillimi nga ana intelektuale dhe morale, pse atëherë bëhet frenim.

Partia, populli, kuadrot, të gjithë si një trup i vetëm, ecin me vendosmëri në këtë rrugë. Vetëm po të analizojmë kohën që nga mbajtja e Kongresit të 5-të e deri tani, ne vërejmë ç'hov të madh të paparë revolucionar ka krijuar Partia, ç'energji kolosale janë hedhur në luftë, sa rezerva të mëdha janë dukur dhe sa të tjera flenë akoma. Ç'heroizëm masiv është krijuar dhe sa me vrull aksionet ndjekin aksionet! Është krijuar kudo një optimizëm i madh, një gëzim nga puna dhe nga lodhja që nuk shkon kot, ka një etje të madhe për të mësuar, për t'u korrigjuar, për t'u spastruar nga të këqijat e së kaluarës. Kjo është një shkundje e të këqijave në masë dhe ky është spastrimi më rrënjësor, më me bazë, pse kjo kalon nga ndërgjegjja individuale, në ndërgjegjen kolektive. Prandaj cilido duhet t'i përgjigjet këtij hovi me të gjitha forcat e shpirtit dhe të trupit të tij.

Letra të thjeshta dhe plot ndjenja të popullit kanë ngritur lart zemrat e gjithë njerëzve tanë. Ç'du-

het të bëjnë në këtë rast shkrimtarët tanë të të gjitha gjinive? Të nxjerrin romane, pjesë teatrale e poezi nga dhoma, të shtrydhin e të stërhollojnë disa fakte banale dhe të na fabrikojnë disa tipare «psikologjike» të paqena dhe të alambikuara, apo të shkojnë të luftojnë tok me masat dhe mbi këtë bazë të pasqyrojnë hovin revolucionar, këtë filozofi të tyre dhe të nxjerrin tiparet e vërteta të psikologjisë së vërtetë proletare?

Ne kemi akoma shumë për të bërë, në shkolla e kudo, por, duke mbaruar me këtë, desha të them dy fjalë për filozofët dhe studiuesit tanë, veçanërisht për ata të shkencave historike dhe shoqërore.

Unë mendoj, në qoftë se nuk gabohe, se ata duhet t'i bëjnë një rishqyrtim serioz punës së tyre, si nga forma, por sidomos nga tematika e punimeve të tyre dhe nga përmbajtja.

Forma ka rëndësi, ka rëndësi si e paraqit punimin, por ka rëndësi të mendosh për kë e destinon, e destinon për dijetarë të paktë në numër apo për masën? Në rast se e destinon për disa të paktë, mund të kesh bërë një punë «shkencore», por atë s'ta lexojnë dhe s'ta kuptojnë ata që duhet ta lexojnë dhe që duhet ta kuptojnë dhe këta janë shumica.

Në qoftë se shkon nga parimi se veprën ia destinon shumicës, atëherë je në rrugë të drejtë, atëherë gjej forma të thjeshta dhe të përshtatshme, me të cilat mund të thuhet edhe ide të thella dhe të realizohen gjëra të mëdha. Këto forma mund t'i gjejsh vetëm në popull dhe jo në librat akademikë, në të cilët referohu, por mos harro qëllimin.

Ndjek kurdoherë me vërejtje tematikën e buletineve të historisë dhe të shkencave shoqërore që nxjerr universiteti ynë. Ato janë mbushur me tema të historisë së lashtë të vendit tonë, të çdo natyre, janë mbushur me rilindësit. A është keq? Aspak. Kjo është shumë e mirë, por këto kanë vendin e tyre, si sasi dhe si cilësi. Kurse probleme të Luftës Nacionalçlirimtare, probleme të kohës sonë të socializmit, të ekonomisë, të historisë, të luftës së klasave e probleme shoqërore sheh pak. Kjo nuk është serioze. Kjo do të thotë të mos ecësh hap pas hapi me kohën, do të thotë të mos e ndihmosh zhvillimin shoqëror me këtë pasuri dhe përvojë të madhe materiale dhe shpirtërore për të cilën ka nevojë aq shumë njeriu i ri i Shqipërisë socialiste. Sigurisht, njeriu i ri mund t'i lexojë edhe ç'thoshin konsujt e Venedikut në shekullin e 15-të për ne, por të harrohen problemet e rëndësishme aktuale në të cilat përpjek kokën çdo ditë punonjësi ynë, kjo nuk është rruga e drejtë dhe e balancuar e studiuesve tanë.

Prandaj, si në çdo gjë, edhe në këta sektorë duhet të bëhet një kthesë pozitive, duke i dhënë prioritetin asaj më të domosdoshmes, pa harruar dhe të tjerat që mund të jenë të nevojshme.

Duke kritikuar punonjësit tanë shkencorë në këtë çështje nuk mund të shfajësohen shokët e Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës, të Institutit të Historisë dhe të Gjuhësisë, universiteti, katedrat e ndryshme, por në këtë drejtim duhet të ndihmojnë më shumë edhe sektorët e agjitacionit e të propagandës në Ko-

mitetin Qendror, Shkolla e Partisë, Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste.

Duhet, më duket mua, të kuptohet thellë si një punë me rëndësi të madhe rishikimi i orientimeve dhe i praktikës konkrete që është vendosur në studimin e shumë problemeve. Nuk mund të themi se nuk veprohet në këto drejtime, por nuk veprohet ashtu si duhet për shumë arsye dhe arsyeja kryesore, mendoj unë, qëndron në atë që për këto probleme mjaft të rënda dhe të koklavitura disa kuadro nuk thellohen shumë në direktivat dhe në orientimet e Komitetit Qendror, që ato të zërthehen deri në fund dhe në gjerësinë e tyre. Kjo ka rëndësi të madhe, për arsyen se kemi të bëjmë me rektifikimin e shumë praktikave dhe metodave të vendosura me kohë, nga të cilat nuk mund të shkëputesh kollaj, pse ndërhyjnë në këto çështje format dhe metodat e vjetra të adoptuara nga shkolla të ndryshme, me të cilat janë edukuar shumë nga njerëzit tanë. Këta e kanë zor të shkëputen nga ato gjëra dhe nga ato forma me të cilat janë mësuar të punojnë vite me radhë.

Ekzistojnë tek intelektualët në përgjithësi (por edhe tanët nuk mund të bëjnë përjashtime) një ndjenjë konservatorizmi dhe egoizmi intelektual, një mendjemadhësi në intelektin e tyre dhe në format e metodat që ata përdorin, për të mos folur për idetë dhe për mendimet e tyre të formuara që përbëjnë çështjen kryesore të problemit. Prandaj është e domosdoshme që direktivat dhe orientimet e Komitetit Qendror të thellohen deri në fund, që të kthjellohen idetë dhe pastaj të spastrohen format, tekstet, të cak-

tohen kritere pune të reja e të drejta dhe të veprohet në mënyrë të organizuar me masa konkrete. Kur Partia thotë të pastrohen teprimet, gjërat e panevojshme dhe disa herë të gabuara nga tekstet, ky është një problem shumë i madh dhe jo i lehtë, si nga ana ideologjike, pedagogjike, por edhe teknike. Ç'po bëhet për këtë? Unë nuk di sa seriozisht e ka marrë këtë Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, por shoh vetëm në gazetën e rinisë ndonjë rubrikë dhe në gazetën «Mësuesi» ndonjë mendim të rastit, të pathelluar, të ndonjë mësuesi. Kështu ky problem nuk zgjidhet.

Këto çështje unë i ngre pse nuk duhet të kuptohen si gjëra të kufizuara të një sektori, si gjëra që mund të zgjidhen vetëm duke mobilizuar disa punonjës të arsimit; ky është një problem kyç që ka për objektiv të madh të edukojë në rrugën marksiste-leniniste breza të tërë, me moral të ri, me botëkuptim të ri. Ky edukim bëhet me forma dhe me metoda të reja, të cilat duhet jo t'i adoptojmë duke thënë se kështu i ka ky ose ai, por t'i gjykojmë si duhet t'i kemi ne, nëse janë të përshtatshme për ne, sa na shërbejnë dhe si duhet të na shërbejnë më mirë neve, në realitetin tonë konkret, në situatat tona të përshtatshme. Këto, pra, janë në radhë të parë, çështje partie, pse kësaj i bie barra e rëndë dhe detyra e madhe të edukojë kuadrot dhe masat.

Edhe kur them se i përket Partisë ta marrë në dorë seriozisht këtë çështje, duhet të kuptohet drejt, se nuk kuptohet si duhet dhe sa duhet nga kushdo. Organizatat e Partisë në rrethe, që nga organizata-

-bazë e deri në komitet, për këto probleme vetëm mendojnë të zbatojnë dhe kjo shpeshherë bëhet me shumë të meta, por jo të krijojnë, të sugjerojnë, të kritikojnë, me një fjalë të ndihmojnë më shumë qendrën që të ndërtojmë dhe të rindërtojmë më shpejt dhe si duhet njeriun e ri të socializmit dhe të komunizmit.

Kur ne themi se shkrimtarët duhet të venë në bazë, pse atje do të gjejnë burimin e freskët dhe të kulluar, atëherë ç'mund të themi për ata shokë që janë me dhjetëra mijë, që rrojnë dhe punojnë poshtë në bazë tok me popullin? A nuk janë këta ndërtuesit e shpirtrave të rinj shumë më të kualifikuar se ndonjë shkrimtar a poet? Por që të bëhet mirë një punë e tillë, nga ana e komunistëve, njerëzit, punët, realizimet, vendimet e direktivat duhet të shikohen nga të gjitha anët thellë e jo cekët, dhe nga këto kurdoherë të nxirren konkluzione të drejta, të matura e të bëhen përgjithësime që janë aq shumë të nevojshme, sepse mbi këto përgjithësime të shumta e të drejta do të mbështetet Partia në atë që thashë më sipër, për të ndërtuar dhe për të udhëzuar në bazë të realitetit tonë dhe që t'i shërbejë këtij realiteti.

Le të marrim, për shembull, një problem shumë të rëndësishëm dhe akut që i vihet përpara Partisë: zgjimin dhe përparimin e malësive dhe në radhë të parë të malësive të Veriut. Ky problem i madh ekonomik dhe shoqëror nuk mund të zgjidhet duke menduar si e kanë zgjidhur të tjerët, por si duhet ta zgjidhim vetë ne, duke u bazuar në gjendjen tonë reale, në karakteristikat tona të veçanta, në mundësitë tona konkrete, duke shfrytëzuar eksperiencën tonë

dhe duke bërë eksperimente të reja. Çdo gjë e mirë e fituar nga eksperiencia e të tjerëve nuk është kurrë e keqe, por kjo të shërbejë si ndihmë dhe jo si shabllon.

Duhet të rrënjosim dhe të kalitim botëkuptimin tonë të ri në malësorët e Veriut, moralin e ri, format dhe metodat e reja socialiste të ndërtimit dhe të prodhimit në një ekonomi të zgjeruar socialiste. Për t'ia arritur kësaj në një kohë sa më të shkurtër, që të kapërcehet prapambetja në këto zona, Partia po përdor dhe duhet të përdorë të gjitha mjetet, format e metodat që disponon dhe të krijojë të reja nga eksperiencia e fituar.

Shumë rrugë ndjekim dhe shumë rrugë të reja duhet të hapim për edukimin e masave dhe të malësive me parimet e ekonomisë së re, të moralit të ri, të arsimit dhe të kulturës socialiste. Në radhë të parë në këto zona duhen edukuar komunistët, njëkohësisht kuadrot dhe masat, dhe kjo gjë duhet të bëhet me forma të shumëllojta, të veçanta dhe masive, të çdo lloji.

Që këto forma edukimi të na japin rezultatin e duhur, Partia duhet të zotërojë, të ketë të qartë, si në pëllëmbën e dorës, shpirtin dhe gjendjen e malësisë dhe mbi njohjen reale të kësaj gjendjeje të ndërtohet çdo punë dhe çdo formë pune.

Malësorët kanë shumë karakteristika morale të larta, fisnike, që Partia duhet t'ua ruajë, por njëkohësisht t'ua llogarojë nga mbeturinat e vjetra me të cilat ato shumë herë janë njollosur. Kjo është njëra detyrë. Detyra tjetër, po aq e madhe bile edhe më

e madhe, është t'u krijojë tipare të reja morale që t'u shtohen të parave të cilat ata, për shumë rrethana ekonomike e shoqërore, nuk kanë pasur të gjitha mundësitë t'i zhvillonin dhe t'i lëmonin.

Malësorët dhe malësoret tona janë njerëz të zgjuar, të mprehtë, trima; ata janë njerëz të fjalës, të besës, të matur dhe të heshtur, të regjur nga vështirësitë ekonomike të së kaluarës dhe të shtypjes feudalo-klerikale. Këto tipare të malësorëve janë krijuar pikërisht nga ato kondita të veçanta ekonomike dhe të terrenit, që kanë zhvilluar atë gjendje shoqërore, e cila ka lënë gjurmët e veta në karakterin e njerëzve, në botëkuptimet e tyre, në mënyrën e prodhimit, të jetesës etj. Këto janë probleme me rëndësi shoqërore ku Partia duhet të thellojë studimin.

Në kryelartësinë e malësorëve do të gjejmë edhe influencën e bajraktarizmit, të pushtetit patriarkal dhe fisnor në bazë të Kanunit, do të gjejmë mbeturinat e theksuara të kapadailëkut, të mendjemadhësisë së «derës së madhe». Në natyrën «e qetë dhe të heshtur të fshatarëve» ne duhet të gjejmë ndjenjën e izolimit, të një jete të vetmuar në male, të mbledhur në vetvete, të një zhvillimi të ngushtë shoqëror e familjar, në luftë të vështirë për t'u ruajtur dhe për t'u mbrojtur nga konditat e rendit shoqëror feudalo-borgjez. Të gjitha këto e të tjera kanë lënë mbresa të thella, që na vihet si detyrë t'i zhdukim nga botëkuptimi i fshatarëve të malësisë, pse vetëm kështu do të spastrojmë rrugën e përparimit socialist.

Na vihet për detyrë t'i riedukojmë me kujdes komunistët e vjetër në malësi, pse dobësitë e punës së

bërë, gjatë kohës kur malësia ishte akoma e pakolektivizuar, i kanë lënë ata me plot të meta dhe me pikëpamje të huaja, siç janë konceptet patriarkale për Partinë, pajtimi i qenies anëtar partie me idetë borgjeze të pronës, të komandimit, të shfrytëzimit të autoritetit për interesin personal. Duke i vënë këtë detyrë të madhe Partisë, kësaj i vihet detyra e edukimit në masë të malësorëve nëpërmjet shkollës dhe edukatës rrënjësore politike e ideologjike, të cilat duhet të synojnë për të luftuar dhe për të zhdukur konservatorizmin, arkaizmin, patriarkalizmin dhe bajraktarizmin në ideologji dhe në jetën praktike familjare, për të luftuar sistematikisht fenë, misticizmin, liturgjinë dhe rutinën e praktikave fetare në format e hapëta ose të mbyllura të tyre.

Partia ka vendosur dhe zhvillon një sërë formash dhe metodash për këtë luftë dhe për këtë edukatë, siç janë arsimiti i përgjithshëm me karakter masiv, zhvillimi me mjete të shumta i kulturës, të cilat duhet t'i shtojmë dhe t'i perfeksionojmë akoma në çdo drejtim. Kurset e ndryshme, të çdo natyre, janë gjithashtu një mjet shumë i mirë edukimi për njerëzit.

Të gjitha këto janë të mira dhe duhet t'i vazhdojmë e t'i perfeksionojmë me ngulm, por ne duhet të gjejmë format që të përfshihen të gjitha masat në këtë ringjallje të madhe. Arsimiti i përgjithshëm është një shembull i edukatës masive të rinisë. Shkuarja e rinisë në përgjithësi dhe në veçanti e asaj të malësisë në aksionet e mëdha kombëtare, është gjithashtu një formë nga më të mirat për edukimin ma-

siv, të cilën ne duhet ta vazhdojmë dhe ta zhvillojmë.

Ne pamë ç'efekt të madh bëri ardhja e cucave të malësisë në hekurudhë, efekt të madh jo vetëm tek ato vetë, por edhe në fshatrat dhe në familjet e tyre. Prandaj aksionet masive duhet t'i vazhdojmë dhe t'i organizojmë kurdoherë më mirë. Por nuk duhet të mendojmë se çdo gjë u arrit dhe se të rinjtë e të rejat e malësisë i mposhtën mbeturinat në ndër-gjegjen e tyre, thyen presionin e hapët ose të hesh-tur që u bëhet paragjykimëve që ekzistojnë në nje-rëzit e fshatit e të familjes së tyre. Rezistenca e së vjetrës ndihet thellë në malësi. Kjo duhet thyer. Po rezistenca më e madhe vjen nga të vjetrit. Atë-herë le të ndjekim edhe për të moshuarit rrugën dhe format që ndjekim edhe për rininë: aksionet masive, dhe këto jo në drejtimin e punimeve nacionale, por në atë të kooperativave bujqësore. Kooperativizmi na e lejon këtë veprim masiv, këtë edukatë masive. Ne praktikojmë në këtë drejtim seminare kuadrosh, dër-gojmë kuadro në malësi (bile akoma pak po dër-gojmë), dër-gojmë kuadro për të marrë eksperiencë në kooperativat e përparuara. Këto duhet t'i vazhdojmë, por nuk janë kurrë të mjaftueshme, prandaj të zba-tojmë eksperiencën e mëposhtme dhe ta shfrytëzojmë këtë si një formë të edukimit të shumanshëm ma-siv, sidomos për të ndihmuar malësinë.

Të organizojmë skuadra të tëra me burra dhe me gra nga çdo kooperativë e malësisë dhe këto të shkoj-në të punojnë një ose dy muaj në kooperativa nga më të përparuarat të fushës ose të malësisë, në Shqi-përinë e Mesme dhe në atë të Jugut. Skuadra të

tjera me burra dhe me gra, me po atë numër, të shkojnë në kooperativat e malësisë nga ato kooperativa ku do të venë skuadrat e malësisë. Në këtë mënyrë ekonomikisht nuk kemi humbje, pse ditët e punës u shkruhen reciprokisht dhe ushqimi ditor i çdo kooperativisti kompensohet, pse cilido nga palët do të rrojë dhe do të hajë në familjen e njëri-tjetrit.

Por cili është përfitimi i madh i këtij veprimi që mendoj unë? E para, shkëmbimi dhe përfitimi në mënyrë masive nga eksperienca e njëri-tjetrit në punët e bujqësisë. Malësorët njihen me Jugun dhe Jugu me Veriun, vëllazërohen e miqësohen akoma më tepër. Malësori, që ka nevojë më shumë, shikon dhe jeton një jetë krejt të ndryshme në shumë pikëpamje nga ajo që bën ai, mëson se si mendojnë vëllezërit e tij të Jugut për probleme të jetës dhe kështu do të arsyetojë e do të fillojë të mendojë ndryshe për shumë gjëra. Kurse ata të Jugut që do të shkojnë në malësi, jo vetëm që do të mësojnë nga malësorët, por do t'u mësojnë malësorëve në mënyrë masive shumë gjëra të jetës, të zakoneve, të agroteknikës. Te malësorët kjo formë edukimi bëhet e dyfishtë: nga ata vetë që shkojnë në Jug dhe nga ata që u venë nga Jugu në shtëpitë e tyre në malësi. Njerëzit e Jugut e të Veriut do të edukohen më thellë ideologjikisht, do të bëhen më të ndërgjegjshëm për rrugët e zhvillimit dhe për të mirat e kolektivizimit në shkallë të gjerë nacionale.

Kështu ne thyejmë shumë gjëra: thyejmë rezistencën që mund t'i bëhet së resë përparimtare në malësi, thyejmë ndjenjën e vetmisë dhe të izolimit,

çelikosim dashurinë për njëri-tjetrin, çelim horizonte të reja për malësozin, pse nga këto lëvizje ai jo vetëm që mëson, mpreh mendjen, por njëkohësisht njih edhe madhësinë e forcën e Partisë dhe të atdheut, del nga bota e vogël e tij në botën e madhe, ndien dhe kupton forcën krijuese të vijës së Partisë, forcën dhe zotësinë e klasës punëtore që e udhëheq dhe që është në aleancë me të. Në rast se Partia e kupton mirë këtë çështje dhe e organizon punën në familjet ku do të jetojnë malësorët e malësoret në hollësitë më të vogla në jetën politike dhe familjare, që kjo kohë të kthehet me të vërtetë në një shkollë edukimi për ta, të mirat që do të kemi nga kjo do të jenë të pallogaritshme.

Partia duhet të vërë të gjitha forcat dhe kapacitetet e saj, të ndritura nga marksizëm-leninizmi, për të ngritur popullin në një nivel të lartë politik dhe ideologjik që të përballojë me sukses ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit. Kurrë të mos harrojmë se jemi një ishull i vogël, por prej graniti, në mes të një oqeani të madh me valë të tërbuara, të cilat duhet t'i thyejmë dhe të triumfojmë mbi to. Të mos harrojmë ç'ngjau në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera ku sundojnë revizionistët. Pas gjysmë shekulli Bashkimin Sovjetik, vendin e sovjetëve, e mbuloi kundërrevolucioni. Me dhjetëra dhe qindra mijë kuadro që përgatiti revolucioni (këtu flas për ata të mirët) u hutuan dhe janë vënë nën thundrën e kundërrevolucionarëve revizionistë modernë. Të tjerët tradhtuan revolucionin. Populli sovjetik që bëri revolucionin, që ndërtoi socializmin, që fitoi luftën

mbi nazizmin, sot është nën zgjedhë, në përgjithësi i hutuar, i heshtur. Kjo nuk duhet të ngjasë kurrë te ne dhe, që të mos ngjasë kjo, Partia vazhdimisht duhet të kalitet, duhet të kalitë njerëzit e saj, kuadrot, të gjithë popullin në masë, t'i drejtojë vazhdimisht e kurdoherë në luftë, në revolucion, t'i mbajë ngritur, t'u mprehë mendjen, guximin, besimin, iniciativën, përgjegjësinë, t'i bëjë të ashpër kundër çdo armiku, çdo armiqtësie që mund t'u bëhet Partisë dhe socializmit, të mos i lërë njerëzit t'i zërë gjumi, të flenë në dafina, të zënë ndryshk në ndërgjegje, por t'i bëjë të zotë, t'i pajisë me një ndërgjegje të pastër proletare dhe me njohuritë më moderne të teknikës e të kulturës. Kjo është garancia më e madhe e ecjes përpara në rrugën tonë që na ka hapur dhe na ndrit Partia.

Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1967-1968», f. 306. Tiranë, 1969

Botohet sipas librit: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje rreprash) 1968-1970», f. 3

PARTIA REVOLUCIONARE I ÇON MASAT GJITHNJË PËRPARA NË REVOLUCION

*Nga biseda me një delegacion të Partisë Komuniste (m-l)
të Australisë¹*

1 shkurt 1968

*Pas shkëmbimit të përshëndetjeve e mori fjalën
shoku Enver Hoxha:*

Siç ju kanë folur edhe shokët, gjatë 4-5 vjetëve të fundit në vendin tonë janë bërë shumë përparime, si në fushën e industrisë e të bujqësisë, ashtu edhe në atë të arsimit e të kulturës. Rezultate të mëdha janë arritur veçanërisht në revolucionarizimin e mëtejshëm të Partisë dhe të masave të gjera të popullit. Në Kongresin e 5-të të Partisë ne morëm vendime shumë të rëndësishme për t'i dhënë një impuls të ri ndërtimit të socializmit në vendin tonë.

Me frymën e vendimeve të këtij Kongresi ne iu përveshëm punës për materializimin në praktikë të tyre, për realizimin e planeve të prodhimit e të ndërtimit, për shpejtimin e ritmeve të ndërtimeve indu-

1 Në vitin 1976 kreu i saj, Eduard Hill, e lidhi këtë parti pas qerres së revizionistëve kinezë.

striale, për fuqizimin e rendit kooperativist në fshat, për forcimin e mëtejshëm të punës edukative, politike, ideologjike, për ngritjen tekniko-profesionale të kuadrit e të masave, për zhvillimin e revolucionit tekniko-shkencor në frymën e marksizëm-leninizmit, duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë që kemi për përparimin e shkencës dhe të teknikës në çdo sektor.

Si rrjedhim, planet tona për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës për vitin e kaluar jo vetëm u realizuan, por edhe u tejkaluan. Kështu, për shembull, punëtorët dhe inxhinierët tanë, që po ndërtojnë hidrocentralin e Vaut të Dejës (të cilin ju mund të shkoni e ta shikoni), duke punuar me një hov të madh revolucionar, realizuan e tejkaluan planin e parashikuar për vitin 1967 dhe morën zotim që ndërtimin e veprës ta përfundojnë dy vjet para afatit. E njëjta gjë ka ndodhur edhe për shumë fabrika dhe objekte të tjera. Kjo tregoi se ne kemi forca e rezerva të mëdha të cilat, nën udhëheqjen e Partisë, do të sjellin përparime të mëtejshme. Edhe vetë ne nuk ishim në gjendje më parë të parashikonim sa e fuqishme do të ishte kjo forcë.

Rëndësi të madhe për ne ka fakti që klasa punëtore, e edukuar me frymën e Partisë, ka kuptuar ç'do të thotë revolucionarizim i vetvetes dhe i prodhimit, ç'do të thotë luftë kundër burokratizmit, ç'do të thotë zhvillim i teknikës dhe i shkencës. Shqipëria është një vend që në të kaluarën s'ka pasur një klasë punëtore të zhvilluar. Numri i punëtorëve para Çlirimit të ne ishte mjaft i kufizuar dhe niveli i tyre tekniko-profesional ishte i ulët. Por pas Çliri-

mit, brenda dy dekadash, klasa jonë punëtore është rritur, ka ngritur nivelin e saj tekniko-profesional duke arritur ta përvetësojë atë dhe ta shpjerë përpara. Këtë e tregon edhe fakti që në shumë degë të industrisë planet e prodhimit po realizohen dhe po tejkalohen.

Rëndësi për ne ka njëkohësisht edhe zhvillimi bujqësisë në rrugën e socializmit. Zhvillim socialist i bujqësisë do të thotë ecja e saj në rrugën e kooperativizmit, kalimi nga prona private në pronën e përbashkët, transformimi dhe zhdukja e mbeturinave të ideologjisë feudalo-borgjeze të fshatarët dhe rrënjosja e ideologjisë socialiste. Këto ishin problemet më të rëndësishme që duhej të kapte e të zgjidhte Partia jonë për realizimin e transformimeve socialiste në fshat. Ato duhej të ecnin tok, kontradiktat të kuptoheshin e të zgjidheshin drejt sipas dialektikës marksiste dhe gjatë këtij procesi njerëzit të kuptonin ideologjikisht dhe të bindeshin plotësisht për domosdoshmërinë e zhvillimit të bujqësisë në rrugën e modernizimit, në rrugën e socializmit, gjë që nuk mund të bëhet me urdhër.

Për këtë qëllim Partia dhe pushteti vunë të gjitha forcat e tyre mendore, politike, ideologjike e materiale dhe arritën në realizimin e plotë të kolektivizimit, në modernizimin e mjeteve dhe të mënyrave të punimit të tokave, në rritjen e rendimentit, në sistemin e tokave. Niveli i jetesës së fshatarëve u përmirësua. Të gjitha këto suksese u arritën sepse fshatarësia kuptoi ideologjikisht dhe pa në praktikë të mirat e kolektivizimit.

Të organizuar në kooperativat bujqësore, fshatarët kuptuan se duhej të ekonomizonin më mirë fondin e përbashkët për forcimin e ekonomisë së kooperativës. Ata morën iniciativa të shkurtonin oborret personale duke mbajtur një fond toke më të vogël për përdorim vetjak, sepse panë konkretisht se forcimi dhe zhvillimi i ekonomisë së kooperativës u sillte të ardhura më të mira, se puna dhe mjetet e përbashkëta janë baza e përmirësimit të jetesës, se interesi i tyre ishte të përqendronin forcat në kooperativë e jo në oborrin kooperativist. Gjithashtu fshatarët, megjithëse akoma mbajnë në oborrin e tyre një sasi të vogël kafshësh personale, si 1 lopë ose 10 kokë bagëti të imëta, ndonjë derr e shpendë, morën iniciativën për të zvogëluar numrin e këtyre kafshëve, sepse kooperativa e fuqizuar ekonomikisht u siguron qumësht e mish. Pra, në këtë rrugë që e udhëheq Partia, fshatari ka arritur të kuptojë ç'do të thotë punë e përbashkët, socializëm.

Ndërgjegjja socialiste është ngritur në një shkallë më të lartë, gjë që u reflektua këta 2 vjetët e fundit në shumë iniciativa të marra nga vetë masat tona punonjëse. Këtë do t'juaj konkretizoj me dy shembuj:

Në aksionin për ndërtimin e hekurudhës Rrogozhinë-Fier, në punë e sipër, u vra një vajzë 15-vjeçare¹. E gjithë rinia e vendit u ngrit për ta zëvendësuar dhe për ta vazhduar punën e saj. Në shenjë solidariteti u morën shumë iniciativa të tjera për të ndihmuar fshatin e saj, i cili ndodhet në një zonë të

¹ Shkurte Pal Vata.

thellë malore. Një kooperativë bujqësore i dhuroi fshatit të kësaj vajze 500 kokë bagëti të imëta. Kjo u bë shkas që kooperativat bujqësore të zonave malore, që janë më të pasura, të merrnin iniciativën për të ndihmuar me bagëti kooperativat më të varfra të malësisë. Rreth 50 mijë krerë (lopë e dhen) iu dhanë falas këtyre kooperativave. Solidariteti socialist u forcua jo vetëm brendapërbrenda kooperativës, por edhe në shkallë kombëtare midis kooperativave, solidaritet i cili tregon ndryshimin e madh në botëkuptimin e fshatarëve tanë, sepse njerëzit me mentalitetin e vjetër borgjez e mikroborgjez nuk të falin asgjë. Ky ka qenë një impuls i madh politik e ideologjik edhe për forcimin e mëtejshëm të unitetit e për rritjen e prodhimit.

Këto iniciativa që përmenda e shumë të tjera, vunë në lëvizje masat. U shtua dashuria për tokën, për pronën e përbashkët, për punën dhe u rrit edhe më tepër mobilizimi i ndërgjegjshëm i masave për ndërtimin e socializmit. Direktiva e Kongresit të 5-të të Partisë për t'i bërë kodrat e malet pjellore si edhe fushat po bëhet realitet. Po të udhëtoni gjatë rrugëve nacionale, do të shikoni kudo toka të reja që janë hapur, tarraca të ndërtuara, por, po të futeni më në thellësi, do të shihni se edhe në malësi janë hapur masive tokash të reja.

Për ne tani është e rëndësishme çështja që, duke shfrytëzuar këtë gjendje të lartë politike dhe këtë rritje të ndërgjegjes socialiste të fshatarësisë, të zhvillojmë me vrull më të madh edhe revolucionin tekniko-shkencor në bujqësi, veçanërisht agrotekni-

kën. Natyrisht, në disa drejtime ekonomike ne jemi akoma prapa nga vendet e zhvilluara, por perspektivat e ekonomisë sonë janë shumë të mëdha. Në mjaft kooperativa dhe ndërmarrje bujqësore kemi rezultate të mira dhe që janë bërë shembull për ekonomitë e tjera. Disa prej tyre kanë arritur të marrin nga 100 kuintalë misër ose nga 50 kuintalë grurë për hektar. Por kemi edhe nga ato ekonomi që marrin rendimente të ulëta. Është pozitiv fakti që edhe në këto ka filluar lëvizja për rritjen e rendimenteve të prodhimeve bujqësore. Këtij qëllimi i shërbejnë sesionet shkencore që po zhvillohen në ndërmarrjet bujqësore dhe në mjaft kooperativa bujqësore.

Një lëvizje e madhe ka shpërthyer për shkëmbimin e përvojës midis kooperativave. Grupe kooperativistësh shkojnë nga njëra kooperativë në tjetrën e qëndrojnë për një kohë atje për të marrë dhe për të dhënë përvojën e tyre, futen në gara, marrin zotime të reja për të tejkaluar planet e prodhimit etj.

Të gjitha këto dhe masa të tjera të Partisë bënë që vitin e kaluar në bujqësi planet të tejkaloheshin. Kjo i inkurajoi jashtëzakonisht edhe vetë kooperativistët, sepse panë të materializuar frytin e politikës dhe të ideologjisë së Partisë, të organizimit që ata ndoqën, frytin e krahut dhe të mendjes së tyre.

Këto suksese në fushën ekonomike Partia diti t'i shfrytëzojë edhe në drejtim të revolucionarizimit të mëtejshëm të gjithë jetës së vendit. Ato i shërbyen punës së madhe edukative për sqarimin dhe bindjen e masave për goditjen dhe eliminimin e mbeturinave të ideologjisë së vjetër borgjeze në ndërgjegjen e ty-

re. Si rezultat, edhe në fushën e ideologjisë lindën lëvizjet revolucionare për luftën kundër fesë, për pjesëmarrjen e gruas në prodhim dhe për emancipimin e plotë të saj, për luftën kundër zakoneve prapanike.

Partia jonë ecën gjithmonë përpara, udhëheq me sukses ndërtimin e socializmit, zhvillon luftën e klasave, revolucionarizon masat, mpreh vigjilencën e tyre që ato të godasin veprimet e padrejta e botëkuptimet e vjetra, si burokratizmin, rutinën, misticizmin, zakonet e vjetra prapanike, fenë etj. Por, që të realizohen këto me sukses, që të udhëhiqen e të çohen masat gjithnjë përpara në revolucion, duhet që vetë Partia të jetë shpatë e mprehtë, domethënë që pararoja e organizuar e klasës punëtore të jetë vetë në kulm revolucionare. Në qoftë se Partia flet kundër burokratizmit, duhet që në radhë të parë ajo vetë të luftojë shfaqjet e burokratizmit në veprimtarinë e saj; në qoftë se ajo thotë se duhet të luftohen zakonet prapanike, duhet që më parë vetë komunistët të pastrohen nga këto; në qoftë se u kërkohet masave të bëjnë sakrifica, duhet që masat të shikojnë më parë komunistët duke bërë sakrifica. Pra, duke luftuar kundër së vjetrës, së keqes, që nuk mund të rezistojnë përpara hovit revolucionar të masave, ne po rritemi e po përparojmë.

Tani mund të themi se vendimet e Kongresit të 5-të të Partisë dhanë dhe po japin frytet e tyre. Me pjesëmarrjen e gjerë të masave po bëhet revolucionarizimi i mëtejshëm i gjithë jetës së vendit. Si marksistë, rezultatet që ne kemi arritur i shikojmë si

fitore dhe si mbështetje për të arritur suksese të tjera akoma më të mëdha. Por këto arritje nuk janë gjithçka. Në punën tonë ne kemi edhe të meta e vëshirësi të zhvillimit. Prandaj mbetet shumë për të bërë, për të thelluar e zhvilluar më tej revolucionin tonë në çdo drejtim.

Qëllimi i Partisë sonë që kur u krijua ka qenë të shporrte fashizmin, të përmbyste të gjitha klasat shfrytëzuese në vendin tonë, të merrej pushteti nga klasa punëtore dhe të vendosej diktatura e saj, të ndërtohej socializmi dhe komunizmi. Duke u udhëhequr nga këto qëllime, Partia ka luftuar të ruajë e të forcojë diktaturën e proletariatit, të zhvillojë luftën e klasave në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim që borgjezia e vjetër ose e re, revizionistët, të mos kenë kurrë mundësi të rimarrin fuqinë në dorë.

Kjo punë e madhe për ndërtimin e socializmit, ruajtja dhe forcimi i diktaturës së proletariatit janë lidhur ngushtë edhe me luftën që bëjnë Partia dhe populli ynë kundër imperializmit, revizionizmit modern, veçanërisht kundër atij sovjetik e titist, dhe kundër të gjitha forcave reaksionare.

Gjatë kësaj pune dhe lufte ne kemi grumbulluar përvojë të madhe që na shërben si bazë për arritjen e fitoreve të reja.

Në veprimtarinë e tyre revolucionare, marksistë-leninistët e vërtetë kanë gjithashtu përvojën e partisë së Leninit e të Stalinit, të partive marksiste-leniniste dhe të lëvizjes revolucionare botërore. Këtu qëndron rëndësia universale e doktrinës sonë marksiste-leniniste. Çdo parti ka përvojën e saj dhe të të tje-

rëve, anët pozitive dhe anët negative, pozitivja shërben për të forcuar luftën revolucionare, kurse negativja është një mësim për të mos i përsëritur ato gabime që kanë bërë të tjerët.

Partia jonë mendon se situata ndërkombëtare është revolucionare. Këtë e tregojnë kriza e përgjithshme që ka përfshirë vendet kapitaliste, kriza ekonomike, zhvleftësimi i sterlinës, lëkundja e dollarit, kërcënimet për luftë të imperializmit amerikan, acarimi i marrëdhënieve midis fuqive imperialiste, kontradiktat që shfaqen midis tyre në organizmat ushtarakë, ekonomikë e financiarë. Këtë e tregojnë gjithashtu kriza e madhe e revizionizmit modern, demaskimi i plotë dhe me baza që u është bërë dhe po u bëhet revizionistëve e në radhë të parë atyre sovjetikë, revizionistëve në Evropë, në Azi e gjetkë. Këtë e tregojnë futja në rrugëkryq dhe demaskimi gjithnjë e më shumë i aleancës kundërrevolucionare midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik. Këtë e tregon lufta që bëjnë revolucionarët, Partia e Punës e Shqipërisë dhe të gjitha partitë e grupet e tjera marksiste-leniniste, e cila i ka futur revizionistët modernë në vështirësi, në kontradikta të mëdha, në përçarje me njëri-tjetrin.

Revizionistët sovjetikë tanimë e kanë humbur hegjemoninë e tyre, prandaj kërkojnë ta rivendosin atë me dredhi, me forcë dhe shantazh. Të gjithë revizionistëve u ka hyrë krimbi, ata kurrë nuk mund të kenë unitet midis tyre. Revizionistët sovjetikë përpiqen të krijojnë te të tjerët përshtypjen e ekzistencës së unitetit midis tyre dhe partive të tjera revii-

zioniste. Mbledhja e Budapestit¹ që ata po përgatitin është një tentativë në këtë drejtim, por kjo nuk mund të arrihet. Qëllimi i kësaj mbledhjeje është lufta kundër partive marksiste-leniniste, kundër marksizëm-leninizmit, por nuk e thonë haptazi, sepse një gjë e tillë do të ishte disfatë e madhe për ta, prandaj edhe nuk bien dakord me njëri-tjetrin. Duke mos mundur të organizojnë një mbledhje ku të flasin hapur kundër nesh, revizionistët sovjetikë do të thonë se mbliidhen të diskutojnë për «luftën kundër imperializmit, për mbrojtjen e Vietnamit, të Laosit, të Koresë dhe të Kubës». Por ky është vetëm falsitet. Në mbledhjen e Budapestit, siç kemi dëgjuar deri tani, nuk do të vejë as Vietnami, as Koreja (me gjithë qëndrimin revizionist që mban Kim Ir Seni), as Laosi, as Kuba. Pra, në këtë mbledhje nuk do të venë jo vetëm partitë e vërteta marksiste-leniniste, por edhe shumë nga partitë e maskuara revizioniste. Fakti që revizionistët grinden e kanë kontradikta midis tyre për luftën kundër imperializmit, do të thotë se as vetë ata nuk besojnë në këtë gjë, prandaj nuk venë edhe në mbledhje.

Tani ndodhet në Japoni Suslovi². Më parë ishte atje Klishkoja³, po meqenëse nuk pati sukses, vajti

1 U mbajt nga 26 shkurt - 5 mars 1968. Shih në këtë vëllim, f. 277.

2 Në atë kohë anëtar i Byrosë Politike dhe sekretar i KQ, të partisë revizioniste sovjetike.

3 Në atë kohë anëtar i Byrosë Politike dhe sekretar i KQ të partisë revizioniste polake.

kali i vjetër, Suslovi. Po përse ka shkuar ai atje? Që t'i lutet Mijamotos¹ të marrë pjesë në mbledhje, të paktën si vëzhgues. Revizionistët rumunë, që thonë se do të venë në mbledhje si vëzhgues, kanë dërguar Apostolin² në Kore për t'iu lutur Kim Ir Senit që edhe ai të vejë si vëzhgues.

Të gjitha këto tregojnë kalbësirën e revizionizmit dhe kjo nuk ka ardhur rastësisht, por si rezultat i luftës së madhe revolucionare që bëjnë partitë dhe grupet marksiste-leniniste, i luftës revolucionare dhe çlirimtare të popujve të botës, i luftës heroike të popullit vietnamez. Të gjitha këto janë merita të revolucionarëve që demaskojnë revizionizmin, zgjojnë masat dhe i hedhin ato në luftë të vazhdueshme klasesore kundër shtypjes dhe shfrytëzimit kapitalist.

Kalbësira e revizionistëve modernë duket edhe në vështirësitë që po kalojnë partitë e tyre. Në gjirin e këtyre partive, si rezultat i degjenerimit të tyre, po ndodhin ndryshime. Krerët e vjetër po zëvendësohen me të rinj. Një gjë të tillë po bën Gomulka, i cili është më pro sovjetikëve. Edhe Novotni i tillë ishte, por procesi i luftës bëri që edhe ai të hidhej poshtë. Dubçeku që zuri postin e tij, nuk është më i mirë se Novotni, por si revizionist ai është më i manovrueshëm nga imperializmi amerikan dhe ai gjermanoperëndimor sesa Novotni.

Tradhtia e revizionistëve modernë ndaj çështjes

1 Sekretar i përgjithshëm i partisë revizioniste të Japonisë.

2 Në atë kohë anëtar i Komitetit Ekzekutiv dhe i Presidiumit të Përhershëm të partisë revizioniste rumune.

së klasës punëtore duket hapur edhe në qëndrimin e tyre ndaj sindikatave në vendet kapitaliste. Krerët e partive revizioniste janë korrumpuar nga borgjezia dhe, në fakt, ndjekin rrugën e socialdemokracisë së vjetër. Me një fjalë, me qëndrimin dhe më politikën që ndjekin ndaj sindikatave, ata kanë bërë integrimin, lidhjen e partisë me aparatën shtetëror borgjez, pra, interesat e partisë komuniste ia kanë përshtatur kapitalizmit. Nga kjo vjen edhe shkëputja e tyre nga masat, sepse kapitalizmi dhe socialdemokracia i kanë masat objekt shtypjeje e shfrytëzimi.

Partitë e vërteta marksiste-leniniste në luftën që bëjnë sot në front të gjerë kundër borgjezisë dhe revizionizmit, po luftojnë kundër partive revizioniste edhe për kuptimin drejt të punës me sindikatat. Qëllimi i partive marksiste-leniniste është që sindikatat të shndërrohen në organizata revolucionare. Këtë ato e bëjnë të udhëhequra nga partimi për të fituar masat që përfshihen në këto e për t'i hedhur ato në aksione revolucionare kundër kapitalizmit. Por kjo nuk mund të arrihet pa demaskuar me forcë të gjitha konceptet oportuniste politike, ideologjike dhe organizative të partive revizioniste për sindikatat, koncepte këto që konsistojnë, më radhë të parë, në atë që sindikatat të mos luftojnë kundër revizionizmit dhe borgjezisë, por t'u nënshtrohen atyre. Vijën oportuniste për sindikatat partitë revizioniste e zbatojnë nëpërmjet njerëzve që kanë në krye të këtyre dhe që njëkohësisht janë edhe në udhëheqje të partisë.

Kuptimi i drejtë i rreziqshmërisë së këtyre koncepteve, shkëputja nga ekonomizmi, lufta pa kompro-

mis e në mënyrë sistematike kundër tyre dhe përpjekjet për të gjetur rrugët se si duhet të punohet me masat në sindikatat kanë rëndësi të madhe. Ka shokë në disa parti të Evropës Perëndimore që diskutojnë nëse duhet të marrin pjesë në sindikatat që ekzistojnë, apo duhet të krijojnë sindikata të reja. Ka disa të tjerë që nuk e shtrojnë akoma çështjen e luftës për të marrë nën drejtimin e tyre sindikatat, për arsye se influenca e tyre në to ende nuk është forcuar. Kjo është çështje e tyre, por sidoqoftë unë mendoj se edhe në këtë drejtim partia komuniste marksiste-leniniste duhet të përcaktojë strategjinë dhe taktikën e saj revolucionare. Ajo duhet të luftojë për të forcuar lidhjet me masat, t'i edukojë ato politikisht dhe ideologjikisht për kuptimin e drejtë të luftës së klasave, të demaskojë idetë false të parlamentarizmit dhe të «demokracisë» borgjeze, t'i shpjegojë klasës punëtore që ajo të kuptojë si duhet se disa të drejta që ka arritur të sigurojë nuk ia ka dhuruar borgjezia, por i ka fituar me luftën e saj, si dhe t'i bëjë punëtorët të ndërgjegjshëm për nevojën e inkuadrimit në një organizatë revolucionare. Pra, partia marksiste-leniniste lufton kundër të gjitha koncepteve reaksionare, politike, ideologjike dhe organizative të partisë revizioniste. Një luftë të tillë të vendosur në këtë drejtim ajo e bën edhe me anëtarët e saj, të cilët punojnë në sindikatat, që ata të mos i identifikojnë ato me partinë. Ata dhe gjithë partia duhet ta kenë plotësisht të qartë se sindikatat nuk janë partia. Partia është udhëheqësja e sindikatave, pararoja e klasës punëtore. Duke i konsideruar sindikatat si or-

ganizata të klasës punëtore, unë mendoj se komunistët duhet të futen në to dhe atje të luftojnë kundër të gjitha koncepteve oportuniste të ushqyera me qëllim nga borgjezia dhe partia revizioniste.

Desha të shtoj edhe diçka. Në qoftë se një parti marksiste-leniniste arrin që në një sektor të inarrë në dorë sindikatat, të metalurgjisë ose të transportit, për shembull, unë mendoj se është mirë që ajo t'i hedhë ato në luftë duke e shoqëruar këtë me veprime e aksione të tjera të sindikatës.

Sindikatat kanë një traditë të madhe për organizimin e klasës punëtore. Në luftën që ajo ka bërë nëpërmjet tyre, siç thashë më parë, ka arritur të fitojë edhe disa të drejta, por punëtorëve duhet t'u bëhet mirë e qartë se këto të drejta janë jo vetëm të cinguara e formale, por edhe minimale përpara qëllimit kryesor që ka klasa punëtore: marrjen e pushtetit në duart e saj.

Neve na duket se është humbje kohe të krijosh sindikata të tjera siç e mendojnë disa shokë të ndonjë partie të re në Evropën Perëndimore. Disa nga këta shokë thonë se krijimi i sindikatave të reja diktohet nga fakti se ato që ekzistojnë janë uzurpuar prej revizionistëve. Ndërsa disa shokë të tjerë janë kundër këtij mendimi, duke argumentuar se komunistët duhet të futen në sindikatat ekzistuese, të punojnë në to dhe atje, në procesin e luftës revolucionare të zhvillohet procesi i diferencimit, ashtu sikurse zhvillohet edhe në parti. Të shkëputesh nga sindikatat e vjetra dhe të mos futesh në masën e tyre në këtë proces lufte që zhvillohet sot, ne mendojmë

se është e gabuar, sepse në këto sindikata janë masat e punëtorëve, të cilat duhet të udhëhiqen në luftë për të fituar të drejtat e tyre deri në përmbysjen e kapitalizmit. Natyrisht, për t'i çarë rrugën këtij synimi duhet të luftohen me vendosmëri, në radhë të parë, të gjitha pikëpamjet politike, ideologjike dhe organizative të revizionistëve në gjirin e vetë sindikalistëve.

Mua më duket se është e gabuar edhe ajo që pretendojnë disa se gjoja qenka më mirë që më parë të krijojmë federatën e sindikatave, domethënë kokën udhëheqëse. Të krijosh më parë këtë, sipas mendimit tonë, do të thotë të kesh një gjeneral pa ushtri.

Natyrisht, çdo parti marksiste-leniniste gjen format e saj të punës për edukimin e masave të punëtorëve në sindikatat në përputhje me kushtet konkrete. Por ne e kemi të qartë se çështja e edukimit marksist-leninist, kuptimi i thellë i detyrës për edukimin politik e ideologjik të masave të punëtorëve në sindikatat, roli i tyre dhe metodat për tërheqjen, organizimin e drejtimin e tyre varen, së pari, nga stadi i zhvillimit ekonomik të çdo vendi, nga kushtet konkrete të çdo vendi, pse ndryshe është, për shembull, zhvillimi ekonomik në Francë, ndryshe në Australi dhe ndryshe është në Vendet Skandinave; së dyti, nga niveli i zhvillimit ideologjik e kulturor i klasës punëtore të këtij apo atij vendi; së treti, nga format dhe metodat e ndryshme të organizimit që përdor kapitalizmi vendas; së katërti, nga të drejtat që ka fituar klasa punëtore me luftën e saj politike dhe ekonomike kundër kapitalizmit. E bazuar në të dhënat

objektive dhe subjektive të vendit, çdo parti marksiste-leniniste ndërton edhe metodën e saj të punës ideologjike që duhet të bëjë me masat dhe sindikatat, duke insistuar në atë çështje ku duhet të rrahë më fort çekani, në mënyrë që puna e saj të jetë sa më efikase, që klasa punëtore të arrijë sa më parë të thyejë zinxhirët e shfrytëzimit kapitalist.

Ideologjia marksiste-leniniste është kundër parlamentarizmit borgjez, kundër pikëpamjeve revizioniste dhe oportuniste, kundër strukturës dhe kuptimit të sindikatave si mjet për t'iu përshtatur kapitalizmit etj. Marksistë-leninistët e çdo vendi, pavarësisht nga sukseset që kanë arritur, kanë shumë për të bërë dhe kjo «shumë» është përmbysja e kapitalizmit. Në këtë zinxhir «të lyer me flori» ka shumë hallka të dobëta të kapitalizmit që duhen parë, duhen studiuar e shfrytëzuar për interesat e revolucionit.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

MBLEDHJA KUNDËRREVOLUCIONARE E BUDAPESTIT — NJË HAP I RI TRADHTAR I REVIZIONISTËVE HRUSHOVIANË

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

21 shkurt 1968

Krerët revizionistë të Evropës dhe të disa partive të tjera, që varen kryesisht nga ata, do të mbliidhen më 26 shkurt në Budapest rreth udhëheqësve hrushovianë të Bashkimit Sovjetik për të diskutuar «përgatitjet e forumit të ri botëror komunist». Në një artikull të mëparshëm¹ ne kemi shpjeguar hollësisht qëllimet kundërrevolucionare të kësaj mbledhjeje dhe synimet e saj për të kundërshtuar luftën revolucionare e antiimperialiste të popujve. Sot do të ndalemi vetëm në disa aspekte të atmosferës konfuze, kontraktore e pa kurrfarë perspektive, që karakterizon stalin revizionist në prag të një mbledhjeje, për të cilën revizionistët sovjetikë nuk kanë kursyer as fjalët

1 Është fjala për artikullin «Përse udhëheqja revizioniste sovjetike ngul këmbë për mbledhjen ndërkombëtare». Shih: në këtë vëllim, f. 200.

e mëdha propagandistike dhe as mjetet e shumta materiale.

Klika e Brezhnjev-Kosiginit ka disa vjet tanimë që, me lajka, presione, mashtrime e kërcënime, po përpiqet të organizojë një paradë të madhe revizioniste që të brohorasë vijën e saj dhe ta pranojë atë si udhëheqëse supreme të «lëvizjes komuniste ndërkombëtare». Në këtë mbledhje, të cilën e shikonte si tokën e premtuar, ajo kishte varur shpresa jashtëzakonisht të mëdha. Në radhë të parë, duke qenë nën presionin e vazhdueshëm të masave popullore dhe të komunistëve të ndershëm, për shkak të mospajtimit me kursin e saj tradhtar të restaurimit të kapitalizmit brenda dhe të bashkëpunimit me imperializmin jashtë, udhëheqja revizioniste e Bashkimit Sovjetik kërkon ta mashtrojë popullin sovjetik, duke i thënë atij se vija e saj nuk mund të mos jetë «marksiste-leniniste», përderisa atë e kanë aprovuar edhe në një mbledhje të madhe komuniste, ku kanë marrë pjesë aq e kaq parti. Prandaj, për pasojë, ka të drejtë ajo dhe jo ata njerëz që e kundërshtojnë e që ajo i burgos e i shtyp me egërsi.

Gjithashtu, po të ecnin punët mbarë, sipas planeve të hartuara pas mureve të Kremlinit, mbledhja duhej të frenonte shturjen e mëtejshme të frontit revizionist, të ndalonte lëvizjen centrifugale, që po merr përpjesëtime të gjera, dhe të vendoste hegjemoninë e hrushovianëve të Moskës mbi revizionistët e tjerë.

Mbi të gjitha, skena e Budapestit u nevojitej atyre për të bërë gjyqin e «dënimit ndërkombëtar»

të Partisë Komuniste të Kinës dhe të Partisë së Punës të Shqipërisë «për t'i izoluar» ato dhe për të minuar procesin e vrullshëm të rritjes e të zhvillimit të lëvizjes revolucionare marksiste-leniniste në botë.

Udhëheqësit revizionistë mendonin se jo vetëm mbledhja, por edhe aktiviteti për përgatitjet e saj do t'u sillte përfitime. Periudhën përgatitore ata e shikonin si një fushatë e cila do të çonte në forcimin e pozitave të tyre në lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe në opinionin publik botëror. Ata shpresonin se, me këtë rast, duke përdorur më shumë demagogjinë, duke ngritur ca edhe zërin kundër «qarqeve» imperialiste, do të fitonin disa pikë për t'u shitur si flamurtarë të forcave revolucionare e të antiimperializmit.

Duke synuar këta objektiva, atyre u duhej, as më pak e as më shumë, forumi i plotë i partive komuniste, unanimiteti dhe gatishmëria e të gjithëve për të shkuar në Budapest, përkrahja e pakondicionuar e secilës parti për iniciativën sovjetike. Vetëm kështu mund të krijohej përshtypja se partitë marksiste-leniniste ishin izoluar dhe se hrushovianët sovjetikë udhëheqin lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Por cila është gjendja tani, në prag të mbledhjes së Budapestit? Cili është rezultati i përpjekjeve të mëdha të revizionistëve sovjetikë?

Duhet thënë që në fillim se tabloja paraqitet mjaft e trishtueshme. Klika hrushoviane sovjetike kërkonte «mobilizim të përgjithshëm» të frontit revizionist për shtimin e luftës kundër partive dhe forcave të reja revolucionare marksiste-leniniste. Kjo përbën-

te bazën dhe qëllimin kryesor të saj për mbledhjen e Budapestit, por këtë bazë ajo nuk mundi t'ua imponojë partnerëve të tjerë. Qëllimi fillestar dështoi dhe pjesëmarrësit e saj u përçanë, jo sepse disa ishin më të mirë e disa më të këqij, pasi të gjithë pjesëmarrësit në mbledhjen e Budapestit janë tradhtarë të marksizëm-leninizmit, po për shkak se planet dhe komplotet e tyre u demaskuan dhe u dërrmuan nga partitë marksiste-leniniste.

Revizionistët e tjerë kishin frikë se duke iu nënshtruar qëllimeve të sovjetikëve dhe duke u bashkuar me fushatën antikineze e antishqiptare, do të nxitnin edhe më tepër rezistencën dhe kundërshtimet në partitë e tyre, do të demaskohej e do të goditej edhe më shumë vija e tyre oportuniste. Këta e gjejnë më të përshtatshme e më oportune një luftë të veçuar kundër PPSH dhe partive të tjera marksiste-leniniste, duke zgjedhur vetë kohën dhe mënyrat. Kjo taktikë, sigurisht, nuk është zgjedhur nga e mira, por nga eksperiencia e hidhur, nga dështimet e planeve dhe të fushatave antimarksiste, nga falimentimi i vijës së tyre tradhtare.

Në vend të kompaktësimit të partive revizioniste dhe të forcimit të unitetit të veprimit të tyre, për të cilin shpresonin revizionistët sovjetikë, fushata përgatitore e shpejtoi edhe më tepër përçarjen midis tyre, çoi në kristalizimin e mëtejshëm të tendencave centrifugale, në theksimin e përpjekjeve për pavarësi nga udhëheqja sovjetike dhe në evidentimin e qëllimeve e të synimeve të veçanta në secilën parti. Përgatitjet sikur shërbyen për t'i nxitur, për t'u dhënë një

formë të prerë dhe për të konsoliduar pikërisht ato qëndrime e ato vija, të cilave revizionistët sovjetikë ua kanë më shumë frikën.

Në situatën që është krijuar mund të themi se mbledhja e Budapestit ka dështuar që përpara se të fillojë. Organizatorët e saj kërkuan që në Budapest të shkonin të gjitha partitë që patën marrë pjesë në Mbledhjen e Moskës më 1960. Por nga 81 parti që ishin atëherë, sipas të dhënave të gjertanishme, gati një e katërta refuzuan të marrin pjesë. Ky është me të vërtetë një dështim skandaloz. Për çfarë forumi komunist botëror, për çfarë unanimiteti dhe uniteti veprimesh mund të bëhet fjalë tani? E rëndësishme është se revizionistët sovjetikë hodhën në çështjen e pjesëmarrjes ose jo në mbledhjen e Budapestit të gjithë prestigjin që u kishte mbetur, vunë në lëvizje të gjitha mjetet politike, të hapëta e të fshehta, që kishin në dispozicion. Në shtypin botëror këto kohë kanë qarkulluar mjaft lajme që vërtetojnë se revizionistët sovjetikë kanë ushtruar mjaft presione ekonomike ndaj disa të pabindurve, për t'i detyruar të marrin pjesë në mbledhje dhe, në ndonjë rast, nuk kanë ngurruar për të organizuar komplete për përmbysjen e udhëheqjeve të partive dhe për zëvendësimin e tyre me njerëz, që do t'i bindeshin verbërisht «shkopit të dirigjentit» të Moskës.

Por edhe ato parti që do të shkojnë në mbledhje nuk përfaqësojnë një masë kompakte, të gatshme për t'iu nënshtruar sovjetikëve dhe për t'u shërbyer qëllimeve të tyre politike. Kjo vihet re fare mirë në pamundësinë për të formuluar për këtë mbledhje një

rend dite të pranueshëm nga të gjithë dhe për të caktuar se ç'qëllime duhet të ketë takimi i krerëve. Gati secila parti, po të gjykojmë nga deklaratat zyrtare që janë botuar në shtyp, ka paraqitur një program të saj të veçantë që, sipas saj, duhet të jetë i vetmi që të shqyrtohet në mbledhje. Kështu, për shembull, miqtë e Titos kërkojnë të anulohen zyrtarisht dokumentet e Moskës të vitit 1957 e 1960, ku është dënuar revizionizmi jugosllav, dhe të mos sulmohet drejtpërdrejt imperializmi amerikan. Disa të tjerë, që po flirtojnë me Gjermaninë Perëndimore, vënë si kusht të mos goditet revanshizmi gjerman dhe mbledhja të mos diskutojë ndonjë çështje konkrete, që do të prekte drejtpërsëdrejti ose tërthorazi politikën që ata ndjekin ndaj shteteve ose grupimeve të ndryshme politike. Në këtë çështje ngulin këmbë sidomos ata që afrimin e shpejtë me Perëndimin e kanë bërë çështjen kardinale të politikës së tyre të jashtme.

Revizionistët italianë e francezë, të cilët gjithë përpjekjet e tyre i kanë përqendruar në shkrirjen me partitë socialdemokrate, duke dashur që mbledhja e Budapestit t'u shërbejë qëllimeve të tyre, kërkojnë që kjo të diskutojë dhe të aprovojë afrimin dhe shkrirjen me socialdemokratët. Mjaft të tjerë pretendojnë se në mbledhjen e Budapestit nuk duhet të marrin pjesë vetëm «komunistët», por edhe partitë përparimtare borgjeze të Afrikës dhe të vendeve të tjera të porsaçliruara dhe se aty nuk duhet të diskutohet çështja e luftës kundër imperializmit, por ndihma e vendeve të zhvilluara për vendet e pazhvilluara. Revizionistët e Amerikës Latine, të cilëve krijimi i par-

tive marksiste-leniniste dhe fillimi i luftës së armatosur në vendet e tyre u ka dhënë një goditje të rëndë dhe që nuk shohin më asnjë perspektivë shpëtimi, dëshirojnë që mbledhja të merret kryesisht me dënimin e PKK, të PPSH dhe të gjitha partive marksiste-leniniste.

Duke pasur gjithë këto kërkesa dhe duke vënë kaq shumë kushte, kuptohet sa vështirë e kanë organizatorët e mbledhjes të gjejnë një formulë për rendin e ditës, që do t'u bënte qejfin të gjithëve dhe do t'i garantonte se nuk do të prekeshin interesat e veçantë të secilit. Për të siguruar pjesëmarrjen, qoftë edhe të kushtëzuar, organizatorët e mbledhjes u përpoqën në minutën e fundit të formulojnë një rend dite krejtësisht të papërcaktuar, që lë të kuptohet se gjatë debateve njëri do t'i bjerë gozhdës e tjetri potkoit. Pjesëmarrësit e mbledhjes revizioniste duan që në Budapest secili t'u imponojë të tjerëve pikëpamjen e tij, të ruajë pavarësinë e plotë të veprimeve, të mos marrë asnjë zotim dhe, për t'u ruajtur nga komprometimet, mbledhja të mos krijojë përshtypjen se ajo i dha preferencën kësaj apo asaj vije të këtij apo të atij grupimi revizionist.

Por është vështirë të pajtohen këto gjëra krejtësisht të papajtueshme. Këtë e kuptojnë edhe revizionistët sovjetikë, por ata tanimë nuk janë në gjendje ta shpleksin lëmshin e ngatërruar të kontradiktave me aleatët e tyre. Makina e mbledhjes është vënë në moto dhe nuk mund të ndalet më. Një shtytje e mëtejshme e mbledhjes, për kur të vijë kohë më të mira, do të thoshte një falimentim akoma më i

madh. Zgjatja pa fund do të ishte një diskreditim kapital për udhëheqësit sovjetikë, një demaskim i pandreqshëm në sytë e opinionit publik të brendshëm e të jashtëm. Kjo do të ishte baras me atë sikur të pranonin publikisht e zyrtarisht se ata falimentuan në përpjekjet për të thirrur mbledhjen e premtuar, se ata nuk i dëgjon më njeri, bile as pasuesit e tyre më të bindur, se ata pushuan së qeni «qendra e komunizmit botëror», gjë që ata e reklamojnë në të katër anët.

Prandaj më mirë një gjysmë mbledhjeje sesa aspak. Një fije shprese u mbetet akoma, se nëpër kullisa, si zakonisht, ata do të bëjnë presione e shantazhe, për t'i detyruar të tjerët të heqin dorë nga interesat e veçantë dhe të bashkohen me vijën e me planet e tyre hegjemoniste. Të paktën, mendojnë ata, këtë pjellë shtatanike me shumë mundime e injeksione mund ta mbajnë ca kohë gjallë, mund ta fryjnë dhe ta reklamojnë me zhurmë si sukses të «kompaktësisë», të «unitetit» etj.

Në këtë mbledhje revizionistët do të llomotitin kundër imperializmit dhe, pa dyshim, nuk do t'i kursejnë sharjet e mallkimet kundër tij. Po kjo zhurmë prej teneqesh bosh është kryekëput demagogji, që ka për qëllim të fshehë komplotet revizioniste dhe të gënjejë naivët. Përmbi këto llomotitje dhe përmbi këtë zhurmë ekziston aleanca sovjeto-amerikane dhe gjithë aleancat e tjera të vendeve revizioniste me shtetet e ndryshme imperialiste, ekzistojnë marrëveshjet dhe bashkëpunimi imperialisto-revizionist për mbytjen e revolucionit dhe për shtypjen e lëvizjeve nacionalçlirimtare të popujve.

Pjesëmarrësit revizionistë të mbledhjes së Budapestit përpigën ta bindin opinionin publik se qëllimi i mbledhjes së tyre qenkërka «mbrojtja dhe përkrahja» e Vietnamit në luftën kundër agresorëve amerikanë. Por tërë kjo është një blufë, një mjet i ulët demagogjik për të maskuar përkrahjen dhe ndihmën e vërtetë që ata u japin Shteteve të Bashkuara për të gjuhëzuar popullin vietnamez dhe për ta kthyer Vietnamin në një plasdarm kundër revolucionit dhe socializmit në Azi. Se sa false e demagogjike është poza antiimperialiste e revizionistëve dhe ajo e ndihmës dhe e përkrahjes së Vietnamit, e tregon edhe fakti se partitë dhe shtetet që ndodhen në përleshje të drejtpërdrejtë dhe luftojnë kundër imperialistëve, nuk do të shkojnë në Budapest. Kjo tregon se ato nuk kanë besim tek «antiimperializmi» i revizionistëve sovjetikë dhe i pasuesve të tyre, prandaj edhe e refuzuan ftesën e organizatorëve të mbledhjes. Është shumë karakteristik dhe kuptimplotë fakti se asnjë nga partitë e vendeve të Azisë, përveç klikës së falimentuar indiane të Danges, me gjithë përpjekjet dhe presionet e revizionistëve sovjetikë, nuk merr pjesë në mbledhje. Do të mjaftonte vetëm kjo për të kuptuar gënjeshtat dhe blufën e antiimperializmit të revizionistëve.

Të gjitha llogaritë që bënë revizionistët, u dolen të gabuara. Mbledhja e Budapestit është e destinuar të dështojë, pavarësisht se cili do të jetë rendi i ditës dhe çfarë do të diskutohet atje, pavarësisht nëse do të quhet ajo konsultative apo deliberative, e vogël apo e madhe, e nivelit të ulët apo e nivelit të

lartë. Ajo nuk është gjë tjetër përveçse një shprehje e thellimit të degjenerimit revizionist, e rrugës pa krye ku kanë hyrë klanet revizioniste, e politikës së tyre kapitulluese e tradhtare. S'ka asnjë dyshim se ajo do t'i nxitë edhe më tepër tendencat centrifugale e policentriste midis revizionistëve dhe do t'i japë një goditje të re hegjemonisë së udhëheqjes sovjetike në kampin e tyre. Grindjet dhe përçarjet në shportën e karavidheve revizioniste patjetër do të bëhen edhe më të mëdha.

Për sa u përket marksistë-leninistëve, ata situatën e shikojnë me shumë optimizëm. Mbledhja e tanishme e revizionistëve u organizua për të goditur marksizëm-leninizmin, por ajo po drejtohet kundër vetë organizatorëve të saj. Revizionistët e trumbetuan mbledhjen e tyre si një masë që do t'i shërbente «unitetit të lëvizjes komuniste», por ata treguan se janë përçarësit më të mëdhenj të saj. Ata thoshin se ajo do t'i shërbejë luftës kundër imperializmit, por realiteti tregon se ata po e sabotojnë atë me të gjitha mjetet e mënyrat. Popujt e botës nuk mund të mos e shikojnë se revizionistët preokupohen si e si t'i shuajnë flakët e revolucionit dhe të luftërave çlirimtare, si të goditin marksizëm-leninizmin dhe të përhapin ideologjinë e tyre helmuese të nënshtrimit dhe të gjunjëzimit përpara borgjezisë e reaksionit.

Është detyrë e marksistë-leninistëve dhe e forcave të tjera revolucionare të përfitojnë nga kjo situatë, për t'u treguar masave, që janë akoma të gënjyera nga revizionistët, se ku i kanë katandisur partitë komuniste liderët e tyre revizionistë, për t'u treguar

punëtorëve e fshatarëve se krerët hrushovianë nuk mbrojnë më interesat e tyre, por ata të klasës së vjetër e të re borgjeze, se ata janë kthyer tanimë në vegla të politikës kapitaliste.

Situata e krijuar nga përgatitjet për mbledhjen e Budapestit zbuloi kalbëzimin dhe degjenerimin revizionist. Popujt duhet ta shikojnë e ta kuptojnë atë për të njohur edhe më mirë fytyrën kundërrivolucionare e tradhtare të revizionistëve, për të parë edhe më mirë rrezikshmërinë e tyre, për të qenë vigjilentë e, prandaj, edhe për t'i luftuar më me guxim e më me vendosmëri.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 44 (6083), 21 shkurt 1968

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1968-1970», f. 30*

PËR REVOLUCIONARIZIMIN E MËTEJSHËM TË SHKOLLËS SONË

*Fjala në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH*

7 mars 1968

Studimi i çështjes së shkollës që merr sot në shqyrtim Byroja Politike, koincidon rastësisht me Ditën e Mësuesit, prandaj mendimet tona më të mira i drejtojmë sot te të gjitha mësueset e mësuesit e vendit tonë, që po kryejnë pa u lodhur një detyrë të shquar patriotike, dhe, me mirënjohje, u urojmë atyre, me këtë rast, suksese të mëtejshme në edukimin revolucionar, në rrugën e Partisë, të brezit tonë të ri.

Populli thotë: «Jeta është shkollë». Në gjuhën e filozofisë materialiste kjo do të thotë se të mësuarit duhet të vazhdojë kurdoherë, të ecë paralelisht pa ndërprerje gjithë jetën, do të thotë, gjithashtu, se puna mendore është e pazgjdhshme nga puna praktike. Kjo do të thotë se puna, krijimi, mendimi janë plotësuese për njëri-tjetrin gjatë gjithë jetës së njeriut, ku materia është primare dhe mendimi sekondar.

Të mësuarit, të menduarit janë produkt dhe pasqyrim i zhvillimit dialektik të materies.

Këtëj lind çështja se të mësuarit, zhvillimi progresiv i mendimit, nuk është thjesht një detyrë, por duhet konsideruar si një fenomen i natyrshëm, që është i lidhur dhe ka prejardhjen nga transformimi i materies, nga zhvillimi dhe transformimi i saj dialektik, pra, është një domosdoshmëri objektive për njeriun dhe shoqërinë. Në çdo kohë, në çdo etapë të jetës së tij, njeriu, si një qenie natyrore materiale, është vazhdimisht në transformim, ashtu si çdo gjë që e rrethon atë. Ai krijon, mendon, mëson dhe prapë krijon e transformon. E gjithë kjo duhet të konsiderohet si një proces i vazhdueshëm, i pandërprerë, që nga lindja deri në vdekjen e njeriut. Ky është një ligj natyror. Duke u mbështetur në këtë ligj të zhvillimit materialist, janë organizuar edhe shkollat që ne po marrim sot në studim. Shkollat dhe të mësuarit nuk duhen konsideruar si gjëra të shkëputura, që i përkasin vetëm një periudhe të jetës së njeriut, ose si një bazë e mjaftueshme një herë e përgjithmonë, e përsosur, brenda një cikli normash të caktuara për të lehtësuar punën organizative të edukimit dhe të mësimit.

Nga ky ligj del çështja e masivitetit të arsimit dhe të edukimit, domethënë ajo që Partia na thotë përherë se të gjithë, pa përjashtim, duhet të mësojmë, të edukohemi gjatë gjithë jetës, që të mund të krijojmë, që mendimi të udhëheqë prodhimin dhe zhvillimin. Por që ky zhvillim të ecë drejt, në rrugën e revolucionit tonë të pandërprerë socialist, du-

het që mendimi, edukimi dhe shkolla të kenë si bazë në çdo gjë filozofinë tonë materialiste.

Ne themi, dhe kështu është, se arsimiti 8-vjeçar është i detyruar me ligj, por ne duhet të themi dhe të kuptojmë se të gjitha shkollat, në format e ndryshme të tyre, dhe jo vetëm në ciklet që kemi caktuar sot, duhet të jenë të detyrueshme për të gjithë, jo në kuptimin e thjeshtë ligjor, siç është shkolla 8-vjeçare, por në kuptimin e ligjit të filozofisë sonë materialiste.

Çështja e organizimit dhe e ndjekjes së shkollës, pra edukimi i pandërprerë gjatë gjithë jetës së njeriut, është një çështje me shumë rëndësi, që nuk mund të arrihet e të perfeksionohet brenda një periudhe të shkurtër dhe vetëm brenda caqeve aktuale të organizimit të shkollës, sepse, pavarësisht nga ndryshimet përparimtare që ka pësuar dhe pëson, ajo akoma ka në vetvete të trashëguara disa koncepte idealiste të filozofisë së shkollës borgjeze, koncepte që kanë mbërthyer me rutinën e tyre mendjen e shumë njerëzve dhe arsimtarëve tanë që, padashur e pa kuptuar, i tërheqin zvarrë, i pengojnë, i bëjnë konservatorë.

Si çdo gjë në rendin tonë socialist, edhe shkolla jonë e re duhet të ketë ligjet e saj të zhvillimit, që të përputhen me strukturën ekonomike shoqërore dhe t'i shërbejnë asaj, pasi shkolla dhe të edukuarit janë një pjesë e rëndësishme e superstrukturës, e cila duhet të udhëhiqet nga filozofia jonë materialiste marksiste-leniniste.

Në rendin tonë socialist, ashtu siç organizohen

puna dhe riprodhimi i zgjeruar socialist, krahas tyre, duhet të organizohen edhe shkolla dhe edukata, që këto t'u përgjigjen nevojave objektive të socializmit dhe të komunizmit, që eksperienca e prodhimit t'i shërbejë mendimit, që zhvillimi i materies të sqarojë mendimin dhe ky të udhëheqë e të ndihmojë zhvillimin e praktikës revolucionare, zhvillimin dhe transformimin e shoqërisë.

Ne trashëguam nga periudha e paraçlirimit një cikël shkollash që nga fillorja e deri tek e mesmja, me një organizim të çrregullt, heterogjen, me mungesa të mëdha, si në format, ashtu dhe në kriteret e ndërtimit të tyre, në përmbajtjen e lëndëve, pa folur për vijën politike, ideologjike dhe pedagogjike krejt të huaj për shkollën tonë socialiste. Regjimi i Zogut, një regjim feudal anadollak, ishte kundër edukimit arsimor e kulturor të popullit, prandaj shkolla ishte kujdesi i tij i fundit.

Arsimi fillor ishte i kufizuar jo vetëm në fshatra, ku mbretëronte padija e organizuar, por edhe në qytete. Në ato krahina ku kishte një numër shkollash fillore, ato ishin të pamjaftueshme, por sidomos të pamjaftueshme dhe gati një privilegj ishin shkollat e mesme, gjimnazet, licetë dhe shkollat teknike. Të gjitha këto të fundit numëroheshin me gisht dhe ndodheshin vetëm në disa qytete të mëdha.

Regjimit të Zogut, politikën e tij në lëmin e shkollës ia impononin rrethanat, kushtet e zhvillimit të vendit, megjithëse edhe këtë ligj të zhvillimit ai përpiqej, me sa mundte, ta pengonte, duke ndjekur një politikë reaksionare, obskurantiste. Kështu mund

të themi se edhe ato shkolla fillore ose të mesme që u hapën në kohën e këtij regjimi, u detyrohen më shumë dëshirës dhe presionit të popullit, clementit mësues dhe intelektualit përparimtar sesa regjimit dhe politikës së tij. Atë zhvillim të paktë arsimor në regjimin e Zogut, sado që të çalë, në atë formë dhe në atë përmbajtje rudimentare, ne ia detyrojmë ndjenjës mësimdashëse të popullit, që, dashur padashur, i hapi rrugën depërtimit të dritës në mes obskuranizmit të madh të regjimit feudal.

Kriteret e ndërtimit të shkollës në kohën e regjimit të Zogut kanë qenë feudale, borgjeze, por edhe brenda këtij kuadri ato ishin kaotike në kulm. Në to përplaseshin njëra kundër tjetrës kritere të ndryshme të shkollave borgjeze, që ishin fryt i politikës servile të regjimit zogollian ndaj imperialistëve të ndryshëm, të cilët kishin synime grabitëse kundrejt vendit tonë dhe midis tyre fitonte kriteri i atij që i paguante më shumë regjimit, i cili nuk harronte t'i bënte favore edhe asaj borgjezie imperialiste që donte të ushtronte ndikimin e vet dhe të përfitonte koncesione për një etapë të dytë. Kur njëri imperialist fitonte pozita të forta në vendin tonë, atëherë ne shikonim ndryshime rrënjësore edhe në shkollat, në strukturën dhe në përmbajtjen e tyre, deri në shkollat fillore. Kështu, në periudhën e regjimit të Zogut ne kemi pasur gjimnaze «kombëtare», gjimnaze kishtarë, lice franceze, shkolla teknike amerikane dhe italiane. Vetëm gjimnaze turke dhe greke nuk u hapën; dhe kjo kuptohet, pasi regjimet borgjeze të këtyre vendeve nuk arritën ose nuk patën

mundësinë t'ia blinin edhe këto koncesione Zogut, i cili ishte i gatshëm t'ia shiste atdheun kujtdo, copa-copa, ashtu siç u dha koncesione të shumta territoriale edhe jugosllavëve, anglezëve dhe, më në fund, Italisë fashiste të Musolinit, së cilës ia shiti të gjithë vendin.

E vetmja notë dhe punë e lavdërueshme në këtë kaos ku gjendej shkolla e vendit tonë, ishin përpjekjet e mëdha të mësuesve dhe të pedagogëve për ta sistemuar shkollën, për ta bërë atë të qëndrueshme, për të plotësuar, aq sa mundnin dhe si mundnin, dëshirat dhe aspiratat e popullit për dije dhe mësim.

Me pak fjalë, procesi i fillimit dhe i zhvillimit të shkollës sonë nuk mund të bëhej para Çlirimit të vendit. Me këtë rast unë nuk kam aspak qëllim të bëj analizën e këtij procesi, sepse u bie detyrë specialistëve të arsimit ta bëjnë këtë në mënyrë objektive. Kjo analizë ka sot për ne një rëndësi të madhe, në qoftë se bëhet, dhe duhet të bëhet, nën dritën e marksizëm-leninizmit.

Pse ka rëndësi të madhe dhe duhet të bëhet kjo?

E para, sepse, me gjithë të metat që ka pasur shkolla në atë periudhë, ajo ka luajtur përsëri një rol të madh në zgjimin e popullit, ka përgatitur kua-dro, shumica e të cilëve, për aq sa dinin, sa mundnin dhe si mundnin. i kanë shërbyer popullit në ato kohë shumë të vështira që po kalonte. Ata shkollarë dhe mësues, mjekë, inxhinierë, agronomë e teknikë të mesëm, sido që të paktë, kanë qenë në shumicën dërrmuese afër popullit dhe i shërbenin atij. Pra, roli i saj nuk mund të lihet pas dore dhe as të mos përfillet.

E dyta, sepse pas Çlirimit të vendit dhe deri sa bëjnë reformën e parë të shkollës më 1946, ne u bazuam në shkollën e vjetër, në mësuesit dhe në pedagogët e vjetër. Ky trashëgim ka rënduar e rëndon akoma edhe tani (natyrisht me shumë ndryshime) dhe shfaqet në konservatorizmin e theksuar të shumë mësuesve e pedagogëve të vjetër, por edhe të rinj. Megjithatë, si çdo gjë që po ndryshonte progresivisht në vendin tonë, transformohej edhe shkolla. Reforma e shkollës që bëjnë ndikoi pozitivisht në këtë drejtim, eksperiencia e shkollës sovjetike na ndihmoi deri diku në këtë çështje, pasi më vonë e tëhu ne konstatuam se edhe shkolla sovjetike e shartuar në shkollën tonë të vjetër ruante mjaft tipare të mbeturinave të pedagogjisë borgjeze, kishte dhe ajo shumë të meta që koha, eksperiencia e fituar dhe zhvillimi i vendit na i vunë në dukje dhe na detyruan të bëjmë vazhdimisht korrigjime të pjesshme, qoftë në strukturat, qoftë në programet dhe në politikën e shkollës.

Ishte e vështirë që për çështjen e shkollës ne të bënim ndryshe nga ç'bëmë, pasi na mungonte eksperiencia, na mungonin mjetet, na mungonin kuadrrot. Nuk mund të bënim dhe do të ishte gabim të bënim *tabula rasa* të shkollës së kaluar. Ne duhej të shkonim drejt kthimit të saj në një shkollë popullore, ta zgjeronim atë kudo në qytete dhe në fshatra, ta bënim arsimin fillor të detyrueshëm, të krijojmë shkollën 7-vjeçare, të shumonim gjimnazet, të shkonim drejt arsimit 7 ose 8-vjeçar të detyrueshëm, të shtonim teknikumet dhe të dërgonim studentë për

të mësuar jashtë, derisa të krijonim në vend universitetin. Nga ana tjetër, qysh në ditët e para të Çlirimit, preokupacioni i Partisë dhe i pushtetit ka qenë vazhdimisht që shkolla, djepi i diturisë, të ishte një vatër e rëndësishme për edukimin e rinisë me politikën e Partisë.

Është e vërtetë se mësuesit dhe pedagogët ndoqën politikën e Partisë, disa iu adaptuan asaj, por megjithatë ata ruanin në ndërgjegjen, në metodën dhe stilin e punës së tyre prirjet dhe mbeturinat e pedagogjisë së vjetër, të shkollës së vjetër, ku kishin mësuar vetë brenda ose jashtë vendit.

Tani çështjet qëndrojnë ndryshe. Ne kemi një eksperiencë të re gati 25-vjeçare mbi shkollën, ku është bërë një proces pozitiv i vazhdueshëm, ku janë arritur shumë objektiva të caktuar nga Partia dhe, të bazuar në to, na vihet për detyrë të bëjmë një hop cilësor përpara në shkollën tonë, gjë që na e kërkojnë nevoja e zhvillimit të prodhimit, ndërtimi i plotë i socializmit dhe shkuarja në shoqërinë komuniste.

Por që ta bëjmë si duhet këtë hop cilësor, mua më duket se duhet të përcaktojmë me kujdesin më të madh parimet dhe rrugët nëpër të cilat duhet të kalojmë dhe si duhet të kalojmë e të mos biem as në platforma nihiliste, as në shartime të padrejta dhe pa kritere të shëndosha.

Partia jonë ka ndjekur kurdoherë për shkollën një politikë me tendencë të theksuar. Me sa ka qenë e mundur, ajo është përpjekur që shkollën dhe edukimin t'i drejtojë në rrugën e marksizëm-leninizmit, t'i lidhë ato me nevojat imediate dhe perspektivën e

zhvillimit të gjithanshëm të vendit tonë, të prodhimit dhe të ndërtimit të socializmit. Dhe prova më e mirë për këtë janë formimi i bindjes në njerëzit e popullit për nevojën e të mësuarit dhe krijimi i mundësive për të mësuar, pasi arsimit u bë masiv, janë përparimet ekonomike, janë përgatitja e një morie të madhe kuadrosh që punojnë dhe drejtojnë me devocion e besnikëri për popullin, për socializmin, në rrugën dhe me mësimet e Partisë.

Por megjithatë, po ta thellojmë pak më shumë këtë problem, do të konstatojmë një të metë, e cila qëndron në atë që shkolla konsiderohej më tepër si fusha e mësuesit, e pedagogut, ku çdo gjë i nënshtrohej më shumë anës pedagogjike, metodikës. Me fjalë të tjera, ishte prirja që për çështjen e shkollës mësuesi dhe pedagogu janë të vetmit kompetentë, të cilëve mjafton t'u jepeshin vijat dhe kriteret, se të tjerat i rregullonin dhe i drejtonin ata.

Ne kemi kritikuar vazhdimisht shokët e Partisë që nuk interesoheshin seriozisht për shkollat. Edhe kur ata detyroheshin të vinin në to, interesimi qëndronte në kalueshmërinë e nxënësve, në ndonjë nevojë materiale, në frekuentimin ose jo të rregullt të shkollës nga ana e nxënësve etj. Pra, interesoheshin për anët pak a shumë formale, duke e ndier veten të huaj nga shkolla, dhe këtë e arsyetonin se kishin shumë punë të tjera, dhe në radhë të parë ato ekonomike. Shokët e Partisë, pra, nuk kuptonin sa duhet dhe si duhet lidhjet e shkollës me prodhimin dhe, kur e themi këtë, duhet të kuptojmë se kjo lidhje është kryesore, vendimtare.

Nga ana tjetër, mësuesit dhe pedagogët ishin krejt të shkëputur nga prodhimi, ndryshimet dhe nevojat që pësonte ekonomia ata i gëzonin, i ndienin, por për shkollën dhe mësimin ndiqnin në mënyrë rutine dhe burokratike forma e metoda pedagogjike dhe stil pune të vjetruar, shumë herë anakronik. Dhe e keqja ishte se ata kujtonin dhe ishin të bindur se detyrën e bënin plotësisht si duhej. Kurse Partia dhe njerëzit e saj, që e udhëhiqnin këtë transformim të madh politik, ekonomik, ideologjik, organizativ, nuk interesoheshin sa duhej intësisht për shkollën, për ndryshimet që duheshin bërë herë pas here, për procesin dinamik të zhvillimit të saj.

Këta dy vjetët e fundit, nga të gjitha masat revolucionare që u morën në vendin tonë, Ministria e Arsimit dhe e Kulturës u gjend nën një presion të fortë, asaj iu prish qetësia, krisën të qepurat. Kjo vërteton atë që thashë pak më lart, se çështja e arsimit dhe e shkollës nuk është një çështje burokratike, nuk mund të jetë vetëm fushë e arsimtarëve në përgjithësi, nuk mund të konsiderohet vetëm fushë e teorisë së shkëputur nga prodhimi, nga puna, por ajo është një çështje e madhe e Partisë, e popullit, e ekonomisë, e strukturës dhe e superstrukturës.

Gjithashtu, nuk mund të konsiderohet i mjaftueshëm vetëm përcaktimi i arsimit 8-vjeçar të detyrueshëm, ose shpërndarja e studentëve në fakultete të ndryshme. Jo, çështja nuk është aq e lehtë, ajo është shumë më e thellë, shumë më e ndërlikuar nga sa duket; dhe pikërisht kjo ka bërë që Ministria e

Arsimit dhe e Kulturës është vënë përpara probleme të reja që kërkojnë zgjidhje. Pikërisht ne duhet t'u gjejmë zgjidhjen më të drejtë marksiste-leniniste këtyre problemeve.

Problemet janë të shumta, ato nuk janë të thjeshta dhe që mund të zgjidhen me një diskutim ose me një të rënë të penës. Për zgjidhjen e tyre duhet të ruhemi nga metodat anarkiste, të mbuluara gjoja me forma masovike, të kemi kujdes nga pikëpamjet subjektiviste, të ruhemi me vigjilencë nga tendencat dhe prirjet e simpatisë për shkolla të ndryshme të huaja ose të brendshme të kohës së kaluar, simpati që, me kalimin e kohës dhe me rutinën, në disa njerëz janë kthyer në dogma që u duken «më të mira» dhe që, sipas mendimit të tyre, pa to shkolla s'do të dalë e mirë, në mos do të bëhet e pavlefshme. Pra, çdo gjë që ekziston në shkollën tonë të re duhet të kalojë në analizën e imët të marksizëm-leninizmit, pasi shkolla jonë e re socialiste duhet të përshkohet dhe të udhëhiqet fund e krye, në çdo gjë, nga filozofia jonë materialiste. Ky është kushti kryesor.

Shkolla jonë e re nuk mund të jetë shkollë e çdo lloji, ajo duhet t'u përgjigjet nevojave të zhvillimit të prodhimit, të jetë e përshtatshme dhe t'u përgjigjet strukturës dhe superstrukturës së vendit tonë socialist. Shkolla jonë, pra, duhet të përfaqësojë dhe të materializojë filozofinë tonë marksiste në të gjitha ciklet e saj, në të gjitha format e organizimit të metodave dhe të stilit, të ndjekë dhe të ndihmojë zhvillimin revolucionar të strukturës dhe të

superstrukturës. Ajo, e udhëhequr nga Partia, duhet të jetë pjesë përbërëse e kësaj të fundit, të ndihmojë prodhimin dhe të zhvillojë mendimin e përpërimin.

Do të gabojnë ata mësues apo pedagogë, do të gabojmë edhe ne, në rast se mendojmë se në ndërtimin e shkollës sonë çdo gjë ka shkuar sipas kriteve që përmenda më lart, ose të mendohet lehtësisht se meqë ne morëm si model shkollën sovjetike, nuk kemi gabuar. Te ne janë vërtetuar gabime jo vetëm nga fakti se nuk kishim eksperiencë, por edhe se vetë shkolla sovjetike ka pasur gabime e të meta serioze, asaj nuk i ishte shkuar deri në fund, ajo ishte në zhvillim. Po përveç këtyre, stadi i zhvillimit ekonomik dhe arsimor-kulturor në vendin tonë (për të cilin do të flas më poshtë) ishte i ndryshëm nga ai i Bashkimit Sovjetik.

Në ndryshimet, plotësimet, korrigjimet që ne do t'i bëjmë shkollës sonë, duhet të bazohemi në gjendjen aktuale dhe në rezultatet e arritura, duke u bërë këtyre një analizë të hollësishme marksiste-leniniste. Me analizë të hollësishme unë nuk kuptoj vetëm një analizë statistikore brendapërbrenda arsimit, por këtë të lidhur me gjendjen konkrete aktuale të vendit, me zhvillimin e prodhimit, të ekonomisë, të kulturës, me nevojat e tyre, me plotësimin ose jo të këtyre nevojave e boshllëqeve, duke i ditur sa janë këto nga ana materiale, si numër kuadrosh dhe nga ana e tyre cilësore. Kështu, ne do të njohim edhe stadin aktual të zhvillimit ekonomik, edhe stadin e zhvillimit arsimor-kulturor, do të shohim ku i kemi boshllëqet dhe

do të na dalin më të sakta se çdo herë tjetër nevojat.

Një ecje e tillë pak a shumë e përsosur neve na ka munguar, por edhe symbyllur asnjëherë nuk kemi shkuar. Pas Çlirimit, në pamundësi për të bërë ndryshe, siç ishim të detyruar të prananim disa tipare të shkollës së vjetër, po ashtu, lidhur edhe me kushtet e prapambetura ekonomike dhe kulturore të vendit, ne i vumë rëndësi, përveç shkollës fillore të detyruar, kulturës së përgjithshme dhe bëmë përpjekje për të krijuar një rrjet të shumëllojshëm shkollash të mesme të arsimit të përgjithshëm dhe profesional. Sidomos në dhjetëvjeçarin e dytë pas Çlirimit ne hapëm mjaft gjimnaze, nëpërmjet të cilave synonim të ngjnim nivelin e përgjithshëm kulturor të rinisë dhe të krijonim një kontingjent kuadrosh të lartë të profileve të ndryshme, për të cilët vendi që po rindërtohej kishte një nevojë të madhe. Ky ishte një orientim i drejtë, pavarësisht se mund të kishte dhe kishte shumë boshllëqe. I drejtë ishte edhe orientimi për përgatitjen e mësuesve në masë.

Kurse çështja e edukimit teknik nuk shkoi plotësisht në këtë rrugë. Në qoftë se në periudhën e parë pas Çlirimit ne hapëm minimumin e domosdoshëm të shkollave profesionale, më pas dhe përgjithësisht në zhvillimin e arsimit profesional pati neglizhenca dhe mjaft boshllëqe. Këtu mund të kërkohet shfajësimi në faktin që ne nuk e kishim të zhvilluar industrinë tonë në atë stad që e kemi sot, por kjo nuk mund të shfajësojë mungesën e kujdesit e të perspektivës plotësisht të qartë për sa u përket ndërtimit material të fabrikave, dhe sidomos zhvillimit të

bujqësisë, që ishte një sektor shumë i rëndësishëm, për të cilin ne duhej të kishim marrë masa serioze qysh në fillim në drejtim të shkollave bujqësore. Duke mësuar nga këto gabime, që janë vërtetuar në punën tonë me shkollat dhe duke u mbështetur në analizën që përmenda më lart, me siguri do të dalim me konkluzione të drejta dhe do të marrim masa të atilla që shkolla jonë të bëhet me të vërtetë një shkollë socialiste e re dhe revolucionare.

Nga ky studim do të na dalë se ndërtimi i socializmit, zhvillimi i mëtejshëm i prodhimit, i ekonomisë dhe i kulturës kanë nevoja të mëdha për njerëz të mësuar, jo vetëm për të plotësuar disa organika të planifikuara, por në masë, njerëz me mësim dhe shkencë të shkallëzuar dhe jo uniformë në çdo gjë dhe për çdo gjë. Mësimi dhe edukata në shkolla nuk mund të konsiderohen, siç i konsideron filozofia borgjeze, si një raket spekulimi dhe fitimi personal, por si një armë e fuqishme në duart e njerëzve të rinj të shoqërisë socialiste, për ta ndërtuar këtë shoqëri, për të çuar përpara prodhimin e përbashkët socialist, për të zhvilluar kulturën socialiste në shërbim të shoqërisë.

Në qoftë se e shohim drejt këtë shumanshmëri të madhe të nevojave, si në sasi ashtu dhe në cilësi, në qoftë se e shikojmë gjithashtu plotësimin e këtyre nevojave në dinamizmin e zhvillimit dialektik materialist dhe historik, atëherë do të dalim në rrugën se nuk mund dhe nuk duhet të kemi një tip shkolle, por një gamë të tërë shkollash, duke përfshirë edhe kurse të ndryshme disamujore.

Për sa i përket shkollës 8-vjeçare, mua më duket

se kjo duhet të mbetet e pandryshuar, tip unik. Karakteri dhe kriteri i saj duhet të qëndrojnë ashtu siç janë, domethënë pajisja e të gjithë fëmijëve deri në shkollën 8-vjeçare me kulturë të përgjithshme të një-llojtë për të gjithë, pa përjashtim. Ndërsa, sipas mendimit tim, programeve të saj mund dhe duhet t'u bëhen përmirësime. Në to mund të ketë edhe shprehje të punës, por këto të mos shndërrohen në specialitete teknike. Pas mbarimit të shkollës 8-vjeçare, një numër shkollash të ndryshme të çdo dege, të çdo profili, u dalin të rinjve përpara, qoftë kur futen në punë, qoftë kur vazhdojnë një cikël tjetër shkolle më të lartë se 8-vjeçarja.

Shumëllojshmëria e shkollave na paraqitet dhe do të na paraqitet sidomos në shkollat e mesme. Ministria e Arsimit dhe e Kulturës ka paraqitur variantet që mund të konsiderohen një bazë e shëndoshë mbështetjeje, vetëm se këto duhet të përpunohen akoma, sepse, më duket mua, në to ka dy të meta bazë.

E meta e parë është se ministria është gjendur nën presionin e drejtë të bazës, e cila, për të plotësuar nevojat e ngutshme e të mëdha që i dalin zhvillimit të prodhimit, kërkon dhe gjen rrugëdalje duke krijuar shkolla në kooperativa e në uzina, me programe të papërcaktuara dhe me profile të ndryshme.

E meta e dytë është se Ministria e Arsimit dhe e Kulturës çështjen e të ardhmes së shkollës dhe të perfeksionimit e shikon më shumë nga ana e zënatit të saj, në mënyrë didaktike, pedagogjike, discipline formale, si edukatë të përgjithshme ose speciale të caktuar njëherë e përgjithmonë dhe më pak në li-

dhjet e ngushta organike me prodhimin. Fakt është se studimi i këtyre problemeve të mëdha të arsimit dhe konkluzionet bëhen nga shtabi i Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës, kurse këto i kapërcejnë kufijtë e shtabit të Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës qoftë ky i përbërë edhe prej qindra mësuesish e pedagogësh kompetentë. Çështja e arsimit është një çështje e madhe e Partisë, e pushtetit, e gjithë popullit.

Për gjithë këtë punë që do të bëjmë për shkollën, mendoj se është e nevojshme të krijojmë një komision shumë të gjerë dhe të rëndësishëm, nën drejtimin direkt të Komitetit Qendror të Partisë, në të cilin të bëjnë pjesë njerëzit më të mirë të arsimit, të industrisë dhe të minierave, të bujqësisë (ferma e kooperativa), të rinj, gra, mjekë, sportistë, muzikantë, filozofë etj.

Pse duhen të gjithë këta? Sepse, duke përcaktuar orientimet, atë që thashë më sipër, këta do të bëjnë lidhjen e gjallë të shkollës me zhvillimin ekonomik-shoqëror të vendit, cilido prej tyre do të paraqitë nevojat e ngutshme dhe në perspektivë, këtej do të dalin më drejt përpjesëtimet dhe prioritetet, do të përcaktohen koha e duhur për plotësimin e nevojave dhe tipat e ndryshëm të shkollave. Kjo është njëra anë e punës së këtij komisioni. Ana tjetër po aq e rëndësishme është ajo e lëndëve, e përpjesëtimeve që secila nga ato duhet të ketë në çdo shkollë e në çdo kurs të ngjashëm, në mënyrë që çdo njeri që mbaron një shkollë ose kurs, të gjejë shkollën ose kursin korrespondues të mëtejshëm për perfeksionimin e tij të vazhdueshëm. Ashtu si zgjidhen dhe si

kërkohet të zgjidhen tani këto punë, nuk është aq e drejtë, sepse disa herë nuk kanë orientim objektiv, marrin forma simpliste dhe anarkiste, shkohet, për shembull, nga rruga që kësaj ose asaj lënde t'i hiqet ose t'i shtohet aq e kaq, duke kujtuar se në këtë mënyrë çdo gjë u zgjidh drejt. Këto operacione përfaqësojnë dhe bëhen patjetër për të mirë, për të pasqyruar sa më mirë në tekste vijën e Partisë, por prapë nuk mund të quhen të plota dhe kurdoherë pa gabime.

Një çështje tjetër është ajo e «ekuivalencës» së shkollës. Kjo nuk kuptohet drejt. Unë mendoj se në këtë çështje nuk duhet të lejojmë nxitjen dhe prirjet e huaja për ne, pasi është mikroborgjeze të mendosh «të marr diplomë, të bëhem njeri me autoritet, të marr rrogë të madhe dhe të zë poste». Kjo ndjenjë, që fshihet gjoja nën stimulin e të mësuarit, në fakt është një mbeturinë latente antisocialiste, të cilën ne duhet ta spastrojmë dhe të forcojmë ndjenjën me të vërtetë socialiste të të mësuarit.

Ka njerëz që mendojnë se një pjesë e brezit të ri duhet të mbarojë ciklin e shkollave normalisht, ndër-sa të tjerët të mbarojnë kurse dhe shkolla të thjeshtë-suara e të cingëra për nevojat e prodhimit, me dëftesë e pa dëftesë, dhe këtyre t'u jepet ekuivalenca e gjimnazeve dhe e teknikumeve të plota. Kjo nuk ka interes dhe nuk është e drejtë. Disa thonë: «Po pse t'ua mbyllin derën e universitetit këtyre njerëzve?».

Kjo çështje duhet kuptuar drejt. Universiteti është një shkollë e lartë, ai përgatit kuadro të lartë, të cilët, gjatë zhvillimit të vendit, do të specializohen

akoma më shumë në punë e në forma të ndryshme kualifikimi. Prandaj ky kualifikim i lartë kërkon edhe bazat arsimore të shëndosha dhe të plota. Dyert e universitetit nuk janë të mbyllura për asnjëri, por ata që do ta ndjekin këtë duhet të kenë arsimin përkatës dhe këtë përcaktim ne duhet ta bëjmë mirë. Ne sapo kemi filluar të shtrojmë problemin e zgjedhjes së studentëve që pranohen në universitet. Por a bëjmë mirë apo jo në këtë rast? Komisioni që do të ngrihet për këtë punë, ta studiojë dhe ta përcaktojë më drejt këtë çështje. Por mendoj se në një stad të mëvonshëm kërkesat ndaj atyre që do të ndjekin arsimin e lartë, do të jenë më të shtrënguara dhe kjo do të vijë pasi do ta kërkojnë kushtet e reja të zhvillimit të prodhimit, të teknikës, të shkencave, të modernizimit të ekonomisë. Kalimi në një stad arsimor-kulturor dhe tekniko-ekonomik më të përparuar, që do të sjellë edhe transformime rrënjësore në shkolla, duhet t'u përgjigjet kurdoherë nevojave dhe t'u shërbejë situatave që kërkojnë koha dhe momenti.

Po ne s'kemi nevojë vetëm për kuadro të lartë, nevojat tona janë shumë të mëdha për kuadro të mesëm. Prandaj kësaj çështjeje nuk mund t'i vihet barrikada e ekuivalencës, ose e mbarimit të asaj apo të kësaj shkolle. Një individ që, për shumë arsye objektive dhe subjektive, nuk e ka ndjekur shkollën në rregull, nuk mund të ketë po atë lehtësi që ka shoku i tij i cili ka kryer shkollën në rregull. Megjithatë, ky individ nuk mund të mbetet pa mësuar, shoqëria nuk e lë atë në rrugë, ajo i ka krijuar atij mundësitë që të mbarojë një shkollë, të ndjekë me

korrespondencë një tjetër më të lartë të këtij tipi, kurse në qoftë se dëshiron të shkojë edhe në universitet, atëherë duhet t'u shtrohet disa provimeve ose konkurseve për ato lëndë që në shkollën që ai ka ndjekur, nuk janë zhvilluar.

Komisioni në fjalë do t'u hapë Komitetit Qendror, Qeverisë dhe organizatave të Partisë horizonte dhe perspektiva shumë më të qarta, do të paraqitë forma organizimi dhe pune më të përsosura për ecjen përpara të shkollës sonë të re.

Si e shikoj unë çështjen e studimit të periudhave të ecjes së shkollës sonë duke kaluar nga një etapë në tjetrën?

1) Ky studim do të na sqarojë rezultatet e arritura që nga Çlirimi e deri tani, do të na sqarojë në mënyrë dialektike zhvillimin e arsimit dhe të kulturës nga një nivel në një nivel më të lartë, të lidhura këto ngushtë me etapat e ndryshme nëpër të cilat ka kaluar ndërtimi i socializmit në vendin tonë, do të na përcaktojë boshllëqet dhe nevojat aktuale.

2) Do të na përcaktojë në mënyrë shkencore format, metodat dhe masat që duhet të marrim, krahas zhvillimit ekonomik, për të ngritur kulturën e përgjithshme të masave deri në një nivel të caktuar përafërsisht, për të plotësuar deri në një nivel të caktuar me kadro teknike të mesëm ekonominë tonë, për të plotësuar me kadro të lartë, deri në një nivel të caktuar, ekonominë, arsimin dhe kulturën tonë.

3) Sikur ne ta quajmë, për shembull, këtë stad zhvillimi stadi i parë, për të kaluar në stadin e dytë më të zhvilluar, shumë nga format, metodat dhe ma-

sat që na shërbyen në të parin, nuk mund të na shërbejnë plotësisht për stadin e dytë, pasi ky i kërkon më të perfeksionuara, sepse ekonomia dhe tok me të edhe njerëzit do të jenë ngritur dhe do të kenë arritur në një kualifikim më të madh.

Shumë forma shkollash do të mbyllen dhe duhet të zëvendësohen me të tjera më të specializuara. Tani në vendin tonë jo vetëm që njerëzit nuk janë më analfabetë, jo vetëm që kanë mbaruar shkollat 8-vjeçare, por edhe ata që nuk e kishin kryer këtë, bënë një sërë kursesh speciale, shkolla të veçanta, plus eksperiencës së jetës dhe punës politiko-ideologjike të Partisë, të cilat i kanë transformuar ata rrënjësisht, ashtu siç ka shkuar përpara ndërtimi i socializmit.

Kështu me radhë, nga një etapë në tjetrën, si çdo gjë, shkolla jonë do të pësojë ndryshime në formë, në strukturë, në përmbajtje. Vetëm një gjë nuk do të ndryshojë kurrë: shtylla e saj kurrizore, e cila do ta udhëheqë atë në çdo drejtim e në çdo transformim të saj — filozofia materialiste marksiste-leniniste.

Prandaj cilitdo, nxënësve, mësuesve, pedagogëve, popullit, punëtorëve, fshatarëve, të madhit dhe të voglit, Partia duhet t'u mësojë me të gjitha mjetet dhe format në radhë të parë marksizëm-leninizmin, shkencën që u ndriçon rrugën të gjitha shkencave.

Njohja e thellë e filozofisë marksiste-leniniste, e materializmit dialektik dhe historik, nga nxënësit, mësuesit dhe pedagogët duhet të na preokupojë dhe në këtë drejtim duhet të rishikojmë tekstet, format dhe

metodat e punës. Shkencat, qofshin ato natyrore, ekzakte ose shoqërore etj., me një fjalë, çdo gjë që mësohet në shkollë, duhet të vihet plotësisht në baza të drejta marksiste-leniniste. Rishikimi rrënjësisht i teksteve për t'i spastruar është një nga punët më serioze që na vihet si detyrë, për të cilën nuk duhet të mendojmë se do ta bëjnë mirë vetëm mësuesit. Tekstet duhen konsideruar si një fushë e rëndësishme ku konkretizohen vija e Partisë, politika e saj, qëllimet dhe programet e saj të tanishme dhe përgatitja e së ardhmes. Nuk duhet ta kuptojmë shkollën e re socialiste me çfarëdo lloj tekstesh, ku të bashkëjetojë botëkuptimi idealist-borgjez me atë marksist-leninist. Ne nuk duhet t'i bëjmë asnjë koncesion filozofisë idealiste borgjeze dhe as më të voglin koncesion teologjisë.

Ka shumë gjëra që ne duhet t'i vëmë në binarë të drejtë. Unë kam thënë edhe herë të tjera se në tekste ka shumë ujë, por më duhet ta shpjegoj pak këtë çështje, sepse kjo në praktikë, më duket, po kuptohet ngushtë e po thjeshtësohet shumë dhe ka prirje t'u bihet me sëpatë lëndëve ku duhet dhe ku nuk duhet.

Të marrim çështjen e shkencave. Këto kanë bërë përparime të mëdha. T'i biesh pa kriter cilëso shkencë që të jetë, kjo nuk është shkencore, kjo do të thotë ta nënvleftësosh shkencën. Studimi i natyrës duhet të bëhet thellësisht në mënyrë revolucionare. Në këtë drejtim çdo gjë duhet të shprehet medoemos qartë në tekstet, shkenca duhet të çlirohet krejtësisht nga teologjia. Me zhvillimin dhe përparimin e shkencave ne sqarojmë materializmin dhe dialektikën, të

cilat duhet të bëjmë të gjitha përpjekjet për t'ua mësuar nxënësve, mësuesve dhe pedagogëve, pasi kështu ata do të jenë në gjendje të kuptojnë teorinë e zhvillimit në trajtën e saj të plotë.

Kam dëgjuar se nga mësuesit tanë po diskutohet çështja nëse duhet mbajtur teoria e Linesë¹, duhen ruajtur të gjitha klasifikimet e tij, apo duhet cun-guar. Ky diskutim është pozitiv, por do të jetë më shumë pozitiv kur këto korigjime mbi Linenë ose mbi teori të tjera të bëhen në dritën e dialektikës materialiste, domethënë të hiqen ato gjëra që zhvillimi i mëtejshëm i botanikës apo i ndonjë shkence tjetër dhe dialektika materialiste i kanë vërtetuar si të tepërta ose të padrejta. Dhe të mos veprohet si ata që thonë në mënyrë të thjeshtë: «Çfarë na duhet ky ose ai». Metodat e tyre kanë arritur njëfarë përsosmërie dhe vetëm injorantët mund t'i eliminonjë me një vijë pene. Djemtë dhe vajzat në shkolla — të mos harrojmë dhe të mos e nënvleftësojmë këtë — duhet të mësojnë teorinë dhe shkencën e vërtetë, sepse kështu do të kuptojnë më mirë teorinë mbi relativitetin e dijes njerëzore, pasqyrimin në zhvillim të vazhdueshëm të materies.

Disa i bien thjesht e shkurt: «Ç'na duhen këto gjëra?». Por këta nuk kuptojnë se pa i mësuar këto gjëra, pa i trajtuar ato në forma të ndryshme, që nga më e ulëta deri te më e larta, nuk mund të formohet botëkuptimi filozofik materialist te njerëzit tanë të

1 Natyralist suedez, autor i klasifikimit të botës bimore e shtazore.

socializmit, nuk mund të ecë asgjë përpara, përkundrazi, do të kthehemi prapa, do të na mbulojë errësira, teologjia dhe filozofia borgjeze. Lenini ka shprehur idenë se pa argumente filozofike të shëndosha as shkencat natyrore, as materializmi nuk janë në gjendje t'u bëjnë ballë presionit të ideve borgjeze dhe rimëkëmbjes së botëkuptimit borgjez. Shkencëtarët tanë të socializmit duhet të mësojnë me durim dhe të jenë përkrahësit më të zjarrtë të filozofisë marksiste, me një fjalë, duhet të jenë materialistë dialektikë.

Programet kanë rëndësi vendimtare për shkollat e çdo kategorie. Për çdo lloj shkolle që do të përcaktohet, duhet të bëhen programe të diferencuara dhe të rishikohen ose të rihartohen edhe tekstet përkatëse. Paralelisht me këtë duhet menduar, po ashtu seriozisht, për përgatitjen e kuadrove të rinj dhe për aftësimin më të lartë të kuadrove ekzistues. Kjo çështje ka rëndësi të dorës së parë, sepse do të jenë këta që, pasi ta përvetësojnë mirë programin, do ta zhvillojnë në shkollat e ndryshme. Aftësimi i tyre nuk duhet t'i lihet rutinës, por edhe për ta ai është çështje discipline, shkolle.

Prandaj komisioni që propozoj duhet të krijojë nënkomisione me specialistë të lëndëve dhe punimet e tyre duhet të udhëhiqen nga kritere të shëndosha e të ndihmohen, të kontrollohen nga komisioni qendror jo një herë në mot, por në periudha të caktuara.

Programet janë të ndryshme e të shumta. Unë nuk jam kompetent të flas për to, por mendoj se, përveç orientimit të drejtë politik dhe ideologjik, duhet të ekzistojnë lidhjet organike në të gjithë gamën

e lëndës që jepet në klasat e ndryshme dhe asnjëherë të mos ketë shkëputje dhe përsëritje mekanike. Kështu, nxënësi në formimin e tij shkollor, mendoj unë, nuk do të harrojë asgjë në rast se teksti është i qartë, i thjeshtë dhe i plotë dhe do të jetë në gjendje të ndërtojë me baza njohuritë që i jepen. Kur këto lidhje do të jenë organikisht të ndërtuara mirë, nuk do të vuajnë as nga spastrimet e nevojshme që do t'u bëhen lëndëve në çdo etapë të shkollës, ose edhe të çdo klase, as nga vënia në baza të drejta në dritën e materializmit dialektik dhe historik, i cili kërkon absolutisht edhe spastrimin, edhe lidhjet organike, edhe qartësinë dhe vërtetësinë e shkencës, cilado qoftë ajo.

Frika e mungesës së erudicionit të gjerë që mund të pretendojnë disa, nuk duhet të na shqetësojë aspak, pasi këtë erudicion të nevojshëm ne duhet t'ua japim njerëzve progresivisht dhe po që se i ndërtojmë programet e tekstet në mënyrën që thashë më lart, njerëzit do të marrin një kulturë dhe edukatë arsimore të shëndoshë, të gjerë dhe relativisht të plotë. Atyre do t'u mbeten shumë gjëra në kokë, bile më shumë se kur lakmohet për ta një erudicion i pamatur dhe jashtë kohës e mundësive të zhvillimit të intelektit dhe të njohurive të tyre praktike. Kështu, linguistët tanë, shkencëtarë apo metodistë, duhet të luftojnë prirjen për t'u mësuar nxënësve gjuhën shqipe në mënyrë akademike, duke i mbushur dhe duke i ngarkuar me gjithfarë kategorish, duke synuar për t'u dhënë edhe njohuri abstrakte e të thata, të tepërta dhe të panevojshme për jetën. Shkenca gjuhësore du-

het ta ndihmojë më shumë dhe më shpejt shkollën për një përvetësim me baza më të shëndosha dhe një aftësi më të madhe të përdorimit praktik të gjuhës së gjallë nga ana e nxënësve.

Erudicioni fitohet me një kohë më të gjatë, me studime më të thella, që i kapërcejnë kufijtë e ciklit shkollor, me një specializim më të madh. Por, megjithkëtë, njeriu që mbaron shkollën në rregull, nuk mund të quhet i paditur; përkundrazi, gjatë jetës së tij dhe në jetë ai do të mësojë shumë gjëra të tjera, do t'i zgjerojë njohuritë e tij. Rëndësi, pra, kanë baza e studimeve, programet, tekstet, eksperimentet e ndryshme dhe lufta në jetë, në zbatimin e kësaj diturie dhe në pasurimin e saj me njohuri të reja. Duhet t'u vëmë rëndësi programeve dhe teksteve të të gjitha shkollave e të të gjitha lëndëve.

Përveç atyre që përmenda më lart, duhet t'u vëmë rëndësi të veçantë shkencave, si: fizikës, matematikës, kimisë; shkencave speciale, si: mjekësisë, gjeologjisë, mekanikës etj. Të gjitha këto shkenca duhet të mësohen mirë dhe që të ndodhë kështu, jo vetëm teksti duhet të jetë i qartë, jo vetëm programi duhet të jetë mirë i lidhur në të gjithë ciklin e shkollës dhe të universitetit, por pedagogu duhet ta zotërojë mirë lëndën.

Kryesore dhe parimore është pastaj çështja që tekstet e programet dhe dhënia e mësimit duhet të përshkohen nga konceptet tona materialiste dialektike, në mënyrë që, nëpërmjet këtyre shkencave, nxënësi, studentit dhe vetë pedagogu të formojnë botëkuptimin komunist dhe zhvillimin e zbatimin e këtyre shken-

cave në jetë t'i shohin nën prizmin e dialektikës materialiste.

Një kujdes i veçantë duhet t'u kushtohet në shkolle edhe historisë e gjeografisë, në radhë të parë të vendit tonë, por edhe atyre botërore, pasi ka një pri-rje që këto të mos përfillen sa duhet. Kjo pri-rje duhet luftuar.

Njerëzit tanë duhet absolutisht të njohin historinë e popullit tonë nën dritën e materializmit historik, prandaj tekstet dhe programet e kësaj lënde duhet të rishikohen me një sy kritik.

Po ashtu edhe historia e popujve të botës. Për këtë mendoj se duhen bërë ndryshime rrënjësore programesh e tekstesh dhe me kohë e me plan të hartohen të reja, pasi janë huajtur nga jashtë dhe shumica e tyre, e në mënyrë të veçantë ato të shkollave të larta, janë ndërtuar me kritere të ndryshme politike e ideologjike të papërshtatshme për shkollën tonë të re socialiste, në to nuk ekzistojnë përpjesëtime të drejta në përshkrimin e saj dhe humbet lidhja organike që ne duhet t'i japim mësimi të kësaj lënde, historisë së zhvillimit të shoqërisë njerëzore, nën prizmin e materializmit historik. Prandaj në këtë drejtim ka shumë punë për të bërë, si nga cilësia, nga përmbajtja, nga politika dhe ideologjia, ashtu edhe nga vëllimi.

Mësimi i gjeografisë së vendit tonë ka një rëndësi shumë të madhe dhe në qoftë se nënvleftësohet, buri-min e kësaj shfaqjeje duhet ta gjejnë në konceptet e shkollave të huaja, në ndikimin e regjimeve shtypëse të vendit dhe të pushtuesve. Interesi i të cilëve ishte që njerëzit tanë të mos e njihnin vendin e tyre.

të mos lidheshin dhe të mos dashuroheshin me të. Prandaj, i shtyrë nga të gjitha këto, mësimi i gjeografisë së Shqipërisë bëhej formal, i thjeshtësuar në kulm, numëroheshin lumenj e male etj. Duhet medemos të ndryshojë krejtësisht kjo gjendje në programet, në tekstet, në metodat e dhënies së mësimi etj. Gjeografia e vendit tonë, si ajo fizike, politike dhe ekonomike, duhet të kthehet në një shkencë të vërtetë, e cila të bëjë që gjatë gjithë ciklit të shkollës njerëzit të njohin plotësisht atdheun, zhvillimin, perspektivën, ta njohin atë dhe ta prekin, pasi mbi këtë tokë rrojnë, punojnë, krijojnë. Mësimi i gjeografisë duhet të jetë nga më të gjallët, nga më interesantët, mësimi në libra të lidhet me terrenin, me arat, me malet, me lumenjtë, me bagëtitë. Ç'perspektivë e madhe i hapet një mësimi të tillë të gjeografisë së vendit tonë! Ajo lidhet me kalitjen e patriotizmit dhe të dashurisë për vendin, lidhet me ekonominë, me bujqësinë, me industrinë; ajo ndihmon në përgatitjen e gjeologëve, inxhinierëve, agronomëve të mirë të ardhshëm, zhvillon shëndetin, sportin, turizmin. Po ta kuptojmë gjeografinë në lidhje me të gjitha këto dhe po të dimë që mësimin e gjeografisë në shkolla ta lidhim me natyrën, me vendin, atëherë do të dalim në konkluzionin e drejtë se në këtë lëndë duhet të bëjmë ndryshime kualitative.

Ndryshime të mëdha duhet t'i bëhen edhe lëndës së gjeografisë botërore, e cila është e papërshtatshme për ne në format dhe në madhësinë që po bëhet tani në shkolla.

Rishqyrtimi i teksteve në këtë prizëm do të thotë

një punë e pastër e me baza shkencore, një punë që lidh si duhet që nga bankat e shkollës fillore dhe deri në ato të universitetit, bile edhe më tej, praktikën me teorinë, sepse praktika ndihmon teorinë dhe teoria ndihmon dhe udhëheq praktikën. Po të bëhet si duhet kjo lidhje organike, atëherë do të jemi në gjendje t'i shërbejmë së tanishmes dhe të përgatitim njëkohësisht të ardhmen.

Rishqyrtimi i teksteve nën prizmin e dialektikës materialiste duhet të bëhet për të gjitha llojet e shkollave që do të caktojmë, kurse shkurtime të lëndëve për çdo tip shkolle ose kurs të ulët apo të lartë duhet të bëhen të veçanta, në mënyrë që t'u përgjigjen nevojës për të cilën është hapur ajo shkollë dhe stadi arsimor të frekuentuesve. Por në përgjithësi mendoj se këto shkurtime duhet të ndjekin kurdoherë kritere shkencore të studiuara e t'u përshtaten disa orientime të caktuara dhe jo njëri t'i bjerë gozhdës e tjetri potkoit, hiq 10 orë andej, shto 20 këtej. Këto duhet të evitohen.

Më sipër fola pak për shkencat. Tani dua të them disa fjalë se si duhet bërë ky spastrim dhe ndërtimi i teksteve të reja për to. Derisa ne duam që tekstet të ndërtohen në prizmin e dialektikës materialiste, ato nuk mund të bëhen nga njerëz që nuk janë kompetentë dhe që kanë botëkuptime filozofike të huaja për marksizëm-leninizmin. Ai që do të punojë për rindërtimin e teksteve të reja jo vetëm duhet ta njohë mirë filozofinë marksiste-leniniste, por edhe ta ndiejë, edhe të dijë ta zbatojë, me një fjalë ta materializojë në tekste, ta lidhë me jetën. Këtu nuk e kam çështjen

vetëm për teknikët dhe shkencëtarët e dalë nga shkollat e vjetra, të cilët në përgjithësi kanë qëndrim të mirë politik, e duan Partinë, popullin, socializmin, por që këta, me dashje ose pa dashje, qëndrojnë të lidhur me fije të ideologjisë idealiste-borgjeze, bile kjo duhet thënë edhe për kuadrot e lartë të rinj që kanë dalë nga Universiteti ynë Shtetëror. Ne kemi mjaft specialistë që, megjithëse kanë mbaruar shkollën e lartë, ku kanë mësuar edhe filozofinë e kanë disa vjet që punojnë në terren, akoma nuk janë në gjendje ta lidhin diturinë e tyre me jetën, nuk kanë arritur akoma atë që kërkon Partia që, si materialistë të vërtetë, siç thotë Lenini, të jenë sulmues dhe të nxjerrin konkluzione filozofike revolucionare.

Atëherë ç'duhet të bëjmë për problemin që po shtrij? Nën drejtimin e Komitetit Qendror të Partisë dhe të Ministrisë së Arsimit e të Kulturës duhet të organizohet për këtë bashkëpunimi i ngushtë i pedagogëve të lëndës dhe i shkencëtarëve, i njerëzve të letërsisë dhe të filozofisë së marksizëm-leninizmit. Por kjo punë e madhe bazale nuk duhet t'u lihet vetëm mësuesve dhe profesorëve, pavarësisht se ata janë kompetentë, pavarësisht se mund të jenë anëtarë partie. Këtu çështja është se ata nuk e zotërojnë si duhet filozofinë marksiste-leniniste.

Po të marrim shkencat shoqërore, dhe në veçanti letërsinë, që trajtohet në shkollat e të gjitha profileve, do të gjejmë gjëra shumë të rënda, megjithëse atje kanë vënë dorë edhe shumë shokë komunistë, edhe pse në këtë drejtim tregohet një kujdes i madh nga ana e Partisë. Po ta shohim me kujdes zhvillimin e mësimit

të letërsisë sonë dhe të huaj, në shkolla dhe jashtë shkollës (dhe këtë duhet ta studiojmë me imtësi në dritën e filozofisë sonë), do të konstatojmë jo vetëm dobësi, çrregullime, shpërpjesëtime, amatorizëm, pasione dhe erudicione të sëmura, por edhe gabime të rënda që na kushtojnë dhe do të na kushtojnë më rëndë më vonë, në rast se nuk i korrigjojmë. Në këtë çështje pasqyrohen pikëpamjet filozofike të shkollave borgjeze, simpatitë individuale të njërit ose të tjetrit sipas prirjes dhe sipas shkollës e kulturës me të cilën ai është mburrur dhe që nuk ka arritur dot akoma të spastrojë rrënjësisht «hauret e Avgjisë»¹. Të gjitha këto ide dhe pikëpamje të papastruara mirë, këto simpati ose pasione për një autor të vendit ose të huaj në erudicionin e tij, të ngarkuar dhe të pakthjellët, i transmeton në shkollë ose në jetë nëpërmjet dhënies së mësimave, leksioneve, konferencave, artikujve dhe librave që ai bën. Kjo përbën një rrezikshmëri të madhe dhe në qoftë se nuk vëmë rregull në këtë çështje, ne kemi lejuar dhe i kemi bërë koncesione filozofisë borgjeze të na luftojë hapur, gati zyrtarisht, në terrenin tonë.

Epoka e Rilindjes është një epokë revolucionare demokratike me shumë rëndësi në historinë dhe letërsinë e popullit tonë, është një epokë e ndritur e udhëhequr nga idetë iluministe, nga njerëzit tanë të shquar të asaj periudhe, që me të drejtë është quajtur Rilind-

1 Sinonim i papastërtisë së madhe. Sipas mitologjisë greke, për të pastruar hauret shumë të pista të mbretit Avgji, u desh të lëshohej lumi.

dja e kombit, dalja nga errësira mesjetare-feudale, imperialiste, në dritë, në kryengritje, në luftë për liri, pavarësi, demokraci, për dritë dhe arsim.

Diku Engelsi ka folur për Rilindjen, jo për Rilindjen tonë, por për vitet «pesëqind» (siç quhet epoka e gjysmës së dytë të shekullit të 16-të). Ai thotë se kjo ishte një epokë e ndritur, që nxori njerëz të mëdhenj, jo vetëm artistë dhe piktorë, por edhe shkencëtarë, filozofë, që u dogjën të gjallë nga kisha, fizikanë, astronomë e të tjerë, që çanë errësirën e rëndë të mesjetës, që rrëzuan besime e sisteme dhe i dhanë një shtytje të mëtejshme zhvillimit ekonomik, kulturor, shkencor. Por analiza që ai i bëri epokës së Rilindjes është një analizë dialektike materialiste dhe jo idealiste, pasi shtytja që rilindësit i dhanë shoqërisë nuk ishte as e plotë, as e përsosur, ajo do të transformohej, do të zhvillohej, do të ngjisnin përmbysje të pjesshme dhe rrënjësore në zhvillimin e shoqërisë njerëzore dhe në shkencat e ndryshme. Ligje të reja ose plotësuese do të lindnin dhe, siç thotë Lenini, nga këto përmbysje

«...lindin në më të shumtën e rasteve shkolla dhe shkollëza, rryma dhe rrymëza filozofike reaksionare»¹,

që vetëm filozofia jonë materialiste mund t'ua shpërndajë mjegullën dhe të evitojë dëmet që sjellin.

Pikërisht nën këtë prizëm e ka shikuar epokën e

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 33, f. 254.

Rilindjes sonë Partia dhe këtë rishikim duhet ta thellojë akoma më shumë nën prizmin e materializmit dialektik, me qëllim që kjo periudhë të kalojë në nxënës, në studentë, në mësues, në profesorë dhe në popull sa më qartë dhe drejtë, e analizuar në mënyrën marksiste-leniniste, si nga ana shoqërore dhe ekonomike, ashtu edhe arsimore, kulturore, historike dhe jo me prirje si i dashka qejfi njerit ose tjetrit. Kjo duhet të bëhet në këtë rrugë.

Rilindësit tanë duhet të vihen drejt në epokën kur kanë jetuar, punuar dhe luftuar, duhet të vihen në dukje idetë e tyre, të cilat ishin prodhimi i zhvillimit të shoqërisë së asaj epoke, duhet të vihen në dukje qëllimet e tyre ku synonin imediatisht dhe në perspektivë. Po të shtrohen gjërat kështu drejt, do të dalë se rilindësit ishin njerëz të shquar me ide përparimtare, ishin iluministë revolucionarë, të guximshëm dhe me një atdhedashuri të madhe e të zjarrtë. Ata luftuan me pushkë e me pendë për lirinë dhe pavarësinë e popullit, për zgjimin e tij. Të gjitha këto janë anë të pozitive të tyre, të cilat janë të mëdha. Të gjitha këto veti edhe karakteristika të epokës së Rilindjes dhe të rilindësve ne duhet t'ia japim popullit.

Por nuk duhet të harrojmë për asnjë çast se po këta rilindës kanë anë të tyre negative, që duhet t'i nënshtrohen kritikës sonë marksiste-leniniste. Këto dobësi qëndrojnë në botëkuptimet e tyre filozofike, të cilat janë idealiste. Ky është një bagazh i rëndë, është filozofia e epokës së tyre, që është në kontradiktë dhe në luftë me ideologjinë tonë.

Të heshtim për këtë antagonizëm, për këtë luftë

të pamëshirshme për jetë a për vdekje që zhvillojmë ne, marksistët, kundër filozofisë idealiste, kundër fesë dhe besimeve fetare? T'i konsiderojmë ata të paprekshëm, tabu, vetëm për faktin se janë rilindës? A mund të bashkekzistojmë në një kohë, që nga një anë luftojmë me rreptësi teologjinë, fenë, kishat dhe xhamitë, priftërinjtë dhe hoxhallarët dhe, nga ana tjetër, të ekzaltojmë ato pjesë të veprës së Naimit ku ai shpreh filozofinë e tij bektashiane; ose të Mjedës, ku flet për teologjinë kristiane; ose të Çajupit, ku thotë, për shembull, se Baba Tomorri ishte «froni i perëndisë» etj. dhe të gjitha këto t'ia japim ushqim ideologjik popullit vetëm pse këta janë rilindës, janë njerëz të mëdhenj, kanë hedhur bazat dhe kanë ndihmuar në lëvizimin e gjuhës, pse vargjet e tyre poetike janë të bukura e kanë krijuar figura të këndshme?

Jo, si marksistë dhe për interes të popullit e të socializmit, ne duhet t'i luftojmë këto anë negative. Në ideologji nuk mund t'i bëjmë koncesion vargut ose gjuhës. Vlerësimi që Engelsi i ka bërë gjuhës së Lutrit¹, si bazë të gjuhës letrare gjermane, nuk e ka ndaluar aspak të çmojë në dritën e vërtetë dhe të demaskojë rolin reaksionar të reformës para dhe pas kryengritjes fshatare në Gjermani.

Prandaj edhe për ne çështja e teksteve shkollore në të gjitha këto lëndë, dhe veçanërisht në ato të

1 Përfaqësues i Reformacionit, që drejtohej kundër kishës katolike dhe feudalizmit në Gjermaninë e shekullit të 16-të. Kundërshtar i likuidimit të marrëdhënieve feudale me dhunë revolucionare dhe armik i fshatarëve kryengritës.

letërsisë, brenda dhe jashtë shkollës, duhet t'i nënshtrohet një analize dhe një kontrolli të vërtetë në prizmin e filozofisë sonë.

Çështja që shtroj për rilindësit duhet të kuptohet dhe të zgjidhet drejt. Nuk lejohet dhe nuk është marksiste të errësohet kjo epokë. Nga autorët e Rilindjes dhe nga veprat e tyre duhet të bëhen zgjedhje me kritere të drejta për kategoritë e shkollave të ndryshme dhe për publikun, duhet të hiqen pa ngurrim anët negative, pasi në rast se i jepen nxënësit të shkollës 8-vjeçare vjersha dhe shkrime të një rilindësi ku fli-tet për zotin dhe, nga ana tjetër, këtë autor e ngre në kulm, atëherë ke ekzaltuar edhe filozofinë e tij idealiste, deiste ose polideiste. Këtyre duhet t'u bësh kritikën, por nxënësi i vogël nuk do të të kuptojë, nuk do të kuptojë nuancat e elozhit dhe të kritikës. Kurse në shkollat e larta tekstet e tyre mund të jenë më të gjera, por asnjëherë pa kritikën serioze marksiste-leniniste të pikëpamjeve të tyre idealiste.

Nga ana tjetër, duhet të ruhem fort nga idealizimi dhe nga kulti i rilindësve. Këtë çështje duhet ta shikojmë në prizmin e filozofisë sonë marksiste-leniniste. Ndryshime kolosale janë bërë në vendin tonë që nga koha e rilindësve e deri sot në fushën ekonomike, shoqërore, kulturore, arsimore. Shqipëria nuk është më ajo e para, as ekonomia e saj, as kultura, as arsimiti, as gjuha, as regjimi, as politika, as ideologjia. Sipas ligjit dialektik materialist çdo gjë ka ndryshuar dhe po ndryshohet. Po të mos i kesh parasysh të gjitha këto ndryshime, të ekzaltosh një dhe të harrosh të tjerat, të rrosh vetëm me të vjetrën dhe të harrosh të

renë, të mendosh se vetëm e vjetra duhet të ndikojë mbi të renë dhe se e reja luan rol të vogël, do të thotë të ecësh në qorrrokak. Duke pasur parasysh këto, duhet luftuar çdo nënvleftësim që i bëhet letërsisë së periudhës së pushtetit popullor. Kësaj letërsie të re të realizmit socialist duhet t'i hapen mirë dyert e shkollës, sepse në të pasqyrohen ndjenjat dhe përpjekjet e një epoke të re të lavdishme dhe është e tillë që mund e duhet të shërbejë për edukimin e gjithanshëm të masave me idealet e larta të shoqërisë socialiste e komuniste.

Po me këto kritere duhen shikuar edhe periudhat e tjera të zhvillimit të mendimit në shkenca e në letërsi, në art e në muzikë, të pasqyruara nëpër tekste. Siç thashë edhe më lart, këto duhet të jenë komplet, por ne nuk duhet të lejojmë maninë e tepruar të disa eruditëve të shquar që duan jashtë masës dhe në një kohë të shkurtër t'u mësojnë nxënësve të gjitha ato që atyre vetë u është dashur një jetë e tërë për t'i mësuar.

Kjo, mendoj unë, nuk duhet të kuptohet se ne nuk kemi nevojë për eruditë të shquar, për specialistë të mëdhenj. Përkundrazi, ne kemi shumë nevojë, këta janë pusi i shkencës dhe i diturisë dhe me anën e tyre ne do të shumojmë dhe do të kualifikojmë kua-dro të lartë, por të mos i ngatërrojmë statet e zhvillimit. Njeriu shumë i mësuar ka dhe duhet të gjejë mundësitë që studentit të universitetit lëndën e tij t'ia bëjë shumë të kuptueshme, pa e ngarkuar rëndë atë, ndërsa specialistit që i çohet për ta kualifikuar më tej, të dijë t'ia ngrejë dozën.

Për sa i përket literaturës së huaj botërore, në shkolla dhe në publik, mendoj se ajo për një kohë të gjatë është ndodhur në një gjendje kaotike mjaft të rrezikshme. Megjithëse dy-tre vjetët e fundit janë bërë disa përmirësime, gjendja mbetet përsëri shqetësuese. Në këtë drejtim nuk ka kritere të shëndosha; dhe atje ku ka ose janë dhënë, ato janë shtrembëruar, janë bastarduar. Prandaj këtu duhet të vërë dorë seriozisht Komiteti Qendror i Partisë, sepse ka çështje parimore që duhen afirmuar me forcë dhe që duhet të organizohet mirë kontrolli i zbatimit. Përkthehet çfarëdo roman që i pëlqen ndonjërit dhe kërkon t'i shtypet; në qoftë se përkthyesi është ndonjë personalitet dhe autori i romanit «klasik», pavarësisht nga idetë që shprehen në të, romani shtypet dhe i jepet publikut të ushqehet. Nga ana tjetër, po ky përkthyes shkon e mban konferenca në emër të Partisë, në kundërshtim me idetë e romanit që ka përkthyer. Aq i bën inkonsekuenca e tij atij vetë dhe Shtëpisë Botuese që tejkalon planin.

Popullit dhe brezit të ri, qoftë në botimet shkollore apo në ato publike, ne duhet t'u japim në duar libra jo për t'i çorientuar ose për t'i çoroditur shpirtërisht, po për t'i ndihmuar të njohin zhvillimin e shoqërisë dhe njëkohësisht t'i armatosim me ideologjinë tonë. Literatura e huaj është një fushë e gjerë dhe e larmishme. Zgjedhja me kujdes në këtë fushë e asaj që na duhet është edhe e mundshme, por edhe e vështirë. Njerëzit që do të bëjnë këtë zgjedhje duhet të jenë me kulturë të gjerë dhe me pikëpamje marksiste-leniniste të formuara. Këta njerëz duhet të njo-

hin mirë nevojat jo në bllok, por në kategori të veçanta, duke përkthyer dhe duke shtypur literaturën e huaj, ata duhet të kenë të qarta qëllimet e caktuara dhe synimet e Partisë. Në këtë problem të rëndësishëm dhe delikat nuk duhen lejuar as snobizmi, as shijet individuale, as shijet e sëmura, por as edhe nihilizmi, duke thënë se «s'na duhen fare». Jo, neve na duhen, por do të marrim aq dhe ato që do të ndihmojnë zhvillimin tonë mendor, artistik, kulturor.

Çdo popull ka literaturën e vet dhe kjo përbëhet nga një varietet dhe shkolla të shumta. Borgjezia, në fazat e ndryshme të zhvillimit dhe të dekadencës së saj, ka krijuar dhe krijon literaturën e saj me shkrimtarë, poetë, muzikantë, artistë e të tjerë, të mëdhenj e të vegjël, nga ata që i kanë rezistuar kohës dhe nga ata që i ka marrë rrëkeja. As nuk mund të mendohet që ne t'i përkthejmë këta *en bloc*, pasi «pa to nuk rrojmë dot», ose pse nuk jemi *à la page*, siç mund të pretendojnë disa. Ne duhet të zgjedhim ata autorë dhe ata libra që janë nga më përparimtarët, nga më revolucionarët dhe të momenteve më revolucionare, në mënyrë që njeriut tonë t'i ilustrojmë ato që ai ka mësuar për historinë e popujve, për luftën e tyre klasore, për zhvillimin e mendimit përparimtar të tyre. Të tillë shkrimtarë, poetë, artistë ka, por kurdoherë të mos harrojmë se në ta nuk do të gjejmë plotësisht atë që kërkojmë dhe ashtu si e duam ne, pasi edhe në këta autorë përparimtarë ose revolucionarë do të gjejmë të pleksur, në mos plotësisht, por në një mënyrë ose në një tje-

tër, pasqyrimin e ideve borgjeze të jetës dhe të mendimeve sunduese të epokës që kanë jetuar.

Atëherë si duhet të procedojmë në këtë drejtim? Unë mendoj se nuk duhet të udhëhiqemi nga mania që romanin medoemos duhet t'ia japim nxënësit, të riut dhe publikut «ta hajë» të tërë, edhe kur ky roman ka tri të mira dhe pesë të këqija. Në këtë rast mund dhe duhet t'u japim atyre pjesë të zgjedhura, pikërisht ato tri më të mirat, pa lënë pas dore për t'i bërë edhe kritikën tërësisë. Unë mendoj se për ta kryer mirë këtë detyrë kaq delikate, duhet të kemi parasysh kurdoherë dhe në çdo hap që bëjmë nëse kjo u shërben dhe sa u shërben formimit dhe edukimit të njerëzve tanë, ndreq apo prish atë që Partia po ndërton çdo ditë e çdo orë. Pasi në rast se nga një anë ne bëjmë një luftë të përditshme e këmbëngulëse për të zhdukur mbeturinat mikroborgjeze nga ndërgjegjja e njerëzve, ose luftojmë çdo ditë ndikimin e fesë e të bestytnive dhe, nga ana tjetër, popullit i japim në dorë libra të autorëve me famë botërore në shekuj, në të cilat ata i trajtojnë të lyera «me sheqer» këto ide, atëherë me duart tona shkallmojmë natën atë që ndërtojmë ditën.

Këto kritere, mendoj unë, duhet të ndiqen edhe për literaturën në universitet dhe jo të shkohet nga prirjet e profesorëve të veçantë dhe të ngarkohen programet me veprat e Aristofanit, siç lexova një kritikë të drejtë të një studenti shkruar në gazetën «Studenti». Në të gjitha programet e universitetit duhet të sundojë në çdo gjë, si në përcaktimin e tyre, në hartimin e teksteve, në format dhe në me-

totat e mësimit, filozofia e Partisë sonë, filozofia materialiste.

E ritheksoj përsëri se studimi i filozofisë marksiste duhet të na preokupojë shumë, pasi pa e ditur dhe pa e zotëruar atë, nuk mund t'i ndërtojmë ato ashtu siç thashë pak më lart. Por mendoj se ky studim bazë i rëndësishëm, aktualisht, zhvillohet i njëanshëm dhe me metoda të vjetra, të huajtura nga shkolla sovjetike, me tipizime, me formalizma, pa e gjallëruar dhe pa e freskuar edhe me eksperiencën e gjallë e luftarake të Partisë sonë, të ndërtimit të socializmit në vendin tonë. Gjithashtu, mendoj se ky studim i rëndësishëm i filozofisë materialiste nuk bëhet si duhet i lidhur dhe i koordinuar me lëndët e tjera, pasi ndërtimi i programeve dhe zhvillimi i mësimëve në praktikën e ndryshme të fakulteteve lënë shumë për të dëshiruar në këtë drejtim.

Duhet të krijohet botëkuptimi i vërtetë materialist në inteligjencien tonë në përgjithësi dhe në studentët e profesorët në veçanti. Studimi i teorisë marksiste-leniniste nga këta duhet të ndjekë disa rrugë paralele për të mbërritur në një pikë formimin e tyre filozofik marksist-leninist.

Rruga e parë është ajo e studimit të materializmit dialektik dhe historik si lëndë e veçantë nga më kryesoret dhe që ky studim të bëhet në mënyrë serioze, me forma të përshtatshme, të kuptueshme, me fjalë të tjera, të mësohet e gjithë sinteza filozofike materialiste e formuluar nga klasikët tanë të mëdhenj, e ilustruar me luftën dhe me praktikën e Partisë sonë dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Pra, du-

het të ruhët dhe të perfeksionohet mënyra e mësimit të filozofisë marksiste siç po e bëjmë aktualisht dhe të dënohet e të demaskohet si revizioniste përpjekja aktuale sovjetike për ta zhdukur marksizëm-leninizimin si shkencë udhëheqëse dhe për ta katandisur në kuadrin e «logjikës». Kjo duhet të jetë baza e shëndoshë e të mësuarit të filozofisë sonë, e cila është teoria jonë orientuese dhe udhëheqëse.

Rruga ose mjeti i dytë, që përforcon të parin dhe që hap horizonte të qarta për zbatimin në jetë, për përdorimin e saj si busull, si udhërrëfyese, është ajo që tekstet, leksionet, metodat e dhënies së mësimit dhe zhvillimi i eksperimenteve dhe i praktikave — të gjitha këto në kompleks duhet të bëhen, të rindërtohen, të zhvillohen në përputhje me teorinë tonë. Teoria jonë t'i ndritë dhe t'i shpjegojë këto hap pas hapi, në mënyrë që studenti dhe pedagogu, mësuesi dhe nxënësi të shohin konkretisht në praktikë dhe në teori se zhvillimi i vërtetë e i drejtë i shkencave ecën në rrugën përparimtare vetëm kur udhëhiqet dhe ndriçohet nga materializmi dialektik dhe historik.

Mjeti tjetër i tretë, po aq i rëndësishëm, është pjesëmarrja aktive në problemet politike dhe ekonomike të vendit nga ana e nxënësve, studentëve dhe pedagogëve edhe gjatë formimit të tyre në shkollë dhe në universitet, pasi kështu ata dalin nga studimi libreshk ose nga praktika në laboratore në jetën e gjallë revolucionare, ku zbatohen në mënyrë krijuese, me një larmi të madhe dhe me rezultate konkrete që shihen dhe preken parimet bazë të filozofisë sonë materialiste marksiste-leniniste.

Përshkimi organik i mësimit dhe i edukimit nga ideologjia dhe politika e Partisë sonë duhet të realizohet së bashku me parimin marksist-leninist të lidhjes së mësimit me punën dhe të politeknizimit të shkollës. Ne kemi hedhur disa hapa në këtë drejtim që në Plenumin e Komitetit Qendror të Partisë të vitit 1960 për riorganizimin e shkollës mbi bazën e këtij parimi. Gjatë viteve të fundit, në atmosferën revolucionare të gjithë jetës së vendit, këta hapa po pasurohen me forma, iniciativa dhe eksperimente të reja. Këtë punë do të vijmë duke e zgjeruar e thelluar gjithnjë.

Këto tri rrugë kryesore duhet të kombinohen mirë.

Për të parën, që na e kanë lënë thesar kolosal klasikët tanë të mëdhenj, ne duhet të perfeksionojmë metodat e punës dhe të studimit; për të dytën kemi shumë për të bërë dhe duhet t'i futemi me shumë kujdes dhe në mënyrë revolucionare këtij procesi; për të tretën kemi filluar, por duhet ta zgjerojmë, ta plotësojmë dhe ta perfeksionojmë këtë proces.

Desha të them edhe pak fjalë për metodën dhe stilin e punës të mësuesit dhe të pedagogut.

Shkolla jonë socialiste kërkon nga mësuesit dhe nga pedagogët një metodë dhe stil të ri pune, revolucionar, dhe që të jenë këta të tillë, vetë arsimtarët duhet të jenë revolucionarë, të edukohen në këtë rrugë, që kështu të mundin të edukojnë edhe nxënësit e studentët. Programet dhe tekstet, të ndërtuara në frymën dhe me metodat e reja, do t'i edukojnë

edhe vetë mësuesit e pedagogët në këtë rrugë. Kjo nuk ka asnjë dyshim, por nuk do të jetë e mjaftueshme në rast se ata mbyllen në kullën e tyre, në botën e tyre të shkollës dhe nuk e ndiejnë dhe nuk e kalitin veten si pjesëtarë aktivë të zhvillimit të vrullshëm revolucionar të shoqërisë sonë socialiste. Në qoftë se ata nuk jetojnë dhe nuk veprojnë kështu, parësisht nga tekstet dhe programet, nuk do të jenë sulmues, novatorë, revolucionarë në metodat dhe në stilin e tyre të punës, ata do t'i mbulojë rutina, formalizmi, tipizimi dhe metoda e stili i tyre i dhënies së mësimit do të jenë amorfë, të vdekur, do të shndërrohen në atë stil dhe metodë të shkollës borgjeze që s'mungon të japë receta, të cilat, duke qenë «didaktike», ose të një «pedagogjie me përvojë», janë antidialektike, jorevolucionare, reaksionare dhe statike.

Metoda dhe stili i dhënies së mësimit është zanati nga më kryesorët për mësuesit e pedagogët, ata duhet të bëhen kompetentë dhe t'i perfeksionojnë ato. Do të jetë e vështirë dhe nuk do të bëjmë mirë në qoftë se japim receta dhe mësuesit e pedagogët, po ashtu, do të gabojnë në rast se mendojnë se metoda dhe stili i punës së tyre kanë arritur perfeksionin dhe duhet të merren si model i përsosur për të gjithë. Eksperienca e mirë në këtë drejtim duhet të përhapet, por puna dhe lufta, ngritja e aftësive do të krijojnë metoda dhe stil pune akoma më të mirë. Perfeksionimi nuk ka kufi. Prandaj, mendoj unë, kjo çështje e rëndësishme nuk duhet të futet në kallëpet e formalizmit dhe të tipizimit, por të jetë kurdoherë në zhvillim. Kjo nuk duhet kuptuar si një amatori-

zëm dhe pa e bazuar fort në programet dhe tekstet. Duhet të ndiqet rruga e punëtorit që është novator dhe revolucionar në punën e tij, i cili nxjerr nga tornoja detalin që i kërkohet, sa më të mirë e të përsosur dhe jo diçka që nuk i kërkohet, ose që është pjellë e fantazisë së sëmurë. Metoda dhe stili i mirë në punë duhet t'i shërbejnë qëllimit.

Çdo gjë do të bëhet mirë kur mësuesi dhe pedagogu do të zotërojnë mirë lëndën. Jashtë kësaj nuk mund të ketë as metodë, as stil të mirë në punë, si për punëtorin ashtu edhe për mësuesin e pedagogun. I çli-ruar, pra, nga moszotërimi i lëndës, arsimtari është në gjendje të njohë nivelin kulturor të nxënësve, prirjet e psikologjinë e tyre, pasi këto e të tjera do ta prijnë atë të zotërojë mirë lëndën, të bëjë ndryshime të vazhdueshme në stilin dhe metodën e punës së tij, që t'u përshtaten gjendjes, dhe të arrijë kështu në atë stad të metodës së tij që ai do ta gjykojë të përsosur.

Një metodë pune e tillë do të shkaktojë që mësuesi e pedagogu të jenë të detyruar (dhe këtu ata do të tregohen revolucionarë e novatorë) të përdorin forma të ndryshme për paraqitjen e lëndës, një larmi formash që do t'i çojnë larg stereotipizmit, dogmatizmit, formalizmit etj. Vetëm kështu, mendoj unë, ata nuk do të kenë frikë dhe druajtje nga pyetjet e nxënësve e të studentëve dhe as këta nga pyetjet që do t'u bëjnë mësuesit apo pedagogët. Kështu krijohet në klasë një jetë e gjallë dhe një komunitet i pastër, i thjeshtë, i ngrohtë, i përshtatshëm, revolucionar në procesin e osmozës së ndjenjave e mendimeve të nxë-

nësve e të mësuesit dhe të diturisë së këtij të fundit te nxënësit.

Verbalizmi dhe «akademizmi» i sëmurë i arsimtarit nuk janë veçse një mani dhe një dobësi e theksuar, prapa të cilave mbulohet dobësia e njohurive të tij për lëndën dhe prirja për ta fshehur këtë përpara nxënësve. Një arsimtar i tillë i gjen këto metoda për të fshehur vakuumin në «diturinë» e tij dhe për ta mbuluar këtë me frazeologji pa përmbajtje. Kjo, natyrisht, krijon një gjendje false në mes edukatorit dhe nxënësve, pengon edukimin e plotë të nxënësve, të cilët edhe mërziten dhe kërkojnë të dalin nga kjo gjendje duke mos qenë të vëmendshëm, duke bërë muhabete, duke bërë zhurmë ose duke zhgaravitur në defterë gjëra të kota. Të gjitha këto shfaqje të nxënësve, që shkaktohen nga një situatë objektive, mësuesi, me një metodë pune jo të mirë dhe me një përgatitje të çalë, ia ngarkon anës subjektive të nxënësve, mungesës së disiplinës, të edukatës së tyre etj. Për ta ndrequr këtë situatë, jonormale për të, ky mësues, duke mos qenë në gjendje të bëjë një analizë autokritike të punës së tij dhe duke e ndier veten epror nga çdo pikëpamje në krahasim me nxënësin, kalon në masa «pedagogjike», autoritare të papërshtatshme dhe që vënë mirë në dukje «autoritarizmin», disiplinën formale, forcën e notës, antipatitë e sëmura, meritë — të gjitha këto antiedukative, anti-pedagogjike. Këto çështje e shumë të tjera Partia duhet t'i ketë parasysh në edukimin politik, ideologjik dhe metodik të mësuesve e të pedagogëve, të cilëve u është besuar një detyrë e madhe.

Duke përkrahur me të gjitha forcat zbatimin më të gjerë të vijës së masave në zhvillimin e arsimit dhe në punën e shkollës, duke nxitur në këtë kuadër me të gjitha forcat iniciativat e shkollave dhe të mësuesve të bazës për zbatimin krijues të programeve mësimore, për përdorimin krijues dhe kritik të teksteve shkollore, për zhvillimin e eksperimenteve, në të njëjtën kohë të gjitha këto iniciativa duhet të mbështeten gjithmonë mbi bazën e politikës arsimore të përcaktuar nga Partia jonë mbi bazën e parimit të centralizmit demokratik.

Dëshiroj të them diçka edhe për çështjen e notës. Ky problem, të përdoret apo të mos përdoret nota, po diskutohet nga mësues e pedagogë. Diskutimi është i drejtë dhe i frytshëm. Të gjithë mund të themi nga një mendim për të kontribuar në këtë diskutim, i cili, shpejt ose vonë, do të arrijë në një konkluzion.

Nota është përdorur vazhdimisht në shkolla. Është krijuar një pikëpamje e tillë që, po të mos përdoret nota, s'ka si të funksionojë shkolla. Pra, nota ka marrë formën e «rregullatorit» të të mësuarit, ka hyrë thellë në mendjen dhe në ndërgjegjen e nxënësit dhe të arsimtarit si diçka që përcakton matematikisht çdo përpjekje të tyre, që nga përvetësimi i lëndëve deri te sjellja. Autoriteti i arsimtarit ndaj nxënësve, me dashje ose pa dashje, lidhet me notën.

Mund të pretendohet se nota është një stimul për të mësuar, por edhe e kundërta është e vërtetë. Ajo mund të jetë edhe frenuese, ajo mund të bëhet një armë e dëmshme në dorën e mësuesit dhe të pe-

dagogut të pandërgjegjshëm dhe mund të mos jetë për të gjitha rastet dhe kohët një stimul për të mësuar për nxënësin, i cili, porsa merr një notë të mirë, e fle mendjen, fshihet «i koracuar» prapa notës.

Për shkollat tona problemi vihet ndryshe. Qëllimi kryesor i shkollës sonë të re është t'i pajisë të gjithë nxënësit me arsim e kulturë të shëndoshë. Shkolla jonë ka karakter masiv, tek ajo janë zhdukur të gjitha barrikadat që pengonin njerëzit për të ndjekur shkollat, siç ngjiste dhe ngjet në shkollat borgjeze. Në shkollën borgjeze çështja e notës, përveç pengesave të tjera, ka pasur dhe ka karakter frenues, seleksionues, dhe kuptohet ndaj fëmijëve të cilave klasa¹.

Shkolla jonë e re, duke qenë masive, synon që të gjithë të mësojnë, bile sa më mirë, dhe asnjëri të mos mbetet në klasë. Kjo nuk do të thotë se të gjithë do të dalin shkëlqyeshëm, por të gjithë do të armatosen dhe duhet të armatosen për jetën; dhe kur njerëzit do të kalojnë nga shkolla në jetë, nuk do t'u kërkohet ç'nota kanë marrë, por si do ta bëjnë punën që u ngarkohet.

Unë mendoj se duhet të zhduket krejtësisht mendimi se «mësoj për të marrë një notë të mirë». Të ngulet mendimi që duhet të mësoj, pasi pa mësuar nuk mund as të rrohet, as të punohet, pasi pa dituri nuk mund t'u shërbejë si duhet popullit, atdheut, shoqërisë. Mësimi është një ushqim i domosdoshëm

1 Klasa shoqërore.

për njeriun. Për ta ngulur këtë mendim të drejtë të nxënësit, ne nuk duhet të përdorim notën, por punën politike dhe atë edukative.

Në këtë drejtim duhet të luftojmë, gjithashtu, mendimin se marrja e dëftesës ose e diplomës të çdo shkolle është një privilegj dhe një armë për përfitime personale dhe të ngulet mendimi se diploma është vetëm një vërtetim i mbarimit të një shkolle dhe i pajisjes me një shkallë diturie e specialiteti, të cilat duhet t'i vësh në shërbim të shoqërisë.

Politikisht, pra, ne duhet të zhvillojmë një punë të madhe dhe të gjerë edukative që të gjithë ata që ndjekin shkollat, të mësojnë jo për notën dhe as për diplomën në kuptimin mikroborgjez, po për të fituar sa më mirë dituri.

Përvetësimi i diturisë në shkolla nuk varet aspak nga nota, ai varet nga kuptimi i drejtë politik në radhë të parë, varet nga ndërtimi i qartë, i thjeshtë dhe i kuptueshëm i programeve dhe i teksteve, varet nga zotësia, metoda dhe stili i mësuesve dhe i pedagogëve, varet nga e gjithë edukata shkollore dhe jashtëshkollore. Këto janë vendimtarët, sipas mendimit tim, dhe jo notat.

Disa mund të thonë: «Këto janë të drejta, por a i kemi arritur ne këto kushte që të heqim notën?» dhe këtëj dalin me mendimin: «Heqja e notës mos është e parakohshme?».

Mendimi im, mund që edhe të gabohem, është se kushtet ne nuk i kemi të këqija, për të mos thënë shumë të mira, pasi duhet punuar akoma për krijimin e kushteve edhe më të mira. Kushtet politike

ne i kemi shumë të mira, pasi kemi një rini të zjarrtë e revolucionare, që e kupton shumë mirë rëndësinë e shkollës e të mësimit dhe që këto i kupton në mënyrë revolucionare. Kushtet e tjera duhet t'i përmirësojmë dhe do t'i përmirësojmë. Atë që thuhet se është e parakohshme, ne duhet ta përgatitim që të bëhet e kohës.

Por si ta bëjmë? Duke hequr notën? Me se ta zëvendësojmë këtë stimul?

Unë mendoj se sikur të pranojmë që nota është vetëm stimul, atë mund ta zëvendësojmë me shumë stimuj të drejtë, kuptohet, moralë; e dyta, duhet të lëmë sistemin e notave me pesa apo me dhjeta, siç e kemi sot, dhe përkohësisht të kalojmë në vlerësimë të përgjithshme, siç i kemi përdorur pak a shumë edhe përpara: «shumë mirë, mirë, dobët» etj., për t'i braktisur dhe për t'i zëvendësuar edhe këto, gradualisht, me karakteristika më të përcaktuara dhe të kualifikuara për aftësitë, përpjekjet e të tjera cilësi ose dobësi të nxënësit që, sipas mendimit tim, vetëm këto të japin idenë e plotë mbi nxënësin dhe i përshtaten si duhet pedagogjisë sonë të re. Tiparet kryesore të nxënësit i pasqyrojnë karakteristikat dhe jo notat e thata.

Në Shkollën e Partisë ne tani nuk praktikojmë sistemin e notës, as në kurse të ndryshme. Ne mund të fillojmë, së pari, të mos vëmë nota në shkollat fillore dhe mendoj se nuk ka asnjë rrezik që të vegjlit të mos mësojnë; përkundrazi, i edukojmë këta me një frymë të re që në vegjëli, që të mësojnë jo për notë ose nën frikën e ndikimit të saj. Kurse për

shkollat e tjera mund të ecim gradualisht, duke bërë eksperimentet e nevojshme, siç thashë më lart, ose në forma të tjera.

Më në fund, nota është e lidhur edhe me kalueshmërinë, ajo është si një çështje referimi për mësuesin dhe pedagogun. Kjo si do të bëhet, me karakteristikën do të kalojë nxënësi ose studenti? Karakteristikat duhet të jenë pikëmbështetja për mësuesin e pedagogun, por si notat ashtu dhe karakteristikat ata i formulojnë në baza objektive, kur e pyesin nxënësin, kur kontrollojnë detyrat me shkrim, ose nga provimet që u bëhen. Për t'ia komunikuar përshtypjet dhe mendimet e tij nxënësit, përse mësuesi të përdorë notën e thatë dhe jo shprehje e vlerësime më të gjalla, më politike, më edukative? Kjo është metoda më e përshtatshme. Dhe në fund, kur nxënësit i jepet dëshmia e kalimit, kjo bëhet në bazë të summit, të përgjithësimin të këtyre karakteristikave të çdo mësuesi, në bashkëpunim me kujdestarin e klasës ose me personat e ngarkuar për këtë punë. Natyrisht, këto ndryshime e forma janë të diskutueshme. Arsimtarët tanë kanë një përvojë të madhe dhe, sigurisht, ata që janë për mbajtjen e notës, kanë argumentimet e tyre jo vetëm pse duhet të mbahet, por si të bëhet ajo vetëm një stimul, ndërsa ata që s'janë për mbajtjen e sistemit të notës, kanë edhe mendimet e tyre se me se e si duhet të zëvendësohet. Prandaj, si përfundim, le të diskutohet dhe të rrihet edhe kjo çështje, si të gjitha problemet e shkollës sonë të re.

Jeta është një shkollë e madhe dhe vetë shkolla nuk është tjetër veçse një pjesë përbërëse e jetës. Prandaj shkolla duhet të gërshetohet ngushtë e në mënyrë të harmonishme me veprimet, punën dhe mendimet e njeriut dhe t'i shërbejë këtij në jetë, t'i shërbejë shoqërisë në tërësi. Shoqëria socialiste dhe ajo e mëvonshme komuniste, që po ndërton dhe përgatit Partia, kanë në çdo kohë e në çdo etapë ligjet dhe normat e tyre të zhvillimit, të transformimeve revolucionare, të cilat duhet t'i njohim, t'i mësojmë, t'i zotërojmë dhe t'i zbatojmë me konsekuencë.

Në çdo gjë duhet përgatitje, si para veprimit, gjatë zhvillimit të këtij veprimi, ashtu edhe pas tij; ndërtohet e tanishmja, por mendohet njëkohësisht dhe përgatitet e ardhmja. Në të gjithë këtë zhvillim jo të qetë, jo spontan, por revolucionar, lufta e të kundërtave krijon progresin dhe zhvillimi dialektik i të kundërtave bën ato transformime cilësore që e çojnë shoqërinë tonë nga një etapë e lartë në një etapë më të lartë. Në këtë revolucion të madh rolin vendimtar e kanë masat, të udhëhequra nga partia komuniste e proletariatit dhe ideologjia e saj marksiste-leniniste. Pra, Partia, me ideologjinë e saj, duhet t'i bëjë masat e gjera të popullit të ndërgjegjshme për këtë rol, t'i edukojë nga të gjitha anët dhe t'i bëjë të afta që të njohin, të zotërojnë, të zbatojnë si duhet ligjet e natyrës dhe t'i vënë e t'i shndërrojnë këto në të mira materiale për njerëzit, për shoqërinë. Prandaj shkolla, krahas veprimeve të tjera të njeriut, është një etapë e rëndësishme.

Qëllimi i madh i Partisë është që, duke ndërtuar

socializmin, të formojë dhe të farkëtojë njeriun e ri komunist, me botëkuptim të shëndoshë politik dhe teorik marksist-leninist, me etikën, guston, shijen marksiste-leniniste, me shpirtin revolucionar, sulmues, të guximshëm, krijues dhe realizues, marksist-leninist. Në këtë luftë revolucionare të formimit dhe të transformimit, në këtë betejë të edukimit dhe të riedukimit, në këtë përleshje të të kundërtave, të luftës së klasave, të së resë me të vjetrën, njeriu ynë i ri, që kur lind dhe gjersa të vdesë, atje ku punon, krijon dhe mendon, në çdo vend dhe në çdo kohë, kudo ku ai përpjek kokën dhe këmbën, duhet të gjejë të materializuar vijën e Partisë dhe filozofinë e saj, të kuptojë politikën, teorinë dhe zbatimin në praktikë të kësaj vije, të nxjerrë konkluzione filozofike dhe praktike nga këto realizime, të armatoset dhe të ecë përpara me forca të shumëfishuara dhe të jetë kurdoherë i vetëdijshëm se të gjitha këto janë realizimet e tij, të masave të popullit, të udhëhequra nga Partia e tij dhe filozofia e saj materialiste.

Humbja e busullës ose e toruas, siç thotë populli ynë, në të gjitha këto çështje shkakton disfata. Asnjë sektor apo nënsektor i aktivitetit shoqëror nuk duhet të nënvleftësohet ose të zhvillohet i shkëputur, në anarki me të tjerët ose me të tërën. Pa asnjë dyshim, do të ketë zhvillime të pabarabarta nga një sektor në tjetrin, do të ketë përparime dhe prapambetje, por këto të jenë të meta të rritjes, të zhvillimit dhe kurrë të mos lejojmë që ta kenë burimin në devijime politike dhe ideologjike.

Një nga arsyet e mëdha të katastrofës që i ngjau

Partisë Bolshevike të Lenin-Stalinit pas vdekjes së Stalinit, është edhe ky dezekuilibër në kuptimin dhe në zbatimin e drejtë të vijës në të gjitha fushat, është sklerozimi i parimeve teorike dhe organizative të Partisë, është mungesa e zhvillimit të luftës së klasave në mënyrë rrënjësore, të vazhdueshme dhe me konsekuencë, janë burokratizmi e shumë të tjera që kanë bërë objektin e shumë studimeve dhe analizave të mëparshme të Partisë sonë dhe që këtu s'është vendi të zgjatem. Vetëm se revizionizmi modern hrushovian rrëmbeu fuqinë, likuidoi partinë si parti të klasës punëtore, likuidoi ideologjinë e saj marksiste dhe e zëvendësoi atë me ideologjinë idealiste, shtetin e diktaturës së proletariatit po e shndërron në një shtet borgjez me një ekonomi kapitaliste.

Revizionistët modernë i kanë vënë kazmën shkollës sovjetike, po e kthejnë atë në një shkollë borgjeze, për të krijuar një brez të ri antikomunist, mbështetje të regjimit kapitalist që kanë restauruar në vendin e tyre.

Si konkluzion, të mos i harrojmë për asnjë çast të gjitha këto situata, këto rreziqe, ta kemi kokën të qartë dhe dorën të hekurt kundër armiqve të popullit, të Partisë dhe të socializmit, të kemi të qartë rolin e masave dhe rëndësinë kolosale të brezit të ri që fuqizon të tanishmen dhe siguron të ardhmen; të mos harrojmë kurrë se në të gjithë këtë luftë të madhe që zhvillon me sukses Partia, lufta për ndërtimin me sukses të një shkolle të re socialiste është një nga detyrat tona më të mëdha dhe më delikate, për të cilën kemi bindjen e plotë se Partia, si kur-

doherë, për këtë dhe për çdo gjë, do të dalë me sukses.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 60 (6099), 10 mars 1968

*Etohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1967-1968», f. 339.
Tiranë, 1969*

ANALIZAT MARKSISTE-LENINISTE TË PARTIVE KOMUNISTE DHE PUNËTORE JANË THESAR I MADH PËR LËVIZJEN KOMUNISTE BOTËRORE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

7 mars 1968

Ne i dhamë fund shqyrtimit të maketit të Historisë së Partisë dhe e aprovuam këtë dokument të rëndësishëm të saj. Me këtë rast mendova të diskutoj për një çështje: si duhet t'i konsiderojmë e t'i shfrytëzojmë dokumentet e Partisë sonë dhe ato të partive të tjera.

Analizat marksiste-leniniste të partive komuniste dhe punëtore janë thesar i madh për lëvizjen komuniste botërore. Marksizëm-leninizmi kërkon që çdo gjë të shpjegohet dhe të interpretohet në bazë të materializmit dialektik dhe historik, prandaj lufta revolucionare e çdo partie marksiste-leniniste, sukseset dhe disfatat e saj, vija që ndjek dhe qëndrimet që mban duhet të shkruhen në prizmin rigoroz të kësaj

1 Në këtë mbledhje u shqyrtuan disa çështje të tekstit të Historisë së Partisë së Punës të Shqipërisë, i paraqitur për diskutim si maket, dhe u miratua botimi i tij.

teorie. Jashtë këtij shikimi parimor nuk duhet të ketë interpretime të ngjarjeve, të rrethanave e të luftërave. Nga marksistë-leninistët nuk duhet të bëhen interpretime fantaziste, me *parti pris* dhe pa u bazuar në realitetin objektiv. Të veprosh ndryshe do të thotë të fshehësh të vërtetën, të gënjesh veten dhe të tjerët, të mos ndihmosh revolucionin proletar botëror, të krijosh konfuzion, të jesh shkak i devijimeve dhe të frenosh ose të ndalosh ecjen përpara drejt socializmit dhe komunizmit. Në rrethana të caktuara, për një kohë, mund të mos arrish të nxjerrësh konkluzione teorike, politike dhe organizative nga lufta, nga ngjarjet dhe evenimentet, por kur këto i ke ekspozuar drejt, pa lustër, pa shtesa të dëmshme dhe i ke qëndruar besnik zhvillimit të ngjarjeve, me të mira, me të meta ose me gabime, kjo duhet të konsiderohet një gjë shumë e mirë. Mungesa e nxjerrjes së konkluzioneve të thella teorike, politike dhe organizative është një e metë, është një e keqe, por është e keqja më e vogël përpara asaj kur relaton falsitete, mburrje dhe pasaktësi që të çojnë në nxjerrjen e konkluzioneve gjoja teorike.

Teoria jonë, që nuk është një dogmë, i vë një rëndësi të madhe zhvillimit dhe pasurimit të mëtejshëm të saj. Pra, eksperiencia e çdo partie marksiste-leniniste, e madhe ose e vogël qoftë, ka një rëndësi të pallogaritshme. Kjo eksperiencë e madhe, e gjerë, e shumanshme duhet të përgjithësohet në rrugën e shkencës marksiste-leniniste dhe të bëhet ushqim për revolucionarët e botës. Model i pagabueshëm për të gjitha partitë tona marksiste-leniniste, për të gjithë revolu-

cionarët për paraqitjen e eksperiencës dhe të konkluzioneve teorike dhe praktike revolucionare për të gjitha çështjet, problemet dhe interpretimet, duhet të jenë mësimet e Marksit, të Engelsit, të Leninit dhe të Stalinit.

Çdo parti marksiste-leniniste, e vjetër apo e re, ka historinë e luftërave të saj revolucionare, ka eksperiencën e saj pozitive dhe negative. Këtë e ka të shkruar ose jo, të formuluar drejt ose me gabime, me konkluzione filozofike, politike, organizative të drejta ose të shtrembra. Por nuk ka asnjë dyshim që thesari më i madh pas veprës së Marksit dhe të Engelsit është eksperiencia e Partisë Bolshevike të Leninit dhe të Stalinit, është veprimtaria e revolucionarëve të lavdishëm bolshevikë, e dy prej katër klasikëve tanë të mëdhenj, që realizuan në praktikë revolucionin socialist dhe ndërtimin e socializmit, që kanë luftuar, vepruar, menduar, udhëzuar, formuluar çdo gjë në rrugën dhe në normat e teorisë sonë revolucionare.

Ne kurdoherë u referohemi Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, kurdoherë mësojmë prej tyre, sepse ata na ndritin rrugën tonë, na ndihmojnë të bëjmë për çdo gjë interpretime të drejta.

Neve, nxënësve të tyre, na bie barra dhe detyra të veprojmë, të mendojmë dhe të analizojmë ngjarjet brenda dhe jashtë Partisë, duke pasur si busull të pagabueshme veprimet, mendimet dhe analizat e tyre. Vetëm duke ecur nën këtë shembull, çdo parti do të mund të nxjerrë konkluzione të drejta marksiste-leniniste që t'i shërbejnë asaj dhe popullit të vet,

por njëkohësisht t'u shërbejnë edhe partive dhe popujve të tjerë.

Në kohën e Leninit dhe të Stalinit, kur vepronte Kominterni dhe Partia Bolshevike deri në vdekjen e Stalinit, lëvizja komuniste botërore kishte një far të ndritshëm marksist, një shembull, një edukues, frymëzues dhe një ndihmës kolosal për revolucionarët dhe për partitë e reja komuniste që po krijoheshin. Kapitalizmi, borgjezia, feudalët dhe partitë e tyre vunë në lëvizje çdo gjë, që te mjetet e shumta të propagandës, që flisnin për gabimet e Kominternit, e deri te mjetet e luftës grabitqare për t'i luftuar Kominternin, Partinë Bolshevike, idetë komuniste, te të cilat ata shihnin armiqtë e tyre të vendosur.

A mund të ketë bërë gabime Kominterni në veprimet e veta revolucionare, në analizat, në interpretimet dhe në udhëzimet që ka dhënë? Me sa dimë jo, sa ishte Lenini gjallë, megjithëse në Komintern kishte dhe tradhtarë si Zinovievi, Kamenievi, Radeku e të tjerë, të cilët e treguan veten si të tillë edhe në kohën e Leninit, edhe në kohën e Stalinit. Po, pas vdekjes së Leninit dhe në kohën e Stalinit e të Dimitrovit, a ka bërë gabime Kominterni? Gabime parimore, strategjike, aq sa di, sa kam studiuar unë, jo. Gabime taktike mund të jenë bërë dhe arsyeja e tyre, në qoftë se janë bërë, duhet gjetur në interpretimin e ngjarjeve botërore ku vepronin konkretisht partitë e reja komuniste të porsaformuara. Këto parti pa eksperiencë të madhe revolucionare e pa kuadro me stazh si udhëheqës revolucionarë, të cilat e kishin të vështirë të mbanin lidhje të rregullta me Kominternin,

sepse vepronin në largësi nga Moska e në ilegalitet të rëndë, nuk ishin në gjendje sa duhet të përgjithësonin dhe të raportonin realisht gjendjen brenda partive dhe vendeve të tyre. Në këto kushte edhe konkluzionet e Kominternit që u dërgoheshin, mund të kishin dobësi taktike, por me siguri edhe interpretoheshin e zbatoheshin me gabime. Nga ana tjetër, njerëzit që dërgonte Kominterni në partitë e ndryshme, disa herë, dhe këtë e ka vërtetuar koha dhe lufta, nuk kanë qenë të qartë. Në këtë diskutim nuk kam ndërmend të ndalem te ky problem i madh dhe i gjerë, se kjo do të kërkonte një përgatitje e studim të veçantë, por e përmenda për dy çështje që do të trajtoj më poshtë:

1. Ne duhet të luftojmë dhe të demaskojmë me forcë të madhe revizionistët modernë, të cilët, duke sulmuar Stalinin, sulmojnë Leninin, Kominternin, PK (b) të BS, marksizëm-leninizmin në tërësi.

2. Revizionistët sovjetikë, megjithëse e luftojnë Kominternin dhe Leninin, për të mos folur për Stalinin, duan të zëvendësojnë në arenën e komunizmit ndërkombëtar Leninin dhe Kominternin. Ata bëjnë çmos që të arrijnë të vihen në krye të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, ta drejtojnë e ta nënshtrojnë atë nën ligjet e tyre antimarksiste, imperialiste.

Partive motra marksiste-leniniste të vjetra dhe atyre që janë formuar rishtas, ose atyre që do të formohen më vonë, u bie barra dhe e kanë për detyrë të parë, tani që nuk rron as Lenini, as Stalini, as Kominterni, duke u bazuar fort në veprat dhe në mësimet e tyre të pavdekshme, të mendojnë, të ve-

projnë, të luftojnë të bazuar kurdoherë në marksizëm-leninizmin dhe të arrijnë në një formë organizimi dhe në një unitet mendimi e veprimi marksist-leninist revolucionar, në platformën ndërkombëtare.

Çdo parti ka meritat dhe gabimet e saj. Marksizëm-leninizmi na mëson që të nxjerrim mësimë nga eksperiencia pozitive dhe negative e të gjitha partive dhe çdo gjë ta shohim në prizmin e teorisë sonë, as të nënvleftësohen e të fshihen meritat e partive të tjera, as të ngrihen e të vierësohen jo drejt meritat e partisë tënde.

Çështja e marrjes së pushtetit me dhunë nga ana e proletariatit është çështja kryesore e revolucionit, dhe, pasi të merret nga duart e borgjezisë, ai duhet të ruhet.

Eksperiencia sovjetike vërtetoi se pushteti u mor në Bashkimin Sovjetik, por nuk u ruajt, përkundrazi, u rimor nga borgjezia revizioniste moderne.

Eksperiencia shqiptare vërtetoi se ai u mor në Shqipëri dhe u ruajt e u forcua. As imperialistët, as reaksioni, as revizionistët nuk mundën ta rimerrnin.

Çështja e krijimit dhe e kalitjes së një partie të vërtetë marksiste-leniniste që do të udhëheqë revolucionin dhe ndërtimin e socializmit në fitore, është një çështje nga më të rëndësishmet. Në rast se nuk ndiqen që në fillim, me besnikëri, me konsekuencë parimet themelore marksiste-leniniste mbi partinë dhe të kaliten këto gjatë revolucionit e të ndërtimit të socializmit, atëherë as revolucionin, as ndërtimi i socializmit nuk do të kenë sukses. Në bazë të këtyre parimeve janë mësimet e Marksit, të Engelsit, të Leninit, të Sta-

linit dhe të Partisë Bolshevike në fazën e parë të saj. Kush nuk i zbaton këto me besnikëri dhe me konsekuencë, kush i harron ose i errëson dhe i zëvendëson me parime gjoja të reja, ai devijon, në mos sot, nesër, siç ngjau në Bashkimin Sovjetik, siç ngjau në Kinë dhe siç mund të ngjasë edhe në partitë e tjera.

Në Partinë e Punës të Shqipërisë nuk ngjau kjo dhe e gjithë merita për këtë i përket vetë asaj, që i ruan dhe i kalit parimet e vërteta marksiste-leniniste të partisë së proletariatit.

Çështja e ndërtimit të socializmit në kushtet e çdo vendi, ku proletariati ka marrë fuqinë dhe ka vendosur diktaturën e tij, është çështje nga më të rëndësishmet, pas marrjes së pushtetit dhe vendosjes së diktaturës së proletariatit. Edhe për këtë, në bazë të punës sonë, në vija të përgjithshme, duhet të jetë eksperiencia leniniste staliniane e Partisë Bolshevike deri në vdekjen e Stalinit. Them në vija të përgjithshme për dy arsye: e para, se në këtë eksperiencë mund të jenë vërtetuar edhe gabime, prandaj duhet vlerësuar me sy kritik, dhe e dyta, se çdo parti ka për detyrë të veprojë në konditat konkrete të vendit të vet. Kush nuk i zbaton si duhet dhe me konsekuencë parimet e ndërtimit të socializmit të kohës së Leninit dhe të Stalinit, duke mbajtur parasys konditat e vendit dhe duke i pasuruar ato me eksperiencën e fituar, ai nuk do të ketë sukses në ndërtimin e socializmit dhe do t'i shkaktojë shumë këqarje, qedere dhe rreziqe vendit të tij socialist.

Meqenëse në Bashkimin Sovjetik borgjezia revisioniste mori fuqinë, ekziston një tendencë antimar-

ksiste dhe deviacioniste shumë e rrezikshme dhe e pa-deklaruar hapur, se «s'kemi çka mësojmë tani nga Partia Bolshevike e Leninit dhe e Stalinit». Ata që mendojnë kështu, nuk mendojnë drejt. Partitë marksiste-leniniste kanë gjithsecila vendin e vet, por vepra e Marksit, e Engelsit, e Leninit dhe e Stalinit nuk mund të zëvendësohet. Veprimtaria e Partisë Bolshevike në kohën e Leninit dhe të Stalinit as nuk mund të zëvendësohet, as nuk mund të errësohet nga veprimtaria e partive të tjera. Kush e tenton një gjë të tillë, ai devijon nga parimet marksiste-leniniste.

Përveç kësaj tendence antimarksiste, e cila ka prirje të nënvleftësojë rolin e madh vendimtar, bazal të Partisë Bolshevike të Lenin-Stalinit në çështjet që shtrova më lart, ekziston edhe një tendencë tjetër, natyrisht jo e hapët, se «vepra e PPSH e mirë është, por kjo është një parti e vogël, e një vendi të vogël» etj., etj. Edhe kjo është një tezë antimarksiste. Marksizëm-leninizmi nuk njih parti të madhe apo parti të vogël. Kjo tezë është e njohur, por ka që nuk e besojnë sa duhet dhe nuk arrijnë të shohin e të kuptojnë vërtetësinë e madhe të saj në praktikë.

Jeta vërtetoi se pikërisht një parti e vogël në numër, si Partia jonë, e një vendi të vogël, mundi të marrë pushtetin, ta ruajë, ta kalitë atë dhe të ndërtojë me sukses socializmin. Si u bë një mrekulli e tillë? A ra kjo mrekulli nga qielli? A nuk e sulmuan dhe e sulmojnë PPSH dhe Republikën Popullore të Shqipërisë nga të katër anët? Dhe çfarë armiqsh dinakë e të fuqishëm! Pse nuk u vërtetuan në PPSH dhe në Republikën Popullore të Shqipërisë gjithë ato gjëra

që ngjanë në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera? Kjo nuk është e rastit dhe këtu qëndron merito e madhe e Partisë sonë. Shembulli i saj duhet të bëjë të reflektojë çdo marksist-leninist, çdo parti marksiste-leniniste. Kjo eksperiencë e Partisë sonë duhet të studiohet nga të gjithë, jo se kështu na pëlqen neve, jo se ne e mbivlerësojmë nga pozita të shtrembra, por fakt historik është se PPSH, që ndjek me besnikëri marksizëm-leninizmin, që zbaton dhe zhvillon drejt teorinë marksiste-leniniste, vërtetoi për gjithë botën, për të gjithë komunistët, se marksizëm-leninizmi është i pamposhtur, se ai del fitimtar mbi çdo armik, se ai kapërcen çdo situatë të rëndë, të tmerrshme, të koklavitur. Shembulli i PPSH, parti e vogël, por e çeliktë, i vërtetoi katërcipërisht të gjitha këto të vërteta të mëdha.

Asgjë nuk mund të qëndrojë në këmbë në rast se nuk vihet në baza të shëndosha marksiste-leniniste dhe, po të vihet në këto baza, atë nuk e luan topi.

Çdo marksist-leninist duhet të përfitojë nga eksperiencia pozitive e çdo partie marksiste-leniniste, por duhet të mësojë edhe nga gabimet e tyre, që të mos bjerë vetë në ato gabime.

Si merret pushteti nga duart e borgjezisë kapitaliste, si vendoset diktatura e proletariatit nën udhëheqjen e së cilës ndërtohet socializmi, marksistë-leninistët dhe masat revolucionare duhet të mësojnë nga Partia Bolshevike e Leninit dhe e Stalinit, pse ajo ka qenë e para dhe baza.

Si u mbrojt, si u ruajt dhe si u kalit diktatura e proletariatit përballë armiqve dhe kreu e kryen

me sukses ndërtimin e socializmit, marksistë-leninistët dhe masat revolucionare kanë se ç'të mësojnë dhe të marrin eksperiencë të pasur dhe të gjallë, nga Partia e Punës e Shqipërisë.

Si borgjezia e re, revizionistët modernë rrëmbyen pushtetin nga duart e proletariatit dhe të partisë së tij, për të bërë transformimin e vendeve të tyre socialiste në vende kapitaliste, marksistë-leninistët dhe masat revolucionare le ta studiojnë në tradhtinë e revizionistëve sovjetikë dhe të revizionistëve të tjerë modernë.

Studimi në tërësi dhe në veçanti i eksperiencës krijon mundësinë e vërtetë dhe më të plotë për pajisjen e marksistë-leninistëve me eksperiencë revolucionare, të bazuar në teorinë tonë marksiste-leniniste, që na udhëheq e na sqaron çdo gjë. Këtij studimi, natyrisht, i shtohet edhe eksperiencia e fituar nga të gjitha partitë e tjera marksiste-leniniste që luftojnë, por që nuk kanë marrë akoma pushtetin.

Të gjitha partitë komuniste dhe punëtoresh kanë historinë e tyre të krijimit, të rritjes dhe të zhvillimit, kanë eksperiencën e tyre me fitoret dhe dështimet, me të mirat, me gabimet dhe devijimet. Historia e secilës parti është një pasuri e madhe për vetë atë, por është edhe e përbashkët njëkohësisht, prandaj të gjithë duhet të krijojmë mundësitë që të përfitojmë nga kjo pasuri e përbashkët, pse kemi një qëllim të përbashkët, të madh, triumfin e revolucionit botëror, vendosjen e socializmit dhe ndërtimin e komunizmit në shkallë botërore, kemi gjithashtu një armik të egër e të përbashkët imperializmin, kapitalizmin, borgje-

zinë dhe partitë e ndryshme të saj, borgjezinë e re revizioniste moderne dhe partitë e saj.

Që të përfitojmë si duhet është e nevojshme të bëhen përgjithësime. Veprat e Leninit dhe të Stalinit, dokumentet kryesore bazë të udhëheqjes së Partisë Bolshevike të kohës së tyre janë një thesar i madh për marksistë-leninistët e gjithë botës. Ato pasqyrojnë një eksperiencë të madhe e të paraqitur në forma shumë të përshtatshme, së cilës mund t'i referohesh me lehtësi dhe të përfitosh. Edhe partitë e tjera marksiste-leniniste kanë bërë përgjithësime, por të gjitha nuk kanë ndjekur metodën që ka ndjekur Partia Bolshevike e Lenin-Stalinit deri në vdekjen e Stalinit. Mund të ndiqen edhe forma e metoda të tjera për ta dokumentuar veprimtarinë e partisë, por kurdoherë duhet të ruhet vërtetësia, objektiviteti, thjeshtësia dhe saktësia në pasqyrimin e ngjarjeve dhe të problemeve që ka zgjidhur partia. Kur në dokumentet e në materialet bazë të partisë nuk paraqitet gjendja në mënyrë objektive, marksiste-leniniste, do të thotë se tek ajo parti veprojnë disa shkaqe. Përveç mungesës së zotësisë e të praktikës, që janë të natyrshme për partitë e reja, të cilave u mungojnë kuadrot me eksperiencë, ndonjëherë, dhe kjo është më e rrezikshmja, influencojnë negativisht ekzistenca në një parti e devijimeve teorike, e rrymave të ndryshme, mungesa e unitetit marksist-leninist të mendimit e të veprimit dhe të gjitha këto gjejnë vend edhe në dokumentet e materialet e ndryshme. Por edhe kur këto devijime në vijë korrigjohen në jetë, në materiale duhet të paraqiten në mënyrë kritike, ku studiuesi të mund të shohë pro-

cesin e zhvillimit dialektik të një partie motër, të mësojë për sukseset dhe për gabimet e saj, të shohë qartë pse u arritën këto suksese, pse u shkaktuan këto gabime dhe si u korigjuan, të shohë se sukseset dhe gabimet u vërtetuan në një situatë objektive të partisë, të vendit, të koniunkturave politiko-ekonomike të brendshme apo ndërkombëtare.

Shumë parti, duke qenë modeste dhe pa pretendime, shohin vetëm anën kryesore, që vendimet, masat, analizat të studiohen, të kuptohen dhe të zbatohen nga anëtarët e tyre, të cilët mund të mos kenë edhe shumë nevojë për t'u paraqitur ambientin ku ata rrojnë dhe luftojnë, por harrojnë atë që nuk është më pak kryesore nga e para, çështjen që nga eksperiencia e tyre, qoftë dhe modeste, duan të mësojnë e të përfitojnë edhe anëtarët e partive të tjera. Këtu qëndron universaliteti i doktrinës sonë marksiste-leniniste, këtu qëndron dhe vërtetohet ajo që doktrina jonë nuk është dogmë. Pra, kur themi se doktrina jonë nuk është dogmë, ne duhet ta pasurojmë atë, ta mbajmë kurdoherë të gjallë dhe revolucionare, ta zbatojmë në mënyrë krijuese, drejt dhe korrekt, ta bëjmë universale, ndërkombëtare jo vetëm në kuptimin që ajo të udhëheqë partitë marksiste-leniniste në revolucion e në komunizëm, por ta bëjmë atë të njohur për të gjithë me zhvillimet e reja, me pasurinë e re që fitohet në luftëra revolucionare.

Partia Bolshevike e Lenin-Stalinit e ka bërë një gjë të tillë në mënyrë të lavdërueshme, derisa vdiq Stalini. Pas kësaj kohe çdo gjë atje u errësua, kështu që partitë marksiste-leniniste dhe revolucionarët e bo-

tës nuk kanë çfarë të mësojnë nga PK e BS e kohës pas vdekjes së Stalinit, veçse anët negative, si u mbyt Partia Bolshevike nga revizionizmi dhe nga kundërrivolucioni, si u zhvillua procesi i tradhtisë së revizionistëve hrushovianë, të cilët e shndërruan Partinë Bolshevike në një parti borgjeze revizioniste dhe vendin socialist në një vend kapitalist.

Por pikërisht këtë gjë, shkaqet e vërteta që e ndihmuan, i përgatitën terrenin lindjes dhe zhvillimit të revizionizmit, format dhe metodat e tij të luftës dhe të veprimit, ne duhet t'i studiojmë thellë, pse kjo është lufta kryesore që partitë marksiste-leniniste duhet të zhvillojnë në gjirin e tyre për të mbrojtur teorinë tonë marksiste-leniniste, për t'i ruajtur të pastra, revolucionare, marksiste-leniniste partitë tona, për të ndërtuar me sukses socializmin dhe për të zhvilluar po me sukses revolucionin kudo në botë, për të udhëhequr me sukses luftërat nacionalçlirimtare të popujve, për të thyer përfundimisht imperializmin, kapitalizmin, borgjezinë, reaksionin, revizionizmin modern.

Revizionistët modernë janë një pjesë e armiqve të klasës punëtore brenda në gjirin e klasës dhe në partinë e saj, janë socialdemokratët e rinj në aleancë të ngushtë me të vjetrit, janë socialshovinistët, socialnationalistët, trockistët dhe anarkistët e rinj në aleancë të ngushtë me të vjetrit, por këtë herë ata luftojnë brenda në partitë komuniste dhe punëtore, me forma të reja, me maska dhe me një demagogji të re. Këta armiq të klasës, të komunizmit dhe të marksizëm-leninizmit duhen luftuar dhe shtypur pa mëshirë. Atyre du-

het t'u zbulosh të gjitha rrënjët, t'i demaskosh plotësisht, t'i shkulësh dhe t'i flakësh sa më parë jashtë partive marksiste-leniniste, t'i hedhësh në koshin e plehut borgjez nga ku kanë dalë, t'i djegësh të gjithë në zjarrin e madh të revolucionit, ashtu siç bënë Marksi dhe Lenini. Revizionizmi modern nuk ishte një lindje spontane, e befasishme, e panjohur dhe e pashfaqur më parë në forma të ndryshme. Në rast se mendohet kështu, mendohet gabim, në mënyrë naive dhe në injorancë të plotë ndaj marksizëm-leninizmit dhe luftërave të revolucionarëve dhe të komunistëve. Çdo gjë ishte studiuar e parashikuar nga Marksi, Engelsi, Lenini dhe Stalini, ishte pjesë përbërëse e luftës klasore, e komunizmit kundër kapitalizmit, imperializmit, reformizmit, trockizmit etj., çdo gjë ishte parashikuar në teori dhe në praktikë nga mësuesit tanë të mëdhenj. Prandaj kanë rëndësi dokumentet e lëvizjes revolucionare, veprat që na kanë lënë Marksi, Engelsi, Lenini dhe Stalini, pse në to gjejmë doktrinën tonë të mendimit dhe të veprimit për të ndërtuar një parti me të vërtetë revolucionare, për ta mbajtur atë të pastër, për ta bërë atë një parti të vërtetë, pararojë të klasës punëtore dhe të revolucionit, për të zhvilluar luftën e klasave në të gjitha frontet kundër armiqve të klasës, për t'u zbuluar këtyre rrënjët dhe për t'i mbytur që në vezë.

Rrymat e ndryshme borgjeze antimarksiste luftonin partitë e klasës punëtore nga brenda dhe nga jashtë. Marksistët revolucionarë zhvilluan vazhdimisht një luftë të ashpër e të shtrënguar nën udhëheqjen e Marksit, Engelsit, Leninit, Stalinit, Internacionales së

Parë dhe të Tretë dhe u arrit ndarja definitive, u krijuan partitë e reja marksiste-leniniste, të cilat u grupuan rreth Partisë Bolshevike. Në periudhën pas vdekjes së Stalinit, në shumë parti marksiste-leniniste u shfaq dhe u zhvillua revizionizmi modern, ky armik i marksizëm-leninizmit, i socializmit dhe i komunizmit. Revizionizmi u bë i rrezikshëm, pse ai doli dhe mori forcë në PK të BS, në partinë më të madhe dhe në vendin e parë e më të fuqishëm socialist. Revizionizmi modern titist ishte shfaqja e parë e këtij armiku të maskuar në një parti që kishte marrë fuqinë në shtet, pas një lufte të armatosur. Revizionizmi modern u shfaq në shumë parti komuniste dhe punëtore, që janë në fuqi dhe që s'janë në fuqi. Pra, procesi i shfaqjes së revizionizmit modern në këto parti dhe në këto shtete nuk mund të konsiderohet as një lindje e çastit, as një proces spontan. Arsyet duhen kërkuar në shkallën e zbatimit dhe të zhvillimit të parimeve marksiste-leniniste të partisë. Për të parë nëse këto parime janë zbatuar e zhvilluar në mënyrë revolucionare, dhe me korrektësi ose jo, duhet të shohim ku janë mbështetur veprimet bazë organizative, si është zhvilluar struktura e partisë, e shtetit socialist dhe e gjithë superstrukturës, si është zhvilluar lufta e klasave, është vënë në plan të parë politika proletare apo jo, si është luftuar kundër burokratizmit në parti e në shtet, sa u është qëndruar korrekt normave të zhvillimit materialist, dialektik dhe historik, natyrisht duke ia përshtatur situatave konkrete të çdo vendi dhe të çdo partie. Por këto situata konkrete, në rast se nuk analizohen në dritën e teorisë marksiste-leniniste dhe në rast se vendimet që me-

rrën në përshtatje me këto situata nuk u përgjigjen normave teoriko-politiko-organizative të marksizëm-leninizmit, atëherë rrjedhimisht do të bëhen gabime.

Pra, lufta kundër revizionizmit modern duhet të ndërmerret në dy fronte njëkohësisht, në planin ndërkombëtar dhe në planin e brendshëm të çdo partie, qoftë kjo në pushtet ose jo. Këndeje del çështja se kësaj rryme armiqësore të re, që i ka rrënjët dhe lidhjet me ato të vjetrat, duhet nga çdo parti marksiste-leniniste t'i bëhet një analizë shkencore në ato drejtime që thashë më lart që të mund të zhvillohet kundër kësaj rryme dhe motrave të saj të vjetra një luftë frontale e rreptë dhe e suksesshme. Këtë analizë, pra, mund ta bëjnë dhe duhet ta bëjnë vetëm partitë komuniste dhe punëtore që qëndrojnë në pozita të forta marksiste-leniniste, që janë ose nuk janë në fuqi, duhet ta bëjnë partitë e reja dhe grupet revolucionare që krijohen rihstas në vendet ku revizionistët janë në fuqi ose në vendet kapitaliste.

Këto analiza të domosdoshme duhet të bëhen nën shembullin e analizave që u kanë bërë ngjarjeve, rrymave e pikëpamjeve të ndryshme Marks, Engelsi, Lenini dhe Stalini. Analizat marksiste-leniniste do të jenë mbështetje e sigurt për të ndërtuar drejt luftën, strategjinë dhe taktikën revolucionare.

Çdo partie marksiste-leniniste, pra, në fuqi ose jo, i bie barra dhe detyra e domosdoshme edhe të zhvillojë luftën kundër revizionizmit modern në planin e brendshëm dhe ndërkombëtar, por edhe të bëjë studime historiko-teorike, të nxjerrë konkluzione teoriko-politike dhe të gjejë format e mjetet që këto anali-

liza të bëhen pronë, ushqim, eksperiencë e të gjitha partive marksiste-leniniste dhe e revolucionarëve në botë.

Revolucionarëve marksistë-leninistë të të gjithë botës, partive marksiste-leniniste u bie detyra të demaskojnë dhe të luftojnë pa mëshirë, me të gjitha mundësitë e mjetet, revizionizmin sovjetik dhe titist. Dikush mund të ketë mundësi më shumë e dikush më pak, por forcat luftarake duhet të koordinohen si në një betejë të madhe. Në këtë betejë duhet ta njohësh armikun, por pa mbivlerësuar ose nënvleftësuar as forcën, as dobësitë e tij.

Sigurisht partive marksiste-leniniste u bie barra të bëjnë atë analizë që thashë më sipër, në radhë të parë për revizionizmin sovjetik. Taktikat që kanë përdorur revizionistët sovjetikë për të marrë fuqinë pas vdekjes së Stalinit dhe zhvillimi i kësaj rryme armiqësore në Bashkimin Sovjetik janë pak a shumë të njohura prej nesh, por jo plotësisht, pse shumë gjëra qëndrojnë në errësirë. Janë po ashtu të njohura në vijën teorike bazat, arsyet, gabimet etj., që e lejuan daljen e revizionizmit modern në Bashkimin Sovjetik. Analizat tona në këto drejtime, në përgjithësi, nuk janë të gabuara, sido që, me gjithë përpjekjet e mira, nuk janë të mjaftueshme. Sa kohë shkon, sa eksperiencë fitohet dhe sa më shumë vërtetohen të thënat dhe të dhënat tona, aq më mirë ne duhet të mendojmë të nxjerrim konkluzione teoriko-organizative dhe t'i formulojmë këto në mënyrë të përshtatshme për të gjithë. Të mos mendojmë se këto gjëra të gjithë i kanë studiuar dhe i dinë, ose i kemi studiuar një herë dhe

çdo gjë është e njohur. Sa më shumë materiale teorike të dalin, aq më i zorshëm paraqitet studimi, prandaj eksperiencia e fituar nuk ka fund dhe kjo duhet të pasurohet medoemos.

Por për nevojat e luftës kundër revizionizmit sovjetik, si dhe për t'i prerë rrugën çdo rreziku që mund të të çojë në pozitë ku ka shkuar ai dhe ku dëshiron të na tërheqë edhe ne, ka rëndësi që të studiojmë sidomos çështjen se si e qysh punuan dhe u organizuan elementët revizionistë brenda dhe jashtë partisë. Kjo analizë ka një rëndësi të madhe, por për ne është e zorshme ta bëjmë si duhet, se na mungon dokumentacioni i vërtetë zyrtar i PK të BS, domethënë ai që nuk është publikuar gjatë viteve të fundit të jetës të Stalinit. Këtë duhet ta bëjnë revolucionarët bolshevikë dhe partia e tyre e vërtetë marksiste-leniniste kur të riformohet. Të nxjerrësh një konkluzion *a priori* se Stalini ka gabuar prandaj ngjanë këto, siç po bëjnë disa që e heqin veten marksistë-leninistë, kjo, sipas mendimit tim, nuk është reale, as marksiste. Pa analizuar gjithçka me hollësi, nuk mund të thuash se partia tok me Stalinin nuk kanë qenë vigjilentë, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore. Që të bëhet kjo analizë me ekzaktësi se ku dhe në çfarë Stalini dhe partia nuk kanë qenë vigjilentë, në ç'degë dhe në ç'drejtime, duhet të mbështetemi në zhvillimin konkret, real të gjërave. Natyrisht jeta dhe lufta e PK (b) të BS është shumë e gjerë dhe e pasur, materiali është i shumtë dhe i zorshëm të shfrytëzohet si duhet, por fakt është se armiqtë revizionistë nuk mundën dhe nuk do të mundin të gjejnë argumente të Veprat e

Stalinit për të vërtetuar tezën e tyre se Stalini ka gabuar. Stalini nuk ka bërë gabime parimore. Ai i ka qëndruar shumë besnik dhe e ka zhvilluar më tej marksizëm-leninizmin. Po, si i zbatuan në jetë udhëzimet e Stalinit kuadrot, aparatet e partisë dhe të shtetit? Kjo është një çështje shumë e rëndësishme dhe pikërisht këtu duhet të kërkojmë ato arsye të vërteta që bënë të ngrejë krye revizionizmi pas vdekjes së Stalinit. Në punën e tij, s'ka dyshim, duhet të jenë vërtetuar edhe gabime, por çfarë, ku, në ç'rrethana, a i ka korrigjuar dhe si i ka korrigjuar aparati, kjo është një çështje prapë e rëndësishme, që kërkon një gjykim të thellë e të argumentuar, se po ta marrësh lehtë, duke u bazuar në faktin e hidhur që në BS revizionizmi mori fuqinë, dhe për këtë të bësh përgjegjës Stalinin, mund të rrëshqasësh në subjektivizëm, në konkluzione të njëanshme, mund të rrëshqasësh në terrenin e revizionistëve sovjetikë. Përgjegjësia për lindjen e revizionizmit modern në Bashkimin Sovjetik nuk mund t'i ngarkohet as marksizëm-leninizmit si teori dhe as Stalinit si udhëheqës.

Studimi i thellë i fakteve, duke u bazuar me besnikëri në teorinë marksiste-leniniste, është një domosdoshmëri e madhe për lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Të gjithë ne duhet të kontribuojmë për këtë, pse kjo na ndihmon pa masë në luftën kundër armikut revizionist dhe padronit të tij, imperializmit botëror.

Si për çështjen e revizionizmit sovjetik, ashtu dhe për atë të titizmit, Partia jonë, përveç të tjerave, në luftën e saj të papërkulur kundër tyre, ka dhënë një kontribut teorik me studimet që ka bërë dhe me kon-

kluzionet teorike e politike që ka nxjerrë nga lufta e saj revolucionare. Natyrisht, këto nuk duhet t'i konsiderojmë të mjaftueshme, se e kemi për detyrë të përhershme t'i pasurojmë. Duke zbatuar drejt marksizëm-leninizmin, fakt është se Partia jonë i dërrmoi kurdoherë tentativat e armiqve të saj, të brendshëm dhe të jashtëm. Këtë e vërteton fakti historik që revizionizmi modern nuk mundi të zinte fole dhe të vepronte në Partinë tonë. Dokumentet e Partisë sonë e vërtetojnë këtë zhvillim të drejtë dhe çdo gjë është vënë në dukje, është analizuar në përgjithësi drejt, pavarësisht nga ndonjë dobësi që rrjedh edhe nga mungesa e eksperiencës sonë. Por neve na vihet si detyrë që akoma më mirë të vëmë në dukje atë që përse te ne nuk mundi të lindë revizionizmi, cilat ishin arsyet, format, metodat, masat, me një fjalë vija e Partisë, e cila bëri që Partia, shteti ynë i diktaturës së proletariatit dhe ndërtimi i socializmit nuk u prekën nga kjo sëmundje. Kjo do të thotë edhe të vërtetosh atë pse partitë e tjera u sëmurën, edhe të japësh ilaçin që të shëron nga kjo sëmundje.

Teksti i Historisë së PPSH, që po përgatitet të dalë, është një dokument i madh, veçanërisht për këtë problem. Ne kemi shumë dokumente teoriko-politike të tjera për këtë problem, por e mira do të jetë që shokët të ngarkohen që për këto dokumente të vazhdohet të punohet, të përmirësohen, të përforcohen me eksperiencën e fituar dhe të paraqiten me forma të ndryshme, të përshtatshme dhe të shfrytëzueshme edhe nga shokët e partive të tjera. Këtë detyrë duhet ta kemi kurdoherë parasysh, të punojmë, të realizojmë,

pse janë një metodë dhe një mjet lufte nga më të rëndësishmit kundër revizionizmit modern.

Eksperiencën pozitive dhe negative të PK të Kinës nuk e njohim sa duhet, jo vetëm ne, por as partitë e tjera dhe kjo ka qenë një minus për lëvizjen komuniste. Njëpërmjet veprave të Maos, të botuara disa vjet më parë, ne njohim, aq sa është pasqyruar në këto vepra, luftën e partisë e të popullit kinez për çlirimin e Kinës nga okupatorët dhe nga borgjezia, por komunizmit ndërkombëtar i mungojnë materialet për një periudhë të gjatë pas çlirimit, që kur partia erdhi në fuqi, mungon manuali shkencor i historisë së PKK, mungojnë analizat objektive marksiste-leniniste të deklaruara publikisht të eksperiencës së zhvillimit të brendshëm ideologjik, politik dhe organizativ të partisë, analizat për luftën e klasave, për luftën fraksioniste, për masat dhe zgjidhjet që u kanë dhënë këtyre. Materiale të pasçlirimit, sidomos artikuj dhe vepra letrare, ka, por këto janë të diskutueshme, s'janë në rrugën e drejtë, pse për një kohë të gjatë revizionizmi apo majtizmi kishin bërë çerdhe në PK të Kinës.

Te PK (b) e BS e kohës së Leninit dhe të Stalinit ne gjejmë në një përqindje të madhe analiza të qarta dhe shkencore, kurse te PK e Kinës nuk i gjejmë. Parimet kryesore të PKK i kemi të njohura deri në njëfarë shkalle, por kjo njohje nuk është e plotë; kemi vendimet e tyre, por jo analizat shkencore. Mundet që kjo ka ardhur nga një luftë e vazhdueshme që zhvillonin midis tyre krahu i djathtë dhe krahu i majtë në PK të Kinës. Megjithëse krahu i majtë go-

ditej dhe merreshin masa kundër tij, ai qëndronte në fakt i paprekur dhe i shmangte këto analiza. Natyrisht, është në interes të vetë PK të Kinës dhe të komunizmit ndërkombëtar, që ky boshllëk i madh që ekziston në këto çështje të zhduket dhe të vihet në vend në rrugë të drejtë.

Çfarë të bëhet?

Përveç ndihmës që i takon PK të Kinës të japë në luftën kundër revizionizmit modern, njëkohësisht, ajo tani të ndihmojë në mënyrë objektive dhe në prizmin e marksizëm-leninizmit e në frymën e internacionalizmit proletar që, duke demaskuar revizionizmin modern sovjetik, të analizojë në mënyrat që thashë më lart edhe arsyet e lindjes së tij, edhe natyrën, edhe mjetet që ai përdor për të luftuar marksizëm-leninizmin dhe socializmin.

Rishikimi i të gjitha dokumenteve aktuale kineze për këtë çështje bëhet i domosdoshëm, pse ato kanë edhe njolla revizioniste. Një rishikim i tillë dhe një studim i mëtejshëm i kësaj çështjeje do të jetë një kontribut i madh dhe duhet të bëhet, në radhë të parë, nga PKK.

Por që të bëhet drejt analiza e shkaqeve që sollën revizionizmin modern sovjetik në fuqi, duhet të bëhet një analizë e thellë e revizionizmit që nisi revanin për të marrë fuqinë brenda në Partinë Komuniste të Kinës. Ç'eksperiencë e madhe është për marksistë-leninistët në rast se bëhet, dhe duhet medoemos të bëhet, kjo analizë ! Kjo, kuptohet, duhet të jetë një analizë shkencore dhe jo propagandë e mbushur me slogane e me fjalë bombastike gazetareske, pa përgjegjësi.

Çdo gjë duhet të mendohet që t'i shërbejë çështjes së brendshme, por njëkohësisht edhe lëvizjes revolucionare ndërkombëtare.

Sipas mendimit tim, në çështjen e eksperiencës kineze janë tri etapa: etapa e parë, lufta antiimperialiste nacionalçlirimtare; etapa e dytë, marrja e pushtetit, vendosja e diktaturës së proletariatit, puna për ndërtimin e socializmit dhe ngritja e zhvillimi i revizionizmit modern; etapa e tretë: Revolucioni Kulturor, riorganizimi i partisë dhe rektifikimi i strukturave.

Të tria këto etapa duhet të rishikohen nga shokët kinezë rrënjësisht e të nxirren konkluzione të rëndësishme teorike, politike dhe organizative që të na ndihmojnë të gjithë. Asgjë artificiale, pa baza të shëndosha teoriko-politike ose të pompuara me zor, nuk mund t'i imponohet gjykimit të shëndoshë marksist-leninist të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Çdo gjë taktike që është e nevojshme për brenda, e kërkuar nga situatat, nuk mund të jetë e nevojshme dhe e pranueshme në platformën ndërkombëtare.

Por si për analizat për PK të BS dhe për partitë e tjera, që ne duhet të bëjmë, për PKK, edhe në këtë drejtim, për periudhën e etapës së dytë dhe të së tretës, Partia jonë, në bazë të fakteve, të dokumenteve zyrtare, duhet dhe kjo vetë të bëjë studime, të nxjerrë eksperiencë, të nxjerrë konkluzione që të ndihmojnë punën e vet, por edhe PKK e partitë e tjera po të jetë nevoja. Kështu bëjnë dhe duhet të bëjnë edhe partitë e tjera marksiste-leniniste për të studiuar eksperiencën e Partisë sonë.

Këto mendime i shënova për t'i diskutuar me shoqët e Sekretariatit të Komitetit Qendror, për të forcuar punën e Partisë në këto drejtime që më duken të rëndësishme.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH që
gjendet të AQP*

KARNAVALET E BUDAPESTIT

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

15 mars 1968

Gjatë muajit shkurt në disa vende organizohen karnavalet. Njerëz të veshur me maska gjithfarëshe, për t'u zbavitur, interpretojnë role nga më të ndryshmet. Organizatorët e karnavaleve nxjerrin fitime të shumta nga këto manifestime. Por historia njeh karnavale e karnavale.

Volteri, mendimtar dhe shkrimtar i dëgjuar francez i shekullit të 18-të, ka shkruar për karnavalet e Venedikut. Në rolin e palaçove shkrimtari ka vënë mbretër të ndryshëm të shkurorëzuar nga fronet dhe tallet me ëndrrat e dëshirat e tyre qesharake. Kjo veper është e njohur në historinë e letërsisë botërore.

Në ditët e sotme bota njohu edhe një lloj tjetër karnavalesh, karnavalet e Budapestit. Pikërisht në muajin shkurt, në javën e karnavaleve, në kryeqytetin hungarez u mbledhën revizionistët modernë, të veshur me maska të ndryshme.

Mbledhja revizioniste e Budapestit u përgatit me shumë mundime nga revizionistët hrushovianë. Qysh

përpara hapjes së saj u dukën shenjat e para se kjo mbledhje nuk do t'i shërbente hegjemonisë aq shumë të dëshiruar të udhëheqësve revizionistë sovjetikë. Të detyruar nga partnerët e tyre, sovjetikët, me shpirt në dhëmbë, në prag të mbledhjes, bënë disa koncesione oportuniste liberale dhe deklaruan botërisht, nëpërmjet një fjalimi të Brezhnjev-it në Leningrad, se Moska nuk është më «qendra udhëheqëse e komunizmit botëror», se uniteti që kërkojnë udhëheqësit sovjetikë bazohet gjoja në idenë e «internacionalizmit proletar», në «luftën kundër imperializmit amerikan» dhe për interesat e përgjithshme të «ndërtimit socialist».

Natyrisht, të gjitha këto i mbulonin me «fletën e fikut» si bartësit e vërtetë të marksizëm-leninizmit, të cilin do ta zbatojnë sipas interpretimit dhe kushteve «specifike» të çdo partie revizioniste. Këto ishin edhe «kushtet» që u vunë revizionistëve sovjetikë për të marrë pjesë në mbledhje, një grup revizionistësh, të cilët e heqin veten si autonomë dhe gjoja si më «revolucionarët» në mes të revizionistëve. Ky grup, bile, duke shpallur vendimin se do të merrte pjesë në mbledhje, paraqiti edhe tezat e veta: asnjë parti nuk duhet të ndërhyjë në punët e brendshme të partive të tjera, asnjë parti nuk ka të drejtë të kritikojë veprimet e partive të tjera, të cilat kanë «plotësisht të drejtë» ta interpretojnë dhe ta zbatojnë si të duan, si t'u vijë për hosh marksizëm-leninizmin.

Këto ide jo vetëm kapërcejnë idenë revizioniste të policentrizmit të Toliatit, por sugjerojnë që çdo parti të bëhet një qendër më vete. Me fjalë të tjera, kjo do të thotë që të lejohen jo më një dhe dy interpretime të

teorisë sonë revolucionare, por me dhjetëra, në mos me qindra. Duket sheshit se ide të tilla kanë për qëllim të sulmohet marksizëm-leninizmi nga të katër anët, që të mbillet një konfuzion i madh ideologjik, të çoroditet lufta politike, ideologjike, ushtarake dhe organizative e popujve, që të diskreditohen sistemi socialist dhe komunizmi.

Pra, qysh para mbledhjes, në kulisa, në parim dhe në praktikë, shtrohej kjo çështje kryesore: A të shkohet në luftë kundër marksizëm-leninizmit duke përdorur metodat klasike dhe nën hegjemoninë e revizionistëve sovjetikë, apo të hidhen poshtë edhe metodat klasike, edhe hegjemonia sovjetike dhe të adoptohen metoda «më të reja, më të ngutshme, më të sigurta», për të shpartalluar e për të shturur plotësisht lëvizjen komuniste? Pikëpamja e fundit përkrahej me forcë nga Titoja, Longoja dhe nga «autonomët». Ajo, siç duket, ishte mjaft tërheqëse edhe për grupe të reja liberale revizionistësh të sapoardhur në fuqi. Partizanët e njërës apo të tjetrës tezë kishin përkrahësit e tyre, të cilët vepruan si matrapazë, në kulisa dhe në skenën e Budapestit, nga 26 shkurti deri më 5 mars, gjatë javës së karnavaleve.

Revizionistët sovjetikë dështuan në synimin e tyre themelor, që mbledhja e Budapestit të merrej me problemin kryesor që i preokupon ata më shumë se çdo gjë tjetër: me mobilizimin e plotë e të bindur të të gjitha partive revizioniste në luftën kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe partive të tjera marksiste-leniniste. Vetëm zgjidhja e këtij problemi mund t'ua hiqte sovjetikëve atë barrë të rëndë që u qëndron mbi

kurriz dhe që përbën shkakun kryesor të thellimit të mëtejshëm të përçarjes në gjirin e frontit revizionist.

Sipas udhëheqësve revizionistë sovjetikë, lufta kundër partive marksiste-leniniste nuk mund të ketë asnjë sukses pa unitetin e gjithë revizionistëve dhe pa hegjemoninë e udhëheqësve sovjetikë për drejtimin e kësaj lufte. Këtë u përpoq të arrinte Hrushovi nëpërmjet mbledhjes së partive komuniste të propozuar nga ai që më 1964 e që dështoi, këtë u përpoqën të arrinin pasardhësit e tij në mbledhjet revizioniste të Moskës të marsit 1965 e të Karlovi-Varit. Ata humbën në të dy drejtimet dhe punët u shkuan gjithnjë keq e më keq. Prandaj, për të dalë nga kjo situatë, klika revizioniste e Moskës luajti në Budapest të gjithë gurët për t'u imponuar të tjerëve mbajtjen sa më parë në Moskë të një mbledhjeje të partive revizioniste, ku ajo shpresonte të merreshin «vendimet» që i ka më shumë në zemër, domethënë koordinimin e luftës së revizionistëve modernë, nën udhëheqjen e sovjetikëve, kundër marksizëm-leninizmit.

Mbledhja e Budapestit, e cila, sipas shpresave të organizatorëve të saj, duhej të bëhej mbledhja e unitetit revizionist, u bë mbledhja e përçarjes, e grindjeve dhe e degjenerimit të mëtejshëm të tyre. Diskutimet në Budapest nxorën në shesh, tanimë botërisht, se jo të gjithë e mendojnë mbledhjen e ardhshme në Moskë ashtu siç e dëshirojnë revizionistët sovjetikë dhe se kundërshtarët e ndryshëm, megjithëse e dhanë pëlqimin, nuk kanë hequr dorë nga qëllimi për të mbrojtur interesat e tyre të ngushtë, për të luftuar udhëheqësit sovjetikë dhe për t'u imponuar të

tjerëve pikëpamjet e tyre. Koha e përgatitjes deri në fund të këtij viti do të vërtetojë përçarje akoma më të thella e më të bujshme. Revizionistët sovjetikë do të hasin në kundërshtime nga më të ndryshmet, pasi revizionistët e tjerë kundërshtarë nuk e duan dhe nuk shpejtohen për një mbledhje të tillë. Për sovjetikët pjesëmarrja e të ashtuquajturave parti të mëdha revizioniste është më se e domosdoshme, megjithëse me fjalë thonë se do ta bëjnë mbledhjen, pavarësisht se kush do të mungojë. Kushdo e kupton se me «partinë» e Guadelupës, me Larbi Buhalin¹, Koli-janisin² ose ndonjë banor tjetër të përhershëm të hoteleve të Moskës nuk mund të venë dot në mbledhjen që dëshirojnë, pasi për ta kjo do të ishte një katastrofë e pandreqshme.

Disa revizionistë, që kanë interesa të kundërt me ata të revizionistëve sovjetikë, kanë objektiva të tjerë, ata duan të intensivikojnë luftën kundër partive marksiste-leniniste me format e me metodat e tyre dhe pa hegjemoninë sovjetike, të forcojnë lidhjet dhe marrëdhëniet me shtetet borgjeze kapitaliste, të arrijnë marrëveshje me socialdemokratët dhe me partitë e tjera borgjeze, të marrin pjesë drejtpërdrejt në qeverisjen e vendit, në rrugën e shfrytëzimit kapitalist etj. Pra-

1 Në atë kohë sekretar i Partisë Komuniste të Algjerisë, shërbëtor i përlurur i N. Hrushovit. Në periudhën kur populli algjerian derdhte gjak për lirinë e atdheut, Buhalia jetonte në Bashkimin Sovjetik, duke e kaluar kohën me zbavitje.

2 Në atë kohë sekretar i parë i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Greqisë.

ndaj këta revizionistë nuk janë për mbledhjen, ashtu siç predikojnë udhëheqësit revizionistë sovjetikë, po për mbledhje pa qëllime të caktuara, gjoja «për të shkëmbyer mendime», për të marrë më mirë vesh ç'mendon njëri dhe tjetri për një problem ose për një tjetër dhe të gjitha këtyre t'u bëhet një publicitet i hapur, gjoja në format «më demokratike».

Këto forma «demokratike» dhe «të hapura» të debateve, për këta revizionistë shprehin në të vërtetë planet konkrete të punës së tyre të përditshme për arritjen e objektivave që përmendëm më lart. Edhe në këto çështje ata duan të afirmojnë zyrtarisht se demokracia borgjeze, «shtypi i lirë dhe i mirinformuar» borgjez përbëjnë qëllimin e përpjekjeve të tyre, janë, si të thuash, stolia e vijës së tyre të «rrugës së veçantë», «demokratike» parlamentare për t'u miqësuar me borgjezinë kapitaliste dhe për të ardhur në pushtet.

Nga ana tjetër, «pavarësia» e këtyre partive nuk u pëlqen aspak revizionistëve sovjetikë, të cilët, duke lënë në mënjane deklaratat hipokrite, të imponuara nga rrethanat, do të bëjnë çdo gjë, do të përdorin çdo presion dhe shantazh për të vënë në fre disidentët. Shantazhet dhe presionet ekonomike, krijimi i turbullirave brenda në partitë dhe në vendet e pabindura, nxitja e rivendikimeve territoriale në ato vende ku ato ekzistojnë etj., janë armët e zakonshme që vë në lëvizje revizionizmi sovjetik për të frikësuar dhe për t'u imponuar të tjerëve pikëpamjet e tij.

Natyrisht, këto armë nuk janë kurdoherë pa efekt, por rezultatet nuk mund të jenë kudo e kurdo në favorin e revizionistëve sovjetikë. Tendenca e përgjith-

shme që vihet re është në disfavorin e tyre, numri i disidentëve dhe i kundërshtarëve të hegjemonisë sovjetike në kampin revizionist vjen gjithnjë duke u rritur. Por, me gjithë dështimet që kanë pësuar e pësojnë, revizionistët sovjetikë do të vazhdojnë t'i përdorin kurdoherë që të mundin këto armë të tyre të preferuara. Në këtë drejtim ata i favorizojnë edhe potenciali i tyre ekonomik, edhe lidhjet e zinxhirët që kanë farkëtuar për satelitët e tyre, edhe potenciali ushtarak që tremb të frikshmit, edhe rrjeti agjenturor që kanë endur në partitë revizioniste dhe në vendet ku ato janë në pushtet.

Revizionistët sovjetikë veprojnë me satelitët dhe me klientët e tyre ashtu siç vepron imperializmi amerikan me satelitët dhe me klientët e vet, që i mban të lidhur me zinxhirë. Ashtu siç veprojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës në OKB kur vënë në lëvizje mekanizmin e votës, ashtu edhe revizionistët sovjetikë në «OKB-në» e tyre, të cilën përpiqen ta quajnë «lëvizje komuniste ndërkombëtare», vënë në lëvizje mekanizmin e votës. Por ashtu siç shkëputen klika kapitaliste nga diktati amerikan, ashtu siç ka nga ata që i hedhin shkelma disa herë imperializmit amerikan, ashtu shkëputen edhe klika revizioniste nga revizionistët sovjetikë. Ka edhe nga ata që, në pamundësi të shkëputen, u hedhin vicka disa herë, ka dhe nga ata, më në fund, që janë rajá të përhershëm.

Një shportë e tillë karavidhesh ishte konferenca karnavaleske e Budapestit. Dhe revizionistët sovjetikë kërkuan të vënë rregull pikërisht atje ku nuk mund të vihet kurrë rregull.

Tani, pas fushatës përgatitore dhe mbledhjes së Budapestit kur tendencat centrifugale, nacionaliste e disidente në grupimet e ndryshme revizioniste u kristalizuan edhe më tepër, rreziqet për revizionistët sovjetikë janë më të shumta dhe më të gjithanshme.

Rreziku kryesor që i preokupon ata më shumë e që u ka hapur një plagë të re të rëndë u vjen nga klikat revizioniste që janë në fuqi. Duhet thënë se tani asnjë prej tyre nuk e do dhe nuk po e duron më gjatë zgjedhën e revizionistëve sovjetikë. Me një mënyrë ose me një tjetër, të gjithë përpiqen ta heqin qafe sa më parë këtë zgjedhë, por duke ruajtur aparenat e «miqësisë» e të «aleancës», aq sa mund të ruhen, dhe duke synuar për të pasur sa më shumë përfitime ekonomike e politike nga koniunktura e krijuar, e cila i detyron revizionistët sovjetikë, të ndodhur nën goditje të gjithanshme dhe me pozita të dobëta, të bëjnë lëshime pas lëshimesh për të qetësuar «fëmijët e pabindur».

Mirëpo duke qenë se tendenca centrifugale është në ngjitje të shpejtë, klikat revizioniste në fuqi nuk paraqesin një front unik e të bashkuar në kundërshtimet ndaj hegjemonisë sovjetike dhe në pretendimet e tyre për «pavarësi» nga ajo. Sot për sot krahun më agresiv, të shkëputurit dhe korodonjësit e hapët të hegjemonisë sovjetike në stanin revizionist, e përfaqësojnë klika e Titos dhe miqtë e saj më të ngushtë. Këta, duke pasur edhe përkrahjen e nxitjen e dukshme të imperializmit amerikan e të borgjezisë së madhe perëndimore, që janë të interesuara për dobësimin e mëtejshëm të pozitave sovjetike në Evropën Lindore dhe për lidhjen e aleancave të vjetra me këto vende,

e sfidojnë hapur udhëheqjen sovjetike dhe i kundërvihen asaj si një pretendent i ri për hegjemoninë, në mos të gjithanshme, të paktën politike e ideologjike, mbi partitë revizioniste të kësaj zone.

Pasues të tjerë të rinj të shembullit të Titos kanë filluar të ecin, edhe ata, në këtë rrugë, por preferojnë të mos i nxitin tani për tani diferencat me revizionistët sovjetikë, pasi kjo do t'u hapte një front të ri, në një kohë kur ata nuk kanë forcuar akoma pozitat e tyre të brendshme.

Klani i Gomulkës është antisovjetik në kulm, po për interesa imediate të koniunkturës, që rrjedhin sidomos nga politika ndaj Gjermanisë, ai qëndron më afër revizionistëve sovjetikë, duke u përpjekur të ruajë autoritetin e një partneri «të barabartë» me ta. Po kështu, gjermanët nuk mund të mos kenë kundërshtime të mëdha me revizionistët sovjetikë dhe me gjithë të tjerët, por çështja e Republikës Demokratike Gjermane në kuadrin e Evropës është në mëshirën e revizionistëve sovjetikë dhe të satelitëve të tyre. Në të tilla ujëra notojnë pak a shumë edhe klikat e tjera revizioniste të Evropës Lindore.

Rreziku i dytë, më pak i mprehtë se i pari, u vjen revizionistëve sovjetikë nga partitë e mëdha legale revizioniste në vendet kapitaliste. Klika e Brezhnjev-it dhe e Kosiginit bën të gjitha përpjekjet dhe përdor të gjitha mjetet për t'i mbajtur ato të lidhura pas vetes dhe për të pasur përkrahjen e tyre. Por edhe në këto parti nuk ka bindje të njëjta rreth çështjes se deri ku duhet shkuar pas revizionistëve sovjetikë, ku duhet të ndahen me ta dhe ku duhen kundërshtuar.

Partia Komuniste Franceze e Valdek Roshesë, për arsye që dihen mirë, është më afër revizionistëve sovjetikë dhe nuk kursehet të vihet në shërbim të tyre diçka më shumë se të tjerat. Ndërkaq, partia revizioniste italiane, që, në krahasim me atë franceze, është si kushëri i varfër pranë sovjetikëve, hedh vicka më tepër, përpiqet të tregohet më «e pavarur», sikur mban një qëndrim të sajën, «të veçantë». Ajo, si të thuash, është partia titiste në vendet kapitaliste.

Pjesa tjetër e partive revizioniste legale në vendet kapitaliste, e cila jeton në mëshirën e Moskës, është një pjesë e madhe e «OKB-së» revizioniste.

Për sa u përket partive të tjera revizioniste ilegale në vendet kapitaliste, ato nuk shkaktojnë as më të voglin shqetësim për revizionistët sovjetikë. Krerët e këtyre partive janë një agjenturë e thjeshtë e revizionistëve sovjetikë, ndodhen në shërbim të plotë të tyre dhe janë numri plotësues e i bindur i votave të «asamblesë» sovjetike. Objektivi i parë dhe i fundit i këtyre partive revizioniste është legalizimi, kërkimi i mëshirës së kapitalistëve të vendeve të tyre për t'i lejuar të veprojnë në format e njohura të opozitës së vogël legale borgjeze.

Si të gjitha shoqet e tyre revizioniste, këto parti e kanë braktisur rrugën revolucionare, luftën e klasave, luftën e armatosur dhe kanë adoptuar rrugën paqësore të bashkekzistencës hrushoviane. Duke qenë tradhtarë të marksizëm-leninizmit dhe duke humbur çdo lidhje me masat, ato e kanë varur gjithë shpresën në mbështetjen që mund t'u japë politika revizioniste sovjetike dhe aleanca e saj me imperializmin amerikan

dhe me kapitalizmin botëror. Këto tani janë katandisur në rrugaçë të revizionizmit, në një bohëmë revizioniste, e gatshme të shitet për një grosh. Revizionistët sovjetikë dëshirojnë ta legalizojnë sa më parë këtë kontingjent agjentësh, me të cilët veprojnë si të duan. Këtu synonte direktiva e revizionistëve sovjetikë e grekë që të gjithë të mërguarit grekë, komunistë ose jo, të shkonin hapur në Greqi në kohën kur atje sundonin Venizellosi me shokë. Një politikë të tillë ka ndjekur dhe ndjek partia revizioniste e Spanjës. Revizionistët sovjetikë e arritën këtë duke dërguar Bagdashin në Siri. Kjo politikë legalizimi dhe heqjeje dorë nga lufta kundër imperializmit dhe oligarkive sunduese u është sugjeruar edhe të gjitha partive revizioniste në Amerikën Latine.

Në këtë gjendje të turbullt dhe të paqëndrueshme të stanit revizionist, korrenti titist, i cili kërkon të fitojë kohë për të konsumuar krejtësisht përçarjen, kundërshton haptazi qëllimet sovjetike për të thirrur sa më parë një mbledhje që do të përkrahte planet e tyre. Klani i titistëve të vjetër e të rinj mendon se koha punon për të, prandaj edhe ka marrë mjaft guxim për t'i sfiduar revizionistët sovjetikë në pikat më të ndjeshme të tyre. Klanin sovjetik koha nuk e pret, ai kërkon të shpëtojë mbytjen e vaporit, të konkludohet diçka sa më parë, pa u bërë tepër vonë. Ai mendon dhe praktika ia ka vërtetuar se me mbledhjet bilaterale midis partive revizioniste nuk arrihen veçse pazarllëqe të përkohshme, shitblerje e intriga me përpjesëtime të vogla. Atyre, për konsum të brendshëm e të jashtëm, u duhet që herë pas here, dhe sa më shumë aq më

mirë, të organizojnë nga një mbledhje të gjerë të partive revizioniste, për të parë se ku ndodhen dhe për të arnuar shqepjet. Prandaj revizionistët sovjetikë, me gjithë kundërshtimin këmbëngulës të korrentit titist, morën në Budapest vendimin që mbledhja e ardhshme e partive revizioniste të mbahet në fund të këtij viti në Moskë, ku, nën perden e unitetit të luftës kundër imperializmit, të diskutohet problemi i vërtetë që i preokupon ata, lufta e koordinuar kundër marksizëm-leninizmit, kundër partive që i qëndrojnë atij besnik.

Synimin drejt këtij objekti të mbledhjes së ardhshme Suslovi e shprehu në mënyrë krejt kategorike jo vetëm nëpër prapaska e korridore, por edhe në fjalimin zyrtar që mbajti në Budapest. Akoma më qartë i përcaktoi rendin e ditës dhe qëllimet e mbledhjes kaq të dëshiruar nga udhëheqësit sovjetikë përfaqësuesi polak, Klishko. Turma e «rrugaçëve» revizionistë, që përbënte shumicën e votave të «OKB-së» së Budapestit, brohoriti me zell të madh për mbledhjen e propozuar nga udhëheqësit sovjetikë, pasi vetëm në një vend të tillë ata mund të mbajnë ndonjë ligjëratë sa t'u ndihet zëri. Të paktën të lehin nganjëherë për kockat që u hedhin!

Në këtë mënyrë, pengesat që vunë neotitistët në rrugën e mbledhjes së ardhshme nuk qenë në gjendje për të mposhtur këmbënguljen dhe presionin e udhëheqësve revizionistë sovjetikë. Kushti që ata vinin për të përkrahur mbledhjen e Moskës, ishte një manovër e thjeshtë taktike, prandaj edhe nuk mund të ishte shumë e efektshme. Kur ata thoshin se në

mbledhjen e ardhshme duhet të thërriten të gjitha partitë, të gjithë e dinin se ata nuk e kishin fjalën as për Partinë Komuniste të Kinës, as për Partinë e Punës të Shqipërisë, as për partitë e reja marksiste-leniniste, por për partinë titiste jugosllave, e cila, si kusht të parë «për të denjuar» të ulet në një mbledhje të përgjithshme revizioniste, përveç të tjerave, ka vënë atë që të rrezohen të gjitha ato ç'janë thënë për të në dokumentet e mbledhjeve të Moskës të viteve 1957 e 1960. Titoja kërkon tani që jo vetëm sovjetikët të bëjnë autokritikë botërisht, siç bëri Hrushovi kur vajti në Beograd më 1955, por të gjithë t'i bien në gjunjë. Revizionistët sovjetikë, për veten e tyre, në praktikë e në parim, e kanë pranuar një gjë të tillë, por, me sa duket, për shkak të koniunkturave të ngatërruara që vetë kanë krijuar, tani për tani nuk janë akoma të gatshëm të pranojnë që kjo të hiqet zyrtarisht dhe me daulle nga dokumentet në fjalë dhe nga mbledhja që do të bëjnë.

Edhe revizionistët italianë, që nuk janë shumë entuziastë për mbledhjen e ardhshme, u munduan t'i vënë asaj barrikatat e tyre, megjithëse të një natyre tjetër. Ata duan që mbledhja e ardhshme të jetë një pazar ku të ftohen të marrin pjesë me kuç e me maç të gjitha llojet e partive, mjaft që të kenë një tabelë në dorë ku të shkruhet se janë «demokratë», «përparimtarë» etj. Ata duan që kjo mbledhje t'u shërbejë si një dëshmi e hapit të tyre të parë e të sigurtë për t'u integruar në kapitalizëm dhe për t'u shërbyer me devocion kapitalistëve të vendit të tyre. Francezët e përkrahën këtë «zbulim gjenial», vetëm

që një mbledhje e tillë të bëhet pas asaj të propozuar nga revizionistët sovjetikë.

Të gjitha këto tregojnë se korrenti titist ishte i dispozuar jo vetëm t'u ngatërronte revizionistëve sovjetikë punët në Budapest, por edhe të luftonte që mbledhja e ardhshme që kërkojnë sovjetikët të mos bëhej. Ky krah revizionist kërkon në këtë mënyrë të luajë në dy fusha: edhe revizionistëve sovjetikë t'u bëjë presion e shantazh, duke i kërcënuar me një grupim të ri revizionist në gjirin e revizionizmit modern, edhe të fitojë akoma më shumë kredi e përkrahje të shumëllojta nga grupimet e ndryshme kapitaliste.

Çarjet e hapëta që ndodhën në Budapest, do t'u sjellin revizionistëve sovjetikë telashe të mëdha të mëtejshme. Por, sigurisht, edhe këta nuk do të rrinë duarlidhur. Ideja revizioniste e përgjithshme është se duhen bërë përpjekjet që «delet e çoroditura» të kthehen në tufë, ose me të mirë ose me presione të çfarëdollojta që mund të pjellë koha e që do të shërbejnë për përgatitjen e pseudokonferencës së komunizmit ndërkombëtar në Moskë.

Fakt është se e ashtuquajtura «pozitë e tretë» që u shfaq në Budapest dhe që ka prapa krahëve Titon, duket se i ka ndarë rolet me ustanë e Beogradit për të vepruar në dy drejtime të veçanta: një në drejtim të revizionistëve të fshehtë dhe tjetri në drejtim të forcave të ndërmjetme kapitaliste.

Titistët jugosllavë, të cilët nuk qenë në Budapest, por siç shkruante një komentator jugosllav, «shumë parti komuniste që do të përfaqësohen në Budapest

kanë mendime të njëllojta me tonat», me gjithë gëzimin e tyre të madh dhe publicitetin e gjerë që u kushtojnë të tilla rasteve, këtë herë nuk po bëjnë zhurmë, për çarjet e reja të Budapestit. Kjo nuk është e rastit, ata nuk duan t'i djegin dhe t'i komprometojnë pasuesit e tyre. Të komprometuar si agjentë të hapët të imperializmit amerikan, ata ua lanë neotitistëve fushën e veprimit për t'u afruar dhe për të bërë me vete të ashtuquajturit «neutralë», «të pavarur» dhe gjithë revizionistët e fshehtë në «lëvizjen komuniste ndërkombëtare». Dhe tanimë është jashtë çdo dyshimi se neotitistët kanë përkrahjen e këtyre të ashtuquajturve neutralë, kur ngrenë çështjen dhe thërresin për «shuarjen e polemikës», për të mos bërë një mbledhje ku të ndizen sulmet kundër Kinës e Shqipërisë, për të mos lejuar që udhëheqësit sovjetikë të vendosin drejtimin e tyre nën çdo formë goftë. Ata ngrenë pikërisht bajrakun e këtyre «neutralëve» kur kundërshtojnë revizionistët sovjetikë dhe kërkojnë që një konferencë të bëhet, por të ketë për qëllim krijimin e një «fronti të gjerë antiimperialist», ku të futen brenda revizionistët, komunistët, socialistët, demokratët, pacifistët etj., etj.

Të ndodhur nën goditje të gjithanshme dhe duke u përpjekur të evitojnë thellimin e mëtejshëm të çarjeve në frontin revizionist, revizionistët sovjetikë u detyruan të japin pëlqimin për të thirrur më vonë, në një mbledhje të hapët, të gjitha partitë e të gjitha ngjyrave, por me kusht që kjo të mos konfondohet, me të tyren, ose të eliminojë të parën, siç kërkojnë titistët, italianët e të tjerët.

Në këtë mënyrë në Budapest u kristalizuan dy tendenca të përgjithshme: njëra, që të bëhet mbledhja që propozojnë revizionistët sovjetikë, pastaj mund të bëhet edhe tjetra. Dhe tendenca e dytë, të mos bëhet ajo e sovjetikëve, të bëhet një tjetër, pa polemikë, pa çështje ideologjike, vetëm formale, kundër imperializmit, në të cilën mund të vijnë të gjithë, edhe papa i Romës po të dojë. Dominoi teza e revizionistëve sovjetikë dhe me këtë mori fund panairi i Budapestit. Por kjo s'do të thotë se problemi i mbledhjes së ardhshme, karakteri i saj, rendi i ditës dhe kush do të marrë pjesë, u zgjidhën përfundimisht. Derisa të mblidhet, në qoftë se do të bëhet, ka shumë mundësi të bëhen përsëri lëshime reciproke e kompromise midis grupeve rivale, që ajo të ketë një fizionomi dhe drejtim krejt tjetër nga ç'e mendojnë tani projektuesit e saj.

Tani, pas mbledhjes së Budapestit, ka disa nga pjesëmarrësit e saj, të cilët, meqenëse nuk ishin plotësisht dakord me revizionistët sovjetikë në të gjitha çështjet, po krekosen dhe po hiqen si «trimat e panairit» duke bërë deklarata, artikuj e vendime të pafund për t'i mbushur mendjen opinionit publik se veprimi dhe vija e tyre na qenkan marksiste-leniniste të kulluara. Sipas tyre, polemika kundër armiqve të klasës dhe të partive duhet shuar, revizionistët nuk duhen kritikuar as për politikën e jashtme as për të brendshmen, ata duhet të lihen të qetë të veprojnë si të duan, se çdo gjë që bëjnë është puna e tyre. Dhe e gjithë kjo teori na qenka «internacionalizëm proletar» i gjallë! Në realitet, nuk mund të ketë gjë

tjetër më oportuniste, më antimarksiste dhe më anti-internacionaliste se kjo vijë e shuarjes së polemikës. Lenini e Stalini, ashtu si Marksi dhe Engelsi, nuk mund të rronin asnjë minutë pa polemikë, pa luftë — pa luftuar me ashpërsinë më të madhe kundër deviatorëve dhe tradhtarëve të çështjes së proletariatit e të revolucionit. E gjithë jeta e tyre nuk është tjetër veçse një luftë e pandërprerë, një polemikë nga më të ashprat, nga më parimoret kundër gjithë armiqve të komunizmit.

Për të gjithë komunistët e vërtetë tanimë është aksiomë se pa luftë, pa polemikë nuk ka revolucion, nuk ka parti marksiste-leniniste, nuk ka socializëm, nuk ka komunizëm. Por ja ku na dalin disa zotërinj që hiqen si leninistë, bile çfarë leninistësh, nga më të «pastrit», të cilët pretendojnë se nuk duhet të ketë më polemikë, nuk duhet të ketë më kritikë. Këtë tezë mbajti dikur edhe Titoja kur u vu me shpatulla në mur nga Informbyroja për tradhtinë e tij. Ai u ngrit atëherë gjoja kundër «ndërhyrjes» në punët e partisë së tij. Me këtë ai donte të thoshte «më lini të qetë të quhem komunist dhe të tradhtoj komunizmin, më lini rehat të bëhem një agjenturë e imperializmit», siç u bë.

Këtë rrugë u përpoq të ndiqte edhe Hrushovi, por s'mundi ta realizojë. Maska antimarksiste e «pushimit të polemikës» iu dogj në duar dhe pasardhësit e tij nuk orvaten më ta përdorin. Ata preferojnë taktika dhe mjete të tjera për t'u mbyllur gojën disave, por taktika e vjetër e tyre, që disa e paraqesin si të re, nuk vlen më. Mbi dy karrige nuk mund të që-

ndrohet për shumë kohë. Komunistë marksistë-leninistë që të pushojnë luftën kundër revizionistëve modernë nuk mund të ekzistojnë, ashtu si nuk mund të ketë revizionistë që të mos luftojnë kundër marksistë-leninistëve. Ata që kërkojnë tani shuarjen e polemikës dhe predikojnë vijën paqësore, kanë frikë për vdekje nga revizionistët e tjerë dhe duan me çdo kusht tradhtie të kenë ndihmën dhe përkrahjen e kapitalistëve. Dhe këta do t'ua japin këtë përkrahje, pasi kjo «taktikë», domethënë «vija e mesme» në lëvizjen punëtore, u shërben shumë qëllimeve të tyre.

Revizionistët thonë se qëllimi i mbledhjes së tyre është bashkimi i të gjitha forcave të mundshme në luftë kundër imperializmit, agresioneve, kërcënimeve të tij etj. Por ky është një mashtrim nga më të turpshmit, demagogji e ulët dhe një blufë hapët. Për ç'luftë kundër imperializmit mund të flasin revizionistët sovjetikë, të cilët aleancën me Shtetet e Bashkuara të Amerikës për ndarjen e zonave të influencës dhe vendosjen e sundimit të dy fuqive të mëdha në botë e kanë bërë bazën e bazave të të gjithë politikës së tyre? Mos vallë duke sabotuar luftën e popullit vietnamez dhe duke përkrahur amerikanët hapur edhe fshehurazi për skllavërimin e popullit të Vietnamit ata luftojnë imperializmin? Mos vallë duke i lënë në baltë popujt arabë në një nga momentet më kritike dhe duke bërë pazarllëqe në prapaskenë me armiqtë e betuar të tyre ata i mbrojtën nga agresioni imperialist? Apo mos thonë se përkrahin çlirimin e popujve kur aprovojnë në OKB ndërhyrjen e armatosur amerikane për të shtypur kryengritësit dominikanë,

ose kur u japin kredi dhe u shesin armë xhelatëve indonezianë, vrasësve të qindra mijë komunistëve e patriotëve të ndershëm?

Vargu i tradhtisë së interesave të larta të revolucionit dhe të çlirimit të popujve nga ana e revizionistëve është i pafund. Bota shikon përditë me qindra e mijëra akte të afrimit dhe të bashkëpunimit të revizionistëve sovjetikë me imperializmin amerikan, por nuk ka parë as edhe ndonjë veprim të tyre, qoftë edhe të shkëputur, që të kundërshtojë politikën agresive të tij. Të mos shkojmë larg për shembuj. Ndërsa në Budapest revizionistët sovjetikë bënë thirrje demagogjike për t'u bashkuar në emër të luftës kundër imperializmit, përfaqësuesit e tyre në Gjenevë paraqitën së bashku me kolegët e tyre amerikanë në konferencën e të 17-ve për traktatin e mospërhapjes së armëve bërthamore një deklaratë të përbashkët në lidhje me garancitë që gjoja Bashkimi Sovjetik dhe SHBA u japin vendeve joatomike, që do të nënshkruajnë traktatin. Përpjekja për të ruajtur monopolin e armëve bërthamore dhe për të ushtruar shantazhin atomik mbi popujt, është një gjë që duket sheshit. Në këto kushte për çfarë antiimperializmi mund të bëhet fjalë?

«Antiimperializmi» i revizionistëve nuk ka pasur kurrë konkretësi, ai është një frazë boshe, një maskë për të fshehur bashkëpunimin me imperializmin. Ai është një demagogji me të cilën ata duan të spekulojnë, të mashtrojnë popujt, të shuajnë flakët e luftës kundër imperializmit, të cilat po përhapen në të gjitha kontinentet.

Në mbledhjen e Budapestit revizionistët sovjetikë mundën t'u shkëputin partnerëve të tjerë pëlqimin për të shkuar në Moskë në mbledhjen e caktuar për në fund të këtij viti. Krerët e Kremlinit po bëjnë tani një zhurmë të madhe dhe u bien gjithë daulleve të tyre propagandistike duke e paraqitur këtë si një «sukses» të madh. Por ky «sukses» është një fitore si ajo e Pirros. Shumë nga revizionistët, për njërën ose për tjetrën arsye, nuk e duan mbledhjen, por janë të detyruar ta bëjnë, pasi i detyroi lufta jonë, krijimi i partive të reja marksiste-leniniste, ngritja e revolucionit dhe e luftës nacionalçlirimtare të popujve. Këtyre sukseseve dhe këtij marshimi të fuqishëm të marksizëm-leninizmit ata janë të detyruar t'u vënë përpara një barrikadë prej kartoni, një perde tymi.

Por çdo përpjekje e tyre do të jetë e kotë, disfata të tjera, më të mëdha, i presin, përçarje akoma më të thella do të vërtetohen. Edhe mbledhja e ardhshme e Moskës do të vejë në shportën e plehrave, ashtu siç vajtën mbledhja e marsit 1965, mbledhja e Karlovi-Varit, mbledhja e Budapestit që sapo mori fund.

Vendimi i revizionistëve për të bërë një mbledhje të përgjithshme të tyre është një, por ç'të shtrohet atje, si të shtrohet, çfarë të vendoset, si të vendoset dhe si të komunikohet, pale si të zbatohet, kjo është një histori tjetër e hidhur për revizionistët modernë dhe në radhë të parë për revizionistët sovjetikë. Janë këta që vendosën në Budapest, por janë edhe ata që nuk vajtën. Në radhë të parë është Titoja, për të cilin revizionistët sovjetikë kanë shumë nevojë, pasi të rrijë jashtë u prish punë, t'u vijë brenda u kërkon kon-

cesione të mëdha. Nga halli, sovjetikët janë gati t'i bëjnë lëshime, por jo aq sa do Titoja, pasi ky u kërkon edhe çelësat, edhe shtëpinë, nënën e babanë, edhe tapinë.

E ardhmja jo e largët do të provojë përsëri atë që ka thënë Partia jonë se përçarja, degjenerimi dhe falimentimi i revizionistëve modernë janë të paashmangshëm. Midis tyre nuk ka pasur dhe as mund të ketë kurrë unitet. Rregull në stanin e tyre nuk mund të vihet kurrë. Historia tanimë ka treguar se kush ngre dorën kundër marksizëm-leninizmit, kush bashkohet me armiqtë e klasës punëtore dhe me borgjezinë kundër revolucionit e çlirimit të popujve, atë e pret disfata e plotë, fundi i turpshëm i gjithë tradhtarëve. Revizionistët kërkojnë ta kthejnë mbrapsht rrotën e zhvillimit historik të shoqërisë, por ajo po i shtyp e po i dërrmon pa mëshirë nën peshën e saj të rëndë.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 64 (6103), 15 mars 1968

Botohet sipas librit: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1968-1970», f. 39

PER FORCIMIN E MËTEJSHËM TË BAZAVE TË SHKOLLËS SONË SOCIALISTE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

18 mars 1968

Komisioni² që propozova dhe që u aprovua në mbledhjen e fundit të Byrosë Politike të Komitetit Qendror, më 7 mars, mendoj të fillojë nga puna.

Si mendoj unë të punojë komisioni?

E para, ai duhet të jetë nën drejtimin e Komitetit Qendror të Partisë. Kjo nuk përjashton aspak mundësinë që në përbërje të tij të ketë edhe specialistë të paorganizuar në Parti, por që janë kompetentë për çështjet e arsimit. Pastaj nuk duhet të kuptohet sikur ky komision do të marrë në duar të gjitha çështjet e arsimit dhe se Ministrinë e Arsimit dhe të Kulturës, e cila është organi kryesor që përgjigjet përpara Partisë për çështjet e ngarkuara, do ta vërë në një qoshe. Jo.

1 Në këtë mbledhje u diskutua për disa detyra që dilnin për zbatimin e vendimeve që mori Byroja Politike e KQ të PPSH në mbledhjen e saj të datës 7 mars 1968 për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës.

2 Është fjala për Komisionin Qendror të Arsimit.

Komisioni do të organizojë punën për të zbatuar orientimet që dha Partia për revolucionarizimin e mëtejshëm të arsimit tonë popullor, do të caktojë detyra, do të shohë dhe do të kontrollojë si shkojnë punët e arsimit, por ministria në asnjë mënyrë nuk duhet të lajë duart nga kjo punë. Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, si organi përgjegjës, do të nxjerrë udhëzime, po ato duhet t'i shohë komisioni, i cili do të orientojë edhe ministrinë për këtë problem. Kjo është e domosdoshme të bëhet. Fjala¹ që mbajta në mbledhjen e Byrosë Politike është vetëm një orientim i përgjithshëm, kështu që për konkretizimin e saj duhet të vihen në lëvizje të tërë, edhe shtypi. Gazeta «Zëri i popullit» deri tani ka botuar nja dy krycartikuj mbushur kryesisht me perifraza, vetëm duke i qepur disa pjesë nga fjalimi im. Në artikujt që do të botojë shtypi mund të merret vetëm ndonjë frazë nga ky fjalim, për një çështje të vetme, dhe këtë artikullshkruesit ta thellojnë, ta zbërthejnë, në mënyrë që, kur ta lexojnë mësuesit dhe pedagogët, ata të ndiejnë se po ndihmohen dhe të nxiten të reflektojnë mbi udhëzimet e dhëna. Në shtyp duhet të shkruajnë ata që janë kompetentë për çështjet e arsimit dhe që e zotërojnë politikën e Partisë në këtë fushë. Po këtë gjë mund të themi edhe për radion. Pra është e domosdoshme që çdo organ e komision që do të merret me këtë punë, të ketë orientime konkrete.

E dyta, shokët që do të përbëjnë komisionin duhet të mendojnë si e qysh duhet vepruar, pastaj këtë

¹ Shih në këtë vëllim, f. 288.

çështje ta shohim edhe ne në Sekretariatën e Komitetit Qendror. Komisioni duhet të na mbajë vazhdimisht në korent të problemeve.

Çështja është ç'duhet të bëjmë tani.

Ne vetë, në radhë të parë, mendoj unë, të kemi të qarta problemet që duhen parë në fushën e arsimit, siç janë ato të strukturave, të teksteve e programeve, të kuadrove etj. Këtu duhet të shohim ne, për shembull, brenda vijës së Partisë, brenda situatave aktuale, problemin e kuadrit, të studiohen nevojat materiale dhe mundësitë teknike që kemi për të përballuar ato që do të na duhen, nëse i kemi të mjaftueshme apo jo etj.

Këto, sipas mendimit tim, janë çështjet kryesore ku ne duhet të mbështetemi. Është e domosdoshme të përpunohen teza, të jepen mendime e të bëhen përpjekje për të gjetur rrugën më të mirë për zbatimin e orientimeve të Byrosë Politike, të hidhen më në detaje disa ide e detyra, sepse ato që hodha unë në fjalimin tim të 7 marsit nuk janë të mjaftueshme. Ato janë vetëm disa orientime të përgjithshme që duhet të përpunohen më tej, prandaj ta studiojmë mirë këtë çështje.

Duke u nisur nga kjo, mendoj se përveç komisionit kryesor qendror, ne duhet të kemi pranë tij dhe të varur prej tij disa komisione të tjera, të përbëra nga njerëz kompetentë, si, për shembull, një komision për shkollat fillore, një për të mesmet, një tjetër për teknikumet, një për shkollat e larta, ndonjë mund ta kemi për kurset e ndryshme etj. Mendoj që puna në këto komisione të konsistojë në zbërthimin e orien-

timeve të dhëna nga komisioni kryesor qendror për drejtimit që thashë, por gjithçka duhet të jetë e organizuar dhe e drejtuar mirë, në mënyrë që të mos bëhet një mishmash, të mendojnë të tërë për çdo gjë, por secili të thellohet për çështje të profilit që i është ngarkuar.

Përveç këtyre, mendoj se duhen krijuar komisione edhe në rrethe, të drejtuar nga sekretarët e komiteteve të Partisë. Komisionet e rretheve përkatësisht për probleme të caktuara duhet të udhëzohen nga komisionet që do të ngrihen në qendër dhe të dinë ta organizojnë mirë punën me njerëzit e tyre. Çështja është që të organizohet mirë puna dhe këto probleme të diskutohen me pjekuri, sepse kështu do të kemi fryte të mira. Komisioni kryesor qendror nuk mund ta ketë syrin kudo, por ai duhet të ndihmojë Partinë në mënyrë të organizuar.

Lidhur me këtë problem mendoj që komisioni për çështjen e teksteve, ai që do të krijohet për çështjen e programeve, komisioni që mund të krijohet për format e edukimit, për atë të kuadrove etj., duhet të shohin nëse duhen ruajtur strukturat që kemi apo duhen ndryshuar. Kjo kërkon që ne të kemi nëpër këto komisione kuadro specialistë. Duhet të jetë gjithashtu edhe një komision për anën teknike, si për pajisjen e shkollave, për botimet, për fondet që do të nevojiten etj. Të kihet parasysh që atje ku duhet, të caktojmë teknikë të rinj, po edhe të vjetër, sepse këta nuk duhen lënë pas dore, pasi kanë eksperiencë të madhe.

Siç thashë, të gjitha këto komisione duhet t'i marrin orientimet nga komisioni kryesor qendror. Po si duhet të punojë ky komision dhe sa kohë i duhet

të merret me këtë punë, kjo varet nga detyrat që dalin. Mbasi të vihen në funksionim të gjitha këto dhe mbasi çdo komision ta shikojë vëllimin e punës që ka përpara dhe nevojat që do të dalin, atëherë mund të përcaktohet se kur do të përfundojë kjo punë.

Gjithashtu duhet pasur parasysh se ata që do të marrin pjesë në komisione janë të zënë me punë atje ku shërbejnë, disa anëtarë do të jenë mësues, të tjerë pedagogë, ekonomistë, filozofë e të tjerë. Ka rëndësi që të ruajmë orientimin për përbërjen e komisioneve, por rëndësi të madhe ka, gjithashtu, edhe planifikimi i punës së njerëzve që do të marrin pjesë në këto komisione, që të mos vijnë vetëm sa për formë në mbledhjet që do të bëjnë, por të kenë kohë në dispozicion për të menduar. Pra, po ta organizojmë mirë punën në komisione dhe po ta mbajmë mirë në kontroll këtë çështje, secili do të ketë kohë të mjaftueshme që edhe punën e tij të zakonshme ta kryejë, por, njëkohësisht, të kryejë edhe këtë punë të rëndësishme që i është ngarkuar. Për këtë kërkohet organizim pune i përbashkët, si edhe punë individuale nga secili. Mbledhjet e komisionit duhen bërë me seanca të rregullta, sa herë të jetë nevoja. Në to të bëhen diskutime e të dilet me konkluzione, të cilat t'u transmetohen nënkomisioneve sipas profileve të tyre.

Mendoj të fillohet nga puna pa humbur kohë, se kjo çështje do të kërkojë një punë të madhe e për një kohë të gjatë. Ne duam të forcojmë më tepër bazat e shkollës sonë socialiste, gjë që nuk bëhet dot brenda një kohe të shkurtër.

Gjatë kohës që do të punojë komisioni, shkolla

jonë duhet ta vazhdojë punën e saj pa e ndërprerë aspak, bile edhe më mirë se deri tani, duke bërë korrigjimet e nevojshme, mbasi tani për çdo gjë jemi të qartë, sepse orientimet e përgjithshme i kemi, por njëkohësisht të vazhdojmë të bëjmë edhe prova, edhe eksperimente.

Mendoj, gjithashtu, që me të gjithë anëtarët e komisioneve të bëhet një mbledhje, ku t'u bëhen të qarta detyrat që shtron Komiteti Qendror për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës.

Komisioni qendror kryesor është e domosdoshme të organizojë edhe nxjerrjen e një buletini, ku të pasqyrohen të gjitha çështjet që ngrihen, që propozohen dhe diskutohen nëpër mbledhjet e komisioneve të ndryshme, me qëllim që të gjithë anëtarët e komisioneve të jenë në dijeni se ç'mendon njëri dhe ç'mendon tjetri për këto probleme, t'u transmetohen, pra, sa më shpejt pikëpamjet dhe propozimet që hidhen për diskutim në njërin apo në tjetrin komision, që secili të jetë në gjendje të paraqitë pikëpamjen e vet për çdo çështje që hidhet për diskutim. Qarkullimi i buletinit tek anëtarët e komisioneve do t'i ndihmojë shumë ata që janë ngarkuar nga Partia për të dhënë kontributin e tyre për këtë çështje kaq të rëndësishme, siç është revolucionarizimi i mëtejshëm i shkollës sonë.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverballi i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP

**KLASA PUNËTORE NË VENDET REVIZIONISTE
DUIET TË ZBRESË NË FUSHËN E BETEJËS
DHE TË RIVENDOSË DIKTATURËN
E PROLETARIATIT**

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

24 mars 1968

Në të gjitha vendet, ku revizionistët janë në fuqi, po shkallmohet diktatura e proletariatit dhe po zëvendësohet me diktaturën e borgjezisë, regjimi socialist po zëvendësohet me atë borgjez kapitalist dhe partia e proletariatit, e degjeneruar nga brenda, nuk shërben më veçse si perde për të fshehur këtë tradhti, për të shuar vigjilencën dhe revoltën e ligjshme të klasës punëtore dhe të popullit punonjës. Vigjilenca dhe dhuna e ligjshme e klasës punëtore, kundër armiqve të klasës, është ajo që i tmerron revizionistët, është e vetmja forcë që mund t'i mposhtë, është e vetmja rrugëdalje nga kjo gjendje katastrofike, në të cilën ndodhen sot socializmi dhe komunizmi, në vendet ku sundojnë revizionistët. Pra, ringjallja dhe ndezja e flakës së revolucionit proletar në këto vende është rruga *sine qua non* e shpëtimit. Çdo rrugë tjetër, ashtu si janë zhvilluar dhe po rrokullisen ngjarjet,

nuk mund të japë asgjë të mirë dhe të qëndrueshme për diktaturën e proletariatit dhe për socializmin, ajo mund të shërbejë si një pozë kompromisi, e dëmshme dhe e përkohshme, me pasojë të rënda për socializmin.

Vetëm klasa punëtore në krye të masave, vetëm klasa punëtore me partinë e saj të vërtetë marksiste-leniniste në krye, vetëm klasa punëtore me revolucion të armatosur, me dhunë, mund dhe duhet t'i futë në varr revizionistët tradhtarë.

Të gjitha vendet, ku në fuqi janë revizionistët, pa asnjë përjashtim, qofshin ato që janë në pararojë, si Jugosllavia, Bashkimi Sovjetik, Hungaria, Çekosllovakia, Polonia etj., qofshin ato që, me maska të ndryshme, fshehin dhe maskojnë vijën e tyre revizioniste, antimarksiste, janë kthyer në vende borjeze kapitaliste, ose ecin me shpejtësi në këtë batak të qelbur.

Çështja kryesore që kanë në rendin e ditës klikat tradhtarë revizioniste, që janë në fuqi, qëndron vetëm në zgjedhjen e formave më të sigurtë për t'ia arritur qëllimit të restaurimit të kapitalizmit, për forcimin dhe stabilizimin e tij, pa ngjallur dyshimin dhe vigjilencën e klasës punëtore dhe të punonjësve, për të evituar goditjet, turbullirat dhe, më në fund, për të qonë në gjendje të shtypin revolucionin, kur ai të shpërthejë. Kjo është lufta për të fituar garën.

Çështja tjetër në rendin e ditës për ta, në këto konjunktura të shturjes, për të arritur qëllimin e restaurimit të kapitalizmit, qëndron në përpjekjet e gjithsecilës klিকে edhe për t'i shpëtuar tutelës së më

të fuqishmit, edhe për të pasur ndihmën e tij në përgjithësi, ose në mënyrë të veçantë kur pozitat t'i ndiejnë të dobëta. Me këtë lidhet shkalla e varësisë së njërit nga tjetri, ndërsa më i fuqishmi prej tyre përpiqet të sundojë korrentet dhe t'i kanalizojë ato në interesin e shtetit të madh. Natyrisht, tani një gjë e tillë nuk ka sukses të plotë, as me të gjithë dhe as vazhdimisht.

Një tjetër çështje, që qëndron në rendin e ditës të këtyre klikave, është tendenca dhe kujdesi i madh për gjetjen e formave të ndryshme të maskimit, të larmive të formave të veprimit, të cilat, disa herë, janë shumë më të avancuara dhe më pak të maskuara nga ato të klikave kolege. Këta «pionierë» u shërbejnë forcave kapitaliste, që frymëzojnë klikat revizioniste, për të nxitur të tjerët, që të shpejtojnë kursin sa të jetë e mundur më shumë, të thyejnë rezistencën e atyre klikave revizioniste që, nga halli, janë më konservatore, sepse të gjithëve u qëndron mbi kokë kurdoherë shpata e Damokleut, revolucioni proletar.

Të gjitha veprimet kundërrevolucionare për marrjen e pushtetit në duart e tyre dhe orvatjet që bëjnë për ta konsoliduar këtë pushtet, revizionistët përpiqen t'i maskojnë, duke krijuar dhe duke rrënjësuar në mendjen e klasës punëtoare iluzionin se gjoja partia e saj «marksiste-leniniste» është në fuqi, se e drejton ajo të gjithë këtë zhvillim dhe transformim në «rrugën e vërtetë të socializmit dhe të komunizmit». Kjo është maska më e rrezikshme, me ndihmën e së cilës revizionistët kërkojnë të shpëtojnë nga goditja ven-

3. — Kundërrevolucionin në pak ditë e likuidoi krejtësisht Partinë e Punonjësve të Hungarisë, ndërsa kundërrevolucionari Janosh Kadar lëshoi dekretin e shpërndarjes zyrtare të saj.

4. — Gjatë pak ditëve të kundërrevolucionit në Hungari dolën në skenë dhe u krijuan menjëherë, si kërpudhat pas shiut, shumë parti borgjeze, kapitaliste, fashiste.

Pra, kundërrevolucionin hungarez u mposht me anën e tankeve sovjetike. Po ai tradhtar që likuidoi partinë, me diktatin e revizionistëve hrushovianë, lëshoi dekretin tjetër të riformimit të partisë, gjoja të re, «marksiste-leniniste», por akoma më të krimbur se ajo e mëparshmja, partinë revizioniste hungareze.

Kundërrevolucionin hungarez u shtyp nga kundërrevolucionarët. Pra, të dy krahët e puçeve do të puçeshin, siç u puçën, do të ndërtonin «Hungarinë e tyre», siç e ndërtuan, do të restauronin kapitalizmin, siç po e restaurojnë. Duke nxjerrë mësim nga gjakderdhja dhe pasi pagoi haraç gjaku për veprimet e tij, reaksioni hungarez tani po zhvillon në qetësi reformat e tij të transformimit rrënjësor kapitalist, pavarësisht dhe pa pasur asnjë kokëçarje nga forcat dhe tanket sovjetike që qëndrojnë në tokën hungareze. Borgjezia hungareze po bën, si të thuash, punën e vet, këtë herë nën mbrojtjen e tankeve hrushoviane. Borgjezia kapitaliste hungareze, armike e klasës punëtore, nën maskën dhe nën «flamurin e partisë», po vë në gjumë dhe po i farkëton zinxhirë të rinj klasës punëtore. Borgjezia kapitaliste ka si pararojë inteligjencien e

saj të vjetër dhe të re revizioniste, në unitet të plotë mendimi dhe veprimi.

Të marrim Poloninë. Si në Hungari, edhe në Poloni në vitin 1956 filluan demonstratat e përgjakshme në Poznan, të cilat u shtypën me tanke, këtë herë polake dhe jo sovjetike. Kisha dhe reaksioni polak kishin gisht dhe Hrushovi u tremb për shkëputjen që atëherë të Polonisë nga Bashkimi Sovjetik, prandaj ai e kërcënoi Gomulkën me invadim tankesh. Gomulka i rezistoi dhe Hrushovi, deshi s'deshi, i buzëqeshi dhe u përqaftua me fashistin Gomulka, siç e cilësonte ai këtë, pas krahëve, në biseda me të tjerët.

Por më vonë dhe tani, ditët e fundit, ngjarjet në Poloni po zhvillohen ndryshe. Ato kanë marrë një pamje tjetër, që është karakteristike për të gjitha vendet revizioniste. Në Poloni kanë filluar demonstratat, përleshjet, gjakosjet e policisë së Gomulkës me shkrimtarët, me inteligjencien, me studentët, të cilët kërkojnë «liri», «demokraci të plotë», «liberalizëm». Këtë herë, kundërrevolucionarët polakë, që janë ngritur kundër kundërrevolucionarëve revizionistë gomulkianë, përshëndetin dhe tregohen solidarë me kundërrevolucionarët çekoslovakë. Inteligjencia reaksionare polake, e drejtuar nga kapitalizmi botëror, nga kleri dhe nga çifutëria, nuk është e kënaqur nga klika revizioniste e Gomulkës dhe do ta qërojë atë, ashtu siç po bën klika e re sllovaqe e Dubçekut me klikën revizioniste të Novotnit, për të cilën do të flasim më poshtë. Por si në Hungari, ashtu edhe në Poloni inteligjencia reaksionare dhe studentët janë në ballë të rivendikimeve, partia është krimbur, organet e dikta-

turës janë në shërbim, hëpërhë, të klikës së Gomulkës dhe klasa punëtore nuk reagon, nuk del në rrugë të bëjë spastrimin e duhur. A do të jetë në gjendje klika e Gomulkës ta mposhtë këtë valë që po ngrihet? Këtë do ta shohim, por rëndësi ka vala e fundit që duhet të përgatitet për të fshirë nga faqja e Polonisë të gjithë tradhtarët, të hapët dhe të maskuar. Kjo valë shpëtimtare do të jetë revolucioni proletar i klasës punëtore polake, i udhëhequr nga një parti e vërtetë komuniste marksiste-leniniste.

Të marrim Çekoslllovakinë. Revizionistët sovjetikë trumbetonin se ajo ishte bastioni i tyre më i fortë, vendi më besnik i revizionistëve dhe Antonin Novotni njeriu më i afërt, «më seriozi dhe më me autoritet» i klanit revizionist, pas sovjetikëve. Edhe kjo gjendje, siç e kemi pasë parashikuar, s'ishte gjë, jo se Novotni dhe klika e tij revizioniste nuk ishte një agjunkturë besnike e hrushovianëve, por ajo nuk realizoi dot urdhrat që i jepnin padronët e Moskës. Në fakt, kali i ngordhur i sovjetikëve, Antonin Novotni, u vithis në batakun revizionist që ai krijoi, kurse kali tjetër që e zëvendësoi atë, Dubčeku, ka marrë frenat në dhëmbë dhe tani po ecën revan drejt «fushave» përrëndimore, ku e presin rrjetat e kapitalistëve francezë dhe gjermanoperëndimorë, të cilët kanë hapur kapitujt e vjetër të agjentëve të tyre famëkeqë Masarik, Benesh, Tizo, Hasha e të tjerë.

Si po zhvillohet kundërrevolucioni i ri në Çekoslllovakia? Hapur, kundër Antonin Novotnit dhe klikës së tij, pra kundër zgjedhës revizioniste sovjetike.

Hapur shkohet drejt kapitalizmit në sistemin e partisë ose të partive, në sistemin shtetëror kapitalist dhe në likuidimin pa maskë të diktaturës së proletariatit, në sistemin ekonomik, në arsim e në kulturë.

Hapur predikohet jo vetëm bashkekzistenca, por lidhjet e shëndosha me kapitalistët perëndimorë. Po bëhen homazhe mbi varrin e Masarikut, babë e bir, mbi varrin e Beneshit, po rehabilitohen me bujë të gjithë, deri te fashistët, dhe të gjithë këta cilësohen si «njerëz të shquar», viktima të «terrorit stalinist» dhe fryt i politikës së gabuar jo vetëm të klikës së Novotnit, por edhe të Gotvaldit, pra të Partisë Komuniste të Çekoslllovakisë, dhe, natyrisht, «të Stalinit, të Kominternit».

Me një fjalë, Çekoslllovakia po shkon me temp të shpejtë dhe pa dredhi e pa demagogji të shumtë në kapitalizëm, në restaurimin e plotë politik, ideologjik, ekonomik, shtetëror të republikës borgjeze kapitaliste.

Me ç'mjete dhe me ç'forma po zhvillohet ky proces? Nuk duhet të merret i shkëputur procesi çekoslllovak nga i gjithë procesi që po zhvillohet në stalin revizionist. Ky është rezultati i shturjes, i kontradiktave të mëdha që ekzistojnë brendapërbrenda klanit revizionist, brendapërbrenda tendencave të ndryshme që ekzistojnë në klanin e çdo vendi të veçuar revizionist, i kontradiktave ndërkombëtare. Pra, shturja çekosllovake dhe kursi që ajo ka marrë, nuk është asgjë e jashtëzakonshme. Asgjë s'duhet të na çuditë. Kjo është krejt normale.

Normale është edhe mënyra e hapur e veprimeve të tyre, dhe kjo për dy arsye: nga njëra anë, një

pjesë e popullit çekoslovak, bile edhe e klasës punë-tore çekoslovakë, janë të përgatitur, janë të predispozuar për këtë rrugë «liberale», siç e quajnë revizionistët. Komunizmi ka qenë për këta një lustër, një incident, dhe Partia Komuniste e Çekoslovakisë, gjatë gjithë kohës që nga çlirimi, jo vetëm nuk ka punuar me baza të shëndosha, por është fakt se pak ka ndryshuar natyrën, prirjet politike, guston dhe shijen politiko-kulturore të një pjese të popullit, e cila, edhe nën regjimin socialist, i ruante dhe i zhvillonte në forma të theksuara ndjenjat borgjeze kapitaliste.

Nga ana tjetër, kursi i ri çekoslovak drejt kapitalizmit vërteton kalbëzimin e mëtejshëm të fuqisë së revizionizmit sovjetik, i cili, i futur në batakun e madh që krijoi vetë, nuk është në gjendje më t'i kërcënojë kundërshtarët as politikisht, as ekonomikisht. Ai u bë skllav i sistemit dhe i tradhtisë që krijoi. Revizionistët sovjetikë janë të detyruar t'u buzëqeshin verdhë fatkeqësive që po u rrokullisen mbi kokë. Kursi i mëtejshëm revizionist çekoslovak ka tani mbështetjen e plotë jo vetëm të imperialistëve amerikanë, francezë, gjermanoperëndimorë, por, natyrisht, të titistëve, të revizionistëve «neutralë» dhe *in petto* të revizionistëve hungarezë. Po kristalizohet, pra, një forcë pak a shumë e organizuar, kurdoherë në kuadrin e shturjes dhe të «pavarësisë» kundër revizionistëve sovjetikë, polakë dhe të tjerë, të cilët kanë shumë frikë nga sëmundja ngjitëse që ka tendenca të qërojë kuajt e vjetër revizionistë dhe t'i zëvendësojë këta me kuajt të rinj.

Kundërrevolucionarët e rinj çekë përdorin meto-

da të reja dhe të shumanshme. I vënë rëndësi të madhe marrjes plotësisht në duart e tyre të gjendjes së brendshme, pa lënë pas dore politikën e jashtme. Natyrisht, për demagogji, haptazi flasin për miqësinë me Bashkimin Sovjetik, për ta minuar plotësisht këtë. Qëllimi i tyre kryesor është likuidimi i Novotnit dhe i klikës së tij pro udhëheqjes revizioniste sovjetike dhe reduktimi i marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik në marrëdhënie të thjeshta tregtare. Fushata për likuidimin e Novotnit, për demaskimin, komprometimin e tij dhe, më në fund, për heqjen e tij, u bë në mënyrë rrethuese. Në pararojë të kësaj fushate ishin nacionalistët sllovakë dhe ndjenjat antiçeke, ishin intelektualët borgjezë të vjetër dhe intelektualët e rinj revizionistë, ishin studentët dhe rrugaçët, të cilët dolën dhe dalin në demonstrata.

Grupi i Novotnit dhe padronët e tij të Kremlinit u vunë përballë policinë, por pa sukses. Novotni, duke parë se po i shtrëngohej litari në fyt, thirri në Pragë tanket, duke kopjuar metodën e Hrushovit që rrethoi me tanke Kremlinin dhe kështu shpëtoi kokën. Por Novotni nuk e realizoi dot këtë qëllim dhe e humbi davanë, ndoshta dhe kokën.

Grupi i Dubçekut, për të fshehur lodrën, po përdor format gjoja legale për të spastruar klikën e Novotnit. Në radhë të parë, ky grup siguroi ushtrinë me kuadro besnikë, kurdisi arratisjen e njëfarë gjenerali, diskreditoi Novotnin, ministrin e Mbrojtjes, Llomskin, dhe vuri në lëvizje partinë «e bindur» që, me peticione, me mbledhje dhe me demonstrata të studentëve, të kërkohet heqja ose dorëheqja sa më parë e Novotnit.

I gjithë ky operacion po realizohet shumë shpejt, pa çak, pa bamb, nën duartrokitjet e stuhishme të kapitalizmit botëror, të cilit iu kthye në prehër një dhi e zgjebosur.

Ç'do të bëjnë sovjetikët? Asgjë, veçse ta marrin për koleksion Novotnin, në qoftë se ua lënë, dhe t'i japin edhe atij një vilë si ndonjë tjetri më parë.

Pas këtij spastrimi, në Çekoslovakia do të luftohet për stabilizimin e gjendjes. E gjithë kjo gjendje, prapëseprapë nuk do të marrë fund me kaq. Do të ketë acarime të mëdha dhe luftëra të ashpra politike, ekonomike.

Në këto dy vende, Poloni dhe Çekoslovakia, ku revizionistët janë në fuqi, po zhvillohet, pra, i njëjti proces i degjenerimit kapitalist, me të njëjtat qëllime, forma e metoda, por me fate të ndryshme, me rezultate të ndryshme. Në të dy vendet, klikat e reja revizioniste, të cilat duan të shpejtojnë procesin e shndërrimit të vendeve të tyre në vende plotësisht kapitaliste, po përpiqen të heqin qafe klikën revizioniste të Novotnit dhe atë të Gomulkës, klika të vjetra revizioniste.

Ndjenjat antiçeke dhe shoviniste sllovaqe, transformimi rrënjësor i ekonomisë çekoslllovaqe në një ekonomi kapitaliste, transformimi rrënjësor i strukturës dhe i superstrukturës aktuale çekoslllovaqe që t'u përshtaten kthimit në kapitalizëm, lidhjet më të gjalla, më të gjera ekonomike, kulturore dhe politike me shtetet kapitaliste, ndjenjat antisovjetike, dobësimi i të gjitha lidhjeve me revizionistët sovjetikë, janë të gjitha këto që frymëzojnë dhe udhëheqin klikën

e re revizioniste çekosllovake, të udhëhequr nga Dubçeku.

Klika e vjetër dhe revizionisti i vjetër Novotni tani janë krejtësisht të izoluar, të shpartalluar. Të gjithë po lënë vaporin e mbytur dhe përqafojnë «rrugën e re». Pra, në Çekosllovaki triumfoi kundërrevolucioni brenda në kundërrevolucion.

Revizionistët sovjetikë e humbën krejt autoritetin politik në Çekosllovaki dhe influenca e tyre ka marrë të tatëpjetën. Duke i njohur mirë se cilët janë revizionistët sovjetikë, ata patjetër kanë bërë presione të mëdha për të shpëtuar katastrofën e tyre në Çekosllovaki.

Nga ana tjetër, Çekoslllovakia kapitaliste përforcon pozitën kapitaliste të Titos dhe të miqve të tij, ndihmon në transformimin e plotë të Hungarisë së Kadarit, me këtë në krye o pa të, ndihmon procesin në Poloni.

E gjithë kjo situatë që po krijohet në Evropën Qendrore, do t'i tronditë thellë Traktatin e Varshavës dhe KNER-in, do të çojë në aleanca dypalëshe dhe shumëpalëshe, krejt me frymë të ndryshme nga këto që ekzistojnë sot, dhe KNER-i e marrëdhëniet ekonomike do të ndryshojnë, do të prishen, do të marrin formë të reja, ku do të bëhet një amalgamë me ato kapitaliste.

Nga i gjithë ky transformim kapitalist rrezikohet seriozisht edhe Gjermania Demokratike, të cilën revizionistët, me formë dhe me mënyra të ndryshme, do ta shtyjnë drejt integritit në Gjermaninë e Bonit. Ky proces është në rrugë. Revizionistët sovjetikë janë krejt të paralizuar. Të vetmet armë të tyre kanë

mbetur presionet ekonomike. Por edhe këto, duket qartë, nuk kanë efekt. Kapitalizmi ka interesa të mëdha t'i financojë ata që shkëputen nga Bashkimi Sovjetik dhe ecin drejt Perëndimit. Ai disponon kapitale për investime, ai kërkon tregje të reja, kërkon koloni të reja dhe satelitë të rinj.

Pra, kapitalistët e rinj revizionistë nuk panë shumë hair nga gjoja «ndihmat internacionaliste» të revizionistëve sovjetikë dhe po ndërrojnë autobus.

Kjo disfatë e madhe e sovjetikëve po duket në hutimin e madh që i ka mbuluar. Kaq kohë ka që po ngjasin këto shkëputje dhe censura sovjetike nuk lë që opinioni i brendshëm sovjetik të mësojë gjë. Kjo nuk tregon veçse frikën që kanë nga populli, nga revolucionarët, nga revizionistët e rinj, dhe këta të fundit, të prekur nga sëmundja çekoslllovae, mund të shfryjnë në rrugë kundër klikës, për ta rrëzuar dhe për ta zëvendësuar me një tjetër klikë revizioniste. Në këtë rast Kosigini e Brezhnjevi do të veprojnë siç po vepron tani klani revizionist i Gomulkës në Poloni.

Po i njëjti proces si në Çekoslllovakia filloi edhe në Poloni, por hëpërhë me fate të ndryshme. Klani i Gomulkës e pengoi përkohësisht këtë proces, jo se Gomulka është më i zgjuar se Novotni, por rrethanat janë në Poloni disi më të ndryshme; prandaj edhe taktikat e Gomulkës janë më të ndryshme dhe duken «më të zgjuara».

Në Çekoslllovakia filloi me shkrimtarët dhe me studentët, por në ta, përveç të tjerave, dominonte ndjenja nacionaliste sllovae, anticeke dhe ndjenja nacionaliste çeke, antislllovae. Të tjerat ishin plotësuese, për-

veç ndjenjës antisovjetike dhe properëndimore që ishin të përbashkëta.

Në Poloni filloi po kështu procesi, po me ato prirje, ide dhe qëllime si në Çekosllovakia, por klani i Gomulkës përdori, edhe ai, siç bëri Novotni, violencën e policisë, por me sukses. Populli polak nuk përbëhet nga dy popuj, si Çekosllovakia, prandaj ai faktor që luajti rol në Çekosllovakia, nuk shërbeu si nxitës në Poloni. Gomulka duhej të gjente një kokë turku objekt të violencës dhe ky e gjeti në «sionizmin». Pra, «turbullirat në Poloni i krijoi sionizmi!» Gomulka nuk e përmend kishën, pasi rrezikohet që revolta të fryhet dhe të marrë proporcione të mëdha. Gomulka përpiket që kishën ta mbajë mënjanë dhe fakt është se kisha nuk u fut në arenë, ajo që herët e tjera bënte thirrje dhe manifestime të zjarrra kundër Gomulkës. Duket që kanë rënë dakord sa të kalojë kjo valë. Nga ana tjetër, Gomulka, antisovjetik i tërbuar, u mbrojt në këto momente me hijen e revizionistëve sovjetikë, të cilët, në fund të fundit, kur ta shohin çdo gjë të humbur në Poloni, mund edhe të guxojnë të ndërhyjnë, gjoja për të shpëtuar Poloninë, gjoja për të mbajtur rrugët të hapura, për t'i ardhur në «ndihmë» Gjermanisë Lindore etj.

Vili Brandi, nga ana e tij, në kongresin e partisë së tij, deklaroi se «është normale të njohim kufijtë Oder-Najse». Kjo ishte një ofertë Polonisë që të shkëputet nga sovjetikët, ishte «një mbështetje», gjoja në popull, politikës «këmbëngulëse» të Gomulkës mbi kufijtë gjermano-polakë dhe, më në fund, është një tentativë për të mbyllur rrethimin e Gjermanisë Lin-

dore dhe për të formuar «kordonin sanitar» rreth Bashkimit Sovjetik kapitalist.

Të gjitha këto rrethana, antijudaizmi, antisovjetizmi etj., bënë që procesi i kapitalizmit në Poloni të vazhdojë sipas Gomulkës. Por kjo është provizore, e përkohshme. Problemi është në rendin e ditës.

Marksistë-leninistët, revolucionarët polakë, populli dhe klasa punëtore, nuk e kanë thënë akoma fjalën e tyre. Gomulka hodhi në demonstrata edhe pjesë të klasës punëtore. Kjo tregon sa paqartësi ka atje, sa punë e madhe duhet bërë për ta sjellë klasën punëtore në binarët e vërtetë të saj, në pozita klasore antikapitaliste, antirevizioniste, kundër Gomulkës, kundër kishës katolike, kundër sionistëve.

Ka gjithashtu vende dhe parti gjoja neutrale që zhvillojnë kursin revizionist drejt kapitalizmit në situata të brendshme relativisht të qeta, pa demonstrata të bujshme, por me siguri me kontradikta të theksuara në udhëheqje, në popull dhe në parti, por që tani paraqiten gjoja në unitet. Ky unitet fals është fryt i frikës së jashtme, dhe në radhë të parë i frikës nga revizionistët sovjetikë, të cilët brenda udhëheqjes së këtyre partive kanë njerëzit e vet, që akoma janë në minoritet. Por në këto vende e parti «neutrale» sundojnë klika intelektualësh borgjezë, që mbështeten vetëm në ndjenjat antisovjetike. Prandaj pak më ndryshe nga çekoslovakët, këta revizionistë po e vënë theksin te politika e jashtme, te lidhjet me shtetet kapitaliste, me Jugosllavinë titiste, me Çekoslllovakinë e Dubčekut, për të kundërbalancuar rrezikun revizionist sovjetik. Në këto koniunktura këto klika po spas-

trojnë kundërshtarët e tyre të brendshëm, që mund t'i rrezikojnë, dhe bëjnë pörpjekje për të forcuar regjimin e tyre borgjez, që po vendoset në vendet e tyre duke likuiduar socializmin.

Le të marrim tani Bashkimin Sovjetik. Degjenerimi hrushovian i Bashkimit Sovjetik, i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, qysh në vitet e fundit të mbretërimit të Nikita Hrushovit, e pastaj në mënyrë akoma më të theksuar, shkaktoi rreziqe të mëdha për klikën e Kremlinit. Ai jo vetëm thelloi më tej kontraktat e kësaj klike me popullin sovjetik, por krijoi edhe një shtresë revizionistësh të rinj, kundërshtarë të klikës së vjetër revizioniste, që synojnë ta likuidojnë dhe ta zëvendësojnë këtë klikë me një tjetër të kësaj natyre, që të jetë më liberale dhe ta shpejtojë procesin e restaurimit të kapitalizmit në Bashkimin Sovjetik. Plehrat e plehrave nuk ishin të ngopur dhe manifestuan pakënaqësitë dhe kërkesat e mëtejshme. Në ballë të tyre edhe këtu ishin intelektualët dhe shkrimtarët e borgjezuar, njerëzit e artit dhe të kulturës revizioniste. Sthurja kishte hyrë thellë në rini, në studentë e në të tjerë. Kjo po merrte forma shqetësuese për klikën. Vetë Hrushovi reagoi disa herë, pasi e nuhati rrezikun, jo pse ata kërkonin të shkohej në kapitalizëm, por sepse kërkonin të shkohej pa të, me të tjerë, më shumë me anë të punës dhe të aksionit sesa të bufonerive dhe të metodës së çrregullt.

Klika që erdhi pas Hrushovit, u përpoq të bënte diçka më të mirë se padroni. Ajo u lidh më ngushtë edhe më sigurt me imperializmin amerikan, shkallmoi më tej partinë, ekonominë socialiste, shtoi degje-

nerimin jashtë dhe brenda. Por e gjithë kjo veprimtari krijoi edhe vështirësi e kontradikta kolosale për klikën. Ekonomia sovjetike ra, prestigji i Bashkimit Sovjetik shkoi poshtë deri në këmbë, «miqtë» e tij e lanë njëri pas tjetrit, aleancat morën forma dhe përmbajtje krejt kapitaliste, shtypëse, formale e qesharake. Rezistenca kundër klikës u shtua nga të gjitha anët. Për të mos folur për arenën ndërkombëtare, grupi Brezhnjev-Kosigin brenda ndodhet në mes shumë zjarreve, që hajde i shuaj! Intelktualët, shkrimtarët, studentët revizionistë kanë shtuar manifestimet e tyre dhe klika e Kremlinit është e detyruar t'i arrestojë dhe t'i burgosë. Pra, burgjet dhe kampet janë mbushur plot me revolucionarë po e po, por edhe me kundërrevolucionarë të rinj.

Revolucioni proletar në Bashkimin Sovjetik, sigurisht, do të organizohet dhe do të ngrihet. Kësaj ia ka frikën shumë klika dhe e godet, përpiqet ta gënjejë, ta neutralizojë sa të jetë e mundur, ta mbajë me iluzione partinë e klasës dhe vetë klasën punëtore se gjoja ajo dhe partia e saj «leniniste» udhëheq, se «çdo gjë ecën sipas vijës leniniste dhe normave leniniste» etj. Në krijimin e këtyre iluzioneve duhet të futim edhe ato gjoja «mendime realiste historike» për Stalinin që disa gjeneralë dhe mareshalë karrieristë, të degjeneruar, janë vënë të shkruajnë, për t'u hedhur hi syve masave dhe revolucionarëve të vërtetë. Por revolucionarët bolshevikë dhe klasa punëtore sovjetike nuk do të gënjehen për shumë kohë. Ata gjithnjë e më qartë po shohin se në realitet në fuqi është një klikë renegatësh dhe administrata e saj bu-

rokratike antipunëtore, partia është shndërruar në një parti borgjeze dhe diktatura është diktaturë borgjeze e klasës së re kapitaliste, e cila shtyp masat dhe klasën punëtore, i shfrytëzon ato ekonomikisht në interes të borgjezisë së re revizioniste, nuk i lë ato për asnjë çast të manifestojnë forcën dhe të drejtat e tyre. Përpjekjet e revizionistëve për ta bërë klasën punëtore apolitike, për ta zhdukur nga skena politike dhe për ta orientuar drejt ekonomizmit, do të dështojnë.

Pra, siç po shohim, të gjitha këto procese kanë tipare të njëjlojta, tani më të dukshme e më të bujshme në Çekosllovakia, në Poloni, nesër edhe në Hungari e gjetkë. Nga këto procese do t'i hapet më tej oreksi inteligjencies reaksionare revizioniste sovjetike dhe do të asistojmë kështu në përleshje jo vetëm në mes kësaj dhe klikës, por edhe në mes inteligjencies së moderuar dhe ekstremistëve të djathtë të saj, në mes inteligjencies së vërtetë marksiste-leniniste kundër klikës dhe këtyre dy tendencave që thamë. Dhe, më në fund, Ivani rus do të zgjohet nga gjumi i rëndë, klasa punëtore sovjetike, e udhëhequr nga revolucionarët marksistë-leninistë duhet të zbresë dhe do të zbresë në rrugë për të thënë fjalën e vet. Ajo do t'i bjerë tavolinës me grusht dhe do të hyjë në revolucionin e dytë proletar. Ne jemi të bindur se kjo do të ngjasë meoemos, procesi dialektik do të bëhet, rrethanat, ngjarjet dhe zhvillimi i tyre do ta pjekin situatën. Kur? Kjo nuk mund të caktohet nga ne.

Nga i gjithë ky zhvillim i ngjarjeve në vendet revizioniste, i taktikave, i formave e i metodave të

luftës që bëjnë revizionistët modernë kundër mark-sizëm-leninizmit, kundër diktaturës së proletariatit, klasës punëtore, partisë së saj dhe regjimit socialist, përveç sa kemi analizuar edhe herë të tjera, Partia jonë ka përcaktuar edhe detyra të qarta që të mos lejojë kurrë që revizionizmi modern, ose çdo sëmundje tjetër antimarksiste, të prekë trupin dhe mendjen e shëndoshë të partisë dhe të diktaturës së proletariatit në vendin tonë.

Lidhur me degjenerimin revizionist në disa vende duhen vënë në dukje disa karakteristika tipike, të ngjashme në partitë revizioniste.

Klasa punëtore në radhë të parë, dhe pastaj gjithë masat punonjëse është fakt se u kapën në befasi, nuk reagues imediatisht dhe me forcë kundër tradhtisë që iu bë çështjes së tyre të madhe, të fituar dhe të konsoliduar me aq gjak dhe sakrifica nga ana e tyre. Elementët tradhtarë që uzurpojnë fuqinë në parti dhe në shtet, jo vetëm në fillim të veprimtarisë së tyre minuese që dinë të fshihen dhe të organizohen, por edhe më vonë, kur qëndrimet dhe veprimet e tyre tradhtarë janë bërë të dukshme, nuk ndeshin në një rezistencë të ashpër nga ana e klasës punëtore dhe e partisë së saj, të cilat, përkundrazi, pranojnë pa kundërshtime të mëdha zgjedhën e tradhtarëve, ose edhe kur reagojnë, reagojnë dobët. Partia dhe klasa punëtore, në radhë të parë, i kanë humbur vigjilencën dhe ashpërsinë e dhunës që i karakterizon dhe duhet t'i karakterizojë kurdoherë në luftën e klasave, në luftën kundër çdo armiku të tyre dhe të socializmit.

Pse ngjet kjo dhe ç'e krijon këtë apati, këtë shuarje të vigjilencës dhe të përdorimit të dhunës, jo vetëm në partitë komuniste me një stazh revolucionar të vogël, por edhe në partinë më të vjetër e më të madhe dhe me një stazh kolosal revolucionar, siç ishte Partia Bolshevike?

Në përgjithësi, arsyet që e kanë sjellë këtë gjendje nuk janë gjëra misterioze, as të panjohura, por në këtë artikull do të theksojmë disa arsye që na duken nga më kryesoret dhe nga më të rrezikshmet për një parti marksiste-leniniste.

Le ta shikojmë këtë çështje në Partinë Bolshevike, në partinë më të vjetër e më revolucionare, nga të mirat dhe gabimet e së cilës kemi mësuar të gjithë.

Para së gjithash dhe mbi të gjitha është çështja e partisë. Këtu duhet të përqipemi të gjejmë të metat dhe gabimet, që ndikuan kaq tragjikisht në daljen e revizionizmit dhe në marrjen e pushtetit nga ana e tradhtarëve hrushovianë në Bashkimin Sovjetik.

a) Çështja e edukimit politik-ideologjik të Partisë Bolshevike, dhe kjo mund të duket çudi, nuk u bë në të gjitha etapat me atë temp dhe në atë thellësi që kërkonin momentet. Një edukim i tillë, përveç të tjerave, vuajti nga format, nga metodat, por disa herë edhe nga brendia. Megjithëse thuhej, prapë lidhja e teorisë me aksionin revolucionar në praktikë nuk bëhej sa duhej dhe si duhej në të gjithë gamën e saj, për të vënë nga të gjithë në plan të parë politikën në drejtimin e revolucionarizimit të njerëzve, në mbajtjen gjallë të frymës revolucionare proletare të të gjithë partisë, në kuptimin dhe në zbatimin nga të

gjithë dhe për çdo gjë në frymë revolucionare të vijës së partisë. Është e vërtetë që në qoftë se kishte shkolla, kurse, forma, mjete, metoda etj., për t'u edukuar politikisht dhe ideologjikisht, kishte në Bashkimin Sovjetik. Kështu mund të themi edhe për përgatitjen dhe edukimin e kuadrove. Këtu nuk është çështja se në Bashkimin Sovjetik u la pas dore studimi i teorisë së pagabueshme marksiste-leniniste-staliniane, porse diçka bëri që edukimi politik-ideologjik të çalonte. Dhe kjo diçka nuk janë vetëm format, metodat dhe tempi, të cilat, siç u tha më sipër, ndikuan në mospërvetësimin dhe në moszbatimin si duhej në jetë të teorisë. Ka edhe një kompleks gjërash të tjera që kontribuan negativisht.

b) Zbatimi i normave të Partisë Bolshevike, ose më mirë të themi kuptimi i thellë ideologjik dhe politik i tyre dhe zbatimi në mënyrë revolucionare në jetë, nuk ishte në lartësinë e duhur. Të gjitha këto norma ishin të drejta, i krijoi e i vendosi me një luftë gjigante Lenini, ato i afirmoi, i mbrojti dhe i zbatoi Stalini. Por në jetë, gjatë procesit të zhvillimit, gjatë punës dhe luftës, ne shohim që këto norma edhe të zbatohen drejt, edhe të zënë pluhur e ndryshk dhe, më në fund, të bastardohen dhe të kthehen në një armë të rreptë dhe shumë të rrezikshme në duart e armiqve të klasës dhe të partisë, siç ngjau në të gjitha partitë revizioniste. Në këto parti flitet me të madhe për centralizmin demokratik, por ai nuk është më leninist; flitet për kritikë dhe autokritikë «bolshevike», por ato nuk janë më bolshevike; flitet për disiplinë partie, por ajo nuk është më disiplinë leniniste, por

fashiste; flitet për moral proletar, por morali është borgjez, antiproletar, antimarksist; flitet për shfaqje të lirë mendimesh në parti, për çdo gjë dhe për cilindo, por shfaqja e mendimeve në frymën e partisë, në frymën proletare, atje tani të çon në burg dhe në kampe përqendrimi, e kështu me radhë për të gjitha normat e vërteta leniniste të partisë. Pra, normat zyrtare, pavarësisht nga maskat, janë antileniniste, janë borgjeze, reaksionare, fashiste. Një kthesë e tillë nga normat leniniste, që përbëjnë forcën e partisë si organizatë e çeliktë e pararojës së proletariatit, në norma revizioniste, është e keqja më e madhe për një parti marksiste-leniniste, është arma e tmerrshme e degenerimit të partisë, e shthurjes së saj, e largimit të saj nga roli historik i transformimit të shoqërisë. Fakt është se kjo kthesë regressive, në këtë çështje, është bërë në Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe në partitë e tjera revizioniste dhe pavarësisht se jo të gjithë komunistët sovjetikë i aprovojnë dhe u binden këtyre normave antileniniste, është e padiskutueshme që normat revizioniste aktualisht sundojnë në këtë parti dhe në parti të tjera revizioniste dhe po i shkallmojnë partinë dhe socializmin në këto vende.

Tani mund të vëmë pyetjen: Në qoftë se politika dhe ideologjia marksiste-leniniste do të ishin kuptuar dhe zbatuar drejt, siç thamë më sipër, në qoftë se normat leniniste të partisë, të vendosura në Partinë Bolshevike nga klasikët e mëdhenj Lenin-Stalin, do të qenë zbatuar drejt, në mënyrë revolucionare, në çdo kohë, a do të ngjiste kjo që ngjau? Jo! Nuk do të ngjiste! Por ja që ngjau, dhe ngjau për ato që u

thanë më lart dhe për këto që do të themi edhe më poshtë.

c) Partia komuniste, si reparti pararojë e i organizuar i klasës punëtore, duhet të jetë, ajo e para, maja e mprehtë e shpatës; të ruajë, të zhvillojë dhe të kalitë vetitë më të mira të klasës punëtore; të përvetësojë e para si duhet dhe ta zbatojë si duhet ideologjinë e klasës punëtore, marksizëm-leninizmin; të jetë e para vigjilente në kulm dhe e papërkulur ndaj armikut të klasës. Dhe që të jetë kështu, duhet të ketë, të kuptojë dhe të zbatojë ato norma leniniste që e bëjnë atë parti të klasës, për të udhëhequr klasën dhe aleatët e saj drejt qëllimeve të klasës. Kjo përbën një unitet të madh jo të çfarëdoshëm, por atë që ne quajmë unitet marksist-leninist, unitet marksist-leninist brenda në parti, unitet mendimi dhe veprimi në bazë të normave leniniste në mes bazës së partisë dhe udhëheqjes, unitet në udhëheqje vetë, unitet marksist-leninist të çeliktë në mes partisë dhe klasës punëtore, unitet të çeliktë, të harmonishëm parti-klasë punëtore-popull. Dhe në të gjithë këtë unitet ideja themelore, baza dhe siguria e tij, është uniteti parti-klasë punëtore, është udhëheqja vendimtare e klasës punëtore me partinë e saj në krye, të frymëzuara, të kalitura, të ndriçuara nga ideologjia e saj marksiste-leniniste.

Ky unitet nuk krijohet në një ditë, as në një vit. Kalitja e tij kalon nëpërmjet shumë luftërash dhe rreziqesh që i vë përballë armiku i klasës, i cili përdor çdo mjet, objektiv dhe subjektiv, politik dhe ideologjik, shtypje dhe terror, masa shtrënguese dhe turbullira ekonomike, korrupsionin e hapur dhe punën

minuese ilegale kundër klasës punëtore në përgjithësi, kundër partisë si organizatë, kundër anëtarëve të partisë e funksionarëve të shtetit, ose të organizatave të masave në veçanti.

Nuk do të zgjatemi në këto çështje vetëm do të theksojmë se ruajtja e unitetit dhe kalitja e tij nuk janë një gjë e arritur përgjithmonë dhe komunistët të flenë mendjen; e dyta, uniteti në rrugën social-demokrate, unitet «shokësh», jashtë parimeve dhe normave marksiste-leniniste të partisë, «uniteti për të mos i prishur qejfin njërit ose tjetrit, pale të cenohen normat dhe parimet», nuk është uniteti ynë. Uniteti ynë nuk është unitet për unitet, jashtë parimeve. Prandaj, uniteti ynë, në gamën e madhe që përmendëm, krijohet me luftë, kalitet me luftë dhe ruhet me luftë të vazhdueshme dhe konsekuente revolucionare. Ndryshe nuk mund të ekzistojë unitet marksist-leninist.

Në Partinë Bolshevike të Lenin-Stalinit ka ekzistuar uniteti, luftohej energjikisht për ta kalitur këtë unitet, por nuk mund të thuhet se në çdo gjë ishte arritur perfeksioni, pasi atëherë do të mohohej lufta e klasave, brenda dhe jashtë vendit, brenda radhëve të partisë, do të harrohej armiku i klasës që bën një luftë të ashpër në të gjitha format dhe që ka për qëllim të vetëm të shkallojë unitetin, të infiltrohet në organizmat e partisë dhe të diktaturës, për t'i krimbur dhe për t'i shpartalluar ata, për t'u futur në ndërgjegjen dhe në pikëpamjet e komunistëve, për t'i demoralizuar e për t'i degjeneruar ata.

Pra, në Partinë Bolshevike të Lenin-Stalinit — dhe këtë e vërtetojnë sukseset në ndërtimin e socia-

lizmit, në ndërtimin e shtetit të parë e të fuqishëm socialist në botë — po ecej në rrugën e drejtë leniniste dhe Stalini, në krye të Partisë Bolshevike, luftoi drejt, me energji, me kuptim të thellë dhe teorikisht e politikisht pa gabim në rrugën e klasës punëtore, në rrugën e partisë leniniste, në normat e saj, për realizimin e qëllimeve të klasës dhe të partisë së saj, që ishin ndërtimi i socializmit dhe i komunizmit në Bashkimin Sovjetik dhe në botë.

Mirëpo vihet pyetja: Kur qenka kështu, atëherë përse pas vdekjes së Stalinit Partia Bolshevike degjeneroi në një parti revizioniste? Kjo është një pyetje e ligjshme që duhet vënë dhe për shpjegimin e së cilës duhen gjetur arsyet objektive dhe subjektive. E kemi thënë edhe në shkrime të tjera se kjo është një çështje sa e rëndësishme aq edhe e vështirë të bëhet e plotë e pa gabime, pa u bazuar në dokumentet, sidomos të brendshme, të Partisë Bolshevike, që ne nuk i kemi dhe vështirë t'i kemi, sidomos në këto situata. Por ideologjia jonë dhe eksperiencia e Partisë sonë dhe e partive të tjera mund të na ndihmojnë për të përcaktuar disa nga këto arsye. Themi disa, pasi ka dhe duhet të ketë shumë. Por edhe këto mendime mund të mos jenë të plota.

Duke e shtruar problemin siç e vumë më lart, pak nga pak, pa u ndier dhe duke u bazuar në sukseset e mëdha të realizimit të ndërtimit socialist, u krijua në kuadrot e partisë dhe të shtetit socialist njëfarë vetëkënaqësie dhe krenarie e ligjshme, por që, pada-shur dhe pa kuptuar, nga format latente, ato trasheshin, deformoheshin në prirje jo të drejta dhe jo

në rrugën e moralit proletar. Ideologjia dhe edukata marksiste, në parim dhe në praktikë, i dënonin këto kur shfaqeshin në mënyrë flagrante dhe të rrezikshme, por në formën e përgjithshme ato zhvilloheshin dhe kjo konsiderohej si një gjë jo e rrezikshme, pleksej me normat e partisë, dhe dalngadalë u jepte edhe atyre një ngjyrë të tillë. Kjo do të trashej më vonë dhe, e pleksur me shprehi të tjera joproletare, do të ndihmonte kompleksin e rrezikshëm.

Anëtarët e Partisë Bolshevike që u udhëhoqën në beteja legjendare nga Lenini dhe Stalini, kuadro me origjinë klase dhe me hov revolucionar, të kalitur në revolucion, në luftëra, në ndërtimin e socializmit, në luftëra kundër trockizmit, kundër deviatorëve dhe tradhtarëve të tjerë, u kalitën politikisht dhe ideologjikisht dhe krijuan një besim të patundur dhe të ligjshëm për Partinë e tyre Bolshevike të lavdishme, për Leninin, për Stalinin, për vijën dhe normat e drejta që përcaktonin këta.

Për ta partia ishte gjithçka, ishte zemra, truri dhe sytë e tyre, prandaj ata e mbronin, edukoheshin prej saj dhe prej udhëheqësit të tyre të madh. Por, ndërsa përpiqeshin të zbatonin vijën dhe normat e drejta të partisë me Stalinin në krye, te kuadrot sovjetikë, në fillim jo të gjithë e në mënyrë jo të qartë, por dalngadalë, kjo shkoi duke u shtrirë dhe duke u kristalizuar, filloi të lindë ndjenja e stabilitetit, që është e huaj në kuptimin revolucionar të zhvillimit. Sa kohë kishin funksione të ulëta, kuadrot punonin me zell për t'i shërbyer sa më mirë çështjes së revolucionit, duke zbatuar me rigorozitet normat dhe vijën e par-

tisë, duke mbajtur lidhje të ngushta me masat dhe me klasën punëtore. Por me kalimin e kohës, me kapërcimin e vështirësive, me fitimin e arsimit dhe të kulturës së nevojshme dhe të domosdoshme ideopolitike dhe të përgjithshme, me kalimin e moshës dhe me rritjen e stazhit në parti, filloi të lindë te disa edhe krimbi i së keqes. Sukseset në punë ushqyen ndjenjën e vetëkënaqësisë dhe tok me këto, në kuadrot sovjetikë humbiste thjeshtësia proletare; filluan të rriten pretendimet jo të drejta, të cilat i quanin «politikisht të ligjshme», sepse kishin punuar dhe luftuar. Me ngritjen në përgjegjësi kristalizohej në ta ndjenja e rehatisë dhe e komoditetit dhe gjithnjë e më shumë molepseshin nga burokratizmi, intelektualizmi dhe teknokratizmi. Kështu, gradualisht, midis kuadrove të Partisë Bolshevike dhe të shtetit sovjetik, nga njëra anë, dhe masave të popullit sovjetik e klasës punëtore, nga ana tjetër, u krijua një shkëputje dhe disnivel. Shumë kuadro nuk dëgjonin si më parë zërin e masave, në ta gjithnjë më shumë mbizotëronte mendimi se çdo gjë e dinin vetë, për çdo gjë ishin specialistë, politikisht e ideologjikisht qëndronin mbi masat, mbi klasën punëtore dhe shihnin më larg se ato. Autoritetin dhe prestigjin që gëzonin Partia Bolshevike dhe Stalini në masat e popullit sovjetik e në klasën punëtore këta kuadro i konfondonin me autoritetin dhe prestigjin e tyre. Të gjitha këto tipare antiproletare deformuan konceptet revolucionare në këta kuadro, të cilët infektuan edhe vijën e partisë e zbatimin e saj, normat revolucionare të partisë mbetën formale, vetë jeta e partisë dhe organizimi i saj,

si dhe gjithë administrata shtetërore sovjetike, po sklerozoheshin.

Prandaj, edukimi, pajisja me arsim e kulturë e kuadrove të partisë, të shtetit dhe të administratës është një problem nga më të rëndësishmit, por në radhë të parë është një detyrë akoma më e madhe edukimi i tyre politik dhe ideologjik dhe revolucionarizimi i tyre i përhershëm.

Rreziku i burokratizimit të kuadrove dhe pajisja e tyre vetëm me arsim e kulturë mund dhe krijon në ta ndjenjën e epërsisë e të mendjemadhësisë, bën që të zënë rrënjë tek ata tiparet e intelektualizmit dhe të teknokratizmit, që progresivisht i vënë mbi masën e partisë dhe klasën dhe krijohet kështu, dalngadalë, gjendja që një shtresë sundon klasën dhe partinë e saj proletare, sklerozon partinë dhe normat e saj revolucionare, i bën këto pa jetë, i propagandon pa zell, u heq dhe i zhvesh ato nga ndikimi dhe veprimi i tyre revolucionar. Këtej rrjedh shkëputja nga masat, nga klasa punëtore dhe drejtimi i saj.

Në rast se partia dhe klasa punëtore nuk tregojnë kujdesin e veçantë e të vazhdueshëm në ngritjen ideopolitike të kuadrove dhe jo vetëm me metodat libeske, por me veprime në jetë dhe në luftë të përditshme e të pandërprerë, ngritja e tyre në pozita drejtuese, disniveli arsimor dhe kulturor i tyre me masën e madhe të partisë dhe me atë të klasës punëtore, stazhi i vjetër në parti, ose në funksione shtetërore, disniveli i madh i rrogave (një e keqe kjo e rrezikshme) dhe privilegjet se gjoja janë kuadro (një tjetër e keqe e rrezikshme) e prishin kuadrin, e shtyj-

në atë të adaptojë progresivisht, me dashje ose pa dashje, tiparet jo të klasës proletare. Një fenomen i tillë mund t'u ngjasë edhe kuadrove me origjinë e me gjendje punëtore, por ky rrezik është më i madh për ata që vijnë nga fshatarësia dhe nga shtresa e inteligjencies. Partia e klasës punëtore duhet t'i edukojë kuadrot në mënyrë që ata të përparojnë dhe të ngrihen në përgjegjësi, por që të kuptojnë drejt kur është nevoja edhe zbritjen e tyre nga përgjegjësitë, jo vetëm në rastet kur nuk tregohen të aftë dhe aktivë për funksionin që u është ngarkuar ose për gabime në punë e në jetë, por edhe në rastin kur janë të aftë dhe e kryejnë detyrën e tyre me korrektësi. Kuadrot duhen edukuar që të kuptojnë se edhe kur janë në rregull, largimi i tyre nga funksionet me përgjegjësi dhe vajtja e tyre me punë në gjirin e klasës punëtore dhe të masave punonjëse është një nevojë, është në të mirën e vetë kuadrove dhe të Partisë, për sot dhe për të ardhmen.

Të tria tiparet që përmendëm më sipër — burokratizmi, intelektualizmi dhe teknokratizmi — bënin që në Partinë Bolshevike dhe në shtetin sovjetik të mos ndihej si duhej ajo frymë revolucionare e kohëve heroike. E gjithë kjo frymë e sëmurë nuk atakonte hapur vijën e drejtë të partisë, kuadrot u qëndronin besnikë asaj dhe Stalinit dhe hidheshin në zjarr për të, pasi Stalini ishte njeri i klasës, ai, me kthjelltësinë e tij marksiste-leniniste të klasës, nuk bëri gabime parimore, as në politikë, as në ideologji, as në ekonomi, as në fushën ushtarake. Ai mbrojti me besnikëri çdo gjë leniniste, e zhvilloi më tej leninizmin.

Mirëpo në këtë amulli që u krijua gradualisht, megjithëse energjia staliniane e partisë dhe e diktaturës së proletariatit prapë e çonte punën përpara, puna e partisë, megjithatë, sklerozohej, normat zbatoheshin, por jo me hov revolucionar, vija zbatoheshin, por jo me atë temp revolucionar, marksizëm-leninizmi mësohej, por nuk përdorej që t'i spastronte këto prirje të rrezikshme. Shumë kuadro të lartë dhe të mesëm të partisë dhe të shtetit, të mësuar me diploma, e shikonin gjendjen nga lart, dhe sidomos nga ndjenja mikroborgjeze e epërsisë nga çdo pikëpamje. Ata krijuan një pikëpamje, sikur kjo të ishte diçka e natyreshme, se janë eprorë mbi masën e partisë, ata merrnin tiparet e një klase mbi klasën dhe mbi partinë, e quanin veten të pagabueshëm pasi ishin në udhëheqje, pasi kishin stazh, pasi kishin dituri dhe ishin ata që bënë shiun dhe diellin. Të gjitha këto pikëpamje antimarksiste zhvilloheshin, dashur padashur, të mbuluara me normat e partisë, flitej për centralizëm demokratik, për kritikë e autokritikë, për disiplinë partie, për zgjedhje nga poshtë-lart, por të gjitha këto e kishin humbur shpirtin revolucionar. Dhe ç'mund të sillte e gjithë kjo? Shkëputjen dalngadalë të udhëheqjes nga masa e partisë dhe të partisë nga klasa punëtoare. Pra, në esencë, dobësohej ai unitet marksist-leninist që përmendëm më lart. Stalini ishte farkëtari i unitetit leninist dhe i ruajtjes së tij, me gjithë amullinë që ekzistonte. Pas vdekjes së tij u vërtetua se në udhëheqje dhe në Partinë Bolshevike u çua uniteti dhe revizionistët morën fuqinë.

Hrushovi dhe shokët e tij tradhtarë kishin punuar sa qe gjallë Stalini, natyrisht në formë shumë të maskuar. Pas vdekjes së tij, duke përfituar nga kjo gjendje e krijuar, morën fuqinë, u përpoqën dhe përpiqen që gjithë procesin negativ ta ruajnë dhe ta thellojnë më tepër, duke bërë transformimin e plotë drejt kapitalizmit dhe drejt likuidimit të Partisë Bolshevike të Lenin-Stalinit. Sulmi kundër Stalinit ishte sulmi kundër leninizmit, kundër marksizëm-leninizmit. Prandaj, hoqën dhe po heqin qafe ata që i quajnë stalinistë dhe, nën maskën se gjoja janë leninistë, përpiqen që procesin e likuidimit të partisë si parti marksiste-leniniste e proletariatit ta thellojnë çdo ditë e më shumë dhe klasën punëtore sovjetike ta izolojnë, ta nanurisin, ta bëjnë amorfe dhe apolitike, për të evituar goditjet që mund t'u japë ajo.

Natyrisht, ka edhe shkaqe të tjera, por mendojmë se këto që thamë bënë që klasa punëtore e Bashkimit Sovjetik dhe me qindra mijë e me miliona kadro sovjetikë të partisë dhe të shtetit u gjendën në befasi, menduan dhe mendojnë (se nuk janë aq të ngritur politikisht dhe ideologjikisht dhe kjo s'duhet të na çuditë) se ajo që bëri Hrushovi ishte «në rrugë dhe sipas rregullave leniniste», u gënjyen nga shpifjet, nga demagogjia dhe nga premtimet e tradhtarëve, por me siguri kjo nuk do të zgjatë për shumë kohë. Klasës punëtore dhe revolucionarëve sovjetikë po u hapen dhe do t'u hapen më mirë sytë dhe ata do ta fitojnë përsëri shpirtin sulmues të luftërave revolucionare, nëpër të cilat i kanë udhëhequr Lenini dhe Stalini. Ata duhet të zbresin me armë në dorë në rrugë dhe

do të zbresin, në mos sot, nesër. Situatat do të piqen. Koha punon për revolucionin proletar.

Edhe në partitë e tjera revizioniste ka ngjarë ky proces, por akoma më i thellë, për arsye se partitë e vendeve revizioniste, përveç partisë polake, janë parti që nuk kanë bërë luftën, nuk kanë kaluar nga ajo furrë, pavarësisht se i bëjnë shumë reklamë vetes si gjoja të vjetra, si gjoja që kanë luftuar. Bagazhi i tyre në këtë çështje — dhe kjo është çështja kryesore — është shumë i paktë, për të mos thënë aspak.

Përveç kësaj, këto parti u ringjallën, u riorganizuan, morën pushtetin në sajë të ushtrisë sovjetike dhe të ndihmës direkte të Partisë Bolshevike dhe të Stalinit. Kjo ishte një ndihmë jetike për to jo vetëm se ato u rimëkëmbën materialisht, por u ndihmuan që të krijohej kohezioni politik-ideologjik në gjirin e tyre. Pastaj në këto parti, si në atë polake, gjermane, çekosllloake, hungareze etj., u bë bashkimi organizativ, politik, ideologjik i partisë komuniste dhe i partisë socialiste e socialdemokrate. Kështu që krimbi socialdemokrat, në vend që të qëndronte jashtë në front, u fut brenda në parti. Iu hodh ujë vorës dhe kjo gjoja verë tani është kthyer në uthull. Këto parti socialdemokrate të Ciriankeviçit, të Oto Grotevilit, të Firlingerit, derisa ishte gjallë Stalini, heshtnin, por punonin brenda, gërryenin, demoralizonin, zinin pozita të rëndësishme sa mundnin.

Kur erdhi Hrushovi në fuqi, filloi gëzimi i natyrshëm. Më vonë filloi shkëputja, por shkëputja rrënjësore, pasi degjenerimi kishte zënë rrënjë të thella

në këto parti dhe në këto vende. Në rast se marksist-leninisti Gotvald nxori punëtorinë të armatosur në rrugë dhe e bëri reaksionin të dridhej dhe të futej në vrima, tani revizionisti Dubçek një pjesë të klasës punëtore çekosllovake e ka në anën e tij. Kështu ngjet në Hungari, por jo tërësisht në Poloni, pasi klasa punëtore polake ka tradita më revolucionare. Por lufta për të fituar klasën punëtore dhe për ta ngritur atë në revolucion duhet të jetë objektivi kryesor i çdo partie marksiste-leniniste. **Revolucion proletar pa klasë punëtore dhe pa udhëheqjen e partisë marksiste-leniniste nuk ka dhe nuk mund të ketë.**

Studentët dhe intelektualët duhet të ngrihen në revolucion dhe të udhëhiqen nga klasa punëtore dhe partia marksiste-leniniste, por edhe e kundërta mund të ngjasë, siç po bëjnë revizionistët, në qoftë se ata nuk vihen në vendin që u takon në revolucion dhe në rast se nuk edukohen drejt në rrugën revolucionare. Rinia asnjëherë nuk mund të marrë dhe të kryejë detyrat dhe rolin që historia ia ka ngarkuar klasës punëtore. Kudo, në çdo gjë, klasa punëtore dhe partia e klasës duhet të jenë në ballë, në udhëheqje absolute. Fshatarësia dhe shtresat e ndryshme shoqërore duhet të ecin në rrugën e klasës punëtore në aleancë me të, të edukohen me ligjet dhe me ideologjinë e saj dhe kush nuk ecën në këtë rrugë dhe vë gurë në rrota, duhet të skartohet, me bindje o me dhunë, sipas rastit.

Në dritën e gjithë këtyre që thamë, dalin edhe më në pah rruga dhe vija e drejtë marksiste-leniniste që ka ndjekur Partia jonë në të gjitha etapat e

zhvillimit, edhe në momentet më kritike, besnikëria e saj e pakufishme ndaj ideve dhe veprës revolucionare të Marksit, të Engelsit, të Leninit dhe të Stalinit. Por Partia jonë ka mbajtur kurdoherë parasysh se asnjë parti komuniste, pra edhe ajo vetë, nuk është e imunizuar nga rreziku i revizionizmit, ajo ka mbajtur kurdoherë të mprehtë vigjilencën kundër këtij rreziku, kurrë nuk ka fjetur mbi dafina. Ajo ka grumbulluar dhe përpunon çdo ditë një eksperiencë të pasur se si t'u pritët rruga revizionizmit dhe rivendosjes së kapitalizmit. Masat që ka marrë Partia për revolucionarizimin e mëtejshëm të të gjithë jetës së vendit, për perfeksionimin dhe për zhvillimin e marrëdhënieve socialiste në prodhim dhe të superstrukturës, për t'i spastruar ato nga çdo gjë e huaj, janë me rëndësi vendimtare e jetike për çështjen e socializmit.

Ajo ka zhvilluar dhe zhvillon në rrugë të drejtë marksiste-leniniste, brenda dhe jashtë Partisë, luftën e klasave, që është forca lëvizëse gjatë gjithë periudhës së kalimit nga kapitalizmi në socializëm, i ka dhënë rëndësi të dorës së parë edukimit klasor revolucionar të punonjësve, e veçanërisht të brezit të ri, në forma të ndryshme, sidomos nëpërmjet aksionit revolucionar, ka zhvilluar dhe zhvillon një luftë parimore e konsekuente kundër çfarëdo shtrembërimit burokratik, për thellimin e vazhdueshëm të vijës së masave në të gjitha fushat, për perfeksionimin e pareshtur të demokracisë socialiste. Mbi të gjitha, i është kushtuar vëmendje e veçantë revolucionarizimit të pareshtur të Partisë e të kuadrove të saj, në mënyrë që këta

kurrë të mos shkëputen nga populli, të mos humbasin tiparet dhe frymën revolucionare, të mos burokratizohen dhe të mos degjenerojnë.

Partia kurdoherë e ka pasur parasysh veprimin dialektik të faktorëve të ndryshëm me të gjitha ndikimet e tyre pozitive e negative. Ajo ka zbatuar e zbaton në thellësi masa të gjithanshme revolucionarizimi, edukimi, punë e luftë në të gjitha frontet dhe këto bëjnë një mori problemesh, të vogla e të mëdha, të gjitha të rëndësishme dhe të gërshetuara ngushtë me njëra-tjetrën, sidomos në frontin e edukimit ideologjik klasor dhe të luftës së klasave. Prandaj, luftën ajo e ka vazhduar dhe e vazhdon frontalisht, pa ndërprerje, kurdoherë në ngjitje, duke mësuar gjithnjë nga sukseset dhe nga të metat, në mënyrë që të metat të mos përsëriten dhe sukseset të mos e dehin e ta vënë në gjumë. Në këtë rrugë të drejtë marksist-leniniste Partia dhe populli ynë ecin me besim të patundur në ndërtimin e socializmit e të komunizmit.

Në kushtet e sotme, kur klikat revizioniste po likuidojnë në vendet e tyre plotësisht të gjitha fitoret e socializmit, klasa punëtore e këtyre vendeve duhet ta ketë të qartë se partia revizioniste në fuqi nuk është më parti e proletariatit, por një vegël në duart e udhëheqjeve tradhtarë për rivendosjen e kapitalizmit, për të mashtruar masat. Sot nuk ka më vend për iluzione, ngurrime e pritje. Klasa punëtore e vendeve revizioniste ndodhet tani përpara domosdoshmërisë historike që të zbresë përsëri në fushën e betejës, të hidhet në një luftë të pamëshirshme e gjer në fund konsekuente për përmbysjen dhe për

shpartallimin e klikave tradhtare, për të kryer edhe një herë revolucionin proletar, për të rivendosur diktaturën e proletariatit. Kjo kërkon patjetër vendosmëri, guxim, sakrifica, ripërtëritjen e shpirtit dhe të traditave revolucionare të kohëve të Leninit e të Stalinit. Kjo kërkon në radhë të parë e mbi të gjitha, organizimin e revolucionarëve të vërtetë në parti të reja marksiste-leniniste, të cilat të mobilizojnë, të organizojnë dhe të udhëheqin në fitore kryengritjen e përgjithshme të proletariatit dhe të masave të tjera punonjëse.

Në këto momente të rëndësishme për fatet e revolucionit, të gjithë marksistë-leninistët dhe proletariati botëror nuk mund të heshtin dhe të bëjnë sehir për ato që po ndodhin në vendet revizioniste. Internacionalizmi proletar kërkon nga të gjithë revolucionarët të ngrenë zërin dhe të zhvillojnë luftë parimore deri në fund për shpartallimin e klikave revizioniste në fuqi dhe t'u japin gjithë përkrahjen klasës punëtore dhe popujve që ndodhen sot në sundimin revizionist, për t'i përmbysur këto klika tradhtare dhe për të ngritur përsëri flamurin e revolucionit e të socializmit.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit»; nr. 72 (6111), 24 mars 1968

Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1968-1970», f. 56

NJË KRIZË E THELLË E GJITHANSHME PO TRONDIT BOTËN KAPITALISTE

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

31 mars 1968

Kriza e përgjithshme politike dhe ekonomike e sistemit kapitalist botëror po thellohet. Politika e sundimit botëror, e agresionit dhe e luftës, e ndjekur me tërbim nga imperializmi amerikan, po dështon. Kjo u detyrohet hovit revolucionar të popujve, zhvillimit të stuhishëm të luftës revolucionare që ka shpërthyer kudo, me armë dhe në forma të tjera, luftës heroike të popullit të Vietnamit, luftës nacionalçlirimtare të armatosur të popujve kundër imperializmit amerikan dhe aleatëve shërbëtorë të tij.

Kriza e botës kapitaliste, siç po paraqitet sot, është e shumanshme dhe shkaktohet nga kontradikta të thella antagoniste politike, ekonomike, sociale e ushtarake. Shenjat e saj ka kohë që janë dukur në vendet kryesore kapitaliste.

Politika hegjemoniste dhe agresive e imperializmit amerikan, që shoqërohet me shpenzime shumë të mëdha ushtarake brenda dhe jashtë vendit, për-

bën një nga shkaqet kryesore të krizës së rëndë që ka pllakosur botën kapitaliste. Paktomania e Dallesit, e përforcuar nga ajo e Kenedit dhe tani e Xhonsnit, dhe e përkrahur nga tradhtia e revizionistëve hrushovianë, nuk u qëndroi dot hovit revolucionar të popujve dhe luftës së tyre për çlirim. Për të vendosur sundimin e vet, imperializmi amerikan krijoi baza ushtarake kudo në botë, shpërndau forcat e veta nga të katër anët. Është e njohur se SHBA mbajnë të shpërndarë nëpër botë mbi 1,5 milion ushtarë. Kjo jo vetëm ka ngjallur një urrejtje të ligjshme ndaj këtij xhandari ndërkombëtar e armiku të egër të lirisë së popujve, por ka rënduar jashtëzakonisht shumë buxhetin amerikan, ka rënduar popullin amerikan me tatime, ka rritur jashtë masës deficitin e bilancit të pagesave të SHBA-së dhe ka shkaktuar një inflacion të madh të dollarit. Ekonomia amerikane është futur thellë në binarët e militarizimit dhe gara e tmerrshme e armatimeve përpin rreth 1/4 e prodhimit kombëtar vjetor. Shpenzimet ushtarake të SHBA-së arritën në rreth 70 miliardë dollarë në vitin 1967. Vetëm për luftën në Vietnam, që ka hapur një të çarë të madhe dhe gërryen pa pushim burimet financiare e materiale të imperializmit amerikan, SHBA shpenzojnë rreth 30 miliardë dollarë në vit. Për të përballuar shpenzimet kolosale ushtarake, u hodhën shuma të mëdha dollarësh në qarkullim dhe sasia e tyre, brenda dhe jashtë Amerikës, arriti përpjesëtime të pashembullta. Në këto kushte vlera e dollarit nuk mund të sigurohet më me ar, por mbahet me zor, me kërcënime e me shantazhe politike, ekonomike e ushtarake.

Imperializmi amerikan, si qen roje, për politikën e vet hegjemoniste të xhandarit ndërkombëtar duhej të financonte me armë e me kredi, natyrisht në forma të rënda shfrytëzuese, edhe qen roje të tjerë, klika dhe xhelatë popujsh, të cilët, me ndihmën e SHBA-së, të frikësonin popujt e tyre, t'i rripnin këta në interesin e padronit të vet. Imperializmi amerikan hodhi në dorë tregjet e Perandorisë Britanike, e vuri këtë nën varësinë e tij ekonomike, politike dhe ushtarake. Por njëkohësisht ai trashëgoi edhe gjithë vështirësitë që e brenin me kohë këtë perandori të krimbur, e cila do të kribë edhe vetë perandorinë e re botërore të fashistëve janki. Në të gjitha anët e botës, ku sundojnë kapitalistët, dhe veçanërisht atje ku ndihen më shumë ndikimi e zgjedha amerikane drejtpërdrejt apo tërthorazi, ka lëvizje, pasiguri, paqëndrueshmëri të madhe. Në këto vende ka kriza të çdollojta, që nga uria, papunësia dhe deri në konflikte të hapëta me armë. Popujt ngrihen në luftë kundër tiranëve. Vendet kapitaliste, të ashtuquajtura aleate, përleshën me njëri-tjetrin për interesa ekonomiko-politikë. Klikat shpërthejnë puçe kundër klikave për të vendosur diktaturën fashiste, për të shtypur lëvizjet, grevat, liritë demokratike etj.

Kjo gjendje e rëndë është pasojë dhe njëkohësisht shprehje e thellimit me furi të krizës së përgjithshme të kapitalizmit. Natyrisht, Anglia, hallka më e dobët në zinxhirin e të ashtuquajturave fuqi të mëdha imperialiste, ishte e para që u godit më shumë nga kjo krizë. Fuqia ekonomiko-politike e imperializmit anglez u dobësua shumë dhe mori tatëpjetën.

Kapitali monopolist francez, që mblodhi këmbët me kohë dhe u lehtësua nga disa detyrime e vargonj amerikanë (politikë, ekonomikë e ushtarakë), për interesat e hegjemonisë së tij, po ia përplas në fytyrë me «këmbëngulje» dyert e Tregut të Përbashkët Evropian Anglisë e, tërthorazi, edhe SHBA-së. Franca po u nxjerr pengesa SHBA-së, Anglisë, Kanadasë dhe partnerëve të tyre në NATO. Ajo përpiqet të dalë nga kriza pa shumë dhimbje, por këtë nuk do ta arrijë dot.

Imperializmi amerikan, për të lehtësuar barrën e tij të rëndë të shpenzimeve kolosale financiare, materiale e në njerëz që i kushton lufta kundër popujve, dhe sidomos lufta në Vietnam, u përpoq pa sukses të madh të tërhiqte në aventurat e tij partnerët e NATO-s dhe të gjitha klikat në shërbim të tij. Shumica dërrmuese e anëtarëve të kësaj organizate agresive i bënë bisht presionit amerikan dhe kontributi i tyre për shpenzimet ushtarake në NATO është i pjesëshëm. Me përjashtim të Gjermanisë Perëndimore, kontributi i së cilës është më i madh pas atij amerikan, pasi NATO-ja është në interesin e saj dhe të SHBA-së, të tjerët, në llogari të fundit, më shumë marrin ndihmë ushtarake sesa japin. Është e vërtetë se buxhetet e tyre ushtarake përpijnë shuma kolosale, që pasurojnë në radhë të parë manjatët e armëve të SHBA-së. Por Shteteve të Bashkuara të Amerikës u intereson mbi të gjitha që partnerët e tyre të jenë krejtësisht të bindur dhe nën diktatin e tyre të plotë. Këtë rrjedhin edhe kontradiktat e thella në gjirin e tyre që shkaktojnë «revolta» dhe të çara.

Franca që e para që «ngriti krye» dhe praktikisht doli nga NATO-ja. Kjo ishte një sëmundje ngjitesë për partnerët e tjerë, të cilët, edhe nëse nuk lëvizin akoma si Franca, janë duke u dredhur si peshqit në ujë për t'i shpëtuar, në një mënyrë ose në një tjetër, darës amerikane. Korrente politike anti-amerikane, në mos të hapëta, të nëndheshme, po krijohen dhe këto shfaqen në mënyra të ndryshme, duke i bërë presione e kërkesa plotësuese kredish ekonomike dhe ushtarake daj Samit, duke eksportuar kapitalet e veta në vende «të pazhvilluara», duke investuar kapitale në vendet ku sundojnë revizionistët dhe ku po bëhet rivendosja e plotë e kapitalizmit dhe, më në fund, duke u bërë Shteteve të Bashkuara edhe presione politike.

Kontradiktat e shumta antagoniste politike e ekonomike, të grumbulluara për shumë kohë në gjirin e botës kapitaliste, shpërthyen krizën e sistemit monetar kapitalist ndërkombëtar. Bota kapitaliste po jeton tani krizën më serioze financiare gjatë 40 vjetëve të fundit dhe i gjithë sistemi imperialist po kërcënohet nga goditja më e fuqishme ekonomike që ai ka pësuar pas krizës ekonomike të viteve 1929-1933. Kjo është rezultat i procesit të kalbëzimit e të shturjes së imperializmit, i ecjes me ritme të shpejtuara drejt shembjes së tij të plotë.

Sterlina angleze krisi dhe u zhvlerësua në një të shtatën. Ditët dhe javët e para këtë krizë monetare bota kapitaliste u përpoq ta paraqiste si një fenomen të izoluar anglez dhe të zonës së sterlinës. Natyrisht, ky ishte një bluf për të fshehur ethet që i kishin

zënë të tërë, pasi kriza e sterlinës nuk mund të ishte e shkëputur nga ajo e dollarit dhe e monedhave të tjera më të dobëta, dhe bile të varura shumë prej dy të parave.

Pas zhvlerësimit të sterlinës zhvlerësuan, nga 8-20 për qind, monedhën e tyre edhe njëzet e ca vende të tjera kapitaliste. Ky zhvlerësim nuk i lejoi Anglisë të nxirrte përfitimin e dëshiruar në bilancin e tregtisë së jashtme, duke pakësuar importin nga këto vende dhe duke shtuar eksportin. Mbi këtë bazë do të acarohen edhe më tej kontradiktat e konkurrenca midis kapitalit monopolist anglez dhe kapitalit të këtyre vendeve. Imperializmi amerikan, meqenëse ka humbje në këtë disfatë angleze, i mobilizoi forcat imperialiste të vendeve të tjera për t'i ardhur në ndihmë Anglisë, por është në pamundësi ta mbajë në këmbë sterlinën, e cila po rrokulliset akoma më shumë teposhtë.

Paniku i zhvlerësimit të sterlinës goditi rëndë e drejtpërdrejt edhe mbi dollarin amerikan. Filloi nga të katër anët një vërshim i papërmbajtur dhe i paparë në histori, për sa u përket përpjesëtimeve, mbi arin, për kthimin e dollarëve në ar, ndërsa besimi te dollari si «i gjithfuqishëm» është tronditur në mënyrë të pandreqshme. Franca kërkoi edhe një herë zyrtarisht zhdukjen e pozitave të privilegjuara të dollarit amerikan në sistemin monetar të botës kapitaliste.

Në këto kushte imperializmi amerikan lëshoi alarmin. Ra boria. Ai filloi manovrat që, për të mbrojtur dollarin, të bëjë kursime, të shtojë taksat, të pakë-

sojë investimet jashtë vendit, të kufizojë numrin e turistëve amerikanë etj. Zyrtarisht u deklarua se këto kursime do të arrijnë shumën vjetore prej 3 miliardë dollarësh.

Këto masa të qeverisë së Xhonsnit shkaktuan alarm në financat dhe në buxhetet e Anglisë, Francës, Italisë, Spanjës, Bencluksit¹, Vendeve Skandinave, Jugosllavisë, Greqisë dhe vendeve revizioniste gjithashtu, që me tradhtinë e tyre kujtuan se «zbuluan Amerikën». Ky është fillimi i tërmetit!

Vendet kapitaliste të Evropës sigurojnë të ardhura të konsiderueshme nga turistët amerikanë. Ngushtimi i këtij burimi do të shkaktojë krizë, papunësi, dhe jo vetëm në këtë degë, por edhe në ato degë ose sektorë të industrisë e të bujqësisë që janë të lidhur ngushtë me turizmin. Bashkimi Sovjetik dhe vendet e tjera revizioniste po lëpinin buzët nga këto të ardhura, për llogari të të cilave ngrinin kështjella mbi rërë me ndihmën «bujare» të daj Samit të tyre. Tani ato mbetën me gisht në gojë. Si pasojë, edhe në këto vende do të shtohen çrregullimet ekonomike e deziluzionet.

Por kriza e turizmit amerikan, e vendit më të pasur kapitalist, do të kufizojë patjetër, bile shumë, daljen e turistëve edhe nga vetë vendet kapitaliste. Po t'i hedhim një sy gjendjes në Angli, do të shohim se ajo sa vete e po e shtrëngon rripin e popullit, po përpiqet të frenojë rrokullisjen e sterlinës, duke shtrenjtuar jetën e masave dhe jo më të mendojë që

¹ Belgjikës, Holandës dhe Luksemburgut.

të nxitë zhvillimin e turizmit anglez jashtë shtetit. Atëherë merret me mend se ç'do të ngjasë në Jugosllavi e gjetkë në vendet ku sundojnë revizionistët, ku valuta e turistëve kapitalistë pritet si një mjet çudibërës.

Investimet e kapitalit amerikan zënë një peshë të rëndësishme në shumë vende kapitaliste. Shkurtimi i investimeve në vendet e tjera do të ketë pasoja të mëdha për vetë kapitalin amerikan, që detyrohet të ngushtojë çairin e madh ku livadhiste, por sidomos për ato vende që gjoja përfitonin nga këto investime. Lëre pastaj vendet ku sundojnë revizionistët, të cilët, qëkurse hynë në rrugën e restaurimit të kapitalizmit dhe të integritit në ekonominë botërore kapitaliste, po u vërsuleshin si të uritur kredive e investimeve amerikane. Perspektivë e bukur u hapet atyre! Vështirësitë, papunësia, varfëria, pakënaqësia do të shtohen.

Por edhe këto masa nuk qenë të mjaftueshme për të përmbajtur krizën që i kanoset dollarit. Kërkesat për të grumbulluar ar në tregjet e Londrës e të Parisit, të Zurikut e të Amsterdamit etj. dhe çmimi i arit po rriteshin në mënyrë të rrufeshme. Thesari amerikan përditë i pakësonte rezervat e tij në ar, sepse qeveritë dhe bankat e huaja, për mungesë besimi te dollari kartë, kërkonin kthimin e dollarit në ar. Rezervat amerikane në ar arritën në pikën më kritike të historisë financiare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Përpara kësaj gjendjeje dhe me qëllim që të largonte katastrofën, së paku përkohësisht, qeveria amerikane, nga njëra anë, mori vendim

që të shpenzojë gjithë rezervën në ar për të përballuar kërkesat e qeverive dhe të bankave të huaja për kthimin e dollarit në ar, nga ana tjetër, provokoi një mbledhje urgjente të drejtorëve të bankave qendrore të shteteve kryesore kapitaliste që marrin pjesë në «grupin» e arit për të marrë masa të përbashkëta për shpëtimin e dollarit. Kjo mbledhje vendosi që tregu i arit të ndahet në dy tregje: një për bankat qendrore të «grupit» të arit, në të cilin çmimi i arit do të jetë i pandryshueshëm, 35 dollarë onci, dhe një treg për përdoruesit privatë, në të cilin çmimi i arit do të jetë i lirë, duke iu nënshtruar ligjit kapitalist të kërkesës e të ofertës. Por të gjitha këto masa mund ta shtyjnë afatin e katastrofës për dollarin, por nuk e zhdukin atë. Nga ana tjetër, qysh tani ato e kanë ngritur më shumë tensionin në botën e financës kapitaliste e në marrëdhëniet midis vendeve kapitaliste.

Kriza monetare, frenimi i investimeve amerikane nuk janë të vetmet shenja që paralajmërojnë keqësimin e klimës ekonomike në sistemin botëror kapitalist. Ato do të shkaktojnë patjetër shpërthimin e gjithë zinxhirit në vendet kapitaliste e revizioniste. Shpërthimi goditi sterlinën dhe ka tronditur thellë dollarin; i gjithë qielli i politikës dhe i ekonomisë kapitaliste botërore është mbushur me re të zeza që paralajmërojnë shtrëngatë.

Shenja të tjera në vende të ndryshme kapitaliste e revizioniste tregojnë se konflikte të reja politike, ekonomike e shoqërore, më të acaruara se më parë, po pihen dhe mund të kalojnë e do të kalojnë në përleshje të armatosura. Vatra të tjera lufte agresive

dhe vatra të reja luftërash revolucionare do të shpërthejnë.

Miti i «lulëzimit ekonomik» dhe i «zhvillimit dinamik të kapitalizmit» është shndërruar në një jehonë të mekët, që u sjell ndër mend gjithnjë më shumë punonjësve të vendeve kapitaliste frikën e kobshme e pasiguri për të nesërmen. Për të zbatuar deflacionin monopolet kapitaliste janë gati të rritin numrin e të papunëve në përpjesëtime të papara. Numri i të papunëve në Francë ka arritur në 400 000, në Angli — në 600 000, në Gjermaninë Perëndimore — në 700 000 e kështu me radhë në vendet e tjera kapitaliste. Gjatë vitit 1967 prodhimi i përgjithshëm industrial nuk u rrit fare në Angli e në Gjermaninë Perëndimore, në SHBA ai u rrit vetëm 0,5 për qind, ndërsa në Francë ka tre vjet që ndodhet në amulli.

Kriza monetare dhe e kredisë, amullia në industri, rritja e papunësisë dhe shtimi i përpjesëtimeve të inflacionit janë shenjat e para të krizës së superprodhimit që po kërcënon ekonominë e tregtinë kapitaliste botërore.

Në të gjitha vendet kapitaliste monopolet dhe qeveritë borgjeze po përpiqen që barrën më të rëndë të krizës së re ekonomike t'ua ngarkojnë punëtorëve e masave të tjera punonjëse. Qeveria angleze qysh tani ka shpallur masa drakoniane «kursimi», duke vendosur bllokimin e pagës së punëtorëve, rritjen e taksave dhe shkurtimin e shpenzimeve për nevoja të ndryshme publike, si për arsim, shëndetësi etj. Të njëjtën «rrugë shpëtimi» u bëhet thirrje të ndjekin edhe punëtorëve në SHBA, në Francë e gjetkë. Kudo

punonjësve u kërkohet të shtrëngojnë rripin. Natyrisht, të pasurit do të vazhdojnë të rritin fitimet e të bëjnë qejf në kurriz të të varfërve. Kjo do të bëjë që në vendet kapitaliste e revizioniste të thellohet shtypja dhe të përligjen edhe më shumë kusaria e grabitja. Presioni e kërcënimi amerikan mbi partnerët e tij kapitalistë e revizionistë do të shtohen, kontraktat midis tyre do të thellohen akoma më shumë, kalbësira e regjimit kapitalist dhe e lakenjve të tij revizionistë do të dalë akoma më në shesh dhe politika e tyre hegjemoniste, grabitqare, luftënxitëse do të demaskohet akoma më shumë.

Analiza e drejtë marksiste-leniniste e gjendjes së kapitalizmit dhe e raportit të forcave të klasës nxjerr në shesh se në vendet kapitaliste kryesore po acarohen gjithnjë e më shumë kontraktat klasore, po ecet drejt konfliktesh e luftërash të reja shoqërore, drejt acarimit të kontrastit të interesave midis monopoleve e masave punonjëse. Kjo e rrit edhe më shumë mundësinë e domosdoshmërisë për t'i bashkuar të gjithë punonjësit në një front të vetëm, nën udhëheqjen e klasës punëtore.

Përvoja e derisotme ka treguar se këtë detyrë historike klasa punëtore mund ta realizojë vetëm duke u udhëhequr nga ideologjia revolucionare marksiste-leniniste dhe nga një parti revolucionare me të vërtetë marksiste-leniniste.

Përpjekjet e partive revizioniste në vendet kapitaliste, dhe e gjithë revizionistëve modernë për të zbatuar të ashtuquajturën politikë të «unitetit të veprimit», politikë të së majtës ose program demokratik,

janë një tradhti e hapët ndaj luftës së klasës punëtore, ndaj interesave të saj jetikë e revolucionit proletar dhe një përkrahje për të zgjatur jetën e kapitalizmit, duke u orvatur të shuajnë luftën e klasave.

Revizionistët sovjetikë përpiqen të propagandojnë nga ana e tyre sikur kriza e sotme i përket vetëm kapitalizmit dhe jo atyre, përpiqen të tregojnë sikur vendi i tyre ka shpëtuar nga krizat. Ky është një bluf. Kriza ata i ka mbërthyer në grykë me kohë, që kur tradhtuan komunizmin dhe ecin me hapa të mëdhenj drejt rivendosjes së plotë politike dhe ekonomike të regjimit borgjez kapitalist. Ata janë me kohë në krizë, në çdo sektor të ekonomisë së tyre, dhe, për të mbyllur sadopak plagët e tyre të mëdha, po shesin pasuritë e vendit dhe djersën e popullit të kapitalistët e huaj. Firma «Fiat» e Italisë, me ndihmën e Bankës Amerikane të Eksport-Importit, po ndërton me kredi në Ukrainë një uzinë për prodhimin e veturave. Firma të tjera italiane do të ngrenë në Bashkimin Sovjetik dy fabrika për makina shkrimi e llogaritëse. Monopolet japoneze do të investojnë 800 milionë rubla për shfrytëzimin e bakrit dhe të pasurive të tjera minerale të Siberisë. Kapitali i huaj monopolist po depërton gjithnjë e më shumë edhe në vendet e tjera ku sundojnë klikat revizioniste.

Për shkak të krizës së brendshme, revizionistët sovjetikë nuk kanë qenë në gjendje të investojnë në ekonominë e satelitëve të tyre. Këtë e vërtetojnë shqyerjet në KNER dhe dalja nga duart e tyre e vendeve të ish-demokracisë popullore. Por kriza që po kërcënon sot botën kapitaliste, do t'i futë akoma më

thellë dhe do t'u nxjerrë telashe më të mëdha edhe vendeve të sunduara nga revizionistët, pasi regjimi i tyre, që është kthyer në binarët e kapitalizmit, s'ka si të mos preket e të mos pësojë nga kriza e përgjithshme e sistemit kapitalist botëror.

Kreu i kapitalizmit botëror, imperializmi amerikan, do të shkojë, do të ecë medoemos drejt krizash e tronditjesh më të thella, tok me partnerin e tij kryesor, shtetin revizionist sovjetik. Kontradiktat në mes tyre janë të pashmangshme dhe acarimi i tyre do ta forcojë gjithnjë e më shumë luftën revolucionare të popujve dhe do të dobësojë armiqtë e revolucionit, të socializmit, të paqes e të përparimit.

Vendet revizioniste të Evropës do të jenë në krizë të rëndë. Tradhtarët në këto vende do të gjenden në mëshirën dhe nën presionin e tmerrshëm të revizionistëve sovjetikë e të kapitalizmit botëror. Ata do të vazhdojnë të zvarriten në gjuhë përpara atij që u paguan më shtrenjt për tradhtitë e tyre. Në vendet e tyre do të shtohet degjenerimi politik dhe ekonomik, do të shtohen korrupsioni, varfëria, shfrytëzimi, papunësia etj. dhe do të thellohet e do të plotësohet transformimi i këtyre vendeve në vende kapitaliste, në rast se popujt, e në radhë të parë klasa punëtore atje, nuk do të ngrihen në luftë e në revolucion, nuk do të zbresin në fushën e betejës për të marrë përsëri fuqinë, për të rivendosur diktaturën e proletariatit dhe për të shtypur tradhtinë.

Situata, pra, në botë po ecën në favor të revolucionit botëror, të luftës nacionalçlirimtare të armatosur të popujve kundër imperializmit amerikan dhe

aleatëve të tij — revizionistëve modernë. Zhvillimi i ngjarjeve vërteton plotësisht ato që ka thënë vazhdimisht Partia jonë për imperializmin dhe për revizionizmin; situata aktuale tregon drejtësinë e largpamësinë e vijës së ndjekur nga PPSH. Partia e Punës e Shqipërisë, në rrugën e saj të qartë e të ndritur revolucionare, do të ecë kurdoherë përpara me guxim, me heroizëm, me pjekuri, e vendosur, për të dhënë kontributin e saj në këtë luftë të madhe revolucionare. Imperializmi dhe pjella e tij, revizionizmi, do të varrosen me siguri. Revolucioni proletar do të fitojë medoemos. E ardhmja e botës i përket komunizmit, e vetëm këtij.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 78 (6117), 31 mars 1968

Botohet sipas librit: Enver Hoxha «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1968-1970», f. 86

STUDIMI NDIHMON PËR FORCIMIN E PËRBËRJES KLASORE TË PARTISË

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

8 prill 1968

Si konkluzion, dëshiroj të shfaq edhe unë mendimin tim për studimin që ka bërë Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste. Ky studim, siç thanë edhe shokët që diskutuan, është i mirë dhe do të ndihmojë për ta përmirësuar më shumë punën për pranimet e reja në Parti.

Duhet të kemi parasysh se klasat në vendin tonë po bëjnë vazhdimisht ndryshime. Klasa jonë punëtore është gjithnjë në zhvillim, ajo sa vete rritet, ndërsa fshatarësia si klasë shkon duke u pakësuar. Edhe në shtresën e inteligjencies po bëhen ndryshime. Numri i atyre që punojnë në administratë po pakësohet në krahasim me numrin e njerëzve tanë të mësuar që marrin pjesë direkt në sferën e prodhimit.

1 Në këtë mbledhje u shqyrtua dhe u aprovua studimi «Mbi problemin e përbërjes së klasës punëtore lidhur me pranimet në Parti».

Po në ç'proporcione po zhvillohet klasa punëtore te ne? Si po punohet për edukimin dhe kalitjen ideologjike të kësaj klase që duhet të bëhet boshti i gjithë jetës së shoqërisë sonë socialiste? Si kaliten me ndërgjegjen e klasës të gjithë ata që mbushin vazhdimisht radhët e saj? Cila është pjekuria e punëtorëve që kanë një stazh më të gjatë në punë dhe ç'ndryshime ka me pjekurinë e atyre që kanë afërsisht pesë vjet si punëtorë? Ç'ndryshime kanë në psikologjinë e tyre? Po në qëndrimin ndaj pronës së vogël private a ndryshon mentaliteti i punëtorit që ka pesë vjet stazh nga ai i fshatarit? A ka ndryshime të dukshme midis punëtorëve me stazh të ri dhe artizanëve të qytetit? Cilët janë më të avancuar, punëtorët me origjinë fshatare apo artizanët e qytetit? Këto probleme Partia duhet t'i njohë mirë e të nxjerrë konkluzione për punën e saj, prandaj orientuam që të bëhej ky studim.

Në qoftë se nuk do t'i njohim mirë këto probleme, atëherë nuk do ta kemi të qartë si zhvillohet e si kalitet klasa punëtore dhe, për pasojë, nuk do të dimë se cilët nga elementët e saj duhet të pranohen në radhët e Partisë.

Për ne ka rëndësi të dorës së parë të dimë se ç'kalitje klasore revolucionare kanë punëtorët që do të pranohen në radhët e Partisë. Kujdes i madh duhet pasur në çështjen e stazhit të secilit punëtor. Me këtë, nuk e kam fjalën për të bërë ndryshime tani në kriteret e pranimeve (megjithëse më vonë mund të lindë nevoja që edhe këtë çështje ta shikojmë), por të kemi parasysh te cilët elementë duhet të

drejtohemi për t'i pranuar në Parti, pasi, për shembull, midis dy kandidaturave që kushtet e tjera i kanë të barabarta, por në stazhin si punëtorë mund të ndryshojnë, s'ka dyshim, ne do të preferojmë të pranojmë në Parti atë që ka stazh më të gjatë.

Për pranimet në Parti, si rregull, pra, ne duhet të orientohemi, në radhë të parë, tek ata që kanë stazh më të gjatë si punëtorë. Por, natyrisht, këtë kriter nuk duhet ta marrim në mënyrë mekanike dhe kaq thjesht, pse mund të ndodhë që një njeri të ketë me të vërtetë 10 vjet, ose edhe më shumë stazh si punëtor, e megjithatë të mos e ketë ndërgjegjen e klasës. Por mund të ndodhë edhe e kundërta, që të ketë, dhe në fakt ka, edhe nga ata punëtorë me stazh më të shkurtër, bile edhe prej një viti, të cilët kudo që kanë qenë janë dalluar dhe kanë punuar kurdoherë mirë si aktivistë shoqërorë, kanë zbatuar me konsekuencë e me besnikëri vijën e Partisë, pra kanë disa cilësi që i bëjnë të shquhen nga të tjerët dhe për këto arsye ne i pranojmë në Parti. Prandaj, kur vjen puna për të bërë pranimin në Parti, qoftë edhe të një punëtori, çështja e tij duhet parë konkretisht, duhet studiuar secili individ më vete. Gjersa një njeri ka hyrë të punojë në një uzinë, pavarësisht se vjen nga fshati ose nga radhët e inteligjencies, me gjendje ai është punëtor, sikur edhe një vit të ketë në punë. Është pastaj çështje tjetër se në ç'shcallë ka arritur ndërgjegjja e tij si punëtor; po ta meritojë, ai mund të futet në Parti më parë, edhe pa mbushur 5 vjet si punëtor.

Është e drejtë, siç parashikon studimi, që të kon-

siderohet e mjaftueshme koha e punës prej 5 vjetësh në një ndërmarrje për ta quajtur punëtor, por, kur vjen puna për të bërë pranime në Parti, në asnjë rast të mos vihet si kusht që një njeri, vetëm pse ka mbushur pesë vjet stazh si punëtor, të pranohet automatikisht në Parti. Partia duhet ta ketë syrin, në radhë të parë, tek ata që kanë një stazh më të gjatë si punëtorë. Te këta elementë të klasës punëtore, me stazh më të gjatë, ne do të kemi siguri më të madhe për përmirësimin e përbërjes klasore të Partisë dhe për futjen e frymës së klasës në Parti sesa te një fshatar ose te një ish-intelektual që ka 5 vjet stazh si punëtor në një ndërmarrje, pse te këta akoma nuk është formuar plotësisht ndërgjegjja e klasës punëtore. Konkluzionet e këtij studimi, lidhur me këtë problem, të interpretohen drejt e të mos zbatohen në mënyrë mekanike.

Punëtorë janë gjithashtu edhe ata që prej shumë vjetësh punojnë në miniera, në sharra, në ndërtim etj., dhe familjet vazhdojnë t'i mbajnë në fshat, por që vetë janë të gatshëm të vendosen në mënyrë të përhershme në qytet, kur u jepet shtëpi dhe u gjendet punë për gratë. Mund të na thuhet se punëtorë të tillë që nuk janë shkëputur akoma nga fshati, kanë mbeturina. Kjo është e vërtetë, por duhet pasur parasysh se mbeturinat në ndërgjegje ata i kanë shumë më të pakta se fshatarët ose se gratë e tyre që s'kanë lëvizur fare nga fshati, sepse atje ku kanë punuar prej kaq vjetësh, në gjirin e klasës punëtore, kanë marrë patjetër një edukatë më të shëndoshë, pse tjetër është karakteri i punës në fshat dhe tjetër ai i

punës në radhët e klasës punëtore. Njerëz të tillë, pra, në fakt janë punëtorë, se kanë punuar në gjirin e klasës dhe janë edukuar me frymën e saj. Megjithatë, Partia e ka për detyrë që të gjithë, qoftë fshatarin, qoftë intelektualin, ashtu sikurse edhe punëtorët, t'i kalitë dhe t'i edukojë vazhdimisht me ndërgjegjen e klasës punëtore.

Këtë studim ne e porositëm se na duhej për të parë si po zhvillohet në numër dhe në stazh klasa jonë punëtore, si edukohet dhe si bëhet kalitja ideologjike e saj. Kjo na intereson shumë, se klasa punëtore duhet të ushtrojë influencën e saj në të gjitha shtresat e tjera të popullsisë, duhet të bëhet boshti i gjithë punës edukative, i gjithë jetës së shoqërisë sonë.

Në studim thuhet se mund të quhet punëtor edhe minatori, edhe ai që punon në bitum, edhe shitësi i një dyqani. Mirëpo puna e shitësit nuk është njëlloj me punën e minatorit. Gjithashtu edhe punëtori i bitumit me të vërtetë bën punë të rëndë, por ama rron jashtë në ajër të pastër, rreth e përçark vendit të punës mund të ketë edhe lule, pemë e gjelbërime, ai gjen edhe ujë pranë, ku mund të lajë duart sa herë të dojë, kurse puna e minatorit, që punon thellë nën tokë, ndryshon krejt. Ne patjetër dhe kurdoherë duhet të kemi parasysh mirë ndryshimet në shtresat e ndryshme që përbëjnë klasën punëtore, kalitjen e njerëzve të secilës shtresë, qëndrimin e tyre ndaj punës, ndaj prodhimit, ndaj pronës së përbashkët, ndaj pagave etj. Duhet të kemi parasysh sidomos tezat e njohura të Leninit, si dhe realitetin e gjallë

tonin për këtë çështje dhe atëherë na bëhet e qartë se punëtori i tregtisë, sikur edhe 10-15 vjet në punë të ketë, vështirë se e arrin nivelin e ndërgjegjes klasore të punëtorit të minierës.

Për pranimet në Parti ka gjithashtu rëndësi edhe origjina shoqërore. Ne tani në Parti kemi akoma pak njerëz me origjinë punëtoare, për arsye se klasa punëtoare në vendin tonë para Çlirimit nuk ka ekzistuar në atë shtrirje dhe në atë masë që e kemi sot. Atëherë ajo ka qenë shumë e kufizuar në numër, kurse tani, me zhvillimin e gjithanshëm të vendit, sa kalon koha dhe rritet. Kjo do të sjellë përmirësimin e vazhdueshëm të përbërjes së Partisë edhe për sa i përket origjinës punëtoare. Natyrisht, për vendosjen e disa kriteve për përcaktimin e origjinës kërkohet një studim i veçantë, i kujdesshëm.

Në qoftë se arrijmë në përfundimin, për shembull, që vajza ose djali i një qytetari që para Çlirimit ka qenë zanatçi, duhet të konsiderohet me origjinë punëtoare dhe nuk quajmë të tillë djalin e një tjetri që pas Çlirimit ka 15-20 vjet si punëtor, nuk veprojmë drejt. Në çdo rast, si për djalin dhe vajzën e zanatçiu të paraçlirimit, të punëtorit apo të intelektualit që ka kaluar në prodhim, duhet parë me kujdes stazhi i babait si punëtor.

Tani ne kemi arritur në një stad kur klasa jonë punëtoare ka fituar njëfarë stazhi, prandaj duhet të studiojmë dhe të caktojmë se cilët nga fëmijët e punëtorëve tanë mund të quhen me origjinë punëtoare. Kushtet dhe mentalitetet e njerëzve sot te ne, natyrisht, ndryshojnë për mirë nga e kaluara, pse edhe

vajza ose djali i fshatarit apo i intelektualit, ashtu si edhe ai i punëtorit, edukohen me frymën e Partisë, por sidoqoftë djali dhe vajza e punëtorit, duke qenë me origjinë punëtore, e kanë shumë më të zhvilluar ndjenjën e klasës nga djali ose vajza e fshatarit apo e intelektualit. Megjithatë kjo çështje duhet studiuar dhe perfeksionuar më tej.

Me pak fjalë, këtë studim mendoj ta pranojmë, se është i drejtë, i mirë. Ai, pra, duhet të na shërbejë në të gjitha çështjet që përmenda dhe jo vetëm për statistika dhe për ta futur pastaj në sirtar. Shokët e Partisë në rrethe duhet ta studiojnë e ta shfrytëzojnë atë edhe për çështjen e pranimeve në Parti, natyrisht siç thashë, jo në mënyrë automate, por lidhur me kushtet e tyre konkrete, duke u qëndruar kurdoherë besnikë normave të Statutit të Partisë dhe udhëzimeve të dërguara herë pas here nga Komiteti Qendror.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP

ORGANIZATAT-BAZË TË PARTISË TË JENË KURDOHERË TË GJALLA, LUFTARAKE, VETËVEPRUESE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

8 prill 1968

Ndërtimi i Partisë në këtë formë siç e kemi sot në ndërmarrjet e në kooperativat bujqësore, me një organizatë-bazë të përgjithshme të ndarë në organizatë-bazë sipas sektorëve, ka qenë i pranueshëm për kushtet e deritanishme, por tani kushteve të reja që janë krijuar duhet t'u përgjigjemi me masa të reja organizative në ndërtimin e Partisë, me qëllim që organizatat-bazë të jenë kurdoherë të gjalla, luftarake, vetëvepruese.

Kooperativat bujqësore i kemi pasur të ngritura në bazë fshati, kështu që as numri i komunistëve, as

1 Në këtë mbledhje, sipas rendit të ditës, u diskutua për heqjen e organizatës-bazë të përgjithshme të ndarë në organizata sektori, si hallkë e tepërt, dhe për shndërrimin e organizatës së Partisë të sektorit në organizatë-bazë.

territori nuk bëheshin pengesë për të funksionuar mirë organizata-bazë e përgjithshme e Partisë, por tani që janë bashkuar shumë kooperativa bujqësore dhe ky proces po vazhdon, organizata-bazë e përgjithshme e Partisë nuk mund ta ketë më dinamizmin që i duhet për të udhëhequr. Në qoftë se organizata-bazë e përgjithshme ka 60-70 komunistë, ajo do ta ketë të vështirë të mbledhet një herë në muaj. Edukimi i komunistëve nuk mund të bëhet duke u mbledhur një herë në katër muaj, nga dy orë, gjatë të cilave flasin vetëm zyrtarët. Nga praktika del se në mbledhjet e organizatës-bazë të përgjithshme, ku marrin pjesë 60-70 komunistë, diskutimet janë të pakta. Ne shkojmë në aktivet e Partisë të rretheve, ku marrin pjesë njerëzit më të ngritur, dhe shohim se mbas 3-4 orëve kanë diskutuar vetëm 10 veta; e si mund të jetë e gjallë e luftarake jeta e Partisë në një organizatë të madhe në kooperativat bujqësore, ku komunistët i kemi më pak të ngritur? Po këtë mund të themi edhe për ndërmarrjet, të cilat kanë ardhur duke i zgjeruar sektorët prodhues dhe organizata e Partisë është rritur në numër e ka një shtrirje më të gjerë.

Numri i madh i komunistëve të një organizate-bazë të përgjithshme dhe territori i hapur që mbulon ajo, po sjellin vështirësi në jetën dhe në veprimtarinë e kësaj organizate. Nga ana tjetër, vetë këto organizata të përgjithshme, duke vazhduar të mbajnë të gjitha kompetencat, po bëhen pengesë që të rritet roli i organizatave-bazë të Partisë në sektorë, të cilave u kemi lënë kompetenca të kufizuara.

Si konkluzion, edhe unë jam dakord me shokët

që paskëtaj të kemi vetëm organizatat-bazë të Partisë të ndërtuara në bazë prodhimi dhe territori. Natyrisht, po të na mbetet një organizatë partie me katër anëtarë, atëherë mund të bëhet bashkimi i dy sektorëve, për të krijuar një organizatë-bazë më të madhe që të mund të bëjë një jetë më aktive.

Me shpërndarjen e organizatës-bazë të përgjithshme na del problemi se kush do ta udhëheqë e do ta koordinojë punën e organizatave-bazë brenda një kooperative bujqësore ose ndërmarrjeje. Mund të kemi byro apo komitet partie, kjo varet nga numri i komunistëve që kanë kooperativa bujqësore, ndërmarrja apo uzina, por ne duhet të ecim nga parimi që këto hallka të mos bëhen pengesë për të penguar vetëveprimin e organizatave-bazë. Në qoftë se do të na duhet të kemi një byro në shkallë kooperative ose ndërmarrjeje, asaj ne duhet t'i caktojmë disa kompetenca të kufizuara, në mënyrë që të mos dalë mbi organizatat-bazë dhe të mos pengojë iniciativën e tyre. Nuk duhet të krijohet mendimi te njerëzit sikur janë këta 4-5 veta të byrosë që mbajnë tërë përgjegjësinë e punës së Partisë në bazë dhe të gjitha lidhjet me komitetin e Partisë të rrethit. Asnjë shkelje e parimit të centralizmit demokratik nuk bëhet në qoftë se do t'u japim këtyre byrove disa kompetenca më të kufizuara.

Jam i mendimit që kjo byro të ketë këto kompetenca:

1) Të drejtojë, të organizojë dhe të kontrollojë gjithë punën që bëhet për edukimin ideopolitik të organizatave-bazë të Partisë. Kjo të jetë një nga detyrat

kryesore të byrosë që do të zgjidhet nga mbledhja e përgjithshme e komunistëve.

2) Të përgatitë mbledhjen e aktivitetit të komunistëve një herë në vit dhe të çdo aktiviteti të zgjeruar me karakter partie, sa herë që ta lypë nevoja. Këtë gjë ajo ka mundësi ta bëjë, pse është në dijeni të problemeve dhe ka lidhje me organizatat-bazë.

3) Të organizojë dhe të drejtojë, kur paraqitet nevoja, mbledhjet e organizatave të masave për shtruarjen e ndonjë problemi.

Përcaktimi më i mirë i kompetencave për organizatën-bazë dhe për byronë e kooperativës ose të ndërmarrjes do të bëjë që të rritet më shumë roli i tyre. Detyra kryesore e byrosë do të jetë të udhëheqë e të koordinojë drejt e me pjekuri punën e organizatave-bazë të Partisë në shkallë ndërmarrjeje ose kooperative bujqësore, duke synuar që të rritet në mënyrë të vazhdueshme roli i tyre. Kjo kërkon punë të kualifikuar nga ana e byrosë, kërkon që ajo të arrijë t'i njohë problemet e organizatave-bazë dhe të jetë në gjendje t'u vijë në ndihmë aty ku kanë dobësitë më të mëdha.

Një detyrë e rëndësishme e byrosë është puna që duhet të bëjë ajo me direktivat. Ne jemi të ndërgjegjshëm se në mjaft organizata-bazë ka vështirësi, për të kuptuar e për të zbatuar direktivat, prandaj kërkohet që byroja t'i kushtojë një vëmendje të veçantë kësaj çështjeje. Duke pasur edhe ndihmën e të deleguarit të komitetit të Partisë, byroja të shtrojë, të komentojë, të japë çdo shpjegim për direktivat që i vijnë nga organet më të larta të Partisë, si dhe të

bëjë çdo sqarim që do t'i kërkohet nga organizatat-bazë. Pra, anëtarët e byrosë duhet të jenë njerëz kompetentë.

Grumbullimin dhe përpunimin e eksperiencës mendoj se duhet ta bëjnë vetë organizatat-bazë, dhe, tok me to, e rëndësishme është në këtë çështje edhe puna e sekretarëve të tyre. Pra, komunistët duhet të mblihdhen të diskutojnë e të shkëmbejnë mendime me njëri-tjetrin për probleme që i preokupojnë. Kjo do të japë mundësi që organizata-bazë të vetëveprojë, të jetë aktive dhe komunistët të jenë kurdoherë në krye të punëve. Byroja e ka për detyrë ta njohë eksperiencën e organizatave-bazë, që të jetë në gjendje të nxjerrë konkluzione e të bëjë përgjithësime të saj. Po si do ta njohë? Format e punës janë të shumta, por ne duhet t'u japim rëndësi të veçantë atyre formave që e mbajnë byronë e kooperativës ose të ndërmarrjes në lidhje të gjalla e të vazhdueshme me organizatat-bazë. Kjo është kryesorja, e jo të na ndodhë që byroja vetëm t'i thërrisë ato në raport. Natyrisht, kur kjo e gjykon të arsyeshme, edhe e thërret organizatën-bazë, por në këto raste kërkohet një punë e menduar mirë që më parë. Përse do ta thërrisë? Cili është problemi më i rëndësishëm që e preokupon këtë ose atë organizatë? Si do ta ndihmojë që ajo të përgatitet mirë për analizën në byro? Kjo analizë, kur përgatitet mirë, ndihmon organizatën-bazë, diskutimet dhe detyrat që i vë byroja i hapin horizont për ta pasuruar eksperiencën e saj, njëkohësisht edhe byroja vetë ndihmohet, nxjerr detyra për ta bërë të njohur këtë eksperiencë. Por kjo formë pune në asnjë më-

nyrë nuk duhet mbivlerësuar, se ka rrezik të burokratizohet byroja. Byroja duhet të ketë kujdes që t'i aktivizojë të gjithë anëtarët e saj, t'i ngarkojë me detyra e t'u kërkojë llogari si i kanë zbatuar, t'i dërgojë herë pas here të marrin pjesë në mbledhjet e organizatave-bazë, t'i porositë që të shkojnë të përgatitur, se në organizatë mund të kërkohet edhe mendimi e ndihma e tyre. Anëtari i byrosë ndihmon jo vetëm në mbledhje, por në çdo rast dhe sjell në byro problemet e organizatave-bazë.

Byroja duhet ta luajë rolin e saj drejtues e koordinues në mënyrë të atillë që të nxitë iniciativën e organizatave-bazë dhe në asnjë mënyrë të mos ndodhë që ajo të kthehet në një aparat burokratik që gjoja merr përsipër t'u japë vetë zgjidhje të gjitha punëve dhe në fakt nuk bën asgjë, veçse vë në gjumë organizatat-bazë dhe komitetin e Partisë të rrethit. Organizatat-bazë t'i edukojmë që të punojnë me iniciativë për të zgjidhur vetë shumë probleme dhe të mësohen të mbajnë lidhje të rregullta me komitetin e Partisë, veç lidhjeve që mban byroja e kooperativës ose e ndërmarrjes nga ana e saj. Por kjo detyrë mbetet prapë e zorshme për t'u zbatuar, në rast se komiteti i Partisë nuk e organizon më mirë punën për t'u lidhur me organizatat-bazë, duke ditur çfarë do t'u japë dhe çfarë do t'u kërkojë atyre.

Komiteti i Partisë mund të mbajë lidhje me organizatat-bazë për disa probleme të përgjithshme dhe për të tilla që ato nuk mund t'i zgjidhin dot, e jo të ndodhë që ose të mos dërgojë njeri fare në organizatat-bazë, ose të ndërhyjë për çdo gjë, edhe për

qështjet më të vogla, i nisur nga mendimi se organizatat-bazë bëjnë gabime. Po mirë, në punë e sipër edhe mund të bëjnë gabime, po prej tyre ato do të mësojnë dhe do të forcohen si të punojnë më mirë në të ardhmen.

Në komitetin e Partisë duhet të zhduket mendimi burokratik se nuk ka kohë për t'u marrë edhe me organizatat-bazë të Partisë. Ne duhet ta mësojmë atë që ta thithë eksperiencën jo nëpërmjet 4-5 vetave që janë në byronë e kooperativës ose të ndërmarrjes, por në burim, në organizatat-bazë. Komiteti i Partisë, pra, duhet të mësohet të bëjë një punë të gjallë me bazën, të njohë problemet dhe eksperiencën e organizatave-bazë dhe jo vetëm çfarë i thonë anëtarët e byrosë ose sekretari i organizatës, të cilët ndonjëherë edhe nuk informojnë si duhet.

Byroja duhet të ushtrojë kontrollin e saj në formë të ndryshme edhe mbi administratën e ndërmarrjes ose mbi kryesinë e kooperativës për të parë se si i kryejnë detyrat e ngarkuara dhe jo të bjerë në ujdi me to. Kjo e fundit do të evitohet në qoftë se shokët e komitetit të Partisë të rrethit, kur shkojnë në bazë, nuk do të takohen vetëm me drejtorin dhe me sekretarin e byrosë. Natyrisht, edhe këta do t'i takojnë e do t'i dëgjojnë, por ne duhet të insistojmë për të marrë takime direkte me komunistët dhe punonjësit e thjeshtë dhe për këtë byroja të mos bëhet barrikadë. Pra, byroja as të mos bëhet ortake me kryesinë e kooperativës apo me drejtorinë e ndërmarrjes, as thjesht ndërlidhëse e organizatave-bazë me komitetin e Partisë të rrethit. Ky i fundit, nga

ana e tij, të mos shqyrtojë dhe të mos vendosë vetëm për çka raporton byroja, por më parë të marrë dhe mendimin e bazës.

Nomenklatura e kuadrit në kompetencë të byrosë duhet të jetë shumë e shtrënguar. Në qoftë se mendojmë të ngremë një punëtor në përgjegjësi, këtë, si në punë dhe në jetën shoqërore, më mirë se kushdo tjetër e njeh organizata-bazë, prandaj ajo duhet të vendosë për të. Në rast se del nevoja për t'u konsultuar edhe me byronë, këtë organizata-bazë mund ta bëjë, po anëtarët bëjnë vetë pjesë në organizatën-bazë, kështu që mendimin e tyre ata mund ta shfaqin më mirë aty.

Jam i mendimit se duhet të ndryshojë edhe metoda e punës së sekretarëve të organizatave-bazë. Sekretari duhet të ketë një kuptim të qartë për detyrën e tij. Ka nga këta që mendojnë sikur ata janë Partia, janë vija, sikur janë çdo gjë dhe harrojnë bazën e Partisë. Po të mendohet kështu, dashur padashur, krijohet pikëpamja se po të mos jetë diku sekretari, atje nuk është Partia, prandaj edhe na ndodh që ndonjë sekretari të organizatës-bazë i rritet mendja. Ai sekretar që mendon kështu nuk ka parasysh se edhe drejtori, edhe kryeinxhinieri i ndërmarrjes janë po aq të besuar sa edhe vetë sekretari i organizatës-bazë dhe më shumë kompetentë në punën e tyre.

Sekretari i organizatës-bazë duhet t'i njohë problemet e ndërmarrjes qysh nga më të voglat e deri te më të mëdhatë, duhet të njohë, po të jetë e mundur, një për një ç'mendojnë komunistët dhe masa e punëtorëve për këto probleme, ç'vështirësi kanë,

çfarë propozojnë, ç'forca fizike e krijuese ka kolektivi etj., dhe të punojnë që organizata-bazë e Partisë të jetë kurdoherë në krye të punës për zgjidhjen e tyre. Por kjo kërkon që sekretari i Partisë të jetojë e të punojë me masën, t'i nxitë mendimin e ta dëgjojë dhe jo të mbyllet në «treshen» drejtor-kryetar i komitetit profesional-sekretar partie, siç po ndodh, se kjo praktikë pune, po nuk e shkulëm nga rrënjët aty ku ndodh, të çon në krijimin e «elitës» së ndërmarrjes ose të institucionit dhe, sipas tyre, është kjo «treshë» që vendos, këta të tre janë ndërmarrja, janë kolektivi, kurse të tjerët në organizatë dhe në kolektiv le të flasin, ata askush s'i dëgjon.

Ne duhet të luftojmë që organizata-bazë e Partisë të bëhet e gjallë, të veprojë me iniciativë dhe, që të bëhet e tillë, duhet ta mësojmë si të punojë. Çështjen se si komiteti i Partisë do t'i mbajë praktikisht lidhjet me organizatat-bazë, ne nuk duhet ta shikojmë nga ana e formës, por të gjitha lidhjet, udhëzimet, e gjithë puna jonë me organizatat-bazë të kurorëzohet me përgatitjen, aftësimin dhe ngritjen e mëtejshme të gjithë komunistëve.

Në punën tonë ne duhet të ecim duke i pasur gjithmonë parasysh këto parime. Sa të jetë e mundur, ne duhet të kemi kujdes t'i zhdukim hallkat e tepërta, pse këto na sjellin pengesa burokratike dhe ulin hovin revolucionar të masave. Natyrisht ne do të mbajmë vetëm ato hallka që na duhen, ndryshe na rroftë demokracia, vija e masave etj. Partia ka orientuar që të zbatohet kudo vija e masave, por në qoftë se i deleguari i një forumi të lartë të Partisë inte-

resohet të dijë vetëm çfarë thotë sekretari i organizatës-bazë ose byroja e saj, me një fjalë, në qoftë se pyesim vetëm hallkat dhe jo edhe masat, do të thotë se ky orientim nuk është kuptuar drejt dhe praktikisht nuk zbatohet drejt. Kur punëtori shikon se një i deleguar nga lart merr vetëm mendimin dhe përshtypjet e sekretarit ose të byrosë së organizatës-bazë, patjetër, edhe ai do të fillojë të punojë në mënyrë individuale dhe, çka është e rrezikshme, do të fillojë t'i fërkojë krahët sekretarit, duke menduar se ky të ka në dorë. Prandaj për zgjidhjen e problemeve të rëndësishme duhet konsultuar direkt me masën dhe të luftojmë vazhdimisht kundër shfaqjeve të burokratizmit.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP

SHTIMI I PARTISË ME GJAK TË RI DHE QARKULLIMI I KUADROVE REVOLUCIONARIZOJNË PARTINË

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

8 prill 1968

Për sa u përket moshave në Parti, mendoj se duhet të ndërrohet kriteri aktual statistikor, që të na jepet mundësia të orientohemi më drejt në shtimin dhe në përtëritjen e Partisë vazhdimisht me gjak të ri.

Grup-moshat, siç janë caktuar, më duket se nuk na shërbejnë. Caktimi i tyre duhet t'i shërbejë më mirë qëllimit, prandaj mendoj të klasifikohen ndryshe dhe konkretisht: 18-35 vjeç, 36-55 vjeç dhe 56 vjeç e lart.

Në këto tri klasifikime përfshihen: brezi i ri, i mesmi dhe i moshuari. Në mes të këtyre tri grupeve, duke marrë parasysh të gjitha kushtet objektive dhe parimet e normat e Statutit për pranimet, në lidhje me nevojat që krijohen për forcimin dhe zgjerimin e Partisë, duhet të ekzistojnë raporte të drejta balancimi. Që Par-

1 Në këtë mbledhje u diskutua për zbatimin e detyrave të Kongresit të 5-të të PPSH për forcimin e përbërjes së Partisë.

tia të qëndrojë kurdoherë e re, ajo duhet të shihet edhe nga rendimenti, edhe nga mendimi, edhe nga pjekuria. Të rinjtë militojnë në organizatën e rinisë deri në moshën 26 vjeç dhe, megjithëse ka edhe përjashtime, ata zakonisht në këtë moshë pranohen në Parti. Pra, nga 26 e deri në 35 vjeç është një stad kohe prej gati 10 vjetësh në Parti dhe me këtë moshë e me këtë stad, komunisti arrin pjekurinë e plotë, qoftë nga pikëpamja fizike, ashtu edhe nga ajo mendore dhe nga eksperiencia në Parti.

Ky brez i ri e fuqizon Partinë. Në numër ai duhet të jetë i atillë që jo vetëm të plotësojë nevojën e vetë brezit të ri të domosdoshëm dhe të natyrshëm të Partisë, por të parashikojë edhe plotësimin e grupit të mesëm i cili paraprin grupin e të moshuarve. Brezi i ri, pra, është njëkohësisht e ardhmja që fuqizon dhe përtërit Partinë. Grupi i moshës së mesme është ai që lidh komunistët e rinj me të moshuarit. Kurse grupi i moshës së kaluar përbën grupin e komunistëve që kanë një eksperiencë më të madhe partie, pune e lufte. Të moshuarit në Parti janë një thesar, sepse ata edukojnë dhe frymëzojnë të rinjtë. Aftësitë e tyre fizike për punë sa vijjnë e dobësohen dhe kjo është logjike, por në Parti anëtarët e saj militojnë derisa të vdesin.

Përcaktimi i grup-moshave të komunistëve nuk mund të bëhet ekzakt, por orientimi, mendoj unë, duhet të studiohet herë pas here për të kontrolluar si zhvillohet Partia nga një brez në tjetrin dhe këtë të mos ia lëmë spontaneitetit.

Përveç problemit të mësipërm, ka rëndësi që, në

periudha të caktuara, të merren në studim dhe të nxirren konkluzione për stazhin e komunistëve në Parti, për përbërjen e tërë Partisë (në pikëpamje stazhi) dhe për kalimin nga një grup-moshe në tjetrin (kurdoherë në drejtimin e stazhit, të vjetërsisë në Parti, të konsekuencës në vijë e të besnikërisë së komunistëve ndaj Partisë), pastaj edhe brendapërbrenda grup-moshave të komunistëve. Një studim i tillë do të na japë gjendjen reale të kalimit si sasi nga një periudhë stazhi në tjetrën. Vjetërsinë e komunistëve në Parti duhet ta konsiderojmë si një thesar dhe siguri të madhe e të çmueshme të Partisë.

Proporcionet në mes grup-moshave dhe stazhit në Parti duhet të jenë të harmonizuara dhe të zhvilluara në mënyrë dialektike. Po të veprojmë ndryshe mund të lindë rreziku që stazhin në Parti ta shikojmë vetëm për ta përmirësuar në mënyrë thjesht mekanike dhe t'u mbyllim derën të rinjve që kërkojnë të hyjnë në Parti, duke menduar se me pranimin e të rinjve ulim në përqindje stazhin e vjetërsisë. Prandaj këtë çështje duhet ta shikojmë në mënyrë shkencore.

Me punën e saj Partia duhet t'i ruajë kontingjentet e komunistëve, por këto kontingjente duhen përtëritur në proporcione të drejta me gjak të ri, me të rinj e të reja që do të zëvendësojnë të vjetrit, dhe kjo nuk duhet bërë spontanisht. Pra, proporcionet, stazhi dhe mosha e anëtarëve të Partisë duhet të ecin në mënyrë të studiuar.

Njohja dhe studimi i gjendjes së grup-moshave e të stazhit në Parti dhe në punë, përveç çështjeve që

thashë më lart, duhet të na shërbejnë edhe për një problem tjetër shumë të rëndësishëm, për qarkullimin dhe revolucionarizimin e kuadrit.

Ne kemi filluar punën për zbatimin e orientimeve të Partisë për qarkullimin e kuadrit, por të mos shkojmë nga mendimi se qarkullimin e kemi bërë të plotë dhe të studiuar si duhet. Ky problem është i vazhdueshëm. Qarkullimi i kuadrit do ta ketë efektin që kërkon Partia, në rast se nuk bëhet kuturu e me fushata, por i studiuar, shkencor dhe në rrugë marksiste-leniniste, i udhëhequr dhe i diktuar nga parime të shëndosha, duke luftuar pa mëshirë tendencat mikroborgjeze e burokratike në këtë çështje.

Në punën për zbatimin e orientimeve të Partisë për qarkullimin e kuadrit duhet të kemi parasysh disa gjëra:

Së pari, kuadri ose punëtori, nëpunësi, intelektual apo kooperativisti të kenë stazhin e nevojshëm në punë, që të mësojnë mirë zanatin. Kjo kohë duhet të kihet parasysh si për kuadrin që mendohet të qarkullojë, ashtu edhe për punëtorin, kooperativistin etj., që mendohet të ngrihet në përgjegjësi, se ndryshe njerëzit që i qarkullon do të jenë të paformuar, ose të formuar përgjysmë dhe kjo nuk na intereson. Pra stazhi në punë është një kriter.

Së dyti, qarkullimi të lidhet edhe me grupet e moshave. Nuk duhet të lejojmë, për shembull, që të rinjtë të qarkullojnë me vend e pa vend, duke men-
duar vetëm se në këtë moshë e kanë më të lehtë për të përballuar vështirësitë që i dalin kuadrit në fillim kur qarkullon. Kjo është e vërtetë, por, po të

veprojmë pa i pasur parasysh të gjitha kriteret, dëmtojmë kriterin e parë, domethënë nuk u krijojmë atyre mundësi të mësojnë zanatin, prandaj nuk na lejohet të veprojmë pa menduar. Kuadrot e grup-moshës së mesme (36-55 vjeç) kanë edhe moshën më të përshtatshme për qarkullim, edhe stazhin, edhe eksperiencën në punë. Por edhe në qarkullimin e kuadrove të këtij grup-moshe nuk duhet të shkohet pa kriteret të shëndosha, që kuadrot të lëvizin vend e pa vend dhe të mbeten kështu me plaçka në krahë. Atje ku çohet, qoftë duke zbritur vertikalisht, qoftë kur lëvizet horizontalisht, ai dërgohet për t'u kalitur, për të shkundur pluhurin, për të kryer punën e re mirë, për të mësuar ndonjë zanat të ri (dhe llogaritet edhe koha e mësimit të këtij zanati), por mëson edhe të tjerët. Ky është kriteri i dytë.

Së treti, kuadrot e grup-moshës së tretë dhe me stazh të vjetër të qarkullojnë për kalitje, për ripërtëritje dhe për të dhënë ndihmë. Për këta, natyrisht, duhet mbajtur parasysh mosha, se atyre nuk u lejon koha, siç u lejon më të rinjve, të mësojnë zanate të reja. Në përgjithësi konsiderohet se këta i kanë kaluar fazat e para dhe nga ana profesionale janë të formuar. Vertikalisht ose paralelisht, ata duhet të lëvizin dhe të shkojnë atje ku mund dhe duhet të japin më shumë nga eksperiencia që kanë fituar. Ky është kriteri i tretë që mendoj se duhet të kemi parasysh.

Qarkullimi i kuadrit është një problem shumë serioz për të tashmen dhe për të ardhmen e Partisë. Ne duhet t'u presim rrugën pakënaqësive që do të rrjedhin nga mbeturinat në ndërgjegjen e njerëzve,

nga ndjenja e rehatisë etj., si edhe pakënaqësive që mund të vijnë në rast se ne nuk vendosim kritere të drejta dhe nuk i zbatojmë drejt ato. Qarkullimin e kuadrit duhet ta bëjmë të kuptueshëm, të natyrshëm, të pranueshëm prej të gjithëve, si një normë të domosdoshme për t'u zbatuar, që të mos i ndodhin asnjëherë rreziqe Partisë.

Kështu duhet të zgjidhet edhe problemi i shkurarjes së komunistëve në prodhim dhe i shpërndarjes së tyre më të drejtë. Vështirësitë që ndihen sot në shpërndarjen e komunistëve ne duhet t'i zgjidhim më drejt për të ardhmen, duke bërë më shumë pranime në Parti nga njerëzit që punojnë në prodhim, sipas rregullave të vendosura. Në përgjithësi këtej, nga puna në prodhim duhet të fitohet stazhi, të bëhet kalitja politike dhe kalitja në punë që në fillim, dhe ajo të mbruhet e të amalgamohet me punën mendore.

Prej këtej dhe pasi ta kenë kryer mirë këtë stazh, ata mund të vijnë në administratën shtetërore apo në vende drejtuese të Partisë për të zëvendësuar ata që duhet të kthehen përsëri në bazë, në gjirin e masave punonjëse. Kështu mendoj të ecet vazhdimisht lidhur me qarkullimin e kuadrove.

Këto çështje mendoj t'i studiojnë shokët që merren me përpunimin e statistikave të Partisë dhe ata të kuadrit.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP

KONTROLLI I KLASËS PUNËTORE

*Fjala në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

9 prill 1968

Në artikullin² e datës 24 mars 1968 botuar në «Zërin e popullit» në lidhje me kundërrevolucionet që po zhvillohen në vendet revizioniste është vënë theksi mbi çështjen e klasës punëtore në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera ku revizionistët janë në fuqi. Përveç të tjerave, në atë artikull flitet: e para, për të treguar nga vjen ajo apati, ajo amulli e klasës punëtore në këto vende përpara asaj tragjedie dhe tradhtisë që i bëhet klasës punëtore e Partisë së saj dhe, e dyta, t'i tërhiqet vëmendja Partisë sonë për rreziqet që mund t'i ngjasin edhe asaj, në rast se nuk tregohet vigjilente, në rast se nuk është në ballë të luftës revolucionare dhe nuk e udhëheqin këtë luftë klasa punëtore dhe Partia e saj.

Unë nuk do t'i përsëris sot këto çështje, por i bëj

1 Në këtë mbledhje u diskutua për raportin e paraqitur nga Këshilli Qendror i BPSH, mbi punën e organizatave të bashkimeve profesionale për kontrollin punëtor.

2 Shih në këtë vëllim f. 389.

thirrje Partisë dhe klasës punëtore të reflektojnë thellë mbi to dhe të mos i konsiderojnë se, meqë këto ngjasin në partitë revizioniste, «s'kanë asnjë lidhje me Partinë e vendin tonë, se Partinë e vendin tonë nuk i kërcënon asnjë rrezik» etj.

Në fund të po atij artikulli theksohen shkurtimisht edhe masat që ka marrë, metodat dhe stili i punës që po zbaton Partia jonë për të mos lejuar që sëmundjet revizioniste të shfaqen, të zënë vend dhe të rrezikojnë ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit në vendin tonë. Ky konkluzion i një gjendjeje reale nuk duhet të krijojë atë vetëkënaqësi të sëmurë, se meqë e kemi gjetur ilaçin, ne jemi krejt të imunizuar dhe çdo gjë do të ecë vetë, pa kokëçarje, pa luftë, pa përpjekje. Të mos çuditemi, sepse ka nga ata që mendojnë kështu, por ka edhe nga ata që jo vetëm mendojnë kështu, por bëjnë edhe të kundërtën e asaj që duhet bërë dhe në një mënyrë ose në një tjetër shtrembërojnë direktivat e Partisë. Por shumica dërrmuese mendojnë dhe preokupohen seriozisht për këto probleme jetike, të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e vijës revolucionare të Partisë dhe për t'i prerë rrugën çdo shfaqjeje të revizionizmit. Megjithatë, në këtë shumicë, ka nga ata që janë të ngritur politikisht e ideologjikisht dhe e kuptojnë thellë se ngritja politiko-ideologjike dhe ndërgjegjja e klasës janë nga çështjet më kryesore, më vendimtare dhe, duke e kuptuar kështu drejt, këtij problemi i vënë kujdesin e parë, të veçantë. Por ka edhe nga ata që përpara problemeve të tjera e harrojnë këtë gjë, shkojnë nga parimi se dikush tjetër interesohet për këtë punë.

Këtë çështje që është vendimtare për të gjithë, që është kyçi që zgjidh çdo problem dhe për të cilën duhet të interesohen, të thellohen, të marrin pjesë gjallërisht të gjithë, e ndajnë në dollape të veçanta, në komisione, në nënkomisione dhe format e punës nuk i konsiderojnë si mjete, por si sektorë të veçantë në vetvete, si skedarët e bibliotekave. Kjo është një praktikë e rrezikshme, pse padashur arrihet në pikëpamjen se i pari dhe i fundit përgjegjës, për të mirë o për të keq, që punët shkojnë mirë ose keq, në atë ose në këtë sektor, është ai person, komitet apo komision që është caktuar me përgjegjësi. Një gjë e tillë të shpie në shkëputjen nga masat dhe në moskryerjen si duhet të detyrave.

Shokët e bashkimeve profesionale na shtrojnë sot në Sekretariat disa probleme. Unë, kurdoherë kam qenë i mendimit dhe e theksoj përsëri se Sekretariatit nuk ka nevojë t'i bëhen raporte me konstatime të përgjithshme, që nuk shpjegojnë asgjë, me përsëritje të direktivave që ai vetë ka lëshuar dhe vetëm më në fund e më në bisht, t'i shtrohet me të vërtetë një problem që ka rëndësi.

Ne duam të na shtrohen copë një ose dhjetë probleme, të na sqarohet plotësisht gjendja, të jepet mendim i qartë për to, që të mundim kështu edhe ne të përfitojmë nga eksperiencia, të reflektojmë dhe të mund të japim ndonjë mendim ose këshillë.

Duke bërë fjalë për kontrollin punëtor, në përgjithësi, shokët e bashkimeve profesionale vijnë në problemin konkret që «komisionet e kontrollit punëtor që janë krijuar nuk japin, jo vetëm kjo, ato janë

bërë elementë burokratikë, kanë eliminuar kontrollin e bazës, kanë spostuar komitetet e bashkimeve profesionale; në to kanë hyrë njerëz të administratës, bile edhe në kryesi të këtyre komisioneve» dhe, si rrjedhim, fryma e burokratizmit ka hyrë brenda në këto komisione që janë gjoja komisione punëtorësh. Në një gjendje të tillë ka shfaqje të theksuar të hakmarrjes ndaj kritikave të punëtorëve, të cilat shprehen, në mënyrë të rafinuar, në praktikë dhe në jetë. Ky është një problem serioz që duhet ta analizojmë. Pra shokët e bashkimeve profesionale mund të hynin drejt në temë dhe t'i linin jashtë kontornot e panevojshme.

Nga këto që na thonë shokët e bashkimeve profesionale për këto komisione, kështu si veprojnë këta në praktikë dhe kërkesa që na bëjnë për të dhënë mendim nëse duhet të jenë të përhershme apo jo, unë mendoj se ato jo vetëm nuk duhet të jenë të përhershme, por duhet bile të ushtrohet plotësisht dhe drejtpërdrejt kontrolli i punëtorëve.

Në qoftë se ne do të pranojmë të ekzistojnë komisione të përbëra vetëm nga punëtorë, pa futur në to zyrtarët e administratës, kjo formë është më e mirë se ajo që kritikohet, por prapë klasa punëtore nuk duhet të flejë mendjen se, meqë ajo caktoi në komision 5 ose 10 punëtorë, çdo gjë do të shkojë drejt. Në qoftë se do të mendohet kështu, arrihet në atë që thashë më lart, në format e skedarëve.

Komisionet e ndryshme që krijojmë mund të ndryshohen, mund të përmirësohen, por funksionimi i mirë i tyre nuk varet vetëm nga forma, por nga kuptimi i drejtë i qëllimit për të cilin janë krijuar, nga

njerëzit që punojnë në to, nga ngritja politike, ideologjike dhe ndërgjegjja klasore e tyre. Dhe më në fund e mbi të gjitha, nëse këto komisione do të punojnë mirë ose keq, kjo varet nga kontrolli i masës mbi to dhe nga ndihma që do t'u japin atyre vetë klasa punëtore dhe Partia.

Por problemi, mendoj unë, është më i madh dhe më i gjerë se çështja e komisioneve të punëtorëve. Udhëheqja e kontrolli nga ana e klasës punëtore dhe e Partisë mbi çdo gjë dhe mbi këdo, mbi kuadrot, forumet, administratat, komisionet, duhet të jenë të plotë, pa të çara, vendimtarë. Kjo kërkon, në radhë të parë, kujdesin dhe vëmendjen më të madhe që klasa punëtore dhe Partia e saj të ngrihen në një nivel të lartë politik dhe ideologjik, të kalitet vazhdimisht ndërgjegjja e tyre e klasës. Nuk mjafton vetëm të themi ose të mësojmë përmendsh disa parime teorike të njohura që vërtetojnë çështjen e madhe se «është në fuqi klasa punëtore dhe Partia e saj», por kjo të realizohet efektivisht në çdo gjë. Një gjë e tillë bëhet realitet vetëm me luftë revolucionare, me edukim të thellë revolucionar dhe, të dyja këto, të gërshetuara si duhet, të sprapsin dhe të thyejnë çdo rrezik. Partia dhe klasa jonë punëtore që janë në fuqi ecin vendosmërisht në këtë rrugë. Kemi korrur suksese, por kemi edhe shumë të meta, kemi shumë për të bërë. Ne duhet të bëjmë akoma më shumë përpjekje të mëdha që organizatat e Partisë dhe bashkimet profesionale t'i kuptojnë thellë këto probleme dhe t'ua rrënjosim ato në kokë masave dhe në radhë të parë klasës punëtore.

Kontrolli punëtor, në qoftë se nuk gabohe, kuptohet ngushtë nga Partia dhe nga bashkimet profesionale. Në teori theksohen parimet që përmenda më lart, «se në fuqi është klasa punëtorë dhe Partia e saj», theksohet parimi se politika është në plan të parë, por në praktikë, në jetë, kjo nuk kuptohet sa duhet dhe nuk merren të gjitha ato masa të shumanshme që klasa punëtorë dhe aleatët e saj jo vetëm t'i kuptojnë me baza, por t'i zbatojnë në jetë, të jenë ata, të bëhen ata dhe Partia e tyre garancia e vërtetë e zbatimit të këtyre parimeve.

Në radhë të parë, më duket mua, çalon puna e organizatave të Partisë në interesimin e plotë për çështjen e klasës punëtorë, në drejtimin e edukimit të saj politik dhe ideologjik, që e konsideroj si një detyrë kryesore. Me këtë nuk duhet kuptuar se Partia nuk interesohet përgjithësisht për edukimin politik të klasës punëtorë, por ajo nuk interesohet sa duhet e në mënyrë të veçantë. Interesimi i Partisë është i mirë për organizimin e kurseve, të shkollave, të seminareve për anëtarët e Partisë, pavarësisht se kemi akoma shumë për të bërë. Me një fjalë, komunistët, në mënyrë të veçantë edukohen në forma të ndryshme, politikisht dhe ideologjikisht. Pra, për edukimin e udhëheqjes së klasës punëtorë dhe në veçanti për kuadrot ka interesim. Kjo është një hallkë e zinxhirit dhe nga më kryesoret, sepse është fakt që sa më të ngritur e të kalitur t'i kemi Partinë dhe kuadrot e saj, aq më mirë do t'i kryejnë ata detyrat, aq më të fortë e më të kalitur do ta kemi edhe klasën punëtorë. Pa Partinë, pa kuadrot e saj, nuk do të mundim ta bëj-

më si duhet edukimin politiko-ideologjik të masave. Mirëpo ky edukim, po nuk u organizua si duhet edhe në gjirin e klasës punëtore, po u la në fatin e vet, ose po u kënaqëm se kemi caktuar disa forma dhe disa propagandistë, të cilët po s'u ndihmuan dhe po s'u kontrolluan në punën e tyre, atëherë ky edukim bëhet formal, pa baza të shëndosha dhe disniveli i ngritjes midis kuadrove dhe masës së klasës punëtore, nuk zvogëlohet.

Organizatave të Partisë nuk e bëjnë mirë këtë punë dhe këtë e kemi kritikuar mjaft herë. Çështja duket në atë që anëtari i Partisë nuk jep maksimumin e vet në punë të organizuar në organizatën e bashkimeve profesionale. Komunistët aty nuk shquhen si masë e organizuar në edukimin sistematik me plan e me program të klasës punëtore. Komitetet e Partisë të rretheve e konsiderojnë në të shumtën e rasteve këtë edukim të klasës sikur nuk është veçanërisht një nga detyrat e tyre të mëdha, për arsye se mendojnë që Partia ka krijuar bashkimet profesionale, i ka ngarkuar këto posaçërisht për këtë punë, u ka dhënë disa kuadro, disa forma organizimi dhe kompetenca. Kjo është e vërtetë dhe bashkimet profesionale e kuadrot e tyre kanë përgjegjësi të madhe në rast se nuk e kryejnë detyrën (dhe unë jam i mendimit se nuk e kryejnë si duhet), po kjo nuk mund t'ia heqë përgjegjësinë Partisë. Dhe fakt është se, gjersa anëtarët e Partisë nuk u japin bashkimeve profesionale atë rëndësi që kërkohet për të kryer si duhet detyrat e tyre të mëdha, kjo vërteton mosinteresimin sa duhet të organizatave të Partisë në këtë çështje kaq të

rëndësishme, siç është edukimi politiko-ideologjik i klasës punëtore.

Me gjithë kritikrat që u bëhen, ne dimë se edhe bashkimet profesionale organizojnë kurse, seminare, leksione, të cilat, ashtu siç janë, të kuptohemi, nuk janë pa efekt, por mendoj se këto po t'i shikojë Partia me kujdes të madh e të veçantë, do të dalim me siguri në përfundimin që nuk janë ato që duam ne, dhe në këtë drejtim duhet të ndihmojmë seriozisht.

Çështjen e edukimit të Partisë me ideologjinë tonë po e marrim vazhdimisht në studim, e korrigjojmë, e plotësojmë dhe për këtë bëjmë shumë mirë. Po ashtu veprojmë dhe për edukimin e rinisë, kurse për sa i përket klasës punëtore, megjithëse themi orë e çast se «është klasa», «është baza», nuk interesohemi sa duhet për çështjen e edukimit të saj ideopolitik. Duhet thënë se shokët e bashkimeve profesionale që e kanë këtë si detyrë të veçantë, interesohen gjithashtu pak dhe nuk trokëllisin këmbët sa duhet në Parti dhe në shtet, jo për të lypur një kuadër a dy, por që të ndërrohet rrënjësisht gjendja ekzistuese. Duhet ndryshuar medoemos një situatë e tillë.

Unë propozoj që Partia dhe bashkimet profesionale në qendër, në rrethe e në bazë, ta marrin në studim gjendjen e brendisë dhe të formave të edukimit politiko-ideologjik të klasës punëtore dhe të vendosin po ato kritere disipline, aq sa na lejon gjëria e klasës punëtore, stazhi dhe arsimi i saj, siç i kemi vendosur edhe për Partinë. Nuk mund të ecë përpara Partia pa masat, ose Partia të jetë e ngritur dhe klasa punëtore e ulët ideologjiksht. Në qof-

të se ngjet kjo, atëherë shumë të këqija na presin.

Asnjëherë nuk duhet ta ndiejmë veten të kënaqur se klasa jonë punëtore në përgjithësi di se ajo dhe Partia e saj janë në fuqi, se diktatura e proletariatit është diktatura e tyre, se socializmi është rendi i tyre. Jo, ne duhet të bëjmë që ajo t'i kuptojë thellë dhe në gjerësinë e tyre këto çështje, t'i kuptojë, t'i lidhë me jetën, me praktikën dhe të jetë në ballë të luftës për t'i mbrojtur.

Në analizën që duhet t'i bëhet mënyrës aktuale të edukimit ideopolitik të klasës sonë punëtore, ne do të shohim sa boshllëqe kemi, sa formalizëm, bile dhe paqartësi. Nuk duhet të shkojmë nga parimi se punët ecin mirë, pra edhe edukimi e kalitja pa përpjekje të mëdha ecin mirë. Kështu problemet do t'i zgjidhim gabim.

Klasa jonë punëtore ka shumë nevojë për t'u edukuar me ideologjinë e klasës, me normat e klasës, me hovin dhe me guximin revolucionar të klasës. Këtu të mos bëjmë iluzione, se mund të gabojmë. Duhet ta marrim ashtu siç është klasën tonë punëtore dhe jo ashtu siç duhet të jetë. Këtë klasë punëtore që kemi duhet ta bëjmë ashtu siç duhet të jetë. Nuk mjafton pra të themi se «klasa punëtore është në fuqi» dhe ta flemë mendjen se ajo i ka të gjitha cilësitë e një klase të kalitur nga çdo pikëpamje. Klasa jonë punëtore mori pushtetin, ajo është në fuqi dhe ka në dorë çdo mjet dhe çdo mundësi që të ndërtojë shoqërinë pa klasa, të ndërtojë socializmin dhe komunizmin dhe, që t'i bëjë këto me sukses, ajo duhet të kalitet vetë në radhë të parë, të kalitë edhe masat

në shembullin e saj. Kjo është detyrë e madhe e Partisë dhe e klasës punëtore.

Por duhet të mos harrojmë realitetin tonë. Klasa jonë punëtore, relativisht, është e re. Këtë çështje duhet ta kemi kurdoherë parasysh në punën tonë, pse vetëm kështu do të shohim rëndësinë e detyrave që duhet të kryejë Partia. Klasa punëtore te ne u formua si e tillë, u zmadhua pas Çlirimit të atdheut dhe me krijimin gradual të industrisë sonë socialiste. Një pjesë e vogël e klasës sonë punëtore është me origjinë punëtore ose zanatçi i vogël, që ka njohur shtypjen e borgjezisë dhe të shfrytëzuesve. Pjesa tjetër, pjesa dërrmuese e saj është me origjinë fshatare dhe qytetare e varfër që edhe kjo ka njohur shtypjen dhe shfrytëzimin kapitalisto-çifligar. Një pjesë e mirë e klasës sonë punëtore, qoftë me origjinë punëtore, qoftë me prejardhje nga fshati ose nga qyteti, ka marrë pjesë në luftën e çlirimit, nën drejtimin e Partisë. Këtu qëndron një nga tiparet kryesore të klasës sonë punëtore. Për kalitjen tjetër të madhe plotësuese të saj ka ndikuar e gjithë periudha e luftës për ndërtimin e socializmit. Kurse brezi i ri i klasës sonë punëtore e ka këtë origjinë të mirë, që është thesari i madh i tij, por ky brez i ri i lindur, i rritur dhe i futur në radhët e klasës punëtore në regjimin socialist, nuk e njeh shtypjen dhe shfrytëzimin kapitalist.

Me këto pak fjalë nuk kam për qëllim të bëj analizën e thellë të përbërjes së klasës sonë punëtore, por dëshiroj të vij në atë që kjo përbërje ose ky formacion i klasës në zhvillim, ka sjellë me vete në gjirin e saj edhe shumë mbeturina e pikëpamje mikrobor-

gjeze, të cilat e dëmtojnë atë kohezion, atë ndërgjegje dhe disiplinë të klasës që ne duam të krijojmë. Këto mbeturina në ndërgjegjen e punëtorëve nuk mund të zhduken pa luftën politik-ideologjike të Partisë, pa një luftë të thellë dhe të shumanshme, pa një edukim politik-ideologjik shumë këmbëngulës.

Duhet të kemi parasysh gjithashtu se punëtorët tanë jo vetëm që sjellin mbeturina dhe i ruajnë, në qoftë se nuk ua spastrojmë, por ata marrin vazhdimisht nga shoqëria edhe të tjera, në rast se këtë shoqëri gjithashtu nuk e edukojmë sistematikisht me tiparet e vërteta të njeriut të shoqërisë socialiste, me tiparet e klasës, me ideologjinë e klasës, me tiparet e shëndosha të Partisë sonë. Këndej dua të theksoj atë që edukimi ideopolitik është një problem i madh, i gjerë, prandaj duhet të kapet i gjithë zinxhiri dhe jo vetëm një ose dy hallka të tij. Të dimë të kapim mirë kryesoret, por jo të lëmë në harresë dhe të mos kordinojmë, të mos ndihmojmë dhe të mos kontrollojmë edhe të tjerat. Me Partinë në krye, e cila duhet të ketë syrin kudo dhe t'u japë ndihmë konkrete të gjitha organizatave të masave, duhet të përqendrojmë kujdesin tonë, në radhë të parë në edukimin ideopolitik të masave, të njerëzve, të kuadrove.

Është një fakt i madh që ne kemi një klasë punëtoresh heroike, me një shpirt dhe guxim të madh revolucionar, kemi një klasë punëtoresh të lidhur ngushtë me Partinë e saj dhe me popullin e vet, kemi një klasë punëtoresh që bën përparime të çuditshme në lëmin e teknikës. Në këtë gjendje ajo nuk ka nivel të ulët politik. Këto janë anët e saj pozitive. Por të mos ha-

rrojmë anët negative që thashë më lart. Rreziku i parë qëndron në atë që klasa punëtore, duke ditur se ajo dhe Partia e saj janë në fuqi, e fle mendjen ose nuk vë si duhet politikën në plan të parë dhe hidhet vetëm në ekonomizëm, në problemet e saj të veçanta, ose u jep vetëm këtyre rëndësinë kryesore. Rreziku i dytë qëndron në atë që punëtorja mund të mbyllet në guaskën e ndërmarrjes së vet dhe të atyre me të cilat ka lidhje ekonomike ndërmarrja dhe mund të mos i vërë rëndësi sa duhet rolit të saj vendimtar si klasë në udhëheqje, e caktuar nga historia jo vetëm për të punuar në fabrikë, por duke punuar në fabrikë, të drejtojë çdo sektor dhe të gjithë të ecin në rrugën e saj dhe të Partisë së saj në fabrika, në fusha, në administratë, në shkolla e kudo.

Klasa punëtore duhet të kuptojë detyrat dhe rolin e saj jo vetëm në fabrikë, por edhe jashtë fabrikës. Brendapërbrenda në fabrikë ne kemi shumë për të bërë, pse edhe atje jemi skllëvër të disa formave pune dhe edukimi që nuk japin sa duhet dhe vazhdojmë t'i mbajmë. Fletërrufetë, që janë një formë edukimi nëpërmjet kritikës publike, kanë mbetur formale. Kur bëhet kritikë nga ndonjë punëtor, ajo merret si një çështje personale dhe nuk diskutohet me zjarr që nga një problem personal të nxirren konkluzione politike për edukim; drejtori, zyrtari ose punëtori që kritikohen, ofendohen dhe përgatitin hakmarrjen në mënyra të ndryshme. Të gjitha këto hidhen në platforma personale mikroborgjeze (disa herë këto mund të jenë edhe të tilla), por duke marrë shkas nga këto, të dilet në debate politiko-ideologjike, që të kalitet

kolektivi. Çështje të tilla të bëhen problem jo vetëm brenda në ndërmarrje, por edhe jashtë saj, të kalohet në të gjitha manifestimet e jetës, ku të bashkohet forca e klasës punëtoare dhe të jetë kjo kudo në ballë, të shquhet për guxim e pjekuri, për modesti dhe ashpërsi, kur shkelen vija dhe normat e Partisë.

Natyrisht, në një kolektiv punëtorësh, si në Fabrikën e Briketit në Tiranë, ku pasi nuk e thyen dot burokratizmin, iu futën një pune antiekonomike: në mungesë të pluhurit të qymyrit për të bërë briketa (pse për këtë ishte ngritur fabrika), morën qymyrin kokërr e bluan dhe pastaj e bënë prap kokërr. Vetëkuptohet se aty puna politike nuk është në lartësinë e duhur, se atje sundojnë në radhë të parë ekonomizmi dhe interesat e ngushtë të ndërmarrjes.

Insistoj në atë gjë të madhe që Partia duhet të sigurojë dhe të çelikosë unitetin e saj me klasën dhe ky konkretisht të jetë i bazuar mirë në ideologjinë dhe në politikën tonë marksiste-leniniste. Kuadrot e Partisë, që janë thesari i madh i saj, këtë problem të madh duhet ta kuptojnë mirë ideologjikisht dhe politikisht, pse po ta kuptojnë kështu, nuk do të ketë kurrë rrezik të ndodhë shkëputja e Partisë nga klasa dhe e kuadrove nga masat.

Nuk mjafton vetëm të themi se «kuadrot edukojnë masat dhe ato mësojnë nga masat», por kjo gjë duhet të ngjasë me të vërtetë kështu dhe jo ndryshe. Shumë pengesa ka në këtë drejtim. Njeriu ka ndjenja, ka shije, është i ndërlikuar, ai është një krijesë e mrekullueshme, por njëkohësisht edhe e ndërlikuar. Prandaj Partia që ka barrën e rëndë, por fisnike të kalitë

njeriun e ri, duhet të bëjë për këtë qëllim një punë shumë, shumë të kujdesshme, të mençur, parimore.

Si konkluzion, organizatat e Partisë e të bashkimeve profesionale, që ne marrim sot në studim, duhet, në radhë të parë dhe në mënyrë të veçantë, të interesohen për edukimin e njerëzve. Kjo do të zgjidhë mirë çdo problem, mbasi është e lidhur ngushtë me punën, me realizimet, me krijimet. Njeriu realizon dhe krijon, prandaj sa më i ngritur të jetë ideologjikisht dhe politikisht, aq më mirë do të na ecin të gjitha punët.

Bashkimet profesionale, të ndihmuara nga Partia, mendoj unë, duhet ta rishikojnë edhe më thellë punën e tyre dhe t'ia përshtatin këtë më mirë dhe më drejt vijës së Partisë dhe kushteve të reja të zhvillimit të shoqërisë sonë. Në bashkimet tona profesionale duhet të ketë shumë mbeturina jo të drejta dhe jo të kohës, nga eksperiencia e vjetër sovjetike, mbeturina këto që me kohë janë veshur me rrobat tona si të thuash dhe vazhdojnë të jetojnë e të pengojnë.

Po të marrim çështjen e preokupimit të bashkimeve profesionale për problemet ekonomike të punëtorëve, deri në hollësi më të vogla, në qoftë se nuk gabohe, këto ua kanë hequr bashkimeve profesionale preokupacionin e madh për edukimin ideopolitik të klasës punëtore. Të kuptohemi, jo se bashkimet profesionale nuk duhet të interesohen për problemet ekonomike të shtetit, të fabrikës dhe të punëtorëve, pse pa u interesuar për to, pa i ditur këto, as që mund të bëhet një punë ideopolitike me themel. Por prirjet, më duket se janë në drejtim të interesimit vetëm për këto çështje, ndërsa puna politike ose të kthehet në formu-

la, ose të lidhet dobët me jetën dhe me praktikën dhe të mos dalë fare jashtë sferave të prodhimit të fabrikës. Kuadrot që punojnë në bashkimet profesionale, në qoftë se nuk gabohe, i kanë bërë të tyret këto prirje. Ata nuk janë pa eksperiencë, por duhet të reflektojnë për punën e tyre dhe, pa harruar punën dhe luftën në ekonomi, të kthejnë fytyrën më shumë nga politika dhe nga ideologjia, të thellohen në përgatitjen e tyre me baza në këtë drejtim për edukimin e vetes së tyre, që të mund të edukojnë edhe klasën punëtore dhe të bëhen me të vërtetë një rrip transmisioni i vijës së Partisë.

Atë që thashë më sipër për klasën punëtore, që kjo të mos e kuptojë vetëm në parim se është në fuqi, ca më shumë vlen për kuadrot e bashkimeve profesionale, të cilët duhet të spastrohen nga mbeturinat e rrezikshme të mendjemadhësisë, të shkëputjes nga masa, nga familjariteti i sëmurë me njerëzit e komitetit të Partisë të rrethit, ose me udhëheqjen e ndërmarrjes. Edhe këta shokë, qofshin ose jo me origjinë punëtore, me stazh punëtori, qofshin kryeinxhinierë, mjeshtër ose teknikë të mesëm, nuk janë të imunizuar nga këto sëmundje dhe shpëtohen vetëm kur rrojnë dhe punojnë me masën.

Ngjet mjaft herë që në parim këto i themi, po kur vjen çështja për të ngritur zërin kundër gabimeve të udhëheqjes së ndërmarrjes apo të dikasterit, kundër shkeljes së ligjeve ose të urdhëresave, udhëheqësit e bashkimeve profesionale i ngrenë këto gjëra në mes tyre, brenda tyre, në qyp dhe nuk i shtrojnë kurrë si duhet përpara punëtorëve, po thonë si pa gjë të keqe

dhe bile duke pretenduar se e kanë bërë detyrën se «ia kanë ngritur këtë problem një ose dhjetë herë drejtorit, nëndrejtorit, komitetit», por masa nuk u morën dhe në Uzinën e Poliçanit, për shembull, na u vranë 2 punëtorë. Po t'ua kishin shtruar çështjen punëtorëve dhe klasa punëtore të godiste me grusht në tavolinë, edhe baranga do të qe ndrequr me kohë, edhe burokratëve do t'u qe gjendur vendi, edhe punëtorët s'do të na ishin vranë.

Mirëpo përse nuk e bëjnë këta këtë punë? Sepse nuk kanë koncepte të drejta për burokracinë dhe si duhet luftuar ajo, nuk kanë koncepte të drejta për klasën punëtore dhe forcën e saj, nuk kanë koncepte të drejta për Partinë etj., dhe po t'i thonë klasës punëtore të trokasë grushtin mbi tavolinë kundër burokratëve, cilëdo qofshin këta, ata mendojnë se «klasa punëtore ngrihet kundër Partisë». Ata arrijnë pra të ngatërrojnë Partinë, vijën e saj, me një ose njëqind persona që nuk janë të mirë dhe që dëmtojnë Partinë dhe punën.

Vetëm një punë politike dhe ideologjike e thellë nga ana e Partisë, e bashkimeve profesionale dhe e të gjitha organizatave të tjera të masave e kalit njeriun, kalit Partinë dhe klasën, forcon socializmin dhe korr suksese të vazhdueshme në çdo lëmë.

Në raportin që na paraqitin shokët e bashkimeve profesionale, i vetmi problem që ngrihet është ai i «komisioneve të punëtorëve» që në përgjithësi quhen «të punëtorëve», kurse ato janë një formë burokratike. Për luftën kundër burokratizmit, të cilën Partia e ka ngritur me forcë, flitet shumë, po kuptohet për lu-

më. Pikërisht, në një kohë kur flitet dhe thuhet se është kuptuar lufta kundër burokratizmit, në parim dhe në praktikë shkohet duke e forcuar burokratizmin nga ana e aparateve shtetërore, dikastereve etj., dhe, si pa të keq, kjo gjë aprovohet edhe nga komitetet e Partisë në rrethe. Në ndërmarrjet ekonomike nuk është krijuar vetëm një komision i shtrembër, por shumë komisione të tilla. Drejtorja e ndërmarrjes duhet të jetë e shkathët, operative dhe të marrë mirë në dorë kompetencat e detyrat e saj, duke e bërë punën me më pak njerëz. Ajo krijon pranë vetes këshillin teknik, vetë titulli përcakton qëllimet e tij që janë të drejta. Por në fakt, ky i ashtuquajtur këshill teknik është kthyer në burokratik. Ky këshill ka marrë në dorë vendosjen dhe transferimin e kuadrit, shpërblimin e punëtorëve, aprovimin e lejeve të zakonshme, vendosjen e organikave dhe deri marrjen e masave ndëshkimore administrative kundër punëtorëve. Kishim pranë një drejtori na u bënë dy drejtori, kishim një burokraci, u bënë dy burokraci.

Por s'mjafton kaq se ka edhe më. Është krijuar edhe një formë pune «treshe», siç e quajnë, me drejtorin, sekretarin e organizatës-bazë të Partisë dhe kryetarin e komitetit profesional. Dhe ky tresh, në ortakllëk, duke shkelur demokracinë, rregullat, vijën, gjoja drejton operativisht, por më mirë të themi janë bërë tre veta vetë zot, vetë shkop. Kjo formë pune drejtimin e Partisë në ndërmarrje e ka reduktuar në drejtimin nga ana e sekretarit të organizatës-bazë, i cili është kudo, por vetëm në krye të organizatës-bazë nuk është; ai është në «treshen», ai është në kë-

shillin teknik, ku ka marrë me vete një ose dy anëtarë të byrosë dhe kuptohet pse i ka marrë, pse kompetencat e Partisë ia ka kaluar këshillit teknik; sekretari i organizatës-bazë dhe byroja e saj më të shumtat e herës i bëjnë mbledhjet bashkë me këtë këshill teknik etj.

Më lejoni të ndalem në këtë çështje, pse mendoj që nuk është thjesht një regjistrim faktesh, por rezultat i disa pikëpamjeve jo të qarta që shokët kanë për vijën e Partisë.

Përse sekretari i organizatës-bazë ose i komitetit të Partisë në fabrikë, në ndërmarrje ose në kooperativë duhet të caktohet edhe anëtar i të gjitha komisioneve, me vend e pa vend, që krijohen për mbarëvajtjen e punës në to? Përse sekretari kthehet nga një person i zgjedhur nga Partia, si udhëheqës dhe punëtor partie, në një funksionar shtetëror, në një njeri zyre? Kjo e ka burimin në kuptimin jo të drejtë të rolit të Partisë, të drejtimit dhe të kontrollit të saj, në kuptimin jo të drejtë të detyrave dhe të kompetencave të sekretarit. Si ngjet kjo? Fare thjesht, por shumë gabim. Sekretarin e futin në të gjitha këto ingranazhe, pse mendohet dhe mendohet shtrembër se, pa qenë sekretari në to, në praktikë Partia nuk është në udhëheqje, domethënë sekretari është Partia, sekretari është vija, sekretari është kontrolli, ai është çdo gjë dhe duhet të jetë kudo nga një çikë. Prandaj kërkohet shumë herë që sekretari të jetë i lirë nga çdo punë, pse është i zënë gjoja me shumë punë dhe, në fakt, ai është i futur ku duhet dhe ku nuk duhet.

Kur një shok zgjidhet nga organizata si sekretar,

ai vishet me një autoritet aq të madh sa harron cilat janë detyrat e tij ndaj Partisë dhe zgjedhësve, në shumë raste i rritet mendja dhe mendon se ai është më i zoti nga të gjithë, meqë e zgjodhi Partia si sekretar. Ai harron se Partia ka në gjirin e saj njerëz edhe më të zotë dhe që i ka caktuar në punë të ndryshme politikisht jo më pak të besueshme. Një pikëpamje e tillë e gabuar për sekretarin e shtyn këtë në jetë të mendojë se «meqë më kanë zgjedhur sekretar unë jam garanti kryesor i vijës së Partisë, prandaj unë duhet të jem kudo, të kontrolloj këdo» dhe harron se garanti kryesor dhe i vetmi i sigurt i zbatimit drejt të vijës së Partisë është vetë Partia, klasa punëtore, janë komunistët dhe punëtorët e kooperativistët. Në radhët e Partisë nuk numërohet vetëm sekretari, por edhe drejtori i fabrikës ose i ndërmarrjes, kryetari i kooperativës, njerëzit e komitetit ekzekutiv etj. dhe që të gjithë këta janë po aq përgjegjës, në mos më shumë, se sekretari përpara Partisë dhe shtetit për zbatimin e drejtë të vijës së Partisë dhe për kontrollin e saj. Por mund të thuhet se këta mund të gabojnë. Po edhe sekretari mund të gabojë, ndërsa organizata-bazë e Partisë, kolektivi nuk gabojnë, ose mund të gabojnë shumë pak, disa herë për një kohë, por jo gjatë.

Në këtë mënyrë, pra, duhet të kuptohet se punët në një fabrikë venë mirë, jo pse është sekretari i mirë, por sepse janë të mirë që nga punëtori i pastrimit e deri te drejtori, se është e mirë organizata e Partisë dhe klasa punëtore dhe në këtë kanë dhënë kontributin e vet edhe komunisti punëtor ose punëtori i pa-

organizuar në Parti, edhe sekretari, edhe drejtori, edhe normisti, e kështu të gjithë me radhë.

Mendime të tilla për sekretarët dhe te vetë sekretarët çojnë në nënvleftësimin e Partisë, të klasës dhe të masës, i bëjnë sekretarët ose byrotë e organizatave-bazë të harrojnë dhe të lënë pas dore detyrat e tyre të vërteta që janë pikërisht: ndihma që duhet të japin ata që Partia dhe klasa të forcohen, të edukohen. Por edhe me këtë funksion të madh, këta shokë të zgjedhur në forumet e Partisë, kurrë të mos mendojnë se ata bëjnë çdo gjë dhe se pa ta s'do të bëhej gjë. Ata duhet ta ndiejnë kurdoherë veten e tyre të thjeshtë përpara eksperiencës dhe zotësisë së madhe të Partisë, të klasës punëtore dhe të masave.

Sekretarët e organizatave-bazë pra, me këto praktika, që futen në të gjitha organizmat shtetërorë ose teknikë të ndërmarrjes, ku Partia ka shokë edhe kompetentë, edhe politikisht të besuar, duke krijuar «treshë», «katërshe», a lloj-lloj komisionesh ku krijohet një frymë e sëmurë familjariteti në mes kuadrosh kryesorë, duke u veshur me pushtet dhe me funksione partie, arrijnë të mendojnë se ata janë më të zotët, se ata mund të zgjidhin çdo gjë, ata janë edhe teknikë, edhe organizatorë, edhe udhëheqësit e Partisë, prandaj vendimet e tyre vlejnë, masa duhet t'u bindet, ose sa për formalizëm i çojnë vendimet e tyre poshtë për aprovim. Pra ata bëjnë ligjin në fabrikë dhe jo Partia e klasa punëtore dhe, kur kritikohen, hakmerren. Punëtorët, duke i shikuar këta «të treshes» etj., kokë më kokë, në familjaritet në mes tyre, dobësojnë unitetin, vigjilencën, sulmin revolucionar të tyre, fillojnë

të mendojnë si individë dhe të thonë «mos fol, mos kritiko, se këta të bëjnë gjëmën».

Shikoni, shokë, sa të rrezikshme bëhen këto pikëpamje të gabuara dhe këto praktika pune jo me vend, që vendosen si pa të keq. Duhet t'i spastrojmë rrënjësisht këto pikëpamje dhe këto forma organizimi të gabuara. Nuk duhet të ngatërrojmë ose të bashkojmë në momentet aktuale, kontrollin shtetëror me kontrollin e Partisë, të klasës punëtoare dhe të masave. Nevoja e kërkon akoma të veprojë paralelisht.

Nevoja e kërkon gjithashtu që sekretarët e komiteteve të Partisë të rretheve, njerëzit e këtyre komiteteve, jo të praktikojnë vetëm takimet me sekretarët e organizatave-bazë, ose me njerëzit e byrove të tyre, por, unë mendoj që në çdo takim të tyre me ta, të ftojnë për t'i dëgjuar e për të zhvilluar biseda edhe komunistë të thjeshtë, edhe punëtorë, edhe kooperativistë nga masat dhe jo medoemos me ata që zgjedh sekretari dhe jo medoemos takimi të bëhet i organizuar si një mbledhje zyrtare. Kjo formë pune është shumë e nevojshme të përdoret për të forcuar praktikën e lidhjeve të udhëheqjes me bazën e Partisë, jo vetëm në format e punës të rregullta që kemi vendosur, por edhe në takime të tilla që nuk lënë të zhvillohen sëmundje në mendjen e sekretarëve të organizatave-bazë e të zgjidhen çështjet «në mes nesh», pësh-pësh nëpër vesh dhe në dhoma të mbyllura. Me këtë praktikë t'u japim atyre të kuptojnë se problemet i zgjidhin dhe duhet medoemos t'i zgjidhin tok me masën e Partisë dhe të klasës dhe që ta bëjnë këtë duhet t'i vëmë në dijeni seriozisht ato, të diskutojmë me

to, të marrim mendimin e tyre dhe pastaj të vendosim. Të mësohemi se nuk jemi vetëm ne udhëheqja që vendosim, por vendos Partia, vendos klasa. Ne si pjesëtarë të saj edhe diskutojmë, edhe vendosim, edhe konkludojmë, por kurrë sipas kokës sonë dhe jashtë dëshirës, vullnetit, vijës së Partisë, të klasës punëtore.

Kështu ne do të evitojmë krijimin e burokratëve, të megalomanëve, të prepotentëve dhe të arbitrareve. Në gabime të tilla bien edhe kuadro kryesorë të Partisë në rrethe siç bëri, për shembull, një sekretar partie rrethi, i cili, pse u grindën në mes tyre dy komunistë (dhe që natyrisht çështja e tyre duhej analizuar), jep urdhër nga lart që brenda 24 orëve të mblidhej organizata-bazë dhe t'i përjashtonte nga Partia, të mblidhej edhe gjykata e t'i dënonte.

Me një fjalë, ka kuadro që flasin kundër burokratizmit, që flasin për demokracinë e brendshme të Partisë, që flasin për zërin e masave, për normat e Partisë etj., etj., por i harrojnë ato si pa të keq, thyejnë direktivat e Partisë, i shtrembërojnë keqas ato dhe krijojnë në rrugë e në forma jo të drejta një grup udhëheqësish burokratë, zot për çdo gjë e mbi çdo gjë dhe i thonë Partisë e klasës punëtore: «Bëni si themi ne, kurse me direktivat dhe me leksionet gargarisuni».

A bëhet me qëllim armiqësor një gjë e tillë? Jo, unë jam i bindur se jo. Por ata bëjnë faje të rënda, bëjnë gabime vije, që duhen ndrequr menjëherë.

Po pse bëjnë të tilla gabime vije kur nuk janë armiq? I bëjnë se nuk thellohen, i bëjnë se neglizhojnë ngritjen e tyre politike dhe ideologjike dhe mendojnë me mendjelehtësi, por edhe me megalomani, se de-

risa janë bërë drejtues, janë të ngritur edhe politikisht e ideologjikisht. Këta shokë as që i thellojnë në studimet e tyre direktivat e Komitetit Qendror dhe të Kongresit, ata mendojnë se këto janë të lehta, të kuptueshme që në leximin e parë dhe janë gati të bëjnë edhe leksione bajate, plot me perifraza, por jo të ndiejnë përgjegjësinë dhe detyrën e madhe që këto direktiva t'i thellojnë me eksperiencën e madhe të Partisë. Këta shokë i bëjnë këto gjëra pse jo vetëm nuk kuptojnë rëndësinë e politikës dhe të ideologjisë, jo vetëm që këtë edukim e kuptojnë si një gjë të shkëputur e në vetvete, por arrijnë të mendojnë dhe të veprojnë në fakt sikur në ndërmarrje ose në fabrikë s'hyn politika, s'hyn ideologjia dhe oburra të krijojmë komisione të çfarëdo lloji t'u japim kompetenca të çfarëdo llojta, duke zhveshur Partinë, klasën punëtore, bashkimet profesionale nga rolet e tyre.

Duhet të reflektojmë, shokë, se të gjitha këto komisione e komitete që kemi në një ndërmarrje o fabrikë, që, po të numërohen, duke futur edhe ato të rinisë e të gruas, mund të arrijnë edhe në dhjetëra, e ndihmojnë punën, ndihmojnë aktivizimin direkt të masave, të klasës e të Partisë, apo e frenojnë dhe krijojnë mëndimin se çdo gjë e zgjidh komisioni ose komiteti, mjafton që këto ne t'i zgjedhim në «forma demokratike»? A e ndihmojnë të gjitha këto komisione pa vend demokracinë e vërtetë proletare të Partisë, disiplinën e vetëdijshme të klasës, apo mos krijojnë një gjendje false, një gjendje shtrëngimi, një disiplinë dhe demokraci formale dhe administrative?

Shokë, duhet të tregojmë shumë kujdes në këto

probleme, se janë probleme vije. Jashtëzakonisht kujdes duhet të tregojnë sidomos administratat qendrore si Ministria e Industrisë dhe e Minerave etj. Njëkohësisht është shumë keq që komitetet e Partisë në rrethe nuk marrin masa të menjëhershme, them të marrin masa menjëherë dhe jo vetëm të sinjalizojnë, në mënyrë që të mos ngjasin gjëra të tilla.

Ne jemi një vend i diktaturës së proletariatit, i udhëhequr nga Partia e Punës e Shqipërisë. Kjo do të thotë se klasa punëtore, me Partinë e saj në krye, udhëheq ndërtimin e socializmit në aleancë me fshatarësinë punonjëse. Në kundërshtim flagrant me revizionistët modernë që thonë se diktatura e proletariatit nuk ekziston më, se shteti është duke u zhdukur, se partia e proletariatit në këto rrethana nuk mund të ketë më as atë përbërje klase, as ato funksione si parti proletare, për arsye të zhdukjes së diktaturës apo të transformimit të shoqërisë, se, si rrjedhim, partia u bë parti e gjithë popullit dhe pushteti u bë i gjithë popullit, te ne ekziston dhe do të ekzistojë diktatura e proletariatit, ekziston dhe do të ekzistojë në udhëheqje Partia marksiste-leniniste e klasës, ekziston dhe do të ekzistojë pushteti i klasës punëtore. Shteti i vërtetë socialist nuk mund të identifikohet ose të barazohet, siç shpifin revizionistët modernë e sidomos ata jugosllavë, me shtetin borgjez kapitalist, të cilit i vihet përballë klasa punëtore, as me atë «burokracinë e re» të krijuar gjoja në socializëm, së cilës përsëri i vihet përballë klasa punëtore. Duke llomotitur të tilla teori antimarksiste, ata kanë dalë në teorinë e vetadministrimit punëtor, që do të thotë shkallmimi i planifi-

kimit të centralizuar gjoja për ta luftuar këtë «burokraci të re», gjoja për ta administruar drejtpërdrejt klasa punëtore brendapërbrenda ndërmarrjes tepricën e fitimit, që do të thotë akumulimin. Me këtë teori antimarksiste ata dalin në rrugën e vërtetë kapitaliste të krijimit dhe të forcimit të klasës kapitaliste. Ky proces i transformimit të vendeve ish-socialiste në vende kapitaliste filloi në Jugosllavi dhe zhvillohet gjerësisht dhe me shpejtësi në Bashkimin Sovjetik, në Çekoslovakia, në Poloni e gjetkë. Kundër kësaj rryme tradhtare lufton me guxim Partia jonë, duke mbrojtur dhe duke zbatuar me konsekuencë marksizëm-leninizmin.

Zhvillimi i harmonishëm i socializmit në vendin tonë, i udhëhequr nga Partia jonë marksiste-leniniste, vërteton domosdoshmërinë e ekzistencës së diktaturës së fortë e të papërkulur të proletariatit, të Partisë së klasës në udhëheqje të plotë, të ekzistencës së shtetit socialist. Rruga e përcaktuar dhe e ndjekur nga Partia jonë me një konsekuencë të madhe në drejtimin e ekonomisë socialiste, në zhvillimin progresiv dhe të centralizuar të ekonomisë, në zgjerimin e prodhimit shoqëror, duke marrë kurdoherë parasysh nevojat e shoqërisë në përgjithësi dhe të punonjësve në veçanti, ka bërë që të arrihen këto suksese të mëdha. Partia, me vijën e saj të drejtë dhe me hov revolucionar, bën që procesi i zhvillimit socialist të vendit të mos ndërrohet në një proces burokratik, por në të të thonë kurdoherë dhe në çdo etapë fjalën e tyre klasa punëtore dhe masat punonjëse, pse janë ato që veprojnë, që transformojnë, që krijojnë. Pjesëmarrja aktive e klasës punë-

tore dhe e punonjësve në çdo gjë, është një nga preokupacionet më të mëdha të Partisë dhe këtu synon e gjithë lufta revolucionare e saj për ngritjen politike, ideologjike të klasës dhe të masës, për demokratizimin sa më të madh të pushtetit, që do të thotë pjesëmarrje e gjerë, aktive, në çdo gjë e në çdo problem e masave punonjëse në luftën kundër burokratizimit të aparateve të shtetit, të administratës, të vetë Partisë dhe të njerëzve të tyre.

Kjo është një punë e gjerë dhe komplekse që çdo njeri, them çdo njeri, duhet të bëjë përpjekje të mëdha për t'i kuptuar thellë dhe për t'i zbatuar drejt, pse këtu qëndron fati i ndërtimit me sukses të socializmit. Ca më tepër kuadrot e Partisë dhe të shtetit duhet t'i kuptojnë thellë ideologjikisht këto probleme, të cilat nuk paraqiten as të shkëputura nga njëra-tjetra dhe as aq të thjeshta.

Në rast se nuk e kupton rolin udhëheqës të Partisë në të gjithë madhësinë, në të gjitha aspektet e veprimtarisë së Partisë, në të gjitha nuancat, atëherë mund të gabosh, si djathtas, ashtu edhe majtas. Shokët që janë të pangritur ideologjikisht dhe jo të lidhur me masën, në punën dhe në luftën konkrete, mund të bëjnë lehtë gabime të tilla. Organizimi i punës së Partisë dhe i aparateve shtetërore për zbatimin e drejtë të direktivave të Kongresit dhe të Komitetit Qendror të Partisë ka një rëndësi të madhe, deri në çështjet më të vogla, edhe në krijimin e një forme pune ose të një komisioni që në shikimin e parë mund të na duket i parëndësishëm. Sa e rrezikshme mund të bëhet, për shembull, në rast se direktiva e madhe e

Partisë «politika dhe ideologjia në plan të parë» kuptohet e shkëputur nga çdo gjë, nga ekonomia, nga arsimi, nga kultura, nga organizimi i shtetit etj. zhvillohet si diçka në vetvete dhe Partia heq dorë nga drejtimi i gjithë jetës së vendit ose i aspekteve të ndryshme të jetës. E kundërta gjithashtu bëhet e rrezikshme, kur Partia merret vetëm me ekonominë, kthehet në një aparat thjesht tekniko-ekonomik dhe harron detyrat e saj të mëdha, të shumta e të shumanshme.

Pikërisht këtu ne mund të konstatojmë se si dy tradhtarët e mëdhenj të marksizëm-leninizmit, Titoja dhe Hrushovi, nisen për likuidimin e partisë nga dy ekstremet, të cilat puqen në një qëllim. Titoja, me reformën e tij të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, i cakton gjoja partisë vetëm «rolin e edukuesit politik dhe ideologjik»; kurse Hrushovi, me të famshmin organizim të partisë, synonte që këtë ta zhvishte nga çdo funksion tjetër dhe ta kthente në një organ thjesht ekonomik.

Nuk është as hera e parë dhe as e fundit që Partia i ngre këto probleme, por mendoj se bëjmë shumë mirë që i ngremë vazhdimisht dhe sa më shumë t'i thellojmë e t'i kuptojmë, aq më mirë do t'i zbatojmë në jetë dhe do të korrin kështu suksese më të mëdha.

Botohet sipas librit:
Enver Hoxha «Raporte e fjalis-
me 1967-1968», f. 390.
Tiranë, 1969

TË STUDIOJMË MUNDËSITË E NGRITJES SË OBJEKTEVE TË REJA INDUSTRIALE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

15 prill 1968

Vërejtja ime e përgjithshme, në radhë të parë, është që ne të mos na mbulojë mania e ndërtimeve të mëdha, perkundrazi, të tregohemi të matur dhe sa të jetë e mundur realistë në ngritjen e gjithë këtyre veprave. Natyrisht, sa më shumë uzina e fabrika të kemi dhe sa më shpejt t'i ndërtojmë këto, aq më mirë është, por të mbajmë kurdoherë parasysh që ato të jenë të bazuara e të balancuara, ndryshe do të na ngjasin gjëra jo të mira. Investimet dhe ndërtimet e shumta që tejkalojnë mundësitë tona mund të sjellin ose mosrealizimin e objekteve, dhe atëherë do të vërtetohet se ne nuk jemi treguar realistë në parashikimin e tyre, ose perturbacione në fushën monetare dhe në nivelin e jetesës së popullit.

1 Në këtë mbledhje u diskutua për projektin e zhvillimit të ekonomisë e të kulturës së RPSH për vitet 1971-1980, paraqitur nga Kryesia e Këshillit të Ministrave të RPSH.

Industrinë ne duhet ta zhvillojmë në bazë të të dhënave konkrete. Është e vërtetë që ne kemi nevojë për hekur, por nuk është e domosdoshme që tani të bëjmë investime të mëdha me parashikimin për të eksportuar hekur pas disa vjetësh. Në qoftë se do të bëjmë të tilla investime duke u nisur nga fakti se vendi ynë është i pasur në mineral hekuri, pa marrë parasysh se investimet e mëdha të parakohshme rëndojnë mirëqenien e popullit, unë mendoj se do të ishte më mirë që hekuri tani për tani të qëndrojë atje ku është, sepse edhe ngritja e nivelit të jetesës së popullit është një çështje shumë e rëndësishme. Prandaj në fillim të bëjmë përpjekje për të shfrytëzuar atë sasi minerali që na e lejojnë mundësitë tona, kurse pas një kohe, kur ekonomia jonë të jetë forcuar akoma më shumë, ne mund t'ia shtojmë edhe një ose dy furra të tjera uzinës së metalurgjisë për shkrirjen e hekurit.

Për uzinën e metalurgjisë së zezë në Elbasan jam dakord që prodhimi i saj të trefishohet, por a është e studiuar mirë mundësia për këtë? Këtë gjë Komisioni i Planit duhet të na e sqarojë duke u mbështetur në eksperiencën dhe në mundësinë që kemi.

Kërkohet shtesë kredie për projektimin e uzinës së shkrirjes së hekur-nikelit me kapacitetet që janë shënuar në projektin e paraqitur, duke e ndërtuar në dy etapa, me perspektivë që më vonë të arrijmë në afro dyfishimin e aftësive që kemi sot. Përse të bëhen investime të mëdha për ndërtimin e kësaj uzine dhe të mos ndërtojmë në fillim një uzinë me kapacitet përpunimi më të vogël dhe një sasi minerali ta ekspor-

tojmë të papërpunuar? Kështu mund të eksportojmë mineral dhe të importojmë çelik. Ne mund të blejmë edhe një fabrikë tjetër për të shkrirë në fillim një sasi të caktuar minerali në vit dhe të mos bëjmë investime të mëdha të menjëhershme. Ne duhet të shikojmë edhe çështjen që të mos rëndohemi shumë me investimet.

Ose të marrim çështjen e naftës, që ka rëndësi të madhe për ekonominë tonë. Të mos e përpunosh në vend dhe ta shesësh atë si bitum, është e qartë për të gjithë se nuk ka leverdi, por edhe të ndërtosh gjithë këto uzina për përpunimin e saj, pa u bazuar në rezervat e zbuluara, gjithashtu nuk është aspak e leverdishme, prandaj më parë duhet medoemos të rritim kërkimet për të gjetur naftë.

Për uzinën e shkrirjes së kromit mendoj të pranojmë që ajo të projektohet ashtu siç është parashikuar. Për hidrocentralin e Fierzës dhe uzinën komplekse të përpunimit të thellë të naftës, gjithashtu, jemi dakord.

Për impiantet që kërkohen për uzinën komplekse të petrokimisë do të ishte mirë të na thuhej më me saktësi sa kushtojnë të gjitha këto. Për ndërtimin e tyre nuk kemi kundërshtim, por më parë duam të dimë ç'llogari janë bërë, ç'mundësi kemi? Ndërtimi i këtyre fabrikave komplekse për uzinën e petrokimisë varet edhe nga disponibiliteti i naftës, prandaj tani për tani mund të mos nxitohemi.

Propozohet, gjithashtu, që të shtohet kapaciteti prodhues i Uzinës së Plehrave Azotike për fazën e parë dhe për fazën e dytë. E tillë është edhe kërkesa

që mendohet të bëhet për zgjerimin e kapacitetit të Uzinës së Superfosfatit në Laç dhe ndërtimin e uzinës së re të këtij lloji. Jam dakord ta zgjerojmë kapacitetin e këtyre uzinave, se, është e qartë, për bujqësinë ne nuk duhet të kursejmë. Nga shtimi i prodhimeve bujqësore e blegtorale varet drejtpërdrejt përmirësimi i nivelit të jetesës së popullit.

Për ndërtim e mekanizim minierash, si ajo e fosforitit së bashku me fabrikat përkatëse për pasurimin e mineralit, ose për zgjerimin e prodhimit në dy fabrikat e çimentos në Krujë dhe në Elbasan, gjithashtu jemi dakord.

Për ndërtimin e fabrikës së pasurimit të bakrit, gjersa thuhet që kemi rezerva bakri, edhe ne jemi dakord. Edhe për ndërtimin e fabrikës së pasurimit të kromit në Bulqizë dhe atë të pasurimit të mineralit të asbestit gjithashtu, jemi dakord të përfshihen në planet tona.

Mund të mendojmë edhe për rritjen e kapacitetit të mëtejshëm prodhues të uzinës së pjesëve të ndërimit për traktorë.

Po TEC-i me fuqi të instaluar katër mijë kilovat përse të ndërtohet pranë uzinës? Energjia elektrike që do të prodhojë ky është afërsisht e barabartë me atë të hidrocentralit «Lenin». Mua më duket nuk është e leverdishme që pranë çdo fabrike të ndërtojmë edhe nga një TEC. Në rast se uzina ka nevojë për avull, të shikojmë ç'mundësi të tjera kemi për ta plotësuar këtë nevojë.

Fabrika për prodhimin e letrës mendoj se na duhet, pse kemi nevojë të madhe për letër.

Për të gjitha lëndët e para rezervat duhen vërtetuar mirë që të mos na ndodhë më vonë të na thuhet se nuk ka. Në ngritjen e uzinave duhet të ecim gjithnjë duke u mbështetur në të dhëna të bazuara dhe jo sipas dëshirës. Çështjen e kam që për të gjitha ato objekte, të cilat, natyrisht, janë të nevojshme, të bëhen mirë llogaritë, me qëllim që të mos shtrëngohemi deri në vitin 1980. Ne duhet të kemi, gjithashtu, parasysh edhe situatën e jashtme se si do të zhvillohet, se si do të jenë marrëdhëniet me botën që na rrethon, nëse do të ketë presione politike kundër nesh, të cilat nuk mund të mos kenë influencën e tyre. Për këto vepra që mendohet të ndërtohen duhet që më parë të bëhen disa studime bazë, siç janë aftësia dhe zgjatja e kohës për ndërtimin e tyre, sigurimi i fuqisë punëtore të nevojshme etj., dhe pastaj dilet me konkluzionin për kreditë që duhen kërkuar.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP

**ATA QË ZGJIDHEN TË RINJ NË FORUMET
E PARTISË TË NDIHMOHEN QË TË AFTËSOHEN
NË PUNËN DREJTUESE**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

15 prill 1968

Radhët e elementëve të klasës punëtore në Parti tashmë janë rritur, prandaj midis gjithë këtij numri të madh komunistësh punëtorë, Partia mund të gjejë me qindra shokë e shoqe që e meritojnë për t'u zgjedhur në organet udhëheqëse, qoftë në plenumet dhe byrotë e komiteteve të Partisë në rrethe, qoftë në byrotë e organizatave-bazë ose si sekretarë të tyre, ashtu sikurse kemi zgjedhur edhe në Plenumin e Komitetit Qendror të Partisë.

Natyrisht, duhet pasur parasysh që këta të jenë shokë të pjekur e me stazh si punëtorë dhe në Parti. Nuk është e rekomandueshme të ngrihen në vende

1 Në këtë mbledhje u shqyrtua studimi dhe u miratuan orientimet për përmirësimin e mëtejshëm të përbërjes shoqërore të organeve të Partisë në rrethe e në bazë, si dhe mbi vendin që duhet të zënë komunistët punëtorë në këto organe.

me përgjegjësi në Parti komunistë që kanë vetëm 1 ose 2 vjet stazh si punëtorë. Pjekuria dhe stazhi i elementit që ngrihet në përgjegjësi dhe vjen në organet udhëheqëse të Partisë duhet të jenë të tillë që, kur një komunist punëtor të zgjidhet në forum, shoku që i lë vendin ta pranojë këtë veprim, i ndërgjegjshëm se vija e Partisë edhe në këtë çështje, si kudo, është e drejtë, se komunisti që vjen në atë vend, e meriton dhe ta ndihmojë me gjithë zemër me diturinë dhe me eksperiencën e tij.

Një problem shumë i rëndësishëm është ai i praktikës së punës që do të ndjekin byrotë e komiteteve të Partisë, për krijimin e sekretariatit pranë çdo komiteti partie rrethi¹.

Kujdesi ynë duhet të përqendrohet sidomos në çështjen që sekretariati që po krijojmë pranë çdo komiteti partie, të mos marrë funksionet e byrosë së komitetit të Partisë. Ky rrezik ekziston për arsye se sekretarët e komitetit të Partisë janë nga shokët kryesorë, ata kanë bërë një jetë të gjatë si anëtarë byroje dhe janë mësuar me njëri-tjetrin, kanë në vartësi aparatit dhe, duke qenë brenda komitetit të Partisë, mbledhen e bisedojnë gjithnjë kokë më kokë midis tyre, kështu që mund t'u duket sikur janë ata vetë udhëheqja e Partisë në rreth. Sekretariatit po e krijojmë për të lçhtësuar byronë nga shumë gjëra të

1 Më vonë, me vendim të Byrosë Politike të KQ të PPSH, datë 24 shkurt 1982, sekretariati i komitetit të Partisë të rrethit u shkri. Praktika tregoi se ai po merrte kompetenca të byrosë së komitetit të Partisë të rrethit, duke krijuar një hallkë që rëndonte strukturën organizative të Partisë.

dorës së dytë, me qëllim që kjo të merret më mirë me çështjet më të rëndësishme të drejtimit të punëve të Partisë në rreth. Të tërë sekretarët e komitetit të Partisë do të përbëjnë sekretariatit e komitetit të Partisë, në të cilin mund të marrin pjesë ose të thirren në çdo mbledhje të tij edhe përgjegjësi i organizatës së rinisë, i bashkimeve profesionale, ajo e gruas etj.

Jam i mendimit që në byronë e komitetit të Partisë të rrethit të bëjnë pjesë sekretari i parë, i cili duhet të merret me çështjet politike dhe ideologjike të Partisë, dhe një nga sekretarët e tjerë që do të merret me çështjet organizative. Sekretari i parë duhet të merret me tërë sektorët, po më shumë e në radhë të parë me këto dy probleme kyç. Kështu, çështjet ideopolitike dhe organizative do t'i drejtojnë dy sekretarët e komitetit të Partisë që do të jenë njëkohësisht edhe anëtarë të byrosë, kurse sekretarët e tjerë që do të drejtojnë ekonominë etj., mundet edhe të mos jenë anëtarë të byrosë.

Komunistët punëtorë që do të vijnë të rinj si anëtarë të byrosë së komitetit të Partisë nuk kanë eksperiencë në punët e udhëheqjes. Kjo është një vështirësi që duhet njohur dhe që e vë byronë para një detyre të rëndësishme për të bërë me këta shokë një punë të veçantë që të mos mbeten formalë në byro, por të ngrihen në nivelin e anëtarëve më me eksperiencë e më aktivë që ka byroja. Nuk duhet të krijohet në asnjë mënyrë një gjendje e tillë që të mos i pyesë e të mos i informojë njeri anëtarët e rinj të ardhur nga prodhimi, ose të mos këshillohet njeri me ta për pro-

blemet e ditës. Një qëndrim i tillë do ta futë byronë në një praktikë pune të gabuar, të atillë që këtyre shokëve të rinj vetëm t'u dërgohen materialet përkatëse për t'i lexuar, t'u kërkohet të vijë në mbledhjet e byrosë së komitetit të Partisë të japin një mendim gjatë mbledhjes, të dëgjojnë në fund sekretarin e parë dhe puna me këta të mbarojë me kaq. Kjo do të ishte fare e pamjaftueshme.

Vihet pyetja: Duhet të mbajnë përgjegjësi anëtarët e byrosë për gjithë punën e forumit? Sigurisht që duhet të mbajnë përgjegjësi kolektive dhe individuale. Midis tyre duhet të ketë edhe ndarje pune, por jo siç e kanë sekretarët. Një punëtor i uzinës mekanike që zgjidhet anëtar i byrosë së komitetit të Partisë të rrethit, ta zëmë, nuk mund të caktohet përgjegjës për punën me organizatat e masave, siç janë sekretarët e komitetit të Partisë, që janë specializuar për atë punë dhe që kanë edhe aparatin përkatës që i ndihmon për çdo çështje. Anëtari i byrosë mund të ngarkohet të ndjekë jetën dhe aktivitetin e një sektori ose të një tjetri dhe në fillim të ndihmohet e të udhëzohet si ta drejtojë atë sektor, por jo t'u hyjë çështjeve në detaje, siç u hyn sekretari i komitetit të Partisë. Punën konkrete do ta bëjnë kuadrot e specializuar që janë caktuar të punojnë për çdo sektor, kurse drejtimin e bën byroja e komitetit të Partisë, duke ndarë punën midis anëtarëve të saj. Kjo praktikë, më duket mua, nuk vendoset me receta, ajo varet më shumë nga puna që do të bëjnë vetë byroja dhe sekretari i parë i komitetit të Partisë.

Përse duhet ta bëjmë këtë ndarje pune? Për të

mos dubluar punën e njëri-tjetrit. Tani që kemi kua-dro të specializuar për çdo sektor nuk është nevoja të caktojmë edhe në byro njerëz të tjerë të specializuar, mbi të specializuarit. Anëtari i byrosë, nga ana e tij, duhet ta ndiejë se është e domosdoshme të jetë i lidhur ngushtë me punën që i është ngarkuar, të ndihmojë me kompetencë e të sjellë mendime të pjekura në byro, por edhe shokët e specializuar, qofshin këta sekretarë të komitetit të Partisë, përgjegjës të organizatave të masave etj., duhet ta ndiejnë vetë nevojën të drejtohen edhe tek anëtari i byrosë, që është ngarkuar me drejtimin e atij sektori, për të kërkuar mendim dhe ndihmë.

Një çështje tjetër që duhet pasur parasysh është edhe ajo e informimit dhe e mbajtjes në korent të vazhdueshëm të anëtarëve të byrosë së komitetit të Partisë për problemet aktuale të Partisë. Mua më duket se mbajtja në korent e shokëve të rinj të byrosë, sidomos në fillim kur sapo janë zgjedhur, duhet të bëhet praktikë e vazhdueshme, bile, po të jetë e mundur, çdo ditë, qoftë edhe për disa minuta. Anëtarët e byrosë, sidomos ata që kanë qenë më parë në udhëheqje të Partisë, mund të takohen çdo mbrëmje, sikur edhe për pak kohë, me sekretarin e parë ose me sekretarin tjetër që është anëtar i byrosë, dhe t'i thonë njëri-tjetrit se ç'të reja kanë dalë gjatë ditës. Sekretari, kur ka diçka, i informon edhe ata, jep mendimin e vet si mund të veprohet për të zgjidhur një problem, kërkon nëse janë edhe ata dakord ose i pyet mos kanë ndonjë mendim tjetër. Sekretari i parë i komitetit të Partisë, në çdo rast, shokëve të rinj du-

het t'u japë të kuptojnë se ai së bashku me ta udhëheqin tërë jetën e Partisë në rreth dhe për këtë mbajnë të gjithë së bashku përgjegjësi para plenumit të komitetit të Partisë të rrethit.

Mendimi im është se anëtarët e byrosë së komitetit të Partisë që punojnë në prodhim nuk duhet t'i heqim nga prodhimi, por duhet t'u krijojmë mundësitë e t'i ndihmojmë të bëhen të aftë dhe të fitojnë një zotësi të tillë që, edhe duke qenë në prodhim, të mbajnë vazhdimisht lidhje me punonjësit e qendrës së tyre të punës dhe me të tjerë jashtë saj. Pas kohës së punës ata duhet të takohen me masat jo vetëm në mënyrë të organizuar (dhe në këto raste duhet pasur parasysh që ata të mos mbeten duke u dërguar poshtë e lart nga një kolektiv në tjetrin), por ata vetë, sa herë që gjejnë kohë, të shkojnë, në një mënyrë ose në një tjetër, në ndërmarrje të tjera, ku të bisedojnë me sekretarin e organizatës-bazë ose me grupe punëtorësh etj. I gjithë ky aktivitet i tyre si anëtarë byroje duhet të mos i shkëputë në asnjë mënyrë nga prodhimi.

Këtu ne po japim vetëm disa orientime se si duhet të punojmë me shokët e rinj që vijnë në udhëheqje nga prodhimi, kurse praktika do të na tregojë si t'i zbatojmë këto më mirë. Rëndësi ka çështja që në këtë rrugë duhet të përgatitim elementë të rinj të klasës për t'i ngritur në udhëheqje, duke i bërë të kuptojnë si duhet problemet politike, ideologjike dhe organizative të Partisë, të kuptojnë problemet shtetërore dhe ekonomike etj., në mënyrë që niveli i tyre të vijë duke u ngritur vazhdimisht dhe në çdo rast. Kur të ketë nevojë Partia për kuadro të përgatitur, të

mos vihet në vështirësi, po mund të caktojë nga këta shokë në çdo kohë për të drejtuar çfarëdo sektori. Pra, duhet të punojmë me pikësynimin që këta njerëz të rinj, të ardhur nga radhët e klasës punëtore, pa dobësuar aspak punën në prodhim, t'i mësojmë dhe t'i bëjmë të aftë për të drejtuar me zotësi njerëzit e specializuar që do të kenë në vartësinë e tyre.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP

TERRORIZIMI I POPULLSISË SHQIPTARE — POLITIKË E PËRHERSHME E KLIKËS TITISTE

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

17 prill 1968

Në fund të muajit të kaluar autoritetet jugosllave organizuan në Manastir një proces gjyqësor kundër një grupi fshatarësh të ashtuquajtur agjentë në shërbim të RP të Shqipërisë. Edhe kësaj radhe propaganda titiste nuk mungoi të bëjë mjaft zhurmë rreth këtij procesi për të shpërthyer në sulme të ulëta kundër vendit tonë.

Fshatarët analfabetë nga rrethi i Strugës u akuzuan se gjoja kishin vendosur që «rajoni i Kosovës dhe i Metohisë dhe Maqedonia Perëndimore të bashkohen me Shqipërinë me anë të përdorimit të forcës». Me të vërtetë të fortë këta fshatarë! Ç'fuqi mbinjerëzore duhet të kenë pasur sa t'i hyjnë një ndërmarrjeje të tillë që të shkëputin me forcë rajone të tëra nga Jugosllavia dhe të «rrezikojnë integritetin e saj», siç deklaroi gjithë seriozitet prokurori titist! Por ai nuk u mjaftua me kaq. I tronditur thellë nga rreziku që i kanosej vendit të tij nga këta fshatarë, i akuzoi ata se

kanë bërë edhe një krim tjetër të rëndë, të cilin «demokracia e hapët» titiste nuk mund ta durojë. Këta paskan dashur të festojnë Ditën e Pavarësisë së Shqipërisë, të çlirimit të shqiptarëve nga zgjedha pesëqindvjeçare e pushtuesve osmanllinj dhe kanë arritur gjer atje sa të vendosin edhe dy flamurë shqiptarë.

Por kushdo bën pyetjen: Përse titistët jugosllavë e montuan me aq ngut këtë proces bajat, përse e bënë në Maqedoni dhe përse zgjodhën momentin e tani-shëm?

Vetë autoritetet titiste kanë pranuar këto kohët e fundit botërisht se të ashtuquajturat procese kundër «agjentëve shqiptarë» kanë qenë kurdisur nga UDB-ja për të shtypur e për të terrorizuar popullsinë shqiptare që jeton në Jugosllavi. Kryerja e akteve diversio-niste nga vetë organet e UDB-së, rekrutimi i njerëzve të degjeneruar që të hiqeshin si agjentë të Shqipërisë dhe të recitonin nëpër gjyqe tekste të mësuara përmendsh, krijimi i organizatave provokatore etj., kanë qenë dhe mbeten nga metodat më të zakonshme dhe më të preferuara të UDB-së titiste dhe të atyre që e drejtojnë këtë institucion terrorist kundërrevolucionar. Jo shumë larg, por vetëm para disa ditësh ata anuluan gjyqin e famshëm të Prizrenit të vitit 1956, i cili shërbeu si mbështetje e vrasjeve, e torturave dhe e persekutimeve çnjerëzore në Kosovë, të kryera nëpërmjet «aksionit të mbledhjes së armëve» e që dënoi me burgime të rënda një numër të madh fshatarësh e qytetarësh kosovarë të pafajshëm. Edhe në atë proces kishte «agjentë të dërguar nga RP e Shqipërisë» që, me hir e me pahir, recitonin pjesën e shkruar nga

UDB-ja, edhe atëherë prokurori i akuzoi fshatarët e paditur se donin të shkëputnin Kosovën nga Jugosllavia etj., etj.

Në dhjetor të vitit të kaluar në Prishtinë filloi të bëhej një gjyq kundër një grupi agjentësh të UDB-së të pakënaqur për rrëzimin e Rankoviçit. Ata pohuan botërisht se kishin djegur fabrika dhe kishin ngritur në mënyrë provokuese në disa vende flamurin e RP të Shqipërisë, me qëllim që të akuzonin pastaj, siç edhe bënë, si agjentë të Shqipërisë, ose si kundërshtarë të regjimit titist, njerëzit e thjeshtë e të ndershëm nga popullsia shqiptare e Kosovës.

Procesi gjyqësor i Manastirit, ashtu si edhe ato të mëparshmet të kësaj kategorie, është një shprehje e politikës antishqiptare e thellësisht armiqësore që regjimi i Beogradit ka ndjekur gjatë këtyre 24 vjetëve kundër vendit tonë. Ai zbulon orvatjet e tij të pandërprera për të paraqitur në një dritë të shtrembër politikën e RP të Shqipërisë, për të njollosur emrin e saj të mirë që ajo gëzon në gjithë botën, për të shpifur kundër saj dhe për ta akuzuar se ajo gjoja ndërhyr në punët e brendshme të një «shteti paqedashës», siç qenka Jugosllavia.

Por gjyqi i Manastirit nuk drejtohet vetëm kundër vendit tonë. Montimi dhe zhvillimi i tij në stilin më tipik udbash drejtohet në mënyrë të veçantë kundër popullsisë shqiptare në Jugosllavi. Ai është një shprehje e politikës shoviniste serbomadhe për terrorizimin dhe shkëmbëtarizimin e saj. Me anë të proceseve të tilla udhëheqësit jugosllavë kërkojnë t'i frikësojnë shqiptarët dhe t'i detyrojnë të pranojnë në

heshtje dhe pa rezistencë skllavërinë titiste. Tanimë është bërë praktikë e përditshme që kushdo nga shqiptarët në Jugosllavi që kërkon njohjen dhe mbrojtjen e të drejtave të ligjshme të kombësisë shqiptare të cilësohet si «agjent» i Shqipërisë. Duke organizuar gjyqe si ato që përmendëm më lart, titistët duan t'u tregojnë shqiptarëve se çfarë i pret po të guxojnë të ngrenë zërin për të drejtat, për liritë, për gjuhën shqipe dhe për zakonet e tyre.

Disa përpjekje të elementit shqiptar në Kosovë, në Maqedoni e në Mal të Zi për të ruajtur e për të zhvilluar kulturën dhe traditat kombëtare titistët i kanë shpallur gati si «mina» që do të hedhin në erë gjithë Jugosllavinë! Mjafton një kërkesë të vogël për hapjen e ndonjë shkolle në gjuhën shqipe, për të krijuar ndonjë institucion kulturor shqiptar, për të festuar ndonjë datë të shënuar nga historia e luftës së popullit shqiptar, për të botuar ndonjë gazetë ose revistë tjetër, që titistët serbomëdhenj të mos e kontrollojnë dot zemërimin e tyre; s'po përmendim reagimin e tyre të papërmbajtur kur shqiptarët kërkojnë të komunikojnë në gjuhën amtare edhe jashtë mureve të shtëpisë së tyre.

Shqiptarët e Kosovës, të Maqedonisë e të Malit të Zi kishin shprehur qëllimin dhe ishin përgatitur që të festonin sivjet 60-vjetorin e krijimit të alfabetit shqip në Manastir. Por përpara se ata të bënin festimet e parashikuara (në qoftë se do të lejohen), titistët, në mënyrë paraprake, organizuan në Manastir manifestimin e tyre, gjyqin kundër të ashtuquajturit grup «agjentësh shqiptarë». Manastiri nuk u

zgjodh rastësisht, ashtu si dhe flamurët shqiptarë ose «agjentët» e Shqipërisë nuk u vunë kot në proces. Titistët duan t'i thonë popullsisë shqiptare se ata që duan të kujtojnë «çështje të vjetra» të Manastirit apo të Prizrenit, të historisë së luftës së shqiptarëve për liri e pavarësi, për arsimin e kulturën shqiptare, për t'u njohur me jetën dhe me sukseset e vëllezërve të tyre në RPSH janë «agjentë» të Shqipërisë dhe se ata i pret fati i atyre të gjyqit të Manastirit.

Por veprimet e regjimit titist kundër popullsisë shqiptare, sado brutale dhe djallëzore që të jenë, tani më nuk mund të bëjnë efektin e dëshiruar, ato nuk mund të kalojnë pa ngjallur reaksion dhe kundërshtime të ligjshme. Shqiptarët e Kosovës, të Maqedonisë e të Malit të Zi kanë një kohë shumë të gjatë që luftojnë për jetën dhe për të drejtat e tyre kundër shovinizmit serbomadh dhe janë mësuar të zbulojnë përmbajtjen dhe qëllimet e manovrave të udhëheqësve të Beogradit, kanë mësuar të mbrohen nga ato dhe t'i kundërshtojnë me vendosmëri. E drejta është me anën e tyre, prandaj ata janë edhe të fortë e të pamposhtur.

*Botuar për herë të parë
në gazetën «Zëri i popullit»,
nr. 92 (6131), 17 prill 1968*

*Botohet sipas gazetës «Zëri i
popullit», nr. 92 (6131),
17 prill 1968*

KU PO SHKON ÇEKOSLLOVAKIA?

«NJERËZ, JINI VIGJILENTË»

Julius Fuçik

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

21 prill 1968

Procesi i kundërrevolucionit ultrarevizionist në Çekosllovakia po zhvillohet çdo ditë me ritëm të shpejtuar. Klika e Dubçekut dhe e elementëve të tjerë reaksionarë, që mbështetet në shtresat e ndryshme të borgjezisë, sidomos në elementët nacionalistë e fashistë sllovakë, në të gjithë ata që kanë «hesape» me diktaturën e proletariatit, në inteligjencien liberalo-revizioniste, në studentët e çakërdisur nga idetë e moralit borgjez, si dhe në borgjezinë ndërkombëtare, ka marrë epërsi të plotë. Ndërkohë, përkrahësit e klikës revizioniste të dështuar të A. Novotnit po përpiqen secili të shpëtojë pozitën e vet me «autokritika të singerta», ose po marrin një «pushim të detyruar» nga jeta politike dhe po futen në strofkë duke ëndërruar për «ditë më të mira».

Teoricienët e kursit të ri ultrarevizionist, si Smrkovski e të tjerë, mburren se tani Çekosllovakia «po çan rrugë të reja në një terren të paeksploruar», se ajo që po ndodh tani në Çekosllovakë është «eksperienca e parë e socializmit me të vërtetë demokratik në botë». Duke pasur parasysh ç'po ndodh tani atje dhe duke e përkthyer këtë frazeologji në gjuhën e thjeshtë, del qartë se në Çekosllovakë po rivendoset plotësisht kapitalizmi. Këtë e dëshmon edhe i ashtuquajturi «program veprimi» që u adoptua në plenumin e KQ të PK Çekosllovakë në fillim të prillit, program që agjencia çekosllovakë e lajmeve «Çeteka» e transmetoi nën titullin «Rruga çekosllovakë e socializmit».

Revizionistët çekosllovakë me të drejtë e quajnë këtë kthim në kapitalizëm si «rrugë të veçantë të tyre», sepse, ndonëse në esencë është e njëjtë me atë të titistëve, të revizionistëve sovjetikë dhe të revizionistëve të tjerë që janë ose jo në fuqi, ajo ka karakteristikat e veta, ka format e veta specifike.

Titistët kanë një kohë të gjatë që po përpunojnë sistemin e tyre të «vetadministrimit punëtor», i cili as sot, por as edhe mot nuk do të gjejë stabilitet, jo vetëm pse është antimarksist, por edhe se duke dashur të jetë një përpunim i maskuar dhe «origjinal» i rivendosjes së kapitalizmit në Jugosllavi, ka sjellë një kaos të papërshkruar në të gjithë strukturën politiko-ekonomike kapitaliste jugosllave, deri edhe në strukturën shtetërore federative jugosllave. Titistët, duke dashur të futin pesë para në grosh edhe klasën punëtores në sistemin e tyre kapitalist, krijuan një sistem të tillë anarkik në kapitalizmin e tyre, sa që e

kanë zor ose do t'u duhet kohë dhe masa akoma më drakoniane për të rivendosur tiparet karakteristike të shtypjes dhe të shfrytëzimit kapitalist. Sistemi i tyre nuk përputhet plotësisht me detyrimet që ata kanë ndaj padronëve të tyre kapitalistë dhe as me kërkesat dhe me detyrimet që i lidhin me partnerët e tyre revizionistë. Sistemi i vetadministrimit punëtor i titistëve, që «punëtor» ka vetëm emrin, po krijon shtresat e kapitalistëve të rinj, po bën koncentrimin dhe polarizimin e trusteve dhe të koncerneve. Por njëkohësisht ai po thëllon edhe më shumë kontradiktat e mëdha të sistemit titist, kontradiktat midis klasës punëtore dhe padronëve, midis fshatarëve të varfër dhe kulakëve, midis vetë padronëve, midis vetë kulakëve, midis republikave dhe nacionaliteteve të ndryshme etj.

Grupi i Dubçekut, siç po duket nga zhvillimi i ngjarjeve, përpiqet të evitojë që në Çekosllovakia të ndodhë kaosi jugosllav. Prandaj ai, në kushtet e reja, restaurimin e kapitalizmit në Çekosllovakia synon ta arrijë duke e kthyer Çekosllovakinë në format, në metodat dhe në brendinë kapitaliste të Çekosllovakisë borgjeze-kapitaliste të Masarikut dhe të Beneshit, duke përfituar njëkohësisht nga eksperiencia e vendeve të tjera kapitaliste, nga teoritë e tyre politiko-ekonomike. Kështu që revizionisti Dubçek po i bie drejt për të arritur më shpejt atje ku dëshiron dhe për të evituar, siç mendon ai, kontradiktat dhe vështirësitë. Prandaj në këtë të famshme «rrugë të socializmit çekosllovak» ne shohim të flitet me demagogji se gjoja regjimi është socialist dhe «mbështetet në klasën pu-

nëtores», por nuk flitet gjëkund për «vetadministrimin punëtor» titist.

Le ta shohim më nga afër këtë gështje.

Klika e Dubçekut deklaroi që në fillim haptazi se «duhet të bëhet ndryshimi i gjithë sistemit politik aktual të Çekoslovakisë». S'ka ku të vejë më qartë.

Grupi i ri, që mori fuqinë në Çekoslovaki, është një grup armik i socializmit, një grup antimarksist, armik i betuar i sistemit politik të diktaturës së proletariatit. Kur ky grup thotë se do të bëjë ndryshimin e gjithë sistemit politik aktual të Çekoslovakisë, kjo do të thotë se do të likuideojë edhe ato forma, gjoja socialiste ose proletare, që ruante grupi prosovjetik i Novotnit. Këtu nuk bëhet fjalë për korrigjime që mund t'u bëhen «regjimit socialist» të grupit revizionist të Novotnit, «gabimeve», «ngurrimeve» të tij. Jo, këtu është fjala për një transformim rrënjësor të regjimit politik në Çekoslovaki.

Në ç'drejtim po bëhet ky transformim politik? Në drejtimin e restaurimit të plotë të kapitalizmit. Atje po rivendoset me të gjitha tiparet themelore regjimi borgjez kapitalist. Por ky restaurim, për t'u maskuar, cilësohet nga ana e tyre si «rruga çekosllovake drejt socializmit».

Kjo është në thelb teza e njohur oportuniste e Toliatit për «rrugën italiane drejt socializmit», por e marrë nga ana e prapme. Të dyja këto rrugë antimarksiste e reaksionare kanë një qëllim të përbashkët: t'i shërbejnë kapitalizmit. Revizionistët italianë dhe ata çekoslllovakë puqen dhe janë plotësisht dakord me njëri-tjetrin. Revizionistët italianë, të cilët prej

kohësh kanë degjeneruar në antimarksistë, reformistë e kundërrevolucionarë, përpiqen, nëpërmjet «reformave të strukturës», rrugës paqësore, aleancave me partitë e borgjezisë, të vijnë në fuqi, të marrin pjesë në pushtetin borgjez. Këtë ata e quajnë «rrugë italiane drejt socializmit», në të cilën, sipas tyre, do të shkohet jo vetëm me Partinë Komuniste Italiane, por edhe me partitë e tjera të borgjezisë. Ky është një mashtrim i madh për klasën punëtore, i cili ka për qëllim shuarjen e luftës së klasave, mbytjen e revolucionit, është një ndihmë e posaçme për borgjezinë monopoliste, e përshtatshme në fazat aktuale të zhvillimit dhe të kalbëzimit të imperializmit. Pra, kjo është me pak fjalë rruga që ndjekin renegatët toliatistë.

Kurse revizionistët çekoslovakë, me Dubçekun në krye, nga ana e tyre, po ndjekin të njëjtën rrugë toliatiste, por duke ardhur nga drejtimi i kundërt. Këta e kanë relativisht më të lehtë punën, sepse nuk po gjejnë rezistencë nga marksistë-leninistët revolucionarë çekoslovakë, kurse toliatistët gjejnë rezistencë nga borgjezia, e cila, hëpërhë, në koniunkturata aktuale nuk i pranon në pushtet. Dubçeku dhe shokët e tij po ecin, pra, në rrugën e shkallmimit e të likuidimit të diktaturës së proletariatit, të të gjitha formave, organizimeve, ligjeve të saj, aq sa kishin ekzistuar. Klasa punëtore çekoslovakë ka kohë që nuk është më në fuqi. Ky është fakti. Derisa ishte në fuqi grupi revizionist i Novotnit, po punohej në thellësi në drejtim të restaurimit kapitalist, po shkohej drejt liberalizimit, por megjithatë ruheshin akoma

disa forma të jashtme të sistemit të diktaturës së proletariatit, sa për sy e faqe. Edhe këto forma i likuidoi grupi i Dubçekut, pasi likuidoi plotësisht grupin e Novotnit, spastroi kundërshtarët, duke i zëvendësuar të gjithë me elementë antiproletarë të patentuar. Në vend që të shkojë në socializëm, duke forcuar pozitën e Partisë Komuniste Çekosllloake, Dubçeku dhe klika e tij po i dobësojnë këto pozita dhe po i ndajnë me partitë e borgjezisë. Borgjezia synon të fitojë pozitën e humbura, siç po ngjet në Çekoslllovakë, por, kur ajo është në fuqi, nuk e ndan pushtetin me të tjerë, për shembull, me toliatistët, Longon me shokë.

Duke e ndarë fuqinë me borgjezinë, kuptohet se do të ndryshohet edhe sistemi politik dhe pikërisht këtë gjë po bën Dubçeku. Kuptohet gjithashtu se në ç'drejtim bëhet ky ndryshim i sistemit: po të ishte për të shkuar në ndërtimin e plotë të socializmit apo në komunizëm, patjetër nuk do të ishte as Dubçeku, as Novotni, as shokët e tyre borgjezë kapitalistë që do ta bënë këtë gjë.

Në kuadrin e transformimit rrënjësor të sistemit, grupi i Dubçekut po ndryshon natyrisht të gjitha strukturat politike, ekonomike, shtetërore, organizative dhe ushtarake. Të gjitha këto ndryshime, që po zhvillohen për të restauruar plotësisht kapitalizmin në Çekoslllovakë, aprovohen dhe duartrokiten me entuziazëm nga revizionistët italianë, të cilët me këtë shembull «të gjallë» duan t'i thonë borgjezisë së tyre: «Të tillë gjë duam të bëjmë edhe ne këtu në Itali, të tillë shërbëtorë tuaj besnikë jemi dhe do të

jemi ne, prandaj na jepni edhe neve një kockë, në rast se nuk dëshironi të keni mbi shpinë klasën punëtore».

Kurse revizionistët sovjetikë nuk mund të jenë kurrsesi dakord me këtë zhvillim që po merr aktualisht Çekosllovakia, megjithëse ata vetë ecin gjithashtu në rrugën e restaurimit të kapitalizmit në Bashkimin Sovjetik.

Ata kanë qenë dakord me revizionistët çekoslovakë deri në fazën kur klika e tyre e Novotnit ishte në fuqi dhe Çekosllovakia ishte një satelit i bindur i revizionistëve sovjetikë, gjoja një nga demokracitë socialiste «më të lira, më të pavarura ekonomikisht». Çekosllovakia e Novotnit i kishte vënë shkelmin diktaturës së proletariatit, ashtu si edhe revizionistët sovjetikë; Partia Komuniste Çekoslovakë gjoja ishte në fuqi, bile si e vetmja parti në fuqi, pra si «parti e gjithë popullit» dhe po degjenerohej po me ato forma e po me ato ritme që zbatonte edhe Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik. Edhe këtu çdo gjë ecte e koordinuar. Ekonomia çekoslovakë gjoja e pavarur, gjoja e përparuar, ishte bërë shumë e varur nga lëndët e para që i furnizonte udhëheqja sovjetike; politika e jashtme çekoslovakë ishte zyrë e Ministrisë së Punëve të Jashtme sovjetike etj. Pra, deri këtu kanë qenë dakord.

Por, u rrëzua Novotni dhe erdhi në fuqi klika e Dubčekut. Tani çdo gjë ndryshoi nga ato që u thanë më lart. Këtu u bë çarja, lindën kontradikta si për çështjen e maskës që duhej përdorur për shkelmin e diktaturës së proletariatit, si për çështjen e

partisë, si për çështjen e ekonomisë, për çështjen e politikës së jashtme, për strukturat etj. Këto kontradikta patjetër do të thellohen, konflikti do të acarohet.

Reaksioni çekoslovak, borgjezia çekoslovakë, që është pjesë përbërëse dhe e lidhur me shumë fije me reaksionin botëror e me borgjezinë ultrareaksionare evropiane, e di mirë ç'është diktatura e proletariatit. Ajo ka luftuar vetë me armë e me legjione të tëra kundër pushtetit sovjetik që vendosi Lenini në Bashkimin Sovjetik. Tani ajo nuk e reklamonte këtë luftë kundër diktaturës së proletariatit, por e zbatonte me konsekuencë. Ajo përdori si sfond të përgjithshëm tymin dhe baltën që kanë hedhur hrushovianët kundër diktaturës së proletariatit dhe veprës së saj të lavdishme në Bashkimin Sovjetik, përdori luftën e drejtë e të papërkulur që Partia Bolshevike me Stalinin në krye dhe pushteti sovjetik kanë zhvilluar në mënyrë shembullore kundër bjellogardistëve, trockistëve, deviatorëve tradhtarë të partisë, të socializmit e të marksizëm-leninizmit si një gogol për të frikësuar njerëzit dhe për të marrë revanshin.

Tradhtia e hrushovianëve i ka ndihmuar e i ndihmon borgjezët kapitalistë çekoslovakë për të kryer veprën e tyre kundërrevolucionare, prandaj nuk kanë përse të rënkojnë Brezhnjevët dhe Kosiginët kur Dubčekët sulmojnë periudhën e Gotvaldit, rishikojnë proceset e tradhtarëve, rehabilitojnë borgjezinë, fashistët, hajdutët, kriminelët, klerikët, kur ata spastrojnë tok me elementët e shëndoshë proletarë, që natyrisht goditen e persekutohen në radhë të parë, edhe njerëzit e grupit të Novotnit e të revii-

zionistëve sovjetikë. Në Çekosllovakia është krijuar klima e terrorit të bardhë, klima e revanshit borgjez mbi diktaturën e proletariatit. Në krye të Partisë Komuniste Çekosllovakie kanë ardhur njerëz të reaktionit më të tërbuar, të kamufluar si komunistë. Në rrugë zotëron hija e demonstratave të studentëve huliganë, të cilave u kanë vënë etiketën e rreme të «demonstratave të popullit». Ministria e Punëve të Brendshme e Çekosllovakisë drejtohet tani nga një person që ka dalë drejt e nga burgu, ku ishte i dënuar për veprimtari armiqësore kundër regjimit socialist. Ministrinë e Mbrojtjes po e drejton gjithashtu një person i dalë nga burgu politik. Çdo ditë, sipas lajmeve, punonjës të sigurimit çekosllovak po vrasin veten nëpër zyra, të tjerë arrestohen, të tjerë e të tjerë nga të gjithë sektorët me siguri do të arrestohen dhe do të dënohen nga diktatura borgjeze që po vendoset.

I gjithë ky transformim kapitalist, i gjithë ky terror i bardhë i spastrimeve e i revanshit, kryhet nën mantelin gjoja të legalitetit, gjoja se po dilet nga një «epokë e errët dhe e turbullt e vrasjeve, e gjyqeve arbitrare» etj., në një periudhë të «paqes mbi tokë, të drejtësisë së vërtetë shoqërore, të paqes klasore, të lirisë së njeriut» e të tjera slogane të propagandës së njohur kapitaliste, që vepron me thikë zhveshur.

Natyrisht, borgjezia çekosllovakie, që po merr pushtetin, së cilës i është përgatitur krevati nga tradhtarët revizionistë, po ecën përpara, duke hedhur në dorë njërin pas tjetrit të gjitha pozitat kyç, pa bërë gjeste të marra si ato të borgjezisë kapitaliste hunga-

reze në kohën e kundërrevolucionit të vitit 1956, por «urtë e butë e plot tigani» derisa është shuar çdo kundërshtim, derisa nuk duket në horizont ndonjë rezistencë nga klasa punëtore dhe nga masat punonjëse.

Borgjezia çekosllovake që po merr fuqinë, natyrisht e përdor pa hezitim termin «socializëm», i cili është bërë i modës, që nga Indira Gandhi e deri te fashisti Franko, për të gënjyer masat. Në këtë drejtim ajo ka marrë diplomën nga hrushovianët dhe nga titistët. Por këtu ajo ndahet nga sovjetikët, të cilët kanë deklaruar se po «shkojnë në komunizëm» dhe, në një kohë kur në të vërtetë kthehen me vendosmëri në kapitalizëm, përpiqen të ruajnë format dhe aparenecat e një rendi socialist, kurse revizionistët çekoslllovakë nuk merren me gjepura të tilla, ata hapur veprojnë për kapitalizmin. Pra, duke bërë «ndryshimin e sistemit politik», që do të thotë shkatërrimi i plotë i diktaturës së proletariatit dhe i ligjeve të saj në Çekosllovaki, borgjezia çekosllovake që ka ardhur në fuqi e sheqeros këtë hapje të hidhur me një frazë «mirësjelljeje» karshi klasës kundërshtare të saj, proletariatit, me atë të «moskthimit në metodat e vjetra subjektive». Për revizionistët modernë ligjet e diktaturës së proletariatit janë metoda subjektive, kurse ligjet borgjeze kapitaliste «janë të shenjta, janë objektive, janë njerëzore».

Borgjezia çekosllovake që po vjen në fuqi, në pikat e programit «të partisë së saj komuniste» thotë pikërisht se «duhet të gjenden dhe të bëhen ligje më të mira se si të mbrohen më së miri dhe më me ve-

ndosmëri të gjitha të drejtat dhe prona private». Këtu s'ka dorashka. Prona personale, prona private! Këtu nuk bëhet fjalë as për furcën e dhëmbëve, as për orën e dorës dhe krevatin e shtëpisë. Këtu bëhet fjalë për diçka të madhe, antiproletare, antisocialiste, kapitaliste, për pronën private kapitaliste që po restaurohet. Për këtë pronë duhet të krijohen dhe të vendosen ligje të reja, që i kishte prishur diktatura e proletariatit dhe këto ligje të reja të mbrojnë me vendosmëri këto të drejta që u rijepen pasanikëve, borgjezisë së qytetit dhe të fshatit.

Si do të procedohet në rikrijimin e kësaj prone kapitaliste? Në programin e revizionistëve çekoslovakë thuhet shprehimisht: «Metodat ekzistuese të administrimit dhe të orientimit të ekonomisë kombëtare u vjetruan dhe kërkojnë ndryshime të ngutshme». Këtu nuk është thjesht çështja e formave të reja të administrimit të ekonomisë, por është puna që nëpërmjet këtyre formave të ndryshohet sistemi klasor i ekonomisë. Sigurisht, revizionistët çekoslovakë kanë një eksperiencë të madhe të administrimit dhe të organizimit të një ekonomie kapitaliste, të vogël dhe të madhe, dhe tani që morën plotësisht fuqinë në dorë e i këputën të gjitha ato fije të vjetra që i mbanin akoma të lidhur, ata do të bëjnë transformimin rrënjësor të industrisë dhe të bujqësisë, të tregtisë dhe të tërë ekonomisë sipas modelit të një shteti borgjez kapitalist të përparuar. Në këtë rrugë ata do të ndihmohen nga kapitalet gjermanoperëndimore dhe amerikane, në radhë të parë, dhe nga rikthimi i kapitaleve e i kapitalistëve çekoslovakë nga këto vende e

nga vendet e tjera perëndimore. Këto kredi nuk mund të jenë kredi të thjeshta, dhënë një shteti nga një shtet tjetër me një përqindje të caktuar, por do të kenë karakter ekonomik dhe politik të caktuar. Nëpërmjet këtyre kredive do të konsolidohet godina kapitaliste që po rindërton borgjezia çekosllovake. Kapitalizmi shtetëror që po restaurohet në Çekoslovakia do të ketë mbështetjen kryesore në industrinë e brendshme dhe në atë të rene që do t'i japin kapitalistët e jashtëm.

Aktualisht në Çekoslovakia po forcohen pozitat politike të klikave të ndryshme borgjeze kapitaliste në pushtet. Ky do të jetë një proces që do të vazhdojë deri në zgjedhjet e ardhshme, ku klikat e rehabilituara borgjeze, që qenë përmbysur nga revolucioni, shprejnë të rifitojnë qytetarinë e humbur dhe të rimarrin plotësisht fuqinë në duart e veta. Natyrisht edhe këtë do ta marrin, do ta ndajnë me njëra-tjetrën, jo me dashamirësi për njëra-tjetrën, por me egërsi si ujtit. Ligji i xhunglës do të mbretërojë edhe këtu, pavarësisht nga fraza demagogjike e programit të Partisë Komuniste Çekosllovake, e cila thotë paturpësisht: «Në fazën e tanishme është karakteristike se nuk ekzistojnë më klasa antagoniste».

Pra, në Çekoslovakia jo vetëm që ekzistojnë klasat dhe antagonizmi midis tyre, i cili do të shkojë duke u ashpërsuar, por aktualisht po rehabilitohen grupet e ndryshme kapitaliste, po organizohen e po sistemohen ato politikisht dhe organizativisht për të përsosur edhe organizimin e drejtimit të ekonomisë së re kapitaliste. Partive borgjeze që po vijnë në fuqi, ligji i ri u cakton

të drejtën dhe detyrën që, duke qenë «parti të pavarura në front, kanë përgjegjësi në administrimin e vendit dhe të shoqërisë». Ligji i ri i revizionistëve çekoslovakë e shpreh haptazi se «interesi i grupeve shoqërore duhet të mbrohet dhe interesat e tyre ekonomike duhet të merren parasysh në politikën ekonomike».

Kështu pra jo vetëm që ekonomia e shtetit do të drejtohet nga grupe të ndryshme kapitalistësh, të inkuadruar në parti të ndryshme, duke përfshirë këtu edhe Partinë Komuniste Çekoslllovakë, por edhe grupe të tjera shoqërore ekonomike do të mbijnë si kërpu-dhat pas shiut jashtë sferës së ekonomisë shtetërore. Kjo do të thotë që do të krijohen industri private të vogla e të mëdha, do të shpartallohet kolektivizimi dhe do të lindin fermerët e mëdhenj kapitalistë, do të krijohen banka të reja kapitaliste të vendit e të huaja që të financojnë këtë ndërmarrje kapitaliste të madhe që po formohet në qendrën e Evropës.

Kapitalistët çekoslllovakë në fuqi, pa dorashka, do të ndërtojnë një shtet burokratik, teknokratik, një regjim trustesh dhe koncernesh të mëdha ekonomike, që të jenë në nivelin e teknikës «moderne» të tregut kapitalist botëror. Për t'ia arritur kësaj sa më shpejt, duhet të çlirohen nga gjendja aktuale, duhet të shkëputen nga traditat «socialiste» të krijuara të ekonomisë, duhet të shkatërrojnë lidhjet dhe format e punës e të bashkëpunimit aktual që kanë me revizionistët sovjetikë dhe me revizionistët e tjerë modernë, duhet ta integrojnë plotësisht Çekoslllovakinë në INGRANAZHET E EKONOMISË KAPITALISTE BOTËRORE.

Planifikimi i ekonomisë së tyre, ashtu edhe decentralizimi i drejtimit të saj, natyrisht, nuk mund të mos marrin forma krejt të reja, të cilat duhet t'u përshtaten kërkesave të koniunkturave të reja politiko-ekonomike të krijuara. Këto mund të mos jenë dhe nuk ka të ngjarë të jenë të njëllojta me ato që janë bërë dhe po bëhen në vende të tjera revizioniste. Modernizimi mbi një bazë kapitaliste i industrisë çekoslovakë, që tani konsiderohet nga më modernet në kampin revizionist, do të sjellë pa dyshim ndryshime në format, qoftë të strukturave, qoftë të metodave të drejtimit. Në këtë do të mbahen natyrisht parasysh edhe shumë çështje specifike: jo vetëm tregu i jashtëm, jo vetëm interesat e investitorëve kapitalistë të huaj, por edhe interesat e veçantë të çekëve e të sllovakëve dhe interesat e grupeve kapitaliste të brendshme, të formuara ose në formim.

Me një fjalë, ekipi antimarksist i Dubçekut, që u vendos në krye të Çekoslovakisë, po e çon këtë me ritëm më të shpejtë drejt kapitalizmit. Ai po bën spastrime radikale të kundërshtarëve, të cilët herë i quan «novotnistë», herë «revizionistë», herë «stalinistë», dhe nuk do të tolerojë në vende kyç drejtuese asnjë person të kohës së Gotvaldit ose të Novotnit. Në fuqi dhe rreth tij ai sjell elementët më të dyshimtë, më të zjarrtë antimarksistë, revizionistë me damkë, klerikale, njerëz të dalë rishtazi nga burgu në bazë të ligjit të ri që shpallën «për rehabilitimin e plotë të komunistëve dhe jokomunistëve që kanë qenë viktime të viteve të kaluara».

Me këto veprime, klika e Dubçekut, duke forcuar

haptazī pozitat e kapitalizmit në Çekosllovakia, u thotë revizionistëve sovjetikë, dhe që ta marrë vesh tërë bota: as në normat tuaja hrushoviane ne nuk do të ndalemi dhe kemi vendosur të shkojmë hapur më tej edhe kundër vullnetit tuaj, por bile edhe t'ju akuzojmë e t'ju demaskojmë në sy të revizionistëve të tjerë si revizionistë konservatorë e të demoduar, që s'bëni hapa përpara drejt «demokratizimit dhe liberalizimit» të predikuar. Kurse për botën kapitaliste ekipi i Dubçekut jep garanci të mëdha, shpresa dhe besim të plotë.

Ky ekip tradhtarësh, natyrisht, do të bëjë reforma rrënjësore, politike, kushtetuese, ekonomike. Pa asnjë dyshim do të vijnë të gjitha me radhë, por, siç thotë një fjalë popullore, çdo pemë piqet në kohën e vet. Aktualisht e shohim këtë ekip të ulë rolin udhëheqës të Partisë Komuniste Çekosllovakë, ta dobësojë atë ideologjikisht e politikisht, ta shproletarizojë e ta borgjezojë plotësisht, të ngrejë rolin e Frontit Kombëtar në një pozitë të paparë, të sigurojë me ligj krijimin, të drejtat dhe funksionet e partive të tjera borgjeze, me të cilat po ndan pushtetin dhe po bashkëvepron për konsolidimin e kapitalizmit. Nga ana tjetër, ky ekip po përgatit federalizmin, domethënë t'i bëjë gjoja «të barabartë në të gjitha të drejtat si çekët, ashtu dhe sllovakët». Duke pasur parasysh kursin që ka marrë klika revizioniste e Dubçekut, kjo, në fakt, do të thotë se ajo nxit dhe do të mbajë ngritur armën e nacionalizmit e të shovinizmit për të goditur socializmin, çdo lëvizje revolucionare, për të shpejtuar rivendosjen e kapitalizmit, për të favorizuar

në këto koniunktura nacionalizmin sllovak dhe për ta pasur për çdo kohë një armë balancimi.

Sigurisht, ekipi i Dubçekut, nën pretekstin se çekët e Novotnit e kishin lënë pas dore «motrën e varfër» Sllovakinë, do ta financojë atë më shumë në zhvillimin kapitalist të saj, sa të arrijë nivelin e «motrës së përparuar e të favorizuar», por pa lënë mënjanë modernizimin e industrisë çeke.

Pa dyshim, në këtë çështje themelore do të ketë kontradikta të vazhdueshme, do të ketë mungesë stabiliteti dhe ne do të asistojmë në një përleshje të vazhdueshme në mes kapitalistëve çekë dhe sllovakë, në mes këtyre dhe padronëve kapitalistë të huaj që kanë influenca më shumë, sepse kanë investuar kapitale më shumë në njërën ose në tjetrën pjesë të kësaj federate ose konfederate me emrin fals «Republika Socialiste Çekosllovake».

Ekipi revizionist çekoslllovak, që do të drejtojë, jo vetëm duhet të balancojë forcat në platformën nacionaliste çeke dhe sllovake, por është i detyruar t'i balancojë edhe në drejtimin e partive politike borgjeze kapitaliste që rehabilitohen dhe të atyre që do të krijohen të reja. Të gjitha këto parti po organizohen, po organizojnë shtypin e tyre, organizatat e tyre të bashkimeve profesionale, të rinisë, po përpunojnë gjithsecila opinionin e vet në masa. Zhurma dhe kërkesat e këtyre organizatave, të studentëve, të shkrimtarëve borgjezë, të gazetarëve të shfrenuar për pavarësi nga Partia Komuniste, revizioniste, deri në pretendimet për të pasur deputetët dhe përfaqësuesit e tyre të veçantë në organet shtetërore, s'janë gjë tjetër

veçse një aspekt i rigjallërimit të grupeve të ndryshme të borgjezisë, i organizimit dhe i përpjekjeve të tyre për pjesë në pushtet e në drejtimin e vendit.

Tani për tani çdo gjë bëhet nën etiketën pseudosocialiste dhe gjoja tradicionaliste të «hegjemonisë demokratike të vërtetë të Partisë Komuniste Çekoslllovakë», e cila aktualisht është partia më e madhe në numër. Por një situatë e tillë është e përkohshme. Forcimi i kapitalizmit në Çekosllovaki do të bëjë edhe diferencimin e partive, ai mund të zbresë nga «piedestali» Partinë Komuniste Çekoslllovakë revizioniste, ta katandisë këtë në një parti me tipare krejt socialdemokrate ose socialiste përëndimore. Parti të tjera mund të marrin supremacinë e fuqinë, mund të bëhet më e fuqishme ajo parti që nuk ka as gjurmën më të vogël socialiste dhe që do të përfaqësojë grupin kapitalist çek apo sllovak më të fortë, të lidhur ngushtë me grupimet kapitaliste të huaja më të fuqishme.

Ekipi aktual revizionist në krye të Partisë Komuniste Çekoslllovakë dhe të shtetit çekoslllovak e përgatit këtë proces të zhvillimit kapitalist nën maskën e «socializmit» për të evituar goditjet hegjemoniste të revizionistëve sovjetikë, për të mbajtur në gjumë klasën punëtore dhe shtresat e tjera punonjëse, për të evituar dhe për të shtypur goditjet dhe turbullirat eventuale të brendshme. Kurse bota kapitaliste e ka fare të qartë ku shkon klika e Dubčekut.

Revizionistët e Dubčekut reklamojnë se tani s'ka më asnjë kufizim, asnjë censurë, asnjë vizë hyrjeje dhe daljeje në pasaportat çekoslllovakë dhe të vende-

ve perëndimore, se asnjë çekoslovak nuk mund të quhet i arratisur politik ose emigrant politik, në rast se del dhe qëndron jashtë. Me një fjalë, klika e Dubçekut e ka kthyer vendin në një han, ku hyjnë e dalin lirisht nga Çekosllovakia në Perëndim e anasjelltas njerëzit, mallrat dhe idetë.

Çekosllovakët po bëjnë bujë për vënien në dukje të të drejtave të minoriteteve kombëtare, sikur këto nuk ekzistonin më parë. Kështu, me sa duket, po përgatitet terreni për të rifitur në Çekosllovakë të një milion e ca sudetët gjermanë, me fjalë të tjera për forcimin e lidhjeve me kapitalistët e Bonit dhe për vërshimin e kapitaleve investuese të Gjermanisë Perëndimore. Kjo do të sjellë patjetër një ndryshim rrënjësor në politikën e jashtme çekoslovake, në qëndrimet politike të saj ndaj Republikës Demokratike Gjermane, Traktatit të Varshavës dhe në përgjithësi ndaj politikës aktuale të shteteve të pellgut të Evropës Qendrore.

Në Çekosllovakë po predikohet tani me zell mendimi se ajo, nga vetë pozita e saj gjeografike, është e destinuar që të shërbejë si «urë midis Lindjes dhe Perëndimit» dhe po flitet çdo ditë për ndjekjen e një «politike evropiane aktive», për një politikë më aktive për «bashkimin e Evropës» etj. Klika e tanishme sunduese në Çekosllovakë nuk e fsheh aspak dëshirën e saj të zjarrtë për të normalizuar marrëdhëniet e gjithanshme me Bonin. «Sigurimet» e saj se gjoja do të përkrahë e do të mbrojë interesat e Republikës Demokratike Gjermane janë false, siç janë false edhe deklaratat se në politikën e saj të jashtme guri the-

meltar do të mbetet gjoja miqësia me Bashkimin Sovjetik.

Në drejtimin e politikës së jashtme, vija aktuale e Çekosllovakisë është krejt provizore, ajo do të konkretizohet shpejt në të ardhmen më qartë drejt Përrëndimit. Emisarët e saj janë çuar me kohë në Amerikë, në Angli e gjetkë. Edhe përmbajtja, edhe format aktuale të politikës me revizionistët sovjetikë dhe me revizionistët e tjerë nuk mund të jenë të qëndrueshme, ato do të pësojnë ndryshime ndoshta dhe «dramatike».

Të gjitha këto ndryshime që po ngjasin dhe do të vazhdojnë të ngjasin në Çekosllovakia, decentralizimi dhe transformimi i ekonomisë, i sistemit politik, i sistemit konstitucional, i aleancave të brendshme dhe të jashtme, rivaliteti nacionalist çek e sllovak, modernizimi dhe lidhja e industrisë me trustet kapitaliste të huaja, kthimi i bujqësisë në rrugën e kapitalizmit, rikrijimi i pronës private, grupimi i kapitalistëve në truste e në koncerne, gjetja e burimeve të reja të lëndëve të para dhe e tregjeve për eksportimet, të gjitha këto dhe të tjera nuk mund të shkojnë pa përleshje të brendshme dhe të jashtme, të gjitha këto nuk mund të mos influencojnë brenda në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera revizioniste të Evropës dhe të mos hasin në rezistencën e tyre.

Imperialistët e ndryshëm do t'i vënë një rëndësi të veçantë dhe do t'i japin një ndihmë të madhe borgjezisë kapitaliste çekosllovakë për restaurimin e plotë të kapitalizmit, duke u nisur nga arsye, interesa, synime e përfitime ekonomike, politike, ideologjike dhe strategjike. Çekosllovakia bëhet për ta një gur rrotu-

llues në Evropën Qendrore dhe Juglindore, ku ndeshen interesat e revizionistëve imperialistë sovjetikë me interesat e imperialistëve perëndimorë, ku ndeshen rreziqet e një kthese në luftën revolucionare, në luftën e klasave midis proletariatit e masave punonjëse, nga njëra anë, dhe klikave revizioniste që kanë uzurpuar fuqinë në parti dhe në shtet, nga ana tjetër.

Me restaurimin e kapitalizmit në Çekoslllovakia imperializmi kërkon të evitojë edhe shembullin e keq të kaosit titist, të realizojë sa më shpejt likuidimin e varësisë ekonomike dhe politike të Çekoslllovakisë nga Bashkimi Sovjetik, të arrijë njëkohësisht borgjezimin e arsimit dhe të kulturës, kështu që Çekoslllovakia të bëhet një mbështetje dhe një vend tipik revizionist tërheqës për Hungarinë, Bullgarinë, Poloninë etj.

Nuk janë më aq lidhjet ideologjike që i mbajnë të bashkuara shtetet revizioniste me revizionistët sovjetikë sesa çështjet ekonomike dhe Traktati i Varshavës. Po u zgjidhën këto nyje, u zgjidhën të gjithë nga diktati i udhëheqjes sovjetike. Në qoftë se imperializmi amerikan dhe shtetet e tjera imperialiste arrijnë t'i këputin edhe këto nyje, Bashkimi Sovjetik revizionist u izolua, u la në baltë nga aleatët e tij revizionistë.

Për të mos folur për Jugosllavinë titiste, edhe ndonjë vend tjetër revizionist mban lidhje formale politike dhe mbrojtjeje me Bashkimin Sovjetik. Këto lidhje kufizohen vetëm në shkëmbime tregtare reciproke dhe çdo gjë është e acaruar. Tani varet se ç'rrugë do të marrin punët në Çekoslllovakia dhe ato s'ka si marrin ndryshe, veçse ashtu si u tha më lart, prandaj kjo që po ndodh atje përbën një disfatë të

madhe për klikën udhëheqëse sovjetike, sepse rrezikon fund e krye politikën e saj kundrejt satelitëve revizionistë. Në shembullin e Çekosllovakisë mund të marrë këtë rrugë të hapur edhe Hungaria apo Polonia dhe atëherë Traktati i Varshavës, lidhjet politike, lidhjet gjoja ideologjike, të gjitha u shembën. KNER-i po ashtu. Dhe atëherë Bashkimi Sovjetik revizionist do të pësojë një tronditje të madhe politike dhe ekonomike. Sidoqoftë një proces i tillë do të bëhet, ai është në vazhdim. Të gjitha këto ndryshime politike dhe ideologjike të bujshme që bëhen në Çekosllovakia kanë dhe do të kenë reperkusione të mëdha në Bashkimin Sovjetik, pavarësisht se revizionistët sovjetikë përpiqen që ato që po ndodhin në Çekosllovakia t'i maskojnë, t'i fshehin, t'i zvogëlojnë, t'i shtrembërojnë për të ndihmuar kauzën e tyre, për të ulur efektin dhe për të evituar pasojat. Por çdo gjë mësohet, në mos sot do të mësohet nesër, dielli me shoshë nuk fshihet, ky është një reaksion zinxhir. Dhe atëherë në Bashkimin Sovjetik, në kushtet kur atje prej kohësh zien kriza e gjithanshme e regjimit revizionist hrushovian, do të vështirësohet më tej pozita e lëkundur e klikës sunduese, do të acarohen kontradiktat midis udhëheqjes aktuale sovjetike, që është e zemëruar në kulm kundër klikës ekstremiste çekosllovakë (por që përpiqet të kurdisë mjete e mënyra për ta hedhur në erë, duke e minuar nga brenda ose me anë presionesh e shantazhesh të shumëllojshme), dhe elementëve sovjetikë proçekosllovakë, të cilët gjithashtu kërkojnë liri veprimi, «demokratizim» e ndryshime. Nga ana tjetër e mbi të gjitha, udhëheqja revizioniste sovjetike ka

shumë frikë nga ngritja e valës së revolucionit, sepse të gjitha këto disfata vërtetojnë përpara masave dhe klasës punëtore sovjetike tradhtinë e krerëve revizionistë. Në këto situata të rënda për ta, udhëheqësit revizionistë sovjetikë, të përçarë sigurisht në mes tyre, përpiqen të ruajnë aparenat e unitetit në udhëheqje, përpiqen të nënvleftësojnë disfatat e tyre jashtë, përpiqen të ruajnë brenda «statukuonë» dhe amullinë ideopolitike, përpiqen të nanuritin partinë dhe klasën punëtore me parulla gjoja të majta e revolucionare, për të dhënë përshtypjen se «liberalizmi nuk hyn në shoqërinë sovjetike». Mirëpo të gjitha këto përpjekje nuk zgjidhin shumë gjëra, dhe ç'mendon se rregullon sot të priset nesër. Kjo është dialektika e gjërave.

Jo vetëm brenda në Bashkimin Sovjetik janë ngritur valët, por ato valë po e godasin revizionizmin sovjetik nga të katër anët nga jashtë, në radhë të parë nga partitë e vërteta marksiste-leniniste dhe nga të gjithë revolucionarët në botë, të cilët shohin, gjykojnë dhe luftojnë. Por përveç luftës së marksistë-leninistëve, ne shohim dhe do të shohim edhe më hapur më vonë se si «partnerët» revizionistë të revizionistëve sovjetikë në vendet kapitaliste do t'u lënë pendët. Tani ata kanë dy dashnorë, një të zemrës dhe një për t'i marrë para. Për revizionistët italianë, francezë dhe për revizionistët e tjerë të vendeve kapitaliste, revizionizmi çekoslovak do të bëhet dashnori i parë, i zemrës, sepse është ai që shpejtoi dhe po realizon ëndërrën e tyre, sepse me të ata do të mburren përpara kapitalistëve të tyre dhe në shembullin e tij do të lypin një krodhë në sofrën e kapitalizmit. Kurse revii-

zionizmi sovjetik është dashnori plak, që duhet të japë subvencionet. Revizionistët italianë, deputetë dhe senatorë, në mitingje dhe në televizion thonë hapur: ne nuk jemi «që këtu në Itali të vendoset një regjim socialist si në Bashkimin Sovjetik, por një regjim socialist, siç u vendos aktualisht në Çekosllovakia».

Grupi i Dubçekut, në rrugën e rivendosjes së kapitalizmit, aktualisht u ka dhënë liri veprimi të gjithëve, me përjashtim të proletarëve, të revolucionarëve, të marksistë-leninistëve. Për të gjithë reaksionin është shpallur «liria e shtypit» dhe në fakt në Çekosllovakinë e sotme nuk ka censurë as për reaksionin më të zi, ndërsa klasës punëtore dhe komunistëve revolucionarë u është hequr edhe liria e fjalës dhe e diskutimit brenda në parti, pa folur për të drejtën që të dalin në rrugë, të kundërshtojnë reaksionin ose të shkruajnë në shtyp. Një gjendje e tillë nuk ekziston as në vendet kapitaliste, ku është në fuqi reaksioni, por ku megjithëkëtë marksistë-leninistët kanë të drejtën të organizohen, të manifestojnë, të bëjnë grëva, të bëjnë mbledhje dhe të kenë shtypin e tyre. Ekipi i Dubçekut, pra, shkon hapur dhe pa dorashka akoma më tej: i gjithë reaksioni, të gjithë fashistët mund të flasin si të duan dhe ku të duan, ndërsa revolucionarët i pret burgu.

Me këtë lloj «lirie» ekipi revizionist çekoslovak është konsekuent në rrugën e tij, ai kërkon dhe punon që të shpejtojë dhe të aktivizojë degjenerimin e çdo gjëje të mirë të së kaluarës. Në këtë rrugë atij i vjen në ndihmë edhe shtypi borgjez i vendeve kapitaliste, të cilit i janë hapur portat e Çekosllovakisë

kaq sa përfaqësuesit e tij mund të asistojnë edhe në mbledhjet e organizatave-bazë të Partisë Komuniste Çekoslllovakë.

Kundërrevolucioni në kundërrevolucion në Çekoslllovakë po përpiqet të konsolidojë pozitat e porsafituara dhe po kremton fitoren. Por klasa punëtore dhe revolucionarët çekoslllovakë akoma s'e kanë thënë fjalën e tyre. Komunistët e vërtetë marksistë-leninistë dhe punëtorët çekoslllovakë a do ta lejojnë më gjatë tradhtinë që po u bëhet popullit çekoslllovak dhe socializmit?

Kushdo tani e ka të qartë se sot në Çekoslllovakë ligjin e bën borgjezia, e bëjnë reaksionarët dhe fashistët, huliganët me flokë të gjatë, të financuar nga borgjezia ndërkombëtare. A do ta lejojnë klasa punëtore dhe revolucionarët çekoslllovakë një gjë të tillë?

Komunistët revolucionarë dhe klasa punëtore e Çekoslllovakisë duhet të shkelmojnë «liritë» false të klikës së Dubçekut. Si mund të durohet që fashistët, tradhtarët dhe ish-të burgosurit të flasin e të sulmojnë lirisht marksizëm-leninizmin, të shajnë si huliganë kujtimin e K. Gotvaldit e të marksistë-leninistëve të tjerë dhe revolucionarët çekoslllovakë të mos shpërthejnë kundër tyre, të mos kenë të drejtë të mbrojnë çështjen e komunizmit? Komunistët revolucionarë duhet të thyejnë të gjitha pseudonormat e vendosura në Partinë Komuniste Çekoslllovakë nga Novotni dhe Dubçeku, me të cilat u janë lidhur këmbët e duart atyre, dhe të vendosin normat leniniste të Klement Gotvaldit, i cili ka thënë: «Partia duhet të jetë udhëheqëse e masave, organizatore e luftës së tyre... Sa

më e ashpër të jetë situata, sa më të acaruarat të jenë kontradiktat klasore, aq më i rëndësishëm e aq më vendimtar bëhet roli i partisë». Klement Gotvaldi ka thënë gjithashtu: «Çdo oportunistët, çdo lëkundje, çdo pajtim me oportunistët, çdo mungesë principialiteti, çon patjetër në likuidatorizëm». Vetëm komunistët revolucionarë dhe klasa punëtore, duke u ngritur në këmbë, mund t'i prishin planet tradhtarë që kanë kurdisur kundër socializmit në Çekoslllovakë klika e Novotnit dhe të Dubčekut, e para e ndihmuar nga revizionistët sovjetikë dhe e dyta nga reaksioni ndërkombëtar.

Klika ultrarevizioniste e Dubčekut ka frikë nga populli dhe nga komunistët e vërtetë, ajo ka frikë nga garda e vjetër që ruan të gjallë frymën e luftërave klasore revolucionare, të luftës partizane, të ngjarjeve të shkurtit 1948¹, ka frikë nga klasa punëtore dhe nga komunistët e frymëzuar sipas mësimëve të marksizëm-leninizmit, nga K. Gotvaldi. Ishte për shkak të kësaj frike që Novotni dhe Dubčeku, si njëri dhe tjetri renegatë e armiq të proletariatit, qëruan hesapet e tyre në prapaskenat e errëta të kështjellës së Pragës duke e lënë mënjanë klasën punëtore e pas shpinës së saj, duke iu shmangur e duke iu trembur gjykimit të saj. Klika e Dubčekut ka frikë nga milicia punëtore që ka armët në dorë, prandaj kjo klikë po përpiqet ta çar-

1 Në shkurt 1948, nën udhëheqjen e PK Çekosllovake punonjësit çekoslllovakë shkatërruan përpjekjet e kundërrevolucionit. Ngjarjet e shkurtit çuan në krijimin e qeverisë së re me në krye Gotvaldin më 25 shkurt 1948.

matosë klasën punëtore. A do ta lejojë kjo një gjë të tillë? Fitoret e klasës punëtore në Çekosllovakia, sido që janë, po kërcënohen seriozisht nga borgjezia, nga fashistët, nga uzurpatorët. Prandaj, o sot o kurrë duhet të tregohet forca e saj.

Situata tragjike, nëpër të cilën po kalon Çekosllovakia, kërkon trimëri e guxim. Këto nuk janë cilësi të tradhtarëve dhe të frikamanëve, por të revolucionarëve. Ç'bëjnë trimat çekosllovakë, marksistë-leninistët e vërtetë dhe klasa punëtore? Pse heshtin dhe lënë të kapardisen nëpër rrugë frikamanët dhe fashistët, të cilët po përdorin terrorin e bardhë dhe fabrikojnë situata të rënda që i çojnë njerëzit deri në vetëvrasje? Nga kush kanë frikë revolucionarët? Ata ndoshta duan të respektojnë «legalitetin» e partisë së tyre dhe ligjet e diktaturës së «proletariatit»? Por sot në Çekosllovakia, as legaliteti nuk ekziston, as partia dhe pushteti nuk janë më të revolucionarëve e të punëtorëve. Ato janë shndërruar në parti dhe në diktaturë të borgjezisë.

Komunistët dhe klasa punëtore ndërkombëtare kanë besim se revolucionarët dhe klasa punëtore e Çekosllovakisë do të dalin në rrugë dhe do të luftojnë për të mbrojtur interesat e popullit, socializmin dhe diktaturën e proletariatit. Në ditët vendimtare të shkurtit 1948, revolucionari proletar K. Gotvaldi lëshonte kushtrimin, drejtuar punëtorëve dhe gjithë punonjësve çekosllovakë: «Ju bëj thirrje të gjithë juve të jeni vigjilentë dhe në gatishmëri luftarake... Shtypni që në lindje çdo provokacion të agjentëve reaksionarë. Jini të bashkuar e të vendosur dhe e drejta juaj

do të fitojë». Në fushën e betejës do të dalin edhe Gotvaldë e Fuçikë të rinj, revolucionarë të talentuar dhe udhëheqës të shquar, që do t'u prijnë në betejë klasës punëtore dhe punonjësve çekoslllovakë për të shembur kalanë e kalbur të klikave të Novotnit dhe të Dubçekut. Kjo është rruga e vetme, e cila nuk çon ujë as në mullirin e revizionistëve sovjetikë, as të Dubçekut, as të imperialistëve, por u përgjigjet vetëm interesave të popullit çekoslllovak, interesave të socializmit dhe të revolucionit proletar botëror.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 96 (6135), 21 prill 1968

Botoket sipas librit: Enver Hoxha «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1968-1970», f. 97

L E N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 37-TË V-IX

1967

- PRODHIMI VARET KRYESISHT NGA FAKTORI NJERI, NGA DITURIA, ZOTËSIA DHE VENDOSMËRIA E TIJ – Fjala në takimin me kooperativistët e kooperativave bujqësore «Shkëndija» të Shtërmenit dhe asaj të Gostimës në rrethin e Elbasanit (3 nëntor 1967) 1-23
- LETËR DREJTUAR SHOKUT PAL VATA (9 nëntor 1967) 24-26
- NDRYSHIMI I STRUKTURËS SË BLEGTORISË KËRKON MASA TË STUDIUARA MIRË – Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (10 nëntor 1967) 27-33
- TË SJELLIM GJAK TË RI NË ORGANET E PUNËVE TË BRENDSHME – Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (11 nëntor 1967) 34-38
- TË ECIM KRAHAS ME VRULLIN E JEPËS, ME KËRKESAT E KOHËS – Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (11 nëntor 1967) 39-60

REVIZIONISTËT I DEMASKON LUFTA DHE QËND- RIMI I PATUNDUR I MARKSISTË-LENINISTËVE – Nga biseda me delegacionin e grave kineze (11 nën- tor 1967)	61–65
DEMAGOGJIA TITISTE NUK MUND T'I MBULOJË PLAGËT E HAPËTA TË KOSOVËS – Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (16 nëntor 1967)	66–84
LETËR DREJTUAR FAMILJES SË PJETËR LLESHIT (20 nëntor 1967)	85–86
SHEMBULLI YT KA RËNDËSI PËR TË GJITHË – Nga biseda me Fuat Çelën (23 nëntor 1967)	87–95
NJERËZIT E THJESHTË JANË NJERËZIT MË HE- ROIKË – Nga fjala në takimin me anëtarët e briga- dës vullnetare të rinisë «Mehmet Shpendi» dhe me patriotin Pal Vata, që punuan në ndërtimin e he- kurudhës Rrogozhinë-Fier (27 nëntor 1967)	96–109
TË KËRKOJMË QË PLANI TË REALIZOHET – Dis- kutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (1 dhjetor 1967)	110–113
AS DEMAGOGJIA DHE AS MBLEDHJA REVIZIO- NISTE NUK I SHPËTOJNË DOT RENEGATËT HRU- SHOVIANË NGA DISFATA E PLOTË – Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (3 dhjetor 1967)	114–124
PLENUMI I KOMITETIT TË PARTISË ËSHTË UDHËHEQJA KRYESORE E PARTISË NË RRETH – Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (4 dhjetor 1967)	125–136

KOMUNISTËT NË SHKOLLA DHE NË SEKTORËT E ARTIT, SI KUDO, TË JENË NË ROLIN PARAROJË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (4 dhjetor 1967)	137—143
TË BËJMË ÇDO SAKRIFICË EKONOMIKE PËR RRI-TJEN E MIRËQENIES SË POPULLIT — Fjala në Plenumin e 4-t të KQ të PPSH (12 dhjetor 1967)	144—159
NË PUNË E NË LUFTË NE DUHET TË MËSOHEMI TA ORGANIZOJMË PUNËN GJITHNJË E MË MIRË NË MËNYRË KRIJUESE — Fjala e mbajtur në Peshkopi, në mbledhjen e përbashkët të kuadrove të Partisë, të pushtetit dhe të organizatave shoqërore të rretheve të Dibrës dhe të Librazhdit (16 dhjetor 1967)	160—198
LETËR DREJTUAR FAMILJES SË TOSUN SHAHINASIT (21 dhjetor 1967)	199—201
PËRSE UDHËHEQJA REVIZIONISTE SOVJETIKE NGUL KËMBË PËR MBLEDHJEN NDËRKOMBËTARE — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (26 dhjetor 1967)	202—221

1968

T'I NGREMË ZONAT E THELLA NË NIVELIN E ZONAVE TË PËRPARUARA — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (10 janar 1968)	222—229
EDUKIMI IDEOLOGJIK I KUADROVE DHE I MASAVE — Fjala në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (13 janar 1968)	230—263
PARTIA REVOLUCIONARE I ÇON MASAT GJITHNJË PËRPARA NË REVOLUCION — Nga biseda me një delegacion të Partisë Komuniste (m-l) të Australisë (1 shkurt 1968)	264—279

- MBLEDHJA KUNDËRREVOLUCIONARE E BUDAPESTIT – NJË HAP I RI TRADHTAR I REVIZIONISTËVE HRUSHOVIANË – Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (21 shkurt 1968) 280–290
- PËR REVOLUCIONARIZIMIN E MËTEJSHËM TË SHKOLLËS SONË – Fjala në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (7 mars 1968) 291–343
- ANALIZAT MARKSISTE-LENINISTE TË PARTIVE KOMUNISTE DHE PUNËTORE JANË THESAR I MADH PËR LËVIZJEN KOMUNISTE BOTËRORE – Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (7 mars 1968) 344–367
- KARNAVALET E BUDAPESTIT – Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (15 mars 1968) 368–388
- PËR FORCIMIN E MËTEJSHËM TË BAZAVE TË SHKOLLËS SONË SOCIALISTE – Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (18 mars 1968) 389–394
- KLASA PUNËTORE NË VENDET REVIZIONISTE DUHET TË ZBRESË NË FUSHËN E BETEJËS DHE TË RIVENDOSË DIKTATURËN E PROLETARIATIT – Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (24 mars 1968) 395–431
- NJË KRIZË E THELLË E GJITHANSHME PO TRONDIT BOTËN KAPITALISTE – Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (31 mars 1968) 432–445
- STUDIMI NDIHMON PËR FORCIMIN E PËRBËRJES KLASORE TË PARTISË – Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (8 prill 1968) 446–452

ORGANIZATAT-BAZË TË PARTISË TË JENË KURDOHERË TË GJALLA, LUFTARAKE, VETËVEPRUESE – Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (8 prill 1968)	452–462
SHTIMI I PARTISË ME GJAK TË RI DHE QARKULLIMI I KUADROVE REVOLUCIONARIZOJNË PARTINË – Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (8 prill 1968)	463–468
KONTROLLI I KLASËS PUNËTORE – Fjala në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (9 prill 1968)	469–495
TË STUDIOJMË MUNDËSITË E NGRITJES SË OBJEKTEVE TË REJA INDUSTRIALE – Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (15 prill 1968)	496–500
ATA QË ZGJIDHEN TË RINJ NË FORUMET E PARTISË TË NDIHMOHEN QË TË AFTËSOHEN NË PUNËN DREJTUESE – Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (15 prill 1968)	501–507
TERRORIZIMI I POPULLSISË SHQIPTARE – POLITIKË E PËRHERSHME E KLIKËS TITISTE – Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (17 prill 1968)	508–512
KU PO SHKON ÇEKOSLLOVAKIA? – Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (21 prill 1968)	513–539